



FLORI BRUQI

NËSE
KAM
DITUR TË
GUXOJ

Poezi ... Kritika letrare në kohë...
Vështrime kritike mbi veprat... Letra

RUGOVA ART

FLORI BRUQI

NËSE KAM DITUR TË GUXOJ

/poezi...për krijimtarinë letrare e publicistike në kohë...
vështrime kritike...letra.../

RUGOVA ART
Prishtinë
2012

BIBLIOTEKA:

FENIKSI

REDAKTOR:

NAIM KELMENDI

RECENSENT:

ESHREF YMERI

DESIGN:

ÇAJUP KAJTAZI

SHTËPIA BOTUESE

RUGOVA ART

PRISHTINË

2012

FLORI BRUQI

NËSE KAM DITUR TË GUXOJ

/poezi...për krijimtarinë letrare e publicistike në kohë...
vështrime kritike...letra.../

RUGOVA ART
Prishtinë
2012

VEPËR VËSHTRIMESH KRITIKE DHE SHUMËSHITESIMESH LETRARE

(Nga fjala e redaktorit)

Libri më i ri publicistik i shkrimtarit, tashmë të mirënjohur, Flori Bruqit, na vjen si një sihariç i mirë letrar. Libri me titull shumë sinjifikativ “Nëse kam ditur të guxoj”, përmbanë një lëndë të pasur në shumë aspekte letrare. Meqë kapitulli i parë përmbanë një cikël poezish të autorit, kapitulli i dytë hap një faqe interesante me shkrimet kritike nga autorë të ndryshëm e të mirënjohur shqiptarë, pra vlerësime kritike e vështrime për disa nga veprat letrare të Bruqit, por të publikuara më parë në shtypin shqiptar të kohës. Autori Bruqi i ka sistemuar këto shkrime, që përbëjnë një sërë vlerësimesh të çmueshme letrare për krijimtarinë e tij letrare, poetike, e publicistike, por edhe për ato botime të fushës profesionale të Flori Bruqit, nga emra tashmë të ndjerë, por mjaft të shquar, si Mehmet Kajtazi, Rifat Kukaj, Zejnullah Halili, Iljaz Prokshi e ndonjë tjetër. Por, edhe nga emra po aq të mirënjohur të letërsisë sonë, të gjallë, janë përmbledhur këtu mjaft vështrime që cilësojnë e vlerësojnë veprën e Flori Bruqit, sikur janë: Fatmir Terziu, Bedri Halimi, Lumturie Haxhiaj, Shyqri Galica, Namik Shehu, Izet Çuli, Zef Pergega, Kristaq Shabani, Naim Kelmendi, Rajmonda Maleçka, Eshref Ymeri, Rushit Ramabaja, Abdullah Konushevc, Rustem Geci, Nehat S.Hoxha, Ajshe Qorraj, Arlinda Meksi, Shpend Ruci, Arian Blushi, Nikollë Frangaj, Faik Xhani e ndonjë tjetër. Do theksuar se në të gjitha shkrimet dhe vështrimet kritike mbi veprat letrare të Bruqit, qofshin ato vështrime të mëdha apo të vogla, ndonjëherë si njoftime mbi librat e publikuar nëpër kohë, të Bruqit, qoftë si vështrime më të gjata, cilësohet e vlerësohet krijimtari letrare e Flori Bruqit, dhënë lëtersisë sonë më të re, duke bërë kështu emër në letërsinë moderne.

Ja si do të shprehej atëbotë shkrimtari i mirënjohur yni, Mehmet Kajtazi, në një vështrim të tijin për poezinë e Floriut: “Temat që ngërthehen në këto vargje nuk burojnë nga inspirimet, që i marrin disa poetë nga librat që i lexojnë, por Flori Bruqi inspirimet i merr nga jeta. Ato nuk mbesin vetëm inspirime, por dalin nga kornizat e një gjirme të thellë dhe si valëzat e detit të shqetësuar afrohen drejt

brigjeve, por edhe kthehen në suprinën e largët të detit me emrin nënë, me emrin martirizim, me emrin LIRI”. Apo në një rast tjetër njëri nga shkrimtarët tanë të shquar, Zejnullah Hallili, shprehet kaq reflektueshëm: “Flori Bruqi po hyn nëpër një shteg të ndritshëm në poezinë shqipe. Figura e tij në fillim të kësaj poeme na sjell shqetësime të shumta që lidhen me Tokën, me Nënë, me Gjakun, me Vallen e Shkrepare, me Baladën e Yjve, me Lotin që ka Ogur, me Zërin me Frushullimën e Krahëve, me Akuairelin e Diellit, me Lumin e Bardhë. Secili varg vendoset në patosin e kësaj Luleje. Secila poezi ka gjethin e Vet, Dritën, shqetësimin dhe besimin, andejza, matanë errësirës, pra, ai këto frymëzime i zë nga jeta, sepse e nxit Bardhësia e katër vargjeve, figura e saj, shpirti shqetësues, Fjala”.

Në kapitullin e tretë mbarështrohet një lëndë po aq e pasur dhe e thekur letrare e autorit mbi veprat dhe mbi jetën e shumë autorëve botërorë e shqiptarë, sipas këndvështrimit dhe shijes dhe dioptrisë krijuese të studiuesit Bruqi. Flori Bruqi këtu spikat me vështrimet e tij të thukta dhe përmbajtësore, me një metodologji klasike të vështrimit: ai shkruan mbi veprën e autorit, jep mjaft shënime biografike dhe shtjellon motivet e veprës së tyre, por edhe klasifikon ndonjë nga poezitë apo prozën apo shkrimin e akëcilit që merr në theks të vështrimit.

Në të gjitha këto vështrime kritike vërehet përkushtimi dhe niveli studimor i autorit me një bagazh të mirë studimor mbi veprat dhe autorët. Poashtu autori, në secilin vështrim jep edhe të dhëna të shumta mbi veprat e autorëve, që përbëjnë opusin krijues të tyre, si informacion të plotë për lexuesin. Janë një sërë artikujsh kritikë e publicistikë edhe për figurat e jetës sonë letrare, por edhe politike e publicistike, sikur artikulli për dr. Ibrahim Rugovën, ku Bruqi qëmton me këndvështrimet e tija, duke na sjellë përshkrime dhe vlerësime për figurën madhore e komplekse të presidentit historik Ibrahim Rugova, por edhe për veprën e tij letrare dhe kritike që është mjaft e bujshme. Gjithashtu me interes janë edhe mjaft shkrime të kësaj natyre, siç janë p.sh shkrimet për Nënë Terezën-nderin e kombit shqiptar, pastaj vështrimet kritike për figurat letrare si për Eqrem Çabejn, Ernest Koliqin, Martin Camajn, Azem Shkrelin, Ismail Kadarenë, Prend Buzhala, Naim Kelmendin, Bardh Frangun, dhe poetë të gjeneratës më të re të postmodernes, sikur Irena Gjoni, Ledianë Kapaj, Alma Papamihali, Keidi Sejдини, Thani Naqo, Jorgo Sofokli Telo, Valdete Berisha e ndonjë tjetër.

Ato që përbëjnë gamën e gjerë të vështrimeve dhe temave sintetizuese, por edhe tematike, janë disa nga shkrimet që zënë vend në këtë vepër, si “Shkrim-

tari idealist shqiptar gjatë shekullit XX”, “Kritita tani ngjanë në një digë të shpartalluar, që i varen Illamarinat nga erërat e fitimit”, ”Spastrimi etnik në Kosovë”, ”Shqiptarët në shtypin arab”, ”Historik i shkurtër i gjuhës shqipe” etj. Me një fjalë, vepra letrare e Flori Bruqit: “Nëse kam ditur të guxoj”, përbën një aureolë pikëvështrimesh të qëmtuara letrare mbi veprat e shumë autorëve të shquar, vendas e ndërkombëtarë, por edhe ato mbi veprën autoriale të këtij shkrimtari, tashmë të njohur në letrat tona, me kontributin e shumë veprave cilësore letrare, poetike e publicistike, që zënë vend të merituar në “Panteonin” e letërsisë shqiptare.

NJË PERSONALITET I SHQUAR I KULTURËS SHQIPTARE

Libri më i fundit, i autorit Flori Bruqi, me titull “Nëse kam ditur të guxoj”, është një tjetër dhuratë e çmuar, që ai i bën masës së gjerë të lexuesve, në kuadrin e korpusit të veprave të tij të begata, duke filluar që nga ato artistike, deri te veprat shkencore, kritike dhe publicistike. Libri hapet me një shënim kritik të poetit, shkrimtarit dhe publicistit të talentuar Naim Kelmendi, i cili është edhe redaktor i tij. Paskëtaj vazhdon një cikël poetik i autorit, që shërben si “tahta mbi kadife”, apo, thënë ndryshe, “si qershia mbi bakllava”.

Krijimtaria poetike e Flori Bruqit, sipas këndvështrimit tim, përfaqëson gulshet e shpirtit të një krijuesi thellësisht lirik, që për asnjë çast nuk gjen qetësi. Është bota e një krijuesi me frymëzim të hyjnishtëm, i cili në qendër të universit të vet poetik, ka vendosur njeriun shqiptar. Përmes plazmimit të karakterit shqiptar, del në pah individualiteti i tij i papërsëritshëm. Krijimtaria e këtij autori është edhe rezultat, edhe proces. Rezultati duket në çdo sekondë të shfaqjes së tij në vargun poetik, kurse procesi vihet re në shpalosjen e botës së tij të brendshme, si shëmbëllesë fort e virtytshme. Pikërisht kështu vjen e ravijëzohet para lexuesit teknologjia e plazmimit të shpirtit poetik të poetit, madje edhe kur trajton një problem të karakterit shkencor apo publicistik. Ky plazmim ka kaluar përmes mohimit të gjithçkaje të dëmshme, që mund ta infektonte në kushtet e një mjedisit amtar, por që ligjin në të e bënte një pushtues i huaj. Në një mjedis të tillë, madje rreziku i infektimit shpirtëror bëhej më kërcënues prej bashkatdhetarit që qe vënë në shërbim të të huajit. Pikërisht në këto kushte poeti i është kthyer vetvetes, për të dëgjuar tërë sy e vesh mendimet, ndjenjat dhe dëshirat e veta.

Me një çiltërsi befasuese, ai krijon në vargjet e veta një botë psikologjike dhe intelektuale të njeriut në të përpjetat dhe në tatëpjetat e jetës së përditshme.

Në poezinë me titull “Ç’rëndësi kishte e ka gjithçka?!”, lexojme këto vargje:

Është tre pasdite,

gjithçka kundërmon vdekje...

E di, është e kotë të kthehem në shtëpi,

të shkruaj dhjetë apo tridhjetë e pesë rreshta,

Ç’rëndësi ka?!

Nga këto vargje, herë-herë të krijohet përshtypja se poetin e ka kapluar një ndjenjë pesimizmi të pashpresë, a thua se ai po e kundron botën përmes një

lenteje erratake. Por kjo është një përshtypje e rreme. E vërteta nuk është kështu.

Filozofi gjerman Shopenhauer (Arthur Schopenhauer - 1788-1860), në veprën e tij me titull “Aforizma të urtësisë jetësore”, thotë: “...kush e shikon gjithçka në një dritë të errët dhe është i përgatitur për më të keqen, ai gabon më rrallë në parashikimet e veta, sesa njeriu që e shikon jetën si fushë me lule në ngjyrë trëndafili”.

Pra, poeti i virtutshëm dhe largpamës për ta ndryshuar realitetin që e rrethon, ai, si interpretues artistik i tij, nuk mund ta shikojë atë përmes ngjyrave të trëndafilin. Ngjyra e trëndafilin është ngjyra e romantikës dhe e optimizmit. Mund të paramendohet se atë e parapëlqejnë njerëz jo shumë të përgjegjshëm, të cilët detyrat e veta kanë qejf t’ua lënë përsipër të tjerëve. Patosi i lirikës së poetit ka për qëllim t’i heq petkun “së keqes” së jetës së përditshme. Këtu kemi të bëjmë me një akuzë që poeti ngre kundër realitetit të shëmtuar social që shpërfytyron gjithçka njerëzore dhe e shtyn njeriun drejt vetmisë vrastare. Përtej këtij realiteti pret fati dramatik njerëzor, i shoqëruar me dhembje dhe vuajtje shpirtërore.

Në poezinë me titull “Fillimi i një poeme” lexojmë:

Nëpër deje na rridhte Revolucioni dhe qumështi i nënave

Dhe ne e dinim:

Pa nëna dëshmorësh,

Pa gra e nuse të veja

S’do të ketë kurrë paqe e liri...

Këto janë vargje të një poeti që shikon përtej maleve të mugëtirës që ka endur tejndanë një pushtues i huaj. Ato të kujtojnë mitin për Josifin biblik, i cili e paralajmëroi faraonin, përmes një këshille profetike, se si duhej ta shpëtonte Egjiptin nga zija e bukës, që do ta pllakoste pas shtatë vjetësh: vetëm me kursimin e drithit. Dhe poeti për ta shpëtuar vendin nga zija e robërisë, që ka mbjellë pushtuesi i huaj, e paralajmëron popullin e vet, duke ia thënë të katër të vërtetat në sy: liria nuk fitohet pa gjak. Kosovës do t’i duhet të sakrifikojë jo pak djelmosha në altarin e lirisë.

Në këtë vepër shkrimtari ka përmbledhur mjaft shënime kritike autorësh të ndryshëm, të cilët kanë bërë vlerësime fort objektive për veprat e tij artistike dhe të fushave të tjera të dijës. I lexova me shumë kujdes. Artikujt kritikë të tij, kushtuar krijimtarisë së autorëve bashkëkombas dhe të huaj, përbëjnë një thesar të vërtetë të mendimit kritik shqiptar. Si poet, si shkrimtar, si shkencëtar, si kritik letrar, Flori Bruqi përfaqëson majat e mendjes së ndritur të kombit shqiptar. Përgatitja e tij erudite, analizat e tij shumëpërmasore, formimi i tij nacionalist, e radhisin atë në plejadën e njerëzve më të shquar të kombit shqiptar. Mendoj

se ai ka nxjerrë dhe vazhdon të nxjerrë nga pena e tij e begatë vepra me vlera të jashtëzakonshme njohëse. Por këtu duhet theksuar se vlera e një vepre, e çfarëdo gjinie qoftë ajo, varet nga një kompleks i tërë përbërësish të suksesit të saj. Ndër këta përbërës të veprës tërësore të tij mund të rradhësim frymën aktuale të saj, peshën që ajo mbart për bashkëkohësit dhe breznitë që do të vijnë, moralin që përcjell, vlerën mbarënjerezore, mesazhin humanist që e përshkon në çdo pore të saj, vërtetësinë e fakteve që shtjellon, natyrën universale të perceptimit të realitetit që na rrethon, zgjedhjen e qëlluar të kompozicionit, stilin original, kulturën e përgjithshme të autorit, pasurinë leksikore të veprës, karakterin origjinal të temës së shtjelluar dhe të idesë që e përshkon tej e ndanë, theksimin e nocioneve më të rëndësishme në jetën mbarënjerezore dhe përzgjedhjen e vlerave më të spikatura të breznive të kaluara. Mund të thuhet pa drojë se natyra unikale e një vepre, e çfarëdo gjinie qoftë, përcaktohet drejtpërsëdrejti pikërisht nga një raport në dukje i pakapshëm dhe kompleks i të gjithë përbërësve të lartpërmendur. Por, sukcesi i veprës së këtij autori varet edhe nga diçka tjetër: varet pikërisht nga aftësia e tij për t'i dhënë në dorë lexuesit një të tillë libër, gjatë leximit të të cilit, ai ta perceptojë atë që është shkruar si një figurë të kundruar me sy. Pikërisht këtu qëndron magjia e talentit të tij. Dihet nga të gjithë se videofigurat kanë vlera shumë më tepër informative, sesa një tekst i shkruar, një tingull i ëmbël muzikor, një ndjesi e përjetuar apo një aromë dehëse. Videoinformacioni regjistrohët më lehtë dhe ruhet shumë gjatë në kujtesë. Në këtë rast çdokush merr një informacion të pamatë në formën e figurave që ka para syve drejtpërsëdrejti. Dhe autori, si një krijues me shije të hollë, që është në gjendje që figura të tilla të veprës së shkruar t'ia përcjellë lexuesit sikur ato të ishin videoinformacione, nuk mund të vlerësohet ndryshe, veçse si një krijues bukur i suksesshëm, boll i lexueshëm, pra, si një krijues tejet i talentuar.

Me krijimtarinë e vet mjaft të pasur në shumë fusha të dijes, autori ka arritur t'i gdhend vetes një lapidar me themele të thella në tokën amtare dhe të shëndosha deri në admirim. Dhe këtë e ka arritur duke ndjekur dy shtigje të thikta.

Së pari, ai ka qenë i vetëdijësuar për mundësitë dhe dëshirat e pashtershme që preheshin brenda personalitetit të tij krijues, të cilat e kanë frymëzuar për t'u bërë dikushi në jetë.

Së dyti, vullneti dhe përpjekjet e pandalshme e kanë nxitur për arritjen e një objektivi që ai i ka vënë vetes dhe që është konkretizuar me botimin e morisë së veprave të tij. Pra, dashurinë për punën, shkrimtari e ka ngritur në kult.

Volteri thotë: “Puna na shpëton nga tri të keqija të mëdha: nga mërzia, nga vesi dhe nga hallet ekonomike”.

Artin e dashurisë për punën, që zbulohet në këtë thënie filozofike volteriane,

autori Flori Bruqi, ka arritur ta përvetësojë deri në përsosmëri. Prandaj, edhe në këtë vepër të re, që po ua përcjell lexuesve, ai shfaqet para tyre si një krijues me zemër të madhe, përherë i palodhur në fushën e dijes.

Prof.dr. Eshref Ymeri
Santa Barbara, Kaliforni
22 shtator 2011

CIKËL POETIK

FILLIMI I NJË POEME

Ujëvarat e malit derdheshin
Mbi shkëmbinj si mendimet
tona mbi ngjarje, mbi shtigje...
Nga t'ia fillonim?!
Nga plagët e trupit, të zemrës, apo të mëmëdheut ?
Nëpër deje na rridhte Revolucioni dhe qumështi i nënave
Dhe ne-e dinim:
Pa nëna dëshmorësh,
Pa gra e nuse të veja
S'do të ketë kurrë paqë e liri...

E sot,
Këngët,
Vallet-
e fabrikat
janë gjerdane
më stolira
të kremtës tonë!

Maj 1982

PORTRETI I NËNËS

*“Nënë, për ta shpëtuar jetën Ty,
dhashë lëkurën e do ta jepja edhe shpirtin”
Prof.dr.sci.Mirlin (Maxhun) Bruqi*

Nga qytetet e fshatrat e largëta vijnë
Banorë(të përkohshëm)në Prishtinë
Pleq
Plaka
Të reja
Të rinj
Me shporta të vogla në duar

Vijnë çdo të diel
Vijnë(ndoshta)çdo ditë
Te dera e Spitalit
Në orën 14

Gumëzhijnë korridoret
Nga hapat e tyre
Zhurmojnë pavijonet
Korridoreve...
Zvarritët rrëqanthi vdekja
Në dhoma hyn shqetësimi
Secili me de(r)t
Për të afërmin e vet
Kështu çdo të diel
Kështu çdo ditë
Në orën 14
Burbuqja kurajon Nënë
Mirlindi jep lëkurën e vet
Për ri(ngjalljen)e Saj
Të afërmit shërim i dëshirojnë
Të tjerët shpresojnë...

Ja dhoma...
Ora mbi radio
Trëndafilat e freskët
Mbi tavolinë
Tok(gati) e gjithë familja
Babai qëndron e mejton
Ndoshta...
Kujton profilin e dhëndrrit
Ja rrudhat e nënës sime
(Kujtoj zënkën e prindërve për mua)
Tik-taku i orës
Dikur pushon
Në orën 4 të mëngjesit
Një qetësi...

Unë
Kam parasysh
Profilin e fëmijëve të mi
Shoh në sy
Profilin e Granitit e Diamantit
Mullarët e sanës
Në oborrin e braktisur
Ja(gati) e gjithë familja
Mungon(vetëm fizikisht)Ajo
Mungon Nëna ime

Në dhoma hyn:

Ajri
Drita
Dashuria
Jeta
Shokët
Shoqet
Babai
Të dashurit....

Dhe një hije
Më ndjek pas
Shkëndijë kohe
Profil i Nënës
Zjarr i Diellit!

RREZE DRITE

(Në kujtim të nënës)

Për Ty nga zemra
këtë poezi po e rris
asnjë hije muzgu
nuk i fus brenda
ti kërkon dritë
se ishe dritë
siç janë dritë
të gjitha nënat
vije Ti
çdo mbrëmje
duke më pëshpëritur:
-natën e mirë bir
çelësin mos ia vë derës
do të vijë nëna
(gjumin pa ta prishur)
me hapa të pranverës
biro
të të shoh mos je shpluar
kur ike
unë të putha
a thua më ke ndjerë
ndoshta vetëm koha
si rreze drite
në mua t'paska mbetur
këtë poezi Nënë
nga zemra e shkrova
dhe hije azhuri
s'i futa brenda
ti kërkon dritë
se ishe Dritë
siç janë Drita
të gjitha Nënat.

LAJTMOTIV I SINQERTË

U këndoj të thjeshtave
të urtave
fjalës së dashur
dritës së qartë
të gjitha ëndrrave
më lajtmotiv të sinqertë
të gjitha këngëve
përherë me kryerresht
femrave -
ejani në këngë
nëna dhe motra
të dashura gra
hyni në këngë
ne lindëm nga këngët Tuaja
nga zëri Juaj
morëm këmbë.

LIRI FJALE

Në ditën e takimit më fole
me zë tjetër
dhe unë çuditërisht prapë erdha
nga zemra të të shoh e të puthi
si Dielli kopshtin me lule
përse qe aq e ashpër
mos vallë në qytetin tënd ilirik të ndjekin
qentë e tërbuar
ndonjë hije nate
apo do të mbetesh
e mbyllur sall për vete
arti nuk të do të vetmuar
as muzikë s'mund të ndjesh
një buzëqeshje do të kërkoj prore
dhe karafila do të dhuroj
e puthje të ngrohta
mos hesht as mos ik luleborë
sigurisht ti ke për t'qeshur një ditë
dhe lufta mes unit tënd e urrejtjes
do të çmend ty të tërën
vetëm jam dhe pres të vish...

QYTETI KU TË PRITA

U ndala ballë spitalit të Prishtinës
hipa si Orfeu në altar
dy vargje të t'i them
më zërin e shterrur nga shqetësimi
dhe unë e pashë qytetin tënd
me një dallëndyshe fola, me beso
dhe ikëm të dytë e më tepër ike ti
unë prapë jam aty ku më ke lënë
në sallën e kuqe të Pallatit të Rinisë
vallëzoi me hijet
nuk e di cilën ta përkëdhel
ti nuk je
retë mbi qytet më nevrikosin
dhe shiu më lag bashkë me vargjet
një ditë në një orë dil e takohemi
kiamet nuk bëhet
nuk bëhet as qyteti det
i mërziur rri, i fyer jam
pres dashurinë tënde
e të fle mbi gjinjtë e tu
mbi buzët e tua të zë një ëndërr
të kërkoj t'i ha ata sy me vargje
po vargjet nuk kanë faj
që ti nuk i ndjen asnjë grimë
mos ik mos u fsheh e as zërin mos e ndërro!...

AKUARELI I DIELLIT

Iku tetëmbëdhjetë vjeçare
E bukur S...
Si hëna pesëmbëdhjetë
Në fletore shkroi vjershën
Për mëngjesin në Prishtinë
I pëlqyen soliterët e lartë
Dhe shtëpitë plot blozë
Tjegullat e çative të ulta
Me myshqe të venitura
Shtegu i fushës kujtonte nënën
Më këmbë t' amputuar
Dhe Agimin e madh pas shiut
Që lëkundin pemët në zgavra
Në Prishtinë..
Ajo me gishtin tregues vizatoi
Në xhamat e atelesë
Profilin e babait plak-Metë
Pastaj e fshiu me dorë
Dhe dorën e puthi
Kur u kthye në vendlindje
Vuri pëlhurën pas një karroje me sanë
Në kalldrëm...
Dhe vizatoi dridhshëm
një rrugicë fshati në muzg
Në agimin e azhurtë
Hapi dritaren e rrotulloi çuditshëm
Lindjen e Diellit
Hijet në vetminë e rrugës
Dallëndyshet, një pikë vesë
Në mbrëmjen e majit
Ngriti penelin
Dhe e ngjeu në Akuarelin e Hënës
Pikturoi rrugën
Me baltë të Strellcit
Durakun plak
Kopshtet me dardhë

Fshatarët e vyer
Me drapërinj në duar
Shtëpi me dyer të rënda
Strehë me borë
Hapësira bojë gushëpëllumbi
Nga fshatrat malorë...

MENDIM I KREDHUR

Shpirti i Saj
Një lëndinë Qershori
Selvitë ndanë rrugës
Trupin e saj imitojnë
E dua atë
Era viteve
Buzët do t'ia vyshkë
Reliefin e kuq të mollëzave
Vizat e rudhave do t'ia prishin
Por
Megjithatë e dua
Sot
Kur me të jam i dritëzuar
Në shpirtin e përjetshëm
Jam i rrethuar edhe më njomësi
Edhe me rrudha
Nga pranvera e syve
Margaritarë të Saj.

REKUIEM I PËRLIGJUR

Prej gjakut e zemrës s'mund të dalë
siç u dogjën të tjerët s'dua të digjem
ç'donin ziliqarët në kopshtin e Edenit
mollën e Eridës në dorë që më lanë

ditë pas dite prej zemërimit të përligjur
nga trishtimi
Zeusi s'e fal Prometeun
pa ia treguar fshehurisht intrigën

dashuritë digjen e përvëlohen
sa fort
brenda çdo ëndrre vuan zemra vetë

udhë u deshën që djajtë të risjellin
poshtërimin e zbritur nga Olimpi i lartë
të lënë shtrëngatën... e të vrasë njerëzinë

edhe lotët kur djegin shpirtin së brendshmi
më ngjan se më hiqet i rëndi mallëngjim
një këngë ilirishte përftohet fshehtësire
e vjen një kohë letargjie me gjëmim

SHPRESA TË DJEGURA

Me çantë mbi shpinë të mbushur plot mall
rrëzë supi rripat e saj fort të shtrënguar
të rrezikuar frikshëm endeni nëpër vargmale
nëpër dhëmbë fatziun fajtor duke mallkuar

Shikimi i nënëmadhes si shqiponjë pas e ndjek
klithma djemsh mbetur ikona nëpër pragje
një dashuri e braktisur shpirtin tuaj e djeg
lot që mundin burrërinë e shkasin mbi faqe

Gra zemërngrira presin në ankth zhytur
veten mallkojnë që nëna s'i bëri dot djalë
motra kërthinj prej trishtimit të mbytur
dhimbje e pamatur që gjunjëzon dhe djajtë

Mërgim mëkatar, mijëra varre bosh ke lënë ti
nënat kobzeza, që s'kanë një gur ku të qajnë
vejusha të pafat ngado mbjellë si tulipanë të zinj
fëmijë që prindërit në prehër dot s'i mbajnë

Emigrant, fjalë mizore që s'di të falësh kurrë
dete lotësh mbush e mallin kudo ti e mbjell
zemra nënash me gozhdë mbërthyer në mur kujtimi
përcaktor njerëzish që tonelata dhimbjesh sjell...!
në shpresat e djegura vret dhe qan trishtimi...

Ç'RËNDËSI KISHTE E KA GJITHÇKA?!

Pensionistët flasin
për infarkt miokardi
e parashikon fundin
në stolat e parqeve publike
mes glasave të sorrave
mes gjilpërave të përgjakura...

Më ndalin në rrugë
përpara vitrinave të mbushura
xhepat e zbrazur të tyre më pyesin për orën
apo për racën e majmunit
Është tre pasdite
gjithçka kundërmon vdekje...
E di, është e kotë të kthehem në shtëpi
të shkruaj dhjetë apo tridhjetë e pesë rreshta
Ç'rëndësi ka?!

Poeti në komisariat
ata nuk e dinë
se poeti në komisariat
është torturuar
për mëkatën e bërë:
„Fjalës i kishte dhënë shumë fuqi...”
Fjala vriste më shumë se shpata
fjala shëronte më shumë se mjalta...
Poetit i duhej dhënë kupa e helmit
të shpejtë apo të ngadalshëm
Ç'rëndësi ka?!

Një libër tjetër
Herët në mëngjes
një vashë rregullon flokët
përpara pasqyrës
në ndërtesën përballë...
Unë mbyll librin „Guximi shqiptar”
e lë mbi tavolinë
ulem dhe hap
një libër tjetër.

Intriganti dhe gazetat
Sa të mërzitshëm janë
Intriganti ,”Ekspressi”, birra e Pejës
femrat, librat, pasqyrat!...
Sa e mërzitshme
është të ulesh e të presësh vdekjen
në ndërkohë
njerëzia kurvëron,
ha, punon apo bën plazh në det
nën diellin e pistë të kotësisë
dhe nuk e di
a do të ndodh gjë,
po nëse ndodh
ç’rëndësi ka?!

Ishte dhembja
Para dy vjetësh
Poeti Iljaz Prokshi thoshte
në një poemë
se nuk do të ndalonte së ndjeri
dhimbjen e pritjes
së një gruaje
sepse e vetmja gjë
që do t’i mbetej prej saj
ishte dhimbja
Ishte kohë tjetër
Iljazi, është i vdekur
edhe dashuria e tij poashtu
edhe ne do të jemi një ditë...
Jeta qenka një përpëlitje
në mes të hapjes e mbylljes
së syve.
Iljazi gjithmonë donte të rrinte
po nuk e kishte mundësinë
se i frikësohej vetmisë
kur të varet me puthje në buzë...
Ç’rëndësi kishte e ka gjithçka
kur jetën e plagos çdo gjë?!

MBI NGJARJE...

Ujëvaret e mia
Derdheshin mbi shkëmbinj
Si mendimet tona
Mbi ngjarje mbi shtigje

Nga t'ia fillonim
Nga plagët e trupit
Të zemrës apo të atdheut
Si gjithmonë
Populli ndodhej pranë
Nëpër dej
Na rridhte qumështi i nënave
Dhe e dinim
Pa nëna dëshmorësh,
Pa gra
Pa nuse të veja
S'do të ketë kurrë
Paqe as liri.

BARDHËSITË E SAJ

Nënë
Këto katër shkronja Dashurie...
Jehojnë
Në agimet e jetës sime
Në bardhësitë e dritës
Më shtegun e së ardhmes
Ne ecëm
Përpara

Figura jote
Në sfondin e ditëve
Që vijnë
Njomësia
E së ardhmes sonë
Hapë
Dejtë e ngrohtë
Të tokës sate.

RRJEDHAT E KOSOVËS

Atdhe

T'u desh të afrohesh

Nga thellësitë e viteve

Deri te kjo kohë

Me dyfek e gjalmë

Që kurrë s'qenë të ftohta, t'u desh

Të vishë

Në këto male pranë

Në këtë baltë

Në këtë Tokë

Dhe të dilje

Ti kështu si je

T'u desh

Flakë vullkani

Atdhe

Po zbardh sot mëngjesi

Flamur të kuq

Shkaba dykrenëshe lart

Frymëzim i ri

Në zemrat e sizifëve në buzëqeshjet e triumfuesve

Në përparsat e shpirthirshmëve

Në çdo fabrikë

Uzinë

Faqe mali

Madhështore

Do të duhej të buçiste

Emrat Ibrahim, Adem, Luan, Shkëlzen, Agim,

Salih, Rustem, Ramush...

Kënga e vështrimeve të ndezura

Me fjalët

Zotim

Gdhendës mermeri

Sypatrembur

Duke u futur

Me krahëroret masivë

Në rreshtat e mëdhenj

Të detit tekanjoz.

RELIKTET TONA

(Pa Kosovën unë nuk do të isha)

Shfletojmë historinë
Rreshta të shkruar
Me gjak
Nëpër faqe
Gjurmët tona shfaqen
Herë breshëritë nxijnë
Arat me misër kudo që ishin
Ngjanin në varreza të Mëdha
Kur rritej vdekja
Ku binin gjethe të rrëkëlyera
Më të freskëta
Se zambakët e majit
Mani i kombajnës
Thasët mbush
Misër e grurë
Në këtë Dhe
Tash e tutje
Gjumi do të oshëtijë
Nga përrenjtë e Ëndrrave
E paepur
Kjo ishte rruga jote
Ndërmjet njerëzve
Me njerëz
Dhe butonët
E dritës.

AGIMET E KOSOVËS

Çerekshekujt
Në kurriz të maleve
Lanë gjurmët e kanoneve
E Ti
Kosovë
U dole para
AGIMËVE TË MËDHA
Kur trolli me nofullat e veta

Kafshonte BIJTË E SAJ
Kosovë
U dole përpara relikteve'
Qindvjetëshe
Kur Trolli pinte gjak
Përtypte barot
Fashatonte plagën
Dhe pashë
Mes atij
Ingranazhi
Yje
Dhe nën Yje
Togun e pusirave
Amësinë Tënde
Sfidojmë
Të bartim
Si një Agim mbi mal
Duke t'i fshirë me Yje
Muzgjet e hijeve
Vezullim urojmë
Brezave që vijnë
Me tepëritë e zellit
Në cepat e Yjeve.

GJAK SHEKULLOR

Mëmëdheu
Lëshoi një britmë
Një zjarr
Si lumi si era si gjaku
Mërsini shpërtheu te praku

Të dua o hyjneshë e Agimit
Me Heliosin e Apolonin
Me vajtje-ardhjet
Me duart
E forta

Të bashkëfshatarëve
Të bashkuara përgjithmonë
Në shpresën ndjellamirë
Eliksirin
Unë-
Ndjej në shpirt
Se biri yt
Unë jam
Frymëzimin tënd
Borxh e kam
Ç'përqaje të sjell
Në qepalla
Gjysmë të mbyllura
Këngët shpesh t'i mbjell
Me besë e shpresë
Për të ardhmen tonë.

THEM SE ËSHTË ZBRAZËSI

Edhe ky qiell i huaj sonte...
më trishton me sy vetmie,
prandaj dua brenda një gote
të shuaj trishtime largësie...

Mbi duar shikoj si në magji
si rrëshqet pikëza e lotit,
ajo ikën në fund të gotës,
rrokulliset si era e motit...

Dua gota ime të përmbysset,
të thyhet përtokë e zbrazët...
Dëgjoj zemrën që më dridhet,
ngre kryet nga yjet e largët...

Mbi trupin tim gjithçka ndahet
dëgjoj, tingulli nuk bie si dikur,
një dorë e ndarë diku zgjatet,

një këmbë më ecën e këputur...

Shpirti thërret fatin e shtrembër,
dua të më shikosh drejt, po ktheu!
Mos vallë jam në ndonjë ëndërr
ndoshta, kupa e mallit më dehu...

Në këtë botë gjithçka gjykohet,
edhe një i lot i derdhur kot fare!...
Më shumë se kurrë kuptohet,
kjo klithma jonë shumëvjeçare...

Mjerimi sërish shpalos flamujt,
mbi varfërimin e shpirtin njerëzor,
thërret gjithkund shtatoret e bruzta,
jetimët barktharë të shekullit të vonë.

Nuk është risi, po kthim i pamjes së rëndë
në kohën e perënduar që kemi zgjedhur,
u kthye prapë për t'i trandë hipokrizitë...
me premtimet nëpër plehra hedhur.

Shpresa më thotë se po shpresoj kot,
e mali ngërdheshet nga larg me zili...
duart kullojnë gjak të përzier me lot
nga prangat e kohës vrastare pa drejtësi.

Lutjet kafshohen dhe shiten në altar,
zotni, sa do, sa të bën haku i vështirë?
Më prit ore, të bëjmë një herë pazar!
Dhe vrava për të fundit herë vargun e lirë....

**KRITIKË LETRARE
NË SHYPIPI E KOHËS...**

FATI I GAZETARËVE NË SISTEMIN MONIST

Mehmet Kajtazi

Romani “Ndërgjegjja” është një pasqyrim real i lidhshmërisë së prozës artistike me shkencën e mjekësisë. Derisa në prozë artistike, shpaloset biografia e vetë autorit, në pjesën e librit shkencor dhe informativ shprehet respekti i tij ndaj tërë asaj që është njerëzore dhe hapërim për t’i shëruar njerëzit. Autori në këtë vepër është në cilësinë e gazetarit në sistemin komunist, kohë kjo kur për një të vërtetë jetike të shkonte edhe koka. Pavarësisht nga kjo mynxyrë, gazetari më shumë e do të vërtetën se edhe vetë jetën, andaj shpesh atij i vihen prangat. Në shërbim të atyre që i kishin prangat dhe çelësat e burgjeve ishin edhe disa gazetarë servilë, të cilët të vërtetën e mbulonin me gënjeshtër dhe vinin xëc para syve të lexuesve. Autori i “Ndërgjegjes” ua di emrat atyre, ua njih edhe biografitë, por nuk bie në ujëra të tyre të turbullta, nuk është hakmarrës. Mjafton që ata, shkruan autori, do të jenë njerëz që i bren ndërgjegjja, ndërsa po patën punë me shëndetin, do t’i shërojnë, edhe gangrenën do t’ua heq, thotë autori. Fati i gazetarëve të sistemit titist ishte përherë tragjik: kur u vinte vdekja nuk meritonin tjetër, pos t’u vihet mbi varr një kurorë e bërë jo nga lulet, por nga artikujt gazetaresk që i kanë shkruar. Gazetarët e tillë e kanë penguar vazhdimisht Flori Bruqin, por ky kishte një besim të patundur, në rradhë të parë, vetveten, andaj trokiste edhe në redaksitë e shteteve të largëta, deri në “Le Monde” të Parisit dhe shkruante në këtë gazetë për njerëzit që ishin në burgje, e ishin të pafajshëm. Këtë mund ta bënte vetëm gazetari militant. Duke lexuar “Ndërgjegjen” e tij, herë-herë, ke përshtypjen se po e sheh Markezin, që ka hyrë në zonat që i ka prekur murtaja, por forca dhe vullneti për të shkruar bënë që me përbuzje të shikojë murtajën dhe të shpëtojë nga vdekja.

Prishtinë, 28 prill 1995

SHQIPFOLËSIT E BARBARIZUAR

Rushit Ramabaja

Romani “Ndërgjegjja” i Flori Bruqit, para së gjithash është një kronikë e sublimuar me gjuhë specifike të viteve të hidhura të së ashtuquajturës kohë e autonomisë, kur shkelësi shtypte Kosovën me ndihmën e shqipfolësve të barbarizuar, të cilët emrin dhe identitetin e vet e bartnin vetëm sa për t’i ndihmuar Beogradit, që në sy të botës ta fshihte okupimin e këtij krahu të dhimbshëm të Shqipërisë. Pothuaj, në çdo faqe të tij ndihet pesha e mallit të autorit (rrëfimtari) për t’u kthyer në vendlindje dhe lufta e pandërprerë e të barbarizuarve, që me anë të shpifjeve, shantazheve e kërcënimeve, t’ia mbyllnin udhën përgjithmonë për në shtëpinë e vetë. Këtë dhimbje, që gjithnjë pikon helm e dashuri njëkohësisht, F.Bruqit ia del mbanë me sukses që ta fisnikërojë me shkrimet mjaft të sukseshme për fytyrat më eminente të mjekësisë botërore, por vetveten e identifikon me së shumti me arkitektët shqiptarë, që krijuan vepra madhështore larg atdheut dhe që jo rrallë, bukuria mahnitëse e artit të tyre u bë kob për ta. Në fejtonet për mjekësinë, për njerëzit e mëdhenj të botës dhe për arkitektët tanë, unë kam parë, veç tjerash, përpjekjen e tërthortë të autorit, që ndjekësve të vet t’ua kthejë urrejtjen në dashuri, mërinë në dhimbje dhe harresën e nëmur në rinjohje. Kjo dëshmon shkallën më të lartë të ndërgjegjes dhe vetëdijes skajshmërisht të sublimuar kombëtare e qytetare për pajtim edhe me të pandërgjegjshmit dhe për bashkim edhe me plangprishësit. Duke pasur parasysh këto që thamë, si dhe vlerat e tjera të këtij libri, mendoj se “Ndërgjegjja” e Flori Bruqit, do të ketë lexues të shumtë të të gjitha shtresave sot dhe nesër, ngaqë në të gjithnjë shquhet zëri që thërret që të mos përsëritet kurrë më e keqja e së kaluarës.

Prishtinë, 4 maj 1995

KUKUDHËT NË KOHËN E MONIZMIT

Nikollë Frangaj

Cdo gjë që krijohet pa dëshirën e një individi apo kolektiviteti është e huaj. Kritika e hapët kundër kukudhëve dhe autorëve të regjimit komunist ka shtyrë autorin e romanit t’iu kundërvihet dhe t’i zhveshë gjer në palcë. Autori për më tepër shenjon aktet absurde të tyre, del përballë dhe sfidon. Duke u bërë njeri i anatemuar nga ata vetëm nga frika se do t’ua përziejnë duart, e censurojnë, dhe më në fund e dënojnë. Por, ai nuk mposhtet. Heroi i romanit “Gjarpërinjtë e pallatit”, ka sfiduar në emër të shkrimtarëve dhe gazetarëve demokratë dhe gati mbetet i vetmuar nga breshëria e fyerjeve dhe diskriminimeve, që i bëjnë njerëzit e regjimit dhe prijësit e gazetave, që përkrahin një regjim të tillë. Autori pret finalen tragjike të kukudhëve dhe rrëzimin e këtyre gjarpërinjve, sepse në anën tjetër qëndron forca e pathyeshme e drejtësisë morale.

Shkodër, më 24 korrik 1996

CENSURA SHQIP

Arian Blushi

Ligji i fortë, anathema dhe censura, që u bëhet shkrimtarëve dhe njerëzve të penës e të dijes, nga regjimi komunist, është tema e romanit “Gjarpërinjtë e pallatit”, të Flori Bruqit. Heroi i këtij romani, Uran Dukagjini, del para këtyre autorëve të regjimit dhe bën sfidë, duke shpalosur shpirtin falso dhe metodat çnjerëzore të tyre. Vepra është shkruar me mllef, dhe tërë kjo revoltë e tij është shprehur nëpërmjet unit të shkrimtarit, i cili, pikërisht në këtë rreth ka parë pjesën më të shëmtuar të shoqërisë komuniste...

Tiranë, 27.7.1996

GJURMË QË MBESIN NË FATET E HIDHURA TË SHQIPTARËVE

Rifat Kukaj

Në këtë prozë të Flori Bruqit, mpleksen fatet e hidhura të njerëzve tanë, si dje, ashtu edhe sot, duke i rrahur pa mëshirë e me fishkullimë rrënjëthënëse shtrëngata e kohës, por që nuk ia del t'ua zbehë shpresat dhe t'ua zhdavarisë ëndrrat për një të nesërme më të mirë e më të sinqertë. Oguri i zi ngulmon, por nuk ia arrin tërësisht t'ua fshijë gjurmët e lashta, edhe pse i fërfëllon dhe i rrah si me bisht gjarpri edhe larg truallit të tyre. Mbase, mu kjo golgotë (që, për fat të keq, na përsëritet), sikur ua shton edhe më shumë dashurinë për vendlindjen e shtrenjtë. Këta njerëz të zakonshëm, me të cilët jeta tallet, përballojnë në mënyrë dinjitoze mynxyrat, që u vijnë nga urrejtja e lashtë e të huajve, por dhe nga përmbushja e mjerushëve tanë shpirtshitur e të katandisur, zhveshur nga gjithçka që është njerëzore...

26 qershor 1996 Prishtinë

GJEOGRAFIA E ATDHEUT

Iljaz Prokshi

Pas vëllimit poetik me titull “**Zjarri i Diellit**” (1995), romanit “**Ndërgjegjja**” (1995), “**Vrasësit e Liridonëve**” (1996), që i botoi në Prishtinë, **Flori Bruqi** ditë më parë në Tiranë botoi edhe romanin “**Ringjallja**”. Tema e romanit “**Ringjallja**”, çon në një kohë këtu e shumë vite më parë. Është koha e “kundërrevolucionit”, e shturjeve të sistemeve, thyerjeve e digresioneve në një ambient të caktuar, të cilat shkaktojnë dramën e individit dhe kolektivitetit, që i përket edhe prozatori. “**Ringjalljen**” e karakterizon një kompozicion i thjeshtë, ku rëfimi rrjedh i qetë dhe natyrshëm. Përmes idesë themelore që transmetohet këtu, dalin në spikamë edhe një varg problemesh etiko-shoqërore, të cilat i shkakton një pushtues jo njerëzor. **Flori Bruqi**, ka përcaktuar fatin e një populli të lënë jashtë kufijve të atdheut, i cili pareshtur i nënshtrohet torturave, ndjekjeve, dënimeve dhe mynxyrave të tjera makabre. Për t’i shpëtuar kësaj dhune me shumë veta detyrohen të lëshojnë vendlindjen dhe të ikën në ekzil, siç ndodh me ikjen e **Çlirimit** për në Shqipëri, familjet e **Ligan Shpatullgjanit, Demë Ali Pozharit, Mërgim Bardhit** e shumë të tjerëve, në shkretëtirën e Anadollit. “**Ringjallja**” e **Flori Bruqit** është një ekuivalent i kohës: me braktisje, vetmi, trishtim, që shqetësojnë jetën e njeriut edhe në çastet më të gëzuara të tij. Një formë herë e çlirët e rrëfimit e herë-herë me një organizim të dialogut krijon bagazhin e mundshëm të ambientit nën pushtim. Asociacionet që zgjojnë dialogjet, toni që u jep ngjyrë proceseve jetësore nëpër situata të veçanta dhe rrethanat e krijuara, e zgjojnë kërshtërinë e lexuesit. Pa dyshim se tema është provokuese dhe jep mundësi konstruktimi artistik i situatave që e bëjnë për vete lexuesin.

28 Qershor 1996

POEZI E NËNQIELLIT DHE NJERIUT PA LIRI...

Mehmet Kajtazi

Poezitë e Flori Bruqit (disa prej të cilave ishin më parë të botuara edhe në revista dhe në gazetat tona), i lexova me një frymë. Një cilësim i tillë i leximit të poezive bëhet atëherë kur të përvetëson, si vargu i parë, ashtu edhe i fundit. Temat që ngërthehen në këto vargje nuk burojnë nga inspirimet, që i marrin disa poetë nga librat që i lexojnë, por Flori Bruqi inspirimet i merr nga jeta. Ato nuk mbesin vetëm inspirime, por dalin nga kornizat e një gjirre të thellë dhe si valëzat e detit të shqetësuara afrohen drejt brigjeve, por edhe kthehen në suprinën e largët të detit me emrin nënë, me emrin martirizim, me emrin LIRI. Meqë poetit i mungon kjo e fundit, siç i mungon tërë Kosovës, është plotësisht e natyrshme që në shumë vargje të ketë shqetësime. Këto shqetësime ta përkujtojnë shkrimtarin Viktor Franklin, i cili edhe pse është i rrethuar me tela në një kamp fashist në vitet e dyzeta, ai gjen shpresën që ta tejkalojë mynxyrën. Ajo shpresë është te vetë harmonia në mes Tokës dhe Qiellit, e kur kjo shtrihet edhe te njerëzit, atëherë vetë Zoti është në mes tyre dhe u ndihmon për t'u çliruar. Flori Bruqit nuk i mungon shpresa, por nuk i mungon as harmonia. E kur harmonia prek edhe brigjet e Lumit të Bardhë të vendlindjes së tij, atëherë edhe më shumë shpaloset riti i ritmit të ujit. Uji e ka ritmin e vet, që është në përputhshmëri me hapërimin e njerëzve drejt “Zjarrit të Diellit”.

25 janar 1995

POEZI E SHQETËSIMIT DHE GJAKIMIT PËR LIRINË

Zenjullah Halili

Flori Bruqi po hyn nëpër një shteg të ndritshëm në poezinë shqipe. Figura e tij në fillim të kësaj poeme na sjell shqetësime të shumta që lidhen me Tokën, me Nënë, me Gjakun, me Vallen e Shkrepave, me Baladën e Yjve, me Lotin që ka Ogur, me Zërin me Frushullimën e Krahëve, me Akuarelin e Diellit, me Lumin e Bardhë. Secili varg vendoset në patosin e Kësaj Luleje. Secila poezi ka gjethin e Vet, Dritën, shqetësimin dhe besimin, andeja, matanë errësirës pra ai këto frymëzime i zë nga jeta, sepse e nxit Bardhësia e katër vargjeve, figura e saj, shpirti shqetësues, Fjala. E fton të hyjë nëpër thellësitë e viteve, deri te kjo Kohë, deri te krahërorët masivë, deri te Deti Tekanjoz nganjëherë. Ai sfidon Amësinë Njomëzake të Teutës, fashaton plagët me fjalët figura dhe rend andej nga Përrenjtë e Ëndrrave për të shtypur lehtë e me ndjeshmëri Butonët e Dritës, për të fituar Bardhësitë e për të kërkuar shëmbëllimin me Hermesin, por atje janë qentë, jo larg, e a do ta shqyejnë si Akteonin e Penteun e a do ta martirizojnë si Ismetin, Agimin, Mujën e Salihun. Me tutje jep Figurë për kohën që me nxitje të Eridës, perëndeshës së Grindjes, u bë një luftë e gjatë në muret e Trojës Drapri i Sinagogës ëshstë edhe këtu në baladën e Floriut, që është e yjve, e shkrepave, e bulëzave, e syrit të mprehtë, e zërit të ëmbël, të cilit Hiçi i vjen përballë mu para viteve të liga. Por, poeti në këtë hije të çastit vëren Dritën, një xixëllonjë që lufton me errësirrën, së cilës do t'ia shohë sytë, sepse aty është puthja, aty pasioni i erës, simbol i bukur i një përçafimi jetësor aty pasioni mëtuës për Fjalën, që është njëra nga vjershat më të realizuara artistikisht. Në ishullzën më të madhe të detit figurative të Floriut është edhe Nëna si Baladë, si Qëndresë e si Ëndërr Ilire, Lumi i Bardhë e ndonjë poezi tjetër, janë kthim imagjnativ i poetit nga njomësia e Euridikës, pra, Vendlindjes.

25 janar 1995

PËRGJIGJE KRASISTËVE TË HISTORISË SHQIPTARE

Nga Dr.sc.Fatmir Terziu

Dhe aty ku kjo xhelozë ndeshet me modestinë dihet rezultati. Ai kurrë nuk është barazimi. Nuk është barazimi, se jo më kot e thotë populli: “Hapja, bre burrë rrugën pimësit!” e që t’ja hapësh rrugën të ‘dehurit’ historik apo më së shumti atij të kudondodhurit elektronik sot, atij që e ka atë në vend të shpatës, pra të nderuarit ‘mik’ duhet “Guximi Shqiptar”. Ai ka armën e Flori Bruqit dhe është botuar në Prishtinë. Është ndarë në disa kapituj dhe flet për historinë, Ramushin, Antropologjinë, Politikën, spiunazhin, gjuhën dhe letërsinë, psikoanalizën, astrologjinë dhe erotikën, por ka edhe fjalën e redaktorit dhe fjalën reçensuese.

Pra, në më shumë se 400 faqe flet me gjuhën e thjeshtë e modeste shqipe, për modestinë e termit “Guximi Shqiptar”. Që në titull duket kapërcimi i modestisë. Vetë modestia që “buron” nga cikloni letrar i shkrimtarit Flori Bruqi, kandidat i shkencave. Një modesti që shënon plot 30 libra. Një modesti që nuk tejkalohet, dhe as që nuk para-prezantohet.

Një modesti që shtrydh fletushkat dhe ndrydh parcelizmat e digitalit dhe elektronikës në një sipërfaqe që as vet njeriu që e krijoi s’e kupton sa xhelozë prodhon.

Ja se si shprehet vet Bruqi “Nacionalizmin neurotik serb e karakterizon resan-timani, ose ndjenja e dinjitetit të nëpërkëmbur, bindja për humbje të padrejtë, mëria për tjetrin si pasojë e përbuzjes, apeli për hakmarrje, për qërim hesapësh, për riinterpretim të historisë, por edhe si xhelozë kundër të tjerëve që janë më të suksesshëm”. Libri më i ri i Flori Bruqit tenton të paraqesë një dritare në këtë valëzim mjegullor, që ndeshet edhe në ditët me diell. Ai në fakt nuk është në rolin e pastruesit të xhamave të kësaj mjegulle, edhe pse fjala e tij e kreh atë mjegullnajë në heshtje dhe pa shumë bujë, teksa ka librat makrometrik të parametrave leksikorë e sfumojnë paralizën kohore dhe detajojnë të sotmen, të shkuarën me të sotmen në alteracion dhe presupozojnë të ardhmen. Prania shtjelluese e disa penave shqiptare tek “Guximi Shqiptar” e bën veprën e Bruqit t’i buzëqeshë të gjithë potencialit lexues. Aty gjendet përgjigja për “A është Rifat Kukaj një thesar shqiptar?”, “Në vend të përkujtimit: Mehmet Kajtazi”, “Kush është Koleç Traboini?”, “Keze (Kozeta) Zyllo”, “Kush është Gani Xhafolli?”, “Kush është Nehat S. Hoxha”, “Muxhahedinët si «Gold-en Boys»”, “Persekutimi

komunist mbi vajzat e Bajram Currit”, “Polemikë pa dorashka”, “Gërmime në llogëme të pista”, “Letër e hapur organizatorëve dhe spektatorëve të koncertit të Goran Bregoviqit” e mjaft të tjera shkrime të kësaj kategorie. Më tutje Bruqi thekson “Çuditërisht, askush nga deputetët nuk parashtrroi pyetjen sesi ata do ta arrinin të menaxhonin, të dilnin në krye me një Kosovë forcërisht të aneksuar, me dy milionë shqiptarë të mllefosur dhe të armiqësuar me shtetin? Për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, së pari duhet të analizojmë natyrën e nacionalizmit serb, e cila prodhon aberracione ciklike të politikës ser- be nga rrjedhat normale historike.” Duke iu rikthyer xhelozisë ai shton: “Mëria zakonisht ka prodhuar konflikte serbe me fqinjët, ndërkaq xhelozia ka prodhuar antievropianizmin fanatik. Kur filloi e gjitha kjo? Kur dhe kush e zbuloi mitin e Kosovës?”. Duke lexuar “Guximi Shqiptar” natyrshëm sqaron edhe detaje të tilla: “Kur nisi ky ortek i iracionalizmit? Zakonisht mendohet se etnologu serb, Vuk Karaxhiq, është prodhuesi i këtij miti, por misionin hulumtues atij ia besoi etnologu dhe linguisti i njohur slloven J. Kopitar, i cili bashkëpunonte ngushtë me Gëten. Shkrimtari gjerman kishte obsesion periudhën antike greke, kohënjë sipas tij, në qenien e njeriut ka ekzistuar harmonia mes elementit apolonik (racional) dhe atij dioniziak (irracional, emotiv). Gëte mendonte se qytetërimi perëndimor lëngon nga ngadhënjimi i plotë i racionalizmit, që e vlerësonte sinjë shkarje të rrezikshme. Ai kishte shpresë të madhe se harmonia e dikurshme antike mund të gjendej ende në baladat e popujve të Ballkanit”. Po a mundet të shkruhet ndryshe historia? A mund të ndriçohet realiteti i saj? Përgjigja e Bruqit ndodhet në “Guximi Shqiptar...”

BURRI DHE GRUAJA, LIBËR KËSHILLASH PËR BASHKËJETESË FAMILJARE

Libër publistiko-shkencor për bashkëjetesën familjare

Marrëdhëniet dashurore para martesës, si dhe jeta bashkëshortore në periudhat fillestare, sidomos, kur të rinjtë dhe të rejtat i verbon dashuria, parafytyrohen dhe në përgjithësi janë të lumtura. Por më vonë, kur bashkëshortët fillojnë të ndeshen me vështirësitë e jetës së përditshme dhe ndodh një farë velje e njërit ndaj tjetrit, jo vetem nis të shfaqet një farë ftohje, por ndonjëherë zhvillohet dhe një luftë, herë e butë dhe herë e rreptë, për mbijetesën e familjes, natyrisht pa i përjashtuar çastet e gëzuara dhe të lumtura. Me qenë se çdo familje përbëhet nga bashkëshortët, të cilët përveç seksit, dallohen dhe ndryshojnë njëri nga tjetri edhe prejardhja, lloji i edukimit familjar dhe shoqëror, veçoritë psikosomatike, formimi intelektual etj. Në mënyrë të pashmangshme, përpjekjet për konsolidimin e familjes ndeshen në mosmarrveshje, grindje, dhe zënie, që bashkëshoqërojnë jetën e tyre. Krahasimisht të lumtur duhen quajtur ata bashkëshortë, të cilët, pasi bëjnë përpjekjet e duhura për ta njohur njëri-tjetrin, mësohen t'i lëshojnë pe shokut ose shoqes së jetës, sidomos kur mosmarrëveshjet e vogla rrezikohen të bëhen të rënda, shpesh me pasoja të padëshirueshme dhe të hidhura për qetësinë dhe qendrueshmërinë e familjes. Pikërisht ky libër i Flori Bruqit, me këshilla dhe shembuj që burojnë nga përvoja shumë shekullore e bashkëjetesës familjare, por dhe i ndërthurur me fjalë dhe porosi të mençura të shumë shkrimtarëve dhe shkencëtarëve botërorë, dhe vendas në studime psikologjike dhe shoqërore serioze për këto probleme, synon që të shërbejë si udhëzues me vlerë për të zgjedhur mënyrat më të përshtatshme për të zbutur dhe kapërcyer mosmarrëveshjet bashkëshortore, që e helmojnë dhe e lëkundin familjen.

Libri shumë shpejt do të bëhet i dashur për lexuesit shqiptar... (Nga Recensionin).

Prof.dr.sc.Ermal Kristo, psikolog
Prof.Kastriot Ymeri, pedagog
Prof.Driton Shehu, pedagog special
Prof.dr.sc.Kaltrina Daka, sociologe

Tiranë, 01.01.2000

BURRI DHE GRUAJ, LIBËR QË LEXOHE ME DASHURI PËR DASHURINË

Interesimi për të thelluar kërkimet në fushën e krijimtarisë, madje në fusha të ndryshme, autorin e librit “Burri dhe gruaja”, Flori Bruqi, i cili pos vëllimit poetik “Zjarri i diellit”(1995), ka botuar edhe romanet “Ndërgjegjja”(1995), “Ringjallja”(1996), “Gjarpërinjtë e pallatit”(1996), “Dorëzeza”(1997) dhe “Toka e djegur”(1998), e ka provokuar edhe njëra nga çështjet më komplekse, dashuria, ku janë shqyrtuar një sërë aspektesh që ndërlidhen me raportin ndërmjet njërezve, përkatësisht sekseve. Është në të vërtetë një qasje specifike një problematike të pashterrshme, aq shumë të trajtuar pothuajse në të gjitha zhanret e gjinisë shkencore, letrare e publicistike.

Marrëdhëniet dashurore në periudha të ndryshme të jetës konceptohen në një spektër pak a shumë të gjerë që këshillat e shumta dhe shembuj përkatës që burojnë nga përvoja shumëshekullore e bashkëjetesës familjare dhe intime, gërshëtuar me mezazhe shkrimtarësh, shkencëtarësh e intelektualësh të botës e të vendit, të artikuluar nëpërmjet paraqitjeve të tyre publike, do të mund të shërbejnë për të mësuar anë të nduarnduarta të këtij realiteti për të kapërcyer situata të pakëndshme, por edhe për ta bërë jetën më të lumtur. Libri “Burri dhe gruaja” është një botim i veçantë, që provokon gjithsesi me kompleksitetin e tij, me mendimet e çlira me sugjerimet konstruktive dhe artistike, që shpejt përvetësojnë lexuesin . Pa dyshim është një zhanër që do të lexohet me dashuri për dashurinë, shumë nga të fshehtat e jetës mbase do të mund t’i gjejnë ata që do ta kenë në duar këtë libër.

**Botoi”Flomed”, Prishtinë, 2000
Sh.G.**

SFIDIMET PËR LIRINË

Arian Blushi

NGPG”Rozafa”Shkodër 1998

NTP”Flomed”Prishtinë 1998

Romani “Tokë e djegur” bën fjalë për luftën në Kosovë, që bëjnë njerëzit e përvuajtur, njerëzit e robëruar, të etshëm për liri. Autori sjell atmosferën e kësaj lufte dhe të luftëtarëve të lirisë, të cilët nuk kursejnë as jetën për liri. Duhet të kihet parasysh se kjo prozë e Flori Bruqit e mban lexuesin të interesuar gjër në fund, meqë krijohet një atmosferë e lehtë, për një çast harron ankthin dhe pret se ç’po ndodh si në zonat e luftës, ashtu edhe në takimet në mes të Albanit dhe Doruntinës, në njërën anë, dhe Kapedan Malësorit dhe të Drenushës në anën tjetër.

Së fundi duhet thënë se ky është një roman që do të lexohet, kap emocione të luftëtarëve, të njerëzve të tjeshtë, të cilët qëndrojnë vigjilentë në luftën e pakompromis për gjënë më të shtrenjtë-Lirinë.

Shkodër, 10.VIII.1998

PROZË E REALITETIT ARTISTIK

Shpend Ruci

Duke lexuar prozën e Flori Bruqit, të duket se sheh njerëzit në betejë, tanë trima të lirisë, që nuk frikësohen nga vdekja. Kapedan Malësori, në frontin e luftës, bën një romancë me Drenushën, por çdo gjë është e matur, njerëzore. Linjën tjetër e përbën, për çfarë i jep mish dhe gjak romanit dashuria e Albanit dhe e Doruntinës, që aq janë të mishëruar mes vete, me luftën, sa që s'ka kush që i ndanë. Autori është i qartë, konkret, bën përshkrimin e ngjarjeve, individëve dhe jep tablo të gjalla nga lufta. Është një prozë e realizuar për këto momente mjaft të vështira për shqiptarët e Kosovës...

Tiranë, 07.08.1998

TRAGJIKA E SERVILËVE TË NJË KOHE TË PERËNDUAR

Arlinda Meksi /Valdet Hoxha

“Pallati i Akeronit”, botoi Shtëpia Botuese Butrinti – Tiranë, 2000

Romani “Pallati i Akeronit”, i shkrimtarit Flori Bruqi, është një zë i guximshëm mbi një periudhë të dhembshme, të mbrapshtë, por edhe të stërkequr, që e krijoi regjimi dhe kukudhët e tij. Ky shkrimtar ka prekur disa nga pikat më të qenësishme të veprimit të disa gazetarëve dhe të atyre politikanëve apo njerëzve të UDB-së. Por në këtë libër që ka edhe elemnte të një romani kriminalistik ku kapet një periudhë e rëndë e shqiptarëve, sidomos, të atyre që punonin për çështjen shqiptare që ishte shumë tragjike. Romani është i ndarë në kapituj, një ndarje kjo formale, por në epilog është narratori i gjithëdijshëm Uran Dugagjini, që përqendrohet kryesisht rreth veprimit të disa gazetarëve të pandërgjegjshëm, spiun të nëntoks së Beogardit, të zier me regjimin, duke përgjuar njerëzit që nuk i shkonin për shtati atij apo diçka ngjashëm me “kundërrevolucionarët”, të cilët ndiqeshin, largoheshin nga puna, dënoheshin gjer në likuidim fizik, siç ndodhi me Jusuf e Bardhosh Gërvallën, Kadri Zekën, Enver Hadrin e shumë të tjerë. Në roman shihet se ky shkrimtar prek edhe çështje të tjera si ato të luftës, heroizmin e disa luftëtarëve e shumë çështje të tjera që për lexuesin do të jenë mjaft interesante. Alergjia e shkrimtarit është e ndjeshme, sepse atij i ndalohet botimi i shkrimeve, si i shumë kolegëve të tij, ndiqet si dhe nuk i lë vend në asnjë shtresë nga veprimi i kukudhëve. Është pra, Uran Dugagjini që njësohet me shkrimtarin, i cili perjeton gjarje të hidhura para dhe gjatë luftës dhe, ende e ndjen veten të “lënë në harresë”, ngase kukudhët janë vendosur në poste të ndryshme, sidomos në mjete të informimit dhe vazhdojnë t’u teket, por tani kuptohet, kinse në emër të “demokracisë”, të cilën deri dje e shkelën apo nuk guxonin ta përmendin. Janë mjaft rrëqethëse disa skena të ndjekjes së tyre që e bëjnë, me ndihmën e UDB-së, qoftë duke përgjuar veprimet e inteligjencisë, qoftë duke i denoncuar në mënyrë mafioze përmes “bajraktarëve” të Pallatit të Lavireve”, të atij të Kuq dhe në fund atij më famëkeqit të Akeronit. Në dhomat speciale, në ato labirinthe shkilej dinjiteti i intelektualit shqiptar, aty bëheshin plane për ndjekje, denigrime dhe burgosje,

e ç'është më e keqja ata shkonin aq larg sa edhe me ndihmën e kriminelëve edhe kryheshin aktet më barbare të krimit. Romani “Pallati i Akeronit” është një qortim publik ndaj atyre që deri dje vepronin me nofka e shifra veprojnë edhe sot; ishin pjesëmarrës të dhënies së informative UDB-së, i nënshkruanin me shifra dhe shumë nga ato përgaditeshin në dosjet speciale për ndjekje e gjyqësi. Autori ka qitur disa fakte, ndërsa është dashur t'i materializojë akoma më tepër, sidmos të dhënat nga dosjet, siç i quan ai “Sekret”. Së fundi duhet thënë se ky roman është sa artistic, aq edhe politik, për vetë faktin se prekë pika të ndieshme të shpirtvogëlsisë së individëve qyqarë, kukudhëve, të cilët të kanë vepruar dhe akoma nuk i vret ndërgjegja mbi veprimet verbuese të tyre në një kohë dhe regjim të caktuar. Rrëfimet e Uran Dukagjinit rikujtojnë një kohë të zymtë, që për shumicën e lexuesve janë të njohura, dhe u ndihmon atyre t'i ndiejnë e përjetojnë akoma më thellë, e ndoshta edhe me keqardhje.

Tiranë, qershor 2000

VEPËR ME INTERES TË GJERË LETRAR

Dr.Lumturie H. Haxhiaj

(Rreth opusit letrar të autorit Flori Bruqi)

Shkrimtari Flori Bruqi, nga Prishtina, që në periudhën e kaluar kishte bërë emër më tepër si gazetar dhe atë prej kronisti, iu rrek edhe fushës së letërsisë, duke botuar kështu poezi, tregime, novela, romane, dhe libra shkencor. Vepra e tij kap një volum prej 10 librash “Zjarri i Diellit”(poezi,1995), “Ndërgjegjja”(roman, 1995), “Vrasësit e liridonëve”(roman, 1996), “Ringjallja”(roman, 1996), “Gjarpërinjtë e pallatit”(roman, 1996),”Dorezëza”(roman, 1997), “Tokë e djegur”(roman,1998), “Burri dhegruaja”(libër-publicistik-shkencor,2000),“Pallati i Akreonit”(roman,2000), “Vademecum DDD”(libër shkencor,2002).

Duke lexuar këto vepra, siç shprehet edhe kritika që e ka përcjellë botimin e tyre, shprehja e autorit është mjaft e lirshme, kemi të bëjmë me ngjarje të vërteta, të përjetuara, gjithmonë bazuar në realitetin objektiv, veçanërisht gjatë periudhave të ndryshme, që nga shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi, e cila jepet në romanin “Ringjallja” e gjer te temat politike, që e kanë shtyer njeriun të demostrojë, të rebelohet dhe më në fund të bëjë sfidë kundër regjimit, spiunëve dhe kukudhëve të ndryshëm çfarë kanë vepruar në Kosovë dhe në shtetin amë Shqipëri (veprat:Ndërgjegjja,Gjarpërintë e pallatit, Pallati i Akreonit).

Vepër me motive të ndryshme

Romani “Ndërgjegjja”(1996) është më tepër një kronikë e sublimuar, thotë shkrimtari Rushit Ramabaja, dhe vazhdon:Ajo ka një gjuhë specifike të viteve të hidhura, kur Beogardi në sy të botës proklamonte ndryshe dhe mabnte nën okupim popullin shiptar, ndërsa këndej shtypte lirinë dhe të drejtat e shqiptarëve, në mënyrë më barbare.Ndërkaq, romansieri Mehmet Kajtazi për këtë roman shprehet se “disa gazetarë sevilë, të cilët të vërtetën e mbulonin me gënjeshtër, emrat e të cilëve diheshin-atëbotë, mirëpo, autori Flori Bruqi nuk bie në ujëra të turbullta dhe nuk është hakmarrës”. Dy autorë, kritikë dhe mbase njëri botues apo redactor, kurse tjetri recensent për romanin “Gjarërinjtë e Pallatit”(1996) shprehen mjaft pozitivisht. Z.Nikolë Frangaj, nga Shkodra, shkruan kështu: “Autori për më tepër në këtë roman i bën një kritikë të hapur atyre gazetarëve qyqarë, që i përshtaten regjimit, shënon për më tepër aktet absurde të tyre, del

përballë tyre dhe sfidon”. Ndërkaq, Prof. Arian Blushi, nga Tirana, thotë se “Ligji i fortë”, anathema dhe censura që u bëhet shkrimtarëve dhe njerëzve të penës nga regjimi komunist është temë e romanit “Gjarpërinjtë e pallatit”, të Flori Bruqit”. “Uran Dukagjini, një intelektual i pavarur, një shkrimtar bie ndesh në regjimin komunist jugosllav dhe argatët e tij, i cili vrojton pjesën më të shëmtuar të një shteti të çoroditur”, shkruan Blushi.

Romani “Pallati i Ankreonit”(2000) është i ndarë në 18 kapituj të lidhur në mënyrë kontinuele me një mesazh të qartë, që të flakën dukuritë e shëmtuara, si thashëthemet, përgojimet, klanet, sepse krijuesi duhet të merret vetëm me anën letrare dhe figurative. Prof. Selim Krasniqi për këtë roman thotë: “Vetë titulli i romanit tregon se “Pallati” është i mbushur me mjaft kukudhë e cerberë të nëntokës, sepse vet Akeroni, sipas mitologjisë greke, është emri i lumit dhe mbretërisë së nëntokës. Krahas persiatjeve të shumta të Uranit, autori me mjaft mjeshtri, e përshkruan luftën e UÇK-së në tërë Kosovën, si në Drenicë, Dukagjin, Llap, Shalë, shkruan për “Kosova-press”-in (2000), Prof. Krasniqi. “Romani që ka zgjuar interesin më së shumti të lexuesit është pa dyshim romani “Vrasësit e liridonëve”(1996), roman ky që pas botimit të tij në Prishtinë, u ribotua edhe në Tiranë e Nju-Jork.

Autori Bruqi, që e shkroi një roman të tillë, në radhë të parë shpreh jo vetëm talentin e tij, por edhe guximin, që t’u rreket temave të tilla”... shkroi në “Fjala e jonë” shkrimtari Bedri Halimi. Romani “Vrasësit e liridonëve” është një lloj apologjie kushtuar Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zekës, si dhe disa patriotëve të tjerë si Enver Hadri e ndonjë tjetri. Vetë tema e romanit “Vrasësit e liridonëve” thotë shkrimtari dhe shkencëtari dr. Shyqri Galica (“Zëri i Kosovës”, 1996) është sugjestive, e kapshme për lexuesin. Aktet barbare mbi popullin shqiptar nga regjimi serbian nuk pushonin, u desh të ngihet një gjeneratë e re intelektualësh, mërgimtarësh që të sfidonin mbi këtë katrahurë të së keqës. Kush tjetër pos një Jusufi, Bardhoshi, Kadriu dhe Enveri, si dhe shumë të tjerë.

Vrasësit e Liridonëve apo synimet baladeske

Autori Flori Bruqi, thotë shkrimtari Gani Xhafolli, (“Fjala e jonë”, 1996) nuk kufizohet shumë vetëm në jetën e tyre, por bën një paralelizëm midis të keqes, barbarisë dhe aktit të vetëflijimit, një synim ky baladesk, plot guxim, një ndjenjë e mosnënshtrimit çfarë është veprimi i vëllezërve Gërvalla e Kadri Zekës, Enver Hadrit e shumë e shumë të tjerëve, të cilët i vrau UDB-ja. “Romani “Vrasësit e liridonëve” është një roman më tepër politik dhe pikërisht

trajton një periudhë shumë të ndieshme, shumë tragjike, atë të viteve 80-ta , kur regjimi i Beogradit shtypte demonstruesit shqipëtarë, i ndiqte, i burgoste dhe i vriste më në fund. Për të shtruar duke zgjedhur një temë të tillë, autorit Flori Bruqi, iu ka dashur të njohë më mirë shpirtin revolucionar të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës, natyrisht, nëse nuk ia ka arritur gjer në pikën më të ndieshme, mjafton që i ka hyrë kësaj teme dhe mendoj se është vepra e parë që iu kushtohet këtyre patriotëve të lëvizjes kombëtare”, shkroi për këtë roman (“Rilindja”, 1996) poeti Esat Loshi.

LIBRI “VADEMECUM DDD”, I AUTORIT FLORI BRUQI, I VEÇANTË NË FUSHËN PROFESIONALE

Mr. Ajshe Qorraj

Autori i tetë veprave letrare dhe i dy veprave shkencore, Flori Bruqi, nga Isniqi i Deçanit, këto ditë, doli para lexuesve me librin më të ri shkencor me titull: “Vademecum ddd”. Siç thotë autori në parathënien e librit “Vademecum ddd”, në dekadën e fundit në Kosovë janë regjistruar afro 200 epidemi lokale dhe masive, si dhe rreth 250.000 të sëmurë, nga të cilët më së 1400 kanë vdekur. Problem në vete në Kosovë, sipas këtij autori, paraqesin sëmundje ngjitëse transmise, të cilat barten nëpërmjet artropodeve dhe ato që përhapen nëpërmjet brejtësve. Zhvillimi në lëmine e preparative DDD (dezinfekuese, deratizuese dhe dezinfektuese) është veçanërisht dinamike në 10 vjeçarët e fundit dhe përcjellja e risive në drejtimin e DDD-së është imperative i kohës, ngase pothuaj kemi një situatë alarmante epidemiologjike, sëmundjet ngjitëse në Kosovë dhe më gjerë në rajon këta 3 vjetëve të fundit. Sëmundjet ngjitëse të traktit digjektiv, sipas këtij autori, janë zbuluar më kohë në Kosovë, ngase afro 40 për qind e popullatës furnizohet me ujë të pijshëm nga ujësjellësit rajonalë, ndërsa 60 për qind e popullatës së vendit tonë pi ujë jo aq të sigurt. Doracaku udhëzues i F. Bruqit “Vademecum DDD”, mbërthen 61 preparate më të njohurat në botë, që përdoren sot në rruzullin tokësor, duke i prekur deri në detaje nohuritë e autorit në punën e tij afro 20 vjet, për ta përpiluar një libër të tillë të patjetërsueshëm-profilaktik dhe kundërepidemik, që u dedikohet mjekëve, stomatologëve, veterinarëve, teknologëve të industrisë ushqimore, agronomeve, hotelierëve, si dhe profesioneve të tjera, ku përdoren me të madhe këto preparate të DDD-së, që shërbejnë si ndihmë në procesin parandalues të shumë sëmundjeve ngjitëse, për mbrojtjen e higjenes personale asaj kolektive, higjenes së objekteve (spitaleve, shkollave, foshnjoreve, hoteleve, kazermave ushtarake-policore etj.) për zhdukjen, shkatërrimin permanent të viruseve, bakterieve, parazitëve, brejtësve e qenieve të tjera të gjalla, të cilat e dëmtojnë mjedisin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi. Siç thonë edhe shkencëtarët botërorë të kësaj lëmie, si dr. Gert Schonberger-redaktor konsultat i këtij libri nja

Vjena, si dhe ing.Rozha Ladislav, recensent- kordinator, “Vademecum DDD”, i Flori Bruqit, nga Prishtina, është i shkruar në mënyrë profesionale, më një gjuhë të rrjedhshme (versioni anglisht dhe shqip) dhe i kuptueshëm jo vetëm për ekspertët e këtij lëmi, por edhe për zbatuesit e këtyre masave”...

Prishtinë, 20.05.2002

PROZË E NJË KOHE TRAGJIKE

Bedri Halimi

Sa herë që vjen janari më vete sjell edhe 17 janarin e vitit 1468, ditën e vdekjes fizike të Skënderbeut. Por ky janar, që sapo shkoi, si në koincidence solli edhe 17 janarin e vitit 1982, ditën e vrasjes së tre martirëve të Kosovës: Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës e Bardhosh Gërvallës. Dhe jo vetëm kaq! Janari pra është përplot kujtesa e data të hidhura. Janari është përplot flakë! Prandaj, çdo janar, kudo në Kosovë, sjell me vet FLAKËN E JANARIT, ku pothuaj nuk ka vend që ndonjë forum, institucion e asociacion që nuk organizon diçka rreth përkujtimit të shembëlltyrave të historisë sonë më të re. Janari është akuzë, është mesazh për “zgjimin e ndërgjegjes së ndryshkur”- si do të thotë shkrimtari i shekullit tonë Ismail Kadare. Kështu më 15 janar të këtij viti, Forumi i krijuesve të artit, organizoi në Prishtinë, promovimin e romanit më të ri të Flori Bruqit “VRASËSIT E LIRIDONËVE”. Po të mos ishte shkruar për “Vrasësit e Liridonëve”, Zjarri i diellit do ta vriste Ndërgjegjen-kështu e hapi aktin promovues të këtij libri, folësi dhe gazetari i BBC-së, Besim Abazi, duke bërë shetitje sintetizmi nëpër titujt e tri veprave të Flori Bruqit. Në këtë promovim merrnin pjesë shkrimtarë, artistë të teatrit, këngëtarë, por edhe veprimtarë, miq e të afërm të shkrimtarit, si dhe shokë e bashkëluftëtarë të kryepersonazhit të romanit- Jusuf Gërvallës. “Kush dëgjon vetëm, një këmbanë, dëgjon vetëm një zë”.- Kështu e nisi fjalën e tij, redaktori i këtij romani, shkrimtari Mehmet Kajtazi, duke iu referuar kësaj thënie të Frang Bardhit e thënë këtu e para 30 vjetësh. Me këtë ai ndërliidhi këtë mendim me të sotmën se as sot, pra as nesër nuk është koha të dëgjohej vetëm një zë. Tematika e romanit nuk është imagjinuar, siç bëjnë disa prozatorë, është reale, por edhe brenda reales e fsheh emrin e vërtetë të personazhit kryesor të romanit. Fshehja e këtij emri nuk e lëndon romanin. Përkundrazi i jep forcë, ngase edhe akademiku, edhe bujku, e njëkohësisht edhe kritiku letrar që vraponë pas hijeve dhe ngjarjet përreth nesh i merr si vogëlsira, do ta kuptojë se personazhi kryesor është poeti dhe romansieri, Orfeu me kitarë, që u vra pikërisht më 17 janar 1982 nga dora e cerebrëtvë të kuq komunistët jugosllavë.

Nëse jeta në përgjithësi ka kuptim, atëherë edhe kuptimi e ka rrjedhën e vet të kuptueshme kur ka durim. Ky mendim i Viktor Franklit qysh më 1962 është përkthyer në 25 gjuhë të botës, e Kosova mesazhin e durimit e ka edhe para 1962. E kur durimi shndërrohet në dëshirë për jetë, atëherë liria ec drejtë tij me hapa

miklues. Hapat e tillë duhet të lëvizin edhe drejtë Flori Bruqit për ta frymëzuar prapë për ndonjë roman të ri, port ë suksesshëm si ky me simbole, krahasime dhe plot figura të tjera që e pasuruan gjuhën e veprës-theksoi Mehmet Kajtazi. Shkrimtari Rushit Ramabaja, shok i ngusht i Jusuf Gërvallës, pos të tjerash theksoi se periudha e fundit, njëra ndër më të përgjakshmet që filloi pikërisht para 15 vjetësh, siç ndodh me të gjitha stinët e stuhishme e të historisë, nxjerr edhe personalitetet e veta . Ata prijnë si zgalemi dhe zbresin në rrënjën e pavdekësisë sonë, që pastaj të jëtojnë përgjithmonë në kujtime, duke u bërë kështu bartës të përhershëm e të pagjumë të të gjitha kohëve që do të zbardhin duke marrë pjesë tok me në në të gjitha gazet, festat e hidhërimit, në të gjitha përleshjet, gulmet e ngadhënjimit. Ata përherë zënë vend pranë nesh në tryezat e të kremtave, gjithnjë na ndihmojnë t’i pakësojmë barrët e hidhërimeve, gjithnjë na ndijmojnë të rrëmojmë terrin e historisë që të mësojmë nga pësimet e saj. Dhe ata kërcejnë natyrshëm, siç zbret dielli në një mëngjes magjik në prozhmë, zbresin në vjershën tonë, në tregimin tonë, në romanin tonë, në notën shkundulluese të operës, në hijedritën e pikturës. I tillë ishte ndër të tjerë edhe Jusuf Gërvalla që u bë frymëzim dhe kryepersonazh edhe i romanit të Flori Bruqit. Në raste të tilla, përpara krijuesve shtrohet përgjegjësi e dyfishtë, të shqiptohet deri në shterim heroikja dhe e bukura, pra që arti të ushqejë heroiken, dhe heroikja artin për të krijuar vepren monumentale, që sadopak t’i shëmbëllejë heroit, i cili me këtë rast, pothuajse me të njëjtin shpirt të shenjtë e kendoj baladën e jetës sonë. E shkroi atë, e pikturoi, për t’u martirizuar më në fund në të gjitha ngapak dhe për t’u bërë përmendore e përjetshme e të gjithave. Më pastaj, autori i këtij shkrimi theksoi se “Militantët e çështjes kombëtare dhe përpjekjet e tyre për liri vazhdimisht i kanë provokuar krijuesit e fushave të ndryshme të artit. Në këtë drejtim edhe Flori Bruqi, ka gërshetuar metodën e përjetimit shpirtëror dhe atë filozofik, dukë dhënë një realitet të çmuar në bazë historike, për fatin e kryepersonazhit, fati i të cilit dje ishte anatemë për t’u shëndërruar në simbol të rezistencës praktike. Vetë rrëfimi i veprës, qasja ndaj subjektit dhe në tërësi personazheve, duke i ikur dialogut intensive, krijon një dramalizëm dhe atmosferë të problemit të kohës së re, të cilën e merr në shqyrtim autori. Gjuha e figurshme, lirizmi dhe komponentët e tjerë që e përbëjnë strukturën e veprës, shquhen me natyrshmërinë psikologjike të personazheve me mendime të thelluara rreth fatit ekzistencial të kolektivitetit, duke t’i kujtuar kështu edhe ngjarjet aktuale...

Në këtë promovim sa krenar aq shqetësues fjalën e mori poeti Esat Loshaj. Romanin “Vrasësit e Liridonëve” e cilësoi si një simbolikë të stojiçizmit tonë në rrjedh të shekujve, që me gjithë pësimet dhe humbjet, një ditë do të kurorëzohet

me sendërtim idealësh të liridonëve. Autori në këtë vepër gjakon jo vetëm të portretizojë tragjikën dhe rrugën e përndjekur të robërise kombëtare, që është mbizotëruese në këtë vepër, por këtë gjendje e gërsheton me të kaluarën e lavdishme... Portretimi i këtij dëshmori është emocionalisht i thellë dhe moralisht i drejtë. Ana impulsive a autorit del në përpjestim të harmonizuar në anën ekspresive të tij.

Poeti Jakup Ceraja për këtë roman tha: “Romani ka një zhvillim tekstor gati spontan, ku terësia del si një poemë liriko-epike. Romani ndjek deri në fund dy vijat kryesore Alban dhe Liridon (vija positive) dhe Sundimtari i Kuq (dykuptimësi) e Vidiç (vija negative). Romani shquhet edhe për mendime origjinale dhe shprehje të reja. Prandaj, ky roman mbi të gjitha është akuzë e rëndë, jo vetëm kundër vrasësve kriminelë, që s’arsyetohen me asgjë, por edhe kundër atyre që mbajtën dhe ushqyen këta vrasës të dyfishtë (të personit të lirisë)”.

Shkrimtari, Gani Xhafolli, i impresionuar, këtë roman e cilësoi si një faturë të ligjërimin dokumentar. Ethet e ndjekjeve të një tragjike, dhe të një shqetësimi krijojnë një tensin të lartë, që shpeshherë këputën siguriesat e një loje dramatike. Montazhi i baladës për vdekjen e Jusuf Gërvallës, romanit i jep një dimension të ri të ligjërimin modernë. E përditshmja dhe imagjinaria krijoi një harmoni universale të modelimit. Shqetësimi si nocion merr formën e një figure të thellë... duke i dhënë kësaj proze një dimension teatral...

-Ka vdekur- tha ai.

-Ndoshta jo.

Të gjitha personazhet jepen në evolucion dialektit... Karakteret zbulohen përmes veprimin dhe dialogjeve...

-Të thash njëherë, kanë vdekur që të tre.

-Ç’po thua rrezikzi, -thirri i panjohuri.

Edhe pse romani ka konflikte dramatike, herë-herë nuk mungojnë as episodet komike as ironike, që krijojnë variacione në stil, përmes të cilave autori fillon sistemin e ligjërimin. Romani mbyllet: “Kush e vrau Liridonin?”- tha ai prapë, ndonëse asgjë nuk kishte mbetur enigmatike. Figurat e djellta lëvizin drejt derës, dielli ngjitej lart. Me sa duket, ky është romani i parë i një autori që për personazh kryesor e merr njërin ndër fatosat e kombit, të kohës së re, prandaj do të ishte mirë që edhe krijuesit e tjerë të merrnin tema të tilla në shqyrtim.

12.01.1996

NË TIRANË, RIBOTOHET ROMANI “VRASËSIT E LIRIDONËVE”

Prof. Shyqri Galica

Pas vëllimit poetik me titull “Zjarri i Diellit” dhe romanit “Ndërgjegjja”, që i botoi vjet në Prishtinë, Flori Bruqi nxorri edhe një vepër tjetër, romanin “Vrasësit e Liridonëve”, që u botua kohë më parë në Prishtinë. Ky roman do të ribotohet së shpejti edhe në Tiranë.

Tema e romanit “Vrasësit e Liridonëve” është interesante: aktet barbare të pushtuesve për t’i likuiduar martirët e ditëve tona, vëllezërit Jusuf dhe Bradhosh Gërvallën, Kadri Zekën, Enver Hadrin, etj. Aludimi në figurat të caktuara dhe shqetësimi, që krijojnë vrasjet tmerruese, krijojnë një atmosferë të tendosur, që është faktikisht një përshkrim i gjendjes së sotme nën pushtuesin serb.

Një formë herë e çlirët e rrëfimit e herë-herë me një organizim të dialogut, krijon bagazhin e mundimshëm të ambientit nën pushtim. Asociacionet që zgjojnë dialogjet, toni që u jep proceseve jetësore nëpër situata të veçanta dhe rrethanat e krijuara e zgjojnë kërshtërinë e lexuesit. Pa dyshim se tema është provokuese dhe jep mundësi konstruktive artistike të situatave që e bëjnë për vete lexuesin.

13.03.1996

U PROMOVUA LIBRI “GUXIM SHQIPTAR” I AUTORIT FORI BRUQI

Të shtunën, në Prishtinë, është promovuar libri, i autorit Flori Bruqi, ”Guxim shqiptar”, i cili nga recensuesit u cilësua si një libër madhor historik që sjellë material me interes të veçantë.

Recensuesi i librit “Guxim Shqiptar”, profesor akademik Namik Shehu, i cili kishte ardhur enkas nga Shtetet e Bashkuara për këtë promovim libri, tha me këtë rast se këtë libër do ta konsiderojë si një libër madhor historik, i cili me përmbajtjen e saj sjellë historinë dhe gjithë ngjarjen deri në ditët e sotme, duke dhënë një informacion të gjatë, që sjellë interes të veçantë për secilin lexues, e në veçanti për ata që nuk e njohin mirë Kosovën.

“Unë e kam konsideruar Flori Bruqin intelektual të shquar, shkrimtar, shkencëtar dhe me këto epitete unë kam përshkruar gjithë recensionin e librit tim me dashuri. Libri është një libër madhor, është një meritë e veçantë e autorit, është nder i Kosovës dhe i gjithë Shqipërisë për këtë vepër që ka bërë Flori Bruqi,” tha Shehu.

Ai e cilësoi librin si një vepër të ndritur, e cila sjellë në përmbajtjet e saj plot ngjarje që më të vërtetë të tronditin në disa aspekte.

Ndërsa, recensuesi tjetër i librit, Abdullah Konushevc, autorin e librit e cilësoi si njeri të devotshëm dhe i aftë për kryerjen e detyrës. Kurse, librin “Guxim Shqiptar”, ai e cilësoi si një libër me të cilin lexuesi mund të njihet me tema të ndryshme, me luftërat, artikulli për Ramushin, antropologjia e racës së shqiptarëve, kapituj politik, kapitujt që i kushtohen Gjuhës dhe Letërsisë, trajtimi i temave për trevat shqiptare, si dhe një varg temash nga Letërsia botërore.

Libri “Guxim Shqiptar”, i autorit Flori Bruqi është libri i 25 me radhë i veprimtarisë së tij botuese. /A.Ademi/

Prishtinë, 17 maj 2008 (Kosovapress)

SFIDA SHKENCORE TË NJË LIBRI TË GUXIMSHËM...

Akademik, Prof.Dr. Namik M. Shehu,

Sekretari shkencor i Akademisë Shqiptaro-Amerikane, Nju-Jork

Libri a përmbledhja e studimeve “Guxim shqiptar“, e intelektualit, studiuesit dhe shkencëtarit Flori Bruqi, konceptohet si një punim kompleks historiko-letraro-shkencor me vlera, përmasa dhe hapësira shumëdimensionale, të përfshira në tetë kapituj, me 45 tematika, dhe me 382 faqe; me materiale mjaft të zgjedhura dhe me interes, të studiuara dhe të përpunuara me kujdes të veçantë dhe të shkruara me vërtetësi reale, historike dhe kombëtare; në të cilën përmbledhet një game e gjerë dhe mjaft e larmishme e shumë fushave të jetës të së kaluarës dhe të së përditshmes, që kërkohen dhe janë të nevojshme të njihen, të mësohen dhe të përvetësohen nga gjithësecili, për t’u bërë pjesë e aktiviteteve të tyre në punë dhe në veprimtari. Titulli i librit “Guxim shqiptar” përbën në vetvete një vlerësim special dhe një gjetje shumë të goditur të autorit, shprehur në mënyrë simbolike, që i lejon çdo patrioti shqiptar, me ndjenjë atdhedashurie, të zgjojë dhe të ringjallë tek ai: kombin (etnik) shqiptar, popullin e lashtë pellazgjiko-Ilirio-shqiptar, legjendat e kahershme martire edhe të Mujës dhe Halilit, traditat zakonore, besën shqiptare, trimëritë heroike, të koduara në kanune dhe të trashëguara brez pas brezi si të shenjta dhe të paprekshme, duke u bërë simbol i vëllazërimit ballkanik, si është treguar gjatë historisë shekullore dhe të propoganduar nga të huajt. Konsiderata më e veçantë e librit duhet të jetë përfundimi që do të nxjerrë lexuesi nga leximi i librit, i cili mendoj dhe konkludoj se do të përmbledhet në qëllimin që i ka përkushtuar vetes autori: në kontributin, mbështetjen dhe dashurinë që manifeston ai për Mëmëdheun, duke Ju përkushtuar në gjithçka dhe për çdo gjë, që qartazi shprehet dhe duket gati në çdo artikull që lexohet në libër, ku ndihet dhe konceptohet patriotizmi, ndjenja atdhetare, emri ilir, epirotas, arbëresh, shqiptar, që kudo e ndesh. Shkurt, nënkuptohet boshti ideor atdhetar, i pushtuar me brezin e kuq shqiptar mbarëkombëtar. Ndërsa, vlera e vetë autorit Flori Bruqi duhet çmuar dhe admiruar me korrektësi dhe me modesti, përpara këtij punimi vëllimor, me tematikë të shumëllojshme, të profileve të ndryshme dhe me materiale të bollshme dhe me vështirësi

interpretuese; të cilat janë paraqitur me mjeshtëri, me një mori njohjesh teknike, profesionale dhe artistike, të cilat i kanë dashur autorit kohë, mund, sakrifica dhe mjaft durim për t'i përballuar dhe për të arritur suksesin e merituar. Ato duhet ta gjejnë shpjegimin e vet të vlerësimit në përgatitjen e tij të lart profesionale, në njohjen mjaft të mirë të gjuhës shqipe, të pastërtisë dhe rrjedhshmërisë së saj, si dhe të shumë gjuhëve të huaja, të profesionit të vet; të vullnetit dhe durimit të një intelektualit të aftë, mjaft aktive dhe konsekuent për t'ia arritur qëllimit. Bindje për këtë mund të formosh nëse u referohesh punimeve dhe veprimtarisë letrare, artistike dhe shkencore që ka realizuar dhe kryer autori, në një kohë të shkurtër, ku brenda 11 vjetëve ka shkruar 24 vepra madhore të gjinive të ndryshme si dhe mjaft shkrime shkencore, që e kanë detyruar të bëjë “haram“ edhe gjumin. Zbërthimi analitik që mund dhe duhet t'i bëhet librit “Guxim shqiptar” është shpërblimi më adekuat, më i pranueshëm dhe më i zakonshëm që kërkon dhe që duhet t'i jepet me të drejtë autorit, siç e meriton, me gjithë vështirësitë objektive dhe subjektive që hasen. Në kapitullin e parë mbi “Lashtësinë e historisë“ autori ka meritë se ka ditur të zgjedhë dhe të na përfaqësojë historinë tonë në periudha kohe të ndryshme, duke përfshirë tërë territorin iliro-arbëror me tema të denja, historikisht dinjitoze, me mburrje kombëtare dhe me të kaluar heroike. Shkrimi “Pirrua i Epirit”, kontibut i z. Sitky Jahjaj, i qëmtuar me vërtetësi nga autori Bruqi, është mjaft i qëlluar në këtë libër; se na njeh me sundimtarin më të shquar të Epirit, pasardhës i Akilit, i biri i Aiakidit dhe përfaqësues i denjë iliro-epirot dhe strateg i zoti, që diti të fitonte mbretërinë e humbur më 296 p.e.s. dhe që epirotët për trimërinë e tij e thërritnin “shqiponjë” dhe ushtarët ai i quante “bij të shqipes”, duke krijuar më pas traditën shqiptare. Pirrua e rriti autoritetin e tij dhe të epirotasve, pellazgjiko-ilir me aftësi, trimëri dhe zgjuarsi, sa maqedonasit e shëmbëllyen me Aleksandrin e Madh dhe e ftuan për ta udhëhequr. Pirrua ëndërronte perandori në perëndim. Ai i shkoi në ndihmë Tarantos kundër romakëve, që vërtet fitoi, por në histori ka hyrë me shprehjen “ fitore si e Pirros “. Ai, në Sicili, më 278 p.e.s. mundi kartagjenasit; por karriera e tij aq e lavdishme u shemb në muret e Argosit nga goditja e një gruaje. Artikulli “ Beteja e Kosovës 1389 dhe kontributi i shqiptarëve “është një meritë tjetër e autorit, sepse evidencon rëndësinë e betejës së Kosovës si bashkim-unitet i ballkanasve kundër Perandorisë Osmane, si vendi i betejës së Fushë-Kosovës, të pjesëmarrjes së popullsisë masive të krahinës së Kosovës dhe vlerëson Milosh Kopiliqin si trim kosovar, i quajtur edhe princ arbëror, që Car Llazari, mbreti i Serbisë dhe komandanti i betejës së Kosovës, pranoi të zhvillonte një bisedë “kokë më kokë” me të si një komandant ushtrie, me historinë e një trimi që vrau sulltan Muratin II dhe ra si dëshmor, kurse popullsia

kosovare e përjetësoi në këngë dhe e ktheu në legjendë të vërtetën e tij. Në këtë betejë të koalicionit ballkanik, autori ka meritë se e pësjtjellon ngjarjen me korrektësi. Faktin bashkëpunimin e dhëndurëve të Car Lllazarit, Gjergj Ballshajt dhe Vuk Brankoviçit me takimin e tij në 1388 për koalicion, se përmend luftëtarët e shquar shqiptarë, si: Gjergj Ballshaj, Theodor II Muzakaj i Beratit, i cili u vra në betejë, për të cilët flasin edhe kronikat turke; se Beteja e Kosovës u mbështet nga një koalicion i gjerë, ku morën pjesë serbët, Vuk Brankoviç që drejtonte popullatën e Kosovës, shqiptarët dhe boshnjakët, duke iu kundërvënë historiografisë falsifikuese serbe, që mohon forcat e koalicionit, injoron historinë, ul vlerën e pjesëmarrjes së shqiptarëve dhe të boshnjakëve dhe akoma më keq, Milosh Kopiliqin e bëjnë serb dhe i shtrembërojnë mbiemrin. Këto konfirmohen nga vetë serbët, që u “zgjuan” vonë për ta njohur, besuar dhe për ta propaganduar betejën e Kosovës si mit në favor të tyre, kur etnologu Vuk Karaxhiç u kujtua dhe mblodhi disa rapsodi nga një i verbër rreth betejës së Kosovës, që më pas i besuan dhe ata vetë. Çudia vazhdoi edhe në ditët tona, shpjegon autori, kur Slobodan Millosheviç, për interesat e veta, të forcimit të pushtetit politik dhe moral, mitin e betejës së Kosovës e ktheu në thirrje për unitet, ku gjente edhe shkakun e humbjes së betejës dhe për jehonë organizoi 600-vjetorin e saj me pretekst për të rindërtuar apo dëbuar shqiptarët dhe për të luftuar kundër pavarësisë së Kosovës me terma të irredentizmit islamik, të terrorizmit, apo krimit të organizuar, të fabrikuar po nga ata vetë.

Mbrojta e Plavës dhe e Gucisë e viteve 1879-1880 është një dukuri tjetër e autorit, që dëshmon për atdhetarizëm, duke dokumentuar heroizmin dhe patriotizmin e pashoq të krahinës së Plavës dhe të Gucisë, të heroit të krahinës, Ali Pash Gucisë me shokë, të Kosovës, të Lidhjes së Prizërenit, të gjithë Shqipërisë, në mbrojtje të së drejtës dhe të tokave shqiptare, me vendosmëri, me luftë të pandërprerë, me gjakderdhje të pashoqe dhe me diplomaci kundër malazezëve, që sulmuan dy here në mënyrë të organizuar dhe me egërsi për të pushtuar Plavën dhe Gucinë në dhjetor 1879 dhe në janar 1880, por u sprapsën me trimëri, me guxim nga forcat e organizuara shqiptare, edhe pse u përdor dredhia dhe përkrahja e Fuqive të Mëdha. Evropa e kuptoj më në fund se vendi atje ka zot shqiptarët.

Dëshmitë dhe faktet angleze mbi konfliktin shqiptaro-malazez rreth Plavës dhe Gucisë të viteve 1879-1880 të përmbledhura në librin e studiuesit Idris Lamaj botuar në Nju-Jork në 1999; konfirmojnë pa ekuivokë shkrimin e autorit Bruqi.

Në vazhdim përmendim artikullin” Skënderbeu dhe rëndësia e infrastrukturës

logjistike për të udhëhequr luftën “që autori me të drejtë e paraqet si një aspekt të rëndësishëm dhe tepër të veçantë të epokës luftarake të Gjergj Kastriotit, që historiografia dhe Sesioni Shkencor i Akademisë tonë, kushtuar 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut e kishin mënjanuar atë, duke e kthyer në legjendë strategjinë dhe betejat e tij luftarake, të cilat mbeten si të fundit .Ky shkrim shfaq interes dhe ka vlerë se për herë të parë evidentohet një koncept i ri, një ekspozim i një faze përgatitore dhe një moment vendimtar që duhet t’i jepet rëndësi në arritjen e suksesit të fitores së betejave, të vlerësuara me të drejtë edhe nga vetë Skënderbeu, që del më se qartas në artikull. Sekretit i Gjergj Kastrioti –Skënderbeut, që i rezistoi Perandorisë Osman dhe fitoi, i dedikohet jo vetëm se ishte vërtet i zoti si strateg, por më tepër se ai iu kushtua dhe kuptoi rëndësinë e infrastrukturës logjistike për të udhëhequr luftën, duke u mbështetur nga suita e tij jofisnike, përbërë nga klerikë, e nga grupi i tij laik, që kryenin punën e diplomacisë, të legatave në qytetet e Italisë, të tregtisë, të lidhjes e bashkëpunimit me shtetet fqinje të Evropës Juglindore dhe Perëndimore nga ku siguronte paranë, armatimet, pagesën e mirë të ushtarëve, bazën financiare dhe organizimin. Në këtë shkrim del se si strategji të tij, Skënderbeu kishte Rodonin si kështjellën kryesore dhe se Lezha për të ishte udhë-lidhëse midis detit dhe malësisë . Shkrim tjetër kurioz, origjinal dhe me interes mbetet “Napoleon Bonaparti dhe shqiptarët”, ku autori jep informacione, njoftime historiko-premtuese mbi origjinën autentike edhe të mbiemrit të Napoleonit, perandorit të Francës .Studimet e autorit hapin fushë veprimi, sjellin burime të besueshme, mendime dhe citime optimiste të mjaft autorëve autoritarë të huaj, që na konfirmojnë bindjen dhe konsideratën që kanë të huajt të pranojnë se heronjtë e tyre kanë origjinë shqiptare dhe që meritojnë përgëzime. Shkrimi sjell citimin e R. Anzhelit, që kujtonte botës se Napoleoni është po aq shqiptar sa edhe Aleksandri i Madh dhe Skënderbeu, ku folklori popullor e ka rrënjësuar në këngë: Ti shqipe ishe e Aleksandrit , zaptove botën dhe vajte deri në Indi. Me Pirron vojte kundra romakëve me Skënderbeun pëmbi osmanllinj. Na kujton dëshminë e Xhozefinës për prejardhjen nga Mali i Peloponezit të Napoleonit, thënien e vëllait të Napoleonit se kemi orgjinë arbëreshe, afrimi i Napoleonit me Ali pashë Tepelenën, dënimi nga ana e Napoleonit e gjeneralit të tij, që i theu në besë shqiptarët, si dhe supozimet se a dinte shqip Napoleoni, a i njihnte zakonet shqiptare, na mbushin me krenari të ligjshme se trualli iliro-shqiptar ka rritur brezni trimash dhe burra të mëdhenj shteti, duke sjellë plot shembuj edhe nga historia.

Kapitulli i Dytë: Për Ramushin

I. “Dora e Zezë e serbëve vret çlirimtarët e Kosovës”

(Intervistë me Z. Adem Demaçi).

Intervista me z. A. Demaçin duket mjaft serioze, e bërë në kohë të përshtatshme, me përmbajtje shumë dinjitoze dhe përbën një thirrje për drejtësi, për patriotizëm dhe dinjitet njerëzor. Përgjigjet janë parimore, mendimet janë të çiltra, realiste, burrërore, objektive dhe pa dorashka. I. “Dora e Zezë e serbëve vret çlirimtarët e Kosovës” (Intervistë me Z. Adem Demaçi).

II. “Hero në luftë, hero në paqe – Ramush Haradinaj

”Titullin e shkrimit e konsideroj mjaft të përshtatshëm, emrin shumë të merituar, ndërsa përshkrimi mendoj se duhet të ishte më heroik, siç është, siç njihet dhe siç kërkohet të dihet për situatën dhe jo thjesht biografik. Akademia jonë në vitin 2005 ka reaguar me një letër ndaj Gjykatës Ndërkombëtare në Hagë në mbrojtje të Ramush Haradinajt me këtë tekst: Krimineli dhe viktima nuk mund të ulen në një bankë gjykimi.

III. Ramushi – viktimë e situatës (neo) koloniale

Shkrimi mendoj se është një portretizim i denjë i figurës së Ramushit, ku përshkruhen kontributi dhe meritat e tij të padiskutueshme, puna dhe veprimtaria e tij prej një aktivisti, luftëtari dhe udhëheqësi trim dhe patriot. Atë e karakterizon burrëria e pashoq, guximi, zgjuarsia dhe drejtësia, për të përballuar padrejtësitë dhe akuzat e sajara. Sugjeroj që figurës së Ramush Haradinit t’i jepet një vend më i merituar, më patriotik dhe më dinjitoz siç e meriton dhe e do situata.

Kapitulli i tretë: Antropologjia .

“Jakov Milaj dhe raca shqiptare”.

Shkrimi është një kontribut i spikatur i autorit, që çmon librin “Raca Shqiptare” si një vepër dinjitoze, që nxjerr në pah për herë të parë dhe në mënyrë më të plotë, veçoritë antropologjike të shqiptarëve, duke i vlerësuar jo vetëm si një komb i kulturuar, por e përcakton me një prejardhje gjenetike sui generis, duke e veçuar si një racë që vërteton origjinën dhe identitetin shqiptar.

Ai na e kujton racën shqiptare, për ta besuar vetveten shqiptari, për ta njohur

atë, se populli i Arbrit ka një origjinë të vetme, të përbashkët dhe autentike, në të gjithë vendin ku banon, pa pasur ndryshime esenciale ndaj përkatësisë fetare, krahinore, toskë apo gegë; por ka nevojë për një politikë shoqërore, që të mbrojë figurën fizike të racës shqiptare.

Autori argumenton qartë dhe me fakte bindëse se vepra e Jakovit zë një vend të merituar në literaturën antropologjike shqiptare, se evidenton dukshëm cilësitë fizike, pasqyron filozofinë, shkencën dhe terminologjinë e kohës së vet dhe merr shumë informacione të vyera, ku njihet me tipat fizikë në evolucionin e tyre, që e përcaktojnë shqiptarinë si race të veçantë. Flori Bruqi u kundërvihet me të drejtë, me argumente dhe fakte bindëse disa “studiuesve modernë”, që duan t’i errësojnë vlerat e punimit shkencor të Jakov Milajt.

Kapitulli i Katërt. Politika

Arvanitasit, Çamëria, Epiri i Veriut dhe gjendja sot

Shkrimi evidenton me mjeshhtëri, me hollësi, me dokumente dhe me fakte historike: 1. Djallëzitë e qarqeve greke ndaj popullit arvanitas, që i dha pavarësinë popullit grek, ku mbi 90 % e tyre me heronjtë legjendarë, si: Xhavellon, Boçarin, Bubulina etj.; u bënë therorë në luftë.

2. Gjenocidin e egër të shovinistëve grekë me Venizellon në krye ndaj popullit çam autokton, parahelenik në token e tyre, të cilët i shfarosën, i dëbuan mbi 30 mijë çamë dhe i persekutuan, duke a u marrë tokat dhe gjithë pasurinë në sy të Fuqive të Mëdha.

3. Agresivitetin dhe armiqësinë ndaj fqinjët të tyre Shqipërisë për pretendimet absurde dhe të padrejta për Vorio-Epirin, duke bërë vrasje, tortura, djegie dhe dëbime masive me dijeni të Evropës.

4. Padrejtësitë ndaj Shqipërisë, duke e copëtuar më dysh në 1913 si dhe pabesinë ndaj popujve fqinjë dhe dinakërisë që kanë treguar ndaj Fuqive të Mëdha. Autori përmend me argumente qëndrimin agresiv të qarqeve greke, që mbajtën gjatë periudhës së demokracisë, ku dogjën shkolla, fshatra dhe bënë tortura dhe masakra që të kujtojnë periudhën e kaluar.

Dëshmi e qartë e dinakërisë dhe djallëzisë së tyre, që nuk njih kufi, është dhe

ardhja e Janullatosit si kryefetar i ortodoksëve shqiptar, për të sjellë ngatërresa ndërftare.

Artikulli mbetet si një akt mbështetës, nxitës dhe si një dokument me rëndësi për popullin çam për të kërkuar të drejtat e tyre legjitime, nëpërmjet të gjitha formave deri në Strazburg, me anën e organizatës së tyre politike.

A ka intifadë shqiptare në Iliridë?

Artikulli është i parapëlqyer se nxjerr në dukje dhe merr më shumë në konsideratë përpjekjet e shqiptarëve të Iliridës, për të fituar dhe konfirmuar me ligje dhe me kushtetutë të drejtat e mbi 40 % të shqiptarëve në shtetin maqedon. Ai mbështet miratimin e të drejtave të njeriut, gjuhën amtare, flamurin kombëtar, njohjen e identitetit dhe të zakoneve të popullit shqiptar, të padiskutueshëm për një komb.

Pushtetarët e kanë frikë heroin e demokracisë.

Shkrimi nxjerr në dritë një të vërtetë aktuale, që duhet të bëhet shembull i një veprimtarie të guximshme vetëmohuese dhe burrërore në mbrojtje të të drejtave të popullit të tij të shumëvujtur dhenxit rininë për t'u bërë flamurtare në interes të atdheut. Nder, respekt dhe krenari është përcaktimi i Albin Kurtit, që mbetet një shembull frymëzimi për të gjithë rininë kosovare.

Mirupafshim në Kosovën e lirë.

Përbën një përgjigje mjaft sfiduese, shumë kuptimplote dhe tepër korrekte për kërkesën absurde dhe të papërgjegjshme, që bën një pretendues që mban edhe petkun e zi të një kleriku, kur me dashje harron arkivat e Raguzës, të Gazulit, Buzukut etj.

A do të ketë një Nuremberg Shqiptar për komunistët dhe krimet e tyre?

E vlerësuar si një deklaratë që bënë jehonë dhe formulon një thirrje për drejtësi, ajo duhet të konsiderohet si nxitëse për të gjetur zgjidhje sa më objektive dhe në një kohë sa më të përshtatshme.

Kapitulli i pestë. Spiunazhi

Agjentura greke dhe Sigurimi i fshehtë i Shtetit Shqiptar.

Autori Flori Bruqi me të drejtë na njeh në libër me këtë material faktik, për të na vënë në dijeni më mirë edhe më tepër për ndërhyrjet, pabesitë, agresionin dhe spiunazhin grek ndaj Shqipërisë, popullit dhe kufijve të tij, të nisur prej kohësh qysh gjatë periudhës së Luftës Nacional-Çlirimtare. Aty evidentohen me fakte, dëshmi dhe me deklarata nga spiuni grek, të deponuar para seancave gjyqësore të gjykatës shqiptare, për grupet e spiunazhit, të rrjeteve organizuese dhe të çetave veri-epirote, që kryenin masakra, tortura dhe shkatërrime në dëm të popullit dhe të shtetit shqiptar.

Kush janë agjentët me influence në Kosovë?

Në shkrim njihemi me fakte dhe dokumente mjaft interesante të sigurimit të fshehtë, që kanë shërbyer si forcë lëvizëse në situata kritike, duke lozur rol vendimtar edhe më të fuqishëm se forca ushtarake apo diplomacia për të arritur fitoren. Për ta bërë më bindëse forcën e sigurimit, sillen fakte nga historia e sh. III p.e.s. të Sun Xus, që thoshte se spiuni është i domosdoshëm. Kujtohet mashtrimi i kalit të Trojës, apo aftësitë e spiunazhit rus të Zorkit në Japoni, ose lufta e spiunazhit midis KGB dhe CIA, që përmbysi pushtetin sovjetik si dhe së fundi terrorizmi i 11 shtatorit 2001, që kanë dëshmuar për forcën kolosale të sigurimit dhe të organizimit të fshehtë në arritjen e fitores. Në këtë aspekt, thuhet në shkrim, duhet parë agjentura e spiunazhit të fshehtë serb në Kosovë, që ka punuar dhe punon nga të gjithë krahët, duke rekrutuar kosovarë të gënjyer në bashkëpunim me mendjen e djallëzuar për të krijuar frontin e spiunazhit që e ka tronditur Kosovën. Agjentët më të rrezikshëm në Kosovë mbeten spiunazhi – sigurimi i fshehtë dhe organizmat klandestinë, që kanë vepruar në mënyra të fuqishme, të padukshme e mashtruese dhe të paraqitura si mjete më të fuqishme se çdo armë vepruese, që arrin të parashikojë dhe të paralajmërojë fitoren.

Kapitulli i gjashtë. Gjuhë, letërsi

Artikulli vlerësohet si një përshkrim, prezantim dhe studim i thellë dhe i përpunuar i historisë dhe shkencës së origjinës së gjuhës shqipe, e përcaktuar siç është e vetme në familjen paraindoevropiane, duke u përballuar me dy teza : të ilirishtes më të besueshme dhe të trakishtes; të denja dhe të dokumentuara nga

albanologët e huaj dhe vendës. Gjuha shqipe autoktone në Ballkan, e pellazgëve me “figurë hënore“, që autori e nxjerr të shkruar nga viti 1462, por që dokumentet e fundit e sjellin edhe më herët rreth 1200, të zbuluar në Vatikan.; kurse logjika natyrisht të çon akoma më herët.

Ndjen kënaqësi dhe krenari kombëtare, kur njihesh me fakte historike nga të huajt, nga klerikët shqiptar dhe nga albanologët tanë mbi gjuhën shqipe të shkruar, mbi alfabetet e krijuara, të përpunuar në kongreset gjuhësore, të ngritur në gjuhë standarde, të njohur me veçoritë e gjuhës sonë, të elaboruar nga korifentët: K. Kristoforidhi, E. Çabej, A. Buda, M. Domi, I. Ajeti dhe nga arbëreshët me në krye J. De Rada dhe që kjo gjuhë e Naimit po flitet sot nga 15 milionë shqiptarë në botë dhe nga 7 milionë vendës në Ballkan, si dhe nga albanologë në shumë shtete, dhe po mësohet në shumë universitete të botës dhe ku gjen libra shqip në vendet më të zhvilluara të rruzullit tokësor. Rëndësia e këtij artikulli qëndron në faktin se aty gjendet gjithçka që duhet, e shkruar me kujdes, me vërtetësi, me hollësi dhe në baza shkencore.

Censura dhe shterpësia letrare.

E konsideroj një diskutim filozofik me objektivitet real, gjetjen dhe shqyrtimin e vërtetësisë letrare atje ku nuk ka krijimtari të lire, të vërtetë, por të censuruar. Atje ku shkrimtari bëhet i vetëdijshëm se ai sheh, ndjen dhe mendon, por nuk mund t’i thotë, se të tjera është i shtrënguar të shpreh, edhe pse vetë nuk i beson. Kështu, ca heshtin, të tjerë mundohen të bëhen përkthyes dhe ndokush i fut shkrimet në sirtar, se kështu i duket më drejt për t’i ruajtur; duke konkluduar se censura censuron ata që pranojnë të censurohen – servilët e regjimit.

Materiali i autorit i shtjellon me hollësi dhe nxjerr si përfundim se censura të shpije në shterpësi letrare, që në regjimin totalitar, krijuesi dhe artisti arrijnë të kthehen në një zanatçi, të instrumentalizohen dhe të diktohen nga censuruesi, duke i dhënë tema të gatshme për të shkruar, për ta depersonalizuar; për të qenë pa personalitet, pa vullnet, pa dëshirë dhe pa dashuri.

Kjo ka sjell si konkluzion edhe boshllëkun që ekziston edhe në ditët e sotme në letërsi, që po kthehet në imitim të perëndimorëve. Autori diskuton edhe si dëm në letërsinë shqipe përkthimet e veprave të I. Kadaresë nga Jusuf Vrioni, në aspektin se janë përkthyer vepra shqip në gjuhë të huaj, që nuk sjellin aq vlera letrare, se sa përkthimet e letërsisë nga gjuhët e huaja në shqip, se kontribuojnë më shumë dhe krijojnë horizont më të gjerë letrar, duke detyruar disa shkrimtarë të heqin dorë nga të shkruarit në kohën e diktaturës.

Lavdi De Radës.

Kjo jehonë dhe thirrje evidenton personalitetin dhe autoritetin e figurës më të shquar letrare të letërsisë së re, që përfaqësoi me dinjitet iluminizmin e ndritur, që do të lindte dhe do të frymëzonte patriotizmin, idealizmin, traditat dhe heroizmin e popullit shqiptar. J. De Rada lëvroi me mjeshtëri, me zgjuars, me shumë kujdes dhe me aftësi profesionale rapsodinë shqiptare, duke sjellë një xhevahir të traditës gojore popullore, shpalljen e Milosaos në 1836 si kryevepër e parë shqiptare në botën shqiptare, duke i thurur lavdi trashëgimisë popullore dhe detyroi të zgjohej kureshtja e të huajve La Martin dhe Ygo, që ta admirojnë etj. Ai shkroi vargun e famshëm "Erdhi ditë e Arbrit", duke dhënë kushtimin se dy shtetet e veriut të Bushatllijve dhe e jugut të Ali pashës, nuk u varrosën, por janë ripërtërirë me idenë e re të çlirimit kombëtar.

Jetoi gjatë dhe prapë Arbërinë të lirë nuk e pa, por edhe kur u bë e përgjysmuar Shqipëria, atë nuk e njohu dot se ajo ishte analfabete.

Branko Merxhani. Ky emër i harruar i gazetarisë shqiptare

Përmendet me të drejtë si një nga penat më të spikatura dhe më të mprehta të viteve '30-të në Shqipëri, si gazetar, publicist dhe përkrahës i idesë së neoshqiptarizmit për një zhvillim kulturor jashtë politikës dhe u dallua si një aktivist i palodhur, për përhapjen e dijes dhe të atdhetarizmit, kudo ku punoi në Shqipëri, Athinë e në Turqi. Bashkëpunorët e tij, Nexhip Alpani dhe Petrua flasin me respekt për kontributin e vlefshëm dhënë në publicitet, ndërsa Flori Bruqi me konsideratë shprehet: figura e harruar e Branko Merxhanit duhet të nderohet, të respektohet dhe të vlerësohet me dinjitet në median e sotme.

Ismail Kadare.

Në librin kronik në gurë, thotë autori, dëshiron të ndryshojë rrjedhën e romaneve si nga ana e paraqitjes dhe të ngjarjeve, megjithëse shfaqen edhe shumë mendime dhe alternativa komplekse; por duket se ajo po ndjek vazhden e luftës, për të reflektuar dhe për t'i parë personazhet me syrin e një fëmije, të vetvetes, pa pasur ndonjë ndikim partishmërie, duke pasqyruar edhe vlerat e një rëndësie etnografike që Gjirokastra e ka pasur traditë.

Klasikët e romanit postmodernë.

Është në nderin e autorit që në librin e tij diti të zgjedhë dhe të përfshijë tri personalitetet më të denja, më të kërkuara dhe më të zgjedhura, që kanë bërë emër dhe e kanë përfaqësuar me autoritet dhe me dinjitet epokën postmoderne me veprat e tyre. Le t'i përmendim për respekt: Valero Massimo Manfredin me trilogjinë e Aleksandrit të Madh, Umberto Eco me Flakët misterioze të mbretëreshës Loana dhe Aleksander Bariccon me Novoçenton apo Legjendën e pianistit, të tre autorë, me tri histori dhe vetëm me tri romane, sollën imazhin e tri epokave, duke pasur vetëm dy gjëra të përbashkëta: atdheun -Italinë dhe famën e tyre ndërkombëtare.

Homeri dhe Odisea nuk kthehen më në truallin grek.

Artikulli evidenton me hollësi dhe me fakte krizën dhe vështirësitë që po has letërsia greke për të kapërcyer izolimin kombëtar të literatures së vendit, e cila u vu në dukje më së qarti në panairin e Frankfurtit në gjermani. Grekërit po përpiqen të mbijetojnë, nga mbiprodhimi i botimeve, që i sjellin në jetë më lehtë se fëmijët e tyre. Po përkthejnë sa më shumë në gjuhë të huaj, hoqën dorë nga fjalori mitologjik grek dhe nga Homeri, që ishte krenaria e tyre, siç bëri Elitys, edhe sepse ishte formuar boshllëk i madh mbi dymijëvjeçar, nga lulëzimi helenik, që akuzohet se kishte vjedhur mite dhe legjenda nga lindja.

Në 60-vjetorin e lindjes së shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Bardhosh Gërvalla.

I njohur si intelektual me merita, autori thekson se nuk duhet të harrohet, por të çmohet si shkrimtar me vlera të larta si poet, prozator, dramaturg, atdhetar, si një figurë poliedrike dhe simbol i kombit, mbasi mbetet edhe nga më prodhimtarët në trashëgiminë e dorëshkrimeve.

A është Rifat Kukaj një thesar shqiptar?

Vlerësohet si një veprimtar mjaft inkurajues, që ka shkruar mbi 40 vepra letrare, libra dhe romane dhe mbi 30 punime të dramatizuara, duke arritur një sukses të merituar në lëmin e letërsisë, ku spikatin proza dhe poezia, të vlerësuara edhe me shumë çmime. Kontribut të veçantë ka dhënë në edukimin e brezit të ri dhe në letërsinë e fëmijëve.

Në vend të përkujtimit: Mehmet Kajtazi.

Njihet si gazetar me kontribute të veçanta, por ka shkruar edhe vepra letrare në poezi dhe në dramë. Përmendet si aktivist dhe atdhetar dhe kujtohet me respekt dhe me nderim për dramën e tij “Një natë e fundit në Goli Otok”, që i kushtohet popullit të tij dhe përshkruan vuajtjet e torturat në këtë kamp internimi. Në kujtim të tij autori përmend shkrimin e tij “Kultura bashkon kombin”.

Kush është Kolec Traboini?

Autori me dashamirësi përgjigjet se është një shkrimtar, gazetar, publicist, që ka shkruar vepra letrare, prozë, poezi, skenarë, me tematika të ndryshme, të karakterit shoqëror, patriotik, erotik dhe dallohet për një stil të tij origjinal dhe për një humor të hollë me karakter konstruktiv dhe dashamirës. Ai ka drejtuar gazetën Egnatia me përgjegjësi dhe ka dhënë një kontribut të ndjeshëm me shkrimet e tij në hapësirën virtuale me të cilat mund të njiheni edhe në libër.

Kozeta Zylo.

Prezantohet si një aktiviste e dalluar e komunitetit shqiptaro-amerikan e Nju-Jorkut, si një intelektuale dhe pedagoge e respektuar në institutin amerikan Globus në Bruklin, si një publiciste, letrare dhe poete, që po bën karrierë. Intervistat e shumë intelektualëve e vlerësojnë Kozetën si një poete me perspektivë dhe e komentojnë librin e saj poetik, Monumentin si një vepër me perspektivë. Ajo ka shkruar edhe një libër tjetër poetik, ku jepen përshtypje të mira.

Kush është Gani Xhafolli?

Njihet si shkrimtar. që ka publikuar mbi 20 vepra letrare, si poezi, romane dhe është vlerësuar me çmime. Ka ende shumë materiale në dorëshkrime, që presin radhën për t’u botuar. Nga poezitë më tepër i është çmuar libri poetik “Gjeometria e syrit”, për të cilën ka mjaft komentime interesante.

Kush është Nehat S. Hoxha?

Kabëremërsi i letrar, poet dhe përkthyes. Ka shkruar 5 libra artistikë dhe ka përkthyer mbi 18 vepra artistike nga anglishtja, me materiale të filmit artistik, arsimor dhe vizatimor. Ai ka bërë dhe mjaft adaptime për TV, radio, gazeta dhe për revista. Është

një aktivist dhe organizator i palodhur dhe pjesëmarrës në delegacionet e huaja. Muhaxhedinët si “Golden Boys”. Flitet për Bernald Henri Levyn, autor i librit “Kush e vrau Daniel Pearl”, që është një dokument, që bënë një analizë letraropolitike, me aspekte të shumta moralo- kulturore e filozofike; që më shumë se çdo burim i mundshëm, të lehtëson udhëtimin në zemrën e Al- Kaidës dhe është një homazh për një gazetar që mizorisht ekzekutohet pse donte të zbulonte një të fshehtë të vërtetë.

Rekuiem për...

Aty njihemi me përshëndetje, konsiderata dhe alternativa të “përzemërta”!

Persekutimi komunist mbi vajzat e Bajram Currit.

Dëshiroj që artikullin ta parafrazoj me një nënkuptim të lartë për nder të Bac Bajramit, duke shprehur për familjen: Konsideratë të veçantë, respekt, nder, admirim për fisnikërinë, atdhedashurinë, mirësjelljen, mikpritjen që kanë manifestuar pjesëtarët gjatë jetës së tyre me gjithë keqtrajtmet që kanë pësuar. Kjo bëhet edhe në përkushtim të kujtimit të të paharruarit Bajram Curri, heroit legjendar të Kosovës dhe të Shqipërisë.

Polemikë pa dorashka. Klajd Kapinova.

Duke mos dashur të prononcohem ,të më falni; por për të mos qëndruar indiferent, do të dëshiroja të jepja disa mendime shoqërore: I konsideroj si replika të pakuptimta midis intelektualësh. Të pasinqerta midis shoqërisë. Me interpretime jomiqësore për jetën dhe pa baza morale për kohën.

Letër e hapur organizatorëve dhe spektatorëve të koncertit të Goran Bregoviçit. Argumenti : Analizë dhe koment

Konkluzioni që del nga artikulli është më se i qartë: një”akuzë”e drejtë, e ndershme dhe e sinqertë që u drejtohet organizatorëve, edhe pjesëmarrësve dhe një fyerje për popullin shqiptar e sidomos kosovar, që me dashje apo pa dashje ose të rënë në kurth, kanë lejuar një bashkëkombës serb të japë koncert në mes të Tiranës, duke u njohur si i padëshirueshëm, për të penguar pavarësinë e Kosovës me gjithë autoritetin e tij.

Kapitulli i shtatë. Psikoanaliza, Astrologjia dhe Erotika

Ç'është psikologjia, psikanaliza dhe kush është Zigmund Frojd (Siegmond Freud)?

Shkrimin e vlerësoj si një artikull shkencor, përshkruar me mjaft saktësi, me nocione shumë të qarta, korrekte, me karakter filozofik, që përbën një material mjaft të nevojshëm për çdo intelektual të çdo profile. Aty gjen të zërthyer terminologjitë e nevojshme të psikologjisë, psikanalizës dhe të psikoterapisë. Nga leximi me kujdes i materialit del një kokluzion i madh: ne të gjithë kemi nevojë dhe duhet ta njohim më mirë vetveten, megjithëse është e vështirë. Figura e Zigmund Froidit jepet mjaft e qartë, me të gjitha atributet dhe veprimtaritë e tij prej një shkencëtari kolos, që krijoi psikanalizën duke filluar nga vetja e pastaj kaloi tek pacienti.

A duhet besuar Horoskopi?

Ai vlerësohet dhe konsiderohet si një art parashikues, me histori shumëshekullore, me ecuri trashëgimore, me njohje dhe besueshmëri të shumë brezave, të kthyer në “mjete-art-parashikim”, “i besueshëm”, por edhe sfidues. Pra, a duhet besuar? Shkenca i bie shkurt – JO, se s' ka baza shkencore. Po a i mbush mendjen “botës”?! Kjo kushtëzohet me shansin- fatin-ndikimin dhe besimin. Shumëkush e beson astrologjinë qiellore, sepse thuhet se horoskopi gjen gjithçka. Ndoshta! Por, kjo vjen nga besimi i verbër dhe se mendja jonë gënjehet. Mirëpo, ato kanë marrë një përhapje kaq të madhe nëpërmjet shenjave të zodiakut, sa që profecia është kthyer si në një perëndi dhe megjithatë nuk duhet besuar.

Psikologjia erotike.

Të dhënat e paraqitura, ndonëse me informacione të shkurta, dhe me materiale orientuese të sferës erotike, mendoj se nuk do ta justifikonin prezencën e tyre të qëndronin krahas materialit aq serioz historiko-letraro-shkencor që është parashtruar në libër me aq kompetencë dhe dinjitet.

Kapitulli i tetë. Çka janë sëmundjet ngjithëse seksuale?

Shkrimi është një literaturë shkencore – popullore mjaft e nevojshme , shumë e rekomandueshme dhe më se e domosdoshme për t’u njohur nga të gjithë, për të pasur dijeni për sëmundjet seksualisht ngjitëse, për t’u ruajtur, për t’u mbrojtur dhe më në fund edhe për t’u mjekuar. Materiali është mjaft orientues, i asimilueshëm, i kuptueshëm, por ka nevojë edhe për plotësime.

TË DISH TË GUXOSH...

Dr. Izet S. Çuli ,shkrimtar dhe neuropsikiatër-Tiranë

Isha me fat kur mora pjesë për herë të parë në Mitingun e përvitshëm mbarëshqiptar të Poezisë (i dyzetëekatërti) që zhvillohet në Gjakovë. Aty u njoha nga afër me shumë figura të letërsisë e të krijimtarisë nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Shkëmbyem me dhjetra libra me njëri-tjetrin. Kur i kalova të gjitha në “sitë”, zgjodha për të filluar leximin e tyre me veprën frymëgjatë “GUXIM SHQIPTAR” (2008) të Flor Bruqit. U ngusha me autorin kryekreje tek MURI I DHEMBJES, ku ne homazhonim; si edhe në darkën përshëndetëse, kur grupit tonë nga Shqipëria, iu dha rasti të ishte në një tavolinë me Z. Kadrush Radogoshi, Abdullah Konushevski, Flori Bruqi, Kristaq Shabani, Agron Shele, Bora Balaj etj. Mbasi e përpiva librin e Bruqit, iu ktheva përsëri dhe mendova nëse mund të arrija të hidhja në letër diçka për të, ngase jo të gjithëve mund t’ju bjerë në dorë libri i tij. Po kush është vetë autori i këtij botimi me 400 faqe, i cili studimet e larta i ka kryer në Prishtinë. Shoh biografinë artistike: me plot 25 vepra të volumshme si: romane, poezi, studime, hulumtime shkencore, historike etj. Një befasim i madh për mua, një zbulesë do të thosha dhe me mjaft punime të virgjërta. Ky libër për mua rangohet nga më të mirët në fushën e vet.

Interesat e Flori Bruqit janë të gjera e të shumanshme dhe me një kohështrirje të madhe nëpër shekuj dhe jo rrallë me këndvështrime origjinale duke na kthjellur më tej disa nga njohuritë tona.

* * *

Le t’i hedhim një vështrim lbrit të tij “GUXIM SHQIPTAR” ashtu sipërfaqësisht se për atë do të duheshin studime zanafillëse e të thella. E nis ai me lashtërinë e popullit tonë dhe pikërisht me Pirron e Epirit, i cili konsiderohet si strategu më i shquar i kohës së vet, që e thërrisnin “Shqiponjë”. Betejës disaditëshe të zhvilluar në Fushë Kosovë (1389), autori i lë mjaft vend në librin e tij stu dimor , e cila ishte më tepër një bashkim rajonal dhe assesi vetëm serb, siç mundohen të thonë sot grafomanët dhe politikanët dështakë, që fabrikojnë frazime të pavërteta (për të serbizuar këtë betejë). Sot ndoshta ka mjaft historianë të tillë trumykur, të palogjiktë e trillanë dhe ndoshta të çmenduruar nga shkurtpamësia e tyre, të cilët janë gjithnjë gojëhapur, po se ç’thonë, pak rëndësi ka për ta! Në këtë përplasje u

shqua Milosh Kopiliqi, mbasi përveç trimërive të tjera, ai vrau Sulltan Muratin I, varrharuar, ndërsa për Miloshin tonë, shqiptarët këndojnë këngë dhe me veprën e tij vendasit mburren edhe sot e kësaj dite. Serbët, të mbështetur nga ustallarët dhe ndihmestarët e tyre epsharakë, e shfrytëzojnë aktin e tij për qëllimet e veta të mbrapshta, kinse për terrorizëm dhe krim të organizuar islamik. Ata, nga ana tjetër, duan të pronarizojnë çka s'mund të pronarizohet, si praktikisht dhe me "studimet" e tyre xhelatore e ekstazore.

Për perudhën skënderbejane dhe Gjergj Kastrioti-Skënderbeun, hero real dhe jo i legjendte, ky kryeluftëtar, ky "poet i madh i politikës shqiptare" -siç shkruan Idro Montanelli, përimitohet shkurtazi këtu dhe çmohet jo vetëm si strateg e prijës i talentuar dhe gjenial, i cili i bëri ballë një superfuqie të kohës (duke shpëtuar Evropën), por edhe si një diplomat, administrator e organizator i zoti, që dinte të përfitonte nga situatat, se ndryshe nuk mund të rezistonte aq trimërisht për 25 vjet dhe të mbijetonte midis ujqërisë. Ai mbetet gjithashtu një humanist dhe iluminist i shquar, një rilindës evropian i klasit të parë.

Me mjaft interes na duhet shkrimi për Napoleon Bonapartin për të cilin sot, sipas shumë studimtarëve seriozë, flitet përherë dhe më shumë për prejardhjen arbëreshe të tij dhe pikërisht nga një fshat i këtillë i Korsikës. Për këtë ia vlen të lexohet edhe libri i shkëlqyer "Enigma" e të madhit Robert d'Angely-t, i sjellë në shqip 10 vjet më parë nga prof. Xhevat Lloshi ("Toena", 1998), ku shprehet për prejardhjen "sigurisht shqiptare, dhe për ta thënë më me përpikëri shqiptare toske) të Napoleonit të madh.

Mbrojtja e Plavës dhe e Gucisë "(tetor 1879-janar 1880)", kthjellon këtu luftrat e mëdha të shqiptarëve, kur është fjala për tërësorinë dhe mbrojtjen e tokave të të parëve tanë në shekuj dhe ku spikatin Ali Pashe Gucia, Mic Sokoli, Sulejman Vokshi. Duhet vlerësuar si një shkrim mjaft i domosdoshëm në librin "Guxim shqiptar" i Flori Bruqit . Ishin kohë të arta, kur vepronte Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Ishin kohë kur derdhej shumë gjak (i cili tanimë s'duhej të shkonte kot), kur kishte aq mllfosje e urrejtje dhe baltosje në shpirt ndaj një vendi që gjithsesi ka ditur të fqinjërojë me të gjithë. E si mund të strehosh kaq dashakeqësi për një popull kaq plagëshumë e dhembjemadh në histori!

Me siguri disa studiuesve të huaj, gojëhelm e gjuhëgjatë, kritikanë të sëmure, ju mungojnë frenat. Shileri shkruante: "Ndër gjërat më të shëmtuara në botë, më e shëmtuara është gjuha që shpif". Po lëri të notojnë në netërinë e tyre! Veç diçka është më se e sigurtë: "Kush nuk shkon përpara, shkon mbrapa"- thoshte Gëtja.

* * *

Në kapitullin pasardhës “Antropologji”, në 12 fletë të mirëfillta shkencore, ndricohet nga kjo fushë shkrimi për Jakov Milaj (ky mik i ngushtë i Migjenit) dhe librin e tij “Raca shqiptare”, në dy botime: 1944,1997. Studimi i Milajt, ndonëse ai nuk ishte antropolog në profesion, ka vlera të mëdha, është burimor dhe zë vendin e gurqoshesë. Aty del mirëfilli rrënjësia e popullit shqiptar, gjenetikisht i përafërt, pa dallesa thelbësore në rrafshin fetar, gjeografik, krahinor etj. Ai u kundërvihet me të drejtë disa kalemxhinjve letërnxirës e shpifjanësh, të cilët duan të vërtetojnë me teoriçkat e tyre vjetërake e pabukse, të kundërtën për racën tonë të pastër dhe me prejardhje të veçantë si askund të ndonjë populli tjetër të Evropës. Është ky komb që ka nxjerrë aq shumë njerëz të mëdhenj e me mendjendrituri në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore; por ngandonjëherë jemi vetë ne shqiptarët që çuditërisht i minimizojmë vlerat e tyre e jo rrallë duke i zeruar fare ato!

Në kapitullin e gjatë “Politikë” (në mbi 50 faqe) Flor Bruqi trajton tema mjaft të mprehta e të rëndësishme, ku e hap siparin me Arvanitasit, Çamërinë, Epirin e Veriut dhe gjendjen e sotme, ku i mëshon faktit të tejhidhur “sesi erdhi dhe u tkurr Epiri shqiptar, i nisur nga interesat e Fuqive të Mëdha dhe në dëmin tonë” –sic shprehet ai. Padrejtësitë nuk kanë të mbaruar ndaj këtij kombi fattragjik, të shumëvuajtur e heqkeq nëpër shekuj. Ja si shkruan romantiku i përbotshëm, poeti Bajron: “Nuk ka komb që të jetë parë nga fqinjët e vet me aq urrejtje dhe tmerr sesa shqiptarët”! E kush nuk e di se në fitoren e Pavarësisë së Greqisë (1829), që i parapriu kryengritja e vitit 1821, 90 për qind e tyre ishin arvanitas me prijës heronjtë legjendarë: Miauli, Xhavella, Kolokotroni, Bubulina Laskarina, Bocari, Aleksandër e Dhimitër Ipsilanti, Andruçi, Karaiskaqi, Koleti, Vulgari, Kanari dhe sa të tjerë.!? Rreth 20 kryeministra në Greqi kanë qenë me prejardhje arvanitase dhe po kështu disa presidentë të saj. Djallëzia është pakufi dhe arrin deri aty sa të “argumentohet”

ajo që s`mund të argumentohet, se kinse popullsia ortodokse në Shqipëri, ishte greke, kurse ajo myslimane-shqiptare, duke u grabitur nga grekët krahina të tëra mbas një hekatombe përbindshore, gjenocidi dhe eksodi masiv të egërsirtë dhe të paparë. “O Zot, ç`padrejtësi !”-thërret me të drejtë gjer në kupë të qiellit z. Bruqi. Si është e mundur të sillësh kështu me një popull, i cili është thinjëruar me pushkë në dorë për vete e për të tjerët?! Si është e mundur të kesh hua për të shlyer dhe të kërkosh pjesë?! Po sa mirë që dinë të tellallisin!

Përsa u përket përplasjeve dhe të drejtave midis shqiptarëve në shtetin maqedon dhe a ka një Intifadë (një term arab, e ashtuquajtura kryengritje violente kundër izraelitëve) të tillë në Maqedoni, autori korrektësisht mbështet të drejtat e njeriut, njëjtësinë, ruajtjen e traditave të shqiptarëve. Për heroin e demokracisë, Albin

Kurtin, shpreh këtu nder, respekt e krenari, qysh nga Nju-Jorku akademiku i Akademisë së shkencave shqiptare-amerikane, prof.Namik Shehu, pikërisht më 12 Maj 2007.Është ky mjek i talentuar dhe pasionant e patriot (një nga recensorët e vëllimit “Guxim shqiptar”, i botuar përfund librit, me mbi 15 faqe), ku këtu kemi rastin të lexojmë në 5-6 faqe edhe një intervistë të goditur, ku jepet një tablo e gjerë e veprimtarisë së tij të madhe shkencore, pedagogjike e shkrimore duke merituar kësisoj mjaft tituj e grada të tilla akademike. Ai tashmë është në plot kuptimin e fjalës një personalitet i spikatur, për të cilin ne duhet të krenarohemi.

Ritheksoj se për interesat e gjera e të gjithanshme të Flori Bruqit flet dhe shkrimi “Kryqëzata e tetë”, ku ai jep të dhëna gjeopolitike dhe gjeostrategjike në Lindjen e Mesme mbas Luftës së tretë të Gjirit, ku ndesh lloj-lloj prapaskenash, që të vënë në mendime: lufta për interesa karburantesh dhe burimesh të mangëta ujore, probleme aq të ditës.

Kapitulli “Spiunazh” është i ndarë në disa nëntituj: I pari bën fjalë për agjunkturën greke që kryente masakra në dëm të popullit shqiptar dhe tjetri shtjellon agjentët, sidomos ata serbë, me ndikesë në Kosovë, veprimet e pashembullta të të cilëve janë të mirënjohura, sigurisht edhe nëpërmjet përfshirjes të mijra kosovarëve të lëkundur e bashkëpunëtorë me të huajin.

Flori Bruqi na njeh më tej me veprimtarinë letrare të Gani Xhafollit, autor i mbi 20 librave, sidomos me poezi dhe romane(veçan atyre me emra të shkurtër “Po” e “Të dua”), të cilët janë vlerësuar me disa çmime letrare. Gjithashtu ai është përkthyer në disa gjuhë të huaja; premtan mjaft në letërsinë tonë dhe botimet e mëpasme do t’a vërtetojnë patjetër këtë. Ndërsa Nehat S. Hoxha me profesion ekonomist, ka publikuar poezi,tregime dhe përkthime (nga anglishtja sidomos dhe me një numër relativisht të madh, afro njëzet prej tyre). E shoqëron edhe këtë autor me një buqetë poezish, si ajo me titull “ Nojma e shqipes” ku nën të shkruan: “ I kushtohet shqipes aq të kamur nga bukuria dhe kaq të drobitur nga robëria” dhe dy të tjerat janë: “I mërguar në Atdhe” dhe “ Hëna në dritare” etj. Më tutje F. Bruqi në nëntitullin “Muxhahedinët si Goldon Boys” fllilëzon odisenë e udhëtimeve të vështirshme të Bernard-Henry-Levit, i cili në librat e tij, vërtet të veçantë në vlerat si në gjini dhe në atë përmbajtësore, homazhon për gazetarin Daniel Pearl, i ekzekutuar nga strukturat gjakësore të Al-Kedës. Ky u vra për të vërtetën që desh të zbulonte dhe të shpaloste para botës, por e deshën më mirë të ishte vetëm një gojëmbyllës i përjetshëm!

* * *

Kapitulli i fundit është ai mbi Psikanalizën (për të cilën kohët e fundit, kolegu im, neuropsikiatri i shquar Miltiadh Veveçka, nën një përkthim mjeshtëror na ka sjellë nga anglishtja librin “Themelet e Psikanalizës” të prof. dr. Çarls Bremerit. Vetë përkthyesi thekson se kjo disiplinë shkencore është si një kockë e fortë për t’u kapërdirë). Po ashtu z. Bruqi tërheq vëmendjen dhe për astrologjinë e erotikën. Pra Flori Bruqi e ka zgjeruar shumë diapazonin tematik duke na paraqitur me kompetencë edhe tema të tilla, të cilat jo të gjitha janë brenda sferës diturake e profesionale të tij. Dhe ja të bëjmë një vështrim të shkurtër:

I lë vend figurës së mjekut neurolog me prejardhje çifute, kandidat të çmimit “Nobel” gjenit Zigmund Froid-it (Sigmund Freud-it), i nismësit, themeltarit të psikanalizës dhe të psikoterapisë së vërtetë. Le të përmendim p.sh. vetëm librin e tij “Shpjegimi i ëndrrës”, (1900) që mund të themi pa drojë se ka revolucionalizuar shkencat psikonervore. “Një zbulesë e këtij lloji i jepet ndonjërit vetëm njëherë në jetë”-shkruan vetë Frojdi më 1931. Shih për këtë përkthimin “Themelet e Psikanalizës të dr Çarls Brenerit, (përkthyer nga dr. i shkencave Miltiadh Veveçka 2008, fq.189).” Po Horoskopi a duhet besuar? – pyet retorikisht F. Bruqi. Shkenca nuk ka si ta pranojë por as “argumenta” nuk gjen ta kundërshtojë.

Në faqet e mëtejshme vazhdon me psikologjinë erotike, me disa terma e njohuri të nevojshme për çdo njeri të kulturuar e të qytetaruar, si dhe me 25 sëmundjet ngjyëse seksuale të njohura e të panjohura nga publiku i gjerë. Ai me këtë rast tërheq vëmendjen për rrezikshmërinë e tyre, por gjithsesi thekson se duhet konsultuar me mjekët përkatës specialistë:seksologë, dermatologë etj.

* * *

Guximi shqiptar është shprehje e trimërisë shqiptare, trashëguar brez pas brezi. Ta ruajmë e ta zhvillojmë këtë cilësi të rrallë të të parëve tanë, që akademi kishim jetën, luftën, kalitjen me vështirësitë, kulti i të cilëve ishte Atdheu, dëshira për ta parë vendin e shqiptonjave të lirë e të pavaruar, fitore kjo që na i siguroi guximshëm Plaku i madh i Vlorës, simbloi i mëvetësisë së Shqipërisë, patrioti i shquar Ismail Qemali. “Guxim,-thotë një fjalë e urtë-është cilësia e parë njerëzore, sepse garanton gjithë të tjerat.” Nuk na mbetet gjë tjetër, veçse të përgëzoj guximtarin kokëplot Flori Bruqi dhe të shpresojmë se në të ardhmen, pa e konfuzionuar lexuesin, si ndonjë tjetër do të na dhurojë libra të këtyllë kuptimthellë si “ GUXIMI SHQIPTAR” (2008), që pos të tjerave kur i mbaron ke dëshire t’u rikthehesh ngase ke mësuar shume prej tyre. Një libër i vëllimshëm nuk të lodh kurrë, kur ka tematikë të pasur dhe gjen mënyrën e bukur sesi i

shtjellon. Është kjo arsyeja që Flori Bruqit t’i dërgoj këtë telegram-urim a SMS. të thjeshtë: “Të lumtë dhe mos e lësho penën nga dora! Ec gjithmonë përpara! Faleminderit!” Le ta mbyll këtë parashtesë të këtij libri me një këshillë të Ismail Qemal Vlorës, për të gjithë ne:”..... të punoni së bashku si vëllezër....!

LUFTA E OPINIONEVE

Rrustem Geci: Ese letrar për librin „Guxim shqiptar“, të shkrimtarit Flori Bruqi

(Nevoja për të fituar lirinë, na detyroi dorën ta bëjmë grusht,dhe troshat e bukës barot)

Libri „Guxim shqiptar“ i shkrimtarit dhe studiusit Flori Bruqi është një libër i arrirë, një libër që lexuesin e tërheq ta lexoj.Temat, motivet, trajtimi, rrjedhshmëria, mesazhi e të tjera kudo janë brenda librit.

Gjithë natën era mbrëmë theu qelqe, porta, pullaze,.. e nata s'kishte të sosur. Në këtë art poetik të poetit Bruqi, libri shpalon shtresat e errësirës,urrejtjen e “bujtësve” këtej, veprimet e tyre prej armiku.

Nuk ishte dëshirë e këtij populli që Kosova të ngjy fjalën në qypin e gjakut. Asnjë betejë në Kosovë nuk ishte pa një pikë gjaku,pa një të rënë në rrënjë të fjalës.Alfabeti i lirisë është ai i moçmi,me pushkë, me dije, me guxim.

Pa pushkën majekrahu të trimave, shprehet Bruqi, liria jonë do të ishte vetëm një dëshirë dhe asgjë më shumë. Libri “Guxim shqiptar” është një dëshmi esesh dhe polemikash se gjakderdhja e madhe, ikja e madhe, dhe kthimi i madh, detyruan bashkësinë ndërkombëtare ta njohin vullnetin e popullit të Kosovës.

Në këtë libër të arrirë, autori Bruqi, ka shtruar me kujdes rreth 73 ese dhe polemika e vështrime kritike nga gjuhësia, historia, antropologjia,politika, spiunazhi, psikoanaliza, astrologjia dhe letersia.

Libri „Guxim shqiptar“ ka një leksik të pasur, të rrjedhshëm e me figura të kohës sonë.

Temat në këtë libër janë nga „ish përditshmëria“ jonë e luftës dhe e opinioneve.

Lufta e Kosovës në këtë libër është me plot guximtarë dhe kryengritës të devotshëm.

Asnjë fjalë e asaj kohe tregon Bruqi nuk ishte pa beteja, pa një guxim në vete. Nevoja për liri krijoka vullnetin për liri.

Nuk ishte i lehtë rebelimi nën atë pushtues.Çdo njeri që nku pajtohej me gjenocidistët serb, ai duhet të ishte trim dhe trim shkuar trimave.Mirëpo,fuqia e popullit është fuqia e pareshtur e betejave të tij.

Në atë kohë të „Guximit shqiptar“ çdo njeri i etnikumit tonë ishte në luftë, në betejën e tij për të mbijetuar.Pak janë ata që janë fshehur hijeve. Në këtë

temë kujtoj se kam shkruar mjaft.Çlirimi i Kosovës nuk ishte i lehtë, për këtë dëshmojnë të rënët.

Flori Bruqi deri më tash ka botuar 30 libra.Libri „Guxim shqiptar“ është libri i 25 me radhë. Krijimtaria e Floriut është e gjerë dhe e thellë.Veprat e Floriut janë të vlerësuara nga kritika.Bruqi është një figurë e madhe në letërsinë tonë...

LIBËR QË SPIKAT ME TEMATIKËN DHE GJERËSINË NJOHËSE TË SHUMË FAKTEVE E TË VËRTETASH

Naim Kelmendi- shkrimtar dhe gazetar nga Prishtina

Do të përmendnim këtu, sidomos vështrimet si Beteja e Kosovës (1389) dhe kontributi i shqiptarëve; Napoleon Bonaparta dhe shqiptarët; Hero në luftë - hero në paqe, Ramush Haradinaj; Ramushi - viktimë e situatës (neo)koloniale; Jakov Milaj dhe raca shqiptare; Arvanitasit, Camëria, Epiri i Veriut dhe gjendja sot; Kush janë agjentët me influencë në Kosovë, dhe mjaft artikuj tjerë interesimesh e lëmenjsh të ndryshëm.

Derisa recensenti, Akademik Prof. Dr. Namik Shehu, për librin “Guxim shqiptar”, do të shprehet:” përbën në vetvete një vlerësim special dhe një gjetje shumë të goditur të autorit, shprehur në mënyrë simbolike, që i lejon çdo patrioti shqiptar, me ndjenjë atdhedashurie, të zgjojë dhe të ringjallë tek ai: kombin (etnik) shqiptar, popullin e lashtë pellazgjiko-iliriko-shqiptar.”

Siç veçon redaktori i librit, poeti ynë i mirënjohur Nehat S. Hoxha, se:”Poeti i frymëzimeve të “Zjarrit të diellit”, 1995, me një guxim dhe përpjekje të ngulmët flak dashurinë për poezinë dhe i rreket zbardhjes së çështjes kombëtare në Kosovë nëpërmjet diturish të nduarduarshme, të spikatura për ndodhjet e situatat aq të ndërlikuara të shekullit të tretur dhe të këtij qindvjeçari.”, Flori Bruqi me librin “Guxim shqiptar” spikat të na ofrojë një vepër interesante me një gamë të gjerë interesimesh të tija, e cila e bën kureshtar secilin lexues që do ta ketë në duar, ta lexojë deri në fund me një frymë dhe “të pasurohet” me leximin e saj.

Flori Bruqi me veprën “Guxim shqiptar” spikat të na ofrojë një vepër interesante me një gamë të gjerë interesimesh të tija, e cila e bën kureshtar secilin lexues që do ta ketë në duar, ta lexojë deri në fund me një frymë dhe “të pasurohet” me leximin e saj. Publicisti, shkrimtari, poeti Flori Bruqi na sjell në botën e librit shqip, për lexuesin tonë, veprën më të re nga pena e tij, “Guxim shqiptar”, botim i 2008 në Prishtinë.

NGA FORMA ELEKTRONIKE TE FORMA E SHTYPUR

Abdullah Konushevc

Libri “Guxim Shqiptar” i Flori Bruqit është një përzgjedhje, një seleksionim i punimeve më të mira elektronike, botuar në faqet e rrjetit (ëeb sites), bas i të cilave qe dhe është autori dhe që tash i afrohen publikut lexues të përmbledhura në një vëllim më vete. Me një fjalë, libri është bërë që edhe publiku lexues, i pamësuar me botimet elektronike, të njihet me tema të ndryshme, që kanë gjetur një trajtim të gjerë e të denjë pikërisht në këtë formë. Pra, kemi një kalim nga forma elektronike te forma e shtypur.

Nga temat e ndryshme historike, për seriozitetin dhe thellësinë e trajtimit, tërheq vëmendjen artikullit “Mbrojtja e Plavës dhe e Gucisë”, sado që janë me interes edhe disa ide të hedhura për origjinën shqiptare të perandorit francez Napoleon Bonaparta.

Një peshë jo të vogël ka kapitulli “Për Ramushin”, në të cilin është përmbledhur intervista e z. Adem Demaçi me titull “‘Dora e Zezë’ e serbëve vret çlirimtarët e Kosovës”, artikulli i autorit “Hero në luftë - hero në paqe: Ramush Haradinaj”, si dhe artikulli “Ramushi, viktimë e situatës (neo)koloniale”.

Megjithatë, pjesa qendrore e librit i kushtohet antropologjisë, në të vërtetë veprës “Raca shqiptare” të Jakov Milajt, ku edhe autori, pos mospajtimeve të hapura me disa autorë, jep dhe ndihmesën e vet në ndriçimin e kësaj çështjeje shumë të ndjeshme.

Në kapitullin “Politikë” kanë gjetur vend shumë tema aktuale, sikundër është çështja e pazgjidhur çame, çështja në ka ‘intifadë’ në Iliridë, frika që kanë udhëheqësit tanë nga kryetari “Vetëvendosjes”, Albin Kurti me titullin shumë domethënës “Pushtetarët e kanë frikë heroin e demokracisë”, dy artikuj për mjekun e dëgjuar shqiptar, z. Namik Shehu etj.

Një kapitull që do të zgjojë interesimin e lexuesve është pa dyshim “Spiunazhi”, ku kanë gjetur vend artikujt “Agjenturat greke dhe Sigurimi i Fshehtë i Shtetit Shqiptar”, “Kush janë agjentët me influencë në Kosovë” dhe “Aktivitetet kriminale të shtyra nga shërbimet sekrete armiqësore në Kosovë”.

Por, kapitulli më i gjerë dhe më i larmishëm është “Gjuhë & letërsi”, ku hetohet edhe karakteri i ndjeshëm hulumtues i autorit, sidomos në portretizimin e figurës

së Jusuf Gërvallës dhe vlerave të veprës së tij letrare; pastaj disa anë të panjohur të shkrimtarit tashmë të ndjerë, Mehmet Kajtazi etj.

Janë me interes edhe artikujt për Kolec Traboinin, Rifat Kukajn, Kozeta Zylon, Gani Xhafollin, Nehat S. Hoxhën, si dhe një varg temash nga letërsia botërore. Libri mbyllet me kapitullin “Psikanalizë, astronomi dhe erotikë”, ku trajtohen tema nga këta lëmenj interesantë të jetës njerëzore.

ZBARDHJA E ÇËSHTJES KOMBËTARE ËSHTË NË LIBRIN STUDIMOR TË FLORI BRUQIT

Nehat S.Hoxha, shkrimtar nga Kosova

Pas një periudhe të gjatë kohore dhe pas luftës në Kosovë, si një sihariq i rrallë na vjen një vëllim i përmbledhur me shije të hollë dhe me një gamë të gjerë temash e disiplinash me larushi të begatë nga fushat e publicistikës, histories e historiografisë, diskursionit, shkencës, figurash krijuesish me rëndësi madhore nga letërsia shqiptare dhe ajo botërore; nga psikologjia, mjekësia, seksologjia; nga fusha e polemikave, artikuj të inteligjencës, të cilët do të frymëzojnë dhe pajisin lexuesin tonë me informacion të kamur, vështirë se do të mund të gjente lehtë një vëllim të vetëm, siç është ky.

Poeti i frymëzimeve të “Zjarrit të Diellit” Flori Bruqi (1995), me një guxim dhe përpjekje të ngulmët flak dashurinë për poezinë dhe i rreket zbardhjes së çështjes kombëtare në Kosovë nëpërmjet diturish të nduarnduarshme, të spikatura për ndodhjet e situatat aq të ndërlikuara të shekullit të tretur dhe të këtij qindvjeçari, për të shfletuar një sasi njohurish dhe për t’i ofruar njeriut një sofër ushqimesh të sojit të vet. Është fare vetjake kjo përpjekje. Dhe kaq e devotshme: lexuesi mund të endet nga rrafshi në rrafsh të parapëlqyer sipas shijes që ka, dhe sipas kërkesës. Temat që janë shtruar, kanë aq shumë të dhëna, sa nuk ka ndodhur ndonjëherë gjëkund në një libër të mëparshëm. Urojmë shëndet e sukses për një disiplinë kaq të pëlqyeshme dhe dobiprurëse për lexuesit tanë.

PIKËPAMJE NGA OLIMPI I MENDIMIT SHQIPTAR

Naim Kelmendi, shkrimtar nga Prishtina

Vepra “Olimp shqiptar” është edhe një kontribut tjetër i mendimit intelektual dhe vështrimit, pikëpamjes dhe mendimit kritik, të shkrimtarit dhe publicistit, Flori Bruqi. Autor i shumë veprave, ai na del para lexuesit edhe me këtë vepër në publicistikë, si çdoherë me veprat e tij në këtë fushë, i arrirë, përmbledhës, i veçuar dhe i shenjuar. Pas veprës paraprake, “Guxim shqiptar”, që tek lexuesi shqiptar, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, nuk mbeti pa jehonën e vet, tash Flori Bruqi vjen para lexuesit tonë me një tjetër vepër hiç më pak të rëndësishme se kjo që e theksuam. Madje, kjo e tashmja: “Olimp shqiptar”, në dukje të parë, mbase nënkuptohet si vazhdimësi e “Guximit shqiptar”, por kjo na del disi më e veçuar për nga kuantiteti dhe kualiteti, për nga seleksionimi dhe vizioni conceptual i librit, poashtu dhe për nga tematika dhe për nga seleksionimi i lëndës së këtij libri. Nisur nga botimet elektronike, si tek libri “Guxim shqiptar”, në vebfaqen “Floart Press”, Flori Bruqi ka ditur të veçojë në këtë vebfaqe letërsi të mirëfillët, polemika të nivelit intelektual e shkencor, shkrime e veçime të tjera nga shumë fusha letrare dhe të publicistikës. Me sajimin e librit “olimp shqiptar” autori sinjifikon një pikë kulmore të asaj lënde që përfshinë brenda kjo vepër dhe, pikërisht këtë synon autori t’ia ofrojë lexuesit. E tërë lënda, kuptohet, më parë e botuar në vebfaqen e njohur “Floart Press”, është lëndë e zgjedhur dhe e përzgjedhur nga kritere të mirëfillta letrare, që përbëjnë një prezentim zhanresh të ndryshme, duke u nisur nga poezia, me autorë të zgjedhur shqiptarë, polemika për çështje të veçanta, çështje me tematikë psikologjike, analiza dhe veçime nga letërsia botërore, kuptohet sipas përzgjedhjes së autorit, por edhe autorë e figura të letërsisë, publicistikës dhe jetës buplike shqiptare, që në një formë o në një tjetër, kanë shënuar pika kulmore në jetën dhe dijen shqiptare. Të tilla figura në këtë vepër i gjejmë, nga bota letrare: Esad Mekulin, Azem Shkrelin, Din Mehmetin, Fatos Arapin, Arshi Pipën, Martin Camajn, Anton Pashkun, Agim Vincën, Sabri Hamitin, Besnik Mustafajn, Naim Kelmendin, Abdullah Konushevcin, Fahredin Shehu, Iljaz Prokshin, Albana Lifschin, Rajmonda Moisiu etj, nga ajo studimore si Rexhep Qosjen, Idriz Ajetin, Jup Kastratin, gjithashtu për jetën dhe veprën e nobelistes shqiptare Nënë Terezën, pastaj për figurat madhore të kohës sonë, legjendën e luftës, rezistencës dhe trimërisë shqiptare Adem Jasharin, atë të presidentit historik të Kosovës,

Ibrahim Rugovën, atë të shkrimtarit tashmë me famë botërore Ismail Kadare, si dhe mjaftë tema të tjera me interes të veçantë... Edhe me këtë vepër diktohet mëtimi i autorit Flori Bruqi që të seleksionojë kategori, vlera dhe çështje që shenjojnë nivele të arrira në botën e kulturës shqiptare, dhe këtë ai arrinë ta bëjë me sukses, me një shije të hollë dhe të zgjedhur. Me zellin dhe sensin e tij prej intelektualit të kujdesshëm, ai pothuajse i vë shenjën pikante mendimit të analizës letrare, prezentimit, vështrimit, krijimit, debatit, recensionit dhe shtjellimeve tematike, që ngrit brenda këtyre vështrimeve dhe tematikës në këtë vepër...

REAGIME DHE POLEMIKA, QË SFIDOJNË TË PAVËRTETAT SERBE TË KOHËS?!...

Nga Naim Kelmendi

Në librin “Polemika shqip”(Prishtinë,2009), shkrimtari dhe publicisti i mirënjohur Flori Bruqi, spikat me sensin për të polemizuar,në të shumtën për të reaguar në shumë çështje, që për temë kishin atë,çështjen e të vërtetës historike shqiptare,por të shkruara dhe të thëna në kohë dhe hapësirë të caktuar nga emra akademikësh serbë dhe shkruesish serbë.

Polemisti Mr.sci.Flori Bruqi, në blogun e tij virtual:”Foart Press” dhe në shumë ëeb faqe tjera shqiptare dhe në gjuhë tjera botërore polemizon dhe reagon shpejtë kundrejtë të pavërtetave të thëna nga akëcilët akademikë serbë, që me “të vërtetën” e tyre publike, ushqenin opinionin vendor e ndërkombëtar për akëcilën çështje a problematikë kundër çështjes shqiptare, qoftë politike,historike, etnike etj.

Flori Bruqi polemizon intelektualisht dhe me kundërargumente kundrejtë shpifjes publike serbe,më mirë të thuhet, kundër rrenës serbe,që sipas thënies së njohur të akademikut serb Dobrica Qosiçit, është moral serb,për ta mendësuar opinionin me pseudoinformim, me pseudoshkencë,me pseudopolitikë etj,por që këtyre, polemisti i mirënjohur shqiptar Flori Bruqi ua heq maskën me kundërargumente.

Pra, në këtë libër, që përmbledhë,në të shumtën polemikat e kohës së pasluftës për shumë çështje,sa të ndieshme, siç është e vërteta mbi masakrën e Reçakut, aty ku më 1999 ishte kryer krim kundër njerëzimit, apo shumë çështje të tjera, që nga pseudoshkruesit, pseudoakademikët,pseudointelektualët serbë të Beogradit, interpretoheshin ndryshe nga ajo që ishte e vërtetë e përnmjëmendët,Flori Bruqi i problematizon çështjet, kuptohet reagon pas shkrimit të atyre, për t’i ndriqar dhe për t’i vënë në vend të vet të vërtetat,apo për t’ua thënë secilës emrin e vet ashtu siç e kanë në të vërtetë.

Sepse,krimi e ka emrin krim,shpifja e ka emrin shpifje,masakra e ka emrin masakër,e kështu me radhë.

Ky libër ofron mjaft material të polemikës,një zhanër ky,jo fort i lëruar në letrat tona të kohës moderne,por ja që, Flori Bruqi,reagon dhe polemizon në nivelin më të mirë me pseudoshkencën serbe...

Në të vërtetë, ky libër ofron për lexuesin edhe mjaft reagime të tjera nga shkruer të ndryshëm në Blogun virtual "Floart Press" etj.

Në këtë libër, jipet gjithashtu një listë e gjatë emrash të të vrarëve shqiptarë, me datëlindje dhe vende ku janë masakruar apo vrarë, në luftën e fundit më 1998-1999 në Kosovë, nga ish ushtria, policia apo paramilitarët serbë.

Kështu që edhe ky kapitull plotëson një anë tjetër të vërtetash, mbi krimet serbe në Kosovë, e që plotësojnë atë kriterin e polemikës argumentuese në raport me polemizuesin/shkruer shpifës e falsifikator të vërtetash historike, politike /etj. Shkencëtari dhe polemisti Flori Bruqi, reagon dhe polemizon duke mos dashur që t'i lë të heshtura çështjet, në të shumtën, atëherë kur ata, nga tabori i "intelektualizimit" serb, pa argumente, shkruajnë e gënjejnë, për çështjet, tashmë të njohura edhe nga opinioni botëror.

NJË SYTH SHPIRTI NË AKUARELIN E NJË KOSOVARI

...brenda syrit poetik të Flori Bruqit

Nga Zef Pergega

Nanat janë krijesa e krijesave njerëzore. Asnjë hije muzgu me fluturim korbash nuk zë vend në shpirtin e tyre. Stoicizmi human dhe krenar është sfida e natës. Ata lindën prej dhimbjes dhe dhimbjes së rritjes i kënduan gjithë jetën. Me këngë e thurin djepin e dashurisë dhe me shallin e ylberit i shërojnë ethet e forta. Asnjë art nuk mund ta shembë tempullin e shenjtë të tyre. Nanat janë bota e qiellit dhe e tokës dhe krah u japin foshnjave të bëhen engjëjt e jetës.

Sa herë ngjitesha shkallëve të drunjtë të kullës së vjetër, nana ime që thurte bukur çorape me luledede apo me degë ulliri, pa më parë me thërriste me emër. Me njihte nga hapat e ngjitjes...Ndërkohë që arti i sotëm e ka shpërfillur fytyrën dhe visarët e shpirtit të nanës dhe është mbërthyer si rriqën në kërthizën e vibrimeve nudo, ngrihet një bir kosovari i lindur në vatrën e lisit të tamlit dhe lisit të zjarrit, një flori-florë poetike mbi kurorë të gurrës së parë me emrin njerëzor Flori, që me pathosin e tij të vllgut e ngre simbolikën e nanës mbi rrezet e dritës, asaj drite që ajo i përket.

Rastësisht e me saktë në mënyrë periodike e lëxoi krijimtarinë e këtij poeti dhe si anija që e hedh spirancën në molon e ancorimit ma mbajti vështrimin një cikël poetik e këtij fisniku të fjalës së lirë. Duke lëxuar poezinë “Rreze drite”njeriu dhe në mënyrë

të veçantë emigranti s’ka sesi të mos ngrohet nga këto rreze dhe të na kujtojë që sado që jemi larg shpinë kthyer, nana kurrë s’e harron birin apo bijen e saj. Që ajo të mos rrijë duke pritur mbas dere nga këto mbrapështi, Flori Bruqi si një thurës vargësh me mbjellje zambaku e trëndofilesh në ballkonin dhe kopshtit të mëvehtësisë së Kosovës, shkëput nga trangu i shpirtit një petale merakë prej vazos së kujdesit të nanës drejt adresës tonë, si pëllumbi që kërkon bregun...

“...Natën e mirë bir

Çelësin mos ia vë derës
Se do të vijë nana
Gjumin e paprishur
Me hapat e pranverës
Mos je shpluar
Kur ike...!”

Poeti Flori Bruqi e ka thënë me një ndjenjë të thellë atë që shumëkush e ka harruar madje e ka braktisur nga shpirti këtë kumt njerëzor. Këtë thesar që rrjedh në lumin e turbulluar të jetës, Flori e nxjerr nga fundi si varken e mbytur. Shumë i kanë kënduar nanës që ngajjnë me tinguj nostalgjie, por motivi i autorit në fjalë ka atë rreze drite që nuk shterr në shpirtin e nanës pavarësisht se koha po i josh brezat me harresën dhe përzierjen e gjakut. Bash kur hollohet e ndryshohet gjaku aty nana loton me sytë nga qielli për pak shpresë dhe respekt për prindërit.

Lajmotivi i poetit Flori Bruqi ka erën e dheut të parmendës dhe e lëron vargun në ngohtësinë e qiellit pa patur nevojë të marrë miell hua, por gruri i arës së tij piqet me afsh trualli. Shpirti poetik me të cilin ka rrethuar tokën e mushtit të vargjeve bashkë me fantazinë dhe dhuntinë rri në dritaret e një kalaje, si zogu që sjell lajmin e begatisë, lidhur gurët me metafora dhe ushqyer me qumështin e zanave të kthyerë përsëri pas shumë motësh ikjesh ndër valë. Poeti kosovar u këndon atyre që nënçmohet, atyre që shkelen me të padrejtë, atyre që u flet puna dhe dikush ua mohon me guna, I këndon urtisë, mençurisë së popullit të tij, bekimit të ballit dhe nderit të nëpërkëmbur. Ai i thërret nanat, vashat të vijnë në këngë se me këngë janë rritur djepat e trimërisë se pa ata djepa Kosova do të ishte përsëri e shtypur, ndaj dhe poezia e tij “Lajtmotiv i sinqertë”, është një zgjim dhe një kurajo, një hov dhe një tingull i ri në piskamë se prej tyre ne morëm këmbë...

“...Ejani në këngë
Nana dhe motra
Ne lindëm nga këngët tuaja
Nga zëri juaj
Morëm këmbë...!”

Para vargut të Flori Bruqit të ndizet një qerpik ngadhnjimi. Ai të fton qetësisht pa tamburante në vargun e rrezeve të perëndimit për ta përjetuar poezinë nga vitrina e pastër e dritës që ndizet në pishtar. Edhe pse politikisht ka ardhur liria

ne Kosovë, shpirti i vashës e përjeton atë me trishtim. Të lehurat e natës nëpër zgavra përgojimesh të paragjykuara me kurtha e gracka dashurie dhe poeti i vëmendshëm e shkoqit këtë ndjesi, mbasi ai nuk i duron njollat e zeza në bluzën e bardhë të transparences së virtytit njerëzor dhe pyet në poezinë “Liri fjale”

“...Mos vallë në qytetin tënd ilirik
të ndjekin qentë e tërbuar
Ndonjë hije nate...?!”

Flori Bruqi, si në jetë dhe në krijimtari nuk thyhet nga pushteti i prangave të pritjes dhe as nuk e kapin ethet e padurimit edhe kur e ndjen vetëvlimin në damarë. Me krah dallëndysheje ngjit muret e heshtura, ku jeta merr serume të hidhura e ai ulet në karrikën e sallonit të pallatit të ëndërrave rinore pasi shiu e ka bërë qull fletoren e vargjeve pa e ndjerë shterrjen kur shkruan poezinë “Qyteti ku të prita”

“...Unë jam aty ku më ke lënë
Vallëzoi me hijet
E nuk di cilën të përkëdhel
Pres dashurinë tënde
Mbi buzët e tua të zë një ëndërr...!”

Një poezi e veçantë me një gurrë me metafora dhe me një kopsht me krahasime është ajo me titullin “Akuareli i diellit”. Ajo iku në moshë të njomë, pa pasaportë e pa adresë. Ndoshta pa mësuar mirë emrat e malit, lendinës, lumit e bregorës që jetës i japin blegërimë. Nxori në rrugë në atë shteg të ngushtë nga gjoksi i paprekur fletoren me vjersha dhe shkroi për mëngjesin e Prishtinës, të vetmin kujtim mori më vete nga majat e ikjes dhe ai ngushtim shpirti e tokë i kujtoi nanën. Në xhamat e retinës vizatoi portretin e bacës plak dhe pastaj e fshiu me dorë dhe dorën e puthi me bekimin e vetvetes. Është gjaku që ndjen gjakun, e kush më bukur se Flori Bruqi e përcjellë këtë penelatë, si visari më i çmuar i shqiptarit. Dikur ajo vashë u kthye në vendlindje. Autori nuk u bën thirrje dallëndysheve të kthehen, por ai nga një kënd i syrit të tij vëzhgon fluturimin e tyre nga qielli që u larguan dhe e stolis tablonë kur vasha e ngjeu penelin në akuarelin e hënës në mbrëmjen e majit dhe pikturoi rrugën. Kishte çelur pranvera e kthimit. Ky motiv është thënë nga Flori Bruqi në mënyrën më mjeshtrore. Në fshat vasha që kishte ikur, por atdheu i ishte mbledhur galuc si një gur në zemër e në shpirt, me të cilin ajo kuvendoi gjithë kohën e largimit

duke gjetur në ato themele hijet e vetmisë dhe të heshtjes dhe me tej melodinë e draperit në duart e fshatarëve të tokës së saj. Flori është i dashuruar pas së bukurës, ai e ushqen atë që të mos vyshket dhe të mos shkilet. Madje ai është një triumf rrënjësh që lartun trungun e inditetit njerëzor. S'ka gjë më të bukur kur femra e ruan feminitetin e saj, sa edhe pemët kërkojnë t'i ngjajnë.

“...Shpirti i saj
Një lëndinë qërshori
Selvitë ndanë rrugës
Trupin e saj imitojnë...!”

Ndesha një krahasim që e vallon së tepërmi strofen e vargun dhe e llamburit mesazhin tek poezia “Mendim e kredhur”. Nuk e di nëse ky poet me një fizionomi të konturuar në brumin e farës kombëtare ta ketë provuar mërgimin. Ai me nota trishtimi e vizaton portretin e shekullit që ndau familjen duke u çirur nëpër tribuna e konferenca për liri e lëvizje të lirë. Sa nana e motra mbetën pa burra, pa fëmijë e autori thotë se nuk patën një gur ku të qajnë!

Vejusha pa fat me prehëra të thatë. Djepa që nuk lidhën dhe as nuk zgjidhen. Kënga Nina-nana e ngrirë në mure të akullta dhe siç thotë Flori, në shpresat e djegura vret e qan trishtimi. Tonelata vuajtjesh që mbytën mbi dallgët e mërgimit mekatar dhe poeti i dhimbsur thotë:

“...Shikimi i nënëmadhës si shqiponjë/ Pas e ndjek/ Klithma djemsh/ Mbetur ikona nëpër pragje...!”

Në akuarelin e dritës së shpirtit të tij që rri në pëllëmbë të vargjeve, një ditë në Amerikë dallova ylberizimin e figurave letrare dhe artistike të këtij poeti, që e shikoj si kurorë magjike mbi ballë të tokës kosovare për t'ia zbukuruar fytyrën lirisë dhe gjithçka që është shqiptare.

(<http://www.fjalaelire.com/kritika/11342.html>)

NJË PUBLIKIM SERIOZ DHE I VLERËSUESHËM NË FUSHËN E DIJES SHQIPTARE, “OLIMPI SHQIPTAR”, I FLORI BRUQIT

Nga Kristaq F. Shabani, shkrimtar nga Shqipëria

Prologim dritësor

Kohët e sotme janë kohë të lulëzimit modernist dhe të daljes nga “prangimi” dhe “ganxhimi”, i të cinguarve me emër pronor, që dolën nga “Lëvozhga mit” dhe elegjuan “vargjet vrara” tregojnë për përçapje studimore jashtë “kuadraturës kriteriale “ e normativave moralizuese... Ende në studimet apo mendimet kritike thuren lavde të pameritueshme për krijues, që shkuan apo që janë aktualisht, pa i këndvështruar ata me sensin e origjinalitetit dhe të prezencës “autoritare“ të kreatorës së tyre..., por shpesh ndiqet përvijimi i rrugëtimit të tyre, nëpërmjet asaj ç’kanë thënë të dikurshmit, të cilët kanë humbur logjikën” e mendimit kritik, në këtë kohë të ndryshimeve të gjithanshme dhe atyre emotive, duke mos kapur fillin e najlonizuar... Krijimi është produkt i një të talentuari me forcë të madhe meditative, me një këndvështrim ndryshe nga të tjerët, i cili dritësohet nga një diell tjetër dhe është i aftë të krijojë lidhësinë shpirtërore në një formë e trajtë çudibërëse dhe në një klimë polarizuese me stina të kthyeshme, të ndërthurura dhe të ndërvarura nga njëra - tjetra. Sot me studime dhe mendim kritik merren dhe ata, që s’kanë minimumin e njohurisë për këtë shkencë të madhe, duke krijuar precedentin e rrezikshëm të vulgarizimit dhe të skeptricizmit të mediokritetit. Ndërmarrja e veprave të studimit analitik në këtë vullshmëri dhe stad krijimi me një temperament e stil më të lirshëm, më të pushtetshëm kreativ është një veprimtari, e cila kërkon nivel të lartë kulturor. Shtëlljesë: Libri “OLIMPI SHQIPTAR”, I FLORI BRUQIT, është një libër voluminoz, i cili edhe nga aktitektura si dhe nga kapitullizimet e tij tregon katërcipërisht erudicionin, nivelin e njohurive të autorit, lëvrues dhe studiues në shumë fusha, duke bërë analitika dhe paraqitje profesionale. Në këtë libër, duke u nisur nga shijet e tij artistike, që duhen respektuar, ai ka rrokur disa nga poetët shqiptarë si: Azem Shkreli, Agim Vinça,

Fatos Arapi, Arshi Pipa, Avdulla Konushevci, Esat Mekuli, Agim Bacelli, Besnik Mustafaj, Arif Molliqi, Din Mehmeti, Naim Kelmendi, Sabri Hamiti, Fahredin Shehu, Rajmonda Moisiu, Mardena Kelmendi, Pal Sokoli, Albana M. Litschin, Raif Gashi dhe Iljaz Prokshin..

Përzgjedhje autoriale

Kjo është një përzgjedhje autoriale, duke u nisur nga këndvështrimi i tij i pavarur dhe i lirë poetik, nga pëlqesat personale kritike, apo nga mendimet kritike të dhëna për këta poetë.

Azem Shkreli trajtohet në këtë vepër të Flori Bruqit si poeti, që zë vend në krye të poezisë moderne shqiptare si dhe e evidenton si impulsues të një sensi dinamik, të një spektri zgjerues tematik, të një risie lirike si dhe të një pasurimi ngjyror të fjalësit në sensin figurativ të ndjesisë. Jep një panoramë dinamike të Azem Shkrelit, duke paraqitur veprat e tij të botuara në disa gjini si poezi, prozë, drama e tjerë.

Azem Shkreli cilësohet si kthesuesi i parë drejt modernitetit në letërsinë shqiptare. Edhe në lëmimin prozaik autori evidenton Shkrelin si thyerës i tabusë dhe marrës i kthesës së mirëfilltë në letërsinë kosovare dhe atë shqiptare me romanin “Karvani i Bardhë” si dhe me tregimet në librin “Sytë e Evës”. I shquar në lirikat e para (vendlindja dhe njeriu në epiqendër të krijimit), të pasuara me lirikat e dashurisë, lirikat atdhetare, lirikat refleksive. Një nga karakteristikat më madhore të këtij produkti lirik dhe poetik është se, Shkreli në kreaturën e tij ishte i prirë drejt meditatimeve filozofike. Për të argumentuar përfundimin e tij logjik studiuesi, shkrimtari Bruqi, ilustron me poezi të Shkrelit me tituj intrigues si: “Bregu i Mollës”, “Këngë e Vrugët”, “Motivet e verdhë”, “Para elegjisë”, “Liqeni”, “Kënga e turpshme” e tjerë. Duhet theksuar se periudha, kur jetoi dhe shkroi Azem Shkreli ishte një periudhë tensionare, e indokrinuar, e trajtesave ditirambore dhe e produktit kënaqësor, një periudhë, ku shembëlltyra poetike devijojë me urdhëresa në “korsi” të njëjta, apo starte të njëjta dhe precipitimi vetiak ndëshkojë, ndaj rrugëtimi në “rrugë të pashkelura” duhet të ishte i studiuar me mjaft vëmendje nga krijuesi, por përmasat figurative duhet të ishin të një lartësie e përzgjedhje, por të buruara nga një spontanitet i nevojshëm, për të shmangur rakitizmin (proliksitetin), i cili

ishite kryefjala e krijimtarisë së poezisë dobësore inervore e kohës, ku ditirambi dhe natyra krijuese stimulonte pa nerv “ecuritë” këmbërrënë dhe ecjet në urat lëkundëse...

Nëse sot analizon poezitë shkreliane me një këndvështrim tjetër të ecurisë poetike në kontekstin e shkëmbimit universal të vlerave do të diktosh që, paçka nga mospërthimet në gjuhë të huaja të kësaj kreature, ruhet supermacia dhe dinamika e krijimit, nga shkathtësia frazore dhe figurative, nga fjala e përkorë, nga vrullimi e gjallesa e përcjellshmërisë së idesë, nga arkitektura poetike. Por duhet theksuar se bukuria lirike e Shkrelit të befason, por në disa raste kalon edhe në momente moralizuese, tonaliteti, paçka nga figurimi si psh. te “Para elegjisë” poezia fillon mjaft bukur dhe precipiton po bukur me natyrshmëri dhe ndjesi, por: ... Një ditë do t’i hash buzët e tua, gjurmët e tua do t’i pështysh... (ka rënie të diagramës poetike dhe duhet të kishte gjetje figurative), pastaj poezia përsëri uniformohet dhe del në udhën që kërkohet, deri sa arrin te “epilogu”, i cili merr “krahë moralizues”. Ruaju, moj se vashat më të bukura i vret bukuria e vet,... paçka nga filozofia mbartëse, pasi poezia e modernitetit i ruhet moralitetit të hapët, pasi humb melodicitetin, e shpreh moralitetin me aftësinë e ndritshme të vargut. Kjo mund të thuhet edhe për “Katër këshilla vetes” (janë vetëm tri këshilla në fakt dhe jo katër, pasi një është e ripërsëritur dhe nuk ka vlerë të katërt), të cilat me me shenjën pikësore pikëçuditëse, janë kthyer në tone urdhërore për veten dhe krijuesit e tjerë. Konteksti përmbajtësor i kësaj poezie është kontradiktor... Këshillën e parë të Shkrelit, që ia ka vënë vetes e mbartin poetët e rinj si lajtmotiv! Një bukurim poetik është poezia “Nënat”, e cila ka një rrjedhë gjallësore, të ndritshme, të figurshme, të buruar nga një shpirt poetik analitik dhe tepër i aftë për të diktuar bukuritë e nënës. Bruqi ka evidentuar në përfaqësuesit më me zë të letërsisë shqipe, poezinë shqipe, poetin dhe studiuesin Agim Vinca . Kam mendimin se Vinca ka kontribute dhe shërbesa të mëdha në letërsinë shqipe, sidomos në studimet e saj, dhe drejt thuhet në librin “OLIMPI SHQIPTAR” se është një studiues i dalluar dhe ka meritë edhe në guximin e tij intelektual. Një vlerë e tij është: i përkthyer në disa gjuhë si hebraike, vietnameze, maqedonase, kroate, sllovene, polake, ruse, frënge, italiane, gjermane, angleze, turke, arabe e tjerë. Në këtë kontekst është ndër të parët dhe vlen të përmendet për kontribut. Vetëm një studim analitik i poezive të paraqitura në librin e Flori Bruqit dhe me një krahasim logjik me krijimtarinë shkreliane, Vinca paraqitet i zbehtë në poezinë e tij. Dua të veçoj poezinë “Paradoks”, e cila është në pëlqesën time, por me një heqje të që –së në vargun e tretë... “Glosë për Çamërinë”, një poezi

tërësisht e dobësuar, me pak vargje poetikë, paçka çfarë kërkon të thotë... Më saktike dhe më e precipituar nisma e poemës për Familjen Jashari... Duhet theksuar se poezia e mendimit konciz kërkon “mbujtje të madhe “. Po kështu mendoj se poezia “Mora Rrugën për në Qafë Thanë” , mendimi i poetit ka mbetur në vargje proliksë...

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për “Psalm për Shën Naumin” ai mbetet në pozicion konstatues dhe precipitimi i vargut të fundit tregon një pasthirmim i dalë jo vetëm nga shpirti i ndjerë poetik , por edhe nga shpirti i çdo njeriu... Pra nuk ka lulim poetik...

Kështu mund të flitet edhe për “Betimi (Anno Domini1999),i cili ndoshta ka nëpër të ca vargje imponantë. Doja të theksoja se studiuesi duhet të jetë dhe poet i nivelit, edhe i shkolluar, për të realizuar një zberthim analitik të krijimit. I nderuar Bruqi, me këtë substrakt poetik të përsjellë për Vincën, nuk justifikohet, sa duhet dhe si duhet prezenca e tij poetike si i “spikator”, që motivohet prej jush në këtë libër voluminoz, kur mund të përzgjidheshin nga krijimet e tij poezi të tharmit. Vendosja e Arapit në këtë libër është e përligjur. Arapi e meriton vendi e tij në këtë “kolanë” të letërsisë e të poezisë shqipe. Duhet theksuar se Arapi ka patur aftësinë të poetizojë me shumë patos dhe lirizëm. Po kështu duhet evidentuar se, “rrudhimi kohor” nuk ka vepruar vetëm në Shqipëri dhe s’ka ndikuar vetëm këtu në krijimtarinë letrare të krijuesve shqiptarë, por shumë edhe në Kosovë, ku, përveç të tjerash ka pasur edhe “flirtime” poetike të detyruara, ashtu sikundër ka pasur edhe represione, reprezalje ndaj krijuesve... Për poetin Fatos Arapi është folur shpesh dhe zoti Bruqi bën një analitikë të kujdeshme për diagramën poetike të këtij poeti. E magjishme poezia e tij për Atdheun... Atdheu yt i vogli, i vogli./ Ai hyjnori i pavdekshi – loti, duke mos mohuar kreaturën e Fatos Arapit, doja të theksoja se dhe poezia e tij nuk i ka shpëtuar rrëfimit, aftësisë rrëfyese dhe, hera – herës, në disa krijime të tij ka rënie, s’ka figurim, paçka se do të shprehë gjendje, ka tepëri dhe zgjatje të panevojshme, të cilat me një përqëndrim më të madh Arapi mund t’i kishte krasitur vetë, duke mos luftuar për një koincizitet poetik dhe të latuar mirë. Kjo poezi ka trajtë afër modernes, por ka dhe tonalitete deklarative. Kjo që theksova më lart nuk e zbeh aspak kreaturën e Fatos Arapit... Nuk dua të zgjatem me këtë poet, pasi të them të drejtën nuk kam parapëlqesë për rimëzimet të formës apo trajtës të puthur, apo përdorimet e rimeve foljore më nervozojnë së tepërmi, pasi humbasin bukurinë... Kur analizojmë kështu dhe kemi mendime kritike për Fatos Arapin ç’mund

të thuhet për disa krijues të tjerë, që janë vendosur në librin “OLIMPI SHQIPTAR”, të cilët kanë dobësi të theksuara në poezi dhe që s’kam ndërmend t’i paraqes në këtë mendim kritik për këtë libër voluminoz. Motivet nga është nisur autori unë i kam parasysh për efekte gjeopoetike, duke u nisur edhe nga mosnjohja si duhet e krijuesve të mirëfilltë shqiptarë modernë, të cilët sot japin kontribut dhe konkurrojnë në poezinë botërore moderne. Me vend e shoh dhe me të drejtë pjesëmarrjen në këtë libër të figurave poetike të tilla kosovare si Esad Mekuli, Din Mehmeti, Naim Kelmendi, Sabri Hamiti, Fahredin Shehu e tjerë. Më gëzon fakti që tre poetët e fundit janë konkurrues, duke përfshirë dhe Avdullah Konushevcin e Besnik Mustafaj (por me një selektim me të mirë të krijimeve të tyre) i mëshojnë fort një poezie moderne dhe kanë mundësi shumë të mëdha për të pasqyruar kreaturën e tyre në rang ndërkombëtar. Që të jem i saktë mund të kem të njëjtin mendim edhe për ndonjë recensë, apo mendim të fryrë për ndonjë krijues, i cili nuk është i atij stadi që është personifikuar. E shoh të arsyeshme të them se, disa e heqin veten, sikur janë në majë të Olimpikut, kur nuk janë tillë dhe një qëndrim i tillë, natyrisht, e dëmton vetë “OLIMPIN”. Poezia nuk kërkon lavdërime, por të thënë troç dhe troçësia është e bukur dhe jo përkëdhelëse.

* * *

Heshtje përkufizohet: “HIÇ...”

Heshtje do të thotë: “MOSJETIM...”

Heshtje do të thotë: “PIKË”...

“Pulsi i Dhimbjes”

Elegancë përzgjedhjeje e Bruqit në korifenjtë e letërsisë botërore

Një përzgjedhje elegante është bërë në kapitullin e dytë të librit. Bruqi ka përzgjedhur korifenjtë të letërsisë botërore, që kanë dafinizuar dhe kanë arritur maja olimpiane në letërsi, pasi vepra e tyre e spikatur edhe sot lulon dhe “jep” mend, pra përzgjedhje të letërsisë që s’vdes... Në pararojë të hyrësisë së këtij kapitulli është Albert Kamy, ky klasik modern, Borges, ky fenomen letrar, siç e motivon Bruqi, Heinrich Heines, poeti i madh gjerman, Gabriel G. Markuez, Hemingueji, shkrimtari brilant, i cili të befason ende me librin e tij të pavdekur kurrë “Plaku dhe Deti”, një mistikë fenomenale letrare, Anton Çehovin, shkrimtar - majë i letërsisë ruse, Fjodor Dostojevski,

shkrimtar i trurit intelektual dhe i përsiatjeve të mendimit letrar të përkorë; Vladimir Majakovski, i veçantë në krijimin dhe stilin e tij të motivuar, Viktor Hugo, shkrimtari madhor francez epokal, Jean Paul Sarte (të çuditshmin mendimor dhe rrëfyes "ndryshe"), Orhan Pambuk, nobelistin turk dhe në epilogram të këtij kapitulli vendos Robert Shvarc, albanologun, shkrimtarin dhe përkthyesin e talentuar të gjermanishtes të Erih Maria Remarkut, Lion Fojtvanger, Leon Uris, Bertold Breht, Hajnrih Hajne, Gëte e Shiler...

*

Kapitulli i tretë duhet motivuar kapitulli i recensionimeve për vepra të Ali Asllanit, homazhim për veprën e Fan Nolit, për Anton Pashkun, për Martin Camaj, Vedat Kokona, Azem Shkrelit e për Fatos Kongolin, Ben Blushin, Flutura Açka, Sadik Përvetica, Zymer Elshanin, Myrvete Dreshaj – Baliu, Ibrahim Skënderi e tjerë...

*

Ndërsa, kapitulli i katërt motivohet si kapitulli i temës psikologjike

Në këtë kapitull autori ka hedhur dritë, që duhen mbajtur mend dhe të mos pësojnë ndryshime rrjedhat historike, si një nga temat kryesore: dhunimet gjatë luftës së Kosovës, ku predominon eliminimi fizik dhe mendor, del në pah lufta e moderuar e Vesli Klark për të mposhtur arkitektin mizor, diktatorin serb Milosheviç, jepet një panorama analitike e Masakrës së Çyshkut si dhe një panoramë tjetër e tej thelluar e spastrimit etnik; po kështu bëhet një analitikë e shkaqeve të vetëvrasjes dhe jepen rekomadime për të eliminuar këtë akt antinjerëzor nëpërmjet parandalimeve dhe kujdesit, që duhet treguar për uljen në minimum të tyre... Evidentimi i faktorëve të rrezikshmërisë që të shpien në suicid është një zbulues kontributi i Flori Bruqit për parandalësë.. I mëshohet në këtë kapitull edhe psikologjisë andragogjike dhe zbatimi të saj në ushtrinë shqiptare dhe në TMK/FSK. Konceptet dhe përvojat e të mësuarit, proceset volitive, orientimi për të mësuar, motivimi i të mësuarit. Ky konceptim ka objekt dhe zhvillimin e mëtejshme të përgatitjes ushtarake, duke u nisur dhe nga klimat: klima e hapët, klima e kënaqësisë, klima humaniste,...

*

Trajtesa më kapitullin e pestë është trajtesa historike dhe rrok disa tema të rëndësishme si Kosova, të pathënat pas luftës, nacionalizmi dhe ndikimet e huaja, Milan Von Sufflay dhe shqiptarët, preket Jeta e Ali Pashë Tepelenës, Ahmet Zogut dhe ky kapitull mbyllet me Adem Jashari, simbol i rezistencës shqiptare. Zbërthim analitik historic në këtë kapitullizim bëhet për Kosovën, shtypjen etnike, arkitektët e kësaj shtypjeje, misonet si dhe ndihmesa e organizuar dhe e detajuar e ndërkombëtarëve me rol parësor SHBA. Jepet dhe një panoramë e pushtimeve të Romës, Bizantit, Turqisë e tjerë, duke nxjerrë në pah dhe fetë e tyre sjellëse në këto troje shqiptare (katolicizmin, ortodoksizmin dhe islamizmin)... Tërheq vëmendjen studimi apo paraqitja që bëhet në vepër të studiesit, albanologur kroat Milan Shufflai, ku jepen të dhëna historike të panjohura si dhe po kështu paraqiten me koincizitet rrethanat e vrasjes së këtij gjeniu të letrave, (objekti i vrasjes i lidhur drejtpërdrejt me çështjen shqiptare, angazhimin e tij në zbulimin e historisë shqiptare, nëpërmejt një punimi disavolumësh), që iu përkushtua dhe studimit të historisë shqiptare, anëve esenciale të pazbuluara të saj, i shkolluar në shkollën austro-gjermane. E rëndësishme dhe shumë dukurore dhe dritësore është se për albanologun jepen të dhëna, veprimtaria e tij si dhe letërkëmbimet me personalitete, po kështu dhe fjalënderuese për veprimtarinë e tij të shumanshme shkencore e historike. Në pjesën tjetër të përshkrimit të Ali Pashë Tepelenës në librin “Olimpi Shqiptar” jepet dhe korelacioni në trajtesë të figurës si dhe përshkrimi në veprën e Dumasit dhe të Zavalanit për Ali Pashë Tepelenën. Bruqi hedh dritë në figurën e Aliut në lidhje me krijimin e shërbimit sekret të Pashallëkut të Janinës, një trajtesë interesante si pashai pati aftësi të organizonte një shërbim sekret të aftë, përballues dhe justifikues për objeksionet e tij me largpamje. Pa dyshim i rëndësishëm është dhe një pasqyrim i jetës së Ahmet Zogut, po kështu dhe e figurës kalendarike, burrërore dhe heroike të Adem Jasharit, duke e trajtuar si simbol të rezistencës kombëtare.

I nevojshëm,ky kapitull,tërheqës vëmendjeje...

Kapitulli i parafundit i “OLIMPI SHQIPTAR: rrok dhe trajton personalitete të mëdha me kontribut nga Bota e Dijes shqiptare si: Gonxhe Bojaxhiu në letërsinë shqipe, (konfigurimi i kësaj figure në shkrimet e autorëve dhe krijuesve shqiptarë), poetin, prozatorin dhe dramaturgun Jusuf Gërvalla (dalin në pah dhe evidentohen panjohësitë për veprën e tij dhe publikimi

i veprave të tij, të kësaj figure poliedrike të këtij shkrimtari martir, cilësuar prej autorit), dr. Mirela Bogdani “Dritësim i botës shqiptare” (shqiptarja e Oxfordit, nën lajtmotivin “Elita e dijes duhet riangazhuar); evidentohet Akademik Idriz Ajeti (pesë veprat e tij, kontribut madhor në fushën e dijes shqiptare), Ledri Kurti – Kraja, eseiste dhe poete shkodrane (tërheq vëmendjen “Skicë e mendimit estetik shqiptar në fillim të shekullit të XX)(Konica, Prozë dhe kritikë); trajtohet Ismail Kadare pak më ndryshe, pas dhënies së një fragmentimi jetësor nga jetëshkrimi kadarean, bëhet një zbërthim i poezisë së Kadaresë, duke e cilësuar poezinë e tij si një prej zhvillimeve më novatore në vjershërimin shqip, gjatë një gjysmë shekulli) si dhe jepet një pasqyrim i qartë i produktit letrar të Ismail Kadaresë, gjatë gjithë jetës së tij shkrimore. Bëhen zbërthime analitike të romaneve dhe veprave të Kadaresë si dhe jepen fragmente nga veprat e tij si “Kronikë në gur, “Përbindëshi”, “Kështjella”, “Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave”, “Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur”, “Qyteti pa reklama”; Jup Kastrati (Jeta dhe vepra e tij), Ibrahim Rugova(bëhet zbërthim njohës për veprat e tij, jepen çmimet dhe titujt Ndërkombëtarë të Ibrahim Rugovës, trajtohet si kultivues i modernitetit në letërsi, si studiues; Rexhep Qosja (jepet një panoramë për jetën dhe veprat e Qoses) si dhe kontributi i tij akademik në ngritjen e kuadrove shkencore në fushën e folkloristikës, fushat studimore në folkloristikë, studimet e tij teorike për figuracionin dhe stilin, studimet krahasimtare. Pastaj kapitulli vijon me: Ukshin Hotin (është një përkujtim memorial i veprës së tij si dhe mendimet e dhëna për Ukshin Hotin nga personalitete të kulturës dhe të letërsisë si Kadare dhe Qosja. Një vend të veçantë në “OLIMPI SHQIPAR” zë dhe vepra e jeta e poetit, fabulistit Izet Çulli, që është dhe në kryesinë e LNPSHA “PEGASI” ALBANIA, ku pasqyrohet vepra e tij dhe tre shkrime të tij për Kosovën; Adem Demaçi, një plotësi për të njohur këtë shkrimtar me veprat e tij), Zymer Neziri, studiues i mirëfilltë dhe kontribues në Institutin Albanologjik të Prishtinës, Adnan Abrashi, Nimon Muçaj, intelektual i Namik Shehu, Begzad Baliu dhe në fund në këtë kapitull i lihet vend pjesës opinionare.

Pjesa e fundit e “Olimpi shqiptar”

Ky kapitull sjell opinione për librin “GUXIM SHQIPTAR”

Shkrime nga Fatmir Terziu, Rustem Geci, Naim Kelmendi, Nehas S. Hoxha, Avdullah Konushevski, Izet Çulli dhe përfundon me poezi të vetë autorit Flori Bruqi dhe myllet me biografinë (jetëshkrimin) e autorit të “OLIMPI SHQIPTAR”.

Si përfundesë:

Këshillim i LNPSHA “Pegasi” Albania për librin “Olimp shqiptar”, të Flori Bruqit, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrinë e Arsimit e Shkencës të Kosovës.

Me një arkitekturë të tillë ky libër duhet të jetë një ogur i mirë për pedagogët, studentët, shqiptarë, mësuesit dhe nxënësit e të gjitha kategorive për të mundësuar zgjerimin e tyre të njohurive në disa fusha si: atë letrare, psikologjike, fushën e madhe të dijes, njohjen e personaliteteve të letërsisë botërore si dhe disa prej përfaqësuesve tipikë të letërsisë së Kombit shqiptar. Komisioni i specializuar për hyrjen e teksteve dhe librave të autorëve të ndryshëm si libra të kontributit në fushën e dijes elitare duhet të evidentojë edhe këtë libër dhe jo të vendosë në programet shkollore libra, që s’meritojnë e s’thonë gjë për letërsinë dhe kulturën shqiptare.

Studentët, tashmë, janë të prirur që t’i marrin tekstet, apo të kryejnë detyrat e kursit, duke kopjuar nga materialet në internet, duke ndryshuar paksa përmbajtjen dhe pedagogët e tyre paqetohen me këtë “vjedhje” dijes dhe errësim dijes... ,ku nuk duket intelijenca e studentit, por krijohet premise e shabllonizimit dhe kopjimit narrativ...

Kjo tashmë është bërë modë dhe sfiluese edhe me nxënësit e shkollave 9 vjeçare e të mesme. Kjo bën që të hiqet dorë nga leximi i librit...

Ky mendim i LNPSHA “Pegasi” Albania të vlejë edhe për përzgjedhje të librave të ndryshëm letrarë, që kanë vlerë të padiskutueshme në fushën letrare e gjuhësore dhe që mund të futen në programet shkollore e të mos vijohet vetëm me letërsinë e dikurshme, por me letërsinë ndryshe të mirëfilltë, që i nevojitet aktualitetit dhe zhvillimit të mendimit progresiv të shoqërisë. Po kështu Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë duhet të ngrejë një komision të veçantë për të qëmtuar, hulumtuar veprat e krijuesve shqiptarë, që sjellin pasurimin e gjuhës shqipe me neologjizma letrare, të cilat të studiohen nga studiuesi në nivelin e mësuesit si deri më tani hezitues, dhe të pasurohet fjalori i gjuhës shqipe në një kongres të veçantë për këtë akt madhor gjuhësor.

(<http://floart-press.blogspot.com/2010/12/nga-kristaq-f-shabani-nje-publikim.html>)

LETËRSIA SI “AKSION” KOMUNIKIMI

(Një libër kritik për krijimtarinë e shkrimtarit Flori Bruqi)

Rajmonda Maleçka

Flori Bruqi është njëri nga shkrimtarët, që ka shkruar njërën nga letërsitë më interesante në Kosovë, veçanërisht në prerjen kohore të viteve 90-të e në vazhdim, me çfarë është bërë prezent një nga zhvillimet më të rëndësishme, jo vetëm për Kosovën, por të gjithë Ballkanin. Në problematikën historike, etnologjike, diplomatike e emblemuar nga të gjithë analistët historik dhe ato të kohëve të vona si “nyja gordiane e Ballkanit”, letërsia e Flori Bruqit është interesante dhe e elementuar si letërsi bashkëkohore me të gjithë problematikën e saj qoftë ajo brenda letrare dhe ajo jashtë letrare. Një korpus romanesh, të cilët në librin kritik që pritet të botohet në Tiranë së shpejti, vlerësohen si detaje të realitetit shqiptar, në kushtet e një klime kolonialiste, hedhin dritë të mjaftueshme në prerjet historike të një populli të sakrifikuar dhe të kryqëzuar për një çështje të hershme dhe hyjnore. Të gjithë konfliktet hyjnore kanë në themelin e vet në raportet me lirinë. Flori Bruqi ndihmon në “paradigmën” për ta kuptuar “legjendën e mbijetesës”, gjithashtu dhe atë temën biblike të dhimbjes. Raportet që letërsitë kanë me popujt dhe tokën në të cilën ato kanë gjetur rrënjët e fjalëve dhe të mendimeve, të kujtesës dhe të nevojës për të ditur se kush është atdheu, liria, njerëzit e lashtë dhe njerëzit e lirisë, kanë prodhuar gjithmonë letërsi që ju kanë rezistuar kohërave. Një letërsi është e mirë, është nënprodukt i një realiteti të madh njerëzorë, kryesisht nga ky raport dhe nga jetëgjatësia që ajo i ka programuar vetes. Pjesa më e madhe e letërsisë së shkruar në Kosovë, veçmas nga gjysmë e dytë e shekullit që sapo lamë pas, është ndërtuar përmes një raporti ekzistencial i elementuar në subjekte, ngjarje, personazhe dhe struktura të shkëlqyera vertikale dhe horizontale me çfarë krijuesit e Kosovës i kanë bërë shërbimin kulturës shpirtërore dhe asaj të kujtesës kolektive, duke qenë e orientuar shpirtërisht. Ekzistencializmi është një konsekuencë e njohur për të jetuar, i cili është shfaqur dhe e ka pjesëtuar veten në letërsinë artistike më shumë se sa në shumë fusha të tjera të dijës dhe të filozofisë. Tek shqiptarët ky lloj raporti ka qenë shumë më herët se sa Hajdegeri të shpallte doktrinën e ekzistencializmit. Nëpër prerjet e këtij ekzistencializmi, shkrimtari Flori Bruqi ka arritur t’i “shkulë” kohës shumë personazh të tipizuar mrekullisht, shumë ngjarje me të cilat i bëjnë prezent epokën, protagonizmin historik, të cilat janë elementë të dukshëm të procesit letrarë. Studimi kritik për

krijimtarinë artistike të Flori Bruqit e karakterizon autorin si një krijues unik në kushtet e një letërsie të re dhe specifike, e cila u shkrua në Kosovë në rrethanat e një kompleksi totalitaro-kolonial, e cila ishte e kushtëzuar të ishte me një simbolikë të qëndrueshme, por të realizonte një komunikim real. Në kohët totalitare dhe ato që inspirohen prej tij, apo janë nënprodukt i tij, komunikimi ka një rëndësi të madhe, i cili lidhet me strategjinë e mbijetesës. Kosova, të paktën për një shekull është kushtëzuar për mbijetesën e saj, pasi mbi të njëri nga kundërshtarët e saj të vjetër praktikoi mbi të gjenocidin, etnocidin dhe shfarosjen e zhdukjes në masë.

a. Letërsitë si prerje të kohërave

Studimi kritik për krijimtarinë e Flori Bruqit si shkrimtarë merr në konsideratë romanet e tij të cilët njëtojnë kohët më emblematike të Kosovës. Bruqi ka arritur të sjellë personazhe, realitete njerëzore, situata, ambiente dhe klimë shpirtërore autoktone, të cilat bëhen të kapshme nga të gjithë kategoritë e lexuesit. Letërsia ka një qëllim të njohur, ajo synon të realizojë një komunikim sa më të gjerësishëm dhe sa më selektiv. Marrëdhënia që letërsia krijon me lexuesin është më e shtrirë dhe më e gjerësishme se sa njoftimi që përcjellin llojet e tjera të komunikimit, dhe të letërsisë dokumentare apo dhe asaj historike. Bruqi arrin të krijojë një raport kompleks të të gjithë llojeve të komunikimit me kohën, njerëzit, relacionet e nevojshme të shoqërisë në saj të tipave, karaktereve, ngjarjeve dhe të lëndës letrare, aq më tepër të gjinisë së romanit, duke e shndërruar të në “aksion”. “Aksioni” i komunikimit, kryesisht përmes një letërsie të ngjarjeve të hapura dhe të përjetuara, ka përmbushur njërin nga kushtet më sendërtare të letërsisë artistike, duke qenë njëra nga pasqyra më besnike ku njerëzit kanë parë fytyrën e vet dhe historia ka shtuar faqet e librit të saj të madh të etnisë, kombit dhe të autoktonitetit të tij.

Romanet dhe krijimtaria artistike e Flori Bruqit, sjell prerjet kohore të zhvillimeve të fund-shekullit të kaluar kryesisht, në një realitet të kushtëzuar njerëzore, ku duken hapur marrëdhëniet koloniale të kolonizatorit si sundues i egër dhe i papërmbajtshëm në egërsinë e vet dhe të një realiteti njerëzorë, i cili i referohet thelbit të tij që nga lashtësia deri në ditët tona. Drama dhe personazhet, aksioni i ngjarjeve dhe definicionet psikologjike, të cilët tipizojnë zhvillimet sociale dhe historike të asaj ku merren dhe autori e gjen lëndën letrare, janë si dukuria e formimit të ortekëve që zmadhohet dhe marrin fuqi në rrugëtimin e vet. Bruqi kujdeset t’i ruajë konvencionet e kohës së tij dhe të personazheve të tij.

b. Letërsitë si vazhdimësi historike

Çështjet kombëtare kanë rrënjë të thella në problematikën e tyre për t'u bërë letërsi për arsyen e njohur të tyre. Letërsia artistike i ruan ngjarjet historike ndryshe arkivave, ndryshe dokumenteve historike, ndryshe historisë, ndryshe kronikave dhe ndryshe gjithë llojeve të tjera të kujtesës. Letërsia artistike i mbush me gjak dhe shpirt ngjarjet historike, i mban ashtu dhe i ruan po ashtu. Letërsia artistike i ka kodet komunikatave më të gjerësishme dhe më shpirtërore se sa të gjithë zejet e tjera të kujtesës dhe të revokimit njerëzor. Letërsia artistike nuk i konservon as ngjarjet historike, as ato njerëzore, as dhe personazhet e tyre, përkundrazi ajo arrin t'i bëjë pjesë të konvergencave të zhvillimeve.

Personazhet e njohur dhe real të Shekspirit të madh, historia i ka fosilizuar, i ka konservuar deri në gjendje bazike, ndërsa shkrimtari i madh përmes letërsisë i ka sjellë ato në marrëdhënie me të gjithë kohët, pavarësisht sa të zhvilluara dhe të avancuara ata kanë qenë krahasimisht me kohën e personazheve real, prej të cilëve Shekspiri e mori "tharmin" e tyre. Thuajse 10 romanet e Flori Bruqit dhe libri më i mirë i tij, "Guxim shqiptar", i cili është ndërtuar si një organizëm unik, me marrëdhënie dhe kumte vertikale, horizontale dhe diagonale, dhe që është një libër për të gjithë, përbëjnë një realitet të veçantë letrarë, qoftë për tematikën po ashtu dhe për profilin letrarë që autori ka paraqitur. Dhe kjo është kaq e vërtetë, sa të zë shumë pak kohë fizike ta absorbosh në leximin e parë këtë lloj krijimtarie, por është ndryshe kur atë kërkon ta zotërosh.

Shkrimtari Flori Bruqi përmbush parimin themelorë të letërsisë si krijim, pasi ajo (letërsia artistike) nuk e përkufizon kohën që zë brenda vetes, por e pasqyron atë përmes zgjedhjes dhe seleksionimit të ngjarjeve, personazheve tipik dhe e bën të komunikueshme me të gjithë kohët. Kjo sjellje elitare dhe e zgjedhur i bashkëngjitet dhe përvetësohet

c. Metafora ekzistenciale e jetës

Duket se Flori Bruqi është një shkrimtar, i cili arrin ta gjejë letërsinë dhe gjendjen e tij krijuese, qoftë në një realitet në të cilin flitet për vdekjen, pritet vdekja, dhe, ku të gjithë lajmet që shkojnë e vijnë kanë të bëjnë po me vdekjen. Baladat e vjetra dhe ato të reja qoftë dhe për ta mundur vdekjen, kanë qenë dhe do të jenë më tragjike në historinë e njerëzimit. Epi i Gilgameshit duket se i ka thënë të gjitha që nga koha kur ai u krijua dhe deri sot. Ka kërkuar dhe ka gjetur personazhe, të cilët kanë plotësuar kapacitetin real dhe atë përtej vetës, që shkrimtari i ka bërë pjesë të një pune, frytet e të cilës jetojnë gjatë.

Jetojnë më shumë se një shtëpi, më shumë se një mundim, më shumë se të gjithë gjërat e tjera më të sofistikuara, që njerëzimi është përpjekur dhe ka luftuar ta “mbajë” kohën, ta sundojë atë. Koha nuk mund të sundohet kurrë, ajo zotërohet dhe të gjithë këtë e kanë bërë shkrimtari me letërsinë, që nga kohët antike deri sot. Letërsia e mirë e “mban” kohën, ajo e merr atë mbi shpinë, siç mund të marrësh mbi shpinën e devesë dhe një shtëpi, e përcjell nga koha në kohë. Asnjë teknologji tjetër sado e sofistikuar të ketë qenë ajo nuk ka arritur ta bëjë këtë, përveçse letërsia dhe shkrimtari. Shkrimtari Flori Bruqi ka kërkuar ngjarje dhe ato i ka gjetur në jetën e njerëzve të tij, në jetën e armiqve të historisë dhe të popullit të tij. Ka qenë një ngjarje që ka shëtitur nëpër të gjithë rrugët e vendit të tij, nëpër rrugët e fisit të tij, prag më prag shtëpie. Ai, shkrimtari është nxënë me atë ngjarje, është rritur dhe pjekur me të. Një pjesë të saj e ka marrë në shpinë si ajo deveja nëpër shkretëtirë, një pjesë tjetër e ka “bërë” burrëri për ta përballuar jetën. E gjithë krijimtaria e Flori Bruqit është një mega-metaforë e ndërtuar “metonimikisht” në raportet e njeriut me njerëzit dhe e qëndresës me ekzistencën. Studimi kritik mbi krijimtarinë e Flori Bruqit arrin ta elementojë të gjithë strukturën artistike të cilës i “perimetrohet” dukshëm ç’ e ka motivuar atë dhe pse ka qenë e tillë. Krijimtaritë universale vijnë përmes thjeshtësisë së vet, por e mbajnë të tillë temat universale, për të cilat njerëzimi ka pasur, ka dhe sot do të ketë përjetësisht nevojë. Studimi kritik për krijimtarinë e Flori Bruqit prek dhe çështjet e tjera të letërsisë që është shkruar dhe po shkruhet në Kosovë.

FLORI BRUQI - TRIUMF SHQIPTAR

Nga Prof. dr. Eshref Ymeri

Albert Kamy (Camus - 1913-1960) thotë: "Asgjë tjetër nuk mund ta frymëzojë kaq shumë njeriun, sesa vetëdijësimi për gjendjen e tij të pashpresë".

Në universin e kulturës shqiptare është i rrallë fakti që një krijues të dalë para lexuesve me autoritetin e admirueshëm të një shkrimtari, poeti, përkthyesi, publicisti, historiani, gjeografi, analisti dhe kritiku të talentuar. Libri më i fundit, me titull "Triumfi shqiptar", i tridhjeti në serinë e botimeve të zotit Flori Buqi ..., nxjerr në spikamë natyrën shumëdimensionale të krijimtarisë së këtij personaliteti të shquar të kulturës shqiptare. Në universin e kulturës shqiptare është i rrallë fakti që një krijues të dalë para lexuesve me autoritetin e admirueshëm të një shkrimtari, poeti, përkthyesi, publicisti, historiani, gjeografi, analisti dhe kritiku të talentuar. Tek lexon këtë vepër kaq interesante, që të rrëmben me tematikën e vet bukur të larmishme, nuk mund të mos ndiesh njëherazi kënaqësi dhe krenari për faktin që krijimtarinë e zotit Flori e përshkon tejandanë një frymë mahnitëse objektiviteti, humanizmi dhe optimizmi të pakundshoq. Mes rreshtave të kësaj vepre nuk është vështirë të kapësh tiparin më themelor të formimit intelektual të zotit Flori - dashurinë e tij të pastër për tokën amtare, respektin e lakmueshëm për këdo që është atdhetar dhe që e do me shpirt punën, si burim mirëqenieje dhe begatie për të gjithë. Albert Kamy (Camus - 1913-1960) thotë: "Asgjë tjetër nuk mund ta frymëzojë kaq shumë njeriun, sesa vetëdijësimi për gjendjen e tij të pashpresë". Duke pasur parasysh këto fjalë të qëlluara të Kamysë, mendoj se të gjithë ata shqiptarë që popullojnë mbarë trojet tona etnike në Evropën Juglindore dhe që janë të kapluar nga pak nga ndjenja meskiniteti, cmire, xhelozie, inferioriteti dhe zvetënimimi të shpirtit njerëzor, pra, nga "vetëdijësimi për gjendjen e tyre të pashpresë", është mirë ta lexojnë, me durim, veprën e zotit Flori, se nuk do të mbeten të zhgënjyer, nëse do të jenë në gjendje të zbulojnë brenda qenies së tyre një çikëz frymë objektiviteti. Kam bindjen se do të dalin të fituar, se vepra e zotit Flori shërben si melhem për qetësimin e shpirtit që janë të infektuar nga mikrobi djallëzor i përçarjes njerëzore. Ne, shqiptarët, kemi dhënë dhe vazhdojmë të japim prova boll të dhimbshme të përçarjes kombëtare, çka e kemi paguar shtrenjtë - me

copëtimin e trojeve tona etnike. Evropa na e ka njohur mirë dhe na e ka “yshtur” po aq mirë këtë mikrob të mallkuar, prandaj edhe trojet etnike na i bëri çarçaf. Vepra e zotit Flori duhet të lexohet me shumë vëmendje sidomos në Kosovë, në mënyrë që njerëzit e infektuar nga mikrobi i përçarjes t’i thërrasin mendjes dhe të heqin dorë një herë e mirë nga sulmet që ndërmarrin kundër njëri-tjetrit nëpër faqet e internetit, ca sulme publike këto, me një fjalor të padenjë për stilin e komunikimit njerëzor, por edhe më shumë të padenjë për një komunikim intelektual. Më gëzon shpirti dhe ndiej një kënaqësi të jashtëzakonshme kur lexoj këtë vepër të zotit Flori, që të mëson dhe të frymëzon që ta duash dhe ta respektosh njeriun, pra, ta duash dhe ta respektosh shqiptarin.

Sepse në analizat e veta shkencore zoti Flori, tërthorazi, zbulon anët më humane të shpirtit njerëzor, ndikimin e tyre në plazmimin vlerave e krijuese dhe rolin që ato duhet të luajnë në shëndoshjen e shpirtit shqiptar me dashurinë e njeriut për njeriun. Në gjykimin tim, mbarë krijimtaria e zotit Flori, për tematikën e gjërë që trajton dhe për objektivitetin e analizave shkencore që shpalosen në të, mund të vlerësohet pa drojë si modeli i enciklopedisë së mendimit shqiptar.

Santa Barbara, Kaliforni
19 qershor 2010

DOLI NGA SHTYPI “OLIMP SHQIPTAR” ME AUTOR FLORI BRUQIN

Një publikim serioz dhe i vlerësueshëm në fushën e dijes shqiptare. Kohët e sotme janë kohë të lulëzimit modernist dhe të daljes nga “prangimi” dhe “ganxhimi”, i të cinguarve me emër pronor, që dolën nga “Lëvozhga mit” dhe elegjuan “vargjet vrara” tregojnë për përçapje studimore jashtë “kuadraturës kriteriale “ e normativave moralizuese... Ende në studimet apo mendimet kritike thuren lavde të pamëritueshme për krijues, që shkuan apo që janë aktualisht, pa i këndvështruar ata me sensin e origjinalitetit dhe të prezencës “autoritare“ të kreaturës së tyre..., por shpesh ndiqet përvijimi i rrugëtimit të tyre, nëpërmjet asaj ç’kanë thënë të dikurshmit, të cilët kanë humbur logjikën” e mendimit kritik, në këtë kohë të ndryshimeve të gjithanshme dhe atyre emotive, duke mos kapur fillin e najlonizuar... Krijimi është produkt i një të talentuari me forcë të madhe meditative, me një këndvështrim ndryshe nga të tjerët, i cili dritësohet nga një diell tjetër dhe është i aftë të krijojë lidhësinë shpirtërore në një formë e trajtë çudibërëse dhe në një klimë polarizuese me stina të kthyeshme, të ndërthurura dhe të ndërvarura nga njëra - tjetra. Sot me studime dhe mendim kritik merren dhe ata, që s’kanë minimumin e njohurisë për këtë shkencë të madhe, duke krijuar precedentin e rrezikshëm të vulgarizimit dhe të skepticizmit të mediokritetit. Ndërmarrja e veprave të studimit analitik në këtë vullshmëri dhe stad krijimi me një temperament e stil më të lirshëm, më të pushtetshëm kreativ është një veprimtari, e cila kërkon nivel të lartë kulturor. Shtëlljesë: Libri “OLIMPI SHQIPTAR” I FLORI BRUQIT është një libër voluminoz, i cili edhe nga aktitektura si dhe nga kapitullizimet e tij tregon katërcipërisht erudicionin, nivelin e njohurive të autorit, lëvrues dhe studiues në shumë fusha, duke bërë analitika dhe paraqitje profesionale. Në këtë libër, duke u nisur nga shijet e tij artistike, që duhen respektuar, ai ka rrokur disa nga poetët shqiptarë si: Azem Shkreli, Agim Vinça, Fatos Arapi, Arshi Pipa, Avdulla Konushevc, Esat Mekuli, Agim Bacelli, Besnik Mustafaj, Arif Molliqi, Din Mehmeti, Naim Kelmendi, Sabri Hamiti, Fahredin Shehu, Rajmonda Moisiu, Mardena Kelmendi, Pal Sokoli, Albana M. Litschin, Raif Gashi dhe Iljaz Prokshin.. (<http://hermesneës.org> 26 Shkurt 2011)

NJERIU QË SHTROI SHINAT E “OLIMPIT” SHQIPTAR

Nga Faik Xhani - studiues

Rrjedha kohore ecën me ritmin e saj, duke ruajtur në memorien e nderit njerëz e personalitete të nderuar. Në epokën e sotme një nga këta është edhe intelektual, publicisti dhe shkrimtari kosovar Flori Bruqi.

Ai, prej kohësh, krahas aftësive profesionale si mjek ka shpalosur talent e mjeshtëri artistike edhe në lëmin e botimeve. Krijimtaria e tij është e larmishme, në prozë dhe poezi, por veçanërisht ka spikatur në prozë, duke botuar 8 romane, 11 libra shkencor, 21 fejtone publicistiko-shkencorë, shumë ueb, faqe interneti me punime socio-psiko-kineozilogjik, të fshehtat e të vërtetat e virusit avian etj.

Flori Bruqi me impenjimin e tij shumëvjeçar, me punën e tij prej intelektual, me obligim atdhetar, me përgjegjësinë e një studiuesi dhe hulumtuesi serioz, me peshore farmaceutike, ka ditur të zgjedh e të përmbush pjesën lëndore të “Olimpit” Shqiptar.

Flori Bruqi, shkrimtari që shtroi “shinat” e “Olimpit” Shqiptar.

Ky shkrimtar me një humanizëm e mirënjohje të thellë dhe me një hulumtim serioz disa vjeçar ka mundur të ngrëjë një “Olimp Shqiptar” me xhevahirët e krijimtarisë të krijuesve shqiptarë duke gjetur, zbuluar, studiuar, vlerësuar e bashkuar në një libër voluminoz prej 665 faqesh, i cili titullohet “Olimpi Shqiptar”.

Ashtu është titulluar dhe ashtu qëndron, jo si lartësi copëzash të ngurtësuar, por si lartësi vlerash ideo-artistike e mjeshtrove të letrave shqiptarë, pavarësisht se ku kanë punuar e jetuar.

Autori Flori Bruqi projektoi dhe hapi “trasenë” e “Olimpit Shqiptar” të krijimtarisë. Ky libër përmbledh 12 poetë shqiptarë, 12 shkrimtarë botërorë, 22 recensione për krijimet më të mira shqiptare dhe botërore, 7 tema psikologjike, 6 historike, 19 shkrimtarë e personalitete nga bota shqiptare, 14 poezi dhe si një epitaf i argjend jetëshkrimi i tij. Ky libër shpërfaq jonizimin e shpirtit të autorit, si më i miri pjalm që bulëzon shpirtra, gjallon zemra, fladit mendje, ndriçon

“maratonën” e krijimtarisë shqiptare dhe e ngre atë në lartësinë e një “Olimpi Shqiptar”, si pjesë integrale e artit dhe kulturës evropiane.

Ferri i Flori Bruqit

Nëse Dante Aligeri na solli Ferrin e fantazuar me të gjitha labirintet e tij deri tek rrethi i 12-të të perëndisë, në ditët tona doli një Dante i Ri. Ai është shkrimtari kosovar Flori Bruqi. Ky autor na ka sjellë ferrin e vërtetë njerëzor, jo si dënësë e perëndisë për të këqijat dhe mëkatet e botës njerëzore, por ferrin e shtetarëve e gjeneralëve të Serbisë, të strukturave të ushtrisë e policisë serbe. Në këtë libër, nga faqja në faqe njihesh me skena të llahtarshme jo të sajuara, por reale, ku artistët që luajnë, janë: plaka, pleq, gra, burra, mandej dhe fëmijë, femra e meshkuj, është një popull i tërë i vënë në kalvarin e vuajtjes e të torturës, një popull i destinuar për t’u përzënë nga trojet etnike e për t’u qitur fare me gjithçka. Është një vend i cili u bë shkumb e hi jo vetëm nga zjarri i predhave e bombardimeve, por edhe nga zjarri i vendosur me benzinë nga dora e shkjaut.

Kur lexon këto faqe të këtij libri nuk ka mëndje që nuk luan, nuk ka sy që nuk loton, nuk ka trup që nuk rënqethet, nuk ka qenie që nuk revoltohet, nuk ka njeri që nuk reagon dhe nuk besoj të ketë qenie njerëzore që të mos jetë e gatshme për t’u radhitur në skalionet e luftëtarëve për t’u thënë ndal, këtyre kriminelëve të njerëzimit, arqitekëve të gjenocidit serb në Kosovë apo atij çam në Greqi.

Duke lexuar librin lexuesi futet në botën e krimit, nuk është më njeri, por duket si një profet që vëzhgon çfarë ndodh në atë labirint krimesh dhe i raporton zotit të tij. Lexuesi xhiron me kamerën e ndjesive, përjetimeve, fantazive dhe riprodhimeve të realiteteve monstruoze që Flori Bruqi, falë aftësive të tij psikologjike, por edhe atyre artistike i sjellë mjeshtërisht në memorien tonë.

Përshfaqet aty Shën Bortolemeu i Gjakovës, objektet fetare qindra vjeçare që digjen, nëna që dhunohen para fëmijëve, mure të përgjakura, bajoneta që presin kopsa, çjerrin gjokse, trupa që digjen me benzinë, makina që mbushen me kufoma dhe nuk dihet ku përfundojnë, prindër që çmenden para torturave të fëmijëve e dhunimeve të nuseve të djemve, gjurmë dhëmbësh nëpër trupësa, shenja plagësh e djegiesh nëpër trupësat e femrave kosovare, sisa të prera, sy të dal, gishta të prerë etj. Shëmbëlltyrat më të këqija të Europës të sotme.

Është shumë tragjike, e paprecedentë dhe nuk mund të kapërdihet pa lënë gjurmë te çdo lexues e te çdo njeri që i thotë vetes njeri, vrasja e 22 fëmijëve të familjes Vejsa, të familjes Cana, Ramadani etj, masakrimi i kirurgut gjakovar Dr. Izet Himës, 2019 femrave të dhunuara që trajtohen nga shoqata “ Jeta në Kastriot” nga të cilat, 124 prej tyre janë me gji të prerë e gishtërinj të këputur, 9

me sy të nxjerr, 16 me plagë në fytyrë që kanë lënë 4327 fëmijë jetimë, të cilët presin me padurim të shohin e të shijojnë kujdesin amësorë. Krime këta që as mendohen, në realitet, kanë ndodhur dhe dëshmojnë çdo ditë para Europës e botës. Ja sepse s'ka kohë për pritshmëri, s'ka asnjë mëdyshje dhe s'ka pse të ketë asnjë hezitim nga Tribunali i Hagës për të hetuar dhe vënë para përgjegjesisë autorët e këtyre krimeve. Nuk ka arsye të heshte të anashkalohen qoftë edhe ata që i kanë kryer, pavarësisht nga ata që i kanë urdhëruar.

S'ka asnjë arsye që të heshte e të anashkalohen veprime e qëndrime vandaliste e shoviniste që shfaqen hera-herës nga serbët në Kosovë dhe grekët me shqiptarët. Qoftë edhe raste të shkëputura duhen vlerësuar me rigorozitet, hetuar dhe parandaluar në kohë.

Pikërisht libri i autorit Flori Bruqi "Olimpi Shqiptar" është sinteza më e mirë e dëshmisë së krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit serb në Kosovë.

Ai është një apel i hapur për EULEX, BE dhe për Kombet e Bashkuara për të nxjerrë mesazhet e duhura e për të vënë para përgjegjesisë çdo shtetar e shtet që kryen krime e gjenocid, për të prerë e parandaluar një herë e mirë dorën gjakatare të masakrimit, terrorizmit e shfarosjes së njerëzve të pafajshëm e të pambrojtur.

Autori i mizoskenave psikologjike të qenieve njerëzore nën presion dhe kanosje për jetë a vdekje.

Në librin "Olimpi Shqiptar" nga faqja 309-400 janë trajtuar me realizëm temat psikologjike. Në këtë sprovë prej 100 faqesh, autori Flori Bruqi jo vetëm paraqitet si njohës i thellë i psikologjisë, por paraqitet i veçantë edhe si prozator. Është veçori dalluese e këtij autori pasqyrimi i proceseve e gjendjeve psikologjike të personazheve të tij artistikisht. Ky autor falë kompetencës në lëmin e psikologjisë, ka harmonizuar bukur me anë të fjalës artistike rrjedhën e përjetimeve dhe tablotë e mizoskenave psikologjike të qenieve njerëzore, veçanërisht kur ata janë nën presion e shantazhim, nën trysni të kanosjes me vdekje dhe shuarje jete. Autori në këtë plan mund të jetë ndër lauerantët e paktë edhe në botë të këtyre mizoskenave e të këtij aereali psikologjik. Flori Bruqi me këtë libër ka sjellë një kinoditar me metrazh të gjatë të traumës psikologjike të njerëzve nën dhunim e torturë. Autori me mjeshtëri artistike dhe profesionale ka sjellë në faqet e librit traumën psikologjike të një populli martir siç është populli kosovar, ka realizuar më së miri edhe një model të rrjedhës së proceseve e gjendjeve psikologjike në kushte të veçanta specifike, në kushtet e traumës e të shantazhimit, kur luhet me jetën e vdekjen. Ai nuk mbetet, thjeshtë një vëzhgues i

këtyre proceseve e gjendjeve psikologjike të personazheve të të gjitha moshave, por i zhbiron thellë ata, i ndjek hap pas hapi, i analizon me detaje, përgjithësisht jep dhe mesazhe profilaktike për kapërcimin e rehabilitimin e tyre. Pikërisht në këtë anë fokusohet shumë, pasi ajo çka ndodhi, nuk mund të ndalohet më as në Kosovë, as në Çamëri, por e rëndësishme është parandalimi i situatave të tilla kudo në botë dhe rehabilitimi i këtyre viktimave nga qeveria e Kosovës, Greqisë, Avganistanit, Libisë e gjetkë.

Autori Flori Bruqi si specialist i fushës së psikologjisë profilaktike fokusohet në mënyrë të veçantë në një dukuri që është shtuar shumë në Kosovë dhe në shumë vende të botës, SUICIDIN (vetëvrasjen). Jep dinamikën e këtij procesi, analizon në thellësi faktorët që i çojnë njerëzit në këtë përfundim si dhe jep mesazhe shumë profilaktik për kujdesin dhe parandalimin e Suicidit duke deduktuar: “ Edhe një i vetëm të shpëtohet është e rëndësishme sepse është jetë njeriu e pakompesueshme me asnjë lloj vlere...” (faqe 391). Më tej duke analizuar këtë akt thekson: “Suicidi është një moment kur dhimbja shpirtërore është e masës sa mjegullon vetëdijen dhe akti si akt, vjen si pasojë e dëshpërimit të madh, ndjenjës së pavlerës e pashpresës për jetën”

Analizat dhe mesazhet që jep autori janë shumë kuptimplote për çdo shtetar e qeveri. Trajtesa e këtij akti nga autori si dhe mesazhi që jep janë sa humanë aq edhe të domosdoshëm për çdo qeveri e për çdo shtetarë për ta kthyer fytyrën më mirë nga shtetasit e vet dhe për ta patur prioritet mirëqenien dhe lumturinë e tyre.

Autori Flori Bruqi është njëkohësisht edhe një analist dinjitoz i situatave e proceseve rajonale e globale dhe duke qenë i tillë, me vizionin e tij shkencor e largpamës apelon përpara organizmave ndërkombëtare për parandalimin e gjenocidit e të traumatizimit psikologjik kudo në botë. Ai i fton partnerët ndërkombëtar për të mos i anashkaluar këto trauma njerëzore, përkundrazi për t'i zbuluar, vlerësuar, hetuar, parandaluar dhe duke dënuar cilin do që shkel të drejtat universale të njeriut, qofshin individë apo shtete.

“Olimpi shqiptar” i Flori Bruqit

Një libër dëshmi e terrorizmit, masakrimit, traumatizimit dhe shfarosjes të popullit shqiptar të Kosovës. Me shqetësimin e një atdhetari të vërtetë, me përkushtimin e një hulumtuesi serioz dhe me vendosmëri të rrallë autori Flori Bruqi ka mundur të zhbijojë thellësisht strategjinë e spastrimit etnik të Kosovës dhe të zbulojë të vërtetën e funksionimit e të veprimit të strukturave policeske të sigurimit serb. Autori ka arritur të zbulojë pseudonimet, ndërtimin, funksionimin, përbërjen,

drejtuesit e tyre, aksionet terroriste, masakruese e shfarosëse të civilëve të pafajshëm e të pambrojtur në Kosovë.

Ky autor nëpërmjet hulumtimit, investigimit, intervistimit nga ai vetë apo të tjerë nga Europa e bota jep të qartë tablonë e krimeve, por edhe të strukturave e autorëve të tyre. Ai ka mundur të japë një tablo të qartë për atë çka ndodhur në Kosovë para dhe gjatë ndërhyrjes së NATO-s, me synim të mirëpërcaktuar nga Millosheviçi dhe krerët e tjerë drejtues të shtetit Jugosllav.

Autori i librit zbulon lakuriq të vërtetën mbi masakrat në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq. Midis tjerash shkruan: “Të premtën, ditën e ngrohtë me diell, më 14 maj, të vitit 199 në një kënd të Europës dhe nën bombat e NATO-s, 41 meshkuj nga fshati Qyshk, ishin vrarë nga forcat kombinuara militare serbe. Moshë nga 19 deri në 69 vjeç. Në mëngjesin e së njëjtës datë, forcat serbe të sigurimit kishin sulmuar dhe dy fshatra të tjerë fqinj, Pavlan dhe Zahaq, ku kishin dëbuar nga shtëpitë gratë, fëmijët dhe pleqtë dhe kishin vrarë në tërësi 72 njerëz. (f.348).

Një nga personazhet e librit Lulja e rrëqethur tregon: “Me këto dy duar unë kam mbledhur eshtrat e dajave të mi, kushërinjve dhe të babait tim. Atë që kishte mbetur nga babai im, e gjeta fare në fund, por jo tërë kufomën. Vetëm disa pjesë nga trupi i tij. Nuk kam gjetur këmbët as kokën. Vetëm brinjët kam gjetur. Dhe me këto duar e kam kallur në dhe kurse, këta-serbët, këta që e kanë vrarë, ata i kanë duart e zhytura me gjak . Ata e kanë vendin në Hagë (f.353).

Duke lexuar librin “Olimpi Shqiptar” lexuesi takon pseudonime të tillë si: “Frenki”, “OPG”, “Mogla”, “Munja”, “Brigada Cara Dushana” etj . Ata janë struktura të policisë, sigurimit e të Armatës Jugosllave që kanë kryer krimet më makabre që ka njohur njerëzimi, të cilët urdhrat i kanë marrë nga njerëzit e gjeneralët më të besuar të Millosheviçit. Gjithashtu emra të tillë si Dragani, Njebosha Miniq (Mirtvi), Vedamir Shalipuri, Miqo Martinoviq, Gjuro Kastratoviq, Milan Kaljeviq, Obrad Rajiqeviq etj. Kanë qenë pjesëtarë të “Munja” që kanë marrë pjesë në disa përlëshje të mëdha me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës “(366). Më represivët e më të dhunshëm në terrorizimin, dhunimin, djegiet dhe vrasjet e civilëve të pafajshëm në Kosovë, veçanërisht në Pejë, Qyshk, Pavlan, Zahaq etj. Pjesët me titujt: “Kush duhet të sjellë drejtësi në vend”, “Na duhet drejtësia sikurse plagës ilaçi”, “Spastrimi etnik dhe ndërgjegjësimi”, “Spastrimi etnik –gjenezë e një ideologjie”, “Përvoja e re, një përvojë e hidhur” etj. Tregojnë vizionin e këtij autori, i cili e lejon atë të nxjerri përfundime me vlerë si dhe të japë mesazhe paqe e lirie jo vetëm për Kosovën e kosovarët, por për të gjithë popujt e vendet e botës. Përvoja e fituar dhe ndërgjegjësimi i plotë për krimet dhe gjenocidin serb në Kosovë e atë Çam në Greqi përbëjnë pika kyçe orientimi, por edhe bazamente të forta përvoja për parandalimin e këtyre krimeve e

gjenocidi kudo në botë. Për nga larmia e tematikës, galeria e personazheve, mënyra e pasqyrimit, analizat e holla e të thella, hulumtimi serioz, të dhënat e njohuritë si dhe deduktimet e mesazhet që jep libri i autorit Flori Bruqi “Olimpi Shqiptar”, përbën një nga librat më të arrirë e shumë interesant nga i cili, kushdo mëson. Ai mbetet një thesar krijimtarie. Ja sepse meriton të zë një vend nderi në bibliotekat e gjithë shqiptarëve kudo që punojnë e jetojnë e më gjerë. Ky libër shtroi “trasenë” e krijimtarisë të “Olimpit Shqiptar”, e cila nevojitet, të pasurohet gjithnjë e më shumë, me krijimet e autorëve shqiptarë nga të gjitha trevat e viset, ku banojnë e jetojnë.

POEMA E DRITËS

Gëzim AJGERAJ

Flori BRUQI: cikël poetik; “Fillimi i një poeme”, nga libri: Nëse kam ditur të guxoi, Prishtinë, 2011

Kësaj here do të ndalemi brenda një cikli poetik të poetit Flori Bruqi, duke depërtuar në brendinë e metaforës së vargut të tij, për ta zbërthyer atë nga brendia e përceptimeve tona. Vargun e poetit Flori Bruqi, në këto dhjetë vitet e fundit, e kemi lexuar me kënaqësi, duke e përjetuar po me aqë laryshi temat që na i sjellë ai, brenda vargjeve. Nga një përceptim i hollë, brenda këtij cikli e gjejmë portretin e nënës. Është simbolika më e mirë e dashurisë, brenda të cilës poeti i tërheq dy paralele të pandashme nga njëra-tjetra. Mëmëdheu dhe nëna, janë dy simbolikat e pandashme të dashurisë, të cilat më së miri fshihen brenda metaforave të vargut, nga të cilat ndërtohet edhe bërthama e këtij cikli me poezi.

...Nga t'ia fillonim?!

Nga plagët e trupit, të zemrës, apo të mëmëdheut ?

Nëpër deje na rridhte Revolucioni dhe qumështi i nënave

Dhe ne-e dinim:

Pa nëna dëshmorësh,

Pa gra e nuse të veja

S'do të ketë kurrë paqë e liri...

...

Fillimi i një poeme

Pra, simbolika e mëmëdheut dhe portreti i nënës, është paralelja më e mirë që i bëhet në vargje, dashurisë për mëmëdhenë, për lirinë e tij. Fillimi i një poeme, na vie edhe si një fillim i ri, për të cilin, u desh mund, djersë, sakrificë e gjak, për të ardhur deri tek drita, liria.

...

“Nënë, për ta shpëtuar jetën Ty,

dhashë lëkurën e do ta jepja edhe shpirtin”

Prof.dr.sci.Mirlin (Maxhun) Bruqi

Simbolika e këtyre vargjeve, është emblema më e mirë, e asaj që e thamë edhe më lartë. Ajo është pasqyra më e mirë e një realiteti, brenda të cilit u përbirua

kauza e jonë, mëmëdheu, kombi. E gjithë kjo, i ngjanë një rikujtese, për një fillim të ri që duhet ndërtuar, pa e harruar kurrë atë që përjetuam. Por, ajo të na vie gjithmonë në rikujtesë, për ndërtimin e një të ardhme të mbarë. Këto thirrje, brenda vargut, hapin dritë, vizion, për këtë fillim të ri.

...

Çerrekshekujt

Në kurriz të maleve

Lanë gjurmët e kanoneve

E Ti

Kosovë

U dole para

AGIMEVE TË MËDHA

Kur trolli me nofullat e veta

Kafshonte BIJTË E SAJ

Kosovë

U dole përpara relikteve'

Qindvjetëshe

Kur Trolli pinte gjak

Përtypte barot

Fashatonte plagën

....

Agimet e Kosovës

Mungesa e nënës, në simbolikën e dytë, krijon një boshllëk që nuk e zëvendëson me asgjë. Kujtimet e saj, fjalët, dashuria, kujdesi, janë sekuencat, të cilat shtrohen brenda metaforave në varg, për ta pasqyruar botën shpirtërore të dhimbjes së poetit. Këtë mungesë, ai e ndien edhe më thellë, brenda mungesës së brezave të të ardhmes së tij, të cilët tani më gjenden diku largë. Dhe kjo mungesë e rrethon nga çdo anë, për ta bërë botën e poetit edhe më të zbrazët.

...

Unë

Kam parasysh

Profilin e fëmijëve të mi

Shoh në sy

Profilin e Granitit e Diamantit

Mullarët e sanës

Në oborrin e braktisur

Ja(gati) e gjithë familja

Mungon(vetëm fizikisht)Ajo

Mungon Nëna ime

Portreti i nënës

Duke e zbërthyer simbolikën e vargjeve për nënën, sërish kthehemi tek simbolika e mëmëdheut, pa të cilën s`do të frymonim as ne sot të lirë. Dashuria për të, e ka ushqyer gjithmonë idealin e flijimit, i cili edhe e solli këtë fillim të ri. Gërshetimi i këtyre simbolikave, nuk është i rastësishëm, janë pikënisjet e poetit, brenda të cilit ai e ndërton edhe vargun, dhe për mes tij frymon ndër ne. Brenda këtyre agimeve të bardha të Kosovës, dhe brenda këtij akuareli të diellit të saj, nganjëherë gjejmë edhe zhgënjime, dhe jo pa arsye. Janë herë herë shpresat e djegura të poetit në varg, ashtu siç po i digjen herë herë shpresat e Kosovës, nëpër rritën e saj plotë plagë e dhimbje në trup e në shpirt.

...

*Mërgim mëkatar, mijëra varre bosh ke lënë ti
nënat kobzeza, që s`kanë një gur ku të qajnë
vejusha të pafat ngado mbjellë si tulipanë të zinj
fëmijë që prindërit në prehër dot s`i mbajnë*

*Emigrant, fjalë mizore që s`di të falësh kurrë
dete lotësh mbush e mallin kudo ti e mbjell
zemra nënash me gozhdë mbërthyer në mur kujtimi
përcaktor njerëzish që tonelata dhimbjesh sjell...!
në shpresat e djegura vret dhe qan trishtimi...*

Shpresat e djegura

Laryshia e temave dhe vargjeve, që na sjellë poeti, na e portretojnë realitetin e këtij fillimi të ri, me plotë sfida dhe të papritura, të cilat shpesh edhe nuk përkojnë me ëndrrat tona, për agimet e bardha të Kosovës, për të cilat u desh gjak shekullor. Ne, e zbërthjem vetëm një cikël me poezi, për ta sjellë tek ju një pasqyrë të shkurtër drite, për vargun e poetit Flori Bruqi, duke uruar atij gjithmonë suksese në krijimtarinë poetike dhe në letrat shqipe.

Zvicër, 21. nëntor 2011

**VËSHTRIME KRITIKE
PËR VEPRAT LETRARE**

ZIGMUND FROJDI DHE NDIKIMET E TIJ NË TEORITË SEKSUALE SI DHE NË LETËRSI

Frojdi u ulë këmbëkryq dhe te tregimi “Mësuesja e Pianos”, ku një grua në moshë të avancuar dashurohet marrëzisht me një adoleshent, të cilit i jepte mësim në piano, ose te novela “Hakmarrja e Penelopës”, ku ndodhin perversitete të tilla seksuale, të cilat vajza Filomenë i percepton në mënyrë dramatike. I tillë ka qenë ndikimi i Frojdit në botkuptimin tim shkencor dhe në veprat e mija.” Sa herë kujtoj të kaluarën, para syve më del biblioteka modeste e tim eti. Të shumtë ishin librat që mbushnin raftet. Midis tyre “Tre contributi alla teoria sessuale” i Zigmund Frojdit, shkruar në vitin 1905, dhe botuar në italisht në vitin 1921. Im at e kishte blerë në librarinë e Lumo Skendos. E kisha të vështirë ta kuptoja atë libër, pasi jo vetëm njohuritë e mija në gjuhën italiane ishin në hapat e para, por dhe e pamundur të kapja thelbin e problemeve. Megjithatë ai hyri në subkoshjencën time për të qëndruar në përgjumje deri në vitet e fakultetit. Por asnjë pedagog nuk merrte kurajon t’na sqaronte rrolin e madh që luante Frojdi dhe psikoanaliza frojdiane në zbulimin dhe mjekimin e një sërë sëmundjesh, që lindnin në thellësi të materjes trunore dhe që manifestoheshin në trajtën e neurozave. Nga ana tjetër, asgjë nuk më pengonte të kërkoja e të thelloja dijet e mija, por ishte e pamundur të shtija në dorë libra të tij apo të psikoanalistëve të tjerë si Fromm, Serain, Morgan, Jung, Breuer, Maeder, Bahofen, Sharko, Niçe, etj. Frojdi në kohën e tij donte të provonte se neurozat (dukuri që çonin në disekuilibër individual) vinin nga ndrydhja e dëshirës seksuale, sepse seksi ishte tabu, dhe sikundër thotë Cvajgu “instiktet nuk lejojnë t’i shtypësh dhe është e kotë të supozosh sikur i shtyp. E shumta mund t’i ndrydhësh duke i kaluar nga vetëdija në pavetëdije. Por ato duke ju nënshtruar kësaj shmangje të rrezikshme, grumbullohen në thellësi të shpirtit dhe duke fermentuar vazhdimisht, krijojnë shqetësim nervor, çrregullime dhe sëmundje.” Sa herë e kam takuar neurozën hysterike në praktikën mjekësore. I joshur nga Frojdi dhe teoritë e tija, duke e parë hysterizmin si pengesë të jashtme ose të brendshme, si një mangësi në plotësimin e vërtetë të kënaqësive erotike, që Silvia V. Finzi e konsideron patologji tipike femërore, këtë aspekt interesant të jetës e trajtova në dy tregime. Një fshatare nga rrethi L, rreth njëzetedy vjeçe, prej katër vitesh e martuar, shfaqte shenja të çuditshme. Ku e

kishte bazën ajo dukuri neurotike? Tek i shoqi, minatorë në një minierë kromi. Ai vinte rradhë në shtëpi, i lodhur sa nuk kishte fuqi të qëndronte në këmbë dhe harronte që gruaja e priste. Kështu nusja e re e gjeti rrugën e zgjidhjes, manifestime e shenja neurotike, tipike për klinikën e histerisë. Ajo mori kurajon, dhe ashtu sikundër e përshkruan tradhëtinë e gruas Anton Çehovi te tregimi “Hakmarrja e një gruaje”, iu dha mjekut, duke plotësuar nevojën fizike dhe kënaqësinë shpirtërore. Rasti i dytë ishte një grua nga Azia e Mesme, që qëndronte mbyllur brenda katër mureve të apartamentit ku banonte. Ajo ishte e re në moshë, ndërsa i shoqi midis të pesëdhjetave ose të gjashtëdhjetave dhe nuk arrinte të kuptonte se çfarë ajo donte, e i trembur kërkonte ndihmën e mjekut. Në rastin e parë kishim të bënim me një çift në moshë deri tridhjetë vjeç, kur seksi bëhet çdo natë dhe çdo mëngjes; kurse në rastin e dytë, gruaja ishte në moshën që e kërkonte bashkimin gjinor dy herë në ditë, ndërsa i shoqi qëndronte midis dy periudhave kohore, kur seksi bëhej sipas mundësisë ose Zoti e di se kur. Këtë aspekt të jetës nuk e kam pranuar si stimulim, por sikundër thotë Frojdi “si sëmundje të shpirtit, si më interesanten, sepse është më plastikja nga të gjitha dhe dëshmon se krizat e kulmet e saja janë pasojë përmbysjesh të brendëshme dhe duhet të kenë shkaqe objektive”. Rasputini, fshatari nga Pokrovskoje në Uralet e largëta, më mbërthente me forcën e tij hipnotizuese. Momentin kur ai do të hipnotizonte njërin nga më të pasurit e Rusisë, princin Jusupov, që më vonë do bëhej vrasësi i tij, e pata të vështirë ta përshkruaja në romanin “Dritëhijet e një perandorie”, sepse nuk gjeja fjalët e duhura, shprehjet, mënyrën e realizimit. Pikënisja ishte parisieni Sharko, që në gjysmën e dytë të shekullit XIX, për të kuruar pacientë me paraliza tipike histerike, futi në përdorim hipnozën. Ai mbështetej në përvojën e tij se tërë aktet psikike janë para së gjithash produkte të pavetëdijes, pra kjo botë pavetëdije sipas tij ishte në vetvete pasive, e palëvizëshme dhe përfaqësonte një jetë të jetuar e të vdekur, një të kaluar të varrosur dhe rrjedhimisht pa asnjë lloj gjallërie, pa asnjë ndikim në ndjenjat tona. Pra ai, si dhe Mesmeri, Frojdi e të tjerë, donin me forcë pavetëdijen ta detyronin të fliste duke e magjepsur dhe detyruar në mënyrë subkoshjente, sepse sipas tyre, në gjendje gjumi hipnotik mund të nxjerrësh nga njeriu më shumë sesa kur ai është i zgjuar, megjithëse Frojdi më vonë hoqi dorë nga ky mjet i dhunshëm depërtimi në vetëdije, nga ky mjet i pamoralshëm, duke u shprehur se: “pavetëdija nuk është në asnjë mënyrë mbeturinë e shpirtit, por lënda e parë nga e cila vetëm një pjesë fare e vogël arrin deri në sipërfaqe e ndriçuar të vetëdijes”. Kush ishte Frojdi? Një njeri i thjeshtë e më pas një gjigant, që ishte lindur në Fribor (Freiberg) të Moravisë më 6 maj 1856, në një

familje hebreje, që merrej me tregtinë e leshit. Ai u largua nga qyteti i lindjes në moshën 4 vjeçare, pasi prindërit, Jakob dhe Amali Nathansone u transferuan në Vienë. Në vitin 1881, sapo mbushi njëzetepesë vjeç, u diplomua mjek. Nuk donte të bëhej kirurg, kardiolog, okulist, otojatër, obstetër-gjinekolog, por thjesht psikiatër dhe filloi të merrej me anatominë e trurit. Shumë shpejt ngjiti shkallët e karrierës dhe në moshën 29 vjeç u bë pedagog dhe mori titullin docent në lëndën e neuropatologjisë. Në moshë 30 vjeçare fitoi një bursë dhe shkoi në Salpetiere në Paris pranë profesor Sharkos, neurologu më i madh evropian në atë kohë. Aty ai pa ndërhyrjen e dhunshme të hipnozës për të nxjerrë në dritë pavetëdijen. Ai, me të shoqen dhe 6 fëmijët, pas pothuaj 69 vjet banimi në Vienë, qytetin e tij të dytë, Vienën magjike, u largua në vitin 1938 në Londër, për t'i shpëtuar përndjekjes së regjimit të Hitlerit, dhe aty u nda nga jeta në 23 shtator 1939. Do vinte viti 2006 e unë do shkoja në Vienë. U vendosa në rrugën Josefstadt, në “Teatër Hotel”. Ditën e dytë, në rrugën Nr.9 “Berggasse” u ndodha para një ndërtese ku shkruhej: “Sigmund Freud–Museum”. Kalova derën dhe ngjita shkallët. Numëroja: një, dy...dhjetë...tridhjetë...plot 74 shkallare mermeri ngjyrë gri të hapur, e për çudi, në vazhdim dhe 19 të tjera, por tashmë prej druri. Në anën e majtë ndodhej apartamenti i gjenit të psikoanalizës, vendi ku ai kishte banuar nga viti 1899. Aty ndodhej dhoma ku ai bënte konsultime, tavolina e punës, kolltuku ku ulej, e pasi mendohej, shkruante leksionet që do mbante, apo librat që do botonte. Ishte njeriu, që asnjëherë nuk e tradhëtoi kujtesa. Qindra pacientë janë ulur para tij dhe ai me durim e përkushtim, pyeste e dëgjonte përgjigje, krasiste e krahasonte të dhënat për të kapur një detaj ose dhe një fjalë të vetme nga ku do niste betejën, që lindte në trurin e tij dhe i “vërsulej” kundërshtarit me qetësi, dashamirësi dhe kompetencë. Në atë apartament të zakonshëm ndodheshin raftet e shumtë, ku ishin ekspozuar të gjitha veprat e tij, artikujt dhe korespondenca me miq e shokë. U gjënda në dhomën e madhe ku në të katër faqet e murit ishin ekspozuar foto, postera të tij ose me shokë e personalitete. Burrë i pashëm, me tipare të rregullta, me vështrim të përqëndruar, buzë të holla e të shtërnguara, shikim të thellë, dëpërtues, dyshues e këmbëngulës, me mjekërr të bardhë e të prerë bukur. Ja, për këtë dyshim këmbëngulës, kundërshtarët e kanë quajtur Dogmatik. Nuk e dija që ai vuante nga neuroza e pagjumësisë e në moshën dyzet vjeç dhe nga ipotenca, gjë që i shkaktonin vuajtje shpirtërore që mendohej me gjithë forcën të gjente rrugë për të dalur nga vorbullat ku ishte futur. Ishte Frojdi ai që u gjënd përballë njëres prej shfaqjeve më të shpeshta të jetës sonë psikike, që shikohet si absurde, madja si model i absurdes, ËNDRRA, që me të

drejt Cvajgu e quante: “vizitore të përditëshme të gjumit tonë”. Më 4 nëntor 1899 ai botoi librin “Interpretimi i Ëndrrave”, që konsiderohet kryevepra e tij, dhe futi artin e zbulimit, psikoanalizën, duke u nisur nga fakte, ankesa në dukje të parëndësishme nga jeta e përditëshme e pacientëve, për të kapur ndonjë fjalë, shenjë apo ankesë, që dilte padashur nga goja e tyre, e thënë ndryshe, kur ata diçka i tradhëtonte. Frojdi nëpërmjet ëndrrave kërkonte të kaluarën e një njeriu. Figurat simbolike të ëndrrës sipas tij fshihnin në shumicën e rasteve dëshira të ndrydhura ose të paplotësuara, të cilat meqë nuk kanë mundur të realizohen gjatë ditës, përpiqen të hyjnë nëpër shtegun e ëndrrave. Këtë dukuri ai e quante të nevojshme për të stabilizuar ekuilibrin psikik, pra si valvul shpërthimi të ndjenjave tona. Ajo është e pranishme si te të rriturit, ashtu dhe te fëmijët. Si të gjitha produktet komplekse, ka motivet e veta, vargonjtë e veta të shoqërimeve të mëparshme. Ajo është si çdo sjellje e matur, rezultat i një procesi logjik, i një lufte midis tendencave të ndryshme në garë mes tyre, ku në fund fiton njëra. Sipas Frojdit, çdo ëndërr paraqet realizimin e një dëshire të ndrydhur. Thelbi ndryshon në varësi të moshës dhe seksit. Ai e shtyn më tej atë, kur te fëmija paraqet instiktet seksuale, ose disa shenja të tyre. Si mund ta anashkaloja një dukuri të tillë në romanin tim “Zjarret e natës”. Andrea i vogël, akoma pa mbushur katër vjeç, dashurohet sipas mënyrës së tij, me bebisiten Klarita. Xhelozia është dukuria e parë neurotike. Ai nuk dëshiron që Klaritën ta preki njeri. Ai e konsideron të tijën. E shikon në ëndërr, e përfytyron si Sirenë, si një qenie gjysmë njeri (nga mesi e sipër) dhe gjysmë peshk (nga mesi e poshtë). Në ëndërr ai shikon Klaritën Sirenë, që marinarët e sollën në anije dhe e lidhën me litarë. Nga mungesa e ujit, ajo qenie mistike u shndërrua në njeri, në vajzë, në Klaritë të bukur. Ai u xhelozua nga veprimi i marinarëve. Nën efektin e ëndrrës, çohet, shkon te krevati ku flinte Klarita, shtrihet pranë saj e ndjen ngrohtësinë dhe aromën e trupit të vajzës dhe në mënyrë instiktive luan me gjinj të e më në fund kërkon të kapë thumthat që ngriheshin përpjetë. Ajo në fillim refuzon, por më pas thuhet nga këmbëngulja e tij, duke menduar se ai do qetësohej dhe do flinte. Por ç’ndodhi? Në gjumë, ai zbret poshtë, drejt barkut të saj, dhe qëndron në Kodrën e Bukurisë. Janë hormonet estrogene që e çuan atje. Klarita e largoi. Sa para bënte? Ai çdo ditë e më shumë dashurohet, dashuri fëminore, sa një natë, përsëri i zgjuar nga një ëndërr e frikshme për moshën, çohet i trembur dhe kërkon të shkoj te Klarita. Kur afrohet te dera, që është gjysmë e hapur, pa dy persona që lëviznin ritmikisht nën çarçaf. E perceptoi skenën si një akt dhune, sikur dikush po rrihte të dashurën e tij. Shkoi në kuzhinë, mori thikën dhe qëllloi “armikun”. Çërçafi skuqet. Klarita e zhveshur, e rrëmbeu djalin në krahët

e saj dhe e çoi në dhomë. Ai nuk e dinte se kishte qëlluar të atin. Frojdi u ulë këmbëkryq dhe te tregimi “Mësuesja e Pianos”, ku një grua në moshë të avancuar dashurohet marrëzisht me një adoleshent, të cilit i jepte mësimë në piano, ose te novela “Hakmarrja e Penelopës”, ku ndodhin perversitete të tilla seksuale, të cilat vajza Filomenë i percepton në mënyrë dramatike. I tillë ka qenë ndikimi i Frojdit në botëkuptimin shkencor në veprat e studiuesit të mirënjohur shqiptar Spiro Mëhilli.

HEMINGUEJ, SHKRIMTARI I DY LUFTËRAVE

Ernest Heminguej (Cicero, Illinois, 21 korrik 1899), i cili vrau tragjikisht vetën më 02 .07.1961, Ketchum, Idaho, kujtohet nga të gjitha qarqet artistike si një ndër shkrimtarët më në zë amerikanë të shekullit 20 dhe si përfaqësuesi kryesor i Brezit të Humbur. Ai përjetoi thellë tragjedinë e dy luftërave botërore, u gjend disa herë ballë për ballë me vdekjen dhe shkroi një letërsi ku dhunës njerëzore i kundërvihet dashuria, ndërsa kotësisë dhe zhgënjimit të jetës, përpjekja për të qëndruar me çdo çmim dhe me çdo kusht. Heminguej, i lindur në Oak Park Illinois, më 21 korrik të vitit 1899, u rrit në një mjedis mbytës provincial, nën autoritetin e një nëne të rreptë, ndërsa vetëvrasja e të atit la gjurmë të pashlyera në zemrën e tij. Universiteti i parë për Heminguejin u bë Lufta e Parë Botërore. Ai shkoi vullnetar si sanitar në Itali, ku u njoh me tmerret e luftës, por edhe me burrërinë dhe vetëmohimin, që do të mbushin faqet e tregimeve dhe romaneve të tij të mëvonshme. Atë që mundi të shkruante, duke bashkuar llojin e gazetarisë me atë të letërsisë artistike, e mblodhi në vëllimin e parë “Në kohën tonë” dhe në vëllimin e dytë “Burra pa gra”. Por në mbarë botën Heminguej u bë i njohur me romanin “Lamtumirë, armë”, ku trajton një histori dashurie, që përfundon tragjikisht në një botë ku sundon ligji i luftës dhe ku njeriu vret njeriun. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Heminguej udhëtoi dhe mori pjesë në veprime luftarake si korrespondent. Në tregimet e kësaj kohe tingëllon e fuqishme ideja antifashiste kundër luftës. Heminguej u bë i famshëm me botimin e novelës “Plaku dhe deti” për të cilën u nderua me çmimin “Nobel”. Si për të vazhduar traditën familjare, Ernest Heminguej vrau veten, duke pasur frikë nga sëmundja, e cila e mundonte prej kohësh. Ernest Hemingway (sqt. Ernest Heminguej) ishte një shkrimtar amerikan me renome. I përket shkrimtarëve të periudhës klasike të letërsisë amerikane. Ernest Heminguej në profilin e tij shkrimtaresk përfaqëson në mënyrë të shkëlqyer realizmin letrar në ShBA. I konsideruar nga shumëkush si strehë e brezit të humbur, Heminguej vazhdon të mbetet shkrimtari më i shquar amerikan. Proza e tij e gjallë shquhet për nga thjeshtësia mahnitëse, dialogu i thjeshtë plotë jetë. Personazhet kryesore të Heminguejit janë gjithnjë luftëtarë të paepur, me dinjitet krenar, toreador, përballë gjendjes së nderë që po përjetonte padrejtësisht brezi i humbur, brez në kurrizin e të cilit rëndoi më së shumti Lufta e Parë Botërore. Ky shkrimtar kolosal amerikan është lauruar me shpërblime prestigjioze letrare, madje në vitin 1954 ky shkrimtar merr çmimin Pulitzer. Bëri vetëvrasje. Në gjuhën shqipe janë përkthyer një varg romanesh, e vëllimesh me prozë

tregimtare të këtij shkrimtari. Vlen të përmenden shqipërimet kolosale të Ismail Kadaresë, Vedat Kokonës.

Vepra të Heminguejit në shqip

- * Plaku dhe deti
- * Dëborërat e Kilimanxharos
- * Për kë bien këmbanat
- * Të kesh e të mos kesh

”Plaku dhe Deti” (origjinal: *The Old Man and the Sea*) është një nga romanët më të shitur (bestseller) të mbarë letërsisë amerikane, shkruar nga shkrimtari amerikan Ernest Hemingëay. Tek kritikët letrarë ekziston mëdyshja në është roman apo novelë, por sidoqoftë “Plaku dhe deti” është margaritari më i ndritshëm amerikan që pushtoi mbarë botën. Që në fillim nga vetë titulli kemi të bëjmë me dy kundërvënie të ndryshme: plakun në perëndim të jetës se tij dhe detin e paskajë, kjo fuqi e pambarueshme. Personazhi kult Santiago është plazmim i vetë ekzistencës njerëzore kundrejt dallgëve të shkumëzuara të jetës me përplot pusi e pabesi. Santiago përçapet me tërë fuqinë e tij të mplakur dhe për çudi të fatit ai del fitimtar. Kjo vepër është grishje e njëmendtë për rrugën e qarte të racës njerëzore: trazimi i përpjekjes për përvijimin e jetës në kushte sado të rënda. Është një luftë e pabarabartë ndërmjet njeriut dhe natyrës, por që gjithsesi i lejon njeriut të masë forcat e veta. Njeriu plaket ndërsa natyra mbetet po e njëjtë, deti mbetet po i pamasë dhe i pabesë. Në qendër të veprës”Plaku dhe Deti” është plaku Santiago, një peshkatar i zoti. Ka edhe disa personazhë të tjerë, por ato vetëm sa skicohen në vepër sa për sfond. Dy miq-armiq të vjetër luftojnë përballë njeri-tjetrit, luftë që jep edhe mesazhin e lartë filozofik se njeriu nuk është krijuar për të pësuar humbje, të asgjësosh njeriun nuk do të thotë që e ke mposhtur atë. Duke krijuar personazhe të tillë si plaku Santiago, E. Heminguej lartëson figurën e njeriut që tregohet dinjitoz përballë dështimeve dhe sfidave në jetë. Është shkruar nga Heminguej me një stil të drejtpërdrejtë, disi të ngjeshur dhe E. Heminguej ka përdorur parimin “ajsberg” dmth. flet pak por nënkupton shumë. Personazhet parapëlqejnë me shumë heshtjen, mbylljen në vetvete çka e bën edhe me interesante e tronditëse leximin e veprës. Në pamje të parë ata duken të ftohtë, indiferente por në fakt cilësitë e tyre qëndrojnë në nëntekstet e frazës. Vihet re edhe dialogimi me vetveten që përbën një veçori tjetër të personazheve të këtij romani. Edhe nqs. personazhet ndiejnë frikë, gëzim etj. Ato nuk jepen, por nënkuptohen nga situatat e krijuara. Kjo mban gjallë emocionin gjatë leximit të novelës.

SERGEI A. ESENIN (1895-1920): U DËRGOJ PËRULËSISHT TË FALA GJITHË LEXUESVE DHE PAKËZ VËMENDJE PËRPARA TABELËS “JU LUTEM MOS QËLLONI!”

Sergei Aleksandroviç Esenin (3 tetor 1895-28 dhjetor 1925) ishte një poet i famshëm lirik rus. U lind në fshatin Kostandino, (sot Esenin), krahina e Rjazanit, në një familje fshatare ruse. Ende fëmijë filloi të jetonte me gjyshërit e vet. Nisi të shkruajë poezi në moshën 9 vjeçare. Në moshën 17 vjeçare, kur nisi të konsiderohej nga të afërmit e vet si një mrekulli e letërsisë, lëvizi drejt Moskës ku u regjistrua në Universitetin Shtetëror të Moskës si student me korrespondencë. Studimet i braktisi pas një viti e gjysmë. Poezia e tij e hershme frymëzohej nga folklori rus. Në vitin 1915 shkoi në Shën Peterburg ku zuri shoqëri me poetë si Aleksandër Blok, Sergei Gorodetskij, Nikolai Klujev dhe Andrej Beli, duke u bërë i mirënjohur në qarqet letrare të këtij metropoli rus. Ndihmë të jashtëzakonshme në promovimin e karrierës së tij letrare i dha Blok. Esenin thoshte se nga Beli mësoi formën poetike, kurse nga Blok dhe Klujev lirizmin. Në vitin 1915 Esenin botoi librin e tij të parë poetik “Radunica” dhe një vit më vonë “Rituali i vdekjes”. Përmes poezisë së tij të mprehtë rreth dashurisë dhe jetës së thjeshtë, shumë shpejt Esenin u bë poeti i ditës. I bekuar nga Zoti, me fytyrë të bukur dhe personalitet romantik, ai ra në dashuri shumë herë dhe bëri 5 martesë të njëpasnjëshme. Martesa e tij e parë u bë me 1915 me një bashkëpunëtoreshë të tij në shtëpinë botuese ku punonte. Ajo quhej Ana Izdrjadnova me të cilën bëri një djalë, Jurin, i cili gjatë terrorit stalinist u arrestua dhe vdiq në një gulag (kamp përqendrimi dhe punë të detyruar) sovjetik në vitin 1937. Në gusht të 1917 Esenin realizoi martesën e tij të dytë me aktoren Zinaida Raik me të cilën pati dy fëmijë, vajzën Tatiana dhe djalin Konstandin, i cili shumë vit më vonë u bë një matematicien dhe statistikien i famshëm në SHBA...

Sipas Anatoly Mariengof:

Nëse Sergei vendosi të na braktiste, ai me siguri do ketë pasur dyshime mbi forcën e tij krijuese. Nuk mund të kish arsye tjetër për vdekjen e tij, sikundër ai nuk kish kurrëfarë qëllimi tjetër në jetë përveç ruajtjes së vargjeve.

Pak para vdekjes...

Në vjeshtën e vitit 1921, ndërsa po vizitonte studion e piktorit Aleksej Jakovlev, ai njohu balerinën e famshme amerikane me banim në Paris, Isadora Dankan (Isadora Duncan), një grua e jashtëzakonshme rreth 17 vjet më e madhe se ai, e cila nuk dinte asnjë fjalë rusisht, ndërkohë që Esenin nuk dinte asnjë gjuhë të huaj. Ata u martuan në 2 Maj 1922 dhe vendosën ta bëjnë muajin e tyre të mjaltit në një turne nëpër Europë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, në këtë periudhë të jetës, varësia e Esenin nga alkooli, kish dalë jashtë çdo kontrolli. Gjate dehjeve apo edhe drogimeve të tij, Esenin fitoi maninë e shkatërrimit të dhomave të hoteleve ku flinte dhe te restoranteve ku hante, duke u vënë në shënjestër të botës së gazetave në mbarë botën. Kështu, martesë me balerinën Dankan zgjati për një kohë të shkurtër, dhe në maj të 1923, Esenin u rikthye në Moskë. Pak kohë më pas ai njohu aktoren Augustina Miklashevskaja dhe u martua me të në një ceremoni të thjeshtë civile, megjithëse është i njohur botërisht fakti që ai nuk arriti të marrë kurrë divorcin nga Isadora Dankan. Një tjetër e dashur e poetit në këtë periudhë ka qenë Galina Belislavskaja, e cila i dha fund jetës së saj mbi varrin e Eseninit një vit pas vdekjes së tij. Ndërsa jeta dhe skandalet e Eseninit sa vijnë e rëndohen ai bën edhe një fëmijë ilegal, djalë, me poetin Nadjezhda Volpin. Esenin nuk ia dha kurrë atësinë atij fëmijë.

Dy vjetët e fundit të jetës së Esenin janë të mbushur me çrregullime të personalitetit dhe dehje e drogime të vazhdueshme, por pikërisht në këtë periudhë ai krijoi poezitë më të famshme të tij. Në pranverë të 1925 Esenin njuh dhe martohet me gruan e tij të pestë, Sofia Tolstaja, gjyshi i së cilës ishte gjigandi i letërsisë ruse dhe botërore, Leon Tolstoi.

Ajo u përpoq që t' i rrinte afër dhe ta ndihmonte poetin brilant, por tashmë ishte tepër vonë pasi Esenin vuante nga sindroma të rënda manjako-depresive, duke u shtruar për kurim një mujor në një klinike psikiatrike. Ndërsa del nga klinika vetëm për disa ditë me rastin e Krishtlindjeve, ai pret damarët dhe me gjakun e tij shkruan poezinë e Lamtumirës dhe të nesërmen në mengjes gjendet i vetëvarur në tubat e ngrohjes në tavanin e dhomës së tij në Hotel Angleterre, kur sapo kish mbushur 30 vjeç. (Ka të dhëna që ajo ka qenë vrasje e organizuar nga agjentët e GPU (KGB e ardhshmë) dhe u kamuflua si vetëvarje e Eseninit.) Edhe pse një nga poetët më të mëdhenjë të Rusisë, shumica e poezive të tij u ndaluan gjatë regjimit të Stalinit dhe Hrushovit. Vetëm pas vitit 1966, poezitë e tij u rifuten në qarkullim në BS. Sot Sergei Esenin lexohet akoma nga miliona njerëz në tërë botën dhe shumë nga poezitë e tij janë kthyer në këngë popullore ruse. Vdekja e tij e

parakohëshme, antipatia që kishte ndaj tij e ashtuquajtura elitë, adhurimi nga njerëzit e zakonshëm dhe sidomos sjellja e tij sensacionale deri tej limiteve, e kthyen popullaritetin e tij artistik dhe vetë Eseninin në një figurë popullore mitike. Esenin prehet në Varrezën Vagankovskoje të Moskës. Varri i tij zbukurohet nga një skulpturë e bardhë mermeri e poetit më ekstravagant që ka njohur Rusia. ... Hartuesit e këtyre parathënieve e pasthënieve, duke qenë kritik zyrtarë, në këtë rast e kanë ndjerë veten ngushtë. Po të mos e megjullonin kësajsoj këtë periudhë të jetës së Eseninit, atyre do t'u duhej të thelloheshin edhe në shkaqet pse ai u katandis të gëdhihej tavernave me "banditë" e prostituta

Shkakun e kësaj ,ai na e zbulon vet:

Në vendin tim po ndihem krejt i huaj, ose më tej:

“Ç”të bësh Atdhe

këtu arriti puna

kujtoja se me ty jam shkrirë përgjithnjë

po sot s'u dashka arti im, as unë

Me ç'po shikoj ,tani s'u dashkam më

Këto nuk janë vargje por ulërime!

Sa keq, që nganjëherë popujt hutohen pas demagogjisë së tiraneve dhe jo vetëm nuk i përfillin bijtë e tyre më të mirë, veçanërisht poetët, por ua bëjnë jetën skëterrë. Kurse pastaj? Pastaj vdis, pa të dua, të të ngre monumente, të të sjell me ceremoni dhe kockat, po t'i kesh lënë diku syrgjyn. E megjithatë poetët kanë shpirt të gjerë. Vuajnë, po kurrë nuk e thonë fjalën e rëndë!, përkundrazi: “të më vishni këmishë Ruse të më vini të vdes nën ikonë”

Vrau veten apo e vranë?

Deri më sot është besuar versioni zyrtar: Sergej Esenini ka varur veten me 28 Dhjetor 1928, në një dhomë të hotelit “Ingliterra” në Leningrad (Sant -Peterburg). Kohët e fundit, ky version është vënë në dyshim. Sipas shumë Eseninologëve, sapo ka zbritur në qytetin e Pjetrit, poeti është arrestuar, e më pas, masakruar prej çekistëve. Pastaj kufoma e tij është vendosur, në njërën nga dhomat e hotelit “Ingliterra”, që kontrollohej prej policisë sekrete. Me anën e një kalimi të fshehtë, ky hotel lidhej me godinën për bri, ku ndodhej dhe njëri nga seksionet e kësaj policie. Dihej prej shumë kujt se dhoma nr.5, ku u vendos kufoma, përdorej prej çekistëve si dhomë përpunimi. Në akt-ekspertizën thuhet se viktima për t'u varur, përdori tubat e vaskës, kur në një kohë ajo dhomë s'kishte fare vaskë.

Përveç asaj, viktimën nuk e ka parë kush të varur, por të shtrirë dhe me gjurma goditjesh të forta në fytyrë. Sipas rregullit ekspertiza duhej të shoqërohej me disa fotografi të viktimës së varur gjithashtu të gjithë dëshmitë mbi ditët dhe orët e fundit të poetit janë lëshuar prej punonjësve të policisë sekrete, përfshi dhe Erlahun, të cilit gjoja ai i ka dhënë poezinë e fundit, shkruar me gjak. Thuhet se ajo poezi është shkruar të paktën një vit para tragjedisë dhe se dorëshkrimi është vjedhur në shtëpinë e poetit. Unë pashë fotografitë e kufomës, maskën e ekspertizës, ku dukeshin qartë, dy kratere nga ana e syrit të djathtë, si dhe akt-vdekjen e përpiluar prej mjekut. Lexova dhe dëshmi të tjera. Pashë gjithashtu dhe akte zyrtare edhe presionet e vazhdueshme psikologjike për ta thyer dhe tjetërsuar. Ka shumë të ngjarë, që versioni zyrtar i vetëvrasjes së Sergej Esenin, të jetë i sajuar dhe që, poeti të ketë dhënë shpirt në duart xhelate të çekistëve, të cilët popullariteti i tij, me sa duket i ka penguar ta likujdojnë publikisht, siç bënë me pas me të gjithë miqtë e vet, që përfunduan në pushkatim, përfshi dhe të birin Georgin. Kjo nuk të çudit. Arti i madh e çliron njeriun, e bënë të ndërgjegjshëm për personalitetin e vet, kurse diktaturat synojnë të kundërtën dhe mjer kush i pengon në arritjen e këtij synimi. Sergej Esenin-in e vranë me dorën e vet, apo të tjetër kujt, kjo pak rëndësi ka. Por, nuk arritën të vrisnin poezinë e tij, përkundrazi, ajo u bë pjesë e jetës shpirtërore e miliona njerëzve në Rusi dhe në mbarë botën. Në vendin tonë, Esenini u bë i njohur përpara 35 vjetësh, me një përmbledhje lirikash, sjell në shqip nga një grup poetësh të rinjë, ndër të cilit bëja pjesë dhe unë. Megjithëse përkthimi linte shumë për të dëshiruar, sepse ne sapo e kishim nisur rrugën e artit, ajo përmbledhje u prit nga lexuesit, madje dhe në një farë mënyre dhe ndikoi në krijimtarinë e disa poetëve ...

“Ah, mëmëdhe, t’u bëra qesharak!
Një e skuqur më shkon faqeve dhe druaj
t’i flas ndokuj, se s’më kupton aspak
Në vendin tim, po ndihem krejt i huaj”

LETËR NËNËS

Gjallë je, nënoke?
Edhe unë gjallë jam!
Shëndet më paç, shëndet!
dritë e bëftë krejt kjo mbrëmje e lum
Izbën tënde, që me mall më pret

Thonë se je ligur e je tretur
Nga merakun im, por nuk ankon
Se, pështjell me një shall të vjetër
fillikat rrugës shpesh kalon
Dhe kur mugëtirë e kaltër bie
një vegim i zi të kall ty frikën
Sikur në sherr diku në pije
Vjen dikush e ma këput me thikë
Kot e dashur, vuan kaq, besomë
Brenga t'i fanit këto nder sy
S'jam aq pijanec i lig sa thonë
Si do vdes pa të të parë ty?
Unë jam po foshnjeë, si njëherë
Dhe një shpresë veç ushqej në gji
T'iki nga ky tym e kjo poterë
te shtëpiza jonë aty të vij
Dhe do vij, kur kopshti ynë i bardhë
Anekënd të vishet me blerim
Vetëm ti, si tetë vjet më parë
Mos më zgjo aq herët në agim.

TI S'MË DO?

S'të dhimbsen sado pakëz?
Ti s'më do? s'të dhimbsem sado pakëz?
Nuk ta mbushkam syrin apo si?
prapëseprapë ti ndizesh e merr flakë
tek shtrëngohesh supeve të mi
Mike, epsh e tëra, lajka s'dua
As i vrazhdët nuk të sillem dot
Veç më thuaj: sa kështu si mua
puthur e shtrënguar ke gjer sot?
Unë e di, të gjithë hije u bënë
Dhe s'ta shuan zjarrin pa mbarim
Prehër pa ulur ti s'ke lënë
Si po rri tani në prehërin tim
Nëse këto çaste ndonjë tjetër

Sjell ndërmend ti, syekat kur pulit
Mos pande se po mërzhitem tepër
Tjetër kend dhe unë kam në shpirt
S'është fat kjo lidhje mendjelehtë
po një flake çasti veç, ta dish
Si të njoha rastësisht i qetë
“Mirëmbetësh ”do të them sërish
Edhe ti do marrësh udhën tënde
Do bësh pluhur ditët plot merzi
Veçse mos lakmo t'i marrësh mendjen
Kujt s'ka njohur puthje e dashuri
krahë për krah me ndonjë tjetër djalë
Udhës kur të shkosh ti, ku ta dish?
Mbase dhe unë do kem dalë
Për shëtitje, e shihemi sërish
Ti më fort pas tjetrit do të ngjitesh
Dhe me kryet ulur ftotësishtë
“Mirëmbërëma ” do më përshpëritësh
Kurse unë “mirëmbërëma, Miss”
Dhe asgjë nuk do më trubullojë
S'do më dridhet shpirti për asgjë
Kush ka dashur s'mund të dashurojë
Kush u dogj një herë, s'digjet më...

SA E MIRË QE TANUSHA

Sa e mirë qe Tanjusha
Më të bukur s'kish në fshat
Sarafani me tantella
Ç'hijeshi i kish në shtat
Të përroi para gardhit
Zbriti vajza plot hare
Përtej mjegullës së bardhë
Hëna luante me re
Doli djali, uli kokën kaçurrele para saj
“Lamtumirë”me një tjetër
I tha:Fatin do ta ndaj

U zbeh vajza si qefini
Porsi vesa, erdh'u gri
Si nëpërkë i'u nder gërsheti
Zemra ju helmua në gji
“Oh, po ndaj dhe unë erdha
Ftohtas ju përgjegj ajo
“Të të them se do martohem
Me një tjetër që më do”
Në mengjes gjëmoi kisha
Çifti s'dihej cili që
Kurse tutje s'qanin gjelat
Pragu i Tanjës që në vaj
Një sopatë e zezë tëmbilin
Plagë, i'a kish bërë asaj
Pika gjaku kish kurorë
Balli vajzës i pa fat
Sa e mirë që Tanusha
Më të bukur s'kish në fshat

ERË,ERË E DËBORËS, MOJ ERË

Erë, erë e dëborës, moj erë
Merrmi vitet në krahët e tu
Dua djalkë të jem dhe një herë
Apo lule e luginës diku,
Nën një fyell bariu plot dhimbje
Dua sytë t'i mbyll në harrim
Zile yjesh, me borën e mbrëmjes
të më bien në vesh pa pushim
Oh! sa bukur e dredh ajo këngën
Në tufan dëshpërimi kur derdh
Do të desha diku me një këmbë
ndanë rrugës të rrija, si bredh
Hingëllima në terr kur të ndjeja
të pushtoja kaçuben përbri...
Zgjati putrat, o hënëz, drejt meje
Merrmi brengat në qiell tek ti

MBRËMJA VETULLAT NGRYSI

Mbrëmja vetullat ngrysi. Se ç'kuaj
hingëllinjë n'oborr, nuk e di
Dje na humbi rinia, më thuaj
Dje u puthëm së fundi të dy?
Trojkë e vonë, ç'gërhet? Më ngadalë!
jeta jonë as la gjurmë gjëkund
Ndoshta nesër, në shtrat të spitalit
Do të prehem në paqen e pafund
Apo ndoshta papritur do ndihem
I shëruar e plot gjallëri
Dhe do rri të mbaj vesh, gjer të shkrihem
Shushurimën e qershive në shi
Do harroj ç'plagë zemre më brejtën
Këta vite të turbullt stuhishë
O fytyrëz, e dashur, e shtrenjtë
Ndër kujtime, veç ti do më ndrish
Mund që nesër të dua një tjetër
Po, ta dish dhe asaj, orë e çast
Veç për ty për mikeshën e vjetër
I përmallur gjithnjë do t'i flas
Do t'i flas për të bukurën kohë
Kur ne shkriheshim n'ëndërra blu...
Koka ime e krisur moj kokë...
Ku t'u shkrep të më shpijësh kështu?

SI T'IA THEM?

Si t'ia bëj, e pyeta sarafin
Në mengjes, kur theva ca para
Si t'i them me ëmbëlsi "të dua"
Në Persishte të bukurës Lejla?
Përsëri e pyeta sarafin
lehtë e lehtë, porsi flad pastaj
Po të perëndishmen fjalë "puthje"
Në Persishte, si t'ja shqiptoj asaj?

Si t'ia bëj, e pyeta së fundi
Edhe zemra gati sa s'më la
Si t'i them "je e imja, vetëm e imja"
Në Persishte të bukurës Lejla?
Ç'mu përgjegj sarafi shkurt e prerë
Dashurinë fjalët s'e tregojnë
dashurinë e thonë vetëm dridhjet
Sytë si rubin kur vezullojnë
Sa për puthjen, as ajo s'do fjalë
Puthja s'është një mbishkrim mbi varr
Puthja lëshon erë trëndafili
Petalet tek i shkrinë te buzët zjarr
Dashuria s'dihet se ç'të sjell
Gaz a helm, duro e mos u ndjej
"Imja je "këtë e thonë duart
ferexhenë kur e flakin tej

SHKRETËTIRË E BORË

Shkretëtirë e borë. Hëna farfurin
Vendi anembanë, dërgjur në qefin
Dhe mështeknat qajnë, pyjeve pa jetë
Kush kështu ka vdekur?
Mos vallë unë vetë?

NJË DËFRIM VEÇ TANI MË KA MBETUR

Një dëfrim veç tani më ka mbetur
Gishtat gojës e fortë fishkëlli
Kudo thonë mbi mua s'ka tjetër
Skandaloz e rrugaç në Rusi
Humbje e madhe ky nam
Por s'mërzitem
Jeta humbje ka plot kësisoj
turp që zotin besova kaq vite
Po mjerim, që tani s'e besoj

Kohë o kohëz e largët e artë!
Llava e jetës, gjithçka e bënë shkrumb
Unë veç për t'u djegur më qartë
Pas skandaleve rënda gjithkund!

Sergej Esenini,për veten...

Jam një bir fshatari. Kam lindur më 21 shtator 1895 në lokalitetin e Kuzminit të qarkut të Rjazanit,po në gubernën e Rjazanit. Qysh në moshën dy vjeç,meqë babai ishte i varfër dhe kishte shumë frymë në familje,mëdërguante gjyshinganaëna,i cili ishte mjaft në gjendje dhe kishte tredjem të rritur beqarë,me të cilët kalova gjithë fëmijërinë. Dajët e mi ishin djem çapkënë dhe kokëkrisur. Kur u bëra tre vjeç e gjysëm,më hipën në një kalë pa shalë dhe më lëshuan revan. Mbjaj mend që u tremba shumë dhe u kapa fort pas jeles së kalit. Pastaj më mësuan të bëja not. Njëri nga dajët (dajë Sasha),më merrte në barkë,më zhvishte e më hidhte si këlysh në ujë. Unë përplasja krahët si i çoroditur e i tromaksur dhe,kur mua gati më mbahej fryma,ai bërtiste:„Eh kuçkë! S’je për asgjë! Fjalën kuçkë ai e kishte përkëdhelje. Më vonë në moshën tetë vjeç,një dajë tjetër unë i zëvendësoja shpeshherë qenin e gjahut,duke notuar nëpër gjole për të kapur rosat e egra. Isha mësuar për bukuri të ngjitesha nëpër pemë. Për këtë ua kaloja të gjithëve. Kur mëllenjat nëpër mështekna nuk e linin ndokënd të flinte,unë ngjitesha shpejt dhe merrja çerdhet. Një herë rashë,po nuk pësova ndonjë gjë të madhe,u gërvisha pak në fytyrë e në bark,po theva një shtamë me qumësht që do t’ia çoja gjyshit që po kosiste. Midis fëmijëve isha gjithnjë i parë dhe sherrxhi i madh,dhe kthehesha në shtëpi përherë i gërvishur. Për këto prapësira më bërtiste vetëm gjyshja,kurse gjyshi më nxiste nganjëherë edhe vetë për sherr dhe i thoshte gjyshes:„Mos e nga moj budallaqë. Ashtu do të bëhet më i fortë”. Gjyshja më donte me gjithë shpirt dhe dashuria e saj nuk njihte kufi. Të shtunave më lanin,më prisnin thonjtë e më lyenin kokën me vaj,se flokët e dredhur mezi më kriheshin. Po edhe vaji s’më bënte shumë dobi. Përherë bërtisja e madje edhe tani sikur s’para i pres me kënaqësi të shtunat. Të djelave më dërgonin gjithnjë në kishë dhe që të siguroheshin se veja vërtet,më jepnin 4 kopejka. Dy kopejka për naforë dhe dy për t’i hedhur te kondizma e Shenjtorit,po unë paguaja vetëm për naforën,kurse te shenjtori bëja sikur hidhja,po s’hidhja gjë dhe ia mbathja në varrezë e luaja me kalamjtë. Kështu më kaloi fëmijëria. Kur u rrita,donin të më bënin mësues fshati,ndaj më

shpunë në një eminar fetar,pas mbarimit të të cilit duhej të shkoja në Institutin Pedagogjik të Moskës. Për fat të mirë,nuk ndodhi kështu. Metodika dhe didaktika më kishin ardhur në majë të hundës dhe as doja të dëgjoja më për to. Vjersha kam filluar të shkruaj herët,nëntë vjeç,por,me ndërgjegje të plotë,krijimtarisë i hyra kur u bëra 16-17 vjeç. Dhe vjersha të kësaj moshe i kam botuar në librin tim të parë “Përshpirtja”.

Kur u bëra tetëmbëdhjetë vjeç,habitesha pse gazetat nuk m’i botonin krijimet që u dërgoja dhe befasi ia mbatha në Petërburg. Atje nuk më pritën keq. I pari që njoha ishte Blloku,i dyti,Gorodeckij. Kur takova Bllokun,më rrodhën djersët çurg,sepse për herë të parë po shikoja një poet të gjallë. Gorodeckij më njohu me Klujevin,që s’ia kisha dëgjuar ndonjëherë emrin. Me Klujevin u bëmë miq të ngushtë,miqësi që e vazhdojmë edhe sot,pavarësisht se kemi gjashtë vjetrapautuar. Tani ai jeton në Viterg,më shkruan se ha bukë me krunde e se ka mbetur për faqe të zezë dhe se i lutet Zotit që të mos vdesë me turp.

Viteve të luftës dhe revolucionit,fati më përplasi sa andej këndeje. I rashë Ruisë kryq e tërthor nga Oqeani i Ngrirë i veriut,e deri në detin e Zi dhe atë Kaspik,nga Perëndimi në Kinë,Persi dhe Indi. Kohën më të mirë të jetës sime quaj vitin 1919. Atëherë kaluam një dimër me 5 gradë temperaturë brenda në dhomë. S’kishim asnjë shkop dru. Në PKR nuk hyra asnjëherë,sepse e quaj veten shumë më të majtë.

Shkrimtari im më i dashur është Gogoli.

Kam botuar shtatë libra. Tani po punoj mbi diçka të madhe,të titulluar „Vendi i horrave”.

Në Rusi,kur s’kishte letër,me Kusikovin dhe Mariengofin i shkruanim vjershat në muret e manastirit të Përkushtimit,ose i recitonim ku të mundnim nëpër bulevard. Amatorët më të mirë të poezive tona ishin prostitutat dhe banditët. Me ta ishim miq përherë. Komunistët na urrejnë tmerrësisht.

U dërgoj përlësisht të fala gjithë lexuesve dhe pakëz vëmendje përpara tabelës „Lutem mos qëlloni!”

Vjersha kam filluar të shkruaj herët,nëntë vjeç,por,me ndërgjegje të

plotë,krijimtarisë i hyra kur u bëra 16-17 vjeç. Dhe vjersha të kësaj moshe i kam botuar në librin tim të parë “Përshpirtja“.Kur u bëra tetëmbëdhjetë vjeç,habitesha pse gazetat nuk m’i botonin krijimet që u dërgoja dhe befasi ia mbatha në Petërburg. Atje nuk më pritën keq. I pari që njoha ishte Blloku,i dyti,Gorodeckij. Kur takova Bllokun,më rrodhën djersët çurg,sepse për herë të parë po shikoja një poet të gjallë. Gorodeckij më njohu me Klujevin,që s’ia kisha dëgjuar ndonjëherë emrin. Me Klujevin u bëmë miq të ngushtë,miqësi që e vazhdojmë edhe sot,pavarësisht se kemi gjashtë vjet pa u takuar.Tani ai jeton në Viterg,më shkruan se ha bukë me krunde e se ka mbetur për faqe të zezë dhe se i lutet Zotit që të mos vdesë me turp.Viteve të luftës dhe revolucionit,fati më përplasi sa andej këndeje. I rashë Rusisë kryq e tërthor nga Oqeani i Ngrirë i veriut,e deri në detin e Zi dhe atë Kaspik,nga Perëndimi në Kinë,Persi dhe Indi. Kohën më të mirë të jetës sime quaj vitin 1919. Atëherë kaluam një dimër me 5 gradë temperaturë brenda në dhomë. S’kishim asnjë shkop dru.Në PKR nuk hyra asnjëherë,sepse e quaj veten shumë më të majtë.Shkrimtari im më i dashur është Gogoli.Kam botuar shtatë libra. Tani po punoj mbi diçka të madhe,të titulluar „Vendi i horrave“.Në Rusi,kur s’kishte letër,me Kusikovin dhe Mariengofin i shkruanim vjershat në muret e manastirit të Përkushtimit,ose i recitonim ku të mundnim nëpër bulevard. Amatorët më të mirë të poezive tona ishin prostitutat dhe banditët. Me ta ishim miq përherë. Komunistët na urrejnë tmerrësisht.U dërgoj përulësisht të fala gjithë lexuesve dhe pakëz vëmendje përpara tabelës „Lutem mos qëlloni.Berlin,14 maj 1922.

NË VEND TË PËRKUJTIMIT... ALBERT KAMY (1913-1960)

Alber Kamy u afirmua qysh në veprat e para si një nga shkrimtarët më të fuqishëm të shek XX. Në veprat e tij ndërthuret arti i hijshëm me mendimin e thellë, teknikat e sofistikuar të tekstit me çështjet themelore të qenies. Për të kuptuar Kamynë, duhet kaluar nëpër letërsitë greke e romake, nëpër historitë e freve e të filozofisë, duke mbërritur te shkrimtarët e mendimtarët klasikë e modernë... Veç kësaj, rrethanat e posaçme të jetës e formuan Kamynë me një ndjeshmëri nga më të volitshmet për artin. Lindur në Algjeri nga baba franceze e nëna spanjolle, te Kamyja u poqën në një harmoni fatlume, fantazia arabe, intelekti latin dhe eleganca hispanike. Për të gjitha këto, vepra e tij përbën një dukuri origjinale dhe me një vlerë të spikatur të letërsisë moderne...

Jeta

U lind me 7 nëntor 1913. Në saje të presionit të babait, i ndjek rregullisht studimet deri në universitet, ku diplomohet për filozofi. Në vitet tridhjetë ai kalon sprova të shumta në jetë dhe piqet nëpër përvoja gjithfaresh: shkruan tekste të vogla meditative me theks biografik, shtrohet në spital për tubërkuloz, por i shpëton vdejes, por jo kurimeve të vazhdueshme... Harton romanin e rinisë “Vdekja e lumtur”, të cilin nuk pranon ta botojë për së gjalli. Viti 1937 shënon çast vendimtar në jetën intelektuale të Kamysë... Boton librin “E mbrapshta dhe e mbara” me ese të rinisë. Në vitin 1939 boton një tjetër libër me ese “Dasëm”. Më pas punon në gazetatat seriose të Algjerit dhe shkrimet e tij i boton në një përmbledhje “Aktualet”. Bëhet i njohur me 1942 me botimin e esesë filozofike “Miti i Sizifit”, sfidë krenare e njeriut ndaj universit të dhunës e të pakuptimtë, që Kamyja e emërton me emrin “absurd”. Po atë vit boton romanin “I Huaji”, pasqyrë e brishtësisë së njeriut dhe e vuajtjes prej absurdit.

Krijimtaria e Kamysë pasurohet dhe me dy drama. “Kalikula”, me 1944, përshkrim poetik i çmendurisë njerëzore të mishëruar në figurën e perandorit romak, Kalikula. Drama tjetër është “të drejtët” himn i sakrificës për liri. Vepër tjetër është eseja “Mendime për gijotinën”, ku dënon mos-heqjen e denimit me vdekje. Botim tjetër është romani “Murtaja”, që mbahet si një nga romanet më të mira të shek XX, ku i bëhet një sintezë qëndresës njerëzore ndaj të gjitha

formave të tiranisë. Botimi i esesë “Njeriu i revoltuar” me 1951, drejtuar kundër mendimit diktatorial e veçanërisht kundër terrorit stalinist, i shkaktonte Kamysë sulmin e ashpër të intelektualëve të majtë francez, me në krye Sartrin dhe një lloj izolimi, të cilin ai e vuajti thellë. Në këto vite dëshprimi e vetmie ai shkroi veprën e tij më pesimiste e të zymtë “Rënia”, aktualizim i parabolës biblike mbi gjendjen e njeriut si mëkatar dhe i pandreqshëm. Me 1957 suksesi letrar i Kamysë vlerësohet me çmimin Nobel.

Kamy e gjen vdekjen nga një aksident automobilistik me 4 janar 1960.

Dorëshkrimi i papërfunduar i Kamysë është romani “Njeriu i parë”, që e botuan më pas të paplotë më 1994. Kushdo që ka lexuar një vepër çfarëdo të Kamysë, kupton se ky është një autor i një lloji të veçantë.

Alber Kamy: aksident apo u vra nga sovjetikët?

Pas aksidentit me makinë që, për shkak të një defekti, i kushtoi jetën shkrimtarit fitues të çmimit Nobel për letërsinë, mendohet se fshihet dora e shërbimit sekret sovjetik. E rrëfen ditari i një shkrimtari disident çekoslovak Mëngjesin e së hënës, të 4 janarit 1960, Alber Kamy u largua disi vonë nga Hoteli “Chapon Fin” i qytezës franceze Tuasej. Një ditë më parë kishte lënë Lurmarinin dhe ishte drejtuar për në Paris. Udhëtonte me makinën e botuesit të tij, Mishel Galimard, që ishte në timon. Mbrëmjen e kaluar kishin qëndruar deri vonë në restorantin e hotelit me dy yje, që stoliste rrugën Mishelin. Kamy ishte ulur pranë Galimardit, ndërsa bashkëshortja e këtij të fundit, Zhanina, ishte rehatuar në sedilën e prapme pranë vajzës së saj dhe qenit të racës “terrier”. Papritmas në lartësinë e Peti-Vijeblevin, makina doli nga rruga dhe u përplas pas një rrapi, krah vijes ndarëse të rrugës. Kamy vdiq në vend: Një fund absurd për atë që absurdin e ekzistencës njerëzore e kishte përballur pa frikë si në jetë ashtu edhe në faqet e librave. Kështu ikte nga kjo botë, në moshën 46 vjeçare, autori i romaneve “I huaji” dhe “Murtaja”, i librave filozofike “Miti i Sizifit” dhe “Rënia”: Pas Rudjard Kiplingut, ai ishte shkrimtari më i ri i nderuar me çmimin Nobel në letërsi, vetëm tre vjet me parë në Stokholm. Mes atyre llamarinave të shtrembëruara, me kafkën të thyer dhe qafen e këputur, përfundonte mundin e tij prej Sizifi ekzistencialisti me fytyrë njerëzore, anti Zhan-Pol Sartri, “humanisti” libertin i cili, pas një aderimi të shkurtër në rininë e tij, doli kundër komunizmit pa hequr kurrë dorë nga impenjimi radikal letrar dhe civil përkrah të shtypurve, duke filluar që nga arabët e Algjerisë, ku edhe u lind në Mondovi, në vitin 1913. Pakujdesi, fat i keq apo tërsllek? Mbi shkaqet e daljes nga rruga të makinës, që rezultoi fatale për Kamynë, dhe njëkohësisht për vetë Galimardin, kanë

lulëzuar që nga fillimi shumë hamendje: “Aksidenti dukej se ndodhi për shkak të bllokimit të një rrote ose thyerjes së një aksi, por edhe ekspertët nuk dinin si ta shpjegonin atë aksident katastrofik mbi një rrap, me një rrugë të gjerë 9 metra dhe pa trafik”, ka shkruar biografi, Herbert R. Lotman në librin monumental të tij, “Kamy” (1984). Por, një dokument i panjohur deri më sot, që publikohet për herë të parë, hedh një rreze drite të habitshme dhe njëherësh tragjikisht të arsyeshme, në gjendje të fshijë nga vdekja e Kamysë atë mbiemër, “absurd”, që gjithmonë e ka shoqëruar. Aksidenti mendohet të jetë përgatitur nga KGB-ja sovjetike, me urdhër direkt të ministrit të brendshëm rus të asaj kohe, Dimitri Trofimovic Shepilov, të cilin Kamyja e kishte sulmuar fort dhe drejtperdrejtë për pushtimin e Hungarisë, në një artikull të gazetës “Franc tireur” në mars 1957. Ai që e mbështet këtë është një personazh aspak ekuivok dhe i padyshimtë për mitomani: Poeti dhe përkthyesi çek, Jan Zabrana, në një faqe të ditarit të tij “Cely Zivot” (E gjithë jeta), i publikuar pas vdekjes në vitin 2004 nga Shtëpia Botuese Torst e Pragës. I ndarë nga jeta në vitin 1984, Zabrana, falë të cilit u përkthye në çekisht edhe romani “Doktor Zhivago” i Boris Pasternakut, ishte bir socialistësh që kishin provuar burgjet pas vitit 1948 dhe u përdoqën gjatë nga regjimi komunist, i cili ndaloi dhe botimin e poezive të tij. U detyrua të merrej me përkthime, mbi të gjitha nga rusishtja, kështu që njihte mjaft mirë ambientin politiko-kulturor të atij “burri që di shumë gjera, dhe ka burime nga mund t’i marrë”, që citon, pa e përmendur në emër (duke iu referuar një burimi të saktë në kontakt me shërbimet sekrete sovjetike), në ditarin e publikuar rregullisht në edicionin në gjuhën çeke, origjinali i të cilit ruhet nga bashkëshortja Maria Zabranova, i kataloguar si “Fletorja blu numër 91”. Ai që e ka zbuluar është një shkrimtar italian, i cili “jeton në Pragë nga larg”, siç ka nënvizuar Antonio Tabuki, teksa ua prezantonte lexuesve të “Pais”, por sapo mundet vrapon për në qytetin e Rudolfit II dhe Franc Kafkës, te Arcimboldit dhe Golemit, sikur ta kishte një atdhe të shpirtit. Bëhet fjalë për kremonezin Xhovani Kateli, autor i dy përmbledhjeve në prozë të shkurtër (Gjeografi dhe Largësi), ndërsa është duke publikuar edhe librin e parë me poezi, “Trena”. “E frekuentoj Pragën prej më shumë se 20 vjetësh”, tregon Kateli, “dhe e njoh mirë Maria Zbranovan, e cila ka mbikëqyrur versionin çek të librit “Gjeografi”. Kur, ndërsa lexoja ditarin e burrit të saj, u gjenda përballë lajmit që lidhej me vdekjen e Kamysë, pata një lloj shoku: Hidhte një dritë të re mbi fundin e një autori shumë të rëndësishëm për formimin tim dhe të kushedi sa të tjerëve. E mora si detyrë për t’ia bërë të njohur të gjithëve”. Në fakt, ditari “Cely Zivot”, një vëllim i rëndë prej 1.000 faqesh, nga i cili qe publikuar tre vjet më parë në Francë një pjesë, nën kujdesjen e Patrik Ourednik në bashkëpunim me shtëpinë e vogël botuese

“Allia”. Por, bëhej fjalë për një antologji rreth 150 faqesh, ku pjesa për vdekjen e Kamysë ishte lënë jashtë. “Në gjendjen aktuale”, nënvizon Kateli, “mbetet fakti se në rreshtat akuzues të ditarit të Zabranas, kaq përvëlues në ftohtësinë e objektivitetit të tyre, nuk është reflektuar aq sa duhet”. Dhe shton një tjetër motiv, veç polemikës mbi faktet e Hungarisë, që mund ta ketë shtyrë Shepilovin për të armatosur krahun operativ të KGB-së kundër një shkrimtari të fortë vetëm në pacifizmin e rrënjosur thellë tek ai dhe në humanizmin e pamposhtur: “Nuk duhet harruar mbështetja vendimtare që i dha Kamy një autori të përndjekur nga regjimi sovjetik si Boris Pastërnaku për të marrë çmimin Nobel në letërsi, që në fakt autori i “Doktor Zhivagos” e mori në vitin 1958, një vit pas tij”. Në një letër që ia dërgonte Roland Bartzit në vitin 1955, Kamy shkruante për një nga romanet më të famshëm të tij: “Murtaja ka (...) si përmbajtje të dukshme, luftën e rezistencës europiane kundër nazizmit”. Nga hipoteza e sabotimit mes 1.000 faqeve të ditarit të Zabranas, një tjetër murtajë totalitare do të bëhej përgjegjëse për fundin e parakohshëm të Kamysë, të përhershmit njeri në revoltë që nuk besonte në revolucionin komunist. Ajo që nuk mund të heshte është zotësia e shkrimtarit për “t’i rezistuar ajrit të kohës”. Vepra e tij, ashtu si murtaja që në roman mbyty për një vit qytetin e Oranit, për t’u zhdukur më pas krejt në mënyrë të pashpjegueshme ashtu siç erdhi, ka ende atë forcë apokaliptike të shfaqjes së shpirtit që nuk mbyllet vetëm në një domethënie njëkuptimëshe. Dhe pikërisht për këtë arsye, na përket më shumë se kurrë nga afër.

Urdhëri i ministrit të brendshëm sovjetik

Nga ditari i Jan Zabranas: “Nga një njeri që di shumë gjëra, dhe ka burime nga të cilat mund t’i marrë këto, kam dëgjuar diçka mjaft të çuditshme. Ai thotë se aksidenti rrugor i vitit 1960, në të cilin mbeti i vdekur Kamy, u organizua nga spiunazhi sovjetik. Arritën të demtonin pjesën pneumatike të makinës falë një mjete teknik që për shkak të shpejtësisë së madhe ka prerë ose shpuar gomën. Urdhëri për këtë aksion eliminimi u dha personalisht nga ministri i brendshëm Shepilov, si “shpërblim” për artikullin e publikuar në gazetën “Franc-tireur” të marsit 1957, në të cilin Kamy, lidhur me ngjarjet e Hungarisë, e sulmoi atë ministër, duke e cituar në mënyrë eksplicite. Thuhet se u deshën tre vjet që spiunazhi mund ta përfundonte këtë detyrë. Dhe në fund ia arritën qëllimit, dhe në një mënyrë kaq përfekte sa që bota deri më sot ka besuar se Kamy ka vdekur për shkak të një aksidenti banal rrugor, siç mund t’i ndodhe kujtdo. Ai njeri refuzoi të më thoshte se si kishte arritur të merrte këtë informacion, por më tha se ishte krejtësisht i besueshëm, dhe se ai e di me saktësi absolute dhe pa asnjë

dyshim se gjërat shkuan pikërisht kështu, që ata kanë mbi ndërgjegjën e tyre vdekjen e Kamysë”. (Jan Zabrana)

I huaji, Albert Kamy

I huaji, (L'Étranger), është kryevepra e Albert Kamy, (Camus), e publikuar për herë të parë më 1942. Është një udhëtim stilistik force që përmbledh shijen autentike të universit të absurdit dhe është konsideruar si vepër me rëndësi kritike për shkrimtarë dhe kritikët si Bartes, Rob-Gillet, dhe Sarute. Rrëfenjësi është Mjursault (Meursault), një algerian me temperament instiktive por jo aq demonstrativ, i cili në pjesën e parë tregon ngjarjet e përditshme të jetës së tij që nga varrimi i të ëmës dhe vrasja e një arabi në plazh. Në pjesën e dytë detajet e vogla kthehen në provat dënuese në gjyqin e tij. Mekanizmi arbitrar i sistemit gjyqësor dhe dënimi me vdekje provokojnë te Mjursault pohimin e jetës kundrejt vdekjes.

Vdekja, jo dhe aq absurde, e Albert Kamy-së

4 janari i 1960-ës do të trishtonte me qindra intelektualë francezë. Ishte dita kur Alber Kamy, 46 vjeç, krejt papritur dhe parakohe do të ndahej nga jeta gjatë një aksidenti automobilistik. Kamy udhëtonte nga Provonsa drejt Parisit në makinën e botuesit dhe njëherësh mikut të tij më të ngushtë Mishel Galimard. Vendimi fatal për t'u kthyer në Paris me makinë ishte marrë në moment të fundit, kur Kamy vendosi të lërë në tren gruan bashkë me dy fëmijët e tij, pa ditur se kjo do të qe hera e fundit që do i shihte. Përplasja pas një peme në një rrugë të rrëshqitëshme nga akulli bëri që Kamy të vdiste në vend, ndërsa Galimardi dha shpirt tri ditë më vonë në spital. Për Francën dhe mbarë botën letrare kjo tragjedi shënonte një humbje të madhe. Humbjen e shkrimtarit dhe filozofit i cili vetëm 2 vjet para vdekjes ishte nderuar me çmimin Nobel për letërsi. Autori i “Miti i Sifizit”, “I Huaji”, “Murtaja” etj, do të linte në makinën fatkeqe dorëshkimin me 144 faqe të asaj çka ai vetë e cilësonte si veprën e tij më të mirë, romanin Le premier homme (Njeriu i parë), botuar i paplotë në 1994. Afro gjysëm shekulli nga vdekja e tij, e përditshmja e njohur italiane “Corriere della Sera”, hedh dritë mbi dyshime që flenë prej kohësh në mendjet e kujtdo që nuk besoi tek vdekja e tij aksidentale. Sipas gazetës, “aksidenti” është sajuar nga shërbimi sekret rus KGB. Këtë teori e mbështet intelektual

dhe poeti italian Xhovani Kateli, i cili ka zbuluar pasazhe të pabotuara nga ditari i shkrimtarit çeko-sovjetik Jan Zabrana. Zabrana shkruan: “Kam dëgjuar diçka vërtetë të çuditshme nga goja e një njeriu i cili dinte shumë gjëra dhe kishte burime shumë të sigurta informacioni. Sipas tij, aksidenti që i mori jetën Alber Kamysë në 1960 ishte organoizuar nga spiunët sovjetikë. Ata dëmtuan një gomë të makinës duke përdorur një pajisje të sofistikuar e cila shkaktoi një vrimë në gomë kur makina mori shpejtësi. Urdhri u dha personalisht nga Dmitri Trofimovich Shepilov (Ministri i Jashtëm sovjetik) si reagim pas një artikulli të botuar në Franc-tireur (revistë franceze) në mars të 1957, në të cilin Kamy sulmonte hapur Shepilovin për ngjarjet që po ndodhnin në Hungari.” Kamy në fakt e kishte cilësuar si “Masakra e Shepilovit” vendimin e Moskës për të dërguar trupa në shtypjen e kryengritjes hungareze në 1956. Por, a do të mjaftonte kaq për të irrituar deri në ekstremitet ministrin sovjetik, sa të jepte këtë urdhër?! Olivier Todd, autori i librit biografik Albert Camus: Une Vie (Alber Kamy: Një jetë) shprehet për Observer se gjatë kërkimeve të tij në arkivat e ish Bashkimit Sovjetik nuk gjeti asnjë reference që lidhet me urdhrin e Moskës për vrasjen e shkrimtarit. “Reagimi im i parë ishte që asnjë nga veprimet e KGB-së nuk do të më surprizonte, por ky fakt dhe pretendim i ri më ka befasuar pa masë. Duhet të pyesni veten se kush përfiton nga ky zbulim dhe pse” – thotë Todd. E ndërkohë që debati mbetet i hapur, në xhepin e xhakëtës që Kamyja mbante veshur ditën e 4 janarit të 1960-tës, gjendet ende një biletë e prerë treni për Paris.

Pjesë nga “I huaji”

Nga “I huaji”: “Mamaja vdiq sot. Ose dje ndoshta, nuk e di. Mora një telegram nga shtëpia: ‘Mamaja na la. Funerali nesër.’ Kjo s’do të thotë asgjë. Ndoshta ishte pardje.” Pjesa 1, Kreu 1, Fq. 3 “Më ra ndër mend se sidoqoftë dhe një e Dielë tjetër kishte marrë fudn tani që kishim varrosur mamanë, dhe se duhej të kthehesha në punë, dhe se, në të vërtetë, asgjë nuk kishte ndryshuar..” Pjesa 1, Kreu 2, Fq. 24 ‘57 është viti kur Alber Kamy fiton Çmimin Nobel për Letërsinë “për prodhimtarinë e tij të rëndësishme letrare, e cila me qartësi ndriçon problemet e ndërgjegjes njerëzore të kohëve tona “. Kamy ishte i pari shkrimtar i lindur në Afrikë që mori këtë çmim.

DR. IBRAHIM RUGOVA, KULTIVUES I MODERNITETIT

Shkrimet e para në letërsi Ibrahim Rugova i filloi me poezi, ashtu siç veprojnë të thuash të gjithë shkrimtarët, kur fillojnë të merren me letërsi. Ai botoi nja njëzetë poezi, të cilat ishin në nivelin e poezive që botoheshin në atë kohë. Por shumë shpejt e braktisi këtë gjini për t'iu kushtuar studimit të letërsisë, veçmas kritikës letrare. Madje qysh në përmbledhjen e tij të parë të shkrimeve në këtë lëmi, në atë "Prekje lirike" 1971, dëshmoi për një prirje drejt letërsisë se avancuar perëndimore duke e iu shmangur asaj të realizmit socialist, që kishte përfshi një pjesë të letërsisë së kampit të ashtuquajtur socialist, trevë kjo së cilës i takonte edhe Shqipëria por edhe Kosova si pjesë përbërëse e Jugosllavisë së atëhershme. Të shtojmë se punimet e këtij libri se pari u botuan në të përkohshmen "Fjala" me mbititull "Zenite letrare", ku shihej orientimi i tij që të merrej me kulmet e letërsisë, kryesisht asaj botërore. Në këtë kontekst duhet shikuar edhe përpjekjet e këtij krijuesi që të lirohet nga dogmat e realizmit socialist, që e kishin kapluar letërsinë që krijohej në atë kohë, veçmas atë që krijohej në Shqipëri e që në njëfarë mënyrë ndikonte edhe në krijimtarinë letrare që krijohej në trojet e ish Jugosllavisë, ku jetonin dhe vepronin shqiptarët. Është thënë dhe shkruar se Ibrahim Rugova ishte ndër të parët që e kundërshtoi këtë drejtim letrar me shkrimet e tij të botuara në shtypin e kohës. Në të vërtetë që në shkrimet e botuara në librin e tij paralajmëronte orientimin e tij që synonte nga kulmet e letërsisë botërore, të asaj pjesë më progresive të kësaj letërsie. Këtë orientim të tij ai do ta përsosë pas qëndrimit disa muajsh në Paris të Francës. Madje mund të thuhet lirisht se krijimtaria e tij lidhet me modernitetin në kulturën shqiptare, me modernitetin e kritikës letrare dhe shkencore, jo vetëm të asaj që krijohej në trojet e ish Jugosllavisë, ku jetonin shqiptarët, por në të gjitha rasonë botërore, ku flitet e shkruhet shqipja. Në këtë mënyrë veprat e tij bëhen fanar që ndriçojnë aspekte të ndryshme të letërsisë, shikuar nga aspekte që deri më atëherë nuk ishin kultivuar në letrat shqipe. Në ndërkohë Ibrahim Rugova botoi edhe veprat tjera "Kah teoria" –1971, "Strategjia e kuptimit" – 1980, "Vepra e Bogdanit 1675-1685" –1982, "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983" – 1983, "Refuzimi estetik" –1987 dhe është koautor i dy veprave të tjera "Kritika letrare" (bashkë me Sabri Hamitin) – 1979, si dhe "Bibliografia e kritikës letrare shqiptare, '44-'74" (bashkë me Isak Shemën) –1976. Shtëpia botuese "Faik Konica" e Prishtinës e botoi kompletin e veprave të tij për të dëshmuar kështu vlerat e pakontestueshme me të cilat disponon kjo krijimtari

e që nuk e kanë humbur aktualitetin as sot e kësaj dite. Në të gjitha këto vepra hetohet mprehtësia e tij për t'i kapë gjerat,për të shqyrtuar me mjeshtri dhe aftësi të rrallë çështje që i shtron në këto punime. Në të gjitha këto vepra duket qartë prirja e tij për të ndriçuar sa më mirë çështjet për të cilat shkruan,duke i qëndruar besnik orientimit të tij primar,që veprën ta analizojë nga aspekte e artit dhe të rolit të saj në zhvillimin e dijes. Ibrahim Rugova ka bërë zgjedhjen dhe përgatitjen për shtyp të vjershave të zgjedhura të poetëve bashkëkohorë,si Din Mehmeti,Ali Podrimja,Beqir Musliu etj,të cilat i shoqëronte me parathënie,që në realitet janë analiza të thukta të vlerave të këtyre veprave.Dy janë veprat më të çmuara të këtij krijuesi,e që me duket se janë kryeveprat e Ibrahim Rugovës dhe ato “Vepra e Bogdanit 1675-1685” dhe “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”. Derisa në të parën ai do merret me studimin e gjithanshëm të veprës së këtij humanisti dhe shkrimtari,në të dytën Rugova do të merret me rrugët e zhvillimit të kritikës letrare në letërsinë shqipe. Sipas tij mendimi kritik për veprat e artit të fjalës së shkruar në letrar shqipe është shumë i hershëm,madje ai zë fill me paraqitjen e shkrimeve të para të shkrimtarëve shqiptarë. Kështu,për shembull,ai ka shkruar edhe këta rreshta:”Po ashtu në vijën e humanizmit kemi edhe poetin dhe filozofin Mikel Maruli (1453-1500),i cili shkruante poezi në frymën e elegjive të Katulit dhe bënte interpretimin poetik të botës sipas Lukrecit. Më 1497 botonte dy vepra të njohura «Epigrame» dhe «Himnet e natyrës»,si dhe la në dorëshkrim veprën «Mbi edukimin princëror». Duke vepruar kështu ai dëshmonte për përkushtimin e tij që të gjurmojë dhe të gjejë elemente të mendimit kritik për vepra letrare,edhe në vende të tjera e ndër popuj të tjerë,që ishin të botuara më herët. Në vazhdim të këtij studimi Ibrahim Rugova do të përqëndrohet në vlerësimet që janë dhënë për letërsinë dhe për veprat letrare në kohë dhe në hapësira të ndryshme. Një vend të rëndësishëm në veprën e tij zë mendimi kritik i shkrimtarëve të Rilindjes kombëtare dhe kontributi i çmuar i shkrimtarëve të kësaj periode,të cilët kishin botuar vepra të shumta në poezi,prozë apo edhe gjini të tjera të krijimtarisë artistike,por që kishin dhënë edhe vlerësime për veprat e botuara,në mesin e të cilëve ai do të përmendë Jeronim De Radën,mandej Faik Konicën,të cilin e radhiste në mesin e kritikëve më të çmuar të mendimit estetik në letrat shqipe,i cili që në shkrimin e tij në “Kohëtoeren e letrave shqipe” dëshmonte për një vetëdije të lartë për nevojën e kritikës letrare shqipe,si pjesë e letërsisë,të cilën edhe e ndihmon në zhvillimin e saj .Mund të themi lirisht se Faik Konica çmohet si njëri ndër kritikët më të mprehte dhe një ndër ata që i ndihmoi zhvillimit të mendimit kritik në letërsinë shqipe. Në këtë vazhdë duhet përmendur edhe shumë bashkëkohanikë të Konicës,në mesin e të cilëve po përmendim Fan S.

Nolin, i cili veprat e përkthyer nga gjuhët e ndryshme në shqip i shoqëroi me introduksione, andaj edhe kritikën e tij ai i quan kritika introduktore. Pa dyshim se këto interpretime të Nolit janë një thesar i çmuar në zhvillimi dhe rritjen mendimit kritik e estetik në letrat shqipe. Si do që të jetë konsolidimi i kritikës letrare shqiptare fillon më mjaft vonësë. Ai nis të zhvillohet dhe të kultivohet pas fillimit të botimit të shumë revistave letrare në gjuhën shqipe, qoftë në Shqipëri apo edhe në diasporë. Në këto gazeta e revista fillojnë të botojnë shkrimet e tyre shumë penda që më vonë do të bëhen të njohura, duke i ndihmuar kështu kultivimit të kritikës letrare si pjesë përbërëse e letërsisë. Kjo ndodh në vitet '20 dhe të '30 të shekullit të kaluar kur edhe fillojnë të botohen revistat "Djalëria", "Shqipëria e re", "Minerva", "Illyria", "Hylli i Dritës" etj. Në faqet e tyre do të gjejmë shkrimet e Eqrem Çabejt, Justin Rrotës, Mitrush Kutelit, Krist Malokit, por edhe ato të Dhimitër Shuteriqit, Gjergje Fishtës e shumë e shumë emrave të njohur të letërsisë shqiptare. Një pjesë të mirë e studimeve të Ibrahim Rugovës i kushtohet kritikës bashkëkohore, veç asaj që u krijua në Shqipëri e veç asaj që u krijua në Kosovë, gjegjësisht në ish Jugosllavi. Autori i veprës në shqyrtim ka sjellë analiza të hollësishme për orientimet dhe vlerat e kritikëve bashkëkohor, qofshin ata që punimet e veta i botuan në shtypin e Shqipërisë apo edhe të Kosovës, bashkë me orientimet e tyre në këtë lëmi të krijimtarisë. Vepra e veta Ibrahim Rugova i ka përcjellë me aparaturë shkencore, duke cituar fusnotat për burimet e shfrytëzuara, ashtu siç ka vepruar edhe me numërimin e literaturës së shfrytëzuar, treguesin historik të termave, treguesin e emrave e të ngjajshme me këto. Në dy veprat tjera, në njërin ai e ka botuar edhe listën e përmbledhjeve të poezive bashkë me vlerësimin e shkurtër për secilën veç e veç, kurse në tjetrën, në atë të fundit "Refuzimi estetik" i ka numëruar romanet e botuara nga viti 1949 deri në vitin 1986, pra vetëm një vit para botimit të veprës në fjalë. Të gjitha këto e bëjnë veprën e tij me vlera të larta jo vetëm estetike, por edhe shkencore.

Mesjeta shqiptare dhe mesjeta evropiane

Studimi i Ibrahim Rugovës, "Vepra e Bogdanit", ku është studjuar në mënyrë integrale vepra e njërit ndër krijuesit më të mëdhenj të mesjetës shqiptare, Pjetër Bogdani, bën pjesë në ato arritje kulturore përgjithësisht, e shkencore veçanërisht, që pos të tjerash, ngjallin respekt edhe për objektin e studimit. Njeriut të kohës sonë, të kësaj ngutie e hutie sikur nuk i mbetet kohë të merret edhe me trashëgiminë kulturore, shkencore, filozofike dhe letrare të stërgjyshërve. Kjo mund të jetë edhe pasojë e mentalitetit tonë se gjoja çdo gjë fillon me ne

ose së paku ka arritur zhvillimin e lakmushëm me ne. Andaj, vështruar nga ky kënd, studimi i Ibrahim Rugovës hap dritare të reja të dijes, duke shpaluar në këtë mënyrë errësirën shekullore, sidomos të Mesjetës, ku edhe si faktografi, ende nuk dihet për gjithë thesarin e trashëgimisë sonë shpirtërore. Më tutje, “Vepra e Bogdanit” heq, pos të tjerash, edhe napën e mosnjohjes së trashëgimisë, e që është burim dialektik i njohjes së drejtë edhe të së tashmes, që bën të mundur të gjenden rrugë për perspektivat e ardhmërisë. Studimi i Ibrahim Rugovës insiston me ngulm në këtë çështje. Çështjet që ka bërë përpjekje t’i ngrisë në nivel interesimi e interpretimi, t’i analizojë e t’i zgjidhë janë çështje të mëdha, që dalin para studiuesit, e në të njëjtën kohë janë edhe pjesë e trashëgimisë sonë shpirtërore, por edhe të mira shpirtërore, në fondin e arritjeve kulturore europiane. Duke u marrë me veprën e Pjetër Bogdanit, autori i studimit ka hetuar vlerat madhore të saj në fusha të ndryshme të dijes, në plane të ndryshme të dijes dhe në plane të ndryshme të arritjeve të mendjes njerëzore. Vepra e Bogdanit “Cuneus Prophetarum”, e botuar për herë të parë në vitin 1685, në Padovë, në shtypshkronjën e Kardinal Barbarigos, është dëshmia më e mirë e zhvillimit të artit, të shkencës e të filozofisë mesjetare shqiptare. Duke e vështruar këtë çështje, autori ka hetuar pararendësit shqiptarë dhe pararendësit europianë, për të krijuar hallkat e kontinuitetit të këtij zhvillimi. Në planin europian ky zhvillim është moshatar i mendjeve të ngritura të Dekartit, Mellbranshit, Spinozës, Paska lit. Në planin e zhvillimit nacional, është pjellë e arritjeve dhe e përpjekjeve të Barletit, Buzukut, Budit e Bardhit. Në studimin “Vepra e Bogdanit” është ndjekur një metodologji e ngultë shkencore, që e ka kushtëzuar edhe objekti i studimit. Të dhënat e shumta historiografike, që i ofrohen lexuesit të sotëm, mund të duket se e rëndojnë studimin, por kjo është e domosdoshme për veprat e lartësisë, sepse vetëm në këtë mënyrë arrihet ai kontinuitet i mundshëm ndërmjet nivelit që i ofron objektit, i cili shqyrtohet në nivelin e arritjeve të mendimit shkencor në kohën e sotme.

Studimi “Vepra e Bogdanit”, hiq “shtojcat”, ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë autori është marrë me gjenezën e veprës, kurse në pjesën e dytë me analitikën e veprës së Pjetër Bogdanit. Këto ndarje kryesore i shqërojnë pastaj nëndarjet e shumta të mëpastajme, që theksojnë çështje të shumta të planeve të veprës. Në pjesën e parë janë trajtuar çështje që janë kushtëzuar nga rruga e mundimshme e deri te krijimi i veprës së parë origjinale kombëtare “Cuneus Prophetarum”. Autorit të studimi i është dashur të merret edhe me çështjet e përkufizimit të letërsisë së vjetër shqipe, do të thotë me probleme të sistematizimit të letërsisë. Më tutje, me klasifikimin e zhanreve dhe të formave që janë zhvilluar brenda letërsisë së vjetër, edhe me biografinë e autorit, vepra e të cilit është bërë objekt

studimi. Për të hetuar kohën e tij, rrethanat shoqërore dhe kulturore të asaj kohe, është marrë edhe me anë të tjera jashtë natyrës së veprës, për të kompletuar kësisoji jo vetëm kërkshërinë shkencore, por edhe kërkeshën e opinionit kulturor të kohës sonë. Sepse, siç ka thënë Shekspiri, e që e ka cituar edhe autori, “t’i kthehem të vjetrës (antikës) se do të jetë një progres”. Më poshtë autori ka dhënë të gjashtë botimet që ka pasur vepra e Bogdanit duke filluar nga viti 1685 e deri më 1977. Deri sot dihet se me veprën e Bogdanit nuk janë marrë shumë njerëz, mendojmë në mënyrë studimore, edhe pse vepra nuk ka pushuar të jetë objekt i interesimeve të ndryshme që nga botimi, 1685, e deri në ditët tona. Vepër e veçantë që dihet deri sot mbi Bogdanin dhe veprën e tij është ajo e Matteto Sciambra me titull “Bogdanica” II, botuar në Bolonjë më 1965, ku janë dhënë shumë dokumente të reja për Bogdanin, kurse analizojnë aspektin gjuhësor dhe aspektin filozofik të veprës së Bogdanit. Mirëpo, si objekt i interesimeve të ndryshme, vepra e Bogdanit ishte përherë në qendër të vëmendjes. Sipas autorit të studimit “Vepra e Bogdanit”, ndër studjuesit e shumtë mund të veçohen disa prej tyre: Mark Harapi, i cili transkripton dhe e pajisë me shënime pjesën e parë të Cunesit, të cilën e boton në Shkodër më 1940-43. Duhet përmendur pastaj kontributi i Prof. Alberto Sratigonit, Anton Santorit, Zef Jubanit, Sami Frashërit, Faik Konicës, Gaetano Potrotta, Eqrem Çabejt, Justin Rrotës, Injac Zamputit, i studiuesit serb Radoniqit, ku janë me interes fotografia e pasur rreth Bogdanit dhe familjës së tij. Studimi i Jovan Radoniqit, më sa duket, është rezultat i polemikës që pati me Çedomir Mijatoviçin rreth origjinës së Bogdanit dhe familjës së tij, të cilën Mijatoviçi bënte përpjekje ta nxirrte me origjinë serbe. Në pjesën e dytë janë trajtuar çështje të shumta që dalin nga struktura e veprës. Kjo strukturë, siç del nga studimi i Ibrahim Rugovës, nis që me organizimin e jashtëm e formal të veprës “Cuneus Prophetarum” (Çeta e Profetëve) e që i shëmbëllen organizimit të Bibliotekës, duke shkuar deri te ndarja në shkallë e rrahë të veprës, për ta interpretuar, analizuar e vlerësuar pastaj veprën e Bogdanit. Për të hetuar të gjitha këto aspekte të vlerave të veprës së Pjetër Bogdanit, autori ka përcaktuar drejt edhe shtrirjen brenda kontekstit kohor, kur është krijuar ajo. Ky kontekst ka dy kahe: Mesjetën europiane dhe traditën nacionale. Siç shihet, plani krahasues ka qenë i pashmangshëm, sepse ai ka bërë të mundshme që të kuptohet drejt, dhe jo vetëm çështja e krijimit të veprës, por edhe niveli shkencor, filozofik e artistik i saj. Këto dhe çështje të tjera, të analizuar e të interpretuar me njohuri nga Ibrahim Rugova, e bëjnë studimin e tij ndër ato vepra që vëjnë bazat e studimit të trashëgimisë sonë shpirtërore. Duke hulumtuar shtresimet e vlerave të veprës, autori ka trajtuar çështje të estetikës e të poetikës, të retorikës e të semiotikës, të semantikës e të poetikës, të retorikës

e të semiotikës,të semantikës e të etikës. Të gjitha këto janë të shoqëruara me argumente të mbështetura,në radhë të parë në vlerat burimore që i ka ofruar Vepra e Bogdanit.

Në traditën e shkrimit dhe të botimit të Mesjetës,dihet se brenda botimeve të natyrave të ndryshme janë futur edhe shkrimet në poezi. Autori i studimit poezinë që është botuar në Cuneus e quan praktikë poetike. Në këtë rrafsh autori ka folur edhe për stilin,për figurat,kurse në tërësinë e veprës edhe për tipa të ligjeratës e që,sipas tij,janë dy:ligjërimi shkencor dhe ligjërimi artistik. Këto dhe plane të tjera të vështruara në veprën e Pjetër Bogdanit kanë bërë të mundshme shpalimin e këndeve të ndryshme të vlerave,që kanë kushtëzuar gjallërimin e saj nga Mesjeta deri në ditët tona. Autorit të studimit,duke mos iu mbushur mendja se ka prekur të gjitha rrafshet e Cuneus-it,në fund sjell një ese. Me këtë vepër,autori ka bërë përpjekje ta shqyrtojë praninë kreative të veprës së Bogdanit në krijimtarinë e mëvonshme të krijuesve tanë. Këtë interesim e nis me De Radën e Naimin dhe vazhdon me Nolin dhe Lasgushin,e vjen deri në ditët e vona,me Sabri Hamitin e ndonjë tjetër. Edhe pse këtë prani e quan si një punë që duhet të hulumtohet,del fakti se madhështia e Veprës së Botimit,me praninë e saj nuk ishte fiktive,por kreative.

****(Botuar në librin e autorit Engjël Koliqi”Dr.Ibrahim Rugova Arkitekti i Dardanisë se re-Republika e Kosovës”,Botues “Rugova Art”,Prishtinë,maj 2011, fq.55 deri fq.60).***

NËNË TEREZA, NDERI I KOMBIT SHQIPTAR

Pak biografi...

Anjezë Gonxhe Bojaxhiu e njohur si Nënë Tereza lindi në Shkup më 26 gusht të vitit 1910 dhe vdiq më 5 shtator 1997 në Kalkuta,(Indi), ishte humaniste e njohur shqiptare, fituese e çmimit Nobel për Paqë. Gonxhja ishte fëmija i tretë i Kolë Bojaxhiut (Nikollë Bojaxhiu) me origjinë nga Mirdita dhe e Drane Bojaxhiut (mbiemri i vajzërisë Barnaj) nga Novo Sella e Gjakovës. Lindi në Shkup, të Shqipërisë të pushtuar prej Perandorisë osmane, sot Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, më datë 26 gusht 1910. Shkupi i merret Shqipërisë prej Maqedoniëe me 1 Janar 1918 në baze të traktatit të Versajes. Një ditë pas lindjes u pagëzua në kishën e Zembrës së Krishtit nga famulltari i atëhershëm Dom Zef Ramaj. Kola dhe Drania kishin 5 fëmijë, dy u vdiqën në fëmijërinë e hershme. Frikë të madhe kishte nënë Drania mos Gonxhja i vdiste menjëherë pas lindjes, sepse me trup dhe shëndet dukej e dobët. Gonxhja kishte një vëlla dhe një motër. Vëllai quhej Lazër Bojaxhiu dhe studioi në Grac të Austrisë në Akademinë Ushtarake, por për shkaqe politike emigroi qysh herët në Itali. Kurse motra quhej Age Bojaxhiu. Babai i saj merrej me tregti dhe mbledhte në shtëpinë e tij artistë dhe patriotë shqiptarë. Gonxhja mësimet e para i mori në një shkollë shqipe në Shkup, ku po ashtu e kreu dhe gjimnazin, por në gjuhën serbo-kroate. Pasionet e rinisë së Gonxhes ishin tre: të bëhej mësuese, të shkruante dhe recitonte poezi dhe të kompozonte e të luante muzikë. Emrin “Tereza” e mori kur ishte 18 vjeçe dhe u dorëzua murgeshë. Nënë Tereza u largua më 26 shtator 1928 nga Shkupi në drejtim të Dublinit, [[Irlandë]. Prej kësaj dite, nënë, bijë e motër nuk do të shiheshin më kurrë. Më 12 shtator 1928, Gonxhja kishte shkruar këtë letër drejtuar tezes së saj: “Shkup 12. 09. 28 E dashura Teze Lis! Më 26 të ketij muajit po nisem prej Shkupit. S’po mund mos me ju shkruaj dy tri rreshta për juve. Lamtumirë, e deshiroj që Zoti t’ju jap gjithcka që ju deshiron zemra. Dua t’ju fal gjerat me të përzemerta, Gonxhja”. Ky ishte momenti kur ajo u nda përfundimisht me familjen dhe vetëm pas 30 vitesh, do të takohej me të vëllanë, Lazrin. Kurse nëna Drania dhe motra Age, shkuan në atdhe, në Shqipëri, qysh para Luftës së Dytë Botërore. Nënë Tereza u vendos në Kalkuta (Indi) ku fillimisht u bë mësuese dhe shumë shpejt drejtore e shkollës së vajzave. “Nënë Tereza e Kalkutës” u quajt kur themeloi urdhërin “Misionaret e Dashurisë”(1951) për t’u shërbyer më të varfërve dhe më të pashpresëve të

Kalkutës,Indisë dhe gjithë botës. Në vitin 1979,kur mori çmimin Nobel për Paqe,e gjithë bota mësoi se Nënë Tereza ishte shqiptare. Por Shqipëria nuk heshte. Republika Popullore Socialiste e Shqiperisë nuk i kishte dhënë vizë nobelistes së ardhshme as sa për të parë nënën e saj që jetonte në Tiranë,as për të marrë pjesë në varrimin e saj më 1974,as...për të parë varrin. Madje këtë vizë nuk ia dhane as kur fama e saj kishte marrë dhenë në të katër anët e botës deri në fillim të viteve '90. Shqiptarja trupvogel ishte kthyer në një legjendë të gjallë. Ajo ishte nënë kujdestare e 7 500 fëmijëve në 60 shkolla,ishte nënë që mjekonte 960 000 të sëmurë në 213 dispanseri,ishte e vetmja në botë që trajtonte 47 000 viktima të lebrozes në 54 klinika,kujdesej për 3 400 pleq të braktisur e të lënë rrugëve,në 20 shtëpi pleqsh,kishte birësuar 160 fëmijë ilegjitim e bonjakë. Këto janë shifrat e mesit të viteve '80. Deri sa Nënë Tereza ishte gjallë dhe sot e kësaj dite shifrat kanë ndryshuar shumë.Nënë Tereza nuk qe ndonjë perëndeshë dhe me të mund të fliste çdonjëri. Madje ajo kishte edhe adresë të saktë:një godinë ngjyrë hiri në Bose Road,të ndërtuar në një lagje të zhurmëshme dhe çjerrëse,të stërmbushur me njerëz,e cila vlonte nga çajbërësit,shitësit dhe tregtarë të tjerë të pjesëve më të ndryshme këmbyses si dhe lëngështrydhësit. Këtu,mu në qendër të Kalkutës shtrihej shtabi i përgjithshëm i Rregullit,,,"Shtëpia e Nënës",pranë portës të së cilës qe vendosur një tabelë druri ku shkruante:,"Mother Teresa. IN/OUT".Shtëpinë e Nënë Terezës e kanë vizituar personalitete si:mbretëresha e Britanisë,ish presidentët e Shteteve të Bashkuara George Bush e Jimmy Carter,Yasser Arafati,princesha Diana e shumë të tjerë. Nënë Tereza ka qenë mjaft bujare,humane e zemërgjerë dhe këto janë karakteristikat që do ta bëjnë të jetojë përgjithmonë në zemrat e gjithë njerëzve,sidomos në zemrat e shqiptarëve.

(Flori Bruqi)

Nënës ë Madhe-Hyjneshtë
Të kam gjetur në shume vende,Nënë,
Nënë e Madhe,
Kam dëgjuar rrahjet e zemrës tënde,Nënë,
Nënë e Madhe,
Në qetësinë solemne të festave,Nënë,
Nënë e Madhe,
Në errësirën e katedraleve të zbrazura,Nënë,
Nënë e Madhe,
Në bashkimin e zemrës dhe të mendjes,Nënë,

Nënë e Madhe,
Në morinë e njërzëve që duam,Nënë,
Nënë e Madhe,
Të kam gjetur në gëzime,Nënë,
Nënë e Madhe,
Ku të kërkoj,shpesh,të gjej,Nënë,
Nënë e Madhe,
Por gjithmonë të gjej në vuajtje,Nënë,
Nënë e Madhe,
Vuajtja është si këmbana,Nënë,
Nënë e Madhe,
Që na thërret t'i lutemi Zotit,Nënë,
Nënë e Madhe,
Të kam gjetur në madhësinë e dashurisë,Nënë,
Nënë e Madhe,
Të vuajtjeve të tmerrshme të tjerëve,Nënë,
Nënë e Madhe,
Të kam parë në gëzimin e paspjegueshën,Nënë,
Nënë e Madhe,
Të atyre,jeta e të cilëve është këputur nga vuajtjet,Nënë,
Nënë e Madhe,
Kam arritur të gjej edhe në shqetësimete e mija,Nënë,
Nënë e Madhe,
Në pakënaqësitë e mia të çastit,Nënë,
Nënë Hyjneshë!

ERNEST KOLIQI (1901-1975)

Nuk janë shumë shkrimtarët t'onë, emni i të cilëve të njifet aq mirë në shtresat letrare shqipe sa ai i Koliqit, të pakët janë ata, prodhimet e të cilvet të kenë marrë aq hapt në çdo kând të Shqipnis, sa ato qi emnin e tij në çfaqje kulturore gjithëfarësh, në botime nëpër fletore e revista të ndryshme, disa prej të cilavet themelue dhe mbajt prej tij vetë, në botime veprash që janë të pacaktueme të zanë një vend të dukshëm, dashtas e padashtas, në historinë e letrave t'ona. - Karl Gurakuqi[1] Ernest Koliqi (1901 –1975) është poet, prozator, dramatisht, studjues letrar e përkthyes letrar. Këtë veprimtari e krijimtari letrare e ushtroi gjatë gjithë jetës. Lindi në Shkodër me 20 Maj 1901 (1903), në një familje të njohur patriotike. Ndoqi mësimet e para në Kolegjin Saverian të Jezuitëve. 1918 –Ishte 15 vjeç. I ati, Shan Koliqi, e dërgon për të studjuar në Itali. Studion në Kolegjin Jezuit Arici në Breshia. Në gazetën “Noi giovani” (“Ne të rinjtë”), të cilën e themelon vetë me disa bashkënxënës, boton poezitë e tij të para në italisht. 1921 –Kthehet në Shqipëri dhe ristudjon shqipen me themel. Në një konkurs për himnin kombëtar, mes krijuesve të rinj e jo të rinj, merr pjesë edhe Ernesti i cili vlerësohet me çmim të parë nga një juri e përbërë prej emrash të shquar si: Gj. Fishta, F. Noli, M. Frashëri, L. Gurakuqi. Ku dy vjet më pas themelon së bashku me patër Anton Harapin dhe Nush Topallin, revisten “Ora e Maleve”. 1924 Bën pjesë në Shoqërinë patriotike “Bashkimi”, e krijuar nga Avni Rustemi. E thërret L. Gurakuqi në Tiranë si sekretar personal. Më vonë bëhet sekretar i Ministrisë së Brendshme. I nxitur nga L. Gurakuqi dhe miqtë e tij, dërgon në shtyp poemthin dramatik “Kushtrimi i Skëndërbeut”. Kjo vepër i dha shpresën për të hyrë përgjithmonë në botën e letrave shqipe. Për shkak të lidhjeve të tij të reja politike, detyrohet t'emigrojë për pesë vjet në Tuzla, Bosnje[2], për t'i shpëtuar ndonjë goditje nga forcat zogiste, pas revolucionit të dështuar të Nolit. 1929- I ndikuar nga ky rreth shqiptarësh, Koliqi shkruan vëllimin me tregime “Hija e maleve”, vëllim i cili e pagëzon edhe si krijuesin e prozës moderne shqiptare. Me një stil të mrekullueshëm narrativ, ai arrin të paraqesë në këtë botim një sërë episodesh të jetës malësore nën ndikimin e rregullave të ashpra të Lekë Dukagjinit por pa munguar edhe skenat e jetës qytetare shkodrane. Me këtë vëllim ai mirëpritet të kthehet në qarqet letrare në Shqipëri. 1930 –Mbretëria shqiptare e fal Koliqin dhe e emëron mësues të thjeshtë gjmnazi. Nga viti 1930 ishte mësues në një shkollë tregtare në Vlorë dhe në gjimnazin e shtetit në Shkodër, derisa shtrëngohet, sërish për arsye politike, të largohet në Itali. Në vitin 1932 botoi vëllimin e parë të antologjisë “Poetët e mëdhenj të

Italisë” (me një parathënie nga Fishta),një antologji me 280 faqe që u përdor menjëherë si tekst letërsie në gjimnazin klerik të Shkodrës dhe përmban katër poetët më të mëdhenj të Italisë:Aligierin,Petrarkën,Arioston,Tasson.1933-34 Jep dorëheqjen nga arsimi dhe regjistrohet në Universitetin e Padovës për të vazhduar studimet. Edhe pse me punë në Padova,Koliqi nuk i shkëput lidhjet me Shqipërinë. Bashkëpunon me redaksinë e të përjavshmes kulturore “Illyria”. Gjitha vjershat e veta i përmbledh në vëllimin “Gjurmat e stinëve” ku paraqiten me një frymë krejt të re skenat e jetës shkodrane dhe gjejmë të pasqyruar shpirtin e poetit të ndjeshëm me ndjesina atdhedashurore. Ndërsa,autodafeja e vendosur në krye të këtij libri vlerësohet si një ndër aktet më të rëndësishme në fushë të mendimit estetik shqiptar. Në një sërë botimesh periodike dhe veprash të tij,Koliqi afirmohet si një talent i letërsisë shqiptare. 1935,Itali –Pas suksesit të vëllimit të parë me tregime,boton një libër me 16 novela me titull “Tregtar flamujsh” me lëndë të nxjerrë nga mënyra e jetesës së popullit tonë,sidomos të atij të qytetit të Shkodrës. Ngjarjet dhe problematikat sociale që prekin veprën gjithnjë i nënshtrohen një analize të thellë psikologjike. Ky vëllim novelash,siç vëren Miaser Dibra,i përket një shkalle pjekurie më të madhe të autorit. Po këtë vit boton edhe poemthin në prozë “Quattuor”. 1936 –Emërohet Lektor i Shqipes pranë Universitetit të Padovës që drejtohej nga K.Taliavini. Boton vëllimin e dytë të antologjisë “Poetët e mëdhenj të Italisë” (me parathënie nga Karlo Taliavini). Ky vëllim përfshin vjersha të përkthyer të katër poetëve italianë: Parini,Monti,Foskolo,Manxoni. Edhe vëllimi i tretë ishte i përgatitur por nuk u botua. 1937 –Në moshën 34 vjeçare kryen studimet (5 vjeçare) në Padova me tezën “Epica popolare albanese” (“Epika popullore shqiptare”),tezë doktorate e cila u vlerësua nga shumë albanologë si N.Jokli,M.Lambertz etj. 1939- Emërohet titullar i Katedrës së Gjuhës dhe letërsisë Shqipe në Universitetin “La Sapienza” në Romë por nuk do të rrijë gjatë pasi po këtë vit nis punën si ministër arsimi në qeverinë shqiptare. Me të marrë në dorë ministrinë e arsimit,ai mbledhi rreth vetes njerëzit e kulturës,shkrimtarët më të shquar dhe i vihet përpilimit e botimit të teksteve shkollore. Sa që Koliqi ministër u arrit:

* botimi i historisë së letërsisë,me kritere të shëndosha,në dyvëllimshin “Shkrimtarët shqiptarë”(1941).

* botimi i të parës antologji në shqip:“Bota shqiptare”(1943).

* mbledhja e folklorit për të plotësuar veprën “Visaret e kombit”(vëllim me materiale nga folklori ynë)

* thirrja në Tiranë e Kongresit Ndërkombëtar të Studimeve Shqiptare në vitin 1940(Instituti i Studimeve Shqiptare me qendër në Tiranë,pararendës i Akademisë së Shkencave).

* botimi i vëllimeve “Rreze dritë”, “Te pragu i jetës”, “Studime e tekste”.

* themeloi e drejtoi të përkohshmen “Shkëndija”.

* hapja e shkollave shqipe në Kosovë; hapi edhe një shkollë të mesme në Prishtinë dhe mundësoi dërgimin e studentëve nga Kosova me bursë në Itali dhe Austri.

Duhet thënë se produktiviteti në kohën e Ernestit mbetet punë e pamohueshme. Në këtë periudhë ai ka bashkëpunuar me revistat “Hylli i Dritës”, “Leka”, “Përpyekja shqiptare”, “Minerva”, “Besa” etj. Si Ministër i Arsimit në kohën e pushtimit italian në kabinetin e Sh. Verlacit e n’atë të M. Krujës, gjatë Luftës së Dytë Botërore; në shtatorin e vitit 1941 kur me një vendim, mbi 400 arsimtarë normalistë dhe të shkollës amerikane të Fullcit, shkuan në Kosovë, trojet shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi, si dhe në Çamëri. Një akt i tillë ka qenë dhe mbetet përjetësisht sublim se ai dha frutet e veta në hapjen e shkollave shqipe, në hapjen e dëshirës për të mësuar dhe rrënjësuar shqipen në të gjithë trojet shqiptare. [4] 1942-43 Nga 1942-43 ishte kryetar i Institutit të Studimeve Shqiptare dhe largohet nga Ministria e Arsimit. Martohet me arsimtaren Vangjelije Vuçani dhe patën dy fëmijë: Markun dhe Elizabetën. [2] Në një letër dërguar më 16 tetor 1941 nga ministri i arsimit të Qeverisë së atëhershme shqiptare Ernest Koliqi drejtuar konsullit shqiptar Nikollë Rrota në Vjenë thuhet se ka angazhuar N. Joklin si organizator të bibliotekave të Shqipërisë me një rrogë mujore prej 600 frangash ari [5]. 1944 –Largohet n’Itali, i dënuar nga qeveria e re komuniste, si bashkëpunëtor i fashizmit [3]. Vepra e tij letrare u ndalua edhe pse nuk përmbante asfarë shenje a parashenje politike. Ajo u ndalua, për shkak të veprimit politik të autorit, përkatësisë fetare dhe dialektit. “L’Albanie Libre” është një e përkohshme e sapo dalë në Romë me të cilën Koliqi fillon bashkëpunimin. Ndër të shumtat shkrime, këtu nis të botojë, nga viti 1954 deri më 1961, studimin krahasues “Dy shkollat letrare shkodrane-e Etënve jezuitë dhe e Etënve françeskanë”. Në këtë studim të tij vërehet përpyekja për të hartuar një histori të mirëfilltë të letërsisë shqiptare, jashtë ngjyrymeve ideologjike. 1957 –Me dekret të Presidentit të Republikës së Italisë, më 2 shtator 1957, për njohje të prestigjit, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe e Universitetit të Romës, nderohet duke u bërë Institut i Studimeve Shqiptare. Në Firenze boton vëllimin “Poesia popolare albanese” (“Poezia popullore shqiptare”) ku spikat si studiues i merituar i traditave artistike dhe folkloristike të atdheut të tij Shqipërisë. Vëllimi ka tekste shqip e përkthime në italisht. Themelon të përkohshmen “Shêjzat” (“Le Pleiadi”) që e drejtoi për 18 vjet. “Shêjzat shërbyen si tribunë dhe dritare informimi mbi aktivitetet shkencore albanologjike në botë. Ato regjistruen në kroniken e tyre edhe ngjarje shoqërore që në të ardhmen do të vlejshëm sadopak si dokumentacion historik e kultural për një periudhë rreth njëzet

vjeçare”. Martin Camaj 1959 –Boton vëllimin “Kangjellat e Rilindjes”(“I canti della Rinascita”) me përkthimin në italisht,kushtuar arbëreshëve të Italisë,ku i nxit ata të ruajnë gjuhën e zakonet e të kenë besim në pavdekësinë e fisit. 1960 –Boton romanin “Shija e bukës së mbrûme” për të cilin Koliqi vetë shprehet:“Ky tregim parashtron edhe përpiqet imtësisht të hulumtojë dramën shpirtnuer të një të riut shqiptar flakrue jashta atdheut nga pasojat e së dytës luftë botnore.”(Paraqitje në “Shija e bukës së mbrûme”,Shkodër,1996) Boton studimin “Gabriele D’Annunzio e gli Albanesi”(“Gabriel D’Anuncio dhe Shqiptarët”). 1963 –Boton “Antologia della lirica albanese” (“Antologjia e lirikës shqiptare”) ku për herë të parë paraqiten në një gjuhë europiane përkthimet e lirikat më të mira të autorëve shqiptarë të vjetër e të rinj ku theksohen autorët kosovarë me qëllim që të njihen më mirë. Riboton “Shtatë Pasqyrat e Narçizit” (që e kishte botuar së pari në fletoren Gazeta Shqiptare të Bari-t më 1936) ku paraqiten shtatë copa proze poetike që përshkruajnë gjendjen shpirtërore të shkrimtarit. 1965 –Del në dritë “Albania”,një monografi italisht,botuar në “Enciclopedia dei popoli d’Europa”,Milano ku paraqet një pasqyrë të gjërë mbi Shqipërinë si në pikëpamjen gjeografike,ashtu edhe letrare e historike. 1969 –Më 4 Maj i vdes bashkëshortja Vangjelija. Zhdukja e saj i shkaktoi një mungesë të pazëvendësueshme e ndoshta shpejtoi edhe humbjen e tij. 1970 –Riboton poemthin “Simfonia e Shqipeve” (që e kishte botuar për herë të parë në fletoren Gazeta Shqiptare të Bari-t më 1936),që është si një testament poetik që nënvizon trashëgiminë kombëtare, lashtësinë dhe traditat e popullit. Kjo vepër ka për argument lartësimin e kohës së kaluar të fisit tonë. 1972 –Botohet vëllimi “Saggi di Letteratura Albanese”,Firenze. Është një përmbledhje e mirë shkrimesh e konferencash përpunuar gjatë disa vjetëve. 1973 –Vazhdon të përkthejë në italisht pjesë nga Lahuta e Malësisë,këngët II-III-IV-V (punë kjo e nisur që në vitin 1961 kur përktheu këngën XXVI;më 1971 këngët XII-XIII-XIV dhe XV). 1975 –Vdes në shtëpinë e tij në Romë 15 Janar dhe u varros po në këtë qytet me datën 18,i nderuar nga i gjithë komuniteti shqiptar n’emigrim,por i mohuar nga vendi i tij. Në ceremoninë e asaj dite kishin ardhur personalitete të ndryshëm,kolegë,shqiptarë, arbëreshë,miq të ardhur nga vende të ndryshme.Koliqi ishte themelues e drejtues revistash,ku botohej e trajtohej letërsia e kultura shqiptare si:Ora e Maleve,Shkëndija, Shêjzat,etj. Si letrar Ernest Koliqi shquhet si krijues në prozë,madje së bashku me Mitrush Kutelin konsiderohet themelues i prozës moderne shqipe. Përktheu në gjuhën shqipe poetët e mëdhenj italianë:Dante,Petrarka,Ariosto,Tasso,Parini,M

onti, Foskolo e Manconi, që i përmbloodhi në dy vëllime të librit Poetët e Mëdhejt' Italis I dhe II. Përgatiti, përktheu në italisht dhe botoi Antologjinë e lirikës shqiptare në vitin 1963. Me librat e tregimeve: Hija e Maleve (1929), Tregtar flamujsh (1935) dhe Pasqyrat e Narçizit (1936), Koliqi sjell një botë krejt unike shpirtërore shqiptare, ndërsa gjuha e tij dhe stili janë krejt të veçantë. Vepra poetike me pretendime më të mëdha e Koliqit është Gjurmata e Stinve (1933). Poezitë më të mira të këtij vëllimi janë ato të shkruara në formë të tingëllimit (sonetit). Shkroi nën pseudonimet Hilushi, Hilush Vilza, Borizani. Pasardhës të Koliqit, sidomos në këmbënguljen e gjetjes së veçantive vendore në gjuhë e në jetë, në letërsinë shqipe bashkëkohore para së gjithash konsiderohet Anton Pashku.

Tituj të veprave

- * Kushtrimi i Skanderbeut, (1924)
- * Hija e maleve (1929),
- * Gjurmata e stinëve (1933),
- * Tregtar flamujsh (1935) [7]
- * Pasqyrat e Narçizit (1936),
- * Symfonia e shqypeve (1936),
- * Kangjelet e Rilindjes (1959),
- * Shija e bukës mbrume (1960),
- * Albania (1965),
- * Epika popullore shqiptare (1937).

Të tjera

- * Themelues i Fletores Ora e Maleve –1923
- * Drejtues i revistës Shejzat –Romë
- * Epika popullore shqiptare –temë e doktoraturës pranë Universitetit të Romes –1937.

SHQIPJA BURIMORE, SHËNON NJË MODEL TË RI NË VEPRAT LETRARE TË MARTIN CAMAJT

Martin Camaj lindi në Temal të Dukagjinit më 21 korrik të vitit 1925; vdiq më 12 mars të vitit 1992 në Mynih. Ishte shkrimtar dhe albanolog i mirënjohur shqiptar me reputacion ndërkombëtar. Në Shkodër, në një kolegji, mori edukatë klasike. Emigroi në 1948 në Beograd ku studioi romanistikën, por mori mësimë edhe nga teoria e letërsisë dhe gjuhët sllave. Në verën e vitit 1956 largohet edhe nga Jugosllavia dhe shkon në Itali. Në Romë doktorohet dhe drejton revistën “Shejzat” si kryeredaktor, nën përkujdesjen e Ernest Koliqit. Këtu njihet më përseafërmi me botën arbëreshe. Nga Italia largohet në vitin 1961 dhe vendoset në Mynih të Gjermanisë, ku specializohet në gjuhësinë shqipe. Në Mynih, ai ligjëron letërsinë shqiptare deri në vdekje. Është përfshirë thuaja në të gjitha antologjitë dhe veprat ku flitet për shkrimtarët shqiptarë. Në Romë ndjek rrethet letrare të këtij qyteti, ku njihet edhe me autorët emigrantë nga vende të ndryshme lindore, rusë, rumunë dhe sidomos me poetë balltikë. Ishin të gjithë anëtarë të një PEN-klubi me qendër në Londër. Atje nën kujdesin e Koliqit bëhet kryeredaktor i revistës “Shejzat” (1957-1975) dhe studion së afërmi botën arbëreshe. Më 1961 transferohet në Mynih (Gjermani), ku specializohet përfundimisht në gjuhësinë shqipe, duke mos u shkëputur nga letërsia. Camaj u bë profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqiptare në Universitetin e Mynihut dhe mbeti atje gjithë jetën, deri sa vdiq, më 1992. Kontakti me kulturat e ndryshme perëndimore, njohja e poezisë moderne të poetëve më të njohur botërorë (Camaj ishte njohës i shumë gjuhëve të huaja), ndikuan në formimin e tij kulturor, ndërsa vepra e tij, qoftë në prozë apo në poezi mbështetet tërësisht në gjuhën shqipe dhe si përmbajtje i ka rrënjët në kulturën shqiptare, sidomos në mitin e trashëguar. “Prandaj nuk është e rastit që Camaj zgjodhi për të banuar një vend të shkëlqyer, me atmosferë disi të paqme e të virgjër shtëpijake, si alpet e Bavarisë, që çdo çast i kujtonin malet e thepisura të vendlindjes, ku nuk mund të kthehej kurrë”, shkruan studjuesi i njohur Robert Elsie.

Studimet

Në të njëjtën kohë Camaj është edhe një ndër albanologët më të shquar, kryesisht me punimet e tij mbi gjuhën shqipe, historinë dhe të sotmen e saj.

Ndër studimet kryesore mund të përmenden: Meshari i Gjon Buzukut, Romë 1960; Tekst mësimor i gjuhës shqipe, Ëiesbaden 1969; E folmja shqipe në provincën e Avelinos, Firenze 1971; Gramatika shqipe, Ëiesbaden 1984; si dhe antologjinë Këngë shqiptare, Düsseldorf 1974.

Tituj të veprave

- * Nji fyell ndër male –Prishtinë 1953
- * Kanga e vërrinit –Prishtinë 1954
- * Djella (novelë) –Romë 1958
- * Legjenda –Romë 1964
- * Lirika mes dy moteve –Munih 1967
- * Poezi (1953-1967)- Munih 1967 [1]
- * Njeriu më vete dhe me të tjerë –1978 [1]
- * Poezi 1981 [1]
- * Drandja (proza poetike)- Munih 1981 [1]
- * Rrathë (novelë) –1981
- * Shkundullima –1985
- * Karpa [1] (novelë)- 1987
- * Poezi 1981
- * Tingujt e parë

Botimet dygjuhësore

- * Poezi (shqip-italisht)- 1985
- * Me pendlat e korbit të bardhë (shqip-gjermanisht)

Të tjera

- * Meshari i Gjon Buzukut –Romë, 1960
- * Tekst mësimor i gjuhës shqipe –Ëiesbaden 1969
- * E folmja shqipe në provincën e Avelinos –Firence 1971
- * Antologjia: Këngë shqiptare –Dusseldorf 1974
- * Gramatika shqipe –Ëiesbaden 1984

Proza

Martin Camaj e nisi prozën, ashtu siç thotë shkrimtari i madh francez

Flober “në moshën e prozatorit”, pra në prag të dyzetave. Djella, tregim në prozë e në vjershë, Romë 1958, është përpjekja e tij e parë, që do të pasohet me veprat: Rrathë, roman, Mynih 1978; Shkundullima, proza, Mynih 1981; Karpa, Romë 1987.

Romani Karpa e vendos subjektin në brigjet e lumit Drin në vitin 2338, ndoshta për këtë autori ka parapëlqyer ta quajë “Parabolë”. Ky roman si dhe vëllimi me proza “Shkundullima” shquhet për një kërkim strukturor në rrënjët e zanafillave, jo vetëm si përsiatje e vazhdueshme, por edhe si gjuhë, në të gjitha dimensionet e saj. Pesë novelat e vëllimit “Shkundullima” janë zgjedhur prej shumë shkrimesh, sipas disa cilësish të përbashkëta, por ato kanë dhe ndryshime. Këto proza paraqesin dy mjedise: i pari lidhet me atmosferën në disa vise të Shqipërisë së Veriut, ku thellësia e bjeshkëve ndahet nga qafa malesh prej fushave të gjera. Ndërsa në tregimet “Shkundullima” dhe “Katundi me gjuhë të fshehtë” pasqyrohen brigjet bregdetare të Italisë së Jugut, treva ku jetojnë arbëreshët e lashtë. Edhe “Gjon Gazulli” anon nga ky mjedis. Ngjyra të përbashkëta janë kataklizmat natyrore, si shkundullima (tërmeti), apo rrëzimet e borës (orteku), që trandin një vend, ashtu si edhe vdekja ose prania e saj: mbarë këto dukuri i ndërrojnë faqet dheut e shoqërisë. Nga veprat e tjera letrare të Camajt me interes të veçantë janë “Loja mbasdrekës” dramë Mynih, 1981; “Kandili argjandit”, dramë, Kozencë 1983; Dranja, madngale, Mynih 1991. Drama “Loja mbasdrekës” trajton disa shkaqe të shthurjes së kanunit të Lek Dukagjinit nga fillimi i shekullit XX. Ajo u shkrua në atë mënyrë që të lexohet lehtësisht, thuaj si novelë, për t’u kuptuar drejtazi dhe pa u vënë në skenë.

Poezia

Martin Camaj është poet lirik me forma e përmbajtje moderne, me faza të ndryshme të krijimtarisë poetike dhe kjo nga shkaku, sepse ka kaluar nëpër kultura të ndryshme. Gjatë qëndrimit në Jugosllavi e Kosovë do të botojë njëri pas tjetrit dy vëllimet e para me poezi “Një fyell ndër male”, Prishtinë 1953 dhe “Kanga e vërrinit” Prishtinë 1954. Në Itali vëllimin Legjenda, Romë 1964 dhe në Gjermani librat e fundit poetikë “Lirika mes dy moteve”, Mynih 1967, “Njeriu më vete e me të tjerë”, Mynih 1978, “Poezi 1953-1967”, Mynih 1981. Dy vëllimet e para të Camajt të botuara në Prishtinë frymëzoheshin nga motivet e vendlindjes dhe ishin në frymën e së ashtuquajturës “Shkollë letrare e Shkodrës”, pjesë e së cilës u bë dhe ai. Në përmbledhjet “Legjenda dhe lirika mes dy moteve” Camaj

dëshmon me të gjitha mjetet stilistike e estetike të gjendurit në ndikimin e poezisë hermetike. Ky ndikim lidhet me kohën studentore në Romë, kur Camaj kishte profesor poetin e madh hermetik Xhuzepe Ungareti. I ndjeshëm tej mase ndaj motiveve të vendlindjes e fëmijërisë ai në gjithë poezinë e tij përpiqet të universalizojë elementet thellësisht shqiptare, si peisazh, mitologji, mentalitet e karakter. Pjesa më e rëndësishme e poezive të Camajt i është bërë e njohur edhe lexuesit të huaj me anë të botimeve “Poesie”, Palermo 1985; Selected poetry, Nju Jork 1990; Palimpsest, Nju Jork 1991; Gedichte, Mynih 1991. Jo vetëm po të nisemi nga vendet e botimit, por mbi të gjitha nga mënyrat e ligjërimit poetik, stilit dhe frymës, mund të vihen re qartazi tri faza të krijimtarisë poetike veçanërisht e letrare përgjithësisht të Martin Camajt:

Faza kosovare (ose klasike)

Faza italiane (ose paramoderne)

Faza gjermane (ose moderne)

Të tria këto faza kanë lënë shenja të qarta në krijimtarinë e tij:

Në fazën e parë ndihet mbështetja e fuqishme në mjetet shprehëse tradicionale e folklorike. “Mali e vërrini” përbëjnë botën rreth të cilës sillet e rreh nervi poetik. Në fazën e dytë kemi pasurimin e elementeve shprehëse me struktura më të komplikuar gjuhësore, duke mos iu larguar kurrësi tharmit të motiveve vendase.

Në fazën e tretë motivi vendas mitizohet, “thahet” e shndërrohet në një substancë me esencë të fortë.

Nga njëra tek tjetra arti i tij bëhet përherë e më formal larg strukturave tradicionale e ideve të ditës dhe synon të bëhet universal.

Disa poezi nga Martin Camaj...

HOQA FLETËN E LIBRIT TË PARË

Hoqa fletën e librit të parë

Prej faqes sime dhe mbetën fjalë të paemën.

Dola jashtë e ndeja në shqimthin e derës

Dhe vrejta fiqtë e hindit me ferra

Në vjeshtën time.
Shpirtënt e rinisë larg korpit endeshin
Me fleta gjethi pa pushini shullajave.
Retë e Oqeanit
Eci krahas me to
Nëpër ditën e gjatë.
Aty ku vete
Asht skaji i kohës së matun
Me rrahje zemre milionësh
Në kërkim të një emni.
Retë me rrajë thella në det
Rriten e bahen lisa:
Ndër gryckat e tyne fantazma
Konkisdadorësh
Vjelin pemë.

FUQIA E KONËS

Ngjyra e verdhë e fletëve
Shkurtoi dritën në faqe të veta
E të katundit jugor mbi kodrinën
Bote së kuqe.
Para derës rrin Kona
Me barrën e randë në gji,
Dashunon rrezet e pemëve të vokta
Në kanistër
Para burrit kalamendë gjumi.
Tjerr Kona në furkë:
Ngrohtësia e pejve të leshtë shpërtheu
Prej gishtavet
E lëvizja e fëmijës në parzëm
E dridhi në kënaqje të paskaj

ATY SI TASH PARA SE ME ARDHË Fiset

Aty si tash para se me ardhë fiset
Ishe
Me tambël në plasarijten e currave
e me themele në ujin e njelmë.
Të dhanë vetëm një emën:Shkodra.
E të thirrën qytet me kunora
E të hodhën përkrye gur e hekurat e para.
U zgjove e përgjakun sa herë
E u kqyre në pasqyrën tande.
Me emën grueje u lave ndër ujna
T'lumenjve dhe ndeje me petka të reja
Në shkamb
E ndritun ballë diellit mbi fusha.

MOTIV ARBËRESH

Në driza janë gjarpij't e zez
E ti je e xhveshun nën diell.
Në driza janë gjarpijtë e zez
E rrijnë buzë në buzë,
E rrijnë buzë më buzë,
E jeta e tyne ashtë e bardhë,
E bardhë e bardhë nën diell,
E jeta e bardhë e bardhë,
Nën diell e bardhë,e bardhë.
Mjaltëzat lugin me mjaltë
Gurzit e projeve të thata.

FILL I GJETUN

Natën që shkoi u fikën dritat e mbeti
qyteti në terr deri n'agim.
Amvisat kërkuen llampat vojguri
e s'i gjetën në terr.

Në nadje ra dielli e zbeu
faqet e rrokaqiellëve.
Në nadje vrejta rrethin e andrrave
në truell
e gjeta fillin e tretun
në pikën e ndaljes së dritës.

DREKË MALSORE

Sot ashtë marrë një gjak.
Dy plumba lëshuen përdhe një burrë.
Sot ashtë marrë një gjak.
Nën tunin e spatës
Pëlset rrashta e kaut te prroni.
(Drekë të mëdha po bahen sot!)
Sot ashtë marrë një gjak.
Gjama e burrave tërbueshëm
Përzihet me erën e mishit ndër zjarre.
E gjethi i Vjeshtës bie i djegun mbi kapuçat e bardhë
Ndë tryeza,jashtë
Natë. Në vorrezat mbi kodër
Tokë e re,hanë e re.
Ujqit janë ulë prej malesh
E pijnë gjak në përrue.

MOTIV I VJETËR NË KTHIM

Shtatë vasha u çuen peshë
Kur ngjyra e korbit fluturoi
Përmbi shtyllën e jetës:
Sqepi i dukej i verdhë,gati i bardhë
Mes pendlave të zeza.
Shtatë vasha u quen peshë
E u turrën vrap me funda
Në duer sa qethi mbas korbave
E vetëm me za i tretën si plafa të murmë

Nën karmat e vendit tim.
Po s'erdhët ju, vasha,
Kur të zbardhen pusat e ujit
Në lumë përpara agimit,
Ngurzohen edhe duert e foshnjeve
Në palare.

LULE

Sonte më lajmëruen se ka vdekë një njeri
Prandej jam i trishtueshëm, Lule.
Dashunia ashtë e vetmja shtyllë guri
Kur andej gardhit fluturojnë
Shëgjetat e akullit.
Dy zemra bashkë janë ma rrufeprojsje
Se dy shpata tu për tu
Me teha përjashta
Ideja e sosjes, Lule,
kur je ti pranë ik si shpend i egër
andej kah vjen terri.

GJARPRI DHE GRUAJA

Ajo mbramë harroi trupin e vet
Zbuluet
E në mëngjes e gjeti pikturë të varun
Në murin e gjanë dhetë pashë:
E kqyri dhe e kqyri e u zhduk.
Petkat e saj teren buzë detit
Me këmishën e gjarpnit mbi gurë.
Shtërpia tha se vjen prap, ajo, po
Deri mbasdite.
Mbasdite vonë, gjarpni i rrejtun
Doli prej nëngurit
E iu zgërdhesh vetmisë ndërsy,
Veshi këmishën e vjetër e shkoi
Me fjetë

ELEGJI E PARË

Ku kam me qenë i këputun
nga munda i vjetve të rrëpita sa 'i shkamb,
mos të vijë keq ty, Taze, për mue
të shtrimë mbi drrasat e vdekjes,
kingj i gatuem për flije.
Leni plakat të qajnë mbi mue at ditë
për njerzit e vet, vdekë qysh kur.
Edhe një amanet, moj grue:
kur vdiq im atë, premë dy qe
me ngimun të unshmit e thneglat e lamit
me grimca buke.
Por unë do të vdes mes njerzve gjithmonë
të ngishëm,
prandej ndër drekët e mija qitni
vetëm kafe të idhta.

Me këtë poezi ndoshta nis epoka e pjekurisë artistike të Camajt drejt modernitetit, gjuhës së kursyer dhe të shumëkuptimshme. Si në shumë poezi të tjera edhe këtu ndjehet ankthi i ndeshjes së dy kohëve dhe hapësirave: Fëmijëria në malësitë e Shqipërisë dhe së fundi vdekja në malësitë e Gjermanisë së jugut. Duket se autori drejton dy amanete njëherësh: një në atdheun e largët (Tazes) dhe një në vendbanimin e përkohshëm (Gruas). Do të jenë dy ceremoni mortore në të njëjtën kohë: një në Dukagjin me plakat dhe elementet e tjera autoktone dhe një tjetër në mërgim mes njerëzve gjithmonë të ngishëm. Poezinë e zotëron një ndjeshmëri e madhe muzikore dhe ritmike dhe pse e shkruar me vargje krejtësisht të lira e me struktura tregimtare. Ajo është një elegji moderne, ku elementet autoktone dhe primi-tive tentojnë të universalizohen e të bëhen të kuptueshme për të gjithë. Ky në përgjithësi është dhe çelësi i gjithë poezisë së Camajt.

MOSHA E QENIT APO DITËLINDJA

Kremtuem gjith natën i ri e i vjetër kohën
që vdiq e vrame në mue.
E thanë: askush s'do të lypi gjak
për të.
Ajo nuk ishte festë, por drekë!
Në mëngjes mbas dere qentë
me sy keqardhës e të butë
nuk pritshin eshtna, por mue
me u nisë me ta shtigjeve bri lumit
teposhtë.

Është një ndër poezitë më të bukura e njëkohësisht më private të Camajt. Çasti i festimit të ditëlindjes së një burri të vjetër, që fatalisht ve re se koha, do të thotë jeta, ka mbetur e vrarë brenda tij, përbën frymëzimin tragjik të poezisë. Ai s'di kë të akuzojë për vrasës të kohës së vet, vrasësi ka mbetur anonim, ndaj dhe s'ka se kush të pagujë gjakun. Në këto rrethana afërsia me qenin bëhet sa e dhimbshme aq dhe humane.

Koha i ka ngrënë gjithçka këtij personaliteti subjektiv, e ka nxjerrë kockë e lëkurë. Simboli i lumit që e pret në fund të poezisë mund të lexohet edhe si vijimi i jetës së pasosur, por edhe si caku që ndan dy jetët e prej kah nis bota tjetër. Poezia duket sikur s'ka fund. Gjithçka i lihet në dorë lexuesit, vazhdimi, përparimi i paskaj, finalja e imagjinuar.

Me mjete thellësisht hermetike, ku fjala e zhveshur nga cilësorët e panevojshëm qëndron si monument, gur i rëndë në vendin e vet, përveçse flet në mënyrë të drejtpërdrejtë, më së shumti sugjeron kuptime e imazhe.

MBRAMJA ASHT LARG

Mbramja ashtë larg
e ti je atje mbi kodër të blerueme
ku gurzit që bashin zhurmë
i përpiu dheu.
Ti je atje me të bijën e heshtjes

e me shoqe tjera e mendon për mue.
Unë jam në detin e tingujve
e ndër gjujt e mij ndieva
peshen e tramit tue u ndalue me turr.
Mandej i lëshova vendin një të vjetri
e mes tallazit të krahve thashë:
mbramja ashtë larg e ti andej lumit.
Heshtja prek qiellin me dorë
E ti atje mbi kodër të blerueme
njeh gjurmët e diellit npër qiell.

Poezia është e ndërtuar me një lirizëm të thellë,të fshehur prej trajtash tregimtare. Një ëndërr erotike mes dy njerëzve larg njëri-tietrit,që një lumë dhe një mbrëmje imagjinare i ndan. Janë dy botë të ndryshme larg në hapësirë,por edhe në kohë. Kujtimi i një krijese femërore i sillet poetit në krye,një krijesë pa formë a trajtë,e ngjashme me një frymë a shpirt (që ka motër heshtjen) e që jeton diku në gji të natyrës. E ky për vete në një botë tjetër,të mekanizuar,me tram (treni i metrosë).E gjitha është një ëndërr që i vjen poetit prej kujtimeve të vjetra të rinisë. Ndjehet i pamundur,por edhe i paepur deri në fund (i lëshon vendin një më të vjetri). E vetmja gjë që ka mbetur është heshtja krijuar prej kohës dhe hapësirës,heshtje krijuar nga numërimi i gjurmëve të diellit nëpër qiell. Edhe kjo një poezi hermetike,e vështirë për një lexim klasik,sugjeruese dhe sugjestionuese,ku fryma e mban në këmbë si njësi unike,e ku vargjet synojnë të jetojnë në vete e për vete.

ELEGJI E PARË

Ku kam me qenë i këputun
nga mundi i vjetve të rrëpita sa ‘i shkamb,
mos të vijë keq ty,Taze,për mue
të shtrimë mbi drrasat e vdekjes,
kingj i gatuem për flije.
Leni plakat të qajnë mbi mue at ditë
për njerzit e vet,vdekë qysh kur.
Edhe një amanet,moj grue:
kur vdiq im atë,premë dy qe
me ngimun të unshmit e thneglat e lamit

me grimca buke.
Por unë do të vdes mes njerzve gjithmonë
të ngishëm,
prandej ndër drekët e mija qitni
vetëm kafe të idhta.

Me këtë poezi ndoshta nis epoka e pjekurisë artistike të Camajt drejt modernitetit, gjuhës së kursyer dhe të shumëkuptimshme. Si në shumë poezi të tjera edhe këtu ndjehet ankthi i ndeshjes së dy kohëve dhe hapësirave: Fëmijëria në malësitë e Shqipërisë dhe së fundi vdekja në malësitë e Gjermanisë së jugut. Duket se autori drejton dy amanete njëherësh: një në atdheun e largët (Tazes) dhe një në vendbanimin e përkohshëm (Gruas). Do të jenë dy ceremoni mortore në të njëjtën kohë: një në Dukagjin me plakatin dhe elementet e tjera autoktone dhe një tjetër në mërgim mes njerzve gjithmonë të ngishëm. Poezinë e zotëron një ndjeshmëri e madhe muzikore dhe ritmike dhe pse e shkruar me vargje krejtësisht të lira e me struktura tregimtare. Ajo është një elegji moderne, ku elementet autoktone dhe primitive tentojnë të universalizohen e të bëhen të kuptueshme për të gjithë. Ky në përgjithësi është dhe çelësi i gjithë poezisë së Camajt.

Dranja (fragment)

Ata që presin barin me drapinj dhe kosa të shkurtra, posare për livadhe me gur në bjeshkën e Cukalit, janë njerz të heshtun dhe vetëm në dukje të qetë: dhimba u bren kocat natën e i kap si pika në mëngjes në muskuj e gjymtyrë kur sjellin së pari rreptas hekurin në bar. Në parzmin e leshtë u fshehet frika e gjarpnit që pret tue njehë në ritëm afrimin e krismës së drapnit në tërfojë. Mbledhësit e barit flejnë në vapën e ditës mbështetë për trungun e ahut nën hije e shohin andrra syçelë. Ma i riu i zgjoi njëherë e u tregoi atë që kishte gjetë, diçka të gdhendun, gungë e madhe ngjyrë ashti, rrashtën e breshkës e mbi atë gjarpnin dredha-dredha, gjithçka të bamun gurë! Mirë – thanë ata – na e dimë qëmoti se nëma e Orëve ndërron në shkamb çdo gja, edhe bariun me tufë përpara, po puna është: si erdhi breshka deri këtu, kaq nalt?

Njeni sish shpjegoi me buzë në gaz:

“Unë kam helm në gjak pse gjarpni më zuni tri herë, andaj unë di në këtë mes pakëz ma tepër se ju. Breshka –tha ai –e pruni deri këtu në shpinë gjarpnin. Shikoni, si janë të ngrimë më një si të mos ishin dy frymorë! Si pela ime, Drania, e unë mbi të kaluer.” Mandej folësi mori briskun e me maje ia shkoqi gjarpnin breshkës nga rrashta mbi të cilën mbeti gërresa dredha-dredha, si ravë që përshkon gjysmën e globit. Dranja, e quejtën njazani ata breshkën në gurë, pa gjarpën... Ndonëse breshkë, Dranja ashtë vrejtuese e vëmendshme kur ndodh se e sheh njerëz apo shtazë si përtypen tue ngranë. Dhisë i lakmon ma së forti si ajo me buzë e dhambë të mprehtë përpin palën e gjethit sa çel e mbyll synin breshka. Kjo, një fletë të vetme sallate, e përçap me orë derisa t’i lëshojë një pikë lang në gojë. Poetit që e vëren Dranjen po në këtë timtë s’i shkon mendja te punët e saj të brendshme: në vetmi ai përtyp në tru si breshka na qenka kosmopolite e mirëfilltë vetëm sepse kupa e rrashtës së saj i përngjet gjysmës së rruzullit me njolla dhenash të çdo ngjyre, si racat e ndryshme në të. Por ai ashtë edhe i zoti ta ndreqë rëmimin e vet, kur ndalet dhe e vëren Dranjen nënçmueshëm e thotë: Dam, që askush s’e ditka se një rruzull i tillë na paska po në thelb një zemër breshke! Vjeshta po kalon ndërrueshëm me vapë e fortunë, dridhje shtërpie lara-lara nëpër dushk. Thonë: kohën që vjen askush të mos presë një ditë të mirë. Si kështu! Kaq pabesim në jetë? E njëmend erdhi moti krejt i mirë, lak i gjatë pa nyja. Dranjes iu sqarue drita e synit si me dashë me pa si asnjë breshkë ndojherë kreshtat e maleve larg-larg mbulue me borë të bardhë: vetëm prei atij vezullimi u ndez dheu e uji mori flakë. Jo, nuk ishin vargmale ato, po fletëza arnejsh në vërvitje në skajin e pyllit, një flakim peshe larg dhe përpara turra kajzish të vegjël barnash të thata. Vjeshta po kalonte, por gredhi me za të burrueshëm si kurrë kërkoi ndër lisa e gjeti ç’ka lypte: pemë të çame përgjysmë me erën e athët në lang. Një lloi bretkose, thithlopa e ngime, i merr amë në hapësi qumështit që shkumbon në vedër mes gjujve të mjeltoses, gërmuq në shkam, ende të pashtitëruem mirë për këtë zeje. Edhe pse tepër ngjyra në këtë vend, koha përputhet për kohë përkueshëm, pa u vra aspak sendi për send.

Rrathë (fragment)

Mbas lutjes së parë u kapën dora-dorë dhe silleshin me hapa të matun përreth ashtu sikur vëhen në varg për të hedhë valle vendëse. Silleshin varg tue u ba rreth ende i papërkryem dhe përsëritnin pajanda në ritëm një thanje, si emën apo fjali. Kryetari qëndronte në mjedis dhe drejtonte fjalë e lëvizje, tue u dhanë

këtyne krah në një drejtim të caktuem,i tretun në ekstazë me sy të mbyllun. “Tash mund ta çojmë zanin e të flasim pa pëshpëritë. –Mbeti e tha Baci. –Tash janë të përqendruem në vete e s’i ndëgjojnë ma tingujt e jashtëm. I vetmi që mund t’i mbajë veshët të hapun kah zanet e jashtme asht zëvendësi,Këshilltari. –Ndeji e u mejtue e vijoi:–Sa kryetarë shkuen e erdhën e ai,Këshilltari,mbeti aty ku asht,në të dytin vend,i ngulun si cung lisi. –Zëvendësi i truhej Hyjnisë si me një gjysmë goje,por megjithatë zani i tij mbizotnonte fjalët e lutjeve të përbashkëta. Fjala e tij hidhej si prej një bahje prej gojës së shthurun dhambësh një gurë i vetmuem në pusin e shterrun. –Shikoje mirë e mos harro tiparin kryeneç,menda e zgjuet që nuk ndërron,prore me një shprehje në fytyrë,i qetë,energjik e sygordhë! ” Zëvendësi i Drenashit,i ashtuquejtun Këshilltari,së fundi u vu edhe ai në valle si pa andie. Shtrini krahun e djathtë mbi shpatullat e valltarit për anë si flatër gjerze dhe dora e madhe e tij prej fshatarit mbulonte një pjesë të supit të shokut,të një fshatari vocrrak të thatë e fytyrëtjerrun. Kambët e thamta e të lakueme të tij lëviznin ploghtë në vallen vendëse:një hap para,një hap mbrapa e mandej shpejt e shpejt,dy para e një tjetër fare të shkurtë përsëri mbrapa.Kështu në varg,dale e dalë dhe mbarë e mbarë zhdërvillohej rritshëm e me hov lëvizja vallëzore,jo pa sqimtari të natyrshme krenarie të përmbajtun hera-herë,dhe ngjit mbas plaste prapë papritmas egërsia e burrave fshatarë si bujena ndër arat e tyne. Zëvendësi lutej fare vetëm me fjalë të veta në të folmen e Ripës së Poshtme:“Zot,po të lus,shqymbi anmiqtë tonë. Të lus,pra,shqymbi! Mos i le gja mangut,po qiti tashti fare me gjindje e mall e gja e fiki si fiket një qiri në ujë,e shnjëzoji ma tepër se i ke shnjëzue ata panukuj panukujsh! Dyndi këtij vendi e dliër sish dhenë,e mbyti pa e lan një sish për farë,mbyti të gjithë në ujin e atij lumi për nën,po ashtu si mbyte vjetin e keq ushtrinë e karkalecave kur ata vërshuen dhenat tona,a more vesh? E mos u le vend nën këtë diell,ashtu deh! Mos u le vend!” Së voni zu secili me u lutë në vete,ulë në gjunj të mëdhenj,disi pa rregull e me tinguj të pakuptueshëm pendestarësh të turpnuem për fajet e veta. Luteshin si për provë,sa për të përgatitë gjuhët për adhurime ma të vërshueshme. Shpërndahej nëpër qiellzanë të trenëve vajtimi i ngashrueshëm i njerëzve në mundime që s’donë me durue ma gjatë. Në këtë mënyrë lutej edhe Këshilltari me të dhanun të devoçëm si mos me i ditë kurrkund shteg vetit. Drenashi e ndërpreu ngutshëm këtë nynyrim ankues të paskaj,si me u pasë kujtue se një ankim i tillë nuk ishte për burra,dhe urdhnoi:“Leni të rrjedhin prej gjuhëve tona fjalë të përflakëta,fjalë që me përshkue detin tej për tej e me ça gurin si me kepa çeliku! Çonje,bre,zanin deri në kupë të qiejve e të na e marrë vesh Ai që vran e kthjell në çdo skutë qiellore!”Dhe si prej një goje ushtoi britma:“Hyjni,Hyjni!”Parreshtun:“Hyjni,Hyjni! Merr vesh! “Dhe u kapën prapë dora-dorë në

valle, tashti ma të shpejtë, gjithnjë tue u çue e tue e ulë zanin si valë deti në tërbim. Në mjedis Drenashi, si valltar i shtitëruem, sillej lehtas majë gishtavet të kambëvet dhe petku i bardhë lini përftonten një kumbonë. Prej kumbonësi lijtë që sillej vorbull rreth vetes iu duk të dy vëshguesvet në fundin e faltores se doli një plakëz, një grusht eshtna në veshjen femnore e të larmishme, vendëse. Plakëza me një tepsì bakri në dorë, e vetmja femën në atë rreth, kishte ndejë deri atëherë mb'anësh dhe po delte tash papritmas e ulej para kambëve të Fetarit në këcim, vetëm. Ajo u ul përpara kambëvet të Drenashit dhe i ra bakrit me unazë argjendi që mbante në gishtin e mesëm të dorës. Ai tingull ua preu zanin në gojë. Mandej ajo vuni tepsinë pingul në truall dhe nisi ta sjellë në vend, rrotull, tue e drejtue me kumtin e vet zanet e lutjeve që kishin fillue përsëri fashitshëm. Kumti i thellë i bakrit të lëvizun prej dorës e llanës së krahut të plakës mori t'i mbledhë të gjitha zanet një nga një si gjasende të shpërndame nëpër truall. U prini të gjitha zaneve të zbutuna dhe u përnjësue me to dhe u ba një tingull i zbutun, si me qenë tue dalë ai za prej gjiut të dheut. Delte prej gjiut të dheut, kapej me mund harqeve të faltores deri aty ku këputeshin vizat dhe zhdukej kushdi se kah. Folkloristi tha me vete se vetëm kjo lutje depërtoi mure e troje, njena mbi tjetrën dhe arriti në veshët e qiejve të naltë. Secili, i qetuem, ngjante se lumnonde në gjamimin e unjishëm të zanit të vet të kapun dora-dorë në valle me zanet e tjerëve dhe të lëkundjeve ringlluese të metalit që ndërprehej në ritme prej copës argjandi në gishtin e plakëzës. Fytyrat e besimtarëve galdonin të shndërruese nën fuqinë e transit dhe pesha e korpit shkëputej prej trollit dhe landa njerëzore e bartun prej ritmeve merrte turr për t'u librue në fluturim me vallen e shpejtueme. Pak a shumë secili gjindej mbrenda një sferë të rrumbullakët, secili vetë gogël që vinte rreth dy rrotullave të ndezuna, rreth Fetarit në këcim e hanës së plotë, metalit zjarmor në dorën e plakëzës. Ndjenja me qenë yll në vartësi të diellit e të hanës në rrotullim të paskaj, thonë rregullat e besimit, asht për secilin shpërblim i të besuemit. Ashtu si përherë edhe në këtë rast flijimi, lutësit panë befasi se rrethi i ndezun në mjedis nisi të lëshojë rreze gjaku. Tërbimi i tran-sit mori flakë në çdonjenin sish. Drenashi kishte hjedhë petkun e bardhë një copë përdhe e qëndronte xhveshë në breze përpjetë. Prej shokësh së ngjeshun krahëqafë, mbushë me gjilpana, thikëza gjithnduersh, hoqi Këshilltari një gjilpnyer e ia dha Fetarit. Mandej i dha njenën mbas tjetrës, gjilpana, thikëza e heshta dhe këto të gjitha Drenashi njenën mbas tjetrës, fluturimthi, pa u kujtue vëzhguesit i ngulte në parzëm e ndër krahë, kudo mbërrinte në mishin e vet. Gjaku maparë i rinoi nëpër parzëm e krahë vizla-vizla e mandej rrëke dhe megjithatë ai nuk ndiente kurrfarë dhimbje. Plakëza, e ashtu quejtun Emtja, pa e ndalë sjelljen e rrotullës së bakrit hodhi me shkathtësi faculetën që e

mbante në brez ndër duert e shtrime të Drenashit kah dera e mbyllun. Faculeta mbeti e varun ndër duert e flijuesit si të ishte një gjasend që i truhej Hyjnisë. Edhe vëzhguesit e rrokun prej euforisë së përgjithshme panë në flakrimin e faculetës së kuqe diçka të gjallë, një shpend që po i pritej fli shejtnorëve. “Edhe një risim –vërejtë Folkloristi –edhe një risim!” Dhe përpiquej me gjetë çfarë shmënie paskej premja e gjelit dhe vetëm kur pëlhura ra përdhe u kujtue se s’ ishte gja e gjallë. Pra, asnjëni s’ u kujtue se Emtja ia kish hjedhë Drenashit pa farë rezhie ceremoniale faculetën që ai të fshijë gjakun, as atëherë kur plakëza e çoi dhe e vuni në brez pa ndërpre sjelljen e rrotullës së bakrit të shkëlqyeshëm. Flijimi kishte mbërritë kulmin: çdo gja rrotullohej ndër sytë e të dy vazhguesve. Edhe Drenashi ishte vu në varg me tjerë. Shpatëza e heshta, gjilpana gjithnduersh, tundeshin në kurmin e tij në rrotullim me tjerë si me qenë degë e rremba të thatë në lisen e rrahun prej erës. Besimtarët përkitnin si të verbët në sonambul majet e gishtave i me dashë të marrin ndjesë e bekim prej tyne. Mandej herë në rresht, herë palë e palë vallja –balladër e lëshueme prej së nalti –mori vrap edhe ma të tërbuem e bashkë me të gjimimi fjalësh mes tingëllimit të shigjetave në mishin e njeriut dhe ehut të bakrit në rrotullim. Fytyra e Drenashit dridhej prej dhimbjes e gjujtë i lakoheshin nën peshën e korpit të therun, kurse besimtarët –vorbull murrhani –fluturonin në vargun e valles tue përpjekë njeni mbas tjetrit dora-dorë vetëm rrëshqitazi gishtat e kambëvet të zdathuna nëpër truell. Atje vonë gjymtyrët e Drenashit u lakuen e u përkulën fare kështu që gjysma e kurmit ra zvarë për tokë. Këtë e vërente edhe Këshilltari në kambë mb’anësh si të mos i përkiste rigatës së valltarëve, si tue e matë rrugën e flijimit. Njeriu i flijuem prej njerëzvet të vet qindronte, por kur heshta e shigjeta në parzëm, krahësh e brijësh ndeshën për rrasat e shtrojes dhe i lënurën thellë mishin, Drenashi lëshoi një britmë dhimbje e i ra të letit. Vigma e dhimbjes i zgjoi befas burrat në vrap vallëzor: një herë i shtangoi në vend, mandej i zgjoi prej kllapisë së randë. Kur erdhën në vete të gjithë, prishën vargun e valles e shkuen e zunë vend në gjuj të mëdhaj anash. Kishin kalue vetëm dy orë prej fillimit të sjelljes fetare, por secili këqyrte me shtangim shokun si të mos ishin pa tash shumë mote. Këqyrnin njeni-tjetrin hulumtueshëm për t’i diktue në fytyrë sa rrudha qenkan mbresë në të mbas të gjithë asaj kohe. Mandej sytë u shkuen në mjedis të faltores. Mbi rrasat e gurit vërenin në heshtje një rreth gjaku të përkryem, rrethin e valles së vet. Kujtoheshin se ata vetë e kishin ngrehë rrëshqanë Drenashin e shigjetuem, shokun e vëllanë e vet. Dy besimtarë kapërcyen rrethin tue u ruejtë që të mos shkelnin hullinë e gjakut dhe u përkulën përmbi flinë: prej parzmit e krahëve të Drenashit nxirrnin hekurinat, hej të ngrimë në gjak në ngjyrë

ndryshku. Duert e tyne lëviznin shkathshëm mbi korpin e flisë deri sa i hoqën të gjitha:Fetari pa thercat e ndëshkimit doli si i xhveshun,lakuriq në shesh. Nësyteetëshumëveshiheshinlotjoaqtdhimbësunisëndajkryetarittëvettëflijuem kushdipërtësatenherë,pormatepërngavetëdijasehapjaederësedaljanëdritëngjaste tepër,kushedi,edhe shekuj të tjerë,varg njeni mbas tjetrit,si ata në vallen e gjakut. Atyne që e libruen Fetarin heshetash e gjilpanash u dha shej Këshilltari që ta praponin andej dhe këta ashtu banë. Nësa e çonin lehtas para duersh,Drenashi hapi mundshëm sytë e pau se si e ulnin ngadalë në skajin e hapësinës së nëndheshme mbi shtrojen e pregatitun mapare me gjeth të njomë lari të stërpikun me uthull. Në përpjekje me atë lagshtinë djegëse i ra Drenashi përsëri të letit. Plakëza e vogël mori t'i lajë e t'i mjekojë varrët e çeluna të korpit pa shqisa,të shtrimë shakull,si me qenë tue e pregatitë për vorrim. Besimtarët u ndanë në heshtje. U zhdukën ashtu si kishin ardhë në të gjitha drejtimet tue i hapë vetes shteg nëpër shkallë guri e kthina të thella për nën tokë,kush me dritë kandili tue e mbajtë si tinëz nën palën e petkut në dorë,kush pa të si,për shembull ma të vjetrit që gjatë moteve i kishin mësue shtigjet e përmbrendshme. Këta matnin me hapa të sigurtë,pa dritë pa pishë,në pikën e territ gjatësinë e kthinave tue prekë symbyllas gunga e kthesa,po ashtu si sivëllaznit e parë të cilët kishin ndërtue me dorë të vet skaje e gjije. Nga kjo rrethanë kishte mbetë në fjalë thanja me vështrim të zgjatuem e cila përdorej posaçe në kohnat e krizave dhe të përndjekjeve prej anëtarëve të besimit:pleqtë e dinë rrugën symbylltas në terr e në dritë. Për t'i shpëtue syve të besimtarëve gjithnjë në përvlim të ekstazës,të dy vëzhguesit u ndanë në drejtime të ndryshme,mjerisht pa i pasë lanë njeni-tjetrit një pikë takimi. Humbën edhe ata në terrin e nëndheshëm e dolën jashtë në drejtim të kundërt,kështu që nuk do të ndeshin kurrë ma. Edhe sot e kësaj dite,mbas shumë motesh,i shtihet në andërr Novelistit labirinti i mbushun me murgj dhe në atë tollovi kërkon përethshëm. Folkloristin:e gjen e s'e gjen,si në andërr ma! I flet e s'i përgjigjet dhe me shpejtësi vetime i del gjumi e gjithçka zhduket si vesa përpara diellit. Për t'u shlirue prej ankthit që i kthen kohë mbas kohe në gjumë,Agoni ka kërkue disa herë hymjet në çerdhen e besimit të fshehtë,për t'i thanë vetes:ja,tek asht labirinti i përmbrendshëm! Hyn,shihe e mos andërro ma! Por deri në sot Novelisti s'i ka ra askund për fije të zbulojë derën prej gurit të latuem. Mbas këso përpjekjesh pa rrugëdalje,kundron edhe një herë ledhet e vjetra të Ripës së Poshtme dhe i duket sikur gjithçka,njerëz,tempull e flijim,paskan qenë vërtet andërr. Mund të jetë,rëmon në vete ai,se mbas zhdukjes së kryetarit të tyne kanë rrënue shtëpitë përsipër e faltoren e kanë sigurue nga jashtë tue i murue dyert,në pritje që t'iu vijë dita.

Fragmenti është shkëputur nga pjesa e tretë e romanit, në kohën kur Agonit i duhet të vendosë për shumë gjëra të lëna përgjysëm. Puna e re që mund të fillojë, fati i dashurisë ndaj Soses e të tjera si këto.

Ai bie në kontakt me ritualin ilegal të “dervishëve”, i cili është sa marramendje aq dhe fthellim i ideve të tij.

Estetikisht fragmenti përbën një prej situatave letrare në të cilën mund të kuptohet më mirë aftësia përshkruese e Camajt. Dinamika e lëvizjes së personazheve është e jashtzakonshme. Të gjithë lëvizin si në një shirit filmi që rrotullohet e rrotullohet pa ndalim për të krijuar kështu iluzionin e lëvizjes reale.

Duhet një njohje mjaft e mirë e shqipes burimore, për të kuptuar më në detaj ve primet, ritmin, tonalitetin, thekset dhe së fundi imazhin fantastik të prodhuar nga shkrimtari. Duket se çdo gjë është e bazuar mbi kujtesën e largët ose fantazinë, në të cilën shkrimtari bujarisht kërkon të na bëjë pjesëtarë.

Mjeshtër i fjalës dhe i tekstit shqip Camaj shënon një model të ri të të shikuarit të botës shqiptare, të asaj bote të fshehur për shumëkënd gjatë një periudhe gjysëmshkullore.

Rrathë ...

Romani u botua më 1978. Autori i njohur si lirik, me Rrathët, paraqiti veprën e parë të madhe, prozaike dhe më të gjerë deri atëherë, për të cilën kishte punuar 15 vjet. Romani përbëhet nga tri pjesë: “Rrathë uji”, “Rrathë zjarri”, “Rrathë gjaku”. Pjesët lidhen me njëra-tjetrën përmes figurave kryesore Bacit dhe veçanërisht Agonit. Pjesa e parë fikson paraqitjen e hollësishtme të tyre dhe të personave të tjerë, të cilët prezantohen të gjithë për arsye të ndryshme, në një ditë vjeshte në të njëjtin qytet. Këtu tregohen anët e ndryshme të jetës pasrevolucionare, në një fshat malor të quajtur “Dheu i Arbënit” (Një aluzion i historizuar për Shqipërinë ndën sundimin komunist). Agoni që i përket brezit të ri, nga profesioni agronom, ndërkaq gazetar dhe shkrimtar, dërgohet prej Partisë për një reportazh mbi ardhjen e traktorëve të rinj, si dhe për marrjen e njoftimeve mbi një kundërshtim në thelb të sistemit në Malësi, në fshatin Ripë. Pjesa e dytë, në qendër të së cilës janë ngjarjet dhe përshkrimet e Agonit, fillon me nisjen e tij në Ripë dhe përfundon me mbërritjen e traktorëve atje, pak ditë më vonë. Ndërkaq Agoni ka bërë të dështojnë përpjekjet e ilegalit për të përdhunuar bareshën e bukur Sose, vajzën e virgjër të rapsodit. Pasi Sosen e ka zënë në befasi natën tek burimi, ai do të pushtohet vetë nga dashuria e zjarrtë për të, që përcakton qëndrimin e tij të mëtejshëm. Ai nuk shqetësohet

më për reportazhin dhe heq dorë nga takimet e planifikuara me mësuesen e zgjuar Zojën,së cilës kishte dashur t'i bënte një deklaratë dashurie. Pjesa e tretë vendoset pas mbërritjes së traktorëve. Agoni pushohet nga redaksia dhe pret për një emërim të ri,si agronom. Pas një vizite në kishën e një sekti ilegal në Ripën e Poshtme,rituali i kërcimit,i përgjakshëm,e shtyn atë dhe i zhvillon gjithnjë e më tepër dëshirën për të jetuar me Sosen. Në kohën kur pas shtegtimeve të përbashkëta në male nuk ka mundur të caktojë me të vendin e martesës,e përdhunon. Një bari që qëllon atje i ndalon atij qëndrimin e mëtejshëm ndër male. Agoni shkon në Ripën e Mesme dhe bie në një letargji të thellë,pasi tashmë kishte humbur ndjenjën e kohës. Pas kohës së gjatë të pacaktuar i mbërrin një kërkesë për t'u paraqitur në redaksinë e mëparshme. Drejtori i ri e qorton atë për shkak të tendencës armiqësore të një dorëshkrimi “Shtëpia pas maleve”që është përshtatur si pjesë teatri kukullash me sukses të madh. Para kthimit të tij në Ripë bëhet takimi me Sosen si dhe me regjizorin e teatrit të kukullave. Prej tij Agoni mëson që ai kishte jetuar pothuajse 20 vjet në “ëndërrën e vetmisë”. Romani përfundon me kthimin në Ripën e Mesme të Agonit,të cilit i është zgjuar sërish dëshira për të shkruar. Krahas këtij trajtimi kryesor romani përmban një varg trajtimesh të tjera që tregojnë jetën e popullsisë vendase në periudhën e ndryshimit rrënjësor e të vrullshëm. Këtu qëndron vlera e veçantë në përshkrimin e mënyrës së të menduarit,të ideve dhe motiveve të personave. “Rrathë”u vlerësua si romani i parë psikologjik shqiptar. Krahas kësaj është karakteristik elementi liriko-folkloristik,që shfaqet veçanërisht në përshkrimet e Malësisë e të zakoneve. Krahasimet popullore dhe frazeologjizmat,si dhe një variant i pasur gjuhësor i gegërishtes,fjalori i zgjedhur janë karakteristike për gjuhën e tij. Baza e tregimit qëndron në monologët e pasur,të brendshëm dhe bisedës së gjallë. Tendenca bazë e romanit,që tingëllon në titull,është të tregojë sesi njerëzit janë të lidhur në rrathë të ndryshëm shoqërorë e metafizikë,ku qëndrojnë simbolet e ofruara:uji,zjarri dhe gjaku. Simboli i rrathëve rimerret larmishëm. Kushtet konkrete social-ekonomike qëndrojnë më fort brenda kuadrit të jashtëm. Temat e mirëfillta janë përgjithësisht:natyra,vetmia,humbja e traditës,kërkimi i fatit dhe i suksesit,lidhja me vetë rrënjët. Mbizotërimi i karaktereve poetike letrare dhe komentimi i gjerë i problemeve të gjuhës,letërsisë dhe artit në përgjithësi,mund të përbënin gjithashtu nëntema të veprës artistike. Romani me figurën kryesore Agonin e,me gjithë problematikën e tij në kërkim të identitetit,tregon më në fund se “Ne më kot përfaqësojmë një epokë të re”.

Dranja

“Dranja”u fillua së shkruari rreth vitit 1975 dhe mbaroi më 1979. Është vetë fati i poetit i ngjashëm me fatin e Dranjës, breshkës së mitizuar në madrigalet e tij, perëndeshës së kujtimit të dalë nga Dheu: Po e kapi dikush si për lojë ta marrë me vete ndër dhena tjera, aio mbaron me të tana! Për Dranjen buzëhollë, lëpusha e laknës së huej nuk e ka shijen e duhun e njimsinë e avullit, i cili si me qenë pëlhurë, i mveshet bimësisë buzë Drinit në mëngjes. Larg këtij vendi edhe shpirtin e jep e s’prek gja me gojë”. Breshkë, rruzull më vete “s’prek gja me gojë” dhe “shpirtin e jep”, më vërtetësisht se në metaforë, ashtu si njeriu dhe shpirti i tij, që kur s’ka ç’të prekë me gojë mbahet me ngjizje: kur kujtoi këtë jerm nuk lyp shpjegim të një andrre, por me jepet me rrëmue mbi sende e frymorë të mbrumë me tharmin e gjakut tim. “Dranja”ndonëse nuk është në vargje si madrigali tradicional, në përmbajtje i përket kësaj gjinie dhe si e tillë i kundërvihet trajtave të tjera letrare, të përdorura deri më sot në gjuhën shqipe. Në lexim e sipër, mundësisht të ngadalshëm, duhet patur parasysh se trajta e jashtme, historia e një breshke dhe e rrashtës së saj, lidhen me nënkuptime simbolike, me fjalë të tjera me zbërthimin e përmbajtjes së brendshme apo “teoremës”. Me rëndësi për autorin është fjala e bukur poetike, ku bëhen përpjekje që gjuha t’i përshtatet lakueshëm çdo situatë. “Dranja” është një formë e re letrare për kulturën e shkruar shqiptare. Duke qenë thellësisht vepër simboliste, madrigalet mund të jetojnë edhe si copa më vete.

EQREM ÇABEJ- JETA DHE VEPRA

Gjuhëtari Eqrem Çabej, lindi më 7 gusht 1908 në Gjirokastrë. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes. Në vitin 1921 mbaroi shkollën fillore, më pas ai fitoi të drejtën e një burse, të dhënë nga prefektura e atëhershme të Gjirokastrës për të vazhduar studimet e mesme dhe të larta jashtë shtetit dhe kështu ai nisi, ashtu si edhe të rinjtë tjerë shqiptarë, rrugën e mërgimit në kërkim të diturisë. Studimet e larta i mbaroi për filologji në Klagenfurt (1923-1926), Grac (1927) dhe Vjenë të Austrisë (1930-), ku ndoqi mësimet e Paul Kretschmer, Karl Patsch, Nikolai Trubetzkoy dhe Norbert Jokl. Çabeji filloi të kishte interes të madh në zhvillimin historik të gjuhës shqipe. Në 1933, ai dorëzoi disertacionin e doktoraturës mbi Studime Italo-Shqiptare, në Vjenë. Çabeji u kthye në Shqipëri ku edhe punoi si mësues gjimnazi në Shkodër (1934), Elbasan, Tiranë dhe Gjirokastrë. Pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore, ai vajti në Romë, ku qëndroi deri më Korrik të 1944-s. Atij iu ofrua posti i Ministrit të Kulturës në qeverinë kukull të Rexhep Mitrovicës në vitin 1943, por ai e refuzoi, ai u kthye në Shqipëri në 1944. Në vitin 1947, ai u caktua anëtar i Institutit të Shkencave, instituti paraardhës i Universitetit të Tiranës. Nga 1952 deri më 1957, ai shërbeu si profesor i historisë së Shqipërisë dhe fonetikës historike. Në 1972, ai u bë anëtar themelues i Akademisë së Shkencave. Dëshira për t'u bërë sa më i vlefshëm për atdheun, e nxiti atë që, pas një viti qëndrimi në St. Pölten, vitin tjetër të merrte njëherësh dy klasa të gjimnazit, që e mbaroi shkëlqyeshëm në vitin 1926 në Klagenfurt të Austrisë. Këtu fillon faza kritike për të ardhmen e këtij të riu të talentuar, i ati ishte një gjykatës i diplomuar në Dar-ul-Hukuk të Stambollit. I nisur nga dëshira që i biri të kishte një të ardhme të sigurt, e këshilloi të vazhdonte universitetin për mjekësi, por, i biri kishte tjetër dëshirë. Ai në Universitetin e Vjenës donte të bëhej gjuhëtar. "Gjuhësia është për pasanikët, kurse neve na duhet një zanat që të na sigurojë jetën", i tha i ati prerazi, atëherë djali i bindur u regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Romës. Por këtu ai më fort shkonte të studionte vepra gjuhësore e letrare nëpër bibliotekat romane. Në këto rrethana, babai i urtë e la të lirë të birin të bënte ashtu si donte vetë, por jo edhe pa i thënë: "Paç vetën në qafë, o bir!". Pra, faza vendimtare për të ardhmen e të riut, Çabeji nis atëherë kur ai fitoi „lirinë“ për të ndjekur degën që i pëlqente. Në vitin akademik 1927 –1928 u regjistrua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Gracit, ku ndoqi studimet për dy gjashtëmujorë (semestra).

Pas mbarimit me sukses të studimeve universitare, 25-vjeçar Eqrem Çabej u kthye përfundimisht në Shqipëri, me diplomën e Universitetit të Vjenës në xhep dhe me dëshirën e zjarrtë për t' i vënë dituritë dhe energjitë e tij në shërbim të atdheut. Nga plaga e rëndë e analfabetizmit vuanin mbi 80 për qind e popullsisë, edhe në ato pak shkolla të mesme që mbaheshin në këmbë, niveli i përgatitjes së nxënësve ishte i dobët, me gjithë përpjekjet e mëdha të disa arsimtarëve atdhetarë si Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipoja, Ahmet Gashi, Vasil Vunjau, Kolë Papparistoja, Sotir Papahristoja, Sotir Kuneshka, Minella Karajani, Hysni Babametoja, Gjergj Cancoja etj. Tekstet mësimore ishin shumë të pakta dhe numri i nxënësve nëpër ato shkolla ishte shumë i vogël në krahasim me nevojat të një vendi të prapambetur, siç ishte Shqipëria e asaj kohe. Në këto rrethana u kthye i diplomuari i Universitetit të Vjenës në Tiranë, ku u mor vendimi për ta emëruar nëndrejtor të konviktit “Malet tona”, pranë gjimnazit të Shkodrës, me të drejtën për të dhënë edhe orë mësimi në atë shkollë. Në vitin shkollor 1935 –1936 Çabeji u transferua në shkollën Normale, ku, ashtu si në Shkodër, ka lënë përshtypje shumë të mira jo vetëm për kulturën e gjerë, por edhe për sjelljen dhe lidhjet e tij me nxënësit. Edhe në Normalen e Elbasanit, Çabeji qëndroi vetëm një vit, nga andej u transferua në Ministrinë e Arsimit për t' u marrë me drejtimin e arsimit të mesëm. Me një lutje më datë 17. 12. 1936, drejtuar Ministrisë së Arsimit, ai kërkon që për arsye shëndetësore të transferohet nga ajo degë e të riemërohet si profesor i letërsisë në liceun e Tiranës, por një kërkesë e tillë, më sa duket, nuk u pëlqeu drejtuesve të asaj dege, të cilët vendosën ta hiqnin qafe, duke e dërguar që të mësonte në Shkollën e Plotësimit Ushtarak! Duke vuajtur nga një sëmundje mushkërishe, ai kërkoi që të lirohej nga një detyrim i tillë, por lutja e tij jo vetëm që nuk u mor parasysh, por edhe i solli kokëçarje të tjera. Këshilli i Ministrave të asaj kohe, vendosi që Çabeji, pas mbarimit të Shkollës së Plotësimit Ushtarak, të transferohej si profesor në Gjirokastër dhe që, po të tregonte shenja të tjera të padëshiruara, kundër tij të merreshin masa edhe më të rënda. Gjatë vjetëve 1938 –1939 e gjejmë përsëri arsimtar, kësaj radhe në Gjirokastër, ku vazhdoi të jepte mësimin e letërsisë të bashkërenduar me elementet e gjuhës shqipe. Në vitin shkollor 1939 – 1940, Çabeji u transferua në gjimnazin e Tiranës ku u emërua si drejtor i shkollës. Me sa duket, autoritetet pushtuese (fashistët pushtues italianë në Shqipëri) shpresonin ta bënë për vete këtë profesor me kulturë, që kishte fituar emër të mirë me studimet dhe botimet e tij, por u gabuan, ai ishte njeri që nuk gënjehej nga të joshurat e armiqve dhe nuk bëhej në asnjë mënyrë vegël e tyre. Në këto rrethana autoritetet pushtuese italiane e larguan Çabejin nga Shqipëria, duke i gjetur një “punë shkencore“ pranë Akademisë së Shkencave

në Romë. Këtu ai e shfrytëzoi qëndrimin e tij të mbikëqyrur, për të punuar për Atlasin gjuhësor shqiptar. Gjatë qëndrimit në Romë autoritetet italiane më 1942 dhe gjermanët më 1943 i propozuan që të bëhej ministër i Arsimit në qeverinë kuisling (person që vihet në shërbim të pushtuesit dhe që e tradhton popullin e vet) të Tiranës, por ai nuk e pranoi. Lidhur me këto propozime ai shkruan, ndër të tjera, në autobiografinë e tij: “Kam hedhur poshtë çdo propozim për bashkëpunim me të huajin, çdo gjë që nuk pajtohet me nderin tim si shqiptar dhe me të mirën e vendit e të popullit”. Në Romë Çabeji qëndroi deri në korrik të viti 194. Pas çlirimit të Shqipërisë edhe për Çabejin fillon një jetë me perspektiva të mëdha. Ai filloi të mbajë ligjërata nga lëndët linguistike dhe albanologji në Shkollën e Lartë të Tiranës, qysh më 1946, vazhdoi punën pedagogjike edhe më pas në Institutin Pedagogjik katërvjeçar dhe sidomos në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, që u ngrit mbi bazën e Institutit katërvjeçar në kuadrin e Universitetit të Tiranës, që u krijua në vitin 1957. Këtu ai zhvilloi për shumë vjet lëndën Hyrje në Historinë e Gjuhës Shqipe dhe Fonetika historike e shqipes, për të cilën hartoi edhe tekstin përkatës, që është ende në përdorim. Në veprimtarinë gjysmëshekullore të Çabejit vendin kryesor e zë pa dyshim prodhimtaria e tij e pasur shkencore, e cila mund të ndahet në dy faza kryesore: faza e parë vazhdon deri në prag të çlirimit të Shqipërisë dhe faza e dytë nis pas vitit 1945. Veprimtaria e tij shkencore gjatë këtyre dy fazave është e kushtëzuar jo vetëm nga interesat e tij shkencore, por edhe nga punët që ishte ngarkuar të kryente. Sidoqoftë, në fazën e parë ai është marrë edhe me studime thjesht shkencore edhe me botime të nevojshme për shkollën e mesme. Në prodhimtarinë e tij të asaj faze bie në sy një interesim i madh jo vetëm për gjuhësinë, por edhe për folklorin e letërsinë artistike, me një anim të lehtë nga kjo fushë e dytë, e kjo duket qartë edhe nga titujt e botimeve të tij të kësaj periudhe, kur krahas studimeve thjesht gjuhësore ka botuar edhe studime nga fusha e folklorit dhe e letërsisë, ose edhe studime me karakter të përzier gjuhësor e letrar.

Studime gjuhësore

*“Tekste italo-shqiptare”, (1935).

*“Elemente dialektore nga Italia”.

*“Marrëdhëniet midis shqipes dhe rumanishtes”.

*“Shprehje dhe frazeologji paralele në gjuhët ballkanike”.

Letërsia dhe folklori

- * Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare.
- * Zakone dhe doke të shqiptarëve.
- * Konstandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut.
- * Për gjenezën e literaturës shqipe.
- * Kultit dhe vijimi i hyjneshës Diana në Ballkan.

Veprat

1. “Hyrje në Indoevropianistikë”
2. “Studime etimologjike në fushën e shqipes”, Tiranë, 1976, 1999.
3. “Hyrja në historinë e gjuhës shqipe”, Tiranë, 1958.
4. “Fonetika historike e shqipes”, Tiranë, 1968
5. “Shqipja në Kapërcyell”
6. “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”
7. “Meshari” i Gjon Buzukut, Tiranë, 1968
8. “Fjalor i gjuhës shqipe”, 1954

<http://floripress.blogspot.com/2011/01/eqrem-cabej-jeta-dhe-vepra.html>

ISMAIL KADARE, SHKRIMTARI EPOKË I SHQIPTARËVE

Sema Kaygusuz (1972) me romanin “Rënia e namazit” përfaqësoi letërsinë turke në konkurrimin për çmimin letrar “Balkanika 2008”. Ajo është autore e vëllimeve me tregime dhe e një romani. Tregimet e saj janë vlerësuar me çmimin e parë në konkursin “Cevdet Kudret”. Ismail Kadare (1935) me romanin “E penguara” përfaqësoi letërsinë shqipe në konkurrimin për çmimin letrar Balkanika 2009. I përkthyer në shumë gjuhë, fitues i “Man Booker International” (2005), Princi i Asturias për Letërsinë (2009) dhe i përmendur prej vitesh në listën e kandidatëve të mundshëm për çmimin Nobel. Shkrimtari Ismail Kadare nderohet në Itali. Çmimi Lerici Pea, që këtë vit shënon edicionin e tij të 57-të, iu dha poetit dhe shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare,... 4 herë kandidat për çmimin Nobel, anëtar nderi i Akademisë Franceze, Kadare nisi të shkruajë poezi që në shkollën e mesme, në qytetin e tij të lindjes Gjirokastrë. Shkrimtari Ismail Kadare nderohet në Itali. Ismail Kadare, një ndër shkrimtarët më të mëdhenj të letrave shqipe, kandidat i çmimit Nobel në letërsi, lindi me 28 janar të vitit 1936 në Gjirokastrë. Ai është autor i romaneve “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, i përkthyer të paktën në tetë gjuhë të botës, “Muzgu i perëndive të stepës”, “Koncert në fund të dimrit”, dhe i një serie vjershash, përmbledhjesh, novelash dhe poezish. Kadare është nderuar me titullin e lartë “Nderi i Kombit”, ndërsa bën pjesë në Akademinë Franceze ndër 12 anëtarë-shok të huaj të kësaj Akademie, apo edhe i Akademisë së Berlinit.

Ismail Kadare kaloi fëmijërinë në qytetin e gurtë të Gjirokastrës dhe jeta mitike që ofron ky qytet duket se la gjurmë të thella në gjithë jetën dhe krijimtarinë e tij. Shkollën e mesme e kreu në gjimnazin “Asim Zeneli”. Më pas kreu studimet e larta në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, pastaj në Institutin “Gorki” të Letërsisë Botërore në Moskë. Kadareja ka punuar në gazetën “Drita”, e më pas drejtoi revistën “Les lettres albanaises”. Përgjithësisht vepra e Kadaresë është e sunduar prej mitit të së shkuarës, evokimit të lavdisë së dikurshme. Kadare synon ta çlirojë njeriun shqiptar prej akuzash që e kanë ndjekur nder shekuj, duke përfshirë akuzën si popull i lindur me instinktin e

luftës dhe të mercenarizmit, binjak me armen dhe peng i saj. Raporti midis jetës dhe vdekjes, midis të gjallëve dhe varreve, midis brezit që shkoi dhe atij që vjen, një nga raportet me thelbësore të qenies njerëzore, përben një rregullator të mbifuqishëm të gjithë yllësisë së veprave të Kadaresë. Synimi parësor i çdo letërsie serioze që të qëndrojë mbi kohën dhe hapësirën zuri vend kryesor që te romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”.

Sa shumë i përkthyer

Vepra e Ismail Kadaresë është përkthyer në 32 gjuhë të huaja, duke arritur kështu një rekord të përhapjes në tërë botën e qytetëruar. Në fushën e prozës, Ismail Kadare ka lëruar tregimin, novelën dhe romanin. Prozën e tij e karakterizojnë përgjithësimet e gjëra historiko-filozofike, subjekti i ngjeshur dhe mendimi i thellë i shprehur shpesh me anë të parabolës, mbi bazën e asociacionit apo të analogjive historike. Ideja e romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1964) është shpirti liridashës i popullit shqiptar. Temën e shpirtit të pamposhtur të shqiptarëve nëpër shekuj autori e trajtoi edhe në romanin Kështjella (1975). Në romanin “Kronikë në gur” (1970) Kadare kritikoi psikologjinë provinciale, ndërkohë që probleme të rëndësishme të historisë janë trajtuar edhe në përmbledhjet me tregime e novela “Emblema e dikurshme” (1977), “Ura me tri harqe” (1978) dhe Gjakftohtësia (1980).

E veçanta e tij, këndvështrimi

E veçanta e Ismail Kadaresë shfaqet sidomos në trajtimin, nga një këndvështrim i ri, i temës historike dhe në tingëllimin e mprehtë actual, që është i aftë t’i japë asaj. Një nga krijimet më të shquara të Ismail Kadaresë dhe të të gjithë letërsisë së re shqiptare është romani “Dimri i madh” (1977). Veprat më të mira të Ismail Kadaresë janë përkthyer në shumë gjuhë të botës dhe janë pritur shumë mirë nga publiku lexues. Por edhe poezia e Ismail Kadaresë është një prej zhvillimeve më novatore në vjershërimin shqip gjatë një gjysmë shekulli. Ajo shprehu vendosmërinë e shkrimtarëve të brezit të viteve ‘60, për të realizuar qëllime estetike të ndryshme prej paraardhësve.

Fillesat epiko-lirike

“Frymëzime djaloshare” (1954), “Ëndërrimet” (1957), “Ëndërr industriale” (1960), “Shekulli im” (1961), “Poemë e blinduar” (1962), “Përse mendohen këto

male” (1964), “Shqiponjat fluturojnë lart” (1966), “Motive me diell” (1968), “Koha” (1976), “Shqipëria dhe tri Romat”, përbëjnë titujt kryesorë të veprës poetike të Kadaresë. Ismail Kadare, në periudhën e parë të krijimtarisë së tij, u tërhoq pas poemës epiko-lirike. Në prirjen e përgjithshme ai nuk u shkëput prej frymës monumentalizuese të poezisë së mëparshme, por e kushtëzoi këtë me tipin e njeriut shqiptar, të historisë së tij kombëtare, të fatit të tij nëpër shekuj. Thujse në të gjitha poemat e shkruara në vitet ‘60 -’70 ka një gërshetim të mjeteve të reja të të shprehurit me mënyrën tradicionale të të vështruarit të jetës dhe të historisë.

Poezi e qartë, pa ekuivoke

Poezia e Kadaresë, ndryshe prej prozës së tij, është përgjithësisht e qartë, pa ekuivoke, shpesh marciale, thujse përherë optimiste. Ajo, në kritikën zyrtare, është pritur si pasurim problematik i poezisë shqipe, veçanërisht me temën e qëndresës shumëshekullore të popullit shqiptar në rrugën e tij të gjatë të historisë. Poezia e tij është poezi e sfidave të mëdha shqiptare. Ajo është e përshkuar nga qëndrimi hyjnizues ndaj historisë kombëtare, ndaj lavdisë së tyre, ndaj tokës së të parëve, ndaj gjuhës shqipe.

Qëndresa hyn në poezinë e Kadaresë qysh prej kohërave antike, deri në periudhat më të afërta të historisë. Veçmas ajo lidhet me “Motin e madh”, të epokës së Gjergj Kastriotit. Por Kadare hyjnizoi një periudhë më të hershme se kjo, që ishte mitizuar me herët prej Rilindjes Kombëtare: periudhën e humanizmit evropian (siç mendon shkenca e historisë, kjo periudhë e gjeti Shqipërinë në të njëjtën shkallë zhvillimi me anën tjetër të Adriatikut), e cila pati shprehjen e saj dhe në njeriun dhe qytetërimin shqiptar. Poema epiko-lirike shqipe arriti një nivel të lartë afirmimi me vepra të tilla të I. Kadaresë, si “Përse mendohen këto male” dhe “Shqiponjat fluturojnë lart”, pastaj me “Shekulli i 20-të”, “Poemë e blinduar”, “Shqipëria dhe tri Romat” e vepra të tjera.

Edhe abstraksion

Poezia e Kadaresë është e prirur drejt sintetizmit dhe abstraksionit. Në këtë cilësi poezia e Kadaresë të sjell ndërmend vjershërimin e Migjenit. Sintetizmi shfaqet në mungesën e çfarëdo subjekti apo elementi të subjektit. Poemat e Kadaresë, përgjithësisht poezia e tij, janë art mendimi, pa elemente të rrëfimit (narracionit). Si të tilla, si poema mendimi, ato ofrojnë shumësi leximesh, në kohë dhe në mjedise të ndryshme.

Gjithashtu poezia intime e Kadaresë përshkruhet nga malli për qytetin e lindjes, për njerëzit që lanë gjurmë në fëmijërinë e tij, për atdheun kur ndodhet larg tij, për kohën studentore, vajzat dhe rrugët e Moskës kur është në atdhe dhe mbi të gjitha, për vajzën që lë gjurmë në shpirtin e tij, por që përgjithësisht ndodhet larg.

Protagonist dhe në jetën politike

Është fakt që Kadare ka qenë dhe është protagonist i jetës politike dhe i mendimit të vendit qysh prej viteve '60. Edhe pse në fund të vitit 1990, Kadare u largua së bashku me familjen në Paris, ai mbajti lidhje me Shqipërinë. Ai është një nga personalitetet më të shquara të kulturës shqiptare, ambasador i saj në botë, është shkrimtari që i ktheu mitet legjendare në realitet, shkrimtari që bëri histori prej prehistorisë; pa rënë në kundërthënie me vetveten dhe gjykimin modern, ai arsyetoi estetikisht në mënyrë të përkorë dhe për kohën absolute. Në Shqipërinë e ndodhur në udhëkryq vepra e Kadaresë ka qenë dhe mbetet një shpresë apo një ogur i bardhë për të. Ismail Kadare është autor i shumë veprave në poezi e prozë, laureat i shumë çmimeve kombëtare, kandidat i çmimit Nobel për shumë vite me radhë, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Anëtar i Akademisë Franceze të Shkencave Morale.

Vepra të Kadaresë:

Kandidati i çmimit Nobel në letërsi është autor i romaneve “Gjenerali i ushtrisë vdekur”, i përkthyer në tetë gjuhë të botës, “Muzgu i perëndive të stepës”, “Koncert në fund të dimrit”, dhe i një serie vjershash, përmbledhjesh, novelash dhe poezish etj. Lexoni më poshtë veprat gjeniale të kësaj pene të rrallë...

Frymëzime djaloshare - 1954
Shekulli im - (1961)
Gjenerali i ushtrisë së vdekur - roman- 1963
Përse mendohen këto male - 1964
Dasma - 1968
Motive me diell - (1968)
Kështjella - roman - 1970
Kronikë në gur - roman - 1971
Koha (1976)
Dimri i madh - roman - 1977

Ura me tri harqe - 1978
Prilli i thyer - 1980
Gjakftohtësia - përmbledhje novelash - 1980
Koha e shkrimeve - 1986
Koncert në fund të dimrit - 1988
Vepra Letrare - 1981-1989
Dosja H - 1990
Piramida - 1992
Hija-1994
Shqipëri - 1995
Pallati i ëndrrave - 1996
Dialog me Alain Bosquet - 1996
Spiritus - roman- 1996
Kushëriri i engjëjve - ese- 1997
Poezi - 1997
Kombi shqiptar në prag të mijëvjeçarit të tretë - ese- 1998
Tri këngë zie për Kosovën - triptik - 1998
Ikja e shtërgut - tregim - 1999
Qorrfermani - roman - 1999
Vjedhja e gjumit mbretëror - tregime - 1999
Ra ky mort e u pamë - ditar për Kosovën, artikuj, letra - 2000
Kohë barbare (Nga Shqipëria në Kosovë) - biseda - 2000
Breznitë e Hankonatëve - 2000
Bisedë përmes hekurash - 2000
Elegji për Kosovën - 2000
Lulet e ftohta të marsit - roman - 2000
Unaza në kthetra - 2001
Eskili, ky humbës i madh - 2001 (ribotim)
Qyteti pa reklama - roman - 2001
Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut - roman - 2002
Pasardhësi - roman - 2004
Identiteti evropian i shqiptarëve - 2006
Hamleti, princi i vështirë - Sprovë - 2006

Përkthimi i veprave të Kadaresë në gjuhë të ndryshme të botës:

1. Gjenerali i ushtrisë së vdekur - 28 gjuhë
2. Kronikë në gur - 15 gjuhë

3. Pallati i Ëndrrave - 15 gjuhë
 4. Kështjella / Daullet e shiut - 14 gjuhë
 5. Prilli i thyer - 13 gjuhë
 6. Dosja H. - 12 gjuhë
 7. Piramida - 12 gjuhë
 8. Kush e solli Doruntinën - 11 gjuhë
 9. Tri këngë zie për Kosovën - 11 gjuhë
 10. Ura me tri harqe - 9 gjuhë
 11. Pashallëqet e mëdha / Kamarja e turpit - 8 gjuhë
 12. Koncert në fund të dimrit / Koncerti - 7 gjuhë
 13. Dasma / Lëkura e daulles - 7 gjuhë
 14. Përbindëshi - 7 gjuhë
 15. Lulet e ftohta të marsit - 7 gjuhë
 16. Muzgu i perëndive të stepës - 5 gjuhë
 17. Nga një dhjetor në tjetrin / Pranverë shqiptare - 5 gjuhë
 18. Nëntori i një kryeqyteti - 5 gjuhë
 19. Dimri i vetmisë / Dimri i madh - 4 gjuhë
 20. Eskili, ky humbës i madh - 4 gjuhë
 21. Viti i mbrapshtë - 3 gjuhë
 22. Spiritus - 3 gjuhë
 23. Nata me hënë - 3 gjuhë
 24. Vajza e Agamemnonit - 3 gjuhë
 25. Pasardhësi - 3 gjuhë
 26. Shkaba - 2 gjuhë
 27. Qorrfermani - 2 gjuhë
 28. Ftesë në studio - 2 gjuhë
 29. Hija - 2 gjuhë
 30. Qyteti pa reklama - 2 gjuhë
 31. Ikja e shtërgut - 2 gjuhë
 32. Legjenda e legjendave - 1 gjuhë
 33. Dialog me Alain Bosquet - 1 gjuhë
 34. Ra ky mort e u pamë - 1 gjuhë
 35. Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut - 1 gjuhë
 36. Pesha e kryqit - 1 gjuhë
 37. Kohë barbare - 1 gjuhë
 38. Katër përkthyesit - 1 gjuhë
 39. Stinë e keqe në Olimp - 1 gjuhë
 40. Poezi - 1 gjuhë
- Etj.

NË SHENJË RESPEKTI PËR SHKRIMTARIN TONË TË MADH, AZEM SHKRELIN (1938-1997)

Drejtuesit komunalë i kanë bërë për nesër(24 maj 2011)përgatitjet për edicionin e 9-të të takimeve letrare “Azem Shkreli”, një aktivitet tradicional kushtuar letërsisë që mban emrin e poetit të njohur nga Rugova e Pejës.

Znj.Shpresa Gjonbalaj,drejtoreshë për kulturë në KK Pejë ,ka paraqitur programin e këshillit organizues dhe orarin e aktiviteteve.

“Edhe këtë vit kemi parashikuar një manifestim me program të larmishëm dhe me pjesëmarrje të autoriteteve me rëndësi në takimet tona”,ka thënë drejtoresha Gjonbalaj,duke shtuar se të martën më 24 maj fillon aktiviteti.

Programi i aktiviteteve përmban orë letrare me poetët e rinj të shkollave fillore të Pejës,një tribunë tematike “Komunikimet ndërshqiptare në fushën e botimeve dhe letërsisë”,në të cilën janë paralajmëruar pjesëmarrja e akademikut Mehmet Kraja,poetit nga Shqipëria,Agron Tufa,shkrimtarit shqiptar nga Maqedonia,Kim Mehmeti dhe shkrimtarit e publicistit pejan,Sejdi Berisha.

Manifestimi qendror mbahet në orën 14:00 në teatrin “Istref Begolli” në Pejë,me programin artistik dhe deklamimin e poezive nga autorë të njohur.

Azem Shkreli zë vend në krye të poezisë aktuale shqiptare. Krahas cilësisë,poezia e Shkrelit shënoi kthesë në rrjedhat e poezisë në Kosovë:e zgjeroi spektrin tematik;e subjektivizoi dhe intimizoi heroin lirik dhe çka është më me peshë,solli një ndjesi të re,të mprehtë ndaj gjuhës,ndaj fjalës. Kështu,ajo i hapi rrugë bindshëm poezisë së viteve pesëdhjetë,të ngarkuar me patosin e euforisë kolektive.

Azem Shkrelí lindi më 1938 në Rugovë të Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje,ndërsa në Prishtinë ai vazhdoi shkollën e mesme për të vazhduar fakultetin Filozofik,degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Për shumë vjet ai ka qenë kryetar i shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës,drejtor i Teatrit Krahinor në Prishtinë dhe themelues e drejtor i Kosova Filmit. Vdiq në pranverën e vitit 1997. Ka botuar këto vepra në poezi Bulzat (1960), Engjujt e rrugëve (1963),E di një fialë prej guri (1969),Nga bibla e heshtjes (1975),Pagëzimi i fjalës (1981),Nata e papagajve (1990),Lirikë me shi (1994),Zogj dhe gurë (1997). Në prozë:Karvani i bardhë (1961),Sytë e Evës (1975),Muri përfundi shqipes Shtatë nga at,si dhe dramat:Fosilet (1968),Varri i

qyqes (1983) etj. Poezitë e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të huaja. Shfaqja e Azem Shkrelit si poet, përpos që përputhej me ardhjen e talentit të fuqishëm, shënonte njëkohësisht kthesën e parë drejt hapjes dhe modernizimit të poezisë shqipe të Pasluftës. Shkreli u ngjít natyrshëm në kulmet e poezisë së sotme shqiptare dhe këtë vend ai e konsolidoi dhe e përforcoi nga njëra vepër poetike në tjetrën, deri në atë të fundit, që e la dorëshkrim “Zogj dhe gurë”, botuar më 1997.

Veprimtaria në poezi dhe në prozë e Azem Shkrelit në fund të viteve pesëdhjetë dhe në fillim të gjashtëdhjetave, shënon kthesë cilësore dhe kthesë në praktikat krijuese letrare. Gjatë viteve pesëdhjetë, si gjimnazist, Azem Shkreli, ka mundur të lexojë nga letërsia e kohës në gjuhën shqipe një poezi tematikisht të kufizuar, me strukturë dhe sajim artistik gjuhësor pa origjinalitetin e duhur. Në prozë gjendja ishte edhe më e varfër. Me përjashtim të ndonjë emri, (Hivzi Sulejmani) ajo pak prozë e autorëve jo fort të talentuar, kryesisht trajtonte tematikën e luftës dhe të fitores përmes rrëfimit klishe bardh e zi dhe të metodës së realizmit socialist. Kështu Azem Shkreli shënoi kthesën e parë më të rëndësishme në poezi, në radhë të parë, duke e çliruar Unin lirik intim nga ai kolektiv, duke selitur në të temën e dashurisë për vendlindjen dhe duke portretizuar njeriun e truallit rugovas, me ngjyrimet e traditës dhe të lashtësisë, dashurinë për vashën, lirikën peizazhiste, etj. Nga ana tjetër thyerjen e parë të madhe në letërsinë shqiptare, kosovare, Shkreli e bëri me romanin “Karvani i bardhë” si edhe me tregimet e përfshira në vëllimin “Sytë e Evës”, që qëndrojnë ndër më të realizuarat në prozën tonë të shkurtër...

Lirikat e para

Vendlindja, natyra dhe njeriu i Rugovës së Dukagjinit, portreti shpirtëror i tij, do të jenë frymëzimi kryesor i poezisë së Azem Shkrelit të shtrira brenda viteve gjashtëdhjetë. Frymëzimi që ngjizet mbi këtë hapësirë e që është kthim i shpeshtë i poetit, nuk është konvencional e aq më pak pozë: nuk ka në të patetikë malli dhe mallëngimi që djeg, “më të bukurin vend”... Bota e vendlindjes së poetit është e pranishme si botë e njerëzve, si besim dhe parim etik, si ashpërsi dhe krenari, si individualitet i papërsëritshëm me hapësirat e tjera, si filozofi jetësore, si raport ndaj lindjes, jetës, vdekjes, dashurisë, si raport ndaj dasmës dhe festës, ndaj punës dhe natyrës, ndaj zotit dhe, sidomos ndaj fjalës. Në këtë frymë janë poezitë e ciklit “Këngë për vete” të shkruara në fund të viteve pesëdhjetë dhe që, së bashku me një tufë poezish të tjera, do t’i emërtojmë si autoportret poetik. Tek poezitë e ciklit “Dukagjinçe” mund të përmendim disa poezi portrete të vendlindjes që shënojnë kulmin artistik të poetit si: “Dukagjinge”, “Vdekja

e Malësorit”, “Bregu i mollës”, “Shkëmbi”, “Lumi” etj. Te poezia “Vdekja e malësorit”, përmes përqasies poetike vihen pranë e pranë tri majat: e malit, e lisit dhe e Malësorit. S’ka lot, s’ka kujë në këtë vdekje, se atëherë rrezohen lisat, shemben majat dhe shterrin krojet. Dhe, s’ka vdekje këtu: vetëm se harroi perëndimin dita në sytë e Malësorit, ndërsa mendimi i vrugët dhe i ftohtë ndër vetulla, është ai që shquhet. Ndërsa poezia “Bregu i mollës” edhe si strukturë vargu, si frymëzim dhe poetikë, është realizuar fare ndryshe nga poezia e mësipërme. Ajo është konceptuar si një rrëfim që rrjedh përnjëherë dhe furishëm, thuajse pa të lënë rast të marrësh frymë. Është njëri nga kthimkërkimet më dramatike të poetit pas gjurmëve të dikurshme që, përfundimisht i ka fshirë koha. Të pashlyera, të njëjta në atë kthim janë vetëm retë shtegtare, të përjetshme në shtegtimin e tyre, sfiduese përballë shtegtimit kalimtar, përballë gjurmëve të fshira pamëshirshëm. Në këtë kontekst mund të përmendet dhe poezia “Lumi”, i cili sikur merr pjesë në këtë komplot kundër poetit, po dhe ai fsheh diç të kaltër dhe të urtë në thellësitë e veta, por që s’do ta thotë. Nga vargjet e poezisë “Shkëmbi” reflekton njëjzëzimi maksimal në mes të portretit, natyrës së vendlindjes dhe individualitetit të Unit lirik.

Lirikat e dashurisë

Dashurinë për vashën, poezia e Azem Shkrelit e ka emocion, dhembje të brendshme, të pazëshme. Fjala është për një cikël jovëllimor poezish, të zëna dhe të lindura, mbase nga një dashuri e pafat e poetit, që përjeton dramë dhimbjesh të thella. Vasha para një udhëkryqi dramatik zgjedh largimin përfundimtar. Vargjet e lindura nga ky detaj jetësor, ngarkohen kryesisht vetëm me një refleks emocional: dhimbjen e poetit pas ndarjes. Edhe për përmasat e emocionit, për figurën, portretin e vashës, poeti gjen ndonjë detaj të rrallë që s’është qëllim në vete, por në funksion të tendosjes dramatike të folësit lirik. Dhembjen e kësaj plage autori parapëlqen ta mbajë të heshtur, vetëm për vetveten dhe, kur ajo kërcënon të dalë jashtë kontrollit, e ndrydh brenda, si një therrje, plagë fizike. Në këto poezi ndjehet gjendja shpirtërore e poetit, supozohen rrethanat, mjedisi, si dhe një ecuri kronologjike se si dhe kur kanë lindur poezitë e ciklit në fjalë, që asnjëra nuk ka datë. Fillimi do të ishte si një “Këngë e heshtur” një takim e gëzim rasti, po ashtu pa bujë, lindja e këngës si një “takim pa hiri”, përthithës në çast, por, njëkohësisht i mbështjellë dhe i përcjellë me një parandjenjë të kobshme që pëshpërit si Korbi i Po-së: do ta dua pa e parë. Pason pastaj periudha e një dhimbjeje që therr thellë, duke u përplasur brenda gjirit të vet në një vetmi absolute të Unit lirik. Kjo fazë lidhet me bredhien e ankthshme të poetit përmes tri lirikave: “Liqeni”, “Nata

në kështjellë” dhe “Në Shën Naum”. Liqeni që depërton andej dhe këtej kufirit mbase dhe mund të ofrojë një sinjal, një hollësi për vashën, por ai, indiferent, luan me valët dhe, sikur s’është më as syri i tij as loti i saj, dhe Unit folës në çast, i vjen të zbresë në fundin e tij. Nuk ka ngjyrim patetik, as vaj ngushëllues në këtë dëshirë, ide e mendim, qoftë i një Basti fluturues, i një jehone të largët. I tillë është një trevargësh nga cikli i lirikës së realizuar si autoportret, konkretisht nga poezia me titull “Ç’ka mësova unë”; -Me qeshë pelim me vuajtë, Me dashtë si me vdekë, Me vdekë si me luejtë. Dashuria dhe vdekja në poezinë e Azem Shkreli nuk janë një fjalë goje. Përkundrazi ato qëndrojnë pranë e pranë fare natyrshëm. Poezia “Në Shën Naum” është një tjetër faqe e bredhjeve të poetit rreth e rreth liqenit që e ndan aq mizorisht. Vargjet e poezisë “Nata në kështjellë” vinë si një fund dite e plumbtë, si një thirrje për strehim qetësues, si një refleks për ta heshtur, për ta vënë në gjumë dhembjen. E kjo nuk ndodh. Përkundrazi dhembja roit e përçudnuar dhe poeti, për ta mposhtur, therr faqen e shkëmbit me gishtat e duarve. Poezia kurorë e ciklit pa dyshim është “Në vend të përshëndetjes”. Para kësaj, një si këndellje, vërehet që në vargjet e poezisë “Para elegjisë”, ku uni lirik sikur e parandjen jehonën e qëndrimit nëpër kohët që vinë. Por përmes vargjeve të poezisë “Në vend të përshëndetjes” poeti do të shpërthejë si klithje dhe anatëmë. Në këtë poezi antologjike vihet re një përplasje e brendshme udhëkryqesh, përplasje përjashtuese, emocionesh në momente të kundërta, që rrjedhin furishëm. Vërehet një konflikt dramatik: aq sa zëri lirik përpëlitet të çlirohet nga kjo magjepsie totale, që kullon dhimbje e ankth. Aq më shumë e ndien ai praninë e saj, të shikimit të saj, “në shtegballin e vet”. Ndjehet se stuhia në këtë poezi, turret si e verbër, herë në një drejtim e skajshmëri, herë në të kundërtin.

Lirikat atdhetare

Azem Shkreli është një nga lirikët më modernë në llojin e poezisë patriotike. Nuk ka eufori në atë poezi, as përbetime e dëshmi atdhetarizmi që, në këtë fund shekulli janë aq me tepriçë në poezinë tonë. Brenda këtij harku tematik poeti me guxim denoncon cenet dhe veset shqiptare, dje dhe sot, duke e ruajtur besimin në substancën e shëndoshë të qenies. Ndjenja e atdhedashurisë shtrihet gati në tërësinë e veprës poetike të Azem Shkreli. Ajo dallohet thekshëm tek frymëzimet poetike të ngjizura nga drama kosovare dhe shqiptare, sidomos të viteve nëntëdhjetë. Në këtë tematikë sidomos shquhen dy veprat e fundit të poetit, “Lirikë me shi” dhe “Zogj dhe gurë”. Nga tërësia e vargjeve atdhetare reflektohet një urti e thithur nga e kaluara, nga tradita dhe lashtësia historike, nga bota shpirtërore kolektive, që i sfidon krizat aktuale morale dhe shpirtërore të shqiptarëve.

Si poezi atdhetare,pjesërisht mund të konsiderohen edhe ato përsiatëse,të llojit “Meshë” apo “Dhiatë e re”. Tek e para përmes një loje fjalësh që,vetëm duke i ndërruar vendet,tek tri vargjet e poezisë, shquhet zëri,në frymë biblike,i vendosur, i prerë në mbrojtje të Dheut dhe qëndrimi shpirtëror e intelektual i poetit ndaj tij. Ajo që e dallon poetin nga shumica e autorëve të lirikës patriotike aktualisht është ndjenja ndaj fjalës dhe e shqiptimit poetik të përmbajtur në emocione;është ndjenja e masës,ndjenja për të mos u rrëmbyer nga brohoritja kolektive në çastet dramatike për fatin e kombit,siç janë vitet nëntëdhjetë. Këto tipare sidomos shquhen tek vëllimi i parafundit i poetit “Lirikë me shi”. Në këtë kontekst,do të veçojmë poezinë e poetit të lënë në dorëshkrim e që lidhet me ngjarjet e pranverës shqiptare të vitit 1997:“Këngë e turpshme”. Cikli i kësaj lirike,në këtë përzgjedhje prezantohet me poezitë “Psalm për Kosovën”,“Origjina”, “Arkeologji”,“Meshë”,“Sogje”, “Zgjim”,“Motiv optimist”,“Ndërtimi i kullës”,të cilat dallohen për shtresime të rralla gjuhësore e poetike.

Lirikat refleksive

Në lirikën e Azem Shkrelit nuk mund të bëhet diferencim i prerë ndërmjet llojeve të lirikës. Substanca përsiatëse,refleksive është e pranishme dhe tek poezitë atdhetare dhe tek ato historike,intime,të vendlindjes,etj. Cilido qoftë frymëzimi poetik,në ecje,gjatë artikulimit gjuhësor të poezisë,vargu ngarkohet me refleksë kategorish nga ekzistenca dhe metafizika. Çdo dukuri në këtë poezi është në lidhje me tërësinë e universit dhe ka kuptimin apo pakuptimësinë e kësaj tërësie. Në këtë lirikë është më i pranishëm synimi për të shtruar pyetje,përmes të cilave ndriçohen kategori metafizike të rëndësishme,jepen sugjerime të tërthorta drejt përgjigjeve që asnjëherë nuk janë të prera,përfundimtare. Rëndom,në atë pjesë të lirikës ku substanca filozofike është më e theksuar,mbesin të hapura dilemat,udhëkryqet në jetë,duke e nxitur dhe pasuruar spektrin asociativ e meditativ të lexuesit. Lindja e kësaj pjese të lirikës,lidhet me çaste dëshpërimi me çaste zhgënjimi poetik nga ligjshmëria e gjithësisë, nga njerëzit,ku s’pushon të gjallërojë një besim,sado i largët ndjehet ai,sia ndodh tek vargjet e poezive “Ajo që s’e them”,“Pagëzim i fjalës”, “Kafshë e zezë”,“Këngë e vrugut”...Një dëshpërim e zhgënjim i thellë i ditëve të fundit të poetit vërehet tek poezia “Përshëndetje me miq”,ndërsa poezia pak më e gjatë “Letër një miku”lidhet me një brengë më të hershme të poetit. Vargjet tek të cilat rrezaton dhe besimi e shpresa për ndreqjen e botës dhe të njerëzve, pra dhe të shqiptarëve,janë më të shpeshta në këtë rreth tematik. Në çaste

të tilla të rralla, poeti parapëlqen të tërhiqet, të strehohet tek hapësirat e pastra, të virgjëra, siç ndodh me llojin e poezisë “Motive të verdha”. Poezitë më të arrirra të kësaj natyre lidhen me trajtat e heshtjes dhe të fjalës, me përthyerjet e tyre në kontekste të ndryshme, qofshin këto sfiduese dhe provokuese, të përditshme dhe të përjetshme. Përshkohet, në këtë cikël lirik, urtia e fjalës dhe e heshtjes, kriza dhe shansi i tyre në rrethana të ndryshme, forca njëherëshe dhe shkatërruese e tyre. Përmes fjalë-heshtjes, në lirikën e vet mendimtare, poeti portretizon kohën e fjalamanëve dhe të heshtakëve aktualë, portretizon njerëzit, bartësit e përditshëm të tyre. Po ashtu brenda këtij rrethi frymëzues Azem Shkrelit arriti majat e artit poetik, për arsye se vetë natyra krijuese e tij është më pranë dhe më e prirur drejt meditimeve filozofike. Në këtë fushë, është pa dyshim poeti më i fuqishëm në letërsinë e sotme shqiptare.

Poetika

Veti parësore e poezisë së Azem Shkrelit është dendësia e mendimit, ngarkesa dhe tendosja emocionale, të cilat nuk janë sajime mekanike, as rezultat i reduktimeve dhe i shkurtimeve sasiore të mjeteve shprehëse. Dendësia në të gjitha shtresimet poetike është në natyrën krijuese të poetit. Kjo natyrë krijuese e ka të mprehtë ndjeshmërinë ndaj fjalës, nga e cila shtrydh të pamundshmen. Duke u vendosur në kontekste të caktuara, fjala, figura, fraza, në këtë poezi aftësohen maksimalisht për të zënë dhe për të bartur në rrjetën e tyre, mendime dhe nuanca mendimesh, emocione, imazhe përfytyrimi dhe imagjinate nga më të nuancuarat dhe nga më të ndërlikuarat. Karakteristikë tjetër është gdhendja mjeshtërore e vargut dhe e frazës poetike. Duke qenë jashtë konvencioneve metrike dhe retorike, poeti, në vargun e lirikës së tij arrin të vendosë një ritëm, një harmoni të natyrshme, jo të imponuar dhe jo në dëm të thelbit përmbajtësor dhe estetik të saj. Nga kjo anë poezitë e Azem Shkrelit u përngjajnë skulpturave të gdhendura mjeshtërisht dhe të krijuara nga lënda kristalore, e tejdukshme. Saktësia e imazhit imagjativ dhe figurativ, saktësia dhe tërësia e perspektivës dhe e filozofisë poetike, qëndrojnë në thelb të strukturës vargëzuese të A. Shkrelit. Është dhe një veçori, mbase e rrallë përgjithësisht, që e veçon vargun e Azem Shkrelit: mendimi, emocioni, nuk i robërojnë strukturat tërësore të vargut, strofës, frazës. Ato sipas nevojës derdhen lirshëm dhe arrijnë përpos efekteve estetike dhe elegancë të përsosur ritmi dhe mendimi poetik.

PSALM PËR KOSOVËN

Po Kur pikon gjak
Kalliu, kur piqet vera
Kur hyn në gjakun tim
Nusërore e të bëhem krushk
Më mëso vetëm t'i bie
Kitarës, më mëso të vdes bukur

BREGU I MOLLËS

Kurrgjë s'qenka kurrgjë
Si e kemi lënë njëherë unë e Lami
As Lugu i Helmit as hijet Bregut të Mollës
Ku mollët veç i kujtonim të kuqe
E na kuqeshin faqet gjithë verën e lume
As mrizi degëbigë mes të cilave
Rrinte dielli në dymbëdhjetepesë
Kurrgjë s'qenka kurrgjë as ai zjarri i rradh
Që ra shi i mbarë e na e fiku
Që ra shi i mlrë e na e fiku se digjen malet
Se digjen more malet e na flet Shaban Syla
Kurrgjë s'qenka kurrgjë
Si e kemi lënë njëherë unë e Lami o zot
Po kush i paska prekur
Po kush i paska prishur e ndërruar të gjitha
Si të mos kishin qenë asnjëher këtejpari
Unë e Lami me delesykat me bukë e djathë
Në gjeth paje dhe me fyell
Kurrgjë s'qenka kurrgjë
Si e kemi lënë njëherë unë e Lami
As Shpella e Bli Hunit as turra e gurëve
Mbi të cilën hypnim të rritemi as lisat as
Gurra e Magjupit Ujëhollë
Gurra e Magjupit ujëmirë
Ku pinim në fletë kërsane
As gjollat e kuqe as
Kurrgjë s'qenka kurrgjë

Si e kemi lënë njëherë unë e Lami
Veç toka e vjetër dhe era
Veç toka e vjetër dhe retë përherë shtegtarë
Të më thonë se rrodhi këtyre lugjeve koha
Rrodhi si s' rrodhi dhe asgjë nuk gjeti
Pos dy pushkëve të vogla shtogu lidhë me tojë
Ose të më thonë
Të gjitha janë këtu të gjitha janë
Pos fëminisë suaj e barit të njomë e qingjave

LIQENI

Flas me ty
Ti hesht e luan me valë.
Ti s'je më syri
Im as loti i saj.
Flas me ty
Ti shikon pulëbardhat.
Për Shën Naumin
Paske zemër t' gjerë
Flas me ty,
Ti kotesh mrekullie.
Më vjen të zbres në fund t' fundit
Të vdes i gjelbërt me algjet.

MOTIVE TË VERDHA

Po ikim nga gjaku im motive të verdha
Po ikim nga gjaku ose një herë tjetër
Po lindim mes bimëve tjera

ATY E TEJ JANË POSHAT

Shtatgjata të vendlindjes janë delet
Të bardhat dele blegërore dhe bari
I njomë i qumështit po ikim
Nga gjaku im aty e tej janë zogjt
Pupël vogël zogjt pupëlgjelbër dhe krojet

Të cementat kroje ujëlotti aty e tej
Janë vashat më të egrat vasha
Të bukurisë që falet dhe vetima
Po ikin nga gjaku im motive të verdha
Aty e tej nuk vdesin vetëm sytë
Na ngjethen dhe gishtat na ngjethen e fjalët
Po ikim nga gjaku im më mirë po ikim
Nga gjaku ose një herë tjetër
Një herë tjetër po lindim mes bimëve tjera

DHJATË E RE

Sikur erdhën, panë e bënë e shkuan
Do bjerë edhe mbi ne njëherë këmbona
Vinë të etur tjerë. Njësoi afshëm duan
S'jemi ne. Por nuk mungon e jona
Thot njeriu dhe zbret i urtë ndër bimë
Djalli e di se në ç'vend u poqën të parat
Pemë të mendimit të mirë. Me urtinë
E kësaj dhjate ne stërpikim arat
Shollit të ditës s'i duhet spermë komete
Ky lloj Shën Njeriu don bibël të re
Një fe tjetër. Fe besimi në vete
Amen. Koha jonë s'guxon të kohosh pa ne

Kjo poezi brenda tri katrenave të rimuara artikulon një mozaik refleksesh mendore dhe emocionale. Këtu rrezaton ideja e vazhdimësisë së vlerave njerëzore, si dhe prania e tyre në përjetshmëri: S'jemi ne (nuk do të jemi ne një ditë) thotë poeti; por nuk mungon e jona (nuk do të mungojë), pra fjala është për veprat, bëmat njerëzore. Por vepra e madhe nuk mund të lindë përnjëherë dhe aq më tepër në boshësi. Vepra e madhe ka një lidhje sinonimike me mendimin e mirë, i cili dhe ai arrihet shkallë-shkallë, ngjizet ashtu i mirë që në embrion dhe zhvillohet vit pas viti, shekull pas shekulli, epokë pas epoke. Poeti kalon madje dhe në një mendim tejet të guximshëm. Ai mohon biblën (të kaluarën) në emër të së tashmes, e cila domosdoshmërisht kërkon një koncept të ri, një mënyrë jetese të re. Po ky mohim nuk është absolut, por një urë që lidh të tria kohët

njerëzore dhe universale:të shkuarën,të tashmen,të ardhmen. Poezia mbyllet me një përbetim solemn (paçka se ka brenda farën e kërcënimit),Koha jonë s'guxon të kohosh pa ne ...Dhe nënvetëdijshtëm lind pyetja:Apo ne do ta lemë kohën të na shkasë nga duart ?.

NATA NË KËSHTJELLË

I mbрами peshkatar me ditën e bjerrun n'rrjeta
Po kthehet. Unë eci duke prekur nëpër mur
Pas zërit të heshtjes zwarem ngadalë përpjetë
Hapin gur e kam. Edhe zemrën,gur.
Ja,tani kështjellës i kam hypë përmi
Vonë është terr. Nata,disi lëmekur
Merr frymë n'për vrimat që mezi shihen zi
Dhe ankhëm m'kundrojnë si sytë e prindit t'vdekur.
Mejtuar si fëmija i shkruaj do emra n'rrasë
E m'duket dashurisë sonë ia fala një grimë amshim
Por gjerbë e rigës s'motit gurin do ta plasë
T'parën pranverë duke tallë mashtrimin tim.
Prandaj me dorë,drithtueshëm,pak'nga pak'
Faqen e shkëmbit fërkoj si vashën. Dua të fshi
At marri t'vogël. Vesë? jo,por gjak
I vokët kullon gishtat t'mij.
Harroj përse,e si,e nga kam ardhë.
Harroj të flas,të lëviz. Harroj pa parë
E ndër gërmadha bëhem një copë gërmadhë,
Një gur mbi gur që gurit s'don të ndarë

KËNGË E VRUGËT

Mëtim i truar fshihu te pendimi
S'ka ndëshkim për mëkatet nga ligështia
Ky rrëmbim i çmendur është i imi
Apo lindi befas trimëria
Nga të errëtat e gjakut. S'di po fryma
Kërkon shkakun t'i vijë era dhe

Diç të kësaj koke do t'pëshpërisë bryma
Ime ndoshta. Do të jetë fjalë e re
Bari të egër. Fjollë e saj nga rrashta
Do të përvidhet me dhunë e pa hir
Sikur ç'linda. Do të kundrojë përjashta
I gjelbër e i qetë do të jem më i mirë
Dhe voglushë të verdhë do të therrin ditën
Me vaje të hollë dhe do të pushojnë së qari
Kur të kuptojnë se për nën këmbë u rriten
Dheu im. E hiri im. E bari.

DUKAGJINÇE

Po vinë argatët
Të heshtur. Të muzgët. Po vinë
Po vini. Err e terr
Brodhi arave të tyre dita
Po vinë. E poqën
Diellin e bakërt të bukës
Po vini. Po vinë
Me bimët mugullore ndër muskuj
Po vinë. Ditë argëtare
Grua që do t'ua mbash mend farën

KAFSHA E ZEZË

Heshtja det i lëkundur dhe vetimët
Fshikin terrin trupi i saj përdridhet
Ku janë njerëzit. Nga janë nisur bimët
Një lingua leh e s'ik as lidhet

Ulurin përmotshëm mbase së ligës
Ja ndjen erën diku në gjakun tim
Ai rrëmbimit të vet i turret digë
Rreptas pastaj etur merr gufim

Tej durimit dhimshëm. Të trazuara
Ngrihen grevë të pabërat duan dëshmi
Protestojnë. Gjithë gjërat e ndaluara
Bredhin mëllefit të vet me zhauri

Dhe leh kafshë e zezë e s'ik as lidhet
Heshtja det i lëkundur dhe vetimët
Fshikin terrin trupi i saj përdridhet
Ku janë njerëzit. Nga janë nisur bimët
Ja që kështu na qenka kafshë e dehur
Mëtimi. Pastaj vetëm cuklat kur të na mbeten
Do thonë: Ai me fjalë e ajo me të lehur
Të rrojnë se njerëzisht e hëngrën veten
Të pastë ndjesë harrimi hero i herav

VDEKJA E MALËSORIT

Asnjë kokë përkulur
Se ja rrëxoni lisat
Asnjë gjëmë mësa guri
Se ja shembni majet
Asnjë lot asnjë
Se ja shteroni krojet
Në sytë e tij vetëm
Harroi prenimin dita
Ç'mendim i vrugët
Ç'mendim i ftohtë ndër vetulla
Lum ky çfarë vdekje

Fjala është për një poezi-portret, portret i pamjes së jashtme dhe i botës së brendshme të malësorit –rugovas (Rugova është vendlindja e poetit). Përmes vargjeve me gjuhë eliptike, përkruhet çasti i vdekjes së tij, duke nënvizuar disa tipare karakteristike të tij sa që gjallë.

Mbi të gjitha shquhet krenaria, qëndrueshmëria jetike, pastërtia dhe bukuria e jashtme e shpirtit. Po të tillë malësori e ka dhe vdekjen, të tillë la bëjnë dhe

përcjelljen e fundit bashkëvendasit, pa gjëmë e pa vaj, për të mos ia lënduar madhështinë karakterit të tij. Nga ana tjetër malësori identifikohet me vetë vendin ku lindi, me malësinë si dhe kthehet në figurë simbol. Ai s'ka tipare të veçanta, dhe për poetin nuk ka nevojë t'i paraqesë ato. Poeti ka një qëllim final. Malësori është një shkëmb i vendlindjes së tij, por një shkëmb me shpirt. Më shumë se sa personifikohet figura e tij, metaforizohet. Forca e tij bëhet më njerëzore nëpërmjet flalëve kyçe që përdor poeti si loti, kroi, perëndimi. Nëpërmjet tyre çasti i vdekjes bëhet shumë njerëzor dhe prekës. Poeti i magjepsur nga kjo pamje ndien përbrenda se kështu do ta kishte dëshiruar dhe vetë vdekjen.

SOGJE

Sonte ne të dy
jemi dy sy të kësaj sogje
Orët zgjuar
Do të rrinë, këmbanat zgjuar
Sonte unë e ti
jemi ai zgjim i zekthët
Ujqit në këmbë
Do të jenë, Kosova në këmbë
Natë që s'more
Pushkë, as të mori pushka

Sogje – në kuptimin në, roje, në zgjim. Është karakteristikë për Shkrelin mënyra koncize e të shprehurit. Shqetësimi krijues vjen në natyrën e lirikës personale për Kosovën. Poetit i mjafton vetja Unë dhe tjetri Ti që Kosova të mund të qëndrojë dhe të mbijetojë. Poezia është shkruar në mesin e viteve '90 dhe poeti që vdiq pak para luftës që u zhvillua në Kosovë, sikur ta parandjente atë. Nuk ka gjumë për armiqtë (Ujqit), dhe si rriedhim nuk ka gjumë as për Kosovën; një lidhje varësie kjo e kushtëzuar nga historia famëkeqe e vendlindjes së poetit. Po kjo lidhje varësie qëndron ndërmjet natës dhe pushkës. Fundi i poezisë sugjeron një gjendje pritjeje të ankthshme ... ashtu siç ishte dhe gjendja e Kosovës deri në ditën kur vdiq poeti.

PËRSHENDETJE ME MIQ
(Ismail Kadaresë)

Plot fjala është me ju, plot kupa,plot gjiri i nënës
Kudo e ngado është e juaja pos mohit,pos orës së prapë
Dhe krismës prapa shpinës,po unë me se të ju zbukuroj
në baladë,o miq,me se,o dega ime e epër e fisit,
Atij tisi të hollë e tisi të rrallë, tri herë të zier
Në ashtin tuaj e timin,po unë me se të ju kem,me se-
Të ju përyjnoj,e vetëm ju e dini atë bar të mirë
Atë lëng rrëzë fjale me të cilin m'i mëkoni plagët
Ethet e qentë m'i përzeni kur kam zjarrmi, kur digjem
Ujë etjes m'i jepni bri kroit të Martinit e bri Kruje
Ullirin e moshës ma piqni,zotynë shëndet iu dhashtë
Nga jeta e vet e popullit,nga gjaku,nga shpendi ynë
Ju dhashtë,me se të ju di,me se të ju zbukuroi në baladë,
e jeni sa krip ka koka,sa fij bari,sa deti,Alkal

NAIM KELMENDI, SHKRIMTAR E POET I VLERAVE TË LARTA POETIKE: 'NË VEND TË ASGJËSË'

Naim Sali Kelmendi lindi më 10.09.1959 në Ruhot të Pejës. Rrjedh nga një familje e njohur për tradita patriotike në Rrafshin e Dugagjinit. Ëshë biri i nacionalistit të mirënjohur Salih Ramë Kelmendi nga Haxhaj -Rugovë. Për të parët e familjes së tij është shkruar edhe në “Lahutën e Malësisë” së Gjergj Fishtës duke përmendur të parin e kësaj familje -Rrustëm Ukën... Babai i Naimit, Salihu ishte i ndjekur dhe i burgosur nga shovenistët serb në kazamatat jugosllave. Deri më vdekje babai i tij mbeti konsekuent ndaj çështjës kombëtare... Naimi, për disa vjet ka punuar si gazetar i gazetës “Bota sot”, kurse gjatë luftës çlirimtare në Kosovë, ishte reporter lufte në betejën famoze të Kosharës (1999) prej nga lexuesi shqiptar njoftohej për luftën heroike të vashave dhe djemëve shqiptarë... Poashtu ai njoftonte opinionin mbarëkombëtarë për të bëmat e lavdishme dhe heroizmin e kësaj beteje të lavdishme, por më vonë Naim Kelmendi shkroi edhe mjaftë radhë, artikuj ,intervista etj., për një tjetër betejë të lavdishme-Betejën e Loxhës në gazetën “Pavarësia Neës” etj. Naim Kelmendi tërë jetën e tij e deri më sot ia kushtojë çështjes sonë kombëtare gjegjësisht penda e tij nuk pushojë kurrë së shkruari poezi e prozë për Kosovën dhe popullin e robëruar shqiptar, dhimbjet e të cilit do t’i përjetojë rëndë në shpirt, njësojë sikur mallin për babanë e tij, ngrohtësinë dhe zërin e ëmbël të të cilit nuk e shijoi kurrë në jetë... Naim Kelmendi edhe tash vazhdon të shkruan poezi, të këndojë dhe t’i thurë këngë lirisë së fituar me aq shumë gjak, do të këndojë bashkë me popullin e tij të cilit i thuri aq shumë vargje, dhe për lirinë e të cilit ishte i gatshëm të sakrifikohet në çdo çast. Poetët janë zëri më i bukur i një populli, janë këngëtarët më të mëdhenjë që i këndojnë lirisë, janë bilbilat më të bukur të botës që ia thonë këngës në çastet më të vështira kur të tjerët vajtojnë, vetëm e vetëm që ta mbajnë të gjallë shpirtin e popullit kur ai kërcënohet me zhdukje, siç ishte rasti para një decenie me popullin të cilit i takonte Naimi. Për këtë ai deri më tani ka botuar mbi 12 përmbledhje poezish, ka shkruar me dhjetra punime publicistike dhe gazetareske, është marrë me aktivitete të shumta kulturore, qoftë në Kosovë (Pejë, Ruhot, Prishtinë) në Zvicër, Shqipëri etj. Naimi ishte redaktor i disa revistave shqipe në diasporë si “Top-Kultura”, “Mërgimtari”, etj. ka organizuar me dhjetra takime dhe mbrëmje letrare, promovime librash, ishte reporter i parë i gazetës “Bota Sot” që arriti të raportojë nga fronti i luftës në Koshare,

ishite bashkëpunor i shumë botimeve në gjuhën shqipe...Ishte pra gjithmonë ndër të parët në front, në ate intelektual dhe ate të luftës, nuk i frikësohej as vdekjes, sepse trimërinë ia kishin lënë trashëgim të parët e tij nga Rugova, gjysh e stërgjysh, denbabaden deri në ditën e kijametit.Veprimtaria letrare e Naim Kelmendit , siç na është e njohur mirë përveç vlerave të larta letrare, stilistike, ka edhe vlera pozitivisht të theksuara gjuhësore. I lindur e i rritur në Ruhot, ai si një fëmijë e më vonë si një djalë e veçmas më vonë si nxënës dhe student vërejt se të folurit e Rugovës ka një veçori të vetën e cila po të mbledhet e të ruhet, jo vetëm që do të jetë një thesar i paçmuar për gjuhësinë, por edhe burim e leksik i pashtershëm për letërsinë, posaçërisht për poezinë.

Qysh në përmbledhjen e parë të poezive me titull “Shtreza në fjalë” është hetuar tek ai se adhurimi i tij është shumë i fortë për leksikun autokton rugovas dhe se ato fjalë të vjetra do të mund të shfrytëzohen pafundësisht në poezi. Kjo prire e tij vazhdoi të thellohet edhe te veprat e tjera, deri tek ajo e fundit. Mund të thuhet se Naim Kelmendi një numër të madh fjalësh të leksikut rugovas e futi me gjeturi në poezi, ia gjeti vendin e përshtatshëm aty dhe ashtu e mbetur ajo u ngulit aty edhe më tej nga bashkëfrymëzuesit e tij, kështu që në saje të meritës dhe të pasuesve të tij, gjuha jonë e ka rinuar një numër fjalësh e shprehjesh të vjetra, ua ka rigjeturur vendin aty dhe aty kanë mbetur e do mbesin përgjithmonë si pasuri edhe e leksikut letrar. Një meritë tjetër e Naim Kelmendit si poet e prozator e ka edhe për gjetjen e neologjizmave (fjalëve të reja), për krijimin dhe formimin e tyre, duke i dhënë një kontribut të madh neologjisë shqiptare. I dhënë pas letërsisë, ku e ka gjetur strofullën shlodhëse për shpirtin dhe ndjenjat e tij, ai si gjuhëtar tërthorazi ia begatoi leksikun gjuhës së vet, e cila në penën dhe gjeturinë e tij, gjeti një mjeshtër kulmor për ruajtjen e të vjetrave dhe krijimin e fjalëve të reja sipas dhe në saje të mendjes dhe syrit shigjetues të tij(Nyja e Gordit). Nga leksiku popullor Naim Kelmendi ia doli të fusë në përdorimin letrar me dhjetra e dhjetra fjalë, të cilat, jo vetëm që nuk ia ulnin vlerën letrare asaj gjuhe, por, përkundrazi ia ngrisinin, ia larushonin dhe ia mbushnin me poezicitet. Natyrisht se një vlerë të tillë nuk mund ta ketë çdo fjalë e leksikut popullor, prandaj ai arriti mjeshtërisht të zgjedhë ato fjalë që në vetvete kishin bukuri fjale, bukurtingëllim, veçanësi emërtimi ose shënjimi(Pse ashtu Pandorë).Nga sa u tha, Naim Kelmendi në lëmën e leksikut ka sjellur një pasuri leksiku jo vetëm me brumin vetanak por edhe duke e rikthyer në jetë një numër fjalësh të gjuhës sonë, të cilat poezisë i japin hijeshi, gjerësi kuptimi e sidomos melodicitet autokton.Fjalët e reja të qëmtuara nga veprat, shkrimet dhe shënimet e tij mua më kanë hyrë në punë si lëndë e pakapërcyeshme në punën time gjatë hartimit të FJALORIT TË FJALËVE TË REJA. Ndër krijuesit më të frutshëm

të fjalëve veçohet i dalluar edhe Naim Kelmendi ashtu si Azem Shkreli dhe Ramiz Kelmendi. Prej pendës së Naimit kam qëmtuar dhe shënuar me dhjetra fjalë të tipit të neologjizmave. Naim Kelmendi këngën e ka ndërtuar me fjalë ngjyrimesh të ndryshme ndër të tjera edhe me përmbledhjen me poezi “Nyja e Gordit” . Ai me një “daltë fjalë” në dorë këndoi edhe kur shkroi përmbledhjen me poezi “Përballje me vdekjën” me atë formën më të bukur që dinë poetët të bëjnë mjeshtërinë e fjalëve (Eklipsi i diellit,Albanoi,Nyja e Gordit,Pse ashtu Pandorë,Kohë për të folur gurët,Sipërfaqja e padukshme etj). Për krijimtarinë letrare e publicistike të shkrimtarit tonë të mirënjohur Naim Kelmendi kanë shkruar:**Ramadan Musliu,Sali Bashota,Basri Çapriçi,Iljaz Prokshi,Fatos Arapi,Azem Shkreli,Agim Vinca, Shyqri Galica, Abdullah Konushevc, Rushit Ramabaja,Skënder Buçpapaj,Arbër Ahmetaj,Januz Fetahaj,Elida Buçpapaj,Hasan Mujaj,Sejdi Berisha, Shefqet Dibrani,Shaban Cakolli,Ali D. Jasiqi,Sinan Gashi,Rrustem Geci,Avni Nezaj, Rexhep Elezaj,Nazmi Lukaj,Ndue Ukaj,Prend Buzhala,Shahbaze Vishaj,Sarë Gjergji,Flori Bruqi,Valdet Hysenaj etj.**

Publicisti Naim Kelmendi ka shumë libra dhe vlejné t'i veçojmë disa prej tyre:

- 1.Shtreza në fjalë,poezi,Prishtinë ,1984.
- 2.Albanoi,poezi,Prishtinë,1986.
- 3.Nyja e Gordit,poezi,Prishtinë,1987.
- 4.Ç' të bëj me dhembjen,poezi,Prishtinë,1987.
- 5.Pse ashtu Pandorë,poezi,Prishtinë,1989.
- 6Përballje me vdekjën,poezi,Prishtinë,1993.
- 7.Eklipsi i diellit,poezi,Prishtinë,1993.
- 8.Vrasja e deputetit,monografi,Prishtinë,2003.
- 9.Shqiptari vdes duke kënduar,poemë për Adem Jasharin,Prishtinë,2003.
- 10.Kohë për të folur gurët,poezi,Prishtinë 2004.
- 11.Sipërfaqja e padukshme,poezi,Prishtinë 2005.
- 12.Beteja e Kosharës,monografi,Prishtinë,2008.
- 13.Pikëpamje dhe reagime ,2008.
- 14.Në një jetë pas Krishtit,2010
- 15.Esenca,2010
16. Shqiptari vdes duke kënduar,botim i dytë,2010

Naim Kelmendi është njëri nga publicistët që, me penën e tij, i doli përballë kimit që mbiu në Kosovë menjëherë pas përfundimit të luftës, pjesëmarrës i së cilës ka qenë edhe vetë si reporter lufte në Koshare. Për këtë guxim të tij, për këtë përpjekje në funksion të ndërtimit të një shteti të mirëfilltë ligjor, për vizionin e tij për një Kosovë demokratike-ishte për një kohë të gjatë i kërcënuar nga grupet kriminale që u konvenonte anarkia, për ta shfrytëzuar këtë (anarkinë) për pasurim brenda nate. Naim Kelmendi krejt çka mendoj për zhvillimet e pasluftës në Kosovë, e tha haptaz. Prandaj, vlera e shkrimeve të tij qëndron jo vetëm te ana cilësore e tyre, por edhe te guximi për t'i thënë me emrin e vërtetë të bardhës e bardhë dhe të zezës e zezë. Në shënjestër të shkrimeve të Naim Kelmendit, ndër të tjera, ka qenë edhe politika e “re” e Beogradit dhe lëvizjet e saj të vazhdueshme për ta frenuar procesin e pavarësimin të Kosovës. Çdo lëvizje antiKosovë nga ana e kësaj politike, publicisti në fjalë bën përpjekje ta demaskojë në sytë e opinionit tonë. Njëkohësisht, i analizon edhe politikat ndërkombëtare në raport me Kosovën dhe, sa herë sheh të meta në të, bën thirrje që ajo të mos bjerë viktimë e taktikave të reja të politikës së “re” të Kalimegdanit kundër pavarësisë së saj. Po ashtu, parashton fakte të shumta në favor të pavarësisë së Kosovës, e cila edhe u realizua më 17 shkurt 2008. Shkrimet e përmbledhura në këtë libër janë të shkruara në gazetën “Bota sot”, “Pavarësia”, “Pavarësia nëës” etj. gjatë viteve të pasluftës. Në të janë përfshirë vetëm disa prej shkrimeve të tij të shumta të publikuara në këto gazeta. Me penën e tij, ishte njëri nga heronjtë e demokracisë në Shqipërinë Etnike . Themi Hero për faktin se t’i identifikosh gjërat negative për një shoqëri dhe një komb, kur nata që bërë kulçedër që i “hante” atdhetarët e Kosovës, është vërtet heroizëm. T’ua vësh gjoksin përpara grupeve kriminale, që gati sa s’e patën dërrmuar përpjekjen e Kosovës për pavarësi, ishte ana tjetër e atdhetarizmit të Naim Kelmendit, pas përfundimit të luftës. Ana tjetër e atdhetarizmit të tij të treguar qysh në kushtrimin e parë për luftë kundër Serbisë. Shkrimet e publicistit ,shkrimtarit ,gazetarit dhe patriotit Naim Kelmendi do ju shërbejnë gjeneratave të ardhshme se si mbrohet Kosova edhe në liri. Se si liria e merr kuptimin e saj të vërtetë....

<http://floripress.blogspot.com/2011/06/nga-naim-kelmendi-ne-vend-te.html>

Poezi nga Naim Kelmendi:

NË VEND TË ASGJËSË

Në vend të asgjësë
kam shpirtin tim
përditë në stacion
të pakuptimësisë

rrugëve të kuptimit
në kërkim të vetvetes
hullive të mnerta të vetëjetës

prandaj s' dua ta trandë as për një çast
këtë kuptim prej asgjëje
sepse s'e kam fuqinë e zotit t'i ndryshojë gjërat

dhe në vend të asgjësë
gjithmonë ka diçka që ma kuptimëson
frymëmarrjen, mendimin për të jetue
dhe që do të shuhemi këtej jete
është aksiomë e njohur nga e vërteta

po sa vështirë ata bëjnë përpjekje për ta mundur vdekjen...
pa mundur t'i qetësojnë askurrëmë dhembjet
e thekshme të shpirtit pa shpëtim
dhe kur vdesin thua se nuk ishin kurrë pjesë jona

unë s' dua të shkel më mbi vetveten
e ta denoj shpirtin tim me gjithfarë teorish
të paqena... që vrasin që helmojnë

dhe në vend të asgjësë
prapë si një luledielli vjen dashuria
prandaj këtu kemi ardhur të duam
e jo të vrasim të urrejmë krijimin e zotit-njeriun
dhe duhet të shkojmë, ama të shkojmë heshtur dhe pavërejtshëm
pa prishur as për një çast as rendin as rregullin

dhe unë zotohem se në vend të asgjësë
do të vijë kuptimi i diçkaje
për të të thelluar në kërkim të njohjes
dhe s'ke për ta njohur kurrë...

ka diçka tej shikimit
diçka ka tej mendimit
ka diçka tej t'vërtetës
diçka ka përtej jetës

bari do të lulëzojë dhe bimët do të kokrojnë
dhe ne dhe ju dhe ata të gjithë dhe gjërat
që s'i njohëm kurrë dhe s'kemi për t'i njohur

përgjithmonë në vend të asgjësë...

MAL I MADH

Mal i madh
e unë kërkoj
majën e gjilperës
veten e humbur

po askush s'e ka humbur veten
që unë ta gjej fatin e humbur
në mjegullën e epshit
dhe dal nga teatri i gazepit njerëzor
për ngritje për forma deri në Maje
servilët pederët laviret dhe shumëkëmbëshat
jetojnë më së miri në këtë zallahi jete

unë ende kërkoj veten dhe melodinë
e humbur në jehonën e një vajtimi të këputur

ec e dije mbrëmë kush kënd e ka mashtruar
deri në poshtërim dhe e ka hedhur si limonin

dua ta them se kështu jeta s'ka asnjë kuptim
në Malin e Madh dal i vetëm dhe humbës
i krejtë kohës në eksplorim...
shëndosh koka pra
rrugën e gjejnë të tjerët
ata që kanë shpikur kodin e jetës
shumëngjyrëshe... shumëkuptimëshe...
shumëmënyrëshe...
mal i madh e unë ende kërkoj majen e gjilperës
e ende kokrroj mendësi kokëdhembëse...
dhe ia shkel bishtin, dikund kokën nxjerr
vjen erë sperme nëpër të qarat e natës

por njeriu dhe unë ecim e ecim e mendojmë ende
për shtëpinë për familjen për ngjyrën prej njeriu
për identitetin për dorën e fshehët për dorën e zezë
që pret lisat natën që shkruan skenarët e lavireve

sikur na e ka ëndja ta hamë më të mirin
na e do gjaku që ta rrëzojmë secilin
dhe s'bëhet gjë prej gjëje
pa dirigjuar dikush nga prapaskena

ato fytyra që shikoni në skenë janë veç maska
të mjera... tragjike... askushët e askundit...
vetja ua ka gërdinë e fatit të tyre t'pafat

TË QENËT E MOSQENË

Mor, me një fytyrë të zbehët del
dikund në fushërrugë
dhe s'i bindesh asnjëherë
fatkeqësisë së vetvetes
nëpër jetë po të përcjell
i njëjti fat cub
cep më cep hapësirës etnike
shanë e përlanë e s'bën dot me tëndin

bjezga e huaj në mes bën vend dhe gjuan
gjaku dhemb natën në shtrat të Prokrustit

i kthehesh vetes në kafshim idhnak kur s'e rrëzon dot tëndin
nga Maja që s'ia duron hijeshinë e mendimin
dhe të bëjnë të flasësh vetmevete vetmashttrimit pastaj,
po sa i zbrazët sa i verbër paskësh qenë vetja
në shërbim të hijes së tjetrit që të jep Dhuratë Danajsh
dhe shikon se në secilën kohë diçka të kanë marrë
nga vetja dhe kanë qeshur me ty paskëtaj
tradhtitë e mnerta se si pranove një cohë që s'e veshin as qentë
e pëshurraftë kur ndjekin kudra

të qenët e mosqenë sërish duket
se vret në shenjë të mendimit tim
të trandur, mor njihe veten se s'bën kështu
gjithmonë nga fundi nis fillimin e çdo gjëje
a s'të kanë thënë mjaft shekujt për gurin e Sizifit
aq tragjikshëm që kurrë s'i del në fund ecjes

del e bërtet për anash e në shesh bërtet e shanë vëllanë tënd
e të ujit hija e të gjithëpushtetshmit
e ta rjep lëkurën e dhembjes dhembja nga i yti
sepse dhemb më shumë dhe s'ia gjen ilaqin vetvetes
tatëpjetave të jetës duke i zbritur për veshëve
duke ia rjepur gjinjtë dhe tamblin e nanës
duke ia pirë deri në fund mëmëdheut

dhe s'i bindesh idesë dhelpërake
sepse të paskan thënë rri kështu si je
merr frymë kështu si je ec kështu si je
mendo kështu si je hije e sakatosur nga ndarja
e shekujve dhe ti ec e ec tragjikshëm e pandalshëm
drejt shekujve të ardhshëm njëllojshëm
të qenët e mosqenë shenjon ligjin e ekzistencës tënde
të bindjes tënde për të mos qenë aty
ku i duhesh kohës ku i duhesh ecjes

në kohë dhe hapësirë kur të thërret
jehu i vetvetes në fushëbetejat e jetës

FTESË PUBLIKE

Lërimi anash sytë ktheni shikimet
në një pikë të vetme dhe shikoni
mbani veten nga trishtimi
mizorët po ngarendin tokave
në dorë mbajnë trofetë e tyre
nga prerja e kokave

lërimi anash sytë e kujtimet
mbi ditët e lumtura
nga ndonjë dashuri vitesh që iku
si çast i mjegulluar në mbamendje
ktheni shikimet në një pikë
si po byrytet Dhevështruesi

dhe mos më thuaj Ante
se unë s'paskështa Atdhe
a është ky që e pëshurrin
çdo ditë e çdo çast
a është ky që po a hanë
nëntokave mafia e verdhë
a është ky që po qajnë natën
fëmija e asaj varfanjakeje për një copë buke
a është ky i këtyre lypsarëve të përditshëm
cep më cep kaq të mërzitshëm duke na prishur
qetësinë e fjalëve në kafenetë e shesheve
dhe në shtëpitë e qendrave urbane
mor a është ky atdheu për të cilin kam menduar
se është edhe i imi dhe vetëm në një fjalë nëne
saherë më thoshte kthehu ku ke lindur
kur i thoja dheu i babës dheu i nënës
unë të dua për emër të Atit e të Birit e Shpirtit të Shenit

lërimi anash dhe hudhni fare sytë mbani veshë
se po vjen Dhevështruesi po i dëgjohet gërhamë

e mos më thuaj kurrë Ante
se unë s'paskështa Atdhe

a është ky që po ia mbushin hundët me marihuanë
a është ky që po ia shesin një vajze dhe shoqeve
të saj seksin në jetën e mbrëmjes stacioneve të vetmisë
a është ky ku s'e kthen kush kokën anash
a është ky ku secili shikon jetën e vet personale
a është ky ku secili vjen e shkon në askund
me heshtjen e vet të sert ndër vete
a është ky ku secili s'mendon të të dhurojë pak gaz
veç thur lavde për të vdekurit e harron të gjallët
që ka para syve përditë e t'u japi pak dashuri
sesa një shikim përbuzës dhe vrasjen në mesditë
me heshtjen e hipokrizisë njerëzore

ECJE VETËM

Zotin tim ku e kam oh Zot
që t'ma shkurtojë njëtrajtshmërinë
e ecjes sime vertikale padukshëm mes rrethit
të përditshëm të gjërave lakuriqe
si e kanë ngulur në hu kokën e një kali
të ngordhur pasditën e një qershori
e kush ma shkroi këtë fat
të ec të ec dhe vetëm të ec
me shikimin e etur për ta parë fundin
e një fati që ka filluar moti
të zhgërryhet mbi pafatësinë
zotin tim ku e kam oh Zot
apo s'merret më me gjërat e përditshme
me fjalët e përlotura kurtheve të vetmisë
kësaj mbretëreshe që ha njerëz e fate
dhe s'i shkruhen askund aktet e tragjedisë

KOHA PA TY

Koha pa ty është kohë pa kokë
kohë që i digjet shkumb dhembja
dhe kohë që i ka mall vargu e fjala

koha pa ty është kohë e ndalur
dikund në një vegim dhe s'i ec
as ora s'i del as fjala as vargu

koha pa ty rrin në rremb të qyqes
krejt qyqevetem
dhe i rriten flokët, dhe
i rriten thonjët, dhe thërmohet
imazheve të pritjes
dhe ia ha vetes thonjët dhe ia ha
vetes vargjet dhe fjalët në gojë

është gjykim i vetes
dhe mallkim është
në hirin e asgjësë

nëse nuk kthehesh...

koha pa ty rri në rremb të qyqes
krejt qyqevetem
Prishtinë, gusht 2010

VETJA NË MUNGESË

Keqas u mungon vetja
rendin pas vetes
së humbur
kërkojnë veten
e munguar

mjerueshëm
shajnë e thejné
gota pezmi
dhe urrejné
shtatë ditët e krijimit
të botës

se, keqas u mungon vetja

PËRFTIM

A na përftuan
para syve të gjitha

po a s'u kishte
shëmtim vetja
si e hanin të vetin
a s'u hypen në qafë
a s'i kalëruan shtatëqind dreqër

dhe a s'i harbuan
lakmizezat
nga vetë mëkata
e vetvetes a s'u vetëvranë

po ku mbeti e drejta
a s'e njohët apo s'e patë
në aureolë jete n'kuptimin e saj

ishte një përftim
që ju gjeti shtrembër
duke menduar -

EKZAKTËSISHT

Tërë jetët, çkado
që erdh u bë
n'pluhurin kozmik
n'hapësirat
stërë t'paanshme, t'pafund

me urdhër t'krijuesit
tek gjithësia
lindën, jo kurrë nga urrejta
por vetëm nga dashuria ...

E PANDRYSHUESHMJA

Ekziston diçka e paarritshme
për ta njohur deri në fund

në botën e kujtesës
qiriu i mendimit rri ndezur
në mua, përreth meje ekziston
e reziston deri në paskajësi

e mjegullt e panjohur
që rrjedhë përditë çdo çast
Panta Rhei, dhe

një ditë që s'do të jemi
më kështu në këtë ajër

po si luan teatër me ne
e padukshmja
e paprekshmja dhe hija
e atij që rrënon dashuritë

ne mbesim veç hijesim, shenja
për t'na çajtur mjerueshëm
pasaktësia nëpër hirin e asgjësë

POR, NE ISHIM

Pa dritat e mendimit...
jemi thjeshtë pjesa e pjesës të pjesëve
diçka që s'do ta shpjegoj assesi
nga erdhëm e kah shkojmë
mor askush s'do ta ndryshojë ligjin
e heshtjes bizare pasi tradhtojnë
dhe veten në fund të fundit

deri këtu kemi ardhur
duke u kapur për një fije t'mendimit
pas betejave të gjëllimit ofshajmë thekshëm

në tërë rrugëtimin tonë vetmitar
ekziston ana e errët që ne s'e shohim
pikërisht aty kemi kurthën
e shpirtit të lënë vishkull

s'është e rëndësishme
nga na vjen gjykimi
ne edhe vetëgjykohemi
për ato që s'ia arritëm qëllimit

tash qetësia ime vajton papajtueshëm

por, ne ishim...
pikëllim fatesh nëpër kohë

E PAMUNDSHMJA

Mësa një fije bari
që mund ta dijë për një fije bari tjetër
që ekziston dikund larg në botë

aq e pamundshme është ta dijë

dikush e dikund se ekzistojmë
ti dhe unë në këtë çast, pra

po flas, ja për çka po flas
për të pamundshmen
dijmë vetëm për raca njerëzish e popuj

kufij, luftëra, dhe tragjedi jetësh
por ne s'e dijmë biografinë e secilit

prandaj ne s'e dijmë as pse jemi këtu
e dikush tjetër e atje dikund
dijmë vetëm se jemi dhe në këtë formë

pra, ja për çka po flas
për të pamundshmen e njohur

BABAI

Kam të ftohtë baba kaq vite
të ftohtë kam dhe frikë
nga e pamundshmja ime

për t'më kuptuar e për t'i kuptuar
të gjitha t'paaritshmet e jetës
t'panjohuart e saj të mistershme

e di, ti s'ke asnjë faj
për pamundësinë e takimit
të fëmiut me prindin
qoftë edhe në një ëndërr

në të shumtën jam rritur e forcuar
me dashurinë ëngjëllore të nënës

por kam ende të ftohtë, baba, kaq vite e tehu
të ftohtë kam dhe frikë nga e pamundshmja ime

e tashmë ti je veç një fije kujtimi në mua
që banon brenda kujtesës sime, kaq gjë –

kujtesa bëhet bishë e egërsuar
me dritat e neonit natën, saherë
nxjerrin krye vargjet për të shenjuar
status quo-n e gjendjes së t'jetuarit pahetueshëm

dhe në mendësi, saherë andej e këndeje harrimit
unë krenohem përgjithmonë se jam i yti –

**NËNA, LOTI,
DHE NJË HISTORI
E DHEMBJES**

Shi binte me shekë apo loti i saj
ëndërronte jetën për bimën
dhe ditën me diell,
për kohën për ekzistencën

e shponte dhe gurin
dhembja qyqevetem
me kujtimin e saj
për humbjen e babait tim
nga ai çast tragjik në kohë t'pakohë
që na kishte lënë ashtu vishkull
në mesjetë në meskohë në mesrrugë

loti i saj me dhembjet
e tmerrshme të pasigurisë
kaltëronin kohët dhe
mendimin për të ekzistuar

nëna ime Xufë,
ëngjulli im mbrojtës
shpirtvuajtura e fatprera...

pas ngjarjes tragjike kur ia vranë burrin
me 1961, babain tim, kur e pyetën tha:
për jetën time jeta janë këta, dy djemtë,
dy zogjtë e saj, dy dashuritë e shpirtit,
dy ëndrrat e jetës, do i rris ndershëm tha
dhe ashtu vijoi për të
jeta e pagjumë
jeta e saj plot sakrificë,
jeta e saj plot altruizëm,
jeta e saj plot dashuri nëne
jeta e saj plot dashuri engjëjlore
jeta e saj nëpër batica e zbatice
dhe deri në fund qëndroi:
dashuri vertikale
dashuri horizontale
dashuri mbi dashuritë
dhe deri tash me 2011
e njëjta dashuri
që mëkon shpirtin e saj
nga dashuria e zotit
vazhdon ta mbajë gjallë...

jeta ka qenë e vështirë, nënë
për ty, për ne
po, thotë, kjo ishte rruga jonë
ky ishte fati ynë...
por kisha t'vetmen ëndërr
juve të ju rrisja, juve të ju kisha...

nëna Xufë, imja nënë e mira
as që kishte dëgjuar
për Shekspirin apo thënien e hamletiane:
të jesh apo të mos jesh
por jetën e saj e kishte vënë në pikëpyetje:
kah t'ia niste e si t'i dilte n'krye me pasaktësi
me tërë t'panjohurat e saj...

në shpirt ndjente
trishtimin e viteve
dhe pikëllimin e jetëshkretës pa gjumë
nën dritën e një fitilaqe
shfletonin dhembjen
netëve ëndrrimtare

as për Korbin e Edgar Allan Posë
s'kishte dëgjuar kurrë
sepse nëna ime s'ka ditur as shkrim lexim
por sa herë ia dëgjonte këngën shpendkeqes rreth shtëpisë
parashihte gjendje të keqe për fatin...
dilte në oborrin e shtëpisë dhe e truante
natë e ditë fytafyt me t'vërtetën pelin

as nuse si bëhen nuset s'është bërë nëna ime
as ka veshur fustan të bardhë nusërie
e ka marrë halamrukas babai atëbotë
nëpër kohën e acart nëpër kohën furtunë
dhe siç thotë vetë më vonë në një kujtim
të saj: mendet kishin rrënjë...

e tash në kujtesë
më kthehen të gjitha
derisa rri pranë nënës sime
këtu në spital

ajo kupton dhe e kujton
se diçka ka ndodhur
në vitin e 78-të të jetës së saj
derisa merr nga dora e majtë
terapinë mjekësore
me ushqimin artificial...

lutem për dashurinë e Zotit
siç lutet mesiguri edhe ajo me t'veten
koha, jeta, vitet rrodhën dhe jemi
ja ku jemi te ky çast jete,

vërej fytyrën e saj engjëllore
e kredhem në një mendim
për t'ia kërkuar domethënien

se, ja çka do të thotë një çast
pra një çast jete dhe i vetmi çast...

Gusht 2011, Prishtinë

REFLEKSIONE (RI) LEXIMI PËR STUDIUESIN ERUDIT PREND BUZHALA

Prend Buzhala u lind më 1 nëntor 1951 në Çabiq të Klinës. Filloren e kreu në Ujëmirë, gjimnazin në Klinë, fakultetin filologjik (gjuhë e letërsi shqipe) në Prishtinë. I ndoqi edhe studimet postdiplomike, po për shkak të burgosjes politike më 1982, iu ndërpre në nga regjimi i kohës, ashtu siç iu ndalua edhe botimi i shkrimeve dhe e drejta e punësimit. Shkrime letrare botoi prej vitit 1967. Shkruan poezi, prozë, kritika e studime letrare, publicistikë. Gjatë tri dekadave të fundit ishte i angazhuar në lëvizjet nacionale, politike e kulturore të kohës. Për këtë arsye, për dy dekada rresht u përdoq nga organet shtetërore të ish Jugosllavisë e sidomos nga ato serbe, kështu që gjatë viteve '90 të shekullit që e lamë pas, u arrestua e u keqtrajtua dhjetëra e dhjetëra herë nga milicia e paramilitarët serbianë. Për arrestimin e fundit të tij, lexo: <http://ëëë.kosova.com/arkivi>

1997/i980602c.htm. Gjatë luftës së fundit në Kosovë, raportonte nga zonat e luftës për disa media. Punoi profesor i gjuhës e letërsisë shqipe në shkollën e mesme të Klinës (1976-1982, 1992-1996), drejtues i arsimit komunal të Klinës (1995-1999), redaktor në gazetën "Fjala" (1990) e "Bashkimi" (1991) të Prishtinës, korrespondent i gazetave "Bujku" e "Rilindja" (1995-shkurt 2002), pastaj të "Epoka e re", Radio Rilindja, "Express" i Prishtinës, redaktor i faqeve të kulturë në të përjavshmen "Focus" të Prishtinës (2006-2008). Punoi edhe zyrtar arsimit (2001-2003). Tash është drejtues i Bibliotekës Publike "Kongresi i Manastirit" në Klinë. Ka qenë ndër themeluesit e themelues i disa revistave lokale të Klinës, si "Jehona e Dukagjinit" (vitet '70 e këndej), "Ylli", "Synimet", "Tribuna", "Profili" etj. Është redaktor e recensues i qindra botimeve në dy dekadat e fundit.

Disa nga çmimet letrare e publicistike:

Çmimi i gazetës "Rilindja" për gazetarin më të mirë të decenies gjatë viteve '90, 12 shkurt 1999.

Çmimi "Agim Ramadani", në Takimet e Dom Mikelit, Stubëll, shtator 2008, për poezinë më të mirë, me titull "Nga ligjërimet e Nji Plake Ditën e Shën Premtes",

Çmimi "Ora e Tahir Deskut" për veprën më të mirë, "Kode poetike të mbijetesës shpirtërore", shtator 2009, Klinë,

Çmimi “Fondi Akil Mark Koci”, për kontribut në kulturë e në krijimatinë artistike, në Takimet e Dom Mikelit, Stubëll, shtator 2009.

I. Veprat në poezi:

O Amë, o Amë, 1995.

Për kë bie këmbanë e re, 1998.

Shtatë seanca pranë Apokalipsit, 1998.

Prend Buzhala ne promovimin e vepres se Anton Nik Berishes, Prishtine 2008

II. Kritika, studime monografike, vështrime:

Metafora e vendlindjes, 1999.

Përqsasje estetike, 2000.

Ex libris –I, 2003.

Odeoni i fjalës, 2003.

Shkrimtari pranë buzëqeshjes. Studim mono-grafik për letërsinë për fëmijë të Ali Huruglicës, 2005.

Muza e zemrës, 2006.

Temë dhe tekst,- Shkup, 2006.

Muza e Kujtesës, 2007.

Aty ku krizat i besohen engjëllit, (Ndërko-munikime estetike: arti –literatura –lufta), 2008.

Res Publica e shkrimtarit, (Ese, trajtesa), 2008.

Kode poetike të mbijetesës shpirtërore/ Mbi romanet për të rritur të Anton Nikë Berishës, Argeta LMG, Tiranë, 2009.

Gjenitivi i lirikës –poezia e Mirko Gashit, 2009.

III. Roman:

Moisiu fluturonte me Qerren e Zjarrtë, 2003.

IV. Publicistikë:

Lartësimi i lirisë. Monografi për mësuesin dëshmor Ismet Rrahmani, 2002.

V. Përgartiti për shtyp:

Testament letrar, Mendimi kritik për veprën e Ramadan Mehmetit, me komente, Prishtinë 2008.

Të kuvendosh nën shenjën e Euterpës, Intervista të Akil Mark Kocit dhënë mediave 1976-2008, Prishtinë 2009.

RRËFIMI PALIATIV

(Nasi Lera: “Ana Zh.”, roman, botimi i dytë, Onufri, Tiranë 2004)

Një parandjenjë e ndarjes fatale e përcjell personazhin që nga faqja e parë e e deri te ajo e fundit, në romanin “Ana Zh.” të Nasi Lerës. Ana, njëzetvjeçare, është e sëmurë nga tumori në mushkëri. Ka dalur nga spitali. Është një dashuri e një çasti të beftë: e Anës dhe e Pirros. Në personazhin, Pirron 31-vjeçar, (përkthyes dhe njohës i letërsive botëore e që ka pasur kontakte me krijues të shumë vendeve) është dashuruar më 22 mars (pra, asociacion letrar i dashurisë me pranverën). Shkrimtari i paraqet dy javët e fundit të jetës së saj në dhjetor, gjatë një udhëtimit që bën ajo me Pirron nëpër tri vende mesdhetare: në Greqi, Itali e në Algjeri; atëherë kur vjen dhimbja e ndarjes së fundit. Ky përfundim i jetës së Anës në shkretëtirë, është posi njajo shenja e simbologjisë së ëndrrave: që ta shohësh shkretërirën në ëndërr, do të thotë se ke brenga të mëdha... e tillë, ku brenga jetësore e përjetimi i dashurisë, janë ndjerë e harxhuar që nga A-ja e deri te Zh-ja “si një dashuri a si një ndarje (fq 12). A nuk ta sugjeron edhe titulli i romanit këtë alfabet të përjetimit e të gjallimit të jetuar nga fillimi e deri në fund? Edhe dhembja e shkretëtirtë është e pafund, e paanë, posi ajo e Shpirtit dhe e Trupit. Shtrati psikologjik i veprës mbushullohet me metafora e me ndjeshmërinë ngapak fatale të personazheve, me shenjat e mavijosura të fatalitetit jetësor.

Spektakli i itinerarit modern, shikim i ngurosur i Meduzës

Në prozën e tij Nasi Lera e përqafton frymën dhe konceptin e Bibliotekës së Babilonit, sipas parimeve borhesiane të krijimatisë, të vetëdijes proteike moderne e postmoderne të narracionit. Te Lera vërehen lehtë këto procese transformuese; që vjen me gjeneratën e prozatorëve të estetizmit modern (me kreacione estetike të suksesshme) e të fantasticienëve të prozës moderne. Dashuria krijon një gjeografi të shenjtë të botës. Kështu duket se e ligjërojnë personazhet e romanit “Ana Zh.” të Nasi Lerës, formulën e eseistit bashkëkohor, Alberoni. Njerëzit udhëtojnë nëpër viseve të largëta e të ndryshme për ta gjetur të panjohurën. Udhëtonin në kërkim të ndonjë utopie. ... Udhëtimi modern përfytyrohet si projekt mbi ardhmërinë: aty ku qyteti “izolohet” nga natyra, nga burimorja. Pelegrini i dikurshëm antik apo romantik shndërrohet në turist. Dikur, në kohët e mitit, udhëtonin në kërkim të bashkës së artë. Romantikët udhëtonin drejt viseve ekzotike, në kërkim të dallimeve kulturore e të identiteve rajonale. Gjakonin shndërrimin e karkaterit kalimtar të jetës në kategori të së amshueshmes: çdo

gjë sikur e shikonin me sytë e Meduzës,iu dukej madhështore dhe e ngurosur në të përjetshmen. Këta sy Meduze e të këtij gjakimi,të përcjellin edhe në këtë roman.

Po personazhet e Lerës? Ata udhëtojnë mu në mes të këtyre gjakimeve të së kaluarës dhe të së tashmes. Udhëtojnë nëpër Mesdhe,aty ku pikëtakohen kulturat,traditat,utopitë dhe religjionet botërore. Udhëtimi,për ta mënjanuar vëmendjen e Anës nga sëmundja vdekjeprurëse dhe për ta kënaqur atë me bukuritë e mrekullitë e parajsës idilike moderne të shoqërisë së konsumit;përfundon në një spektakël hiçasgjëje,shkretëtire;përfundon pikërisht e shtyrë nga mbufatja për ta krijuar përshtypjen e jetesës në botën reale;se gjithë ky spektakël udhëtimi po bëhet vetëm për Anën...E tëra kjo dëshmon se parajsa e tillë qenka vetëm “një hiper-realitet.” Të duket se është një udhëtim që nuk mbaron kurrë,apo zgjat sa një çast,një orë apo një sekondë (fq 24). Çka i ka rrëmbyer ky hiper-realitet fiktiv Anës dhe atdheut të saj me shumë sëmundje? Autori këtë vetëm sa e sugjeron nëpërmes fatit të dy-tri personazheve fatalë shqiptarë në Greqi (fati i Fridës që përfundon si prostitutë e “afarsitit shqiptar”) a në Itali (fati i një shqiptari të vrarë “pa identitet”):ata nuk janë aktorë,apo “faktorë vendosës”,si thuhet në gjuhën politike,po statistë,imitues a kopjues të jetës së tillë,reprizues të mjerimit e të fatalitetit të vetvetes...Përfundimi e shkrirja me shkretëtirën,do ta ngërthejë edhe anën tjetër të metaforës romanore:kjo është shkretëtira e realitetit! Këto janë simbolet e fuqisë industriale! “Kopjimi është kthyer në mënyrë të jetesës”,klith revoltueshëm narratori i romanit të Lerës. Dhe këtë e thotë,tek shëtit nëpër kërthizën e Mesdheut:në Greqi (aty ngriten përmendore të bukura të mashtrimit),Itali a Algjeri. Sado zhvendosje ngjarjesh që të ketë,sikur kjo Omfali (kërthizë e botës) e Olimpiti grek,gjendet në Shqipëri,ku sintetizohen fatalitetet,mitet,religjionet. Prandaj,dialogu romanor i paraqet refleksionet e personazheve edhe mbi sintezat e civilizimit mesdhetar. Sikur para nesh zgjohen dramat e dikurshme antike,mimesis-i,polis-i,eros-i,katarza...mandej vijnë peizazhet ekzotike,sensibiliteti dhe temeperamenti mediteran. Enigma e pazgjidhur e jetës së përditshme. Dashuria hidhet përballë këtij spektakli indiferent,me gjithë plagët e saj të jetës,me gjithë temperamentin dhe vendosmërinë që jeta të përjetohet “deri në fund.” Poetika romanore e kundërvënies ndaj këtij spektakli të itinerarit modern,na ligjëron se jeta na është kaq e ashpër;e zhveshur aq shumë,sa është bërë “kokërr rëre”. “Njerëzit janë si rëra e shkretërtirës”,thotë Ana. Janë mekanizmat e shoqërisë që e brejnë së brendshmi jetën,që e çojnë drejt zbehjes kufomatike. Kurse personazhet gjakojnë kaq shumë të bukurën,dashurinë dhe atë që mungon. Tashmë udhëtimi i përbashkët,si dhe refleksionet për jetën,vdekjen,dashurinë

dhe përjetësinë,ngërthehen tek qenia e Anës:e tërë qenia e saj,zemra dhe intelekti i saj,janë të hapura ,posi deti,posi viset mesdhetare a posi shkretëtira! Hapësia e qenies. Qenia e hapur! E kaltërta e qiellit dhe e detit,e kuqja e artë e shkretëtirës,e flakës simbolike,e pasioneve njerëzore dhe e bashkësolidarësisë së përvojave... e Artit të harruar të Vetmisë:a nuk dëshiron kështu Nasi Lera të na bëjë më të ndërgjegjshëm për vlerat që kemi në thelbet e brendshme të qenies sonë? Se kështu,ne mund të ekzistojmë,vetëm kur gjendemi në bashkësolidarësi (dashurore) me Tjetrin.

Vlerat e brendshme të ekzistencës:si ta qetësosh vdekjen

Dhimbja dhe simptomet tjera kanë përbërjen e tyre organike,porse dhimbja e sëmundja përmbajnë edhe strukturën e tyre emocionale-piskologjike,shoqërore dhe shpirtërore (Cicely Saunders). Prandaj,një prekje dore,një qëndrim miqësor afër të sëmurës,për të mos e ndjerë ajo veten të vetmuar;një ndarje e emocioneve me të (loti,apo gëzimi);një udhëtim i përbashkët... a nuk janë këto shenja të solidarësisë emocionale e të bashkëvuajtjes në dashuri? Dhe,mbi të gjitha,përjetimi dhe prekja sa më afër e jetës së përditshme,a nuk janë përpjekje që Ana të mos e ndiejë veten jashtë këtij realiteti,po të integruar qenësisht në të? Ata arrijnë t’i vënë urat e mirëkuptimit,të dashurisë e të miqësisë,“deri në çastin e fundit”. Në këtë komunikim nuk ka panik,nuk ka ndjenjë fajësimi a mëshire,as atmosferë frike a mohimi,as largim nga njëri-tjetri a mllëf të pakontrolluar në mes dy të përafëruarve. Atmosfera e tillë krijon mundësi të dihet më shumë për të vërtetën,. Kështu krijohet besimi. Në këtë paliativë romanore ndërfiten edhe personazhë grekë (krijuesi solidar,Akriti,plaku që dhuron një vazë),familja e Savinos,ish ushtar italian në Luftën e Dytë në Shqipëri etj. E çka nuk dëshiron të bëjë Pirroja për Anën që ta largojë atë nga atmosfera e dhimbjes dhe e sëmundjes? Ta largojë nga miti i sëmundjes së kancerit (dikund personazhja atë e përfytyron si një qenie të lashtë mitike). Pirroja përdor të gjithë mekанизmat jetësorë,piskologjikë,miqësorë etj që të ikën sa më larg çdo gjëje që zgjon asociacione të fatalitetit. Ata janë aq gjakueshëm në kërkim të qetësisë,sepse ashtu do t’i shprehin më mirë mendimet dhe ndjenjat. E ku nuk futet Ana me Pirron,për ta qetësuar Vdekjen e Afërt? Futen deri edhe në barkun e një varri për të qëndruar “përkohësisht” jashtë kohës e hapësirës! Ndryshe,të sëmurën shkrimtari e ka nxjerrë nga ambienti i ftohtë i spitalit dhe i hospitalizimit – dhe nga ky këndvështrim trajtimi,ai është thellësisht humanist. Krijuesi qëndron në anën e të drejtave jetësore të Anës deri në “shkrirjen me shkretëtirën”;ai i jep të drejtë Anës të shpresojë;të shprehet,më në fund,hapur për sëmundjen e saj,për jetën dhe për vdekjen që po i afrohet;i jep të drejtën që të marrë përgjigje të hapura e të japë përgjigje të hapura;të dijë për të vërtetën e

të ballafaqohet me vdekjen; ai ia jep të drejtën edhe për të vdekur. Ana, në çastet e tilla, e ka të drejtën edhe për të reflektuar e për t'u interesuar për përvojat shpirtërore/fetare (“Unë i besoj shkretëtirës”, thotë Ana, në vend që të thotë “I besoj Zotit”; semantikisht: e pranon vdekjen hapur, çfarë është, në të drejtën për të jetuar). Ashtu sikundër e bëjnë këtë gjë institucionet paliative botërore, Nasi Lera e respekton edhe mënyrën e veçantë të vdekjes së personazhes së saj paciente. Do të thotë, që personazhet e këtij romani e afirmojnë jetën, kurse vdekjen e shohin si proces normal. Në mes eutanazisë dhe paliativës mjekësore, shkrimtari e përzgjedh metaforën e paliativës së dashurisë për ta mbisunduar vdekjen dhe për ta përqaftuar, më në fund, një fillim të ri, sikundër e sugjeron këtë romani me shumësinë e vet semantike: vdekja është gjendje e re e qenies; Pirroja do të gjendet tashmë në një gjendje të re jetësore, me përskuqjen metaforike të mëngjesit që sjell lindjen e një dite (a kohe) të re. Shkretëriria është në pritje të kthimit të jetës (siç sugjeron rrjeta e pasur e asociacioneve meditative-mediterrane të vetëdijëve të romanit). Posi te Soren Kjerkekord, personazhet e Lerës gjakojnë unitetin e së jashtmes me të brendshmen; gjakojnë mundësitë e pakufishme që shenjojnë një fillim të ri. Ana është posi figurat e femrave moderne të fatalitetit: përjetimi i vuajtjes, i dhimbjes, i frustrimeve – të gjitha këto e tensionojnë dhe e nxisin botën e brendshme psikike të personazhes për reflektime e përsiatje. Ana është siluetë e Antigonës moderne (personazhi e përmend diku një vepër me motiv të tillë të fatalitetit), siluetë e Margaritës së “Faustit” të Gëtes. Ana e Lerës është e zbetë, posi siluetat e saj, porse gjërat qëndrojnë diametralisht të kundërta: ato jetojnë ekskluzivisht në botën e tyre të brendshme; introversionin e tyre ato e paguajnë me jetën e vet. Lera nuk ia kundërvë Anës një dashnor të pabesë. Alesi. Ai vë pranë saj një figurë paliative, që e merr rolin e rrëfimitarit paliativ të romanit me strukturë të tragjedisë moderne: rrëfimi ndodh jo ashtu si dëshiron autori, por ashtu si ia imponon vetëdija e narratorit. E ky personazh që e merr rolin e tillë paliativ-narrativ e që rrëfen aq kujdesshëm në veten e parë, është Pirroja; aq i ndjeshëm për ta larguar Anën nga mbamendja e sëmundjes. E Ana këmbëngul: “Mos më fol me gjuhën e librave, fol më me zërin tënd”. Zatën, a nuk është pikërisht “zëri personal i jetës” kuintesencë e artit?

Gjarpëri si gjerdan, mistika e shkretëtirës

Kur pesonazhja shkon në shkretëtirë: ajo nuk e pret askend, nuk shpreson asgjë, nuk shkon askund. Sprovat janë të rënda, me pasoja të paparashikueshme. Është zhytur në shkretëtirë: sikur dëshiron të mësojë nga secila kokërr zalli, të bëhet njësh me të, me ngrohtësinë e saj... posi asketët që duan ta kalisin idealin

e krishterë a përsosmërinë e amshueshme të një çasti. Shkrimja e tillë dashurore me shkretëtirën,ta sugjeron atë dhuntinë e amshueshme dhe esenciale të flakës në kandilin që nuk shuhet;për ta ngrohë zemrën e drobitur e të cflitur nga frika e parrëfyer prej sëmundjes që të afron gjithnjë e më pranë vdekjes. Posi shtegtarët a pelegrinët e moçëm të dashurisë,qenia e Anës tashmë i lë prapa historinë e memorizuar,dhembjet e Atdheut e dhembjet personale;dhe dëshiron ta jetojë vetëm Atë Çast:krejt e gatshme të pranojë çkadoqoftë. Në shkretëtirë edhe një gjarpër shërben si stoli a si gjerdan rreth qafës! E zhytur në mistikën e shkretëtirës e të Mesdheut,tashmë vetë qenia e saj shndërrohet në Qenie Mistike,në Simbol të Flakës së Kandilit të Pashuar;në Flakë Të Gjallë,në Qenie të Zhdukur,Të Padukshme,posi Elementi i Pestë mistik (janë katër elemente që e përbëjnë jetën),i cili ende nuk mund të shihet as të përceptohet,e,megjithatë,është i pranishëm kudo tek qeniet e gjalla...mbase shkrimtari ka dashur të na thotë që kjo gjithëprani e amshueshme mistike tek këto qenie,është vetë dashuria. Nëse Simone de Beauvoir gruan e konsideronte burim të ekzistencës e jo të lindjes;nëse me qenien e saj asociononte shkretëtirën,si një hapësirë “të shtypur e të ndrydhur me shekuj”,si asociacion të mungesës së jetës;atëherë Nasi Lera,duke i vënë në përçasje gruan dhe shkretëtirën,jetën dhe vdekjen;dëshiron t’i spikatë mu ndërliqësitë dhe laryshinë e jetës e të vlerave të ekzistencës. Porse,shkrimtari Lera reshtet t’i trajtojë enigmat e jetës së përditshme e jo lëndën e ëndrrave,halucinacioneve,situatave të absurdit,të fantastikes apo të gjendjeve iracionale,sikundër veprojnë prozatorë modernë e postmodernë. Zaten,me këso lënde ai ka proceduar artistikisht tek libri i tregimeve “Ulërima e heshtjes”. Përfundimin e tillë të jetës së Anës te “shkrimja me shkretëtirën” do të mund ta lexonim edhe si ironi të hidhur të fatit,si revoltë sociale e njerëzore:kundër burokracive moderne (e të dikurshme si në Delfi),kundër politikanëve që paraqiten si apostuj të tranzicionit demokratik e tashmë të metamorfizuar në afaristë e që e lënë popullin në mëshirën e tij të marrë botën në sy,si judenj të që endeshin në shkretëtirë për Tokën e Premtuar (“do të jetë më mirë”,premtojnë gjithmonë apostujt e tillë të të gjitha kohëve). Endja nëpër tri shtete (kudo gjen shqiptarë e plagë të Atdheut që e ndjek pas),a nuk i ngjet endjes nëpër shkretëtirën e Tokës së premtimeve të mëdha?

Metafora e Natës:paralelizmi semantik dhe ai kompozicional

Brendia e romanit zhvillohet kryesisht natën. Nata nëpër të gjitha faqet e romanit merr rolin e kontrastimit me dritën;ajo ndillet vazhdimisht për ta mbuluar “të vërtetën” për sëmundjen,të cilës i del në ndihmë edhe mjegulla. Ajo e merr

edhe rolin e kategorisë metafizike:ajo është në konflikt kosmik me dritën,ashtu sikundër vetë njeriu është një mikrokosmos i tillë. Errësimi imagjativ i natës dhe mjegullës kontraston me ndriçimin semantik të personazhit narrator:rrjedha e kohës nxit edhe gjendje të ndryshme psikike,kurse bukuria e peizazhit,e hapësirave të jashtme urbane a natyrore,kushtëzohet simbas rrjedhës së kohës,natës a kohës sa zgjat mjegullimi:aq sa zgjat rrjedha e kohës nga një shekull deri te një sekondë. Për ta zënë çastin e një përjetimi të rrallë të dashurisë aq pasionuese:“kishim aq kohë për të jetuar së bashku”. Natës i shkon misteri,e fshehta:Akropoli është simbol e dëshmi e kësaj dashurie kaq të prekshme;ai është edhe “mister i thjeshtë e i pafajshëm,” mbase,për ta ndriçuar semantikisht gjendjen psikike të personazhit. Imazhet imagjinateve esenciale të pamjeve që paraqet Lera,zgjojnë asociacione të shumta,sikundër janë nata dhe drita,mëngjesi dhe lindja e diellit,shkretëtira dhe deti,toka dhe qielli,retë dhe lëvizja e njeriut në udhë. Edhe vetë imazhi e prania e natës subjektivizohen,dramatizohen simbas prirjeve të brendshme të gjendjeve psikike të personazheve. Vetë nata është dramatike dhe i ka tri akte e skena:nata athinase,nata italiane dhe nata algjeriane,me epilogun e ndarjes fatale. Personazhet paraqiten edhe para fytyrës së vërtetë të natës,të sëmundjes,të jetës,të vdekjes e të dhimbjes;e që flet për ekzistencën konkrete të njeriut. Në planin e brendshëm,aktet e kësaj drame e paraqesin natën me kobin e saj që vjen në trok dramatik drejt fundit fatal të personazhes,ajo sjell shqetësime,një kërkesë për ikje e dhimbje;kurse në planin e jashtëm nata përjetohet me gjithë bukuritë,me veskun e saj,me imazhet e me mishërimet e saj hyjnore-mitike,tek i shënjojnë harmoninë,qetësinë dhe të bukurën. Nata nxit asociacionin e enigmave të jetës,krejt në kontrastim me kaosin dinamik të ditës. Dikund në roman flitet për “çnatyralizimin e vdekjes”,mandej për shkrirjen e trupit me natën,me hapësirën,me mëngjesin,e,në fund,me shkretëtirën. Kurse qenia e Anës ndeshet e gjendet në konflikt metafizik (ashtu si është gjithmonshëm qenia njerëzore) me forcat krejt të kundërta:në mes materies dhe frymësisë,trupit dhe shpirtit,përkohësisë e përjetësisë,jetës e vdekjes,tokësore e hyjnore. Nga ky plan kontrastimesh e ndeshjesh,autori kalon në planin e së brendshmes,emocionit dhe heshtjes:“Heshtja është e kaltër”,shkrirja me heshtjen etj. Nata është hapësirë e përshtatshme për t'i projektuar dëshirat,synimet,refleksionet dhe idetë,anise ato nuk mund të realizohen. Nëpërmes paraqitjes së peizazhit,natës dhe udhëtimit,Lera e realizon mrekullisht paralelizmin semantik dhe paralelizmin kompozicional:gjithçka flet dhe bëhet që t'i zbutet dhimbja Anës,ta harrojë,së paku përkohësisht sëmundjen;megjithatë,gjithçka nën mjegullën,(natën athinase,natën italiane,natën algjeriane) narratori ndjell

dhe parandien fatalitetin;nxit vuajtjen e brendshme. Nëpërmes përshkrimit të hapësirës së jashtme,kontrastohen hapësirat e brendshme;hapësirat e jashtme përmbajnë ngjyra,mjegull,fxsime të befta drite...mandej kjo hapësirë tërhiqet ngadalë nga skena romanore,këmbehet me hapjen e perdes së botës së brendshme të personazhit... dhe të personazhes,që nuk gjen ngushëllim.

LIRIKA E INTELIGJENCËS EMOCIONALE

(Agim Deva:librat e poezive për fëmijë “Gurët fluturues” dhe “Mungon një zemër”,Prishtinë 2007)

Të dy librat e fundit poetikë për fëmijë të Agim Devës,“Gurët fluturues” dhe “Mungon një zemër”,e kapërcejnë shifrën prej shtatëdhjetë vëllimesh të botuara të këtij krijuesi letrar e studiuesi të letërsisë. “Herë jam këtu e herë askund/ Rrugët e mia nuk kanë fund”,kuvendon shtruar folësi lirik i poezisë “Zjarr e shi” në librin e fundit poetik “Gurët fluturues”,aty ku ky subjekt,nëpërmes identifikimeve të krijuesit letrar me poetikën e këndimit lirik,shpalos energjinë e pashtershme krijuese. Po kështu,te “Poezia është si unë”,kjo pjekuri e kuvendimit sintetizohet në vargjet:“Si unë është poezia.../ kurrë nuk përfundon”.

1. Kufijtë e padukshëm midis letërsisë për fëmijë e letërsisë për të rritur

Krijuesi Agim Deva në secilin libër dëshmon se mundësitë e këndimit lirik të këtij autori janë të pakufishme:duke i zgjeruar gjithnjë rrahët tematikë me përmbajtje gjithnjë të reja tematike në shqyrtimin me kujdes e në këndvështrimet e pasura të jetës së fëmijëve në rritje e sipër,duke e pasuruar pamjen mbi interesimet,shqetësimet e preokupimet e të vegjëlve,nga njëra anë,si dhe të subjektit lirik të moshuar,të kësaj poezie,nga ana tjetër. Sepse e pakufishme dhe e larmishme është vetë jeta,ashtu sikundër të tilla janë përjetimet dhe bota e njeriut,pa marrë parasysh moshën. Porse Agim Deva,nëpërmes letërsisë për fëmijë,dëshiron t’i komunikojë lexuesit të tij gjëra jashtëzakonisht të rëndësishme;që nga lojërat për fëmijë e deri te shteti,që nga parlamenti apo jeta e rëndë sociale e deri te jeta politike;që nga kujdesi për tjetrin,nga brenga për hallet e tjetrit,e deri te miqësia e kërkimi i harmonisë njerëzore;që nga konfliktet e luftërat e deri te interesat e vockla e kundërsociale;që nga kategoritë etike të së keqes dhe të së mirës e deri te protagonistët lirikë të dashurisë,princat e princeshat. Në këtë univers temash e motivesh të përmbledhura krijuesi shtegton që nga një këshillë për pastërti e për mësimin e vjelë nga përvojat jetësore e deri te gjërat e ndaluara që mbahen në heshtje për të vegjlit,sikundër janë gjërat e prozës së vrazhdë të jetës,aspak poetike,apo sikundër janë edhe paraja,shfrytëzimi i njeriut prej njeriut,pabarazia sociale,paraja si forcë e errët që sundon dhe krijon të mirën e të keqen;e që i iu jep këtë apo atë pamje tejet të

pezmatuar kontrastive gjërave esenciale të kësaj bote. Poetikën e tillë e të rëndë të jetës sociale, poeti e sintetizon me vargjet “Zihet në popull, diçka po zihet/ Ndaj kësaj vjershe s’i duhet arti”. Porse Deva aq sa e poetizon seriozitetin e temës së kënduar, po aq e vë në gërshet lojën dhe përtalljen, kurse në shoqëri atyre ua vë edhe ironinë, mjete poetike këto që nuk janë të rëndomta për moshën e të vegjëlve. Qeshja e fëmijëve te poezia “A të qeshim prapë?...” merr konotacione e ngjyrimë të reja ironike në lirinë me lak në fyt e me duar të shtrira lypësish. Më tutje, qeshja merr ngjyresë zemërate: “Kam frikë, nesër qeshim prapë”, duke e mbuluar ironikisht semantikën e fjalëve luftë apo revolucion me fjalën qeshje. Ndodh kështu, se përpara, në tryezën e leximit, na vjen një krijimtari që tashmë dëshiron të jetë unike, me pikësnyimin t’i bëjë sa më të padukshëm, t’i hallakasë e t’i fshijë kufijtë midis letërsisë për fëmijë e letërsisë për të rritur. Ironia, e kund e kund edhe sarkazmi e satira, fishkëllejnë si attribute të realitetit tonë social.

2. Universi estetik i vizioneve/ realiteti i ndërliqshëm

Vërtet, diçka e pakëndshme ka ndodhur, çuditërisht, edhe pas kësaj lufte çlirimtare! Më se njëherë poeti ua tërheq vëmendjen të rriturve, kryesisht atyre që u mveshën me pushtet, se gjërat kanë marrë teposhtëzen dhe mund të ndodhë shpërthimi popullor. Brezat krijues të Agim Devës tashmë vijnë me përvoja të reja krijues e jetësore. Po edhe fëmijët i kanë përvojat e veta: ata vijnë nga lufta e po rriten nën trysninë e rëndë sociale e politike të mbasluftës. Këta fëmijë nuk janë naivë, sa të mos i kuptojnë gjërat që ndodhin rreth nesh. Qenia poetike e karaktereve lirike të këtyre librave, sa do që është fëmijë, nuk është një qenie infantile, krejt e pasherr; sepse kjo krijesë e vogël di të vërejë, të vëzhgojë dhe të zbulojë me mendjemprehtësi e urti aq e aq gjëra e cene në jetën e të rriturve përreth nesh, aq e aq të meta, ligësi e sjellje që vrasin mendjen e tij e botën e tij; ashtu sikundër edhe entiteti i arrirë poetik, ai i moshës së shtyrë, vetë krijuesi, tek e merr rolin e folësit lirik; është një subjekt me imagjinatë të pasur e me vizione jetësore krejtësisht të lira e jashtë kallëpeve të çfarëdo ngjyre a ideologjizimi qoftë ai. Ndoshta, duke i parë këto vizione kundruall realitetit që nuk ia fsheh fëmijës, ky folës lirik rebelohet, revoltohet, dëshiron ta ndryshojë realitetin, fillimisht me anë të ëndërrimit a revoltës individuale e, mandej, edhe përmes zemërimit kolektiv të qytetarit të kohës sonë. Lirika e këndimit të mirëfilltë ia liron vendin pamjeve të reale të jetës, porse këto pamje na vijnë me ndjeshmëri të re poetike. Protagonistët e poezisë së mëparshme, si Xhela me shokë, tashmë janë rritur, e kanë bërë luftën e tyre, dikush ka rënë në altarin e Atdheut, të tjerët vazhdojnë të jetojnë nën thundrën shtypëse të realitetit të ashpër social. Është

po ky Xhelë që përbën portretin kolektiv të gjeneratave të reja e që i bartën mbi supe kohët që u thyen mbi ne e brenda nesh. E, me këta protagonistë, është rritur edhe poezia, e cila tashmë kuvendon me të rriturin njësoj si me fëmijën. Prandaj edhe poeti për fëmijë bën të tjera kërkime poetikash, kërkon të tjera fjalëfillesash e formulash poetike për t'u dhënë emërtesa të sakta kohëve që po i jetojmë. Se koha e sotme solli jo vetëm përvoja të reja, po edhe njerëz të tjerë, emra të rinj, telashe të tjera, krijues me ide e procedime të tjera që erdhën nga rrugë të ndryshme. Kurse poezia e Devës, pse jo, e tumir këtë situatë të ndryshuar, duke na u paraqitur me pamje të reja e të pazakonshme, të papërjetuara më parë, na vjen me një ndjeshmëri të re humori e përtalljeje, qortimi e urtie, porosie e këndimi. Të duket sikur poeti i ka ndryshuar përmbajtjen e lëndës artistike, po i ka ndryshuar edhe theksin e ritmin, fjalorin poetik a metrikën, procedimorin lirik a përqsajen ndaj jetës dhe artit. Dhe, ky univers kaq i pasur tematik-motivor e ideor, dëshmon edhe për qëndrimin estetik të krijuesit Agim Deva: se shkrimtari për fëmijë nuk zë vend diku në margjina të gjërave në gjirin e jetës shoqërore apo të asaj letrare e kulturore; porse qëndron e lëviz mu në thelbin e këtyre gjërave dhe mu në zemrën e kësaj shoqërie. Nga ana tjetër, duke sjellë informacione diturore të rëndësishme si për të rriturit, ashtu edhe për fëmijët, duke kënduar e trajtuar rrëfime poetike të temave kaq të zymta, të papërballueshme e të ngrysurat të përditshmërisë sonë të mbasluftës, ai na i sjell pikërisht të vërtetat e mëdha të kësaj kohe. Por poeti Deva e respekton nga shumë anë lirinë e botës së fëmijërisë e të fëmijëve, sepse ai nuk i imponon kësaj fëmijërie tendenca a pikëpamje që do ta rrënonin këtë liri; ai dëshiron që ky fëmijë, qoftë edhe i rrituri, të bëhet Njeri në kuptimin e plotë të fjalës, e jo një Homo politicus që tjetërsohet pandalshëm, ani se këtë qenie nuk e lë të qetë zoon politicon-i ynë, sikundër këndohen te poezitë “Çka hanë xhepat”, “Këngë e sotme popullore”, “Karrocieri pa karrocë”, “A të qeshim prapë”, “Xhelë, qëlloja se kush jam”, “Pse pështyn babi në ekran”, “Ëndrra të këqija” etj të librit “Gurët...”; apo “Kjo poezi s’është për fëmijë”, “Thesi është thes”, “Mali”, “Fisnikja dhe muri kinez”, “Kërkuj një fjalë me k” (si e konceptojnë fëmijët fenomenin e korrupsionit), “A është gjallë Migjeni”, “Si shkon në punë një baba”, “Kush ma verboi zogun tim” etj të librit “Mungon një zemër”. Pikërisht mbi këtë taban këndimi poeti sjell thelbin e përmbajtjes së dinjitetit njerëzor që në poezinë e parë me motive lufte, me titullin gurët fluturues: duke kënduar pikëmbështetjen të rrënja atdhetare, nga e cila nuk ke se si të çrrënjosesh, ani se Deva nuk parapëlqen kësaj radhe të rikëndojë e të poetizojë legjenda, përralla e kallëzime të moçme, sikundër veprojë jo pak autorë të letërsisë sonë për fëmijë. Porse fëmijës së subjektit lirik të poezisë së Devës nuk i mungon optimizmi jetësor, e ky optimizëm nuk është as naiv e

as imagjativ,por realist,që kërkon nga ky subjekt të mbajë qëndrim pozitiv ndaj problemeve e aspekteve jetësore. “Optimizmi është shkathtësi e zotësi që mund të mësohet”,thotë Lorens E. Shapiro. Kurse Martin Seligman në veprën e tij “Fëmija optimist”,thotë se njeriu optimist beson në qëndrueshmërinë e ngjarjeve të lumtura,në proceset me përfundim të lumtur dhe merr përgjegjësinë për të ndodhur gjëra të mira. Kundruall situatave të përshkuara me stres social e jetësor,Deva sikur na thotë se fëmijët nuk kemi pse t’i mbrojmë nga realiteti i ashpër,por i mëson ata,që njeriu,me shembullin e tij jetësor,mund të ballafaqohet me situatat më të rënda.

3. Vjershërimet/ në vullanjtë e tipologjisë së lirikës moderne

E tillë është poetika realiste e Devës:sepse përsiatja realiste është objektive,e pikëvështron botën të tillë,çfarë është,dhe lë që të kuptohet tërthorazi se ti duhet të mendosh si t’u përgjigjesh këtyre situatave me anë të vendimit që merr dhe veprimet që e bën. Në tipologjinë e lirikës moderne,poezia e tillë përkufizohet si lirikë e inteligjencës emocionale. Poeti e ka edhe strategjinë e tij poetike për ta ndryshuar realitetin e dhënë:e ka diagnostifikimin e problemit social,jetësor e emocional;e ka tipin strategjik të luftimit të këtij problemi (me anë të trajtës lirike të dinakërisë,duke e rrëfyer problemin në mënyrë të re e dinake),e ka luftën e tij lirike guerile (lejohen të gjitha mjetet deri te revolucioni),e ka sheshin dhe arenën e tij të luftës,kohën më të përshtatshme,aleatët,zonat e lira,po edhe paktin e marrëveshjes si në poezinë “Fisnikja dhe muri kinez”;apo si mund të jetojnë të rriturit e fëmijët etj,si te poezitë “Çka hanë xhepat”,“Këngë e sotme popullore”,“Karrocieri pa karrocë”,“A të qeshim prapë”,“Xhelë,qëlloja se kush jam”,“Pse pështyn babi në ekran”,“Ëndrra të këqija” etj. Kund e kund poezia të duket se herë-herë është një monolog e herë-herë një bisedë e subjektit lirik me vetveten,një si procedimor a mënyrë e të mësuarit të sjelljes së re,si do t’i shkonte në interpretim thënia e Daglas Bloh-ut në librin e tij “Monologu pozitiv për fëmijë”. Aty diku në universin e larmishëm të këtij këndi,përmbliiden dhe e gjejnë trajtimin e tyre edhe tema të “ndryshimit”,të përmirësimit të botës apo tema alkimike,tema të dashurisë së parë,që këndohen e kujtohen mjeshtërisht nga dy kënde ligjërimi:nga ai i folësit lirik të fëmijës dhe nga plani i kujtesës jetësore të të rriturit (poezitë “Klara”,“Çka pa hëpna në dritare” të librit të parë,apo “Mungon një zemër”,“Maji etj të librit të dytë). Aty poeti sjell imagjinatë dhe përshkrim real të gjendjes,sjell dashuri të ngrohtë,sjell miqësi dhe lojëra. Në kornizat e tilla të imagjinuara poetike të rritjes së këtyre fëmijëve,ai i vendos protagonistët e vegjël,nga njëra anë,si dhe subjektin e rritur poetik,nga ana.

Folësi lirik e merr përdore lexuesin e tij të vogël a po për të rritur. Tema bosht që mbizotëron kësaj radhe në këta dy libra poetikë, është raporti në mes të fëmijëve dhe të rriturve. Poeti na thotë se në imagjinatë ka gjithçka më të bukur se në jetën e përditshme, kurse jeta e përditshme, me andrallat e saj, po edhe me përvojat, preokupimet, interesimet, përjetimet, pamjet e ndodhitë, është po aq e pasur, sa edhe universi i imagjinatës. Dhe le t' i lexojmë këta dy libra si metafora të kohës sonë. Poeti e ndan librin në vjershërime, sikundër e përdor këtë nocion të bartur nga rilindësit tanë, për të na sugjeruar vertikalen e këndimit tonë klasik/modern. Trajta e vargut a e vjershërimit, i përgjigjet kërkesës së fëmijës për thënie të formuara ritmike, me rimarium aq të pasur, e të cilat shndërrohen mjeshtërisht në lojë. Duke ndër nevojë, që, kund e kund, të rrëfejë, poeti trajton edhe vjershërime ca më të gjata e që për afrohen me poemën: “Kush ma gjen Gjonin” (evokim i valëve të jetës për një nxënës të talentuar të dikurshëm që ka shkruar vjersha, por tani i tretur me gjithë prirjen e tij), “Pallati me rrufepritës” (jeta urbane me kontrastet e mahisura e të acaruar), “Nga më çon karroca ime” (përsiatje lirike për situatat sociale-jetësore e për realitetin e ndërliqshëm, për botën gjithë labirinte të artit, diturisë etj), “Skënderi e singeri” (portreti psikobiografik e psikosocial i një rrobaqepësi të braktisur në moshë të thellë në një simetri kontrastuese kohësh) e ndonjë tjetër – te libri i parë; apo “Roli i skamnorit” (po i njëjti portret psiko-social-biografik i një aktori po ashtu të braktisur, të lënë pas dore, pa përkujdesje, pa ndihmë e pa përkrahje e ku shoqëria e “konsumit” ia kthen shpinën në moshë të thellë), “Çokolatat” (përsiatje imagjinative e me figura të çrëndomtësuar për fatin jetësor), “Kush ma verboi zogun tim” (mësuesi hallexhi në hapësirat e parlamentit përballë ish nxënësit të tij, tani i tjetërsuar e me shpirt të korrumpuar) e ndonjë tjetër – te libri i dytë. Deformimet e tilla sociale, politike e jetësore, e kanë pezmatuar aq shumë jetën tonë dhe pamjet e tilla janë të stisura në të dy librat. Së këndejmi, poema i jep mundësi autorit t' i ndër lidhë poezinë me rrëfimin lirik, duke e zgjeruar dhe zgjatur kënaqësinë e receptimit. Poeti këmbëngul që lexuesit të tij të vogël, a ca të rritur, t' ia komunikojë një pamje, një ngjarje, një rrëfim, një mbresë e, po ky lexues, në të gjitha këto, do ta rinjihte vetveten dhe do t' i ndriçohej më mirë rruga për t' i parë problemet e shqetësimet që e mendojnë. Në planin tematik autori, pra, ndër fut edhe përpunime të tilla artistike që nuk i drejtohen vetëm lexuesit të vogël. Agim Deva është i ndërgjegjshëm se zhvillimet letrare gjatë shekullit që e lamë pas, e kanë zhvilluar edhe prirjen për t' i lëkundur kufijtë e themelet e letërsisë së mëparshme, sepse fjala e shkruar nuk është privilegj vetëm i të rriturve, po edhe i të vegjëlve; tek kanë përjetuar përhapje të shpejtë zhvillimi urban, teknologjia informative, sistemet e reformuara arsimore, teknologjitë e reja të mësimin e të

metodikës së mësimdhënies. Së këndejmi, tekstet e shkrimit letrarë tashmë e kanë braktisur rolin e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë në procesin e njohjeve e të thënies estetike: e pra, do të thotë se kufijtë në mes letërsisë për fëmijë e asaj për të rritur tashmë janë zvogëluar. Te e fundit, kjo poezi na fton që ta lexojnë po e me të njëjtën kërshtëri edhe të rriturit. Kjo do të thotë se letërsia për fëmijë tashmë e ka arritur shkallën e mirënjohjes shoqërore, shkallën e receptimit nga të gjitha moshat. Lirika e tillë ia kalon së ashtuquajturës letërsi për të rritur në komunikim. Letërsinë e tillë mund ta krijojnë e ta shkruajnë vetëm poetët me pjekuri, urti e dhunti të mëdha krijuese.

ROMANI “PASIO” I ANTON GOJÇAJT

Të mos harrojmë:një letërsi e tërë rrëfëhet në tipin e passio-s. Passio është edhe rrëfimi funksional,i shpërndërrimit të tensionit jetësor në një tension rrëfimor ekzistencial,një ngjarje e jetuar shpërndërrohet në ngjarje tërheqëse të përjetuar...Është rrëfimi për vuajtjen,të cilës i jepet kuptim nëpërmes rrëfimit. Passio quhen edhe rrëfimet biblike për vuajtjet e kalvarin e Jezusit,gjithandej janë rrëfimet për vuajtjet e personazhit deri te antiteza kryqëzim/ringjallje,ripërtëritje...Këtë paradigmë të bukur biblike Anton Gojçaj arrin ta funksionalizojë artistikisht nëpërmes ankthit ëndërrues e psikologjik të piktorit mërgimtar Jozef Montanaro-s që arrin përsëri të bëhet Zef Gjoni i dikurshëm. J.M Adam (Les Textes:types et prototypes,Paris,1997) do të theksonte se fenomeni i passio-s i referohet një situatë të përgjithshme emocionale:një ndjenjeje të fuqishme të dimensionit emocional,të zgjuar nga zëri i përvojës,që e nxjerr në pah pasiviteti! Madje, personazhi ka shfaqur dëshirën e tij,të selitur nëpër dekada,që ta harrojë krejtësisht të kaluarën,idenitetin,familjen...Të duket se Jozefi zgjohet nga ky pasivitet shumë dekadash dhe këtu zë fill romani. Emocioni i rikthehet rrëfimit:porse ky emocion është kaq e kaq i kontrollueshëm nga ana e narratorit objektiv të romanit. Nga ana tjetër,passio dhe narratio kundërveprojnë dhe bashkëpunojnë:do të thotë passio (reflektimi,ndërdija,ëndërrimi) dhe narracioni i japin e i marrin njëri-tjetrit. E papritura këtu vjen nga zgjimi i Jozefit për të ndërmarrë një aventurë të kthimit kah vetvetja e për t’u kthyer,së fundmi,në vendlindje:aty ku ai takohet me nënën e tij,martohet,i lind trashëgimtari (shenjë e trashëgimisë etnike të mendësisë shqiptare) dhe jeta vazhdon e ringjallur pas një tragjike të shumëfishtë,të zhvilluar në heshtje.

1.

Jozef Montanaro (Zef Gjoni),piktor vetmitar,i njohur që jeton në Nju Jork,i pamartuar,shëh në ëndërr,që,në prag të festave të ringjalljes së Jezu Krishtit,armiqtë e Malësisë ia vrasin babanë,në përpjekje për t’ia shpëtuar Qengjin Zefit të vogël. Këtu zë fill gjithçka te ky roman. Në “Librin mbi Jobin”thuhet:“Në një ëndërr,në një vegim të natës,kur një gjumë i rëndë i zë njerëzit,kur dremitin në shtretërit e tyre,Atëherë ai hap veshët e njerëzve dhe vulos paralajmërimet që u bënë,për ta larguar njeriun nga veprimet e tij dhe për ta mbajtur larg nga kryelartësia,për të shpëtuar shpirtin e tij nga gropa dhe për të penguar që jeta e tij të mbarojë nga shpata.” (JOBI,33,15-18). Po e thërrasim në ndihmë edhe Gustavus Hindman Miller-in,i cili në “Leksikonin e ëndrrave –interpretime” thotë:“Nëse e shihni në ëndërr babain tuaj,do të thotë se ju

jeni gati të përfshiheni në vështirësi dhe ju duhet një mbrojtës i mençur për të dalë nga ajo situatë.” Sa e sa herë e kemi ndeshur në letërsi projektionin ideal të ëndrrës,të vegimit a të idealitetit etnik,të identitetit personal e të atij nacional,tek paraqitet si korrekativ i vetëdijes së heroit. Duke qenë studiues i veprës së Anton Harapit (ka botuar studimin “Fakticiteti në letërsi,Proza letrare e Anton Harapit,BUZUKU,Prishtinë 2007),Anton Gojçaj ndjek paradigmen letrare të prozës sonë të traditës. Po te kjo traditë shkrimi do përmendur edhe “Andrrën e jetës” të Ndre Mjedjes. Nga ato anë është Martin Camaj.

Nga ato anë është edhe autori i romanit “Passio”,Anton Gojçaj,i formuar nga ato tradita letrare,të cilat e shqiptojnë fuqinë e shkrimit si tekst letrar. Ndryshe nuk ke si e kupton atë thukni stili të narracionit. Ëndrra e Zefit është një ajo ndërvoja e skalitur kolektive te ky personazh;me hallakatjet e polemik të Malësisë nëpër të katër anët e rruzullmit. Ëndrra është trajtë e rrëfimit,por ëndrra është edhe trajtë e dytë e ekzistimit. Nga ëndrra shpërthejnë përvijimet e jetës reale. Pranë e pranë vihen lirikja e dramatikja,plaga e kurbetit me amullinë e ambientit jetësor kundruall romantikës së vazhdimësisë së jetës,lirizmi refleksiv kundruall një narracioni të një shpirti të trazuar. Ëndrra për babën e vvarë,për ta shpëtuar Qengjin,simbol biblik i pafajësisë për mëktatet e botës,simbol i ringjalljes pas martirizimit,zgjon asociaconin e veprës së Harapit për copëtimin e trojeve shqiptare,Malësisë,etnisë më të pafajshme,që e sakrifikojnë dhe e kryqëzojnë me Anë të copëtimin e dhunës. Kurse qengji këtu thur Arketipin e Ringjalljes në disa nivele:të ringjalljes individuale (ringjallja e familjes),të ringjalljes si Zë i Ndërgjegjes (ringjallja e Truallit Etnik) dhe të ringjalljes në shkallë të ndërgjegjes së Kulturës/besimit. Të gjithë këta zëra të brendshëm,përmes një rrëfimi në veten e tretë,i faniten personazhit si rrjedhë e ndërvojes,përmes ëndërrimit e ëndrrës,përmes kujtimeve e përmes teknikës së introspektionit,tek ky personazh nuk mund të shqitet nga ngjarjet e rënda të së kaluarës,nga koha me peshën e ngjarjeve,me barrën e rëndë të kujtimeve e me barrën e bëmave historike. Transformimet moderne narrative,saktësimi dhe ngjizja e ideve,koherenca e tekstit artistik në rrethana të ndryshme të komunikimit artistik (Dressler),e ka çuar këtë prozë tek funksionet thellësore krijuese të gjuhës e të fiksionit letrar. Të gjitha këto perspektiva narrative,në këtë roman,konvergojnë njëra me tjerën në mënyrë të habitshme,të magjishme.

2.

Të gjitha këto theksime të fillimit na çojnë andej,kah një lexim i mundshëm i romanit “Passio”. Tek e fundit,është thënë që intepretimi i një vepre letrare nuk merr fund asnjëherë,nuk ka lexim përfundimtar a lexim të kryer. Kontekstet e dikurshme të leximit prodhojnë kontekste të reja. Zhak Derrida do të

nënvizonte se asnjë kontekst nuk ka se si të mbyllet brenda vetvetes. Hapësirat e veprimit,kronotopi i ëndrës e i veprimit jetësor,shfaqen e zhdrivillohen që nga Nju Jorku e deri në Malësi. Nga ana tjetër,duke e vënë pranë e pranë pikturën dhe jetën,pikturën dhe artin e fjalës,pikturën dhe etninë...shkrimtari thur ndërlihdje konkrete të ndërkomunikimit estetik,sepse aty ku pena i ligjëron intelektit,aty ngjyra do t'i drejtohej,gjithsesi,ndjesive. Kështu do të ketë nënvizuar Ben Xhonsn, kur fliste për strukturat krahasimtare të letërsisë dhe pikturës. Naracioni me reminishencat për pikturën,së bashku,do ta krijojnë një shtresë tjetër,të ndërliqshme,të kësaj vepre letrare:atë sintezën në mes Pikturës e Fjalës,të Artit e të Jetës e të Etnisë,të Mitit,të Historisë dhe të Tragjikës. Mandej lëvizin figurat e dhembjes e të harrimit,figurat e vuajtjeve të zgjimit,të cilat shenjojnë akte e shkallë të njohjes e të rinjohjes,të kërkimit e të dhembjes. Shtegtimi,gati si një aventurë shpirti,gjithnjë merr fund me kthimin e personazhit te vetja,te bota e tij e brendshme. Nga kjo hapësirë e brendshme rrezaton një energji e pasionit dhe e gjakimit për t'i arritur kulmet e jetës së ardhur,të bëshme,pra të pjekur. Çlirimin përmes katarzës së Artit,do ta ndiejë si kthim kah vetja,si rilindje e jetës dhe artit...si rilindje e etnisë në trojet e bjerra. Kuvendimi ndërkomunikues në mes artit e jetës,shndërrohet në përgjërimit për ta interpretuar artistikisht klithmën e zërit të dikurshëm që e thërret:“Zef ktheu”,ashtu sikundër aty ndërkomunikon edhe ëndrra me pasionin për jetën dhe artin.... si shenjë për të mos e humbur rrugën gjatë aventurave të shpirtit a gjatë odiseiadave të jetës. Nga elegjia jetësore e nga zëri i thellë i ndërdisjes,zgjohet thirrja për t'iu kthyer vendlindjes,vetes,identitetit të bjerrur...Ndërthuren situata të heshtjes me ato të ethshme. Aty i lexojmë situatat e ankthit,të ëndrës kundruall realitetit rrëgjues,të cilin duan ta ringjallin.

Te hapësira strukturore e tekstit romanor,te hapësira shumëdimensionale e figurës pikturore;te arketipat polisemantikë të ëndrës dhe ëndërrimit...aty bëhet krejt e afërt njajo prekje e brendshme e qenies së fshehtë estetike të artit dhe njajo frymë ndërkomunikuese e së bukurës. Krijuesi tashmë ka hyrë,kështu,në hapësirat ontike e ekzistencialiste të estetikës. Sipas kësaj estetike vepra artistike është krijim ontik:ajo nuk paraqet e as nuk shenjon asgjë jashtë vetes;ajo (vepra) e paraqet dhe e shenjon vetëm vetveten,dhe,së fundi,ajo është shprehje e përsëritjes së vetë qenies,do të thotë qenka qenie e qeniesuar.

SHKRIMTARI THANI NAQO DHE ROMANI I TIJ I RI “MURMASHËT

Kushdo që zbret në Tampa të SHBA, nga bashkëatdhetarët, do të gjejë një pritje të ngrohtë nga ata që janë vendosur aty prej vitesh. Cdonjeri prej tyre ka një histori të veçantë. Dikush është mbyllur në vetvete dhe sheh vetëm mundësinë për një jetë më të mirë për familjen. Por ka edhe nga ata që mendojnë edhe për të mirën e bashkëbesëlidhësve të tjerë. I kudo ndodhur është njëri prej tyre, që përveç punës së përditëshme, bisedon me bashkëkombasit e tij, jep mendime dhe i dëgjon ata, gjen kohë për të hedhur në letër mendimet e tij për shoqërinë, jetën e bashkëatdhetarëve, hallet dhe gëzimet e tyre. Ai quhet Thani Naqo që vjen nga një familje e dëgjuar e Ziçishtit. Gjyshi i tij ka qënë vendosur prej kohësh në Amerikë dhe aty i la kockat e tij. Edhe të afërm të tjerë aty i kanë varret e tyre, apo të tjerë nuk dihet ku prehen...Thani i kujton ata here pas here dhe rrëmon për të ndërtuar gjenealogjinë e familjes së afërt dhe të largët... Libri i tij i parë me tregime, “Shtëpia e përgjumur”, është botuar në vitin 1977, kur ishte student në Fakultetin Ekonomik. Njëri nga recezentët ka qënë shkrimtari Dritëro Agolli dhe, në kapakun e dosjes ku qe dorëshkrimi, ai kishte shkruar : të botohen kështu siç janë. Botim të parë për publikun Thani kujton tregimin “Duke kërkuar manarin”, i cili fitoi çmimin e parë në konkursin e letrarëve në Korçë. Gazeta Bashkimi e botoi atë. Ka qënë pragdimri i vitit 1972. Ishte gjimnazist, mustaqe porsadirsur dhe ende nuk kishte vënë brisk në faqe. Pastaj ai nisi të botojë libra me poezi, me tregime, romane, të shkruajë skenare filmash...Fitoi dhe çmimin e dytë me poezinë për Nënë Terezën, dhënë nga Universiteti Popullor Shqiptar në Gjenevë. Poezitë dhe lirikat e tij përmbajnë nota realiste për vëllezërit e tij nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Ndër të tjera ka botuar librat me poezi dhe lirika “Fate paralele”, “Capkënet e mëhallave të botës” “Sinfonitë e stinëve”, romanin “Përgjumje iluzionesh”, skenarin e filmit “Përsëri pranverë”, etj. Dikush mund të thotë nga ju se unë jam tepër entuziast kur është fjala për poezitë, tregimet, romanet e shkrimtarit Thani Naqo që jeton në Florida të SHBA. Por e them pa doreza se pas botimit të disa vëllimeve me poezi dhe lirika, romani i fundit i tij “Murmashët” është pritur me tepër interes nga lexues edhe në Largo e Clearëater të Floridës, ku unë pata fatin të kem në dorë kohët e fundit romanin me autograf nga autori. Disa prej tyre ja kanë shprehur edhe Thanit në bisedat e lira, por unë mendova se me disa rreshta të shpreh atë që ndjejnë ata duke lexuar këtë roman, që

shënon një arritje të shkrimtarit tonë të urtë, të ditur e me vizion të largët. Jo vetem shkrimtarë, por edhe lexues të pasionuar pas letërsisë shqipe, miq të tij në Shqipëri, Kosovë, Greqi, Amerikë e gjetiu, në mesazhet e tyre shprehen se shpesh në personazhet e sjella në roman prej Thanit ata gjejnë veten apo atë të bashkëbesëlidhësve të tyre. - Romani përmban shumë nota reale, nga jeta e përditëshme e bashkëkombasve tanë jo vetëm në Amerikë por kudo ku ata janë vendosur përkohësisht apo përgjithmonë.- Thani Naqo është një vëzhgues i mprehtë i realitetit shqiptar në Shqipëri por edhe në Diasporë. Siç shprehet vetë autori: “Në romanin Murmashët i kam mëshuar më tepër realitetit të përjetuar dhe fantasia letrare mbështet qëllimin tim. Realiteti në këtë libër është konceptuar nga këndvështrimi një emigranti të rregjur në botën Perëndimore. Ndjesitë dhe subkoshiençën e tij ia përcjell lexuesit shqiptar. Ky pozicionim në këtë vepër është krejt i ndryshëm nga pikpamja tradicionale shqiptare dhe kjo do ta bëjë që lexuesi të përdredhë vetullat i habitur. Pra, lexuesi do të ndodhet midis përplasjesh morale tradicionale të nacionaliteteve botërore. Ajo, që për botën e zhvilluar Perëndimore është e natyrshme, për tradicionalizmin shqiptar shfaqet me nuanca dramatiko-tragjike”.- Gjuha e qëlluar e përdorur në roman i përshtatet tepër personazheve të krijuara prej tij.- Romani lexohet me një frymë dhe është e vështirë të shkëputesh prej tij kur fillon e lexon. Shume prej lexuesve kanë qëndruar edhe në orët e vona të natës për të parë ecurinë e romanit dhe të personazheve të tij. “Murmashët” nuk është aq shumë fantazi, sepse ajo është bota e brendëshme njerëzore.- Pas romanit të Thani Naqos “Pergjumje iluzionesh”, lexuesi ndjen se ka një vazhdimësi figurash të arritura dhe ngjarjesh që lidhen me Diasporën shqiptare këto vite të tranzicionit.- Tek Thani Naqo sheh të mishëruar figurën e shqiptarit patriot dhe të palodhur që me art dhe me një penë të hollë sjell ndjenjat, pasionet, virtutet, dashurinë, mallin, si dhe traditat e mira të bashkëkombasit. I uroj nga zemra shkrimtarit tonë Thani Naqo të vazhdojë të shkruajë dhe të na japë vepra të tilla të arrira që i duhen lexuesit shqiptar, përballë një morie veprash të autorëve të huaj që shpesh me pa të drejtë serviren nga shtëpitë tona botuese dhe reklama maramendëse e tyre. Nuk jam kundër paraqitjes së vlerave të veprave të shkrimtarëve të huaj me zë, por jo që çdo gjë e huaj të na serviret dhe të harrohet letërsia e bukur shqipe. Do të uroja që romani “Murmashët » të përkthehej edhe në gjuhën angleze pasi nderon letrat shqipe.

Murmashët - Roman nga Thani Naqo

(Demonët bëjnë sikur flenë)

1

Letrën e kishte lexuar disa herë dhe sot në mëngjes Artan Bareli pati ndjesinë se ç'shkruhej në të i dinte të gjitha përmendësh. Ardhja e Anita Traboninit në Amerikë i zgjoi kujtesën e një çerek shekulli të shkuar dhe ai kishte rënë në kurthin e ankthit që sjell pritja. Ndezi cigaren dhe hodhi shikimin mbi kurorat gjigante të pemëve tropikale. Tufa e shpendëve murmashë oqeanorë vinte rrotull mbi to dhe kjo i kujtoi se shiu do të befte së shpejti. Thëthiu etshëm cigaren dhe pa dashje i doli psherëtima që u pasua me rrathë tymi mbi kokën e tij.

-Eh, Anita Trabonini - tha gati me zë.

Termometri amerikan tregonte 90 gradë nën hije, zagushi e mbetur pezull, por e nxehta e tropikut Artan Barelin nuk e bezdiste aspak. Nëse qëndronte në sallonin e pritjes, atij i duhej të përballej me ankimet e përditshme të nënës për dhimbjen e kockave nga reumatizma, ndërsa pompa, që përdorte i ati me astmë, lëshonte kërcitje dhe atij i linin përshtypjen se dikush ecte përmbi lajthi. Pasioni i dikurshëm për gdhendje në dru iu rizgjua tre muaj të shkuara kur ai u ndje i ngeshëm nga papunësia për shkak të krizës ekonomike. Rastësisht i pati zënë syri në një garash-shitje gleta, thika dhe çekiç; i zoti i tyre kishte ndërruar jetë dhe, mikesha e tij, trupmadhe e tejet e shëndoshë, i kërkoi dhjetë dollarë për to.

-Mjaftojnë për qirinjtë e përshpirtjes - kishte thënë ajo, ndërsa ai u pati hedhur një sy relieveve në dru. Talenti i gdhendësit të vdekur tregonte haptazi maninë e tepruar ndaj frutave dhe perimeve.

-Ishte vegetarian. Sa kam unë një rën këmbë - kishte bërë shaka e zonja e shtëpisë - aq peshonte trupi i Xhonit. Ama, i tha lamtumirë kësaj bote, i ngopur me të gjitha - dhe ai mezi kishte mbajtur të qeshurën kur përfytyroi skenën romantike të seksit të tyre.

Mbi 40-vjet Përpraim Hysi ka punuar mësues dhe gjithmonë ka dhënë gjuhë dhe letërsi shqipe. Pothuaj gjithë vjetët ka punuar në fshat dhe kjo ndodhte për arsye biografie.

Ka lindur në fshatin Petovë të Fierit më 21 janar 1943. Në vitin 1959 ka mbaruar shkollën Pedagogjike (ish Normale), në Elbasan. Është diplomuar për gjuhë-letërsi (me korrespondencë) në vitin 1973. Gjatë kohës së diktaturës nuk ka shkruar asnjë rresht. Kur erdhi Demokracia ka filluar të shkruajë, fillimisht në poezi e, mandej, në prozë. Në Shqipëri deri në vitin 2000 ka botuar 4 libra me poezi. Është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë qysh nga krijimi i kësaj shoqate... Gjithë kohën ka qenë kryetar i zonës për lëndët e sipërme: ka marrë pjesë në seminare kombëtare, i dërguar nga rethi, dhe ka drejtuar kurse kualifikimi për mësuesët jo vetën në zonë, por edhe në rreth.

Është rast i jashtëzakonshëm: nuk është dekoruar asnjëherë se, megjithëse propozohet, pothuaj, një herë në 5-vjet, kurrë nuk u pa e “arsyeshme”, për “arsye shtetërore?” Ndaj ka të drejtë të shkruaj poezinë metaforë ”Koha”ku shkruan:

Koha ka veshur pantofla
Dhe reshperon pa u ndjerë
Po mua pse më bloi në mokrra?
Ç’është ky mister?.

Ka qenë drejtor shkolle, formator për mësuesët e qytetit (sado që punnte në fshat!), inspektor në Drejtorinë Arsimore të Fierit për 4-vjet (1996-2000). Në vitet e demokracisë ka kandinduar për deputet si përfaqësues i PD në zgjedhjet e para pluraliste dhe nuk fitoi. Ka qenë kryetar i Komitetit Ekzekutiv Pluralist për zonën Qendër në Fier dhe ka dhënë dorëheqje pas 4-mujësh ku dhe deklaroi: “Pushteti ma shpallë. Më tremb më shumë edhe se lufta. Është kalë që më hipën dhe shtylla ime kurrizore nuk e duron një suport të tillë”. Mund të haja me “lugë floriri” se ndava mbi 120 troje në Fier dhe bëra mbi 300 pashaportizime. Dhe mbeta pa kacidhe, Kam shkruar dhe botuar në Shqipëri 4 libra me poezi lirike dhe, kur po bëhesha gati të nxirrja të pestin, erdha në Amerikë. Ky, libri i pestë, pret i ndrymë në sirtar ashtu siç presin qindra poezi dhe disa tregime që, për “arsye objektive” tani nuk i botoj dot. Në s’arritsha t’i botoj, se plak jam tani, do ngjallem luvgat, se ky është pengu im. Sa për shkrimet e mia, mos kujtoni se jam narcisist. Për të formuar edhe një përshtypje më të plotë për mua, lexoni këtë poezi:

Po thanë për mua
Po thanë për mua
Si mësues? Ç’ka! Mesatar...
E çfarë ka këtu për t’u zëmëruar?

Po thanë
Si krijues? Shkruan shumë
Dhe për lumë?!...
E pse do hidhërohem unë?!

Por po thanë
Se zhgënjeva dikë si njeri
Atëherë kush t’ më dojë
Të më qajë me oi...

Botime:

- 1.Rekëtimat e dashurisë
- 2.Prushi i dashurisë
- 3.Më piku dashuria
- 4.”Luftë me dashurinë
- 5.Mbeta dashurive
- 6.Kot jam i vdekshëm
- 7.Njerëz që du a
- 8.Kurthi i mallit
- 9.Tregime.

Etj,

Në poezitë e tij të këtij vëllimi autori i çmon lart virtytet dhe cilësitë e fëmërës, që e dashuron dhe që i jep “leksionin e parë”. Faqe pas faqeje, “plakushi” Papi, me zemër të re, bie në ekstazë dhe magjepset para shikimit zhbirues të femrave, e vë kokën në prehërin e tyre, ku gjen qetësi e shikon dritën verbuese në sytë e tyre. Figurat janë të gjetura, gjuha e pasur e, së bashku, të joshin e të bëjnë të ecësh në rrjedhat e dashurive të Papis. Ato, megjithëse ai është ca i moshuar, nuk kanë të sosur, se edhe jeta e tillë është.

Vëllimi i dytë mban titullin simbolik “Kurthi i mallit”. Janë 99 poezi, se, me ato që shkruan, Përparim Hysi ka bërë e bën të 99-tat në fushën e dashurisë (ha,ha). Por, siç dëshmon dhe përvoja e tij, shpesh në këtë udhë mund të ndodhesh edhe në “kurthin” e paparitur të saj. Ndërsa kësaj here ai e ka fjalën për një dashuri tjetër, që është mbi të gjitha dashuritë: ajo për vendlindjen, për Atdheun. I ndodhur kaq vite emigrant, kur mediton, kur udhëton ose kur pushon, por edhe në gjumë atij i shfaqen bukuritë e tij, e pushton malli i pashuar për të. Vërtet e ndan një oqean me kontinentin e tokës, ku ai ka të parët, por malli e zhurit për gjithçka: “Oqeani duket sikur ka marrë zjarr,/ në këtë perëndim krejt të kuq,/ po mendja ime s’ di nga ka marrë,/ që “vidhet” nga unë, e ka bërë huq...”. Ai pret të daravitet mjegulla e të hidhet përtej Oqeanit Atlantik: “Për matanë, ku më është Shqipëria;/ më griu, më griu malli për të,/ largohu, o mjegull, nga gjithësia,/ nuk pres, nuk pres dot më!” Atje, në dhe të huaj, ai sjell ndërmend fusha e male, lumenj e liqenet, ndjen aromën e mirë të tokës stërgjyshore. E ka marrë malli për fshatra e qytete, për Fierin, Elbasanin, Tiranën...Sepse “Unë kam lindur në

Petovë,/ njoh çdo lagje, çdo shtëpi;/ edhe sikur të mbetem qorr,/ unë, s' humbas, rrugët i di...”.

Në përgjithësi, në tërë këtë vëllim, me vjarsha malli e dashurie, autori na jep detaje të dhimbjes, brengave e mallit të tij të zjarrtë për Shqipërinë e tij të dashur, që asnjë çast nuk i del nga mendja: “Kur them kështu, e kam për mallin për Atdhenë,/ që ngrihet mbi çdo mal, më i lartë se Everesti,/ këtë mall e kupton kush lë si unë Atdhenë,/ nga kurthi i këtij malli, s' shpëton deri sa të vdesi!” Me zemër të plagosur, ai thërret me vargun e tij, që ta dëgjojnë të gjithë e kurrë të mos largohen nga pragu, ku u ka rënë koka: “M'u ça zemra, m'u bë thela-thela,/ se ika nga vendi, nga vendi ku leva./ Kështu jam këtu, me zemër të çarë,/ s' e di si rroj, i vdekur apo i gjallë?!” Prandaj shkruan me lotë në sy dhe një vjershë me titullin domethënës, për tokën ku i ka lënë rrënjët e tij: “Ma lini derën hapur, se jam nisur dhe do të vij!...”

Një njeri me ndjenja të holla, buzagaz e shpirtgjerë si Përparim Hysi, shkruan dhe vëllimin me poezi “Një rëz që dua”. Janë 92 krijime të tilla, që na mbërthejnë me bukurinë e vargjeve të tij. Prandaj janë që në fillim krijime të frymëzuara, kushtuar profesores Vjollca Omari, “Nderit të Kombit” Petro Marko, babait Hazis Hysi, vëllait Hilmi, kunatit Ismet, bashkëshortes Sika e mbesave Alba, Jola e Megi dhe bashkëkrahinasit Avdul Çepele. Në kujtimin për nënën e paharruar, Zegjine, shpërthen: “Vdiq nëna, po unë nuk jamë atje,/ që t'i hidhja qoftë dhe një grusht dhe./ A ka mallkim më të rëndë në botë,/ pse më ke mallkuar kaq rëndë, o Zot?” Por autori i kujton me vargun e përmalluar edhe mësuesit Dhoksi e Sotir Meço, poetin Bashkim Çepele, Profesor Dhimitër Shuteriqin, Vangjush Mion, mikun Zenel Sallata, poetin Spiro Sota e Kujtim Spahivoglin. Ashtu si në poezitë e mëparshme të këtij vëllimi, në vargjet e dhimbshme, në kujtim të Prof. Jup Kastriotit, shkruan: “Një vit u mbush. Ku je, Profesor?/ Mungesa juaj: e madhe, e dhimbshme,/ të presim, si gjithmonë, në auditor,/ të dëgjojmë fjalën tuaj të magjishme”.

Varg e varg dhe kujtonn e nderon me poezitë e tij shkrimtarë, poetë e artistë, si: Migjenin, L. Poredecin, F. Rreshpjen, Ali Asllanin, Nexhat Hakiun, Dhori Qiriazin, Agim ë penën e tij gjejnë vend edhe kolegët e sotëm të fjalës së gdhendur në poezi: Vangjush Ziko, Xhevahir Spahiu, Monda Moisiu e Grigor Jovani... Po a mund t'i përmendësh të gjithë ata, që Papi u ngriti “lapidarë” me vargjet e tij?

Në vëllimin tjetër, “Kot jam I vdekshëm”, në 104 poezi të bukura, Përparim Hysi përsëri e rimerr temën e dashurisë, kësaj ndjenje të përhershme njerëzore. Por, tashmë, ai shkruan me nostalgji për kohën e shkuar dhe nuk do që ta pranojë se i ka ardhur pleqëria. Një femër atë e sheh ngultazi, por ky e mallkon me zemër

e shkruan: “Se s’duroj, kur sytë m’i ngul,/ një mendim më vjen, më shkul,/ vjen më shkul, më ngre nga vendi/ dhe ndjek syrin që më “hëngri”. I përhumbur në vitet e tij, ai kujton vajzën nga fshati: “O, moj vajzë nga Libofsha,/ s’të harroj, që unë mos qofsha!/ Si ta harroj syrin filxhan?/ Jo nuk mundem, moj, aman!” Plakushi është në siklet dhe shpërthen: “Mirë llërët përjashta; gjoksin pse zbuluar,/ apo më fut dreqin, sa për t’më ngacmuar?/ Po fundi i shkurtër, prapa pse i çarë,/ apo më fton, diku për të shkuar?” Me shqetësimin e moshës, ai shkruan: “Mos u qesh, mos u llasto!/ (Gjasme, ja, të dukem plak?!)/ Mos kujto të bësh si do,/me demek, nuk u ndizkam “flakë”?!”

Janë të shumta poezitë, që Papi shkruan për “gushëpëllumben”, “lulen kryeneçe”, “zezaken”, “vajzën kaprolle”, “zogëzën lariskë”, “zonjën si tulipan”, “dardhën elbasanase”, “qershien përmbi tortë”, “trëndafilin e bardhë”, “boshnjaken”, “mëshqerrën”...Dhe meraku i pandarë i tij është, kur pyet me emocione:” A më lë, që të “kullos” në “livadhin”, që ke pronë?” ose harliset, kur shikon nga vajza e shkruan: “Gjiri yt si luleshtrydhe,/ mendja ime aguridhe...”. Pastaj : “Unë të thashë:-a të puthi pak?/ Ti ma ktheve:-Dashke shumë!/ Dhe u bëra zemërak,/ pa marrë leje t’putha unë”. Megjithatë, më në fund, poeti Papi kujtohet për moshën, që ka e vargëzon me trishtim: “Ziliqar, po kam dhe neps,/ ku s’më qasin, kërkoj pjesë;/ dua pjesë e zë e grindem,/ pleqërisë aspak s’i bindem!”

Po të mos e kisha në dorë librin tjetër të Përparim Hysit, “Tregime”, do të thoja se ai vetëm di të thurë poezi dhe, shumicën e tyre, për dashurinë. Po ja që ai edhe ka provuar të shkruajë tregime. Janë tetë të tillë, në një vëllim modest, me 64 faqe. Përmbajtja është e larmishme, si ai “Pas orës së këngës”, kushtuar kujtimit të Hilmi e Mynever Hysit. Më tej, tregimi “Nusja” flet për një ngjarje a “mesele” interesante. Por autorin e ka ngacmuar edhe tema atdhetare, kur shkruan tregimin “Gjëmon historia”(Në Petovë e në Mbrostar...). Ndërsa tema e mallit e dhimbjes së kurbetit gjen pasqyrim te tregimi “Valixhja e kurbetçiu”. Me kërëshëri lexohen edhe tregimet tjera: “Pakot”, “Veç...”(kujtimit të babait) e “Burrëria” (kujtimit të Bajram Makes). Libri mbyllet me tregimet “Rrëfenjë e lashtë” e “Ç’bëri Runja, ç’ bëri Kupja”.Tregimet janë shkruar me gjuhë të pastër e të pasur, me motive popullore e që e bëjnë lexuesin të krijojë ndjesi të mira.

DITA E DASHURISË
(Të rinjëve për Shën Valentinin)

Jam krehur,jam ujdissur si dikur kur kam qenë djalë
Edhe pak jam”kashaisur”,si një kalë që pret për shalë
Hoqa vite unë nga supat,s’jam më gjysh,po jam”riosh”
Tani pres të vij në çupat,për ato jam kthyer”djalosh”

Pres,or pres,po pak si kot, sepse pritja shkoi pak gjatë
Vjen një zogë dhe me një zog;unë po mbeta duarthatë.
Zoga zogun ka për dore dhe zë puthet ashiqare
Unë,dikur,dashkëmbore; mbeta thatë në rrugë të madhe.

Ta hajë dreqi ,them me vete, a më panë apo s’më panë?
Ata puthen për 7-qejfe(duket njëri-tjetrin “hanë?!”)
Ja,ja djali po puth çupën(ku është parë?Në sy të botës!!!)
Mua me gropa ma bën rrugën,se më luajti çargu i kokës.

Ca më”keq?!”:çupa puth djalin dhe i hipën kaliqafë
Sado plak,s’e mbaj “inatin”;mënd tani bëra “bërdaf!”
Ç’është kështu?U “prish” dynjaja(a dynjanë unë shoh përmbys?)
Të kërcas sheshit sevdaja?Jo.U bë apokalips!!!

Puthen,puthen dy nga dy, edhe qeshin apo s’qeshin
Ah,më plaçin që të dy!Mua më duket:më përqeshin!!!
Pastaj shkundem,vij në vete(pas kthiellies,vjen gjykimi)
Çiftet puthen për 7-qejfe,se është Shën Valentini!

Është ditë e shënuar,ditë e madhe e dashurisë
Ndaj të rinjtë kanë”harbuar” dhe zënë qielln’ e lumturisë
Pa i shoh dhe unë,plaku;(se,ende,mua më sheh syri)
Pak nga pak më ngrohet gjaku(se më zë dhe mua”gripi”)

Edhe zë e “kollitem” për një kohë që iku,shkoi
Pak nga”kolla”,edhe”mbytem”;kush në botë nuk dashuroi?!
Kur shoh puthjet dashurisht,edhe po shkëmbejnë peshqeshe
I bekoj si babagjysh,unë,plakushi me shtatë teste.

13 shkurt 2010

MOJ E BUKUR SI PRILLI

Moj e bukur si prilli
Dil,moj,dil atje,tek pylli
Dil,moj,se më iku syri
Se s'duroj dot

Hajde se këndon bilbili
Apo nuk fryn zefiri
Se u dogja si qymyri
Frymë s'po marr dot

Moj e bukur si prilli
Hajde se të pres fakiri
Mu si dallgë më hidhet gjiri
Zemra fshan me lot...

1 prill 2001

ANALOGJI

U mek bilbili tek këndon në pyll
Po ti ku je,e dashura si yll?
Pa shih si e dredh zërin,me derte e qarje
Bilbleshën po ndjell...duket ashiqare

E ndjek nga afër:e shoh që derdhë mall
Mendja tek ti;ku do jeshë,vallë?
Tani s'është punë:i shqeu kordat fare
Duket është si unë:ngarkuar me malle.

2 prill 2001

AMOR

Shpirtin diçka përbrenda ma bren
Se ç'diçka është,askush nuk e gjen.
Ma bren avash,ma bren ngadalë

A s'bën kështu mola që bren ca trarë?!

Nuk gjej rehat,nuk gjej qetësi
Si mund të qetohem kur ike ti?
S'më vjen të dalë dhe mbeta brenda
Oh,ç'plagë që kam,këtu,përbrenda!

Dhe plaga rrjedhë,dhe plaga dhëmb
Unë vj vërdall dhe hiç nuk zë vënd
Se është një plagë që s'do doktor
Ilaçin e plagës:e ke ti,amor...

2 prill 2001

FATI

“Me fatin veç u gridkam kot
Ai më talli dhe më fort...”
Lermentov
Fati me mua bëri si deshi
Kur doja baluke,ai më qethi.
Më la pa punë;pa plangë e shtëpi
Më nisi kurbetit,në pleqëri.

I humba unë me miq e shokë
Dhe vërdallisem,por fare kot
Ditët i shtyj sikur jam murg
Trupin të lirë,po shpirtin në burg.

Më talli dje,më tall dhe sot
Po pse,kështu,o i Madhi Zot?!
Kur e kam radhën të më qeshë fati?
Apo kështu do vdes unë,i ngrati?

3 prill 2001

UNË

Unë s'renda pas një dashurie të kotë
As dashuri nuk kërkova me dhunë
Për dashurinë kam qenë zemërdobtë
Gënjështër si Don ZHuan s'përdora unë.

Mua vërtet më rrëmbente një sy
Apo një buzë sensuale që të ndjellë
Unë kam bërë vërtet dashuri
Kur ndjenja qe reciproke,e thellë.

Ndodhte që dikush s'më priti krahapur
(se bukurosh nuk qeshë si Esenini?!)
Po urrejtje kurrë-kurrë nuk kam shfaqur
Për iksin që s'i pëlqeu Përparimi.

Thashë që kam dashur me zemër,me gjak
Dersa tek unë një ditë erdhë Sika
Dhe ndjenjat i shtypa,i zura në lak
Për Sikën,dhe tash,më bie pika.

3 prill 2001

PRITJA

Qielli i mbushur plot me yje
Disku i hënës-gjak
Po ti hajde,mikja ime,
Se u mardha pak.

U këput një yll nga qielli
(thashë unë emrin tënd!)
Hajde,moj,të pres,i mjeri
Meraku më çmënd.

Qielli i mbushur plot me yje
Ç'qetësi ka kjo natë!

Ja tek vjen, o shpirtja ime,
Dal të pres me vrap.

Disku i hënës kuqëlon
Në qiellin me yje
PO ne hiç s'na bëhet vonë
Shtrirë në korie.

4 prill 2001

NË GJUNJË, JO, KURRË S'MË ULËN!...

(Rreth forumit “Stërkalla” dhe poetit brilant Valter Lazeri...)

Dashuria ndaj Shqipërisë, Kosovës, Iliridës, Luginës së Preshevës etj., është dashuri e shenjtë, siç është dashuria ndaj nënës, babait, fëmiut, gruas, familjes dhe flamurit.

Mirësevini në toplistën informative dhe kulturore në gjuhën shqipe “Stërkala”, thekson moderatori Valter Lazeri... Ky forum i blogosferës shqiptare është ngritur pa dallim feje vendi ,apo ideje dhe ka si qëllim bashkimin e shqiptarëve nëpër botë, mbrojtjen e gjuhës shqipe dhe trashëgiminë e saj nga brezat që po lindin jashtë trojeve etnike. Gjithashtu qëllimi i këti forumi është shërimi i plagës shekullore të shqiptarëve, bashkimin e trojeve tona me Shqipërinë Etnike . Shekujt u lëshuan gjeraqinat slave mbi trojet tona, duke i coptuar por asnjëherë nuk arritën që të shuajnë gjuhën e ëmbë shqipe, kulturën e lashtë ilirike. Në Faqet virtuale “Stërkala” që Editohet nga Lazër Valteri. shkruajnë fytyrat më të ndritura të kombit tonë në internet, Valter Lazeri, Dr.sc. Fatmir Terziu , Akademik prof.dr.Namik Shehu, Prof.dr.Eshref Ymeri, poeti prof.Engjëll Koliqi, Merita Bajraktari McCormack, Ndue Hila, Luigj Shkodrani, Vlashi Fili, Albana M. Lifschin, Kostaq Duka, Jeton Kelmendi, Vullnet Mato,Nafi Çegrani, Demir M.reshiti, Bedri Halimi, Alber Zholi, Akademik prof.Mr.sc.Akil Koci, Agim Gashi, Flori Bruçi, Zef Përgega, Përparim Hysi, Prof. Naim Kelmendi, Reshat Badallaj, prof.dr.Begzat Baliu, Paul Tedeschini, Ajet Nuro, Riza Lahi, Agim Bacelli, Prof.dr.Sabile Basha, Mimoza Enver Dajçi ,Ruf Dragu ,Faruk Myrtaj ,Fritz Radovani, Daniel Gazulli, Shefqet Dibrani ,Adem Zaplluzha, Kristaq Shabani ,Mimoza Sali, Fatime Kulli, Keidi Sejдини, Dr. Ismet Hebibi, Faik Miftari, Fehmi Ramadani ,Thani Naqo, Prof.dr.Flamur Maloku ,Dr. Gjekë Marinaj, Pal Sokoli, Petraq Kote, Prend Buzhalla, Sali Mehmeti, Albin Kurti, Sejdi Veseli, Engjëll Shehu, prof.dr.Vedat Shehu, Vitore Stefa Leka ,Mardena Kelmendi, Përparim Kulla, Partizan Cene, Rexhep Shahu ,prof. Mr.Ramiz Kelmendi ,Reshat Sahitaj, Remzi Limani ,Rrustem Geci ,Mexhid Yjvesi ,prof.dr.Jahja Kokaj, Fatos Aliu etj. etj.

Vend prioritar në spektrin e revistave të mirëfillta shqiptare që respekton kriteriumet profesionale të gazetarisë evropiane është edhe “Floripress”, paralelisht me të cilën shquhen Gazeta Kritika, Forumi Shqiptar, Mëmëdheu, Tribuna Shqiptare, Albemigrant , Stublla.com, Teuta shqiptare dhe një varg

mediash tjera të rëndësishme që i japin prioritet letërsisë dhe publicistikës. Një tribunë interesante është edhe ëbebi Shqip.dk I drejtuar nga shkrimtari shkodran Luigj Shkodrani me moton: Kurrë mos e ndalo dashurinë për Shqipërinë, si dhe Fjala e lirë e Dr.Fatmir Terziut, Dituria e Sokol Demakut, Pashtriku i Sheradin Berishës, “Diplomacia “e Xhemil Zeqirit, dhe sidomos Zëri i shqiptarëve/ Voice of albanians, duke patur për drejtor Skënder Buçpapajn, një moderator brilant që militon për komunikimin mbarëshqiptar, duke afruar bashkëpunëtorë me vlera, duke ndikuar për afirmimin e vlerave shqiptare dhe ndërkombëtare, në të gjitha fushat e jetës letrare, artistike, shkencore dhe politike....

BUQETË LIRIKASH NGA POETI, MIKU IM I MIRË, JORGO SOFOKLI TELO

Jorgo Sofokli Telo, i lindur në 6 janar 1945 në fshatin Konckë të Zagorisë (Gjirokastër), pas shkollës së mesme pedagogjike, mbaruar në Gjirokastër në 1963, vazhdoi studimet e larta në Institutin pedagogjik “A. Xhuvani” në Tiranë, fakulteti gjuhë-letërsi-histori, të cilin e mbaroi, duke përfutur diplomën e mësuesisë në vitin 1965. Veç profesionit u angazhua tërësisht vit pas viti në veprimtari kulturore në shkollë e në fshatrat ku punonte si mësues, duke krijuar humor e satirë si lëndë e parë për estradat, koncertet tematike, krjoi shumë librete për mbasditet argëtuese, sidomos skeçe, parodi, kuplete gjer te tablo të zgjeruara; ndërkohë shkruante poezi, duke startuar qysh në vitet e arsimimit shtatëvjeçar e më tepër në të mesmen e të lartën, si pjesëtar i rretheve letrare. Mjaft nga shkrimet në poezi a prozë i niste që të pasqyroheshin në organet e shtypit të kohës që nga gazeta “Mësuesi”, “Zëri i Rinisë”, “Hosteni” e gjer te organet periodike të rrethit, “Pararoja”, më pas “Java” e “Dita Jug” apo “Gjirokastra”, “Policia pranë”, duke shtuar edhe kontributin si redaktor apo zëvendëskryeredaktor i gazetës “Pegasi”, organ i Lidhjes letrare me të njëjtin emër ku Jorgoja vazhdon të jetë aktiv i papërtuar e prodhimtar. Ka shkruar dhe për gazeta të tjera rajonale. Kontribut më të spikatur, ku është nderuar dhe me çmime, ka dhënë në fushën e krijimtarisë rapsodike. Në periudhën para vitit 1990 u përpoq të botonte librat e parë, por ndeshi në zvarritjet burokratike të kohës e individëve redaktorë, që i nxirrnin arsye nga më absurdet, por që ia prenë disa herë hovin krijues e sidomos atë botues Jorgos mjaft prodhimtar në fushën e letrave në vitet rinore të tij. Vetëm në vitin 1998 mundi të nxirrte librin e parë poetik “Evë, moj, si u gënjeve?” që u pasua pas një viti me 3 libra të tjerë radhazi: “Bubushi e Dikushi” (poemë humoristike për fëmijë), “Babi, keq mos të të vijë!” (poezi për fëmijë), “Verë dhe uthull” (fabula). Kurse në vitin 2000 nxori librin e dytë poetik “Klithja e yjeve”; në vitin 2001 vëllimin e tretë poetik “Tingujt e shpirtit”. Vëllimin me epigrame “Humorpipereska” dhe librin me lirika: “Kumte dashurore” e nxori në vitin 2004. Kurse në vitin 2005 doli me dy vëllime të tjerë: poemën epiko-lirike “Sfidanti legjendar” dhe romanin e parë “Hedhja e zareve”. Në vitin 2007 sapo nxori fantareportazhin “Mysafirët e rinj të Çajupit” ose “Intervistë me Babanë e “Baba TOMORI”- t” dhe “Kush i gjen, të lumtë i them” (gjëgjëza e pyetje lodruese për fëmijë). Në vitin 2009 botoi librin “Diloiada” (Poemë-Baladë), dedikuar familjes më të madhe zagorite e njëkohësisht më të persekutuarës nga vitet ‘44 e gjer në ‘90. Ka mbaruar së

hedhuri në kompjuter një vëllim me fabula e ka gati një vëllim me poezi të stilit “Hajku” si dhe një tjetër me novela e tregime e dy poema për fëmijë, por që mbeten hëpërhë dorëshkrime në sirtar për vështirësi mundësimi për botim e shtypshkrim.Ndërkohë edhe si studius ka përgatitur përsiatjen e zgjeruar”E folmja zagorite porsi një fladitje” e të tjera dorëshkrime në miniaturë...Ka redaktuar mjaft libra që janë botuar prej disa autorëve të jugut.Pasionin për të kontribuar në fushën e letrave e ka të pareshtur edhe pse përballet me pengesat e ligshita që i sjell sëmundja e rëndë prej vitesh, duke u kapur fort pas kurajës, sedrës e dhuntisë për të shkruar e sidomos te dashuria dhe respekti për jetën. Ka marrë pjesë edhe në dy konkurse ndërkombëtare në Greqi, ku ka fituar një çmim të dytë me fabul e një çmim të parë me poezi-poemth, respektivisht në vitet 2005 e 2006.etj...

Ç’KEMI THËNË E STËRTHËNË?!

A mban mend, hënëz e ngrënë,
Ç’kemi thënë
e stërthënë?

Sy ndër sy ndenjëm parmbremë,
Ç’kemi thënë
e stërthënë?

Përmbi bar te molla tëndë
Ç’kemi thënë
e stërthënë?

Folëm pak edhe diç bëmë...
Ç’kemi thënë
e stërthënë?

Na spërkatën zogjt’ me këngë.
Ç’kemi thënë
e stërthënë?

DEHUR NGA BUKURIA

Brenda kopshtreve të mia
Sulet vrap ujët nga vija.
Ç'i përdredh degët hardhia!
Luleplot vishet kajsia.
Dehur-o nga bukuria.

Refreni: (pas çdo vargu)
Rrituni, rrush e kajsi,
Kokrraplot me ëmbëlsi
Për mua dhe miqt' e mi.

GUDULISJET

Vashë me fustan të bardhë,
Fap me sy, çëk – me qepallë.
Gudu-gudu-gudulia
Prush i ndez ndjenjat e mia.

Ku gjën më bukur, moj mike
Nat' e dit' me gudulisje!
Gudu-gudu-gudulia
Prush i ndez ndjenjat e mia.

Një gudulisje nën dorë
Ma jep me gishtin e hollë.
Gudu-gudu-gudulia
Prush i ndez ndjenjat e mia.

Me gudulisjet në injë
Sytë tanë vetëtijnë.
Gudu-gudu-gudulia
Prush i ndez ndjenjat e mia.

Le kur gudulis në buzë
Me buzët e tua shpuzë!
Gudu-gudu-gudulia
Prush i ndez ndjenjat e mia.

Vitet vinë edhe ikin.
Gudulisjet ndezin shpirtin.
Gudu-gudu-gudulia
Prush i ndez ndjenjat e mia.

PËRKËDHELITË

Dhelet e përkëdhelitë
Gosti janë për të rinjtë.
Kalon koha kili-vili...
S'i kursen këngët bilbili.
Kili-vili ikin orët...
S'njohin të velur rinorët.
Me kilikosje, përkdhelje
Edhe pleqtë s'kanë velje.
Ku ka mëri dhe urrejtje
Shteron jet' e kësaj jete.
Me gaz e përkëdheli
Kalon shpirti mrekulli.

VOGËLUSHES

Sumbull e kësaj mëhalle,
vogëlane, vogëlane,
sumbullesha bukurane!

Para meje hapin ndale!
vogëlane, vogëlane,
sumbullesha bukurane!

Mos u ngut, ec me ngadale!
vogëlane, vogëlane,
sumbullesha bukurane!

Eja tek unë përfare.
vogëlane, vogëlane,
sumbullesha bukurane!

PËR FËMIJËRINË DHE NËNOCKËN QË MË RRI TI ME HALLE

Vullnet Mato, është poet dhe prozator. lindi në Sarandë në vitin 1937. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes. Pasi i burgosën babanë për agjitacion dhe propagandë u la disa vite pa punë. U detyrua të largohet nga Saranda në moshë të re dhe punoi kinomekanik në kinematë e sharrave Hotolisht e Stravaj e më pas në qytetin e Librazhdit. Aty mbaroi me korrespondencë Liceun Artistik të Tiranës për pikturë dhe studimet e larta në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës në degën gjuhë-letërsi shqipe. Punoi drejtor në shtëpinë e kulturës dhe në muzeun e këtij qyteti. U pranua anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë në vitin 1970. Botoi publicistikë dhe letërsi artistike në disa organe të shtypit. Bëri disa skenarë filmash dokumentarë dhe kronika të TVSH. Mori pjesë në festivalet kombëtare të Radiotelevizionit shqiptar ku fitoi disa çmime për tekstet. Dy tregime të tij u botuan në frëngjisht. Disa cikle me poezi të tij u inskenuan të recituara nga aktorë të Tetarit Popullor. Pasi u bë i njohur me krijimet e tij u tërhoq nga redaksia e Revistës “YLLI” ku u emërua redaktor. Por një vit më pas, u vërtetua mungesa e garancive të nevojshme politike dhe me urdhër nga lart e kthyen sërish në Librazhd, ku u dërgua disenjator në repartin e pikturës. Më tej, punoi mësues në gjimnazin e qytetit. Dhe në vazhden e keqtrajtimit klasor u dërgua mësues në shkollën e mesme të fshatit Qukës. Me ndërrimin e sistemit u emërua shef në drejtorinë arsimore të këtij rrethi dhe u zgjodh kryetar i degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Librazhdit.

Vitet e fundit jeton e punon në Tiranë. Romani i tij “Lakmia” U nderua me çmim në konkursin e Ndërmarrjes Botuese “Gjon Buzuku” të Kosovës. I janë përkthyer jashtë shtetit tregime dhe poezi të ndryshme. Revista “ADMET” në Greqi dhe Revista “Fjala e Lirë” në Londër kanë publikuar pjesë nga krijimtaria e tij në prozë dhe poezi. Disa nga romanet e tij janë tërhequr nga bibliotekat e mëdha të shteteve të huaj. Ka faqe të veçantë në internet me: “vullnetmato.tripod.com” Kryen detyrën e kryeredaktorit të gazetës periodike “Domosdova”.

Veprat në vite

Është autor i vëllimeve poetike: “Tinguj malesh” (1969), “Krahët e erës” (1972), “Ninullat e hekurit” (1984), “Dritaret e prillit” (1994), i vëllimit me poema “Katër plagë të Shqipërisë” (1999) dhe i poemës “Nënëmadhe Ftterra” (2007). Ka botuar vëllimet me tregime “E fshehta tronditëse” (1999) “Klithmat e mishit

të bardhë” (2006). Romanet: “Ujësinor” (1976), “Era e kësaj kohe” (1984), “Lakmia” (2000), “Maturantët” (2002), “Damkosja e engjëjve” (2004) “Vajza e kuçur” (2007), Marrëzia e madhe” (2008), “Matura e paharruar” (2009). etj...

SHKARRAVITJA E VETVETES

Njeriu lind si faqja e pashkruar e letrës,
pa asnjë njollë në bardhësinë e shpirtit,
siç lind rrezja në qiellin e kthjellët të verës,
nga gjaku i bardhë i mitrës së diellit.

Kur njeriu me rrezen e vet shpirtërore,
Shkruan mbi letrën e pastër të vetvetes,
duke kaluar mes reve të bardha pupëlore,
mbetet gjithë dritë faqja e tij gjatë jetës.

Por kur rrezen e ngjyen nëpë re bloze,
dhe shkruan bardhësinë e shpirtit me sterrë,
nxin tërë jetën faqja e tij jetësore
dhe bëhet i urryer për njerëzit e tjerë.

E habitshme pse disa tipa plot dritë,
rrezen për të shkruar faqen e jetës,
shkojnë e ngjyejnë te bataku politik,
të nxijnë shpirtin, të shkarravitin vetveten!...

Të nxijnë qiellin ku na shohin kontinentet...

KU I KEMI HERONJTË E SOTËM

Ku janë guximtarët e bëmave të mëdha heroike?
Ku i kemi heronjtë e sotëm të vetëflijimit fitimtar?
Flenë moteleve me dashnore e kurvicka hysterike,
pinë “Viagra” dhe injektojnë “Heroinë” në damarë.

Mbushin faqet e shtypit dhe ekranet me ngjyra
disa prototipa të rëndomtë të llojit “Big Bradhër”,
që kacafyten tre muaj dhe bëjnë tualet në pasqyra,
për të fituar miliona duke puthur vajzat e radhës.

Palosin lojëra fjalësh në mikrofonta opinionesh,
oratorët që shfaqen njëmijë herë në njëmijë ditë.
Mohojnë me nihilizëm bëmat pozitive të çdo kohe,
dhe pompojnë pareshtur të paaftët për “mrekullitë”.

Nderohet kush zotëron mirë mjeshtërinë e shpifjes,
kush zbraz për rivalët helm më të fortë se gjarpri.
Kamera spiune peshkon heronj video-përgjimesh
dhe hajduti milioner del nga lypsarët më i varfri.

Çmohet kush pa turp i rrëshqet moralit të elitës,
kush durimin njerëzve ua shkërmoq me daltë.
Ngrihet lart në qiellin ashiqare të mesditës,
kryevepra e atij që shkel ligjin, sa e bën baltë.

Quhet kryetrim ai që përdor lirinë si pronën e vet,
dhe nga milli i rebelimit të gjakut nxjerr shpatën;
sulmon të drejtën e të tjerëve egërsisht dhe godet,
duke plagosur rëndë kushtetutën dhe gjykatën.

Mendjehollët më të mprehtë po dalin gënjeshtarët,
që shpikin shfajësime duke pasur dështimin kalikiçi,
që fshehin si disa gra jastëkun te barku i barrës,
dhe në përfundim pjellin hiçin nga mitra e hiçit.

Ku janë guximtarët e bëmave të mëdha heroike?
Ku i kemi heronjtë e sotëm të vetëflijimit fitimtar?
Flenë moteleve me dashnore e kurvicka histerike,
pinë “Viagra” dhe injektojnë “Heroinë” në damarë.

KANARINA E TREMBUR

S'më harrohet
kur te supi im në rini,
më erdhi një kanarinë
me krahë të shkruar.
Ajo filloi të cicëronte
me aq ëmbëlsi,
sa nga padurimi
zura ta trazoj me duar.

Zogëza plapuriti krahët
para syve të mi
dhe fluturoi e trembur
tutje moskthimit.
M'u duk sikur më la
një pendë në sy,
nga e cila m'u mbulua
rrezja e shikimit.

Kjo zgjati derisa
gabimin kisha kuptuar,
se afrimi i zogave
me sqepin plot gaz,
nga dëshira instinktive
për të kënduar,
nuk qenka dorëzim
për të hyrë në kafaz...

SKLLEVËRIT E MIJËVJEÇARIT TË TRETË

Kush tha se ka vdekur përgjithmonë skllavëria
me agimin e Lirisë së Njeriut në Konventë?
Ajo rron dhe do vazhdojë në vite me mijëra,
kur ka skllavër të urtë si në mijëvjeçarin e tretë.

Vajza studente me trupin si ngjala e Vivarit,

detyrohet me kofshët e saj prej ajri dhe drite,
të kënaqë epsheet e pështira të plak pronarit,
ndryshe nuk diplomohet pa rrogën pasdite.

Adoleshentja pret stinën të çelë petalin e vajzërisë,
po kur nuk arrin mesataren e lartë të maturës,
pranon t'ia shpupurisë gonxhen profesori pis,
ndryshe të drejtë studimi nuk fiton kurrën e kurrës.

Femra e re nga Veriu gjer në Jug të kontinentit,
pas ecejakeve me gotat dhe pjatat e çdo tryeze,
mund ta lërë përparësen e kamerieres së klientit,
po nuk dhuroi te aneksi gjoksin e shijshëm për meze.

Sekretarja me fundin rrëzë kofshëve të rrumbullta,
pasi të ngrihet nga kolltuku i kompjuterit të zyrës,
po kundërshtoi t'i ulet shefit në prehrin me gunga,
mund të riveshë fustanin e zhubrosur të amvisës.

Nëpunësi i fyer e poshtëruar nga titullari arrogant,
për një vonesë të vogël e pasaktësi në dokumente,
ngaqë e ka të vështirë të gjejë vend tjetër vakant,
duron gjithçka skllavërisht e përulet me buzëqeshje.

Shoferi i pronarit e ministrit me pushtet autoritar,
shpie gratë në punë, fëmijët në kopshte e shkolla,
mbush bagazhin me qeskat ushqimesh në pazar,
sepse po s'u bë shërbëtor, bëhet hamall në furgona.

Punëtori pranon djersitjet suplementare pa pagesë,
të punojë për vilat e zyrtarëve deri në orët e vona,
të mos dalë tellall ditë të tëra punën të thërresë,
te "Partizani i Panjohur" apo te sheshi "Omonia"

Kush tha se ka vdekur përgjithmonë skllavëria
me agimin e Lirisë së Njeriut në Konventë?
Ajo rron dhe do vazhdojë në vite me mijëra,
kur ka skllavër të urtë si në mijëvjeçarin e tretë.

PYLLI DHE DETI

Më shkoi fëmijëria mes detit me vërshime
Dhe më mbetën dallgët brenda gjoksit.
Më erdhi burrëria mes pyjeve me valëzime
Dhe më mbeti në gjak stuhia e motit.

Ndaj kur jam në det shoh pyllin e blertë
Dhe kur jam në pyll shoh detin aty.
Sa herë kam vrarë mendjen të gjej
Ç'kanë të përbashkët këta të dy.

Si deti dhe pylli më rrëmbyen thellësive
Me frymëmarrjen e gjerë shushurimat, valët,
Me kafshët që sillen përbrenda tyre
Me bilbilat, qukapikët, - çafkat, pulëbardhat.

Më magjepsën tregimet e ashpra të detarëve
Kur ktheheshin me rrjeta të rënda në muzgje
Dhe më mahnitën kallëzimet e druvarëve
Kur zbrisnin me kamionët e stivuar plot trungje.

Tani më kanë mbetur në sytë e kujtesës
E veçanta e tyre dhe ngjasimi i përbashkët,
Por mbi të gjitha bota e madhe e njerëzve,
Që ndeshen pareshtur me drurët dhe dallgët.

I PREMTOVE SHPIRTIT NJË SERENATË...

Mimoza Rexhvelaj ka lindur më 1981, në Malësinë e Madhe. Pasi mbaroi shkollën e mesme në vendin e lindjes, u shkollua për gjuhë-letërsi në Universitetin Luigj Gurakuqi, Shkodër. Ka botuar edhe tre libra: “Dashuri ti je mekati im”, nga shtëpia botuese “Marlin Barleti”, 2002, “Fshima lotin” nga shtëpia botuese “Shtjefni”, 2004 dhe “Jepi fjalës kohë”, nga shtëpia botuese “Camaj-Pipaj”, 2006.

Poezia e saj ka jo vetëm ndjenjë por edhe realitet të shprehur brenda konturit me të cilin Mimoza ka mënyrën që shpalos ndjenjat. Poezia e Mimosës është si një pikë e pastër uji, që kërkon të njomë rrënjën e zhuritur të realitetit. Ajo është këngë, që shoqëron ndjenjën për nënën, dashurinë, të mirën dhe të keqen... Duke i uruar suksese, po publikojmë tre poezi të Mimosës, duke premtuar se kështu do veprojmë përsëri!

E SHTRENJTA NËNË

Borxhlie gjithë jetën..
prehrit që rrita shtatin,
Duarve të rrudhosura,
për të cilat malli më ka verbuar
Jam gozhdë në shpirt ngujuar....
Si zog i arratisur nga foleja
me brengën e mallit kuror
shtegëtare në vende të largëta
mes mjegullës përplas flatrat..
Naltësohem e luaj me retë
qiellin me duar prek...
Me krahët e mi formoj ylberin,
Botën e njom, lotët më bien rrëke....
Borxhi i papaguar në zemër peshon
lidhur me hallkën e gjakut që rrjedh
vij... e kokën mbështes në prehërin tënd
ninullën e jetës këndoma...
e shtrenjta ime nënë !!

KUSH JE TI?

Kush je ti ?
Mëshirues i botës fatkeqe
Fatin me zinxhir ke lidhë.
Ndër leqe...

Vampir i lustruar,
i parfumosur, i krekosur
Në gjumë më sheh, po fle
Thonjtë nxjerr të më bësh dhé.

Kush je ti?
Ujk i mallkuar
Më tregon se ke ndryshuar
Po në shpirt je ai...
Egërsirë hekuri.
Kush je ti?

Etje, uri, prehën kërkon
Gjak pi, gjak don,
U ngope, i pangopur
Ushqyer, barktharë
Shpirtin me mëkat ke larë.

Kush je ti?
Idhulltar,
Medaljon ferrin
ke varë.
Nuk e di!
Kush je ti?

VAJTOJE SERENATËN, KITARË

I premtove shpirtit një serenatë,
Me kitarën e vjetër të harresës,
Kumbon vaji, zërave të natës

Puhizë mbetur, shtegtare e largët.
Trupi i kitarës së pa prekur
i varur në gozhdë, murin ledhaton
Martir i dashurisë së fjetur
Tingull i vrarë, këngëzen më zgjon.

Murg në manastirin e kujtimeve
struket bosh, shpresa melodioze
Shuhet mes qirinjve të kishës
Për dikë, luten sorrat zëçjerrë....

Shpirti i zgjat dorën premtimit
Serenatën vajtoma, zemër e kitarës.
Mes gurve të varrit, simfonia
gulçon heshtjen e zhurmëshme
Tingujt shuhen...
Nën dritën e hënës...
Këndoma serenatën
kitarë!
Paqshëm të tretem
mes tingujve të latuar...

U LUTA PËR TY

U luta për ty.
Me forcën që fluturon
hapësirave të shpresës...
Dhe fryma e shenjtë
si flad i ëmbël
më ledhatoi me mirësi.
U luta për ty
vetmia flaku zemërimin
si bishë e zgjebosur
e shpirti im puthi
ngrotësinë e pajtimit
u luta për ty
Ndeza njëmijë e një qirinj

njëmijë e një ëndrra,
harrove njëmijë e një përralla të frikshme.
po ti...
do të lutesh një ditë për mua?

AJO S,TË PYET

Ankthi më pushtoi.
Lëvrin në palcë.
Dhimbja rrjedh gjak....
Frymëmarrje e paralizuar,
temperaturat vallëzojnë
në gjumin e vdekjes...
Fantazma pa ngjyrë
zgjasin duartë të më përpinë.
U fsheha pas krahëve të ëngjëllit
më ndjek si shpirt në terr...
Mes gumëzhimave të mëngjesit
si ylber pas një rrebeshi....
e shenjta virgjëreshë,
ajo s'të pyet?
Të prek dhe ty
oh....kam frikë.

BORXHLI GJITHË JETËN

Borxhli gjithë jetën.
prehrit që rrita shtatin
Duarve të rrudhosura,
për të cilat malli më ka vërbuar.
Jam gozhdë në shpirt ngujuar....

Si zog i arratisur nga foleja
me brengën e mallit kurorë
shtegëtare në vende të largëta
mes mjegullës përplas flatrat...

Lartësohem e luaj me retë
qiellin me duar prek...
Me krahët e mi formoj ylberin,
Botën e njomë, lotët më bien rrëke....

Borxhin e papaguar në zemër peshon
e lidhur me hallkën e gjakut që rrjedh
vij...e kokën mbështes në prehërin tënd
ninullën e jetës këndoma...
O e shtrenjta nënë !!

BARDH FRANGU, EMËR I NDRITUR NË LETËRSINË SHQIPE

Krijues që e shkruan poezinë, prozën, dramën dhe kritikën e arteve, Bardh Frangu para lexuesit këto ditë doli me librin e tij më të ri, përkatësisht me romanin, “Fluturimi dhe rënia e Ben Balës”, që është libri i katërt me radhë i autorit. Romani fillon me një prolog të ndërtuar nëpërmjet disa thënieve aforistike origjinale, të cilat bëjnë të mundur akseptimin e mesazhit të romanit. Për ta zgjeruar hapësirën poetike të romanit, autori fillon me një kronikë të vjetër, e cila ka për qëllim identifikimin etnopsikologjik të mjedisit ku vendoset ngjarja. Lajtmotiv i romanit është fati i një futbollisti, i cili koncentron të gjitha energjitë për të arritur fluturimin, në fund për t’u bindur se fatkeqësia e njeriut është vetë gravitacioni, i cili objektivist e mban të lidhur për copën e tokës, ku është ngritur vertikalisht. Në këtë kontekst, veç fluturimit, duhet kuptuar edhe peripecitë e tij në diasporë, të cilat edhe janë pjesë e rëndësishme e ndërtimit të urës që bën dramën e këtij romani. Në shikim të parë duket se kemi të bëjmë me një temë shumë triviale, por në fakt fati i një futbollisti në të gjitha dimensionet e zhvillimit të jetës së tij është po ai që mund t’i përkasë edhe një filozofi a mekaniku. Në planin e ndërtimit romani ka një strukturë shumë të veçantë. Përshkrimi këtu i lë shumë më shumë hapësirë narracionit. Dialogu është shumë i dendur sa poetikën e romanit e afron me atë të dramës. Janë edhe reminishencat ato që ndikojnë në thyerjen kompozicionale, duke përplasur kohët dhe hapësirat, të cilat reflektojnë çështje ekzistenciale. Në fakt romani mund të cilësohet si një roman dashurie, ndërsa në lajtmotivin e tij strukturohen tema që kanë të bëjnë me dashurinë, madje deri në një kufi ku mund të shtrohet dilema e asaj se çka është erotike dhe çka është porno. Në planin narrativ romani zhvillohet në tri plane. Heroi kryesor i romanit, futbollisti Ben Bala në atdhe ka lënë dashurinë e parë që nuk mund ta harrojë, në diasporë ka gjetur një dashuri tjetër e cila e ndihmon në fluturim, në fund rënia për ta lidhur përgjithmonë me një të tretë, e cila gjithashtu e ka kuptuar se po të mos ishte gravitacioni njerëzit do të shndërroheshin në zogj. Gjuha e romanit duket e thjeshtë, por në fakt edhe sendet edhe fenomenet këtu ngiten në metafora të ndryshme dhe si të tilla mundësojnë një vëmendje për gjuhën kontekstuale. Romani ka një frymë të dukshme të realizmit magjik, ngaqë besëtytnitë autoktone janë si shenja zodiaku. Ajo që e bën krejt të veçantë këtë roman është fakti se lexohet shumë me lehtësi dhe mbase me një frymë. Romani është plotësisht i liruar nga

ngarkesat historike dhe filozofike. Si i tillë, subjekti i tij është një fikcion i pastër dhe çdo ngjashmëri është krejtësisht e rastit. Shkrimtari Bardh Frangu (1956) deri tash ka botuar librat: “Ora e shtëpisë” (poezi, 1989), “Kohë të kauçukta” (roman, 1993) dhe “Kakafizma” (aforizma). Romanin “Fluturimi dhe rënia e Ben Balës” e botoi shtëpia botuese “Rozafa”, Prishtinë, 2010 dhe ka 180 faqe.

Poezi nga Bardh Frangu:

BIMË E KEQE

Dëshpërimi ka lëshuar rrënjë te stela
Si një bimë e keqe i bën hije qenit
Sa tmerr kur ulurin netëve të vona

Dashuria është tharë si një kore buke
Ka kohë s’ka rënë shi në zemër
S’ka pikuar lot s’ka vjellë ndonjë ëndërr

Bimë e keqe rritet me pështymë
Me glaca sorrash e laraskash idiote
Që gjithë ditën krrokatin pa ndalë

TAKIMI I PARË ME EZOPIN

Takova Ezopin në tregun e kafshëve
Lidhte në këmbë një opingë
Dhe vëngër shikonte një dem me një bri

Më kanë bërë kasap më tha
Më kanë kidnapuar një bandë hajnash
Tash zgjedh mish për ta

Nuk më tregoi sa zor e kishte
Njërën opingë e ngrehte zvarrë
Dhe qeshte me personazhet e tij

QENI LLASKUC

Qeni më është bërë llaskuc
Dikush e ka mashtruar me asht zogu
Sa tmerrshëm leh kur jam në gjumë

Qeni im i mirë ka dalë në rrugë
Shkon pas atyre që bartin fjalë në lagje
Që jashtëqitjen na e shesin për mjaltë

Shumë e kam dashur si këlysh
Kam besuar se rritet me zogjtë
Se hënës i bën roje kush mos ta puthë

DITA PA ZOGJ

Zogjve u kanë rënë puplat
Janë cullakuar janë bërë si minj
Erë e keqe ka thyer degët e ftoit

A mund të shtrihet pranvera mbi cung
A jetohej pa këngë zogjsh
Pa erën e ftoit a ka gjumë

S'bëhet jeta me fjalë zinxhirë
Me metafora të përjargura
Mbi një letër të nxirë

BATANIA

Mbështillesh me batanije
Më mirë se me lëkurë femre
Të zë gjumi si zogun në degë

Me rëndësi është ta bësh gjumin e mirë
Të gjitha të tjerat janë jashtëqitje

Teprica që bartim në trupin e ndyrë

Kur gjendesh nën batanije
Ëndrrat çelin si zogjtë nga vezët
Ditën e mund si gjel maje plehu

SHIGJETË E ËMBËL

Atë ditë ishte mesi i verës
Lulet këputeshin nga vapa
Fshiheshin nëpër plasa zemrash

Shën Valentini hapi pelerinën e zezë
Një lule iu ngul në kraharor
U shndërrua në shigjetë të ëmbël

Katërbëdhjetë shkurti
Ishte dita më e gjatë atë botë
Çeli lulja që lëshoi rrënjë në zemër
Hënëzoi ditët që u mungon hëna

IRENA GJONI, NJË ZË QË PO VJEN NË POEZINË SHQIPE

Irena Gjoni ka kryer Studimet Universitare për degën gjuhë – letërsi. Në vitin 2007 ka përfunduar Studimet Pasuniversitare dhe ka fituar gradën “Master” si dhe Dr shkencash , për letërsi në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Ka punuar si gazetare në median e shkruar kombëtare dhe lokale, në Radio “Gjirokastra”, në radio dhe televizion lokal të Sarandës. Aktualisht është pedagoge e jashtme në Universitetin e Tiranës Filiali Sarandë, mësuese letërsie në gjimnazin “Hasan Tahsini” Sarandë si dhe gazetare në mediat lokale. Është nënkryetare e “Klubit të krijuesve Jonian”, si dhe redaktore e revistës “Arti Jonik”, anëtare e Këshillit Artistik të Bashkisë Sarandë. Që prej viteve të shkollës së mesme e në vijim ka botuar poezi, prozë letrare si dhe shkrime kritike e studimore në periodikë të ndryshëm. Në vitin 2003 ka botuar librin me poezi “Tatuazh në shpirt të detit”. Në 2008 boton librin studimor “Marrëdhënie të miteve dhe kulteve të Bregdetit Jonian me ato ndërkufitare” (material me të cilin ka fituar Gradën “Master”), si dhe vëllimin me fiksione “Gjysma dashurish”. (2010)

BIONDIA E DETIT

Biondia e Detit
Përmbysi Detin
Iku e larë mëkatesh
(Pa të fundit)

E shndërruar në një ujëvarë bionde
Që binte mbi përndritjen e një qiriri,
Strehim gjeti tek shtëpia e Muzave
Si për të qenë më afër zemrës së qiellit
Prej nga priste një kartolinë
me urim mbretërisht ciganë

Që nëpër rrugë vetëtimash,
do t’i shtynin
Duke u pëshpëritur me zë sirenash

në tundim për mbërritje të shpejtë

“Unë një cigan
imagjinoi në sa i mirë do të shndërrohem
Kur të njelmtesohem në flokët e ujëvarës bionde
Ikni, ikni në vrapime të çmendura
ju urime mbretëresh ciganë”

Por gjarpërinjtë e zjarrtë të vetëtimave
kafshonin kokët, bishtat e njëri-tjetrit
duke lënë rrugë në mes
a duke krijuar udhëkryqe

Dhe urimet e mbretërve ciganë
ende s’kanë mbërritur tek
Biondia e Detit

... JETONIN NË TË NJËJTËN TJETËR BOTË...

Erëligat e orëligat po e ndëshkonin
shkulshëm-flokësh
shkulshëmrrënshëm
shkulshëmzemrash
përpiqeshin t’ia merrnin

Tërbimi frenetik ish’ pa fre
Pse e deshti
sa nuk e kishte dasht’
kush tjetër në këtë jetë
e nuk kishte për ta dasht’
as në përtejjetë.

Shpirti vajtueshem kolovitet
nga parajsa në ferr
Stiksi ishte kufiri i fatit
Fati ishte AI
Ajo ishte e destinuar

të jetonte brenda fatit
Ajo jetonte brenda tij.

Ajo po e ndërtonte veten brenda tij
Ndanin të njëjtin pulsion zemre
Një frymëmarrje u mjaftonte të dyve
Hanin të njëjtin ushqim amëshimi
Tirrnin të njëjtën fije drite
Ternin të njëjtin tingull ajri

Vetëm në një lot ngrinin uragane
Tek një flokëz dëbore
ndërtonin themele lumturie
Deheshin në ekstazë
nga e njëjta aromë manushaqeje

Udhëhiqeshin nga të njëjtat muza
Tek i njëjti shikim shpërthenin
e shuanin vullkane brenda një sekonde
Shihnin të njëjtën ëndërr apokaliptike

... Jetonin në të njëjtën tjetër botë...

DASHURIA SI ZJARRET E CIGANËVE

Hënëzohj ditët që u mungon hëna
Dielloj netët që u mungon dielli
Sa herë shoh sytë e tu prej përralle

Thith helmin e ditëve
Vjell gëzimin e netëve
Kur më arratisen prej shikimit
sytë e tu prej përralle cigan

Në zemër, në tru, në shpirtin tim,
ndeze një dashuri të çmendur
si zjarret e fisit tënd

Një dashuri - zjarr ciganësh
që s'dihet sa do të zgjasë
që s'dihet:
në do të shndërrohet i gjithi në hi,
në do të ngelen ende urë të shuara përdhunshëm,
në do të merren prej tij
disa thëngjij për të ndezur një zjarr të ri
(të paktën për të krijuar egzistencën e dikurshme
të një zjarri të lashtë
si qiri i ndezur mbi kufomat e së shkuarës)

... që s'dihet...

Ah, kjo dashuri si zjarret e ciganëve...

KOHË TEK SHTYLLAT E HERAKLIUT

Më në fund...
Më në fund mbërrita
tek Shtyllat e Herakliut

Gdhendur në një rën
(Ndoshta prej parambërritit tim
A ndoshta prej mbërritit të parë
pas Herakliut)
deri në shpirt të shkëmbit
gati në thërrmim gjeta fjalët:
“KOHA SHËRON GJITHÇKA,
PAÇKA SE ME VONESË”

Në hutimin tim,
në të pabesë më puthi
Perëndia e Diellit

Unë riktheva të puthurën
po në të pabesë
Në gdhendje tek shtylla tjetër:

“PO NËSE S’KE MË KOHË,
MOS NDOSHTA ME PLAGË TË PASHËRUARA
TË DUHET TË VDESËSH?”

Më në fund...
Më në fund mbërrita
Tek Shtyllat e Herakliut
Para më pak se të më dilte gjumi...

DEDIKIM MUA

E mora zemrën në njërën dorë
Dhe me dorën tjetër në zemër,
U nisa...

Trokita në një derë lyer me bojë të artë
Prita.
Dhe drynin me ndryshk,
vetëm atëherë e pashë
Atëherë kur qe bërë natë
(Mallkuar sytë e mi
që dinin të shihnin veç natën)

E mora dorën ngarkuar
me sytë e mallkuar
dhe e futa në xhep
(Në një xhep të verbër
që ish ‘pagëzuar nga soji i banorëve të tij)

U KTHEVA...

Veten s’e gjeta atje ku e lashë
Gjeta vetëm qenin besnik
që ruante shtëpinë e braktisur

Atëherë u ula të qaja
për vete, për zemrën e ikur,

shtëpinë e braktisur,
për sytë e vjedhur nga xhepi
dhe atë tatuazhin e vajzës,
vdekur në asfaltin e thatë
që s'kishte kush ta lante më me lotë

U ula të qaja dhe qesha
Kisha harruar se të qash pa sy
dhe me zemër të lënë diku,
Është e pamundur

U ngrita i verbuar dhe eca drejt vetes
Truri më tha t'i thosha vetes i bindur
se kisha vdekur më në fund...

* * *

Ëndrra thonë që është e shkurtër,
por ajo që le pas, është e gjatë
Më e gjatë se gjatësia e jetës së fundme
Dhe pak më e shkurtër
se gjatësia e jetës së përjetshme

...JO ME LOTË NË SY, POR...

...me sytë në lotë
Në një akvarium grushtash,
Eci rrugëve të verbëra të detit
Për të gjetur ty shpirt

Egziston,
a je imazh iluzionesh vallë... ? !

AUTOPORTRET

Ngjitur shtyllave të rrugëve

- Si në kohët e lashta,
lajmërimet e vdekjeve, - pëshpëris

(Ej, bukuroshe, kjo erë vjeshte
ta zhbën nocionin kohë?)

Fletës së letrës,
në këmbë i ka ngelur vetëm një gisht,
i mjafton balerinës virtuoze
të bëjë vallzimin e vdekjes
nën ritmin e erës

Fryma po i del çikë e nga një çikë

Ekspozitë...fotografike
Modele...- Biondia...e...Detit
Fo...to...graf...-me...ndjet... ..e... ..
a...dh...u...r...u...e...s...v...e...
...t...ë... ..s...a...j...

Shpirti i fluturoi
rrathëve të ferrit - rrugicave vjeshtake
Per t'u bastarduar
Nënkëmbëve të kushedi kujt
Fotograf - Mendjet e adhuruesve të saj

E fiksuar fotografive nga mendjet
Në çastet më fatlume a fatkeqe
sjellë adhuruesve të saj

Një vetull perfekte në ironi të dashurisë
e vjedhur një fije floku e verdhë,
e mbajtur fatsjellës,
një arkivol sysh - guackë perle kënaqësi,

një buzëqeshje vrasëse pa pagesë,
buzë të kopjuara me karbon të kuq buzësh
për t'u risjellë pranë netëve ogurzeza,
një gjoks ngacmues, përtej dekoldeve
dhe bluzave të ngushta,
mantel të kuq gëzofësh - mburojë shigjetash,
një lot i zi,
përzier me helmin e dhimbjes e rimelit,
duar të sikletshme, përherë në mbajtje të shanceve,
ëndrra të mëdhaja,
pa ditur ditën e lindjes e vdekjes,
mendje në lojëra fantazie,
hipnotizuese për të tjerë

E gjitha e ndarë,
në një labirinth mendjesh,
E ngelur në të njëjtin vend,
E ngelur në të njëjtën moshë,
E gjendur në të njëjtën bukuri Beatrice

Ekspozitë e parë me shpirt të rrënuar,
E paçuar gjer në fund,
E trembur nga bukuria e dikurshme,
Nga adhuruesit e shumë gati mitikë,
Nga ëndrrat të ëndërruara dikur fatlume

Me shëmtimin krijuar prej zhgënjimit,
Me çmendurinë prapë pinjoll të zhgënjimit,
Eci rrugëve duke mbledhur gjethet e vjeshtës,
Me përfytyrime - fotografitë e mendjeve të adhuruesve
Pa i parë
Vetëm duke iu trembur
Bastardimit nga nënkëmbët
E kushedi kujt...

LEDIANA KAPAJ, ZË I VEÇANTË POETIK

Bëj të shkruaj...s'më bën dora, bëj të qaj....zemra më plas.. bëj të flas ...fjalët pengohen, bëj të hesht....Po uluras....

Lediana Kapaj lindi në Tiranë. Fëmijëria e saj ka qenë tepër e dhimbshme, pasi prindërit i ka patur të ndarë. Është rritur me shumë vështirësi nga nëna dhe disa vite edhe nga gjyshërit e saj, me mungesën e dashurisë. Është larguar nga Shqipëria në vitin 1990, kur u hapën ambasadat, atëherë kur akoma ishte fëmijë. Franca është shteti që ia hapi krahët dhe i mbajti si një nënë e dytë. Jeton në këtë shtet që prej tashmë 20 vjetësh dhe po këtu kreu shkollën e mesme dhe të lartë. Punon prej vitesh si eksperte dhe përkthyesë në Gjykatën e Lartë të Apelit. Që në moshën e vogël ka shkruar poezi dhe tekste patriotike, për atdheun dhe vendlindjen, por nuk i ka publikuar kurrë. Duke shkruar poezi dhe prozë ajo ndjehet ëndërrë e munguar, dashurinë dhe jetën vetë. Ka vendosur t'i shkruajë dashurisë, ndjenjës, dhimbjes, lumturisë, të cilat i solli para lexuesit në një botim të parë, titulluar “Dallgë dashurie”, në shkurt 2010. Librin ia fali dhe ia dedikoi shoqatës së fëmijëve jetimë në Shqipëri ... Në fund të tetorit 2010, libri i saj i dytë është i botuar nga shtëpia botuese “Ada”, i titulluar: “Fillad dashurie”

1) UDHËVE TË PAUDHA

Udhëve të paudha si të humbur shtegtojmë,
kryq e tërthor dhe e uritur çapitet shpresa.
Endërrat në ëndërra të lënduar kërkojmë.
stërgjaten pa mëshirë si tërkuzë, dëshira e mbresa.

Mëndje e njëmëndët si e çmendur marrohet,
labirinteve të pafund të pa anë e pa fill.,
zemër e s'provuar si Borëbardha harrohet,
në të ashpërin, të brengosurin dhe të errëtin pyll.

Vetmi e mallkuar si kuçedra pareshtur sëmbon,
në shpirtin e brengosur dhe të tharë të çdo udhëtari,
Dëshira e lënduar dhe e etur shteron,

duke lene pas saj një mjegull...ku sundojnë veç gurë varri.

Persiatje e përçartur më në fund mbaroj,
pa gjurmë e zhurmë dhe si shumë herë të tjera,
si zogu i pranverës në agim, shpirti vetë fluturoj ,
në krahë trishtësinë,e përndoqi një çast era!!

2) PLUHURI I HARRESËS

Do mbulohemi një ditë,nga vetë pluhuri i harresës,
do na zhduket krejt papritur dhe vetia e kujtesës,
do na fshihen gjurmët, që mes hallesh lamë në jetë,
më s' do mundemi të shikojme sa i bukur është ky det....

Se kam friken që të fle,më trishton mos jem e zgjuar,
më tremb dita kur do iki,diku larg për tu harruar,
nuk e di në ç'botë do shkoj, ku e ka misterin vallë,
a ka dritë,a do ketë ujë,dashuria është më gjallë?!....

Dhimbje kam që më mos shoh, lebetitem mos kem lot,
s' mund të lë ata që dua,s' mund të rri pa i parë dot,
e përbuz të vrazhdë qetësinë,zhurmën dua të dëgjoj,
dua ti shijoj unë tingujt,dua këngën ta lëndoju...

Dua diellin që ta shoh,dua yjet ti veshtroj,
dua shiun të më lagë,dua boren të më mbuloj,
dua luleve tu mbaj erë,dua gonxhen lehtë të çelë,
dua të qesh,dua të shkruaj,dua frutat vetë ti vjelë....

Nuk e di a do kem ftohtë,shumë e dua ngrohtësinë,
a do jem e robëruar,a do kem aty lirinë,
a mos vallë do jem e vetme dhe me shpirt te përcëlluar

3) KU KAM GABUAR?!

Nëse nga dhimbja jam tjetërsuar,
dhe lotëve endem pa hijeshi,
mos më gjykoni ku kam gabuar,
se mbi të gjitha jam veç “njeri”.....

Nëse në gjunjë, nje çast më shihni,
Dhe klithmat buzët po mi përshkojnë,
mos ligështoni...mëshirë mos kini!
Në dashuri dot s’komandojmë...

Nëse nga malli ëndrrat brengosen,
dhe nata e ftohtë duket “lubi”,
mos i qortoni, pse më plagosën,
se dhe zhgënjimi quhet..”njeri”....

Nëse nga etja gjakun ma morën,
dhe trupin, mëndjen ma vunë në gjumë,
nëse shikoni që shpirtin vodhën,
mos u trishtoni...ngelem po “Unë”.....!

4) PËR TY ELODIE...

Bëj të shkruaj...s’ më bën dora,
bëj të qaj....zemra më plas..
bëj të flas ...fjalët pengohen,
bëj të hesht....Po uluras.....

“Brymat” e faqeve të tua si pika uji i sjell në mëndje,
buzëqeshjen e ëmbël më dhuroje..moj shpitmirë,
dy sy që përhapnin gjithkund aromë dashurie,
Elodi....vogelushja me shpirt të pastër dhe të lirë...

Erdhi prilli i mallkuar...plot 2 vjet që s’të kam parë,
nënë shoh si të vajton, të mjeruar le babanë,
zogjtë i shoh si po këndojnë, mbi mermerin të lotuar,
bukuria i magjepsi....ndaj vajtojnë të pikëlluar....!

Endem vargjeve e brengosur, më lër pak që të flas,
të ti puth të ëmblat duar... Të më dali ky maraz..
Të të përqafoj me mall dhe të them sa na mungon,
ah kjo humbje zemra vogël... shpirtin po na përcëllon...

Shumë pranvera të përkisnin... shumë pak kishe kaluar,
para ishte vetë jeta... u largove pakuptuar,
sot në foto të shikoj... bëlbëzoj dhe psherëtim,
e mjeruar shoh nga zoti... "Pse lë vdekjen që të vij"?!

Asnjëherë s'mora përgjigje dhe pse ëngjëjt i lakmova,
askush s'diti të më thoshte dhe pse zinë me zë mallkova,
padrejtësia më lëndoj dhe papritmas.. U tërbova!
"Përse... Përse vogëlushe..."?!... Dhe mbi klithmat u rrëzova....

Këtë poezi ja kam kushtuar vajzës së shoqes time të ngushtë
e cila u nda nga kjo botë para dy vjetësh në një kohë që ishte
vetëm 14 vjeçe Bashkohem me hidhërimin e familjes dhe uroj
që shpirti i Elodit të prehet në paqe...
Të duam shume Elodie..... Të puth fort....
Per Elodi Selami Limaj

5) MË TREMBI VETËTIMA

Ngarkova mbi kurriz një thes me psherëtima
dhe nisa udhëtimin në brigjet e vetmisë,
kalova shkretëtirë... gëlltita vetëtima ,
e vetme kisha mbetur, si peng e dashurisë...

U ndesha nëpër vite me dhimbjen e mallkuar,
pa ditur se ku shkoja... në pritje të qetësisë,
megjithëse plagët mora, jo shpirtin kurrë s'ma mundën,
mes ëndrrash të përhumbura.. ju luta lumturisë..

Stuhia më ka shtyrë.. nuk dija ta ndaloja,

me erën kam vrapuar...shëtita gjithësisë,
rrufetë i hasa rrugës...më trembi vetëtima,
një skllave e pabindur në pritje të qetësisë....

Ngarkova përmbi supe ca vargje që rënkonin,
nuk munda që ti thurja kurrë lavde tradhëtisë...
zhgënjyer..por me shpresa dhe zemër të pashuar,
kam pritur ti shikoja pak dritën “ madhështisë”....

6) LËNDUAR ENDEM...

O Zot...Përse më bëre?...Lënduar endem vetëm,
përmallur nga dëshira, të fle me shpirt të qetë,
dhe ndonëse kalimtarë në rrugën tende mbetëm,
me shpresat po luftoj,të ndjej pak fjalën “ jetë”!

Po shkrihem e përmbytur në ujërat e misterit,
ky trupi i përhumbar mes brengave më nget,
se di kur te vije vdekja...!!!A do jem pjesë e ferrit,
se di...!! Mos vetë parajsa me ngrohje po më pret?!

O Zot...jam lebetitur....! Pse shpirti u është tharë?
Të gjithë ata që desha, kurrizin më kanë kthyer,
nuk dua të më quajnë...” të ligë” ..dhe as të “marrë”,
mes mureve prej kujtimesh, një pjesë zemre është thyer!!

Por zoti s’ më përgjigjet ...vetë ëngjëjt janë të zënë,
mes lotëve përgjërohem...s’po di kë të thërras,
jam mbytur në mendime..gërthas...” Ku je moj nënë”?
mallkimi po më ndjek...!! Ky shpirti po më plas....

7) KUSHTUAR MOTRËS SË NJË MIKU

Ah ky mall i përvëlur, shpirtin tim mes zjarrit tret,
ikën ditë e ikën muaj...dhimbja, brenga po më vret.
I hutuar shoh nga qielli, një takim me ty kërkoj,

si dikur moj motra ime...Kam dëshirë të bisedoj!

Iku viti i mallkuar...zemra, syri të kërkon,
si t'ia bëj...? Të lutem thuat..Pritje gjatë...Me gllabëron!
Pres të vish..dhe pse s'dëgjon...mi prano lutjet e mija,
kemi lindur prej një gjaku...Po më ha e trishtë vetmia....

Lule je....lule të fal...A i ndjeh si kundërmojnë?
folmë pak...përqafo më...! Engjëjt lart të ledhatojnë.
Nuk të quaj dot “ të ikur”...! Po më lodh kjo plogështia...
falmë fjalët...Falma lotin... më pikojnë nga dashuria..!!

8) POETIT...

Të jesh poet..do të thotë që zemra,
me vargun vetë është mrekulluar,
të kesh një botë si vetë kristali,
me fletën, penën ...je dashuruar!

Dhe rreshtat mbushin...mjeshtrit e ndjenjës,
të pasionuar...plot bukuri,
duke kërkuar të gjejnë mes tyre,
të ëmblën ëndërr plot mirësi!

Të jesh poet...do të thotë që shpirtin,
ta kesh të madh...padjallëzuar,
të shtypësh cmirën, shkelësh urrejtjen,
të presësh mallin...kur rri “vetmuar”....

Të japësh shumë...të vetëflijojesh,
ta mbushësh jetën si me magji,
të bëhesh shok me djallin vetë,
duke e bindur...ta bësh njeri!

Të falësh bukën kur sheh të mjerin,
të japësh krahun, të dhurosh ndihmë,
të shuash zjarrin që mban vetë “ferri”,

në vënd te hirit të mbjellësh bimë...
Të buzeqeshësh dhe kur vetë dhimbja,
të hyn në trup...për të përpirë,
me mjeshtëri ta derdhësh vargun,
të shohësh diellin edhe pa gdhirë....

Mos kërkosh shumë...se ke gjithçka,
mos të mbulojë kurrë zyrtësia
të mposhtësh fatin dhe të ngresh kokën..
...Të ka bekuar vetë perëndia!

9) BIJA IME!

Të shoh si trupin hedh o trëndafil behari,
ti prek të bukurat flokë si rreze ngjyre ari,
nga ty moj bija ime, vetë mrekullinë takova,
që ditën kur si prind në gji fort të shtrëngova....

Me ty dhe vetë u rrita, me ty u bëra “nënë,
tek sytë e tu vogëlushe pashë yje edhe hënë,
thesar ke qënë për mua,tek ty veten kam parë,
oh lotë nuk po nxjerr dot...Gezimi i ka tharë!

Dhe rruga ime jetës nuk ishte aq e lehtë,
por njësh me ty u bëra...më bëre të kem “fletë”,
i preva hovin djallit që dhimbja mos afrohej,
të mbrojta ty si ëngjëll ...kur shpirti më lëndohej...

Mesnatës shpesh jam ngritur..”Mos vallë nuk po merr frymë”?
dhe ftohja më përshkonte...mëngjeseve plot brymë,
ah frika mos të humbja, nga shpirti kurrë s’është ndarë,
një frut i bukur ishe....Në dashurinë e vrarë!

Por koha iku shpejt...vështroj sa shpejt je rritur,
sa shumë me ty krenohem ...akoma je e mitur,
kështu do të qëndrosh gjithmonë “ e vogla ime”,
dhe befas lotët dalin...më futin në mendime..!

Dhe koha prapë të vetën...! Nga unë do të largohesh,
por zemra hapur mbetet...do presë të ledhatohet,
si sot kur më pushton dhe thua..." Sa të dua",
një ditë me zor do pres...të rrish pakëz me mua....

10) DHIMBJA SHFAQEJ NËPËR GERMA!

Me ka ndodhur nëpë netë, vargut papushim ti flisja,
plot sekrete e kam mbushur..si e marrë, "shpëtim" therrisja!
Me keqardhje më shikonte por i mjeri dot s'vepronte,
dhe mes lotësh, rreshtat mbushte,"terapinë" në shpirt kërkonte!!

Nuk kuptoja gjithë misteret....e çuditshme dukej jeta,
pse lëndohej njerëzimi, pse varrosej e vërteta?!
Pse përbuzej vetë e mira,pse plagosej dashuria?
Por i mjeri s'kish ç'te thoshte....i sunduar nga habia!

Dhimbja shfaqej nëpër gërma...Këmbëkryq rrinte me mua,
si ulkonja turfullonte...kur një ëndërr thosh: "të dua",
brenghën donte të pershkruaja...Sa u lodha! Kisha gjumë!
Ja keshtu kalonin orët...Përmbi letër flija unë!

Sytë e enjtur nga të qarët, lart nga dielli i dërgoja,
të më ngohte me ca rreze...ngrohtësinë ta shijoja,
dhe kur drita më përshkoi...ledhatarja tha ca fjalë :
" Shkruaj mike mos pusho, mirësinë e ke të gjallë!

DEGËT LARG TRUPIT I THYEN ERA?!...

Prof. Dr. Adem Zejnullahu (“Rrënjë e Degë” Tiranë, 2008, f.257.)

Mërgimi ndër shqiptarët njihet si plagë e vjetër kombëtare, e cila asnjëherë nuk arriti të shërohej. Për kurbetin shekuj me radhë është kënduar në poezinë popullore, është rrëfyer në kallëzime popullore dhe janë shkruar forma të ndryshme të zhanrit letrar. Që pesë shekuj në poezinë popullore, lirshëm mund thuhet se askund, nuk mund të gjendet ndonjë varg që e lavdëron atë, përveç që e mallkon rëndë, ngase bart me vete barrë të rëndë dhembjeje, mallëngjimi, dramë jetësore që jo rrallë është shndërruar në tragjedi individuale, familjare e kombëtare. Deri tash për mërgimin janë kënduar shumë këngë popullore për nizamët, për kurbetin, balada popullore historike etj., janë shkruar shumë poezi, tregime, romane, drama të autorëve të shumtë, e janë bërë shumë filma etj., që kanë për objekt trajtimin e lëngatës shekullore të kurbetçinjve tanë.

Që nga kohërat e hershme ka pasur migrimë popujsh të ndryshëm, prej një vendi në një vend tjetër, të cilat kryesisht bëheshin për të mira materiale, duke pushtuar tokat e popujve më të dobët, nga më të fuqishmit, dhe duke marrë popullin e tyre si robër lufte për përfitime të ndryshme. Më vonë fillojnë lëvizje popujsh prej një kontinenti në një kontinent tjetër, prej një vendi në një vend tjetër. Kryesisht këto migrimë bëhen për kushte më të mira jete e pune, ose për shkak të klimave më të përshtatshme etj. Shpërngulja e shqiptarëve dhe paraardhësve të tyre për në vende të ndryshme të botës ka filluar shumë herët, që nga viti 167 para erës sonë, atëherë kur mbreti ilir Genti u mund nga forcat romake dhe me dhunë u depërtua në Romë nga konsulli romak Pal Emili, duke bartur me te edhe një numër tejet të madh banorësh të cilët i shndërroi në skllevër. Që nga ajo kohë e keqja si hije e ndjek pas popullin tonë. Historikisht mërgimi të shqiptarët është bërë për shkaqe ekonomike, sociale dhe politike. Populli ynë me shekuj i robëruar nga të huajt, mbi të ka rënduar, veç barra e rëndë ekonomike dhe dhuna e pandërprerë e sunduesve, të cilët kanë bërë çmos që në trojet shqiptare të mos ketë shqiptarë. Mërgimi, si e keqe kombëtare, fatkeqësisht nga mbarë trojet shqiptare po vazhdon edhe sot e kësaj dite, me intensitet të pa zvogëluar, nëpër vende të ndryshme të botës, duke e dëmtuar rëndë atdheun dhe imazhin e tij. Kjo dukuri ka marrë përmasa të mëdha shqetësuese e cila do shqyrtuar me seriozitetin më të madh nga qeveritë shqiptare dhe institucionet e tyre përkatëse, po që se duam t’ia ndalim hovin, ose edhe ta zhdukim tërësisht. Kohëve të fundit

dëgjohen zëra intelektualësh të cilët edhe shkruajnë me përkushtim artikuj e vepra të ndryshme lidhur me këtë problematikë të ndërlikuar. Këta intelektualë, me angazhimet dhe shkrimet e tyre, mundohen që në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndikojnë sado pak në ndaljen e kësaj rrjedhë të turbullt. Shkrimet dhe veprat e tyre ua tërheqin vëmendjen qeverive dhe institucioneve shtetërore shqiptare që të merren më seriozisht me këtë problematikë sa nuk është bërë vonë. Në këtë grup intelektualësh, Sabit Alidema, zë një vend të rëndësishëm me veprën e tij “Rrënjë e Degë” (Mërgata dhe kujdesi ndaj saj). Ai deri me tash ka botuar edhe këto vepra: Dallëndyshet braktisën foletë e veta, 1958; Drangonjtë e Anamoravës, Prishtinë, 2003; Njeriu me shpirt të blertë, Tiranë, 2003; Meteorë Lirie, (Monografi për Halil e Teuta Alidemën), Tiranë, 2006. Në veprën: Rrënjë e Degë, Sabit Alidema, mërgimin, gjegjësisht inkuadrimin e punëtorëve tanë të inkuadruar përkohësisht në botën e jashtme e kundron nga shumë aspekte, duke filluar nga shkaqet e mërgimit, dhunën institucionale të shtetit robërues serb, vështirësitë e shumta për t’i kaluar kufijtë e shteteve të ndryshme, vendosja e tyre, jeta dhe veprimtaria e tyre, gjeturia në vende të caktuara, e deri tek brought, mallëngjimet, dëshirat, ëndrrat, revolta dhe synimet e tyre për t’u kthyer në atdhe. Pra, vepra në fjalë, ngërthen në vete të dhënat të shumta për mërgatën tonë, pa lënë anash kontributin e diasporës që dha për popullin dhe për Kosovën, deri te vërejtja se tani këta duhet të merren më tepër me hallet e saj. Titulli i veprës “Rrënjë e Degë”, në mënyrë simbolike, paraqet rininë tonë e cila lë atdheun e vet dhe vendoset nëpër vende të ndryshme të botës. Struktura tekstore e veprës ngjesh në vete momente të rënda dramatike jetësore e historike, madje nganjëherë edhe tragjike. Vështirësitë me të cilat ballafaqohen kurbetçinjtë mund t’i dinë dhe t’i kuptojnë vetëm ata që i kanë përjetuar ato rrugë ferri dhe e kanë ngrënë atë bukë të mundit e të mallëngjimit. Vepra “Rrënjë e Degë” përmban në vete shkrime publicistike, zyrtare, historike, fjalime me rastin e përvjetorëve të ndryshëm të figurave të shquara të kombit tonë, e veçanërisht rrëfime të drejtpërdrejta, të mara nga goja, jeta dhe veprimtaria e mërgimtarëve tanë nëpër mjedise të caktuara. Pra, ka këtu shkrime publicistike, kujtime, dialogë, shkrime në formë ditari, krijime artistike etj. Libri ndahet në tetë kaptina kryesore të cilat përfshijnë në vete një tematikë të nduarnduarshme, me disa nën kaptina të tjera të cilat e plotësojnë njëra-tjetrën duke sajuar tërësinë e veprës. Këtij shkrimi të rëndësishëm i paraprinë një parathënie e autorit, në të cilën ai njofton lexuesin në mënyrë të hollësishëm për përmbajtjen e veprës, arsyet dhe shkaqet të cilat e kanë shtyrë që t’i rreket një problematike kaq të rëndësishme, por edhe të ndërlikuar. Deri më tash, askush nuk e ka trajtuar mërgimin në mënyrë aq të përkushtuar sesa Sabit Alidema me këtë vepër, i cili nuk ndalet vetëm

në trajtimin e punëtorëve tanë të inkuadruar në botën e jashtme përkohësisht nga treva e Anamoravës, por këtë problematikë e trajton edhe në përmasa më të gjera të hapësirës gjithëkombëtare. Autori në këtë vepër i bën një analizë të gjithanshme mërgimit si dukuri dhe si plagë shoqërore e kombëtare. Vepra flet në mënyrë të vaçantë për kontributin e diasporës që ka dhënë me vite të tëra për rezistencën, qëndresën, përgatitjen dhe Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të vitit 1999. Në kaptinën e parë: “Rrënjë e degë”, autori me shkathtësi të veçantë depërton në mesin e bashkë atdhetarëve tanë, pa marrë parasysh moshën dhe gjininë e tyre. Ai më këtë rast zhvillon një dialog të zhdërvjelltë, duke provokuar vëmendjen, ndjenjën, fshehtësinë dhe nga ata merr atë që do ta shkruajë në letër. Sipas shkrimit të tij, ai arrin të depërtojë thellë në botën intime të mërgimtarëve, duke ua zbuluar fshehtësitë e tyre që i ndryjnë thellë në vete, siç janë dashuria për fëmijët, për prindërit, për gratë, për vendlindjet, për yjet e qiellit për Kosovën etj. Ata vuajnë që s’kanë mundësi të kthehen në vendlindje, aty ku çdo gjë që ka e s’ka shpirt i thërret, i fton e i do, ku kanë lindur, ku kanë folur gjuhën e nënës, ku janë rritur dhe ku kanë kujtimet më të mira në jetën e tyre. Shumë prekëse janë rrëfimet e mërgimtarëve kur ata shikojnë në vetmi qiellin dhe mendojnë, duke i bërë vetes pyetje - a thua a ndriçojnë këto yje edhe mbi shtëpitë dhe vendlindjen tonë të dashur?! Ka të tillë që deri vonë zhvillojnë dialog me yjet me hënën, me qiellin për fatin e tyre. Nga biseda që zhvilloi autori i kësaj vepre, jo pak vijnë edhe ankesa të ashpra drejtuar Qeverisë së Kosovës se nuk ka bërë asgjë për kthimin e tyre. Nga rrëfimet dhe kujtimet e mërgimtarëve, lexuesi mëson për momentet më të rënda në jetën e tyre, duke filluar nga ndarja me familje, farefisnin dhe atdheun, të cilët në largësi u sjellin vuajtje mundim e mallëngjim...

PËR FLAMUR, SHQIPTARI S'FAL...

Alma Papamihali , është poete, publiciste, pedagoge e mirënjohur shqiptare. U lind në qershor të vitit 1974 në Tiranë. Aty kreu gjimnazin Ismail Qemali më pas studjoi Gjuhë dhe letërsi. U rrit në gjirin e një familjeje atdhetare ku mori nxitje dhe përkrahje artistike. Bota letrare, veçanërisht poezia, ia rrëmbeu shpirtin që në fëmijëri. Ka lexuar shumë libra qysh në moshë të njomë duke patur për model shkrimtarët dhe poetët e vet të preferuar: Millosh Gjergj Nikolla- Migjenin, Naimi Frashërin , Dom Ndre Mjedën, Lasgush Poradecin, Ismail Kadarenë, Dritero Agollin, Bardhyl London etj.

Nga letërsia e huaj preferonte Pushkinin, Heinrich Heinen, Pablo Nerudën etj. Gjatë viteve shkollore ka bashkëpunuar me gazetatat dhe revistat e qytetit, si Rinia, Intervista, Pasqyra etj. Aktualisht jeton me familje në Gjermani, ku mallin e shuan për Atdheun me një hallkë të fortë të lidhjes sentimentale, siç është poezia. Në shtator 2007, në Aschaffenburg të Gjermanisë, ka krijuar shkollën shqipe Iliria, në gjirin e së cilës vepron si mësuese. Është anëtare aktive e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptar në Gjermani.

Botime:

Përmbledhja poetike “Nën tingujt e natës” e Alma Papamihalit me 100 poezi, është botuar në Tiranë në shtator të vitit 2007 (redaktor, Viktor Canosinaj). Poezitë e Alma Papamihalit janë përmbledhur dhe përkthyer edhe në gjuhën franceze, apo atë rumune, (në antologjinë “Çelësi i Shpirtit”), si dhe në revista, apo gazeta të ndryshme periodike.

Disa poezi nga libri “Nën tingujt e natës”

ENIGMË KTHIMI

Jemi shumë, sa shumë jemi ne,
fëmijë dyvendesh lindje-perënduar,
si të huaj njërës anë përcjellë,
e në tjetrën mysafirë pritur,
dhe pse më parë (kurrë) s'ishim harruar...

Qindra duar zgjatur sportelesh,
shpesh fundosur kur indentifikohen,
më shumë largohemi se vijmë,
jetë që ecin pas ndërprerjesh,
por që pa nisur ende, mbarohen...

Çdo centimetri gjendemi ne,
të ashtuquajturit “binjakë perëndimi”,
vërtetë nuk veshim të njëjtat ngjyra,
por skenar ëndrrash të një autori jemi,
përfunduar me enigmën e një kthimi...

Jemi shume... sa shume jemi ne,
që dy herë më shpejt, vdesim nga të tjerë...

SHTEGTIM PULBARDHE

Largohem për të mos u kthyer më,
Ndaj iki tutje, fluturoj,
Në pulëbardhë etur bregut shndërrohem,
Duke dashur të lënit pas t' i harroj...
Por të harrosh s' mjafton gjithmonë,
Drejt qiellit të kaltër një fluturim,
Dhe pse pulëbardhë shndërruar jam,
Ka dhe shtegtime me drejtim kthim...
Drejtuar qiellit ti vazhdon sheh,
Me tëndin shpirt ndjek shtegëtimin,
Kur lartësive në pikë shndërrohet,
Oh sa i largët të duket kthimi.
Larg fluturoj, pa frikë largohem,
Sepse e ndiej që çdo shtegtim,
Sado i largët në vetvete,
Do më riktheje pranë detit tim.
Dhe për çudi vazhdoj e ngjitem,
Aspak s' kërkuj të shoh nga pas,
E mjerë do mbetej çdo pulbardhë,
Të huajat brigje po të trokasë...

Ndaj ngjitem lart, ndaj fluturoj,
Në pupël reje jam shndërruar,
Nëse ky qiell mbi det s' do flinte,
I imi mall do ish' harruar...

ËNDRRAT

Nëse ëndrrat nuk do ekzistonin
Jeta do kthehej në përvëlím,
Etja e jetës do mbetej pashuar,
Pa ëndrrën një jetë do quhej trishtím.
Nëse me fjalë s' mund të zgjidhej,
Nyja mpleksur pa dëshirë,
Ëndrës do i rikthehesha ,
Atje je vërtetë i lirë.
Ëndërr dhe jetë!
Sinonime të etjes së pashuar,
Nëse një ditë do shuhej etja,
Dije, nga kjo jetë ke shkuar.

KUJDES

Nëse një degë këput
mos pyet më pas,
pema si quhet.
Para se dikë të lëndosh,
mundohu të dish,
çfarë duhet...

EMIGRANTI

Diku veç në tavolinën
Me mbulesë të bardhë shtruar,
Birrë të huaj ke përpara
Dhe një pamje të menduar.

Diku veç në tavolinën
Në një qoshe të lokalit,
Shokun tënd se ke përballë
Pi vetmuar ti prej hallit.
Diku veç në tavolinën
Në një lagje të panjohur,
Gjithçka është akull e ftohtë
Vetëm birra është e ngrohur.
Diku veç në tavolinën,
Që të bën ty shoqëri
Gotën s' di ku t'a trokasësh,
Tavolina s' është njeri.

KUAJT

Kurrë s' ia qava hallinkalorësit për këmbët,
që i vareshin. Netëve ulëriva,
me kuajt në stallë.

Më dhimbej,
kurrizi i tyre i dalë...

FLIRTIMI

Secili ulur në karrigen e tij,
të dy përballë...
nuk e njohin njëri-tjetrin,
ndaj nuk shkëmbejnë fjalë.

Ndërkohë që s' flasin,
ju puthen vështrimet.
Stacioni vjen. Njëri zbret.
Ja pra, ç' na qenkan flirtimet.

HËNA GËNJEN

Nuk bie hëna,
mos prit t´a presësh
dhe nëse pranë e ke...

Nuk bie hëna,
mos prit t´a presësh,
veç djallëzisht të sheh...

SHPIRT I RI

Çdo mur i dhomës,
ka varur një pasqyrë,
ku veten sheh çdo ditë...
Por të rinohesh,
nuk vlejné pasqyrat,
që s´depërtojnë në shpirt...

RRUGË QË SHKELEN

Kjo rrugë ende më do,
dhe pse çdo ditë e kam shkelur...

Sa rrugë të tilla ka në botë,që të pafjala kanë ngelur...

LULJA

Lule në kopështin tënd, nën barin e njomë fshehur...

Kujdes kur hapat hedh,
nuk flet, por s´duhet
shkelur...

Përmbledhja poetike “Nën tingujt e natës” e Alma Papamihalit hapët me poezinë

“Dashuri e përjetshme” e cila ndjeshëm shprehë dashurinë ndaj Shqipërisë, dashuri e cila shndërrohet në mall. Ajo dashuri nuk vdesë, nuk harrohet, nuk vyshkët, nuk shteron, dhe nuk plaket kurrë. Dashuria ndaj natyrës që ajo e do dhe i mungon shumë e shtyn të bëhet poete, të ushqehet më gjuhën e vet, sepse fëmijët nuk mund të mbesin viktimë e natës. Të “Nëna” krijuesja lidhët tërësisht më moralin e Nënës, dashuria dhe përvujtëria e saj me lumturinë më të madhe ndër duar. Sikur për të gjithë poetet e mërgimit, edhe për Alma Papamihalin jeta në mërgim është Dimër edhe pse ndryshe e kishte imagjinuar, në mërgim çdo stinë qenka dimër, edhe pse Alma ka në shpirt edhe stinën e pestë që e mban ngrohtë gjithnjë, ajo është stina e dashurisë. Vetminë në mërgim pa të dashurit, në një lagje të panjohur, ku nuk ke me kënd e cakërron gotën, e përcjellin malli, meditimet, shtohen thinjat që ushqehen me këso meditimesh, siç të poezia”Thinjat”: “Dikur fëmijë mendoja/ thinjat qenë për ata/ në moshë të thyer/ por sot i dua thinjat/ mendimi i çdo dite / m’i ka ushqyer. Dhimbja dhe solidarizimi i saj më të vuajturit të poezia “Kuajt” shpreh një diferencim shoqëror që vështir i shpëton pa vërejtur syrit krijues.” Tirana ime” dhe “Në Tiranë” janë poezi që i kushtohen qytetit të saj të lindjes, ashtu siç është, aty ku ka shumë zhurmë, ku ka smog, pluhur dhe trotualet kah kalojnë gocat e pispillosura, pellgjet me uji që rënkojnë njësoj si poetja, dhe se është plagë e këtij qyteti njësoj si Alma, qytet që me së miri e njih: M’u lagën këmbët / në pellgun me ujë / që rënkoj si unë ... Por edhe qyteti i Korçës është qyteti nga ka sythet e ëma dhe është po aq i dashur për poeten. Pastaj Kosovës i kushton gjithashtu vëmendje të veçantë, të poezia apeluese “Indiferentizëm që vret”, i drejtohet botës që nuk sheh, as nuk dëgjon, apo nuk dëshiron të dëgjoj apo flet:”Ah botë e vjetër / që sheh, dëgjon, por s’flet / indiferentizmi yt i sotëm / sa e sa zemra i vret”. Poetja komunikon me realitetin, me natyrën nuk i lëshohet rastësisë, nuk pret që ti bie nga hëna diçka, apo ti vijë në paketë diçka e dhuruar, e nuk i dihet paketa të tilla mund të sjellin edhe halle ose surpriza që nuk gëzojnë. Krijuesit duhen të jenë këmbëngulës si bleta apo tekanjor si fëmijët, kundrejt rrethit i cili nuk është gjithmonë i mëshirshëm, por herë-herë edhe si lule e heshtur që numëron ditët që kalojnë e që “Nen tingujt e natës” dhe të muzikës përpiqet që jetën ta kalojë të dyfishtë:”Dita stafetën i dha natës / prisja diçka të tillë/ kur muzgu zë të bjerë/ frymëzimi merr zanafillë. Heshtje dhe përsëri muzikë / mbrëmjeve dëgjoj një serenatë / nëse di dhe natën ta jetosh / jeta është dyfish e gjatë. Të poezia Nen Tingujt e natës. Shprehja e saj alegorike për poetet dhe poezinë, që të paret dashurojnë e nuk e shijojnë kurrë, por që nuk vdesin kurrë, sepse ata rilindin aq sa lexohen, ndërsa frymëzimi vjen i papritur e shpesh i gjënë poetet të pa përgatitur. Lirika e Almës për dashurinë është gjithashtu një temë sublime që i kushton disa poezi. Jeta është plot

kundërthënie e qe dashuria duhet ta mbisundojë, të dhurohet dhe të pranohet. Aty ku rrah pulsi i dashurisë asgjë nuk plasaritët as thyhet në jetë. Rolet ndahen nga rastësia por vuajtjet i përjetojnë ata qe nuk e kanë rolin kryesor. Dashuria i ka të gjitha të mirat, përkëdheljet, ëndrrat, jetën ,besimin, vetëm atëherë kur është reciproke, e barabartë: Përkulu / në do të me puthesh / s'jam aq e gjatë / sa ti / Zgjatu / në do të me duash / kacavjerrjen e urrej / në dashuri. Të poezia “Barasvlerë”. Me poezinë “Reflektime” Alma Papamihali e përmbyllë këtë përmbledhje poetike pothuaj se me apel qe të merren përgjegjësi për ta lëvizur jetën përpara, dhe të korrigjohen gabimet e së kaluarës sepse na ulërinë zemra nga çalimet,nga fantazmat e maskat. “Shqiptar i përgjumur në krevat i gozhdur / mos prit më nga bota, lëviz për të ndryshuar. Alma lufton determinizmin në jetë, në art dhe e ruan origjinalitetin e vet krijues nganjëherë edhe me fanatizëm feminist, edhe pse shihet se Alma edhe pse në mërgim përcjell me dashuri letërsinë shqiptare, por edhe atë gjermane. Njeri nder poetet tjerë të preferuar të Alma Papamihalit është edhe poeti gjerman Heinrich Heine në një libër të tij “Ausgeähltete Kostbarkeiten” kur flet për Artin dhe fjalën thotë”Ashtu siç ishte i pathyeshëm dhe i fortë Anteusi i madh kur qëndronte me këmbët e tij mbi sipërfaqen e nënës Tokë,dhe forcën e vet e humbi atëherë kur Herkulesi e peshoj lartë, ashtu është edhe poeti i fortë dhe i qëndrueshëm për aç sa nuk shkëputet nga baza e realitetit,dhe do të bëhet i pa vetëdijesuar derisa shpirtërisht qëndron në ajrin e kaltër”. Pra poezia është pasqyrë e jetës. E tërë poezia e Almës është e tillë,shpalosë momente reale e pa ngarkuar me simbolikë të tepruar dhe mbi rrafshin real edhe pse nga njëherë rrafsh i dhimbshëm. Poezia e saj me varg të rimuar për afërsisht tetërokëshe është e rrjedhshme me metaforë e alegori të sinkronizuar shumë mirë me semantik apo porosi të qartë dhe të e lexueshme mëton realizim të mirë të fjalës së shkruar poetike për çka i urojmë nga zemra suksese dhe t’i ketë lexuesit e saj,thekson studiuesi Pal Sokoli.

DURRSAKJA RREBELE ...

Keidi Sejdini është e lindur në Durrës me 13 korrik 1983. Shkollën fillore dhe të mesmen e kreu në vendlindje. Diplomoi në Departamentin Juridik (2011), si dhe në Akademinë e Arteve të bukura në Tiranë(2007). Punon si dizajnere në Studion Grafike në Durrës. Flet mirë gjuhën shqipe, italiane dhe anglishte.

Poezitë më të mira, të botuara në shtypin e kohës nga Keidi Sejdini janë: “Rrëshqasin burrat...”,(cikël me poezi), Ndryshe (“Drita ndryshe”, suplement), nr. 46, 28 shtator, 2008, f. 21, “Një orë artistike”, poezi Globus R.Tiranë,2006, “Në nderim të Gavril Priftulit”, profesorit tim të parë:miqtë humbën mikun, unë humba profesorin, Durrësi humbi nderin e tij, Shqipëria humbi artistin, Ndryshe, nr.305,16 maj ,2007,fq.20, “Simfoni e vaskës sime”(poezi), Ndryshe (“Drita Ndryshe”,supliment), nr.16,24.2.208.fq.10, “Kam frikë nga mungesa e jote e gjatë”(poezi) Ndryshe (“Drita ndryshe”, suplement), nr. 561, 16 mars, 2008, f. 19, “Sa sirtarë ëndrrash theva për dru”, (cikël me poezi) Ndryshe (“Drita ndryshe”, suplement). Nr. 29, 25 maj, 2008, f. 10, “Unë luaj shah me fatin”, (cikël me poezi) Obelisk, nr. 3(35), 24 janar, 2009, f. 4, 19, “Një orë artiste”, poezi, Globus R, 2006 Etj.Shumica e poezive të Keidi Seidinit modelohen dhe konceptohen në trajtë mozaikësh dhe tablosh emocionuese. Syri konfirmues që vete e vjen nëpër to, herë është i hapur e i kthjellët, e herë tjetër i veshur me një mjegull të lehtë e kapriçioze, si për të bërë më të vështirë konfigurimin. Por një gjë është konstante për të: rrezatimi i vërtetë që vjen prej tyre është ngazëllues. I ngjashëm me ngazëllimin e luleve të bardha të kumbulles, që fëshfërijnë në oborrin e shtëpisë së saj në pranverë. Shpesh fjala e saj, pothuaja në të gjitha llojet e poezive, kanë një bagazh letrar të dyfishtë, shpirti i Keidit nuk e parapëlqen burgun e ndjenjave, ndaj ajo u le atyre lirshmëri në të shpërthyer. Është atëherë kur një sy empirik, e koncepton si paradoks.

Bëj zhurmë, zhurma ime
E ngjirur në qiell fluturo
Bëj zhurmë, zhurma ime,
O vdis, o dashuro...

Kjo poezi e ndërtuar mbi një gjetje interesante dhe përdorimi efikas të paralelizmit lirik, edhe pse sendërtohet rreth një bërthame të trishtë, siç është vdekja, të

rikrijon një botë sa reale, aq dhe surealiste njëkohësisht... Duke luajtur poetikisht me fjalën dhe theksin tonik të saj, ajo arrin të rrokë kuptimet thelbësore të saj, duke pohuar mes mohimit.

Tek poezitë më të realizuara, autorja Keidi Sejdini, krahas spontalitetit të rrëfimit, ka ditur të krijojë dhe mënyrën, gjuhën vetëshpallëse të ndjenjave të saj. Ndaj nuk mund të kalojnë pa rënë në sy poezi të tilla si: “Jeta ime”, “Kohë pas kohe”, “Të dashurosh”, “Dhe qeshi”, “Një orë artiste”, “Çamërisë”, “Vetmisë” etj. Krijime të tilla që dalin nga një mendim vizionar e vështrim i tejskajshëm, janë si rrahje krahësh, në agim i një tufe zogjsh të dashuruar me qiellin dhe erën. Duke lënë peng emocionet dhe ndjenjat e saj, ky lloj narracioni poetik tenton t’i largohet foshnjërisë së saj të tejkaluar për t’iu afruar (duhet thënë që deri tani ende nuk e ka arritur) trupëzimit të kontinuitetit të dëshiruar. Sidoqoftë, autorja është ende në eksplorim të formës e stilit të saj poetik të së ardhmes. Rëndësi ka që udhët poetike ku ajo ecën, të thërrasin edhe ty t’i shkelësh këto poezi, efekti tingëllor me brendinë e mendimit, janë në një unison të dukshëm. Poezia e Keidi Sejdinit shkon edhe më thellë në hapësirat shpirtërore. Semantikisht dhe ndjenjësisht kjo poezi krijon një imazh të shpirtit në vija të gjëra, duke e ndërtuar atë me fjalë dhe gjuhë vetanake, dhe këtu është ajo që e dallon këtë poezi dhe këtë ndjenjësi nga të tjerat.

Poezi nga Keidi Sejdini:

NESËR

Tani dëgjoj këngën tënde të preferuar
dhe mbetëm pa frymë e kujtoj që sot nuk është dje!
Nesër... e sotmja ime do jetë e largët...!
e largët si pentagram i tingullit të orgazmës tënde
(nuk e kam shkruar akoma atë pjesë)
Në veshët e mi oshëtinë çdo ditë tingulli i frymarrjes
muzika dhe kafshimet tona dëgjohen në ikje
nesër...si në të sotmen dje...
S’do ta mbash mend sa u deshëm ne...!

KAM PRITUR

Kam pritur
Atë natë kur puthjen ma mohove
Kam pritur të t'mungoj
Kur udhëtove pa mua
të ndjesh mungesën e shtrëngimit të duarve!
Por ti s'ke numëruar shtegëtimin e zogjëve
brenda mungesës sime frymarrjen e fundit..
ndaj sonte... kam të gjitha arsyet të qaj!
Të gjitha arsyet të të dua përsëri..
Kam pritur të të mungoja
por jo që do më mungoje ti..!

TI ÇELE NJË DRITË...

Ti çele në zemrën time një dritë...
Aty ku kursej energjinë elektrike...
Dhe neuronet mbyllën sytë.
Të tjerët hynë e dalin në fikje..
Ti çele një dritë dhe më pe..
Të shtrirë si virgjëreshë në shtrat të dashurisë..
Po spate kohë të rrije atje
....mëngjeseve largohesh sërish..
Në zemër tashmë s'mbaj as llambë...
Me vetë more ti dritën për çudi..
...dhe ike si gjithë të tjerët
E unë më kurrë s'bie në dashuri..!

VALDETE BERISHA DHE POEZIA E NDJENJËS DHE VEGIMEVE EMOCIONALE

Poetja shqiptare nga Mitrovica, Valdete Berisha, vjen këto ditë para lexuesit me vëllimin e ri poetik “Gotë e thyer”. Një vëllim konceptual që zhbirron ndjenjat dhe vegimet emocionale të poetes në sensin e një prezantimi erotik të poezisë. Në tërë konceptualitetin e saj Valdete Berisha jep një rrugëtim pothuaja në çdo varg erotik. Pasqyron një histori të lidhur me dashurinë e saj që erdhi nga thellësia e brumit të gatuar në poezinë e hershme. Ajo vjen si një lidhje me preambulën e Erosit dhe duke diktuar një armëkrah-ide të teorisë së gatuar që nga ideja e kënaqësisë së “ledhatimeve nudo” tek elokuenca e “Gotës së thyer”. Vëllimi poetik është një gatesë vargore e një të tërë letrare dhe filozofike e sensit të dashurisë, të përqëndruar në trashëgiminë e vetë autorës. Poezitë e Valdete Berishës zbulojnë një ‘dashuri të sjellshme’ që është kyçur fort në memorijen e artë të autorës dhe që tashmë del ngadalë e ndriçon një eter të afshët. E karakterizuar nga sensi i etikës së sakrificës dhe shtyrjes, por edhe e ngacmuar nga “ekstaza e dashurisë” (poezia “Shpirti yt”, fq.13) që ishte “uragan” (poezia “Rreze dielli”, fq.14) kënaqësi, “Zemër e mbështjellur”, lumturi e papërfunduar (poezia “Ditët”, fq.23), poezia e Berishës vjen me këmbë të forta e tejet elegante. Poezitë “Shi i shpirtit”, “Buzëqeshja “, “Gotë e thyer”, “Freski”, “Koha ikën”, tregojnë se poetët janë shpesh të dukshëm në dijeni të gjuhëve të mbivendosjes etike të filozofisë dhe poezisë erotike. Këtë e gjejmë edhe tek Valdete Berisha. E gjejmë në poezi të tilla si “Egzod” (fq.49) ku autorja sjell e ristrukturon egzodin shqiptar “me plotë kalamajë” për të hyrë deri në detaje të flirta kënaqësie që zbulohen nga natyra e fizionomia e jetës dhe metafizikës: “burrat me armët zvarrë/ecin nën qiellin e rrënuar”, ku “para atyre njerëzve happen dyert e ardhmërisë “...Në këtë vargëzim ku konteksti i analizës psikoanalitike vjen disi argumentativ e ngacmues, si terminologji më vete vjen edhe një akt normativ i një rivlerësimi të ideve poetike dhe etikës psikoanalitike përmes teorisë dhe ideve të detajizuara mire në 43 poezitë e librit “Gotë e thyer”. Poetja Valdete Berisha na jep një model. Modeli vjen me produktin e saj nga rruga e largët (poezia “Dritare e hapur”, fq.28) që është sfidë e shtratit të zbrazët, që i përcillët asajë “si e vetmja shoqe” në shtratit ‘plotë lule’ (“Vetmisë”, fq.29). Ajo shpesh paraqitet si ngushëllim ngase shndërrohet në pikëpyetje të natës. Atëherë subjekti lirik në vend të vuajtjes e ngushëllon vetveten me ëndërrimin, që bëhet ilaç në hapësirën e madhe. Shndërrimi i

dashurisë në diçka të mbetur peng nuk e lë të qetë të dashëruarin. Ky peng sa vjen e trashet, por kurrë nuk shuhet, madje është e vështirë edhe të harrohet. Kur ajo grishet për t'i shijuar ëmbëlsitë e saj, apo për t'i cakërruar gotat në çaste vetmie, paraqitet një imazh tronditës. Ajo, tashmë veç ka mbetur “pas shpinës së botës”. Në këto çaste tronditëse vetmia është i vetmi ngushëllim. Vetëm me të mund të cakërron gotat. Vetëm ajo bëhet mike. Në këtë libër me poezi ka edhe elemente dhe aspekte të tjera të jetës dhe të ngjyrave të saj. Autorja i selekton me kujdes ato dhe i projekton si virtyte, por edhe si vese, për t'i shfaqur artistikisht në vargje. Ajo e arrin suksesin më të madh duke zbritur në embrionin e tyre. Sidoqoftë, opusi i figuracionit i veprës së parë poetike “Gotë e thyer” të Valdete Berishës, shpreh disa qasje paksa të veçanta në temën që trajton, pra, për dashurinë që ka mbetur peng i imazhit të një jete dhe një kohe (“Në krahët e hijes”, fq.47; “Intimitet vetmie”, fq.50; “Jetë me shumë t’ panjohura”, fq.55)... ISBN 978-9951-536-17-2

Biografia e shkurtër e Valdete Berishës

Valdete Berisha lindi më 2 nëntor të vitit 1968 në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe shkollën e mesme i mbaroi në vendlindje, pra në Mitrovicë. Por, si dhe shumë kosovarë të tjerë në moshën e re u detyrua të shkojë në mërgim. Që nga rinia e hershme merret me shkrimin e poezive. Përveç poezisë, Valdetja merret edhe me pikturë dhe ka arritur suksese të lakmueshme. Ajo deri tash ka marrë pjesë në disa ekspozita kolektive dhe individuale, në qytete të ndryshme, si në: La Loviere, Manage, Anderlues, etj. Ajo pret që ta hapë një ekspozitë të saj edhe në Kosovë, e sidomos në vendlindje, në Mitrovicë. Autorja jeton dhe vepron në Belgjikë, por është shumë e lidhur emocionalisht me Kosovën, të cilën e viziton shpesh.

Ka botuar veprën me poezi Mos e zgjo dhimbjen (2008) dhe Gotë e thyer (Rugova art, 2011)

Disa poezi nga Valdete Berisha:

STUHI DIMRI

U jipem ledhatimeve
Të egra
Që përshkojnë lëkurën time, nudo
Me shenja perverse

Ngris kokën të shoh
Mizerinë time
Në frymën tënde

Thahen lotët e hidhur
Më bartin në ofshamën
Tënde
Më zgjon nga dehja
Kalimtare

Ledhatimet rrokullisen
Në mesin e universit tim
Të hidhur

Jam e prangosur me ty
Vetëm stuhi dimri
Ledhaton ëndrrat e mia
Të çmendura...

ÇMENDURI

Të ka ndodhur
Ndonjëherë të jesh vetëm me vetminë

Të ndjesh jetën pa shije

Të pyesësh veten çfarë realizon
Në këtë jetë

Në atë moment nuk ekziston
Nuk kupton çfarë të frustron
Tmerrësisht

As njeri nuk përgjigjet
Dhe sytë e tu
Janë si ti...

YLLI I MESNATËS

Mesnata kaloi
Një yll u shua

Ndezi një dëshirë
U plotësua
Erdhe,sa shumë u gëzova
T'u afrova

Zemra m'u bë varr
Sa paske ndryshuar

Vija të paskan qëndisur ballin
Sy të vuajtur
Në atë buzëqeshje të largët...

ZGJIMI

Shikim uragani
Për një çast

Mjegullat ranë
Humba

Puthja jote më zgjoi
Një qetësi

Mbi të cilën
Mund të vendos
Fjalë e dhembje...

SYTË E TU

Sytë e tu
Asgjë nuk tregojnë
As butësi as ftohtësi

Dy margaritarë
Të ftohët të bashkuar
Si hekur dhe flori

Hija jote zgjohet
Jetëson ëndrrat e mia...

***Nga përmbledhja me poezi: “Gotë e thyer” (Rugova Art, 2011)**

NURIE ZEKAJ, NJË ZË POETIK QË U SHUA HERËT

Nurie Zekaj lindi më 11 mars 1967 në fshatin Raushiq afër Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Gjimnazin “11 Maji” (drejtimin e pedagogjisë) në Pejë. Ishte studente e vitit të tretë në Degën e Pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, derisa humbi jetën tragjikisht më 23 prill 1990. Nuria u inkadrua herët në Lëvizjen demokratike dhe ishte mjaftë aktive. Por më së shumti u shqua në Këshillin për pajtimin e gjaqeve (ishte njëra ndër nismëtares e këtij aksioni humanitar). Kjo e re u mor edhe me krijime letare, sidomos me poezi, të cilat i botoi kohë pas kohe në revistat “Zëri i rinisë”, “Kosovarja”, si dhe në gazetën e studentëve “Bota e Re”. Pas vdekjes iu botua libri me poezi “Vesë a lot” nga Shtëpa Botuese “Buzuku”, i cili u ribotua në 20 vjetorin e vdekjes nën përkujdesjen e mikes së vet më të ngushtë, Vera Kolëgjeraj.

Me këto poezi të marra nga libri i saj “Vesë a lot”, e rikujtojmë Nurie Zekajn edhe pas 21 vjetësh, natyrisht me shumë mall dhe dhimbje...

REFREN KËNGE

Ai këndon këngën e asaj nate pa yje
ulur në atë rrap
mua më bën refren në këngë
ai mori udhën e mërgimit
që të mos kthehet kurrë
mua në pritje më la

Ai nëse kthehet dikur
në shtratin e zemrës
a s’do të jam melodi e këputur
pyes heshtjen që më këput në shpirt

ZOG I PLAGOSUR

Mbi qepallën time
këngë e pakënduar
në këngën e pakënduar

zog i plagosur
në zogun e plagosur
fluturim i lënduar
mbi syri tim
qiell i përlotur

PA TITULL

Kur çdo gjë ishte jona
edhe shëtitja qeshja brengat
edhe emri sdudent
kur më bëhej se vetëm ne jemi
udhëheqeshim si donim
qeshja jonë qe ushqimi ynë
edhe lotët ishin tanët
po edhe ata kishin bukurinë e vet
mu si shiu pas diellit

ATËHERË

Atëherë kur vetës ia mbylla portën
ti shtrive duart nga unë
kur ngrita kokën nga qielli i mrrolur
vëreja jehonën e zërit tënd
atëherë kur numroja shkronjat e emrit tim
e vëraja se sot kam një më tepër
numëroj ,numëroj e zhdukem në numrin e fundit
të vetës sime.

LOT I PADERDHUR

Të ngrohtë të ruaj përherë
si mallin e zemrës
të kam ndryrë
si fjalën e pathënë
je vullkan im
që s' do të shpërthesh

ILIRIANA SULKUQI: “PYEJE PA PËRGJIGJE”

Iliriana Kadri Sulkuqi (Fejzullai) u lind lind në qytetin e Elbasanit në vitin 1951. Mbasi mbaroi gjimnazin “Dhaskal Todri”, në qytetin e lindjes (1969), vazhdoi studimet në Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore në Tiranë. Është diplomuar në vitin 1971. 1971-1995: Oficere , në Akademinë Ushtarake, gazetare në shtypin ushtarak dhe në Shtëpinë Botuese të Ushtrisë. Gjatë kësaj periudhe ka mbaruar studimet për gjuhë-letërsi dhe filozofi. Së fundi ka punuar si gazetare në gazetën “Drita”, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë... Nga viti 2004 deri sot jeton në SHBA, New York.

Krijimtaria

Botimet e para – rreth viteve ‘60. Është vlerësuar disa herë me çmime të para kombëtare dhe ndërkombëtare. Poezitë e saj janë përkthyer në disa gjuhë si : italisht, greqisht, maqedonisht, bullgarisht, arumanisht, anglisht. Renditet në disa antologji si brenda dhe jashtë vendit, si dhe në Enciklopedinë Shqiptare të Gazetarëve, në “Leksikoni i shkrimtarëve Shqiptarë 1501-2001, me autor Hasan Hasani(Shtëpia Botuese Faik Konica, Prishtinë, 2003). Është anëtare Nderi e Organizatës Shqiptare Amerikane: ”Motrat Qiriazit”,(15 janar 2006). Është anëtare e Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve.(5 janar 2006). Është Anëtare Nderi e Shoqatës së Ushtarakëve në rezervë-Dega Athinë (13.04.2008) Është anëtare e Klubit të Shkrimtarëve “Drita” dhe Kryeredaktore e Revistës Letrare Artistike “Pelegrin”.

Libra të botuar:

- “Më kërkojnë sytë e nënës”(1974)
- Ç’u fala stinëve që ikën?”(1988)
- “Të jesh grua”(1990)
- “Do të jetoj”(Rozafa-1996)
- “Trokit dhe zgjo”(“Egnatia”- 2000)
- “Kush ma vrau OFELINË” – italisht-shqip(Toena-2000)
- “Për një mollë që hëngri Eva...”(Prishtinë- gusht 2002)

- “(F) Shihemi në sy”(janar –shkurt 2002)
- “Pulëbardhë në det’ të zi”(“Ilar”-maj 2002)
- “Lirika” (Medaur-2003)
- “Hajku”- bashkëautorë(“Egnatia”-2004)
- “...Më kërkon falje” (Arbëria-2004)
- “ Poezi” (dy libra në Një) (botimet “Snaj”-2007)

-Çmimet:

- Çmimi i tretë për vëllimin poetik ”Ç’u fala stinëve që ikën”, (1988), në konkursin me rastin e 45 vjetorit të Krijimit të Ushtrisë Popullore, organizuar nga Ministria e mbrojtjes dhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë
- Çmimi i parë (në poezi), në konkursin e shpallur me rastin e 45 vjetorit të revistës “Shqiptarja e Re”.(15.8.1988)
- Çmimi i tretë për vëllimin poetik dygjuhësh shqip-italisht “ Ma vranë Ofelinë!.... Oiii...Oiii....! “, dhënë nga Ministria e Arsimit, Kulturës dhe e Sporteve, si dhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe e artistëve të Shqipërisë, në Ditët e Poezisë Shqipe ”Lulet e Verës”, maj 2001
- Çmimi i parë- për poezinë më të bukur për Dashurinë, në Ditët poetike ballkanike 2.06. 2002- Korçë.
- Çmim të veçantë në takimin ballkanik “Ditët e Asdrenit”-Shkup(2005)
- Çmimi i parë - për poezinë më të mirë në takimin poetik”Pëllumbat e Bashtovës”, akorduar nga Dega e Lidhjes së shkrimtarëve, Durrës, 4 tetor 2005.
- Çmimi “Migjeni” (2007) revista “Kuvendi”- Miçigan-SHBA
- Çmimi “Ali Asllani”-liriku më i mirë i vitit (maj 2008), akorduar nga Ambasada Shqiptare në Athinë dhe Klubi i Shkrimtarëve Shqiptarë të kudondodhur në botë “Drita”, për vëllimin poetik “Poezi”.

PA PYEJTE – PA PËRGJIGJE

Po plas!...

Po plas, po plas,
përse nuk shpika
rrota gjigande sa Dashuria...
Si një bujkrobe do e tërhiqja
gjithë Amerikën tek Vendlindja...

Po plas, plas që askund s'jam-
as ku kam lindur,
as ku do vdes...
Që s'bëra dot një varg të malltë
dhe pse me rrokjen fjeta jashtë.

Po plas, po plas,
kujt t'i rrëfhem
që m'troket ikja n' rrëz' të veshit,
as bardh, as zi s'më mbeti vargu,
një oqean m'ndau nga Deti...

Po plas...po plas...
Që dhe një dorë-
shtatë breza nerv,
shtatë malle varg,
një firmë s'e hedh as për shkronjë,
një firmë s'e hedh as për një varr...

Po plas...Po plas
si në legjendë:
« ...Plasnë si poçe me verë... »
...ndaj syhapur...
malli qenka dhe i bukur..
edhe pse të than si eshkë...
Jeta vetë na qenka –mall
Ndaj syhapur çdokush vdes.

4 korrik, 2008 Brooklyn

I THASHË LOTIT...

Një ditë pa dritë, një natë pa hënë,
Lotin intim ma shanë e vranë...
I pata thënë lotit tim-
përballë botës mos i dil...

Është kohë e keqe, një Zot e di,
do të të thajnë pa dalë mirë...
Nuk më dëgjoi, nuk më dëgjoi...
Si djal' plangprishës
pa mua shkoi...
Një ditë , ah, ditë, pa mbushur ditën,
kthehet sërish lodhur e tretur...
Lutet e lutet mardhur e ngrirë
përmbi qerpik nga pritja djegur...
I kisha thënë, i pata thanë:-
S'i duhet botës një lot që qan...

MË THIRRE?...

...ja, erdha.
Sa të kaloj mbi njëmijë vjeshtëzat e mia,
Sapo t'ua mbledh gjethet e zverdhura,
Sapo t'ua shtroj tryezën "Hapy Birthday"
Në larg-ikjen time...
Erdha!

MË GJENI NJË TITULL...

Më gjeni një titull...
pa fjalën zjarr
pa fjalën akull,
pa fjalën vdekje,
pa uri pa çtje...
pa zë të mekur...
pa pikën e lotit,
pa emrin e Zotit,
pa emrin tim
pa emrin tuaj...
pa ngjyra muzgu
pa plor prej hëne
pa diell të djegur

pa mllef, pa hakmarrje,
pa fjalë përralle
pa ëndrra prej nate
pa dallgë e stuhi
pa puthje prej vlage
pa valëza, pa breg
pa mbërritje, pa shteg...
Më gjeni një titull
pa emër shpendi
pa emër ylli
pa emër mali
pa emër ishulli
as oqeani...
pa rrahja zemre,
pa ankthe malli...
pa vjeshtë të artë
pa dimër, pa ngricë
pa stinë të pjalmte
pa verë t' lakuriqtë...
Më gjeni një titull
pa pentagram,
ku notat lozin
me shpirtrat tanë!

Shtator, 2007

MËSHTEKNA

Buzët
më humbën mes buzëve...
gishtërinjtë
mbi tastierat e brinjëve...
trupi
si një grusht i mbledhur...
Mështekën,
më thuaj, moj
si e ruan kaq vjet virgjërinë?

TË VIJ SONTE, APO?...

Të vij sonte,
apo nesër,
a pasnesër, duke gdhirë...
a me Hënë, në të mehur,
a me Diell n'perëndim?...

Të vij sonte,
në të ngrysur,
me qirinj në Galaktikë,
a me Yllin e Mëngjesit
që i bëhem Zgjim me zgjim?

Të vij sonte
apo sonte,
dhe me Hënë, dhe me Diell,
dhe me yjet në një shportë
dhe me zemrën sa një qiell?...

Të vij nesër
a nxitimthi,
me një shkronjë që më flet shqip,
dhe me Zotin që më lindi
dhe me zë - prelud- në shpirt?...

Të vij sonte
apo nesër,
a me ëndrrat që s'u prekën,
a me fjalët që s'u folën,
a pas - kurrë, në këtë shekull?

Të vij sonte,
apo sonte?
a, pas vetes së përdjegur?...

MOS MA FSHIJ LOTIN!

Mos m'i shih këmbët
kanë veshur këpucë të arnuara,
si jeta ime,
si një dashuri e harruar...

Mos ma fshij lotin,
lëre të rrjedhë
në lumin e rrudhur,
ku lahet një hënë
e joshur nga yjet...

Mos ma zgjo ëndrrën,
Dua të më dhembë!...

LETRA E FUNDIT PËR ANA AHMATOVËN

E dashur Anna,
nuk e di, nëse të kanë ardhur letrat e mia,
ku me pak vargje të shkruaja
për botën e ëndrrës ...
Nuk kam asnjë lajm prej teje
edhe pse më premtove
që do të më shkruaje
nga jeta e përtejme...

Mesa duket je e kënaqur
në atë botë, ku marrin fund vuajtjet
dhe shuhen dashuritë...
Më thuaj motër,
të vijnë më lot tek sytë?!

Posted by AGJENCIONI FLORIPRESS, shtator, 2011

PROMETHEU SHQIPTAR-ADEM JASHARI DHE SHTRATI I POEMËS NACIONALE

Naim Kelmendi,” “Shqiptari vdes duke kënduar”,poezi,botoi Shtwpia Botuese “Rugova Art”,Prishtinë 2010, faqe 74.

Heroi biblik, e zotëroi nga fillimi e deri në fundin e vet, Betejën e pasmbrapsur të heroizmit -shqip. Në çastin kur bishat e çmendura arritën ta vrasin më të mirin(o zot sa keq ata u sollën me koka të prera, njerëz të vrarë, pleq e plaka, nëna të therura me shtatëzani!)diçka e thellë, e tillë u shkrep në truallin dhe shpirtin që kërkonte vetëm gjak arbëror.

Fillimisht në këtë truall lindi poeti ynë,i cili, ka gjëra të përbashkëta me vargjet fishtjane, mbase të ndërtuara në mënyrën më pikante te poema “Shqiptari vdes duke kënduar”...

Por, poeti i ditëve tona, është poet modern, i fuqishëm, që e bëri të flasë shqip – heroizmin e babë Shabanit, bacë Ademit, Hamzës, Agim Ramadanit etj.

Homerit shumë i pëlqente zotërimi.Deri në momentin kur dueli hyjnor-ishte i pa-kryer, poeti i verbër e kishte dashtë shumë Akilin e kishte vlerësuar atë si një zotërues, krejt ashtu siç e synonte dhe ai vetë botën...

Bota i pranon dy a më shumë zotërues. Ne nuk e dijmë se si e ka ”parë” Homeri duelin Hektor-Akil, ashtu i verbër, ashtu me errësirën e padepërtueshme dhe të përjetshme nëpër sy, ashtu i pamundur, por e ka ndjerë e ka dëgjuar nga shembja e”thelbit” të tij.

Akili ka qenë një rast-hata, një kohë hata, një njeri – hata, një vrasës dhe një fitues – hata.

Ka qenë momenti që poeti ka kuptuar se ai, Akili, nuk është zotëruesi, por sunduesi,e vetmja gjë e përjetshme që nuk ju ka pëlqyer poetëve.

Zotëruesi i baladës është nga Ruhoti i Pejës, është shqiptar, ka të botuara 17 vepra letrare. Ai është si zogu që ka hyrë edhe vetë në balada lufte, sepse edhe ky ishte njeri i Baladave. Ai u ngrit me vargun e tij për t’i denuar ata - mizorët, që u sullen pabesisht - pas shpine, me elaborate, histori të tmerrshme, për t’i zhbërë me rrënjë nga faqja e dheut-Njerëzit Legjenda -Adem Jasharin ,...Drenicën, Deçanin, Rugovën, Logjen e Llapin,...Isa Boletinin, Agim Ramadanin, që “pikturën dhe poezinë dardane e la ta shkruajë në kohë paqje...”, që kurrë për së gjalli s’e arrijti....

Poeti shqiptar ka emër dhe mbiemër, ai është Naim Kelmendi, që këto ditë,

ribotoi në Shtëpinë Botuese “Rugova Art” poemën –Legjendë, me titull “Shqiptari vdes duke kënduar”...Dhembja e çdo vargu, e shkruar nga poeti ynë, pulson në çdo strukturë të brendshme, që shtrihet gjatë leximit në thelbin racional, ndërsa dhembjet ai i vë në shtratin e poemës nacionale ...Pozicioni i çdo fjale,shenje,është i paracaktuar.

Poema për Adem Jasharin, e ka strukturën fishtjane.

Ajo është fabulë, prandaj e ka strukturën e poemës në gur. Duke e lexuar baladën kushtuar Adem Jasharit, me titull”Shqiptari vdes duke kënduar”, e cila është botuar para 11 vjetëve, në numrat e gazetës” Bota sot”(15 mars 1999 dhe 31 mars 1999), që më vonë është botuar si libër poetik(viti 2000) dhe ribotuar sivjet me disa plotësime, me kapitujt II dhe III: “Poezi nga lufta”(5 poezi), të shkruara në frontin e Kosharës, pra gjatë luftës, me vjershat : Shqiptarët në luftë, Histori e gjallë, Vargje në mes plumbash, Fundi, Ora e fundit; kapitulli i tretë me titull “Kapërcimi i ujërave të turbullta”(13 poezi të shkruara gjatë luftës: Shqiptarët, Hyrje në atdheun e djegur, Zabullimë, Shkëlqim i zi, Misteri, Rendi i shurdhmemecëve, Fjalë e drejtë, Pëshjtjellim, Tregim i moçëm, A pritët vdekja në shtrat, Krimet, Kapërcimi i ujërave të turbullta, Mundja e përbindshave, janë eksponent i shkëlqyer në ndihmë të argumentit për ndryshimin semantik të kësaj tradite të të menduarit. Dihet se, shkrimtarët dhe të gjithë krijuesit e artit të vërtetë janë subjekte të faktorëve të ndryshëm jetësor.Lexuesi pasi ta ketë lexuar librin”Shqiptari vdes duke kënduar”, gjithsesi do të bindet se, Naim Kelmendi është poet modern.

Lexuesi i mirëfilltë kur i lexon 47 baladat e Naim Kelmendit, do ta ndjejë veten si në një shfaqje filmike, ku personazhet, si Adem Jashari, Hamza Jashari, Shaban Jashari, Isa Boletini, Oso Kuka, Agim Ramadani, Kosharja legjendare, lëvizin si në ekranin e filmit duke na dhënë një art skenik në heshtje, apo një vallëzim të zjarrtë, që herë-herë është i akullt, me përplotë akrobacione të kryera skenike të një kalibri protonizmian, rrymë kjo e krijuar nga shkrimtari ynë i mirënjohur Shefqet Dibrani.

Sekreti dhe talenti estetik i homerianit tonë shqiptar i përket një fuqie tjetër: asaj të njohurive të shkëlqyera të kodeve të shkruara dhe të pashkruara të gjinisë së poemave të gjata, asaj të përvetësimit të plotë të gjitha elementeve të poezisë (e veçanta është se askund nuk përdorën shenjat e pikësimit), asaj të zotësisë së tij profesionale për t’i kthyer këto njohuri në instrumente diplomatike, që ndihmojnë drejtëpërsëdrejti në kryerjen sa më të përsosur të plotësimit të ”shkyer” të hartës arbërore nga Evropa plakë.

Le të përqendrohemi në disa prej këtyre elementeve, si dhe në mënyrën se si efektet e tyre kanë ndikuar kaq pozitivisht në poemën, që i gjejmë në librin e posabotuar

”Shqiptari vdes duke kënduar”....

Që në rreshtin e parë të poemës (prej 30 baladave) kushtuar Adem Jasharit, legjendës së trimërisë shqiptare, është një rrëfim fishtjan, i gjallë, i shfaqur me një sugjestivitet, i cili të tërheq më shumë kënaqësi drejt fundit. Vini re fjalitë e para:

Gjaku është e vetmja metaforë e kuqe
Vdekjes i jep kuptim përjetësisë rrënjë
Mbi imazhin e sakatosur të Dhe Atdheut

Si dhe vargjet :

“aty ku dhemb Kosova a nuk derdhet gjaku
aty ky vritet Kosova a s’është gjasë e vjetër”

(balada 1, faqe 11)

Ose:

.....

përmyllet njëra krizë hapen të tjerat
ngërdheshën dhëmbët hapen varret
bëhet varr pa varri deri në çmenduri
u humbin edhe emrat pa ditur ku i kanë
as eshtrat as letërnjoftimet as pa ditur
përse kanë lindur aq të pafat e pse vdesin
pa asnjë mbrojtje në duar gjakëpirësish
ndërsa atje në kancelaritë hijerënda
mbahet prapë mbledhje dhe shkojnë
e flasin të mëdhenjtë pështyma u thahet
fjalët bëjnë spektakël fjalët keq tradhtojnë
të vërtetën e shenjtë fjalët bëhen kafshë
të egra dehjes me shampanjë me shikime
të dhëlpërta me orekse të egra ujçërie.

(balada 5, faqe 11).

Pra, poeti Kelmendi e zotëron lirshmërinë narrative, paraqitjen dinamike. Duke fokusuar aspektin psikologjik të ndodhisë apo gjendjes, ai përqendrohet pikërisht në rrëfimin e këtij aspekti. Kjo i ka dhënë atij mundësinë të mos bjerë në komente apo analiza psikologjike, por që gjendjen psikologjike e manifeston brenda tekstit apo nënteksit në strukturën tekstore:

....

pahetueshëm a s'po e sheh gjakun tim
të shprishur gjeografisë popullore copat
e ndara në duar të ndyra në gojë myku
përgjaket njeri cep shpopullohet tjetri
masakrojnë të parin e copëzojnë të dytin
andej u vrasin zogjve këngën e parë

....

(balada 6, faqe 16).

Ose:

...

fjala e pathyer në emër të Atit e të Birit
e në emër të shpirtit vetëvdekja e trimit
në shtat e shtatqind vafshin se Unë njëherë
kam vendosur të bëj timen për dhe Kosove
ah, këtij dheu i pëlciti mjaft zemra,...

(balada 7, faqe 17).

Tek analizojmë poezitë i identifikojmë argumentet, gjendjet dhe, falë pastërtisë së jashtëzakonshme të baladave të Naim Kelmendit, nuk e kemi të vështirë t'i kuptojmë shtresat e niveleve filozofike dhe psikologjike, që gjenden pothuaja në çdo varg të këtyre baladave-Legjendë!

Në secilin varg të librit " Shqiptari vdes duke kënduar", gjejmë domethënie të dyta e nganjëherë të treta për t'i analizuar në detaje. Është interesante se, çdo varg është i regjistruar si me kamerë, me imtësi funksionale, sikur veprime e gjeste të aktorëve, trillët e zogjve, instiktet e kanibalëve sadistë, që... "skanë gjak njeriu, janë krijesa shpirt djalli, vijnë nga terri monstruoz i historisë makabre, të mësuar brez pas brezi të pinë gjak shqiptari"(balada 24, faqe 34).

Naim Kelmendi e di mirë se me çfarë cilësish duhet t'i veshë protagonistët dhe në ç'fushëbetëjë duhet t' i vendosë ato figura.

Ai është shumë i kujdesshëm se kush janë, ç'qëllime kanë dhe ku e kur humbin apo fitojnë. Personazhet e Naim Kelmendit janë të besueshëm sepse vetë ai si autor është i besueshëm. Ai u lejon atyre gjuhën që ata zakonisht përdorin, vetitë dhe vesët që kanë.

Naim Kelmendi është dhe do të jetë i suksesshëm në poezinë moderne shqipe, sepse, nga njëra anë, ai e njeh mirë njeriun, vuajtjen dhe psikologjinë e tij, shoqërinë së cilës ai i përket, si dhe jetën në përgjithësi.

Nga ana tjetër, ai ka triumfuar në artin e krijimtarisë edhe më dy vepra tjera “Në një jetë pas Krishtit”(Rugova art,2010) dhe “Esenca”(Rugova art,2010).

Naimi zotëron mirë të gjitha sekretet e zanatit të tij si një poet i madh bashkëkohor.

SHKRIMTARI IDEALIST SHQIPTAR GJATË SHEKULLIT XX

Në cilën anë është shkrimtari? Anën e kujt e mban ai?

Problemi është i moçëm,ç’prej se mbahet mend krijuesi i parë në punë të artit. E pra,dikur e tani,shkrimtari ishte në anën e atdheut,lirisë,demokracisë,përparimit etj etj. Do të thoshim,në anën e Njeriut e të Humanizmit. E në radhë të parë,ai qëndron në krahun e artit. Tek e fundit,krijimtaria artistike,përbën esencën afirmative të të gjitha gjërave. Kurse në anën tjetër të barrikadës do të qëndronin ideologjitë e ndryshme agresive,totalitarizmi,dogmatizmi,absolutizmat e ndryshëm politiko-sistemorë,etj etj.

I. Abeli në anën e Shkrimtarit,Kaini në anën e Politikës

Vetëm krijuesit e mëdhenj,këta ëndërrimtarë të pandreqshëm,si thotë një poet,kanë arritur t’i realizojnë e t’i ndërtojnë sintezat e suksesshme në mes letërsisë dhe politikës;në mes shoqërisë dhe artit,në mes kombit dhe krijimtarisë artistike,në mes të vizioneve për humanizmin e demokracinë dhe të esencave estetike. Nëse problemet e çështjet njerëzore shenjohen nëpërmes Sfinksit antik,që shtron enigma për zgjidhje,zbërthyesi i tyre shenjohet nëpërmes Edipit,kurse privilegji i krijuesit iu jepej perëndive e pajtove të arteve,muzave,që ua sjellin frymëzimin;nëse nocioni zanafillor biblik mbi kreacionin mbështetet në Hyjin si semper creator;epoka moderne që zë fill me Humanizmin e Renesancën,këtë privilegj e zbret tek njeriu;por jo krejtësisht tek Njeriu i Rëndomtë,po tek Të Zgjedhurit,tek Heroi,Mbreti,Gjeniu,Artisti. E pra,përsëri Njeriu e njerëzimi e ngjizin dimensionin e të fshehtës a të së mistershmes në natyrën njerëzore krijuese a në vetë aktin e krijimit. I zgjedhuri i tillë,i shenjuari i tillë,ka diçka që e dallon nga të tjerët të jetë Hero,Gjeni,Krijues,Mbret etj. Shekspiri tek “Mbreti Riçardi i Dytë,ndër të tjera,e vë këtë replikë dramatiste:“Si ju jam,prandaj a jam mbret?” Gjeniu,Krijuesi e Heroi përkujtohen përjetshëm,kurse Mbreti ra. Megjithatë,që nga Ezopi e këndeje,krijuesi letrar është konsideruar si kryengritës i përhershëm,si opozitar i lindur karshi shoqërisë. Nga ana tjetër,janë qindra krijues shqiptarë që i provuan mbi kurrizin e tyre për ndjekjet,burgosjet,privimet,libërdjegiet,pushkatimet,vrasjet,eksodet,anatemimet e çka jo tjetër,vetëm për shkak të qëndrimit të tyre në anën e atdheut,identitetit

të rrezikuar shqiptar, humanizmit, demokracisë, ideve largpamëse e vizioneve emancipuese, ashtu sikundër iu ka ndodhur dhjetra humanistëve arbërorë, si Marin Barletit, Marin Beçikemit, Mikel Marulit, Leonik Tomeut, Martin Segonit, apo autorëve të Letërsisë së Vjetër Shqipe, si Buzukut, Dhimiter Frangut, Pjetër Bogdanit, Pjetër Budit, Lekë Matrangës, Pal Engjëllit e engjëllorëve të tjerë, Lukë Bogdanit etj etj, të cilët i përndoqi okupatori turk, i detyroi ta braktisin atdheun apo edhe të vriten nga po ky okupator, më mizori që ka njohur historia e këtij populli në këto anë. Okupatori turk i gjeti arbërorët me universitete e shkolla të larta të frymës humaniste evropiane. Tash vetëm mund ta imagjinojmë se ku do t'ishim sot me një traditë 600-vjeçare universitare, të cilën e ndërpreu sundimi turk që nuk kishte se çka t'iu sillte arbërorëve, pos errësirës e oskurantizmit. Kështu iu ka ndodhur edhe qindra krijuesve të tjerë shqiptarë që nga vitet njëzet e këndej të shekullit që e lamë pas, të cilët nuk i kanë mbyllur sytë para realiteteve të reja, prandaj e kanë pësuar atë fat, qoftë nga diktatura e Zogut, qoftë nga ajo e regjimit totalitar komunist për pesë dekada rresht. E mandej na vijnë librat e burgut në letërsinë shqipe, tek na shkon mendja te diktaturat e përgjakshme, si në Shqipëri, si në Kosovë: nga njëra anë gjenden të dënuarit, të mallkuarit, të ndarët nga familja e shoqëria, të poshtëruarit, na shkojnë ndër mend skenat e pushkatimit, prangat, qelitë, të torturuarit, autoburgu, njerëz që s'arritën të dalin nga burgjet, mbasi vdiqën në të të sëmure, apo që vdiqën nga torturataplumbi. Nga anatjetërtë dalin parakujtesësprokurorë, mendjezezë, njerëz-bisha, skuadrat e pushkatimit, policë, hetues, gjykatës e gjyqe, spiunë, diktatorë. Makina e përbindshme shtetërore e krimit. Uria, etja, mundimet e vuajtjet pafund. Në emër të popullit: gjyqe e çka jo. Prej këtij universi të ferrit real, aspak fantastik, lindi edhe një letërsi e veçantë, një letërsi tjetër, sikundër thuhet. Po përmendim pak fakte: Etëhem Haxhiademi, shkrimtar i shquar tragjedish, i shkolluar në universitete evropiane, kthehet në Atdhe për t'u angazhuar për ndërtimin e idealeve evropiane demokratike, por është burgosur nga regjimi zogist, më vonë është përndjekur nga eksponentët e pushtuesit fashist, dhe, së fundi, për njëzetepesë vjet rr esht, ka vuajtur burgje komuniste, duke i lënë edhe eshtrat në burgje. Ai sikur e parandjeu se Letërsia e Politika, në këso kushtesh kundërdemokratike, janë sinonim i luftës së Kainit kundër Abelit. Kaini u hodh në anën e Politikës, Abeli në anën e Shkrimtarit. Ose rasti i Mati Prennushit që i fliste dhe shkruante në gjashtë gjuhë. Po ky Mati Prennushi që iu kishte priçetave të armatosura kundër Turqisë, ai që ishte profesor gjimnazi; ai që më 24 mars 1911 bashkë me Atë Buon Gjeçajn shpalosën nga gjoksi i tyre flamurin në Deçiq; ai do të dënohet me varje në litar nga malazezët, por shpëton; porse më 1924 dënohet me pushkatim edhe nga Zogu (kur u ekzekutua nga perkrahesit

zogist Don Gjon Gazulli), pse ishin në anën e opozitës noliane, por me ndërhyrjen e qarqeve ndërkombëtare i shpëton ekzekutimit. Po ky Atë Mati që do të konsiderohet nga autoritetet fashiste italiane si “franceskan me ndjenja të theksueme nacionaliste dhe antifashiste italiane”; nuk do të mundë t’i shpëtonte edhe një ekzekutimi tjetër, të egër e mizor, nga regjimi i diktaturës komuniste, atij të vitit 1948 “për veprimtari antikombëtare”!!! Noli dëbohet nga Atdheu, Luigj Gurakuqi vritet. Kurse menjëherë mbas Luftës së Dytë Botërore, nga letërsia shqipe po largoheshin shkrimtarët e pjesës së parë të shekullit XX, si Lazër Shantoja, Ndre Zadeja, Bernardin Palaj, Anton Harapi e Gjon Shllaku, të cilët ekzekutohen barbarisht; ndërsa kjo lagje shkrimtarësh, po vdiste në burg nga torturat si Vinçenc Prennushi, ose si i ndodhi Ndoc Nikajt, romancierit të parë shqiptar, apo “Balzakut shqiptar”; ekzekutohen arbëreshi Terenc Toçi, bektashiu Ali Tomorri, botuesi Nebil Çika; përndiqen e burgosen Ibrahim Dalliu, Mirash Ivanaj, Arshi Pipa, Sejfulla Malëshova, Petro Marko, Mitrush Kuteli, Andrea Varfi, Nexhat Hakiu, Mustafa Greblleshi, Lazër Radi... Lista do të shkonte e shkonte shumë gjatë. Mirëpo, fizionomi letërsisë shqipe do t’i japin edhe autorë tjetër të përndjekur e të burgosur, si Kasëm Trebeshina, Pjetër Arbnori, Daut Gumeni, Havzi Nela, Visar Zhiti, Bilal Xhaferri, Maks Velo, Zyhdi Morava, Genc Leka, Trifon Xhaxhika... Kurse në Kosovën e martirizuar, për aq e aq dekada rresht, po ndodhnin tri burgosjet politike të shkrimtarit Adem Demaçi. Ai i vuajti 28 vite nëpër kazamatet e ish Jugosllavisë. Kurse sot, për të qenë ironia e thellë e kohës, gjenden ende krijues të ish regjimit serbokomunist, tashmë të hedhur nëpër taborre të reja politike e të një mendësie politike të trashëguar, që duan ende ta fyejnë e ta denigrojnë nën maskat e “rendit demokratik”! Dhe kanë fytyrë të quhen shkrimtarë! E dihet se çfarë mesazhesh humaniste e atdhetare, liridashëse e demokratike, estetike e etike, përçon vepra e Demaçit. Mandej, na vijnë emrat tjerë të shembujve të mëdhenj të rezistencës kundër të gjithë absolutizmave: Fazli Greiçevci i vdekur nën torurat në burgjet serbe, në mërgim vritet krijuesi atdhetar, Jusuf Gërvalla, burgje vuanin Xajë Nura, Kosovë Rexha –Bala, Teki Dërvishi, Beqir Musliu, Kadrush Radogoshi, Adem Gashi. . . , janë dhjetra emra të tjerë të shkrimtarëve të Kosovës. . . e deri te emrat e krijuesve Latif Berisha, Ymer Elshani, Selman Konjuha, Gaspër Karaçi etj, të pushkatuar në luftën e fundit çlirimtare nga soldateska serbe. E pra, nga ana tjetër, jo rrallë po ky shkrimtar shqiptar, si kudo në botë, ka qenë edhe bashkëpunëtor i Ministrisë së Milicisë shqiptare a sllave, eksponent i regjimit, ekzekutor i Res Publica-s, kalemxhi shpirtshitur, që ka luajtur rolin e censorit ideologjik të vrasjes së vlerave, të përndjekjes së fjalës së lirë e të përndjekjes ogurzezë ndaj vetë kolegut të tij krijues. Do të duheshin qindra e mijëra volume për ta paraqitur të vërtetën

e dhimbshme jetësore të Shkrimtarit Shqiptar. Shkrimtari shqiptar ka qenë i ndërgjegjësuar se njeriu i kënaqur me gjendjen e lirisë, thënë pak butë, është konformist. Poeti shkodran, Anton Çefa në librin e tij poetik „Dritarja e një britme“ shkruan: „Për shokët e mi brezin e poetëve jokonformistë, që u rritën e u plakën pa e gëzue lirinë e fjalës dhe pa e shijue fjalën e botueme, poezia asht një bisedë e gjatë me vetveten për ruejtjen e dinjitetit e njëkëhësisht shkrim ndaj diktaturës“.

Diku nëndheshëm, në Republikën e Shpirtit, në Republikën e Imagjinatës, në Republikën e të Idealeve krijuese e njerëzore, është latuar Kujtesa Alternative, Kujtesa e Viktimave dhe e të Martirizuarve përballë represionit pushtues gjenocidor a totalitarist, përballë Kujtesës së Fitimtarit të Armës, që synonte shlyerjen a zhdukjen e Kujtesës së Parë; që pikësynonte, më në fund, imponimin e vetëm Një të Vërtete, kurse të tjerat të Vërteta duhet të heshteshin. Shkrimtarët e përndjekur, krahas dëshmorëve të tjerë të Atdhuet, kanë qenë Roja e Mburoja e kësaj Kujtese, e themelimit të këtij Identiteti nëpër shekuj, përballë inkvizicionit e shfarosjeve armike osmane, sllave apo komuniste. E vërteta ka qëndruar në anën e krijuesve të përndjekur: janë djegur, zhdukur e anatemuar mijëra libra e dorëshkrime, por të gjitha ato janë rehabilituar, sistemet e dhunës janë shembur, kurse dënimin e historisë e kanë marrë inkvizitorët. Triumfi i Lirisë, Demokracisë dhe Humanizmit i dhanë të drejtë shkrimtarit, sepse çdo fjalë, varg a vepër ai ia dedikonte këtyre idealeve. E shkrimtari shqiptar nuk kishte se si të mos ishte i tillë, atdhetar e liridashës. Te e fundit, a ka shkrimtar shqiptar që nuk ka shkruar për Atdheun dhe për Lirinë?

II. Shkrimtarët: dyshues e opozitarë të përjetshëm

Nëse krijimi është akt individual, vepra letrare, me të arritur në librari, në bibliotekë, në institucione kulture a në duart e lexuesit, bëhet edhe res publica, apo një e mirë e përbashkët. Autorët e moçëm të Antikës thoshin se Shteti apo Res Publica na është çështje publike dhe shtonin: “Videant consules, ne quid detrimenti res publica capiat! (Konsujt le të kujdesen që shteti të mos pësojë asnjë dëm).” Res Publica-n ata e mendonin si qeverisje të interesave të përgjithshme apo të të mirave të përbashkëta. Pra, politika është ajo që merret me çështje publike, kurse letërsia, si nevojë e brendshme shpirtërore e njeriut, nuk kufizohet në kohë e në hapësirë. Shoqëria si sinonim i politikës dhe qytetarit, vetë do të vendosin se si ta qeverisin veten, vetë do të kujdesen për çështjet a punët e veta, do ta bëjnë kushtetutën, o t’i zgjedhin qeverinë dhe deputetët, do të mbështeten, si deklarojnë ata, në vullnetin e popullit. Të zgjedhurve do t’iu

besohet pushteti për një kohë të caktuar. Nuk ishte e rastit, pse Platoni pati kërkuar që harmonia do të arrihej, kur shtetin e pushtetin e drejtojnë filozofët si përfaqësues të urtisë e të mendjes, kurse i përjashtonte poetët. Res Publica antike e përfaqësuesve të popullit, tek koncepti i Rusosë shndërrohet në patriae, në atdhesi, në vlera të atdheut. Kurse shkrimtarët humanistë i afirmuan gjakueshëm idealet e tyre të epokës moderne: republikën dhe demokracinë, përkushtimin atdhetar, humanizmin dhe kultin e njeriut, liritë dhe të drejtat njerëzore. Ideja e lirisë është themel i identitetit evropian dhe e lindur po nga ky identitet. Porse njerëzit e lashtë të Antikës nuk e kishin parashikuar se të mirat e përbashkëta apo res publica, do të shndërrohen në interesa të veçanta, e, posaqërisht, në konflikte interesash. Prandaj, padëgjueshmëria qytetare, e lindur po nga ky opozicion i përhershëm i fushës së letërsisë, tani në kuadër të rendit demokratik, vendoset në anën e kundërt të këtij rendi. Dhe kushtetutat moderne e njohin të drejtën qytetare të padëgjueshmërisë e të mosbashkëpunimit, së këndejmi, si e drejtë, edhe e garantuar, e drejtë edhe e realizuar, sidomos në ato raste kur pushtetarët e shndërrojnë shtetin apo pushtetin në Res Privata. Dhe jo pak qeveritarë e drejtues shtetesh e pushtetesh, vendin e tyre e kanë dërguar në theqafje, në luftëra, në shkatërrim, në sundim diktaturash të përgjakshme etj etj, kur kjo harmoni në mes urtisë e qeverisjes nuk përputhej. Mendimtarë modernë, si Rols (Raëls), Hondrih, Erikson, Berri etj pohojnë se padëgjueshmëria qytetare është akt i hapët e i ndërgjegjshëm politik, i padhunshëm, i një grupi a pakice që qëndron kundër ligjeve a sistemit në fuqi, me qëllim që ta ndërrojë një ligj apo ndonjë veprim politik e që është në duart e shumicës që e kanë në duart e veta forcën politike. Pse të mos e themi se shkrimtari gjithnjë qëndron në anën e padëgjueshmërisë. E kjo padëgjueshmëri gjithnjë gjakon parimin e Barazisë e atë të Drejtësisë. Në këso rastesh, kujtohen protesta e tilla të Martin Luter Kingut në SHBA për realizimin e të drejtave të zezakëve, ato të Gandit për pavarësimin e Indisë, pavarësi e arritur nëpërmes padëgjueshmërisë së padhunshme qytetare. Shkrimtarët disidentë të periudhës komuniste, në emër të idealeve për liri, demokraci e humanizëm, i kanë frymëzuar edhe revolucionet paqësore, me anën e të cilave janë përmbysur qeveritë totalitare e diktaturat komuniste në Evropën Lindore e në shumë vende të Evropës Juglindore. Gjithsesi, që Res Publica nuk mund të trajtohet sot si Ide platonike, si qasje spekulative teorike, si mit ideologjik mbi rendin ideal e të pagabueshëm, si rend demokratik, në të cilin është e panevojshme padëgjueshmëria qytetare, sepse ky qytetar tashmë na i paska të garantuara të gjitha të drejtat. Kështu, e shikojnë shtetin nga këndi metafizik, domethënë, si rend demokratik që nuk iu nënshtrua ka ndryshimeve, evoluimeve apo progresit. Harrohet fakti që në këtë botë tokësore, në

këtë botë të gjërave njerëzore,të jetës kalimtare me pikën e lindjes e të vdekjes –nuk ka gjëra ideale,të përkryera pafundësisht apo të paprekshme,dhe,i tillë,me cene e huqe,na është edhe vetë shteti demokratik. Kurse shkrimtarët e dinë se kjo botë nuk është idilë,në të cilën ia vlen vetëm të ëndërrosh. Por,kur qytetarët binden se ky shtet nuk ua realizon të drejtat e tyre,se me veprime e programe kundërdemokratike e kundërnjerëzore,ka për qëllim t’i degjenerojë njerëzit e shoqërinë,atëherë pse të mos kenë të drejtë qytetarët që ta kundërshtojnë? Te e fundit,edhe ligjet nuk janë të përjetshme,po që vlejné për një kohë të caktuar. Shkrimtarët janë shpesh inicues të asociacioneve demokratike,gjithnjë me pikësynimin që të bëhet transformimi demokratik i shoqërisë dhe i shtetit. Ata janë ndër të parët,që,në kohë krizash,angazhohen në legalizimin e të drejtave e të lirive njerëzore e në zgjidhjen e konflikteve shoqërore apo etnike. Ndryshe nga mercenarët e zhurnalistikës a të literaturës së porositur e të paguar nga qarqe kundërnacionale,ndryshe edhe nga esktrimizmat ideologjikë;shkrimtarët pikësynojnë të tjera caqe;ata nuk vuajnë nga iluzioni për triumfin përfundimtar të së Mirës,prandaj janë dyshues,por ata nuk pajtohen në asnjë kohë e në asnjë rast me triumfin e së keqes. Ata e vazhdojnë betejën e tyre për liri,humanizëm e demokraci. Ata krijojnë aso parzmoresh krijuese,me të cilat do ta mbrojnë me fanatizëm të drejtën për jetë;jetën që ishte dhe është ende e rrezikuar nga stihia e frikës,nga skenat e prapaskenat kundërdemokratike,nga kurthet anti-liri,nga urrejtja e dhuna;ata e kuptojnë vetëçlirimin qytetar që mund të arrihet vetëm nëpërmes luftës kundër kësaj stihie të dhunës e të frikës,duke u përcaktuar për lirinë e individit e të shoqërisë. Shkrimtarët janë ata që rezistojnë kundër stihisë dhe anarkisë,që angazhohen për media të lira e të pavarura,tek iu japin mbështetje atyre ideve e atyre bartësve,që angazhohen për ndryshime konkrete demokratike. Dikur një shkrimtar i afirmuar thoshte:„Nëse dëshiron të dijsh se çfarë është shteti e sundimi i tij,dhe çfarë e ka ardhmërinë,shiko dhe mëso,se sa njerëz të ndershëm e të pastër ai vend ka nëpër burgje e sa kriminelë,dhunues të ligjit e kundërvajtës ka në liri. Kjo për ty do të ishte mësimi më i mirë”. E çka do të thotë nëse ky shkrimtar nuk i ka qëndruar besnik këtij formulimi të shqiptuar në ish Jugosllavinë? Kjo do të thotë se Letërsia e Politika mund të ecin bashkë,nëse angazhohen për ideale të njëjta,për liri,demokraci,humanizëm e drejtësi;por asesi nuk mund të ecin së bashku në fushën e demagogjisë,në të cilën mund të veprojë vetëm politika. E dihet,vendimet për fatet e njeriut,pra edhe për idetë e humanizmit e të demokracisë i merr politika e jo letërsia. Letërsisë nuk i duhen deklaratat për lirinë e krijimtarisë që vijnë nga politika,sepse ato janë deklarata politike. Prandaj,në dekadën që shkoi,shkrimtarët i kemi parë,tek angazhohen edhe për dialog në mes të njerëzve,janë ithtarë të vizioneve liridashëse e të ideve

humaniste,liberale dhe demokratike,gjithnjë në kundërshtim me shumësinë e ideologjive të stalinizmit,klerikalizmit,shovinizmit apo të patriarkalizmit militant. I kemi parë tek e ngritnin zërin e tyre për realizimin e kushteve ligjore,institucionale e procedurale;si dje,si sot,ata reagojnë për të drejtën e informimit objektiv,për shprehje të lirë të interesave,bindjeve e ideve,në mënyrë që Res Publica e tyre të ketë publik të formuar e me ndikim në të mirat e përbashkëta. Ata shprehin zemëratën e tyre kundër propagandës e manipulimit me opinionin publik;e afirmojnë dhe e zhvillojnë mendimin e qëndrimin kritik,kulturën e mendimit e të krijimit. Nuk është e rastit pse në këto parime të qytetarisë moderne,tek formulohen nëpër programet e lëvizjeve apo të partive politike,në radhë të parë,marrin pjesë vetë shkrimtarët. Mbase,edhe mund të zgjohet dyshimi rebelues i dikurshëm:në mos shkrimtari shitet te programi i një partie,duke e tjetërsuar esencën e lirisë së krijimtarisë? Ata janë kultivues të tolerancës e jo të urrejtjes ndaj bashkësive të tjera etnike apo ndaj pakicave. Ata janë në konfrontim e ballafaqim të vazhdueshëm me idetë çorientuese e izoluese,ata,madje,janë ithtarët më të mëdhenj të evropeizimit të popullit tonë e të formësimit të identitetit evropian në proceset e reja integruese. Nuk është e rastit pse shumë vepra që përkthehen kohëve të fundit nga thesari i letërsisë bashkëkohore botërore,e ngërthejnë farën e herezisë,dyshimit dhe intepretimimit ndrydhe të rendit të të vërtetave të vendosura nga politika,nga ideologjitë e ndryshme apo qoftë edhe nga religjioni (shih romanet „Kodi i da Vinçit“ apo „Vita brevis“). Shkrimtari e ka botën e tij,të pavarur nga politika. Më në fund,ata janë dyshues të përjetshëm e opozitarë të përjetshëm.

SHQIPTARËT NË SHTYPIN ARAB

Shqiptarët kanë historinë dhe rrënjët e tyre. Gjatë historisë shumëshekullore, ata u detyruan të emigronin në vende të ndryshme, për shkak të trazirave të vazhdueshme në rajonin e Ballkanit, e veçanërisht ndër trevat shqiptare. Një ndër vendet në të cilët u vendosën shumë shqiptarë qe dhe Egjipti.

Prof. Dr. Beqir Ismaili është një nga linguistët dhe letrarët më të njohur, i stolisur me dinjitet dhe i formuar në të gjitha sferat vepruese. Ai është autor i shumë botimeve të njohura dhe studimeve të vlefshme. Prof. Dr. Ismaili është një nga autorët e mirënjohur kosovarë, i specializuar në fushën e gjuhësisë dhe letërsisë arabe, personalitet i shquar për diturinë, oratorinë dhe metodën mbresëlënëse të komunikimit. Aftësia dhe veprimtaria e tij shkencore, arritjet dhe stili i tij i veçantë i mundësuan atij që të jetë kurdoherë në shërbim dhe dobi të kombit shqiptare.

Prof. Dr. Ismaili, ka lindur më 04/10/1959 në Kosovë, një nga republikat e Gadishullit Ballkanik që ndodhet në zemër të Evropës dhe, rrjedh nga një familje me tradita të hershme islame e atdhedashëse. Familja Ismaili, një familje e respektuar dhe e qytetëruar, ka dhënë dhe ka sakrifikuar shumë për Kosovën dhe popullin e saj. Ajo shquhet për qëndrimin e saj islam dhe patriotik dhe për rolin që ka luajtur në shërbim të Islamit dhe të Kosovës. Babai i tij, Mulla Haki efendi Ismaili, ishte një nga hoxhallarët më të respektuar, i cili u bë i njohur për mendimet e tij të matura në zgjidhjen e çështjeve islame dhe për ndjenjën atdhetare që ushqeu tek bijtë e tij. Dy djemtë e mëdhenj, Nuhiu – i cili u zhduk nga genocidi serb në luftën e Kosovës - dhe Abdullahi janë imamë të njohur në Kosovë. Djali i tret, Ismail Ismaili, u zhduk bashke me Nuhiun me 24 Mars të 1999, nga serbët në luftën e Kosovës.

Por nuk mund të lemë pa përmendur këtu, atë figurë të ndritur, që qëndron në ballë të kësaj familje, Prof. Dr. Beqir Ismailin, i cili ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në shërbim të çështjes së Kosovës. Me këtë rast ai ka ndihmuar dhe i ka shërbyer jo vetëm popullit shqiptar, por edhe rajonit të Ballkanit në përgjithësi.

Prof. Dr. Ismaili ka kryer shkollën tetëvjeçare në Kosovë, për të vazhduar më pas me studimet e mesme në Siri dhe studimet e larta në Universitetin e njohur të Al-Az'harit, në Kairo. Këtu ai studjoi gjuhën dhe letërsinë arabe, derisa u specializua dhe mbrojti titujt shkecorë Magjistër dhe Doktor i shkencave.

Menjëherë pas mbarimit të fakultetit, filloi të merrej me shkrime e botime të ndryshme, tematika e të cilave ishte e larmishme. Aftësitë e tij të shkëlqyeshme, prej studiuesi dhe dijetari, i mundësuan të krijojë një lidhje mes gjuhës dhe letërsisë arabe dhe asaj shqipe. Këto dy gjuhë përfituan shumë nga ky studjues për vetë faktin se ai ishte ndër të parët që lëvroi studimet në këtë fushë. Prof. Dr. Beqir Ismaili gjithashtu njihet edhe si gazetar dhe publicist i kalibrit ndërkombëtar. Shkrimet e tij u bënë rrezatim i së vërtetës dhe realitetit Kosovar, për Botën e Lindjes e më gjerë. Krijuesi i Gjithësisë, ka tubuar tek ai aftësi të shumta, që e bëjnë të shquhet në fusha të ndryshme shkencore dhe shoqërore. Ai sot njihet si një prej dijetarëve më të shquar dhe më aktivë të Kosovës, në Botën Arabe. Ai është një personalitet i njohur, linguist, letrar, publicist, autor i shumë e shumë librave të ndryshëm studimorë, historik dhe kronologjik, i cili ecën shtigjeve të diturisë, duke sfiduar pengesat me të cilat përballet në rrugën e tij. Prof. Dr. Beqir Ismaili shquhet për aftësinë e thellimit në dituri, njohjen e gjuhëve, diapazonin e gjerë të të menduarit dhe eksperiencën në plotitike. Prof. Dr. Ismaili ka ushtruar dhe ushtron shumë detyra, ndër të cilat mund të përmendim detyrën e tij si përfaqësues i Kosovës në Egjipt dhe në Lindjen e Mesme, drejtues politik dhe gazetar aktiv, organizator dhe komunikativ i njohur. Me profesionalizmin dhe përpjekjet e tij të pashtershme, ka dhënë kontributin e tij në të gjitha sferat, duke u bërë kështu shembull me veprimatrinë e tij botuese, me publikimet në shtypin e përditshëm dhe atë javor si dhe në politikë.

Kujtimi i disa individëve, mbetet i gdhendur në histori edhe pse kalojnë vite dhe shekuj. Kjo për shkak të vlerave të larta humanitare, morale dhe të bashkërendimit të mënyrës së tyre të veprimit në rraport me të tjerët. Ata asnjëherë nuk përdorin forcën në luftën me armikun edhe pse kanë mundësinë t'a bëjmë një veprim të tillë. Por njëkohësisht, lufta për ta, asnjëherë nuk është shkak që të tërhiqen nga populli dhe të anashkalojnë problemet e tij por përkundrazi, ata vazhdojnë të mbrojnë interesat e popullit duke sakrifikuar gjithçka, madje shpesh edhe veten e tyre. Dihet se gjatë luftës së Kosovës edhe dijetarët përjetuan goditje të rënda. Ata u përballën me armikun dhe u detyruar të mbijetonin edhe pse në kushtë të vështira jetese. Ndër këta dijetarë pa dyshim bën pjesë edhe Prof. Dr. Beqir Ismaili, i cili mori mbi vete përgjegjësinë e zbardhjes së të vërtetës së çështjes Kosovare në Botën Arabe e më gjerë. Ai ndihmoi materialisht dhe shpirtërisht, duke u përpjekur me të gjitha mundësitë e tij, që Kosova të fitojë të drejtat dhe pavarësinë, populli të fitojë paqen dhe lirinë.

Prof. Dr. Ismaili, me punën dhe kontributin e tij, arriti të realizojë detyrën e vështirë që kishte marrë përsipër duke fituar kështu një vend të lartë dhe të merituar ndër intelektualët dhe shtresat e tjera të popullsisë si ndër shqiptarët

ashtu edhe ndër popujt e ballkanit e më gjerë.

Përveç sa u përmend më lart, ai është bërë simbol i dijes, mendimit dhe vetflijimit. Në këto momente të vështira, Kosova ka nevojë për bijtë e saj që ti dalin zot në çdo fushë të zhvillimit duke plotësuar detyrën e tyre përpara atdheut si mendimtarë, historianë, politikanë, gazetarë etj. Për të gjitha këto arsye emri i tij do të hyjë në analet e historisë si mendimtar, dijetar dhe politikan që ka lënë gjurmë në mendimin, shkencën dhe politikën, Kosovare.

Kur flasim për figurën e Prof. Dr. Beqir Ismailit, mundohemi të përmendim disa prej kontributeve të tij në fusha të ndryshme të dijes dhe shkencës, por në të vërtetë do të na duheshin shumë lapsa, letra dhe një gjuhë e pasur në shprehje, për t'a përshkruar kontributin dhe sakrificën e tij në fushën e mendimit. Profesor Ismaili dallohet si një mendimtar dhe historian që e njeh mirë të kaluarën dhe të tashmen, gjë kjo që i mundëson atij të rradhitet ndër mendimtarët e mëdhenj të shoqërisë, ndër ata që dinë të japin mendime të shëndosha, që dinë të barazpeshojnë dhe të konkretizojnë mendimet e tyre. Këtë e përforcojnë më shumë veprat dhe shkrimet e tij të botuara dhe të shpërndara në shumë vende të botës.

Të gjithë studimet e tij shkencore, librat, artikujt e publikimet e ndryshme kanë stil që e zgjojnë njeriun, i tërheqin vëmendjen me shumë argumente që kanë të bëjnë me realitetin, ndikojnë në "shërimin" e sëmundje të vjetra e ndihmojnë në mësimin e dispozitave fetare. Sa herë që ai flet, i drejtohet dëgjuesit sinqerisht, duke i përcjellë atë që ka në zemër, duke thënë gjithmonë të drejtën, me ndjenja të pastra që e hijeshojnë fjalën e tij në thirrjen në Islam dhe imanin e tij të sinqertë.

Ai është nja nga njohësit e mirëfilltë të Kur'anit, sunnetit (praktikës) së Pejamberit a.s., shkencave të gjuhës dhe letërsisë arabe dhe asaj shqipe, historisë dhe kulturës së civilizimit islam të të gjitha kohërave, historisë njerëzore, diturive shkencore të ndryshme, kulturës bashkëkohore që ka të bëjë me shumë drejtime dhe filozofi.

Kontributi i tij ka një ndikim të përgjithshëm pasi ka botuar një sërë botimesh të fushave të ndryshme, që kanë lënë gjurmët e tyre brenda dhe jashtë vendit. Ky zinxhir botimesh – i shpërndarë në Kosovë, Egjipt dhe vende të tjera- përbëhet nga më se 100 vepra, ku secila prej tyre, i flet qartë lexuesit për qëllimin e saj. Një numër botimesh janë autobiografike dhe flasin për jetën e dijetarëve të njohur dhe për kontributin e tyre në lidhje me fenë Islame.

Prof. Dr. Beqir Ismaili ka filluar të ngjitë shkallët në lëvrimin e mendimit islam qysh herët, që në hapat e parë të studimeve të tij. Sa më shumë thellohej në studim, aq më shumë mahnitej nga bukuria e madhështia e mendimit dhe e

filozofisë Islame. Kjo bëri që, në studimet dhe shkrimet e tij, burimet Islame, qofshin ato të një periudhe më të herëshme apo bashkëkohore, të jenë pika e tij më e referuar, duke u përpjekur që të analizojë lidhjet burimore që ekzistojnë midis këtyre mendimeve.

Gjykuar nga gjithë sa u përmend dhe u analizua më lart, Prof. Dr. Ismaili vlerësohet si mendimtar dhe dijetar i rrallë, që shquhet për aftësitë dhe sinqeritetin e tij, që përdor arsyen e shëndoshë në të gjitha aspektet dhe që përpiket gjithmonë të realizojë një lidhje të fortë për të arritur tek e vërteta.

Prof. Dr. Beqir Ismaili ka një pjesmarrje të gjërë dhe aktive në një sërë veprimtarish kombëtare dhe ndërkombëtare në Egjipt dhe në krejt rajonin e Lindjes së Mesme, si në konferenca, simpoziume, panairë, kongrese, mbledhje solemne, ku ka paraqitur kumtesa, referate dhe punime të tjera shkencore dhe kulturore vetjake. Gjithashtu pjesë e kësaj veprimtarie, janë dhe takimet e shpeshta dy dhe shumpalëshe në institucionet e rëndësishme diplomatike vendase dhe arabe, lidhur me informimin për problemet e Kosovës dhe zhvillimet demokratike të saj.

“Albapress” është një qendër informative shqiptare për Kosovën dhe shqiptarët jashtë atdheut. Ndodhet pranë zonës universitare të Kairos, në lagjen e quajtur Nasser. E njohur dhe e frekuentuar nga shqiptarë dhe miq e dashamirë të tyre vendas si dhe nga studentë të Universiteteve të ndryshme të Kairos, ajo njihet edhe si “Qendra kulturore e shqiptarëve”.

Janë të shumta motivet që e shtynë Prof. Dr. Beqir Ismailin të ulet e të shkruajë për figura të shumta intelektualësh të vjetër dhe të rinj, që jetojnë ende dhe që nuk janë më dhe që janë të njohur, të nderuar dhe të vlerësuar jo vetëm nga njerëz me të cilët punojnë, por dhe nga institucione dhe vende të qytetëruara, ku janë formuar dhe kanë dhënë prova të shkëlqyera përkushtimi dhe aftësisht drejtuese dhe krijuese. Shkrimet për këta intelektualë të nderuar shqiptarë, janë botuar në mediat arabe, edhe për ta bërë të njohur në këtë anë të globit, kombin dhe popullin shqiptar, vlerat, energjitë dhe talentet e tij, për t’ju përgjigjur vetëm me vepra dhe me fakte, propagandës mohuese dhe denigruese antishqiptare të të gjitha llojeve, duke filluar nga ajo serbe.

Turqizmat në shqip, pse nuk u zhdukën

Në diskutimet rreth zëvendësimit të toponimisë “së huaj” në Shqipëri, sillet ndonjëherë, si kundërgargument, trajtimi i suksesshëm i turqizmeve nga kultura shqiptare, që nga Rilindja e këtej.

Kundërgargumenti mund të formulohet kështu: nëse ne arritëm të pastrojmë turqizmat nga shqipja, duke i zëvendësuar me fjalë tonat, pse qenka e pamundur të ndërrojmë tani toponimet e huaja?

Në fakt, arsytimi nuk qëndron

Në kulturën shqiptare ka pasur vërtet një lëvizje për t’i pastruar turqizmat, por ajo lëvizje në thelb puriste nuk pati sukses.

Le të kthehemi për një çast në periudhën e Rilindjes, kur një grusht patriotësh po kërkonin të gjenin rrugë për t’i shkëputur shqiptarët nga Perandoria Osmane. Një nga këto rrugë, ishte edhe arsimit dhe kultura, të cilat parakuptonin dhe kërkonin që gjuha shqipe të shkruhej dhe të mësohej në shkolla.

Po si do të shkruhej gjuha shqipe? Dhe më tej akoma, si do të mësohej në shkolla?

Për Rilindësit rol kryesor në këtë lëvizje kulturore do të luante letërsia.

Tani, deri në atë kohë, letërsia shqipe pothuajse nuk ekzistonte, me përjashtim të letërsisë së bejtexhinjve, e cila lëvrohej nga disa poetë.

Për një poet madhor të Rilindjes, si Naim Frashëri, poemat e kushërinjve të tij bejtexhinj Dalip dhe Shahin Frashëri ishin pikë referimi kryesore dhe përfaqësonin të vetmen traditë të poezisë shqipe.

Kujtoj këtu se për Naimin Hasan Zyko Kamberi, një bejtexhi edhe ky, ishte më i madhi poet i gjuhës shqipe. Letërsia e bejtexhinjve i përkiste një kulture të cilën Rilindja po gatitej ta mohonte: në përmbajtje dhe në formë. Nuk po zgjatëm në çështje të përmbajtjes, por po kujtoj vetëm se forma poetike e bejtexhinjve ishte në thelb e tëra e huazuar nga modele orientale, përfshi këtu edhe fjalorin poetik.

Naimin e kanë quajtur ndonjëherë “bejtexhi pa bejte”, dhe me të drejtë: ai e mori traditën e bejtexhinjve dhe e çoi përpara, por duke e pastruar nga orientalizmat (ose “turqizmat”, siç i quajmë ne sot, dhe siç do t’i quaj unë tash e tutje në këtë shkrim; termi orientalizëm është më i saktë, sepse shumë nga këtu të ashtuquajtura “turqizma” janë në fakt fjalë arabe dhe persiane që përdorte osmanishtja e kohës, por le ta bëjmë një kompromis për hir të qartësisë).

Nëse përpiqemi sot të lexojmë një tekst të një poeti bejtexhi, nuk do të arrijmë

dot; për shkak të turqizmave që gjenden aty. Nuk është e sigurt, për filologun e sotëm, nëse këto fjalë që përdorin bejtexhinjtë kanë qenë përdorur edhe në shqipen jashtë modeleve poetike apo jo. Tahir Dizdari i ka futur në fjalorin e vet të orientalizmave, por ai fjalor i përmbledh të gjitha instancat e orientalizmave, pavarësisht nga statusi i tyre.

Gjithsesi, Naimi ishte poeti që e ndërmori hapin kritik dhe shkroi një poezi e cila i shkëputi lidhjet leksikore dhe stilistike me rrymën e bejtexhinjve, pikërisht duke mënjeluar fjalët orientale nga leksiku poetik.

Kjo që bëri Naimi me të tjerë, ishte pastrim vërtet – por jo i gjuhës shqipe, sesa i një regjistri specifik të kësaj gjuhe, atij poetikut.

Përndryshe, statusi i turqizmave në shqipe ka qenë gjithnjë problematik.

Dihet se ndikimi i osmanishtes në shqipen ka qenë kryesisht urban, ose ka depërtuar fillimisht në qendrat urbane dhe vetëm shumë më vonë është përhapur edhe në zonat rurale. Për këtë arsye, të folmet e qyteteve kanë pasur shumë më tepër turqizma sesa ato të fshatrave.

Turqizmat në shqipe hynë së bashku me kulturën osmane: kulturën materiale (jetesa e përditshme, mallra konsumi, zeje, veshje), kulturën shpirtërore (leksiku fetar), kulturën ekonomike dhe juridike, dhe kulturën shtetërore-administrative.

Bëjmë mirë t'i këqyrim si pasqyrim të periudhës osmane në gjuhën shqipe.

Me shkëputjen e Shqipërisë prej sferës kulturore osmane, numri i turqizmave në përdorim do të vinte duke u ulur natyrshëm. Teksa qeveritë shqiptare i kthenin sytë nga Perëndimi, një numër i madh fjalësh që lidheshin me botën osmane do të dilnin vetvetiu nga përdorimi. Kush kishte më nevojë për bimbash, sadrazem, kadi, vali, vezir, mytesarif dhe qatip, në rrethanat kur këto figura profesionale u zhdukën nga qarkullimi?

Veç kësaj, një numër i madh turqizmesh kishin hyrë në shqipe pa nevojë; meqë shqipja i kishte fjalët përkatëse. Për shembull, kishin hyrë dhe përdoreshin fjalë si zaman dhe sene, edhe pse shqipja i kishte fjalë si kohë dhe vit. Gjuha zakonisht nuk i duron dot sinonime të tilla absolute; dhe kur letërsia shqipe që po lëvrohej rishtas nisi të hedhë në qarkullim fjalë thjesht shqipe, atëherë barasvlerat e tyre në turqisht nisën të dalin nga përdorimi.

Në masë të madhe, një ligjërim shqip i mbytur nga turqizmat po kthehej në shenjë dalluese të shtresës së mesme qytetare të kultivuar nga Perandoria Osmane, e cila përçonte, nga qendra drejt periferive, vetë pushtetin osman. Jo rastësisht, kjo shtresë e mesme qytetare do të konsumonte jo vetëm marrëdhëniet ekonomike, tregtare, juridike, fetare dhe politike të kohës, por edhe disa aspekte kulturore tipike të periudhës, siç ishte letërsia shqipe me alfabet arab, ose e bejtexhinjve.

Përhapja sociale e turqizimave në shqipe nuk ndikohej aq nga ndarja në myslimanë e të krishterë, sesa nga ndarja qytet/fshat; mjaft të lexojmë disa poetë katolikë shkodranë të fillimit të shekullit XIX (Leonard De Martino, Pjetër Zarishi), për të parë se deri në ç' masë kishin depërtuar këto turqizma në shqipen "e kultivuar". Përkundrazi, fshati shqiptar kishte mbetur relativisht i paprekur prej tyre, sidomos sa i përket leksikut abstrakt dhe të kulturës.

Sa më shumë që punëtorët e gjuhës dhe të shkollës shqipe, të shumtë dhe të përkushtuar gjatë Rilindjes, nisën të vënë në dispozicion të folësve fjalë shqipe të mirëfillta, aq më problematik do të bëhej statusi i turqizimave në shqipe, në fillim të folur, pastaj të shkruar.

Këtu duhet pasur parasysh edhe se turqizmat kishin hyrë relativisht vonë në shqipe dhe nuk ishin integruar dot mirë në sistem; p.sh. nuk ishin bërë produktive, duke u ofruar si tema për fjalë të tjera, por kishin mbetur relativisht si mish i huaj, leksikisht të izoluara. Veç kësaj, pjesa më e madhe e tyre ishin emra, ndërsa foljet ishin fare të pakta; çka e kufizonte edhe më aftësinë e tyre për të ndërvepruar në gjuhë – po të kihet parasysh se nga foljet mund të kalohet lehtë në emra prejfoljorë abstraktë të veprimit dhe në gjithfarë mbiemrash prejpjesorë, etj. Të krahasohet, bie fjala, defter me fletore dhe të vihen re lidhjet horizontale të së dytës me fletë, shfletoj, etj.

Fati i turqizimave të shqipes u vendos nga një konvergjençë: vullneti i Rilindësve për ta pastruar gjuhën nga turqizmat konvergoi me vjetërimin e vetvetishëm të turqizimave, për arsye historike (shkëputja e Shqipërisë nga bota osmane).

Praktikisht të gjithë shqiptarët mësuan të shkruajnë shqip me tekste të ndërtuara sipas parimeve gjuhësore të Rilindjes. Turqizmat që mbijetuan gjatë gjysmës së parë të shek. XX, mbijetuan në ligjërimin e folur, të shtresës kryesisht analfabete të popullatës.

Ndërkohë, falë mendësisë së Rilindjes dhe një zgjimi të përgjithshëm të krenarisë kombëtare, por edhe kthimi të vështrimit kulturor drejt Perëndimit, elitat në Tiranë, në Shkodër, në Korçë, në Elbasan dhe në Gjirokastrë do t'i konsideronin turqizmat e shqipes si shenja të një mendësie orientale, anadollake, turkoshake, nga e cila do të distancoheshin me përkufizim, për të merituar statusin e tyre të ri si elita kombëtare të Shqipërisë. Brenda një shekulli, statusi i turqizimave në ligjërimin joletrar u përmbys: nga mishërim i mendësisë urbane perandorake, në mishërim të mendësisë së prapambetur, fshatarake, provinciale të shqiptarit të vjetër, që i kishte mbetur ora "në kohën e turkut."

Ndërkohë, purizmi – që është gjithnjë i gabuar – kishte filluar të jepte efekte anësore të padëshiruara, duke e varfëruar shqipen letrare. Noli, që ishte ndoshta i pari shkrimtar shqiptar që ia pa shqipes së re mangësitë e mëdha, kur e ballafaqoi

me gjuhë dhe shkrimtarë madhorë në punën e vet si shqipëruet, u detyrua... t'i kthejë disa turqizma në shqipen e vet poetike; dhe këtu s'e kam fjalën për poezi satirike, si Kënga e Salep Sulltanit, por edhe për poezi të stilit të lartë, si ato për Bajram Currin dhe Luigj Gurakuqin. Me Nolin ndodhi kështu një tjetër ndërrim paradigmatic; që nga ajo kohë, turqizmat nuk është se u dëbuan nga gjuha në mënyrë të padiskriminuar, por vetëm u rivlerësuan nga pikëpamja stilistike ose e përdorimit. Kjo do të kërkonte, gjithsesi, shumë kohë për t'u realizuar. Një koleg, në një koment të lënë në temën tjetër, shkruante – po parafrazoj – se pse qenka kaq e vështirë të ndërrohen toponimet e huaja, kur janë ndërruar “fjalët tenxhere dhe penxhere.” Në fakt, komenti është tipik për të ilustruar përshtjellimin në mendjen e njerëzve, kur vjen puna për turqizmat e shqipes. Tenxhere dhe penxhere nuk janë ndërruar – të gjithë i dimë dhe i përdorim. Çfarë ka ndryshuar, është statusi i tyre – veçanërisht për penxhere, e cila është zëvendësuar, në tekste neutrale (p.sh. një manual i arkitekturës), nga dritare, që është neologjizëm (fjalë e krijuar në tavolinë). Penxhere, ndërkohë, është kufizuar disi në përdorim, duke fituar edhe ngjyrim stilistik.

Kjo u ka ndodhur tashmë shumë turqizmave: nuk janë larguar krejt nga gjuha, por vetëm janë “shënjuar” stilistikisht, nëpërmjet një procesi në thelb letrar, që e ka pasuruar gjuhën. Të krahasohet, p.sh. fjala dynja me fjalën botë; unë besoj se shqipja vetëm ka fituar, duke i mbajtur të dyja fjalët, sepse dynja jep disa nuanca specifike, të cilat botë nuk i jep dot.

Mund të thuhet, pa e tepruar, se sot turqizmat janë një pasuri e rrallë e shqipes, e cila gjen shprehje në regjistra të caktuar gjuhësorë, sidomos në letërsinë satirike, në teatër, dhe në përgjithësi në ligjërimin bisedor. Madje ligjërimi bisedor, si sistem i pavarur nga dialektet – ose diferencimi gjeografik i shqipes – nuk do të krijohet dot pa rehabilitimin stilistik të turqizmave. Rilindësit vërtet u nisën të “pastrojnë” shqipen, sepse e tillë ishte koha. Njëlloj si shqipja ishte pastruar më parë greqishtja (nga turqizmat) dhe rumanishtja (nga sllavizmat); më pas, të njëjtat “turqizma” (në fakt, orientalizma) që u dëbuan prej shqipes do të dëboheshin edhe prej turqishtes moderne, krahas me ndërrimin e alfabetit në atë gjuhë. Megjithatë, pastrimi nuk është asnjëherë politikë gjuhësore e mirë. Një nga kritikantët që i kanë bërë Naimit, sidomos nga Shkodra, ka qenë se gjuha e tij tingëllon e sheshtë, për të mos thënë e varfër; dhe gjithsesi monotone. Në fakt, po të nxirret nga konteksti historik dhe letrar i kohës, gjuha e Naimit ashtu është: artificiale, e varfër në mjete leksikore, e sheshtë. Mirëpo kritika vetë është anakronike, sepse harron të marrë parasysh sa eksperimental ishte Naimi; dhe sa e re do të ketë tingëlluar shqipja e tij, në veshët e shqiptarëve të kohës. Gjithsesi, kjo është çështje tjetër. Çfarë dua të theksoj, është se purizmi, si politikë

gjuhësore, nuk funksionoi – dhe nuk mund të funksiononte, me gjithë zellin me të cilin u zbatua ndonjëherë. Ndoshta shërbeu në fillim, kur duhej vendosmëri dhe sakrificë, për t’u shkëputur nga Perandoria Osmane dhe përqaftimi i saj politik, ekonomik dhe kulturor; por kjo nuk ishte arsye për ta sanksionuar si politikë zyrtare në pavarësi nga rrethanat. Përkundrazi, politikë e drejtë me turqizmat e shqipes do të rezultonte disiplinimi i tyre – i cili u arrit shkallë-shkallë, krahas me lëvrimin e shqipes si gjuhë polifunksionale, veçanërisht në sferat e letërsisë, të teatrit, të filmit, të televizionit. Sa më i artikuluar bëhej ligjërimi shqip, aq më shumë kishte nevojë për diferenca – të cilat do t’i përmbushte, ndër të tjera, edhe duke shfrytëzuar thesarin leksikor të turqizmave, të cilin më kot ish përpjekur ta groposte krahu më radikal i Rilindjes. Prandaj sot fjalë si tenxhere dhe penxhere janë pasuri e paçmuar e shqipes, me kusht që të përdoren nga një publik me arsimin dhe kulturën e duhur gjuhësore.

Prof.dr. Shaban Sinani: Besa nuk ka lindur me shqiptarët. Përpara se të krijoheshin etnitë, përpara se të ndaheshin kufijtë, ishte fjala, ishte kënga, ishte rapsodi që me lahutë i këndonte trimit me mustaqe të gjata që luftonte shkjaun, bajlozin, apo katallanin. Pikërisht aty, tek i quajturi epos, gjen gjurmët e krijimit të së “ndryshmes”, etnikes. “Etnos në epos” është studimi monografik i prof. dr. Shaban Sinanit, që sapo ka dalë në qarkullim së fundmi. Pas një studimi 15-vjeçar, ndërsa përgatitet dosja për përfshirjen e epikës legjendare shqiptare në listën e trashëgimisë botërore, Sinani na tregon rrënjët e etnosit në epos, dallimin e eposit shqiptar nga ata të huaj, temat, heronjtë, por edhe disa “fjalë-kyçe”, të cilat kanë një peshë të veçantë në jetën shpirtërore të shqiptarëve. Një ndër to është edhe fjala “besë”, e cila nga shumëkush trajtohet si një fjalë mirëfilli shqiptare, madje e papërkthyeshme. Në një intervistë, Sinani sqaron disa prej çështjeve të trajtuara në libër. Sapo ka dalë nga botimi një monografia juaj, për të cilën keni punuar 15 vjet dhe përkon me përgatitjen e dosjes për përfshirjen e epikës legjendare shqiptare në listën e trashëgimisë botërore. Cili ka qenë qëllimi juaj parak? Libri “Etnos në epos” është një studim monografik, që vijon punën që pata bërë në kohën e mbrojtjes së doktoratës (“Mitologji në eposin e kreshnikëve”, 1998) e më herët, në një shkallë më të thelluar. Në këtë kuptim, nuk ka ndonjë lidhje funksionale me nismën e ndërmarrë dy vjet e gjysmë më parë nga qeveria e Kosovës për t’i propozuar UNESCO-s regjistrimin e epikës legjendare shqiptare në një prej programeve të saj për promovimin ndërkombëtar të pasurisë shpirtërore (jomateriale) të njerëzimit. Kur u ndërmor kjo nismë dhe më caktuan në përbërje të grupit të punës për përgatitjen e dosjes shkencore, mendova se një monografi që synon të ndriçojë kushtëzimin etnos-epos mund ta bënte atë më të shëndetshme shkencërisht. Tani kjo është një punë

e përfunduar dhe mund të kryejë detyrën e vet, pavarësisht se si do të ndërrohet nisma që përmenda, e cila kohët e fundme ka pësuar disa ndryshime në shkallën administrative. Qëllimi im parësor ka qenë që, përmes mjetesh filologjike, përmes formulave të ngurtësuara apo shprehjeve klishe, siç i quajnë themeluesit e teorisë së oralitetit, M. Parry e A. Lord; përmes idiomave me kuptim të mbyllur dhe fjalëve të shkuptimësuara, përmes “sintagmave shëtitëse”, të mbërrihet deri tek një thelb zanafillës, tek shtresa e kryehershme, që lejon të vërehen raportet e dy dukurive parakombëtare, etnisë dhe epit, gojëdhënës së origjinës. Me mjete historiografike kjo nuk do të kishte qenë e mundur të bëhej, për më tepër do të ishte metodologjikisht e gabuar, sepse kur lind historia, eposi e mbaron misionin e vet dhe thjesht trashëgohet si pasuri shpirtërore. Pse kjo pjesë e trashëgimisë gojore shqiptare duhet të merret në mbrojtjen e UNESCO-s? UNESCO, në konventën e saj për trashëgiminë, merr në mbrojtje pasuritë e papërsëritshme të kulturave të popujve, të mëdhenj e të vegjël; me qëllim që ato të bëhen të njohura dhe të përcjellshme mbi kufijtë që paracakton gjuha. Epika legjendare shqiptare ka cilësi artistike origjinale. Ajo është e fundmja epike në Europë që është ruajtur vetëm në formë gojore. Kodifikuesit e parë të eposit shqiptar janë fretnit franceskanë (veçmas B. Palaj e D. Kurti) dhe dy homerologët amerikanë M. Parry e A. Lord. Epika legjendare shqiptare ka rëndësi parësore për studimet teorike mbi trashëgiminë gojore, për çështjen homerike që trazon ndër shekuj e mijëvjeçarë mendimin njerëzor, për ndikimin e tejskrimeve letrare në ngurosjen e epopesë, për rolin e rapsodëve dygjuhësh në krijimin e lidhjeve dhe ndikimeve tek popujt fqinjë dhe për shumë çështje të tjera. Për një shumicë studiuesish është e pabesueshme që eposi shqiptar edhe sot bën jetë të gjallë dhe paraqitet në jetën e popullit pa regji, pa inskenime, pa improvizime. Kjo mbijetesë e epit shqiptar u ofron studiuesve e antropologëve mundësi të pafundme kërkimesh dhe krahasimesh. Por, nuk është vetëm interesi ndërkombëtar që e bën këtë pasuri të denjë për mbrojtje prej UNESCO-s. Epika legjendare shqiptare, mekanizmi krijues i së cilës mbyllet me ciklin e këngëve kushtuar betejës së Fushë-Kosovës (1389), kur për herë të parë shfaqen kufij të përcaktuar kohorë e mjedisorë; është një rezervat i vërtetë mjetesh të shprehjes, që ofron pasuri të shkëlqimta për etnologët, filologët, gjuhëtarët, për dijen shqiptare në përgjithësi. Nga kjo anë, eposi mbetet ende i pastudiuar. Çfarë të dhënash na ofron eposi shqiptar mbi “ngjizjen” e etnosit shqiptar? Eposi ofron burime për të arritur deri tek të dhëna etnodalluese të shkallës fillestare. Në epos nuk ka heronj historikë, por heronj kulturorë. Në epos nuk ka shqiptarë në kuptimin etnonimik të fjalës, as arbër, as ilirë. Heronjtë kulturorë të botës vendëse dallojnë qartë tjetrin, që mund të jetë, sipas etnonimeve që përmban vetë rapsodia: shkjav (sllavi), jelin (heleni, greku), harapi-harambashi (arabi), maxharri (hungari), Itini (latini),

jevrenia (hebreja), osmani (turku), miskovi (rusi), tali (italiani), katallani (spanjoli, katalonjasi), frangu (frëngu, francezi), gumani (igumeni), allamani (gjermani), madje dhe kujtim i ndonjë bashkësie që mbetet e paqartë në rrjedhat e shekujve (si uskokët, për shembull). Por, për vetidentifikim në epos, heronjtë mjaftohen me shenjën se flasin “në gluhë të vet”, vishen “në veshën e vet” dhe kjo është shkalla më e hershme e njohjes së dallimit të bashkësisë. Eposi shqiptar, duke pasur si shtresën më të hershme të konfliktit ardhjen e sllavëve në Ballkan, përkon me daljen e etnisë së re prej burimit protoshqiptar, që historikisht lidhet me shekullin e 7-të, kohë kur lind shqipja e shuhet ilirishtja; kohë kur ndodhin disa dallime themelore midis rendit gjuhësor të toskërishtes dhe atij të gegërishtes, si dhe veçimi i dy makro-njësive etnografike shqiptare (Toskëri e Gegëri). Pavarësisht se kur epika popullore legjendare shqiptare mori përmasën e një trashëgimie themelore të stabilizuar, për çka studiuesit kanë mendime të ndryshme, kujtimi më i hershëm dhe sundues i saj është pikërisht i kohës kur lind dhe etnia e re: albane, arbëre më vonë dhe prej fundit të shekullit të 17-të – shqiptare. Në monografinë tuaj merreni me disa fjale kyçe, mes të cilave edhe “besa”. Është ajo vërtetë një fjalë e “papërkthyeshme” në gjuhët e tjera dhe që merr apo ka kuptim vetëm si e tillë në shqip? Më ka interesuar një krahasim i tre stileve më të hershme të ligjërimit shqip parashkrimor: ligjërimit biblik-ungjillor, ligjërimit epik-legjendar dhe ligjërimit etnojuridik. Të tre këto ligjërime, duke i vështruar në një krahasim të brendshëm në epikën legjendare, lejojnë të arrihet në përfundime se si kanë ndikuar, implikuar, shmangur njëri-tjetrin, si një koncept fetar është kthyer në vlerë poetike, si një vlerë poetike është kthyer në nocion etnojuridik. Këto ndikime nuk mund të dalin në dritë as prej fjalorësh etimologjikë, as prej fjalorësh të historisë së fjalës, sepse shenjat e tyre ruhen vetëm në trashëgimi të mbyllura, siç është epika legjendare. Një prej këtyre fjalëve-çelësa që ka qenë e pashmangshme në këtë krahasim, ishte fjala “besë”. Para së gjithash, kjo fjalë jo vetëm që nuk është e papërkthyeshme, por, siç ka shpjeguar E. Çabej, është e një burimi indoeuropian. Së dyti, siç del prej përdorimit të saj në këngët epike legjendare, “besë” nuk është as fjalë e parme, shenjë e sigurt, se është krijuar vonë, si të gjitha fjalët me kuptim abstrakt. Besa nuk ka lindur bashkë me shqiptarët, sikundër trajtohet në studime postromantike, madje as gjuhësisht nuk ka lindur para shqiptarëve. Besa është një kategori historike, që u shfaq ndër shqiptarët në një kohë kur lindi vetëdija e tejkalimit të kufijve të zotërimeve të familjeve patronimike. Në studimin tim besa shihet si kategori e të besuarit, si kategori etike dhe si normë etnojuridike. Ajo del për herë të parë në formë të shkruar si folje, “bessare”, në “Statutet e Shkodrës” (1469), dhe ka kuptimin e dëshmisë së besueshme. Dekodifikimi i nocioneve të tilla si besa, fjalë të cilën Sami Frashëri e përdorte për “fe, besim”, është i

nevojshëm për procesin e vetënjohjes dhe të zhvillimit pozitiv të mendësisë njerëzore. Absolutizimi i besës si dukuri shqiptare shumë lehtë mund të çojë në kompleks epërsie, që është po aq i dëmshëm sa dhe ai i vetëpërçmimit. Në fund të fundit, miti i fjalës është një mit biblik, që e ka gjithë njerëzimi (“Në fillim qe Fjala”). Dhe më tej, miti i fjalës, i mbitheksuar në mënyrë etnocentriste, është mbitheksim i një miti të një kulture parashkrimore. Jo rrallë herë kemi dëgjuar debate për vjedhje, apo huazime këngësh epike mes ballkanasish, si qëndron e vërteta? I kemi huazuar, na i kanë huazuar, apo janë ca tema apo motive “migratore” që i gjen në të gjitha këto vende? Mendoj se kjo ka qenë një prej grackave që kanë mbajtur dijen shqiptare në një kurth qindvjeçar. Lufta për mbrojtjen e epopesë i ngjan një skajimi të frymës luftarake të vetë eposit. Epose të pastër nuk ka asnjë popull. Sot dija europiane e shtron çështjen e ndikimeve në formën e pyetjes “voisinite, affinite et fraternite” – “fqinjësia, afërsia apo vëllazëria”, kush ka ndikuar më shumë. Ngjashmëritë midis eposit sllav dhe eposit shqiptar janë të papërrjashtueshme. Studiuesit në këtë rast më shumë i intereson origjinaliteti i epopesë kombëtare, se lufta për primatin, që është një luftë fanatike dhe jo laike-shkencore. Eposi shqiptar ka si përparësi themelore hershmërinë. Klani i Qyprillinjve (“Koprülü”), që sundoi për gati një shekull perandorinë osmane, nuk ka lënë shenja në eposin shqiptar, sepse mekanizmi i tij nuk vepronte më; por, në eposin e sllavëve të jugut Æupriliæ veziri ka një cikël më vete këngësh heroike legjendare. Në traditën shqiptare nuk vërtetohet tipi i rapsodit që këndon me pagesë në saraje, si ndër sllavët. Rapsodi shqiptar ka ruajtur deri në kohët moderne një sjellje “të shëkrueme”, sipas një fjale të Buzukut, një sjellje sakrale ndaj heronjve, të cilët nuk vdesin, por mbyllen në shpellë dhe atje jetojnë përtej-jetën. Kurse në eposin e sllavëve të jugut, “hrnjiæki brati” kanë varre pelegrinazhi popullor në Banja Luka. Diku citoni Nopscen që ishte i mendimit që Shqipëria të “izolohej” për ta ruajtur trashëgiminë gojore të paprishur, si ju duket kjo ide? Po, ka pasur albanologë, si F. Nopsca, por edhe Rose Lane, që kanë propozuar të muzealizohet gjendja e prapambetur e Shqipërisë, të kthehet ky vend në një muze të gjallë të së shkuarës kalorësiake, me qëllim që Europa metropolitane t’u japë mundësi brezave të rinj të shohin të shkuarën e stërgjyshërve të tyre. Rose Lane shprehimisht thotë se “unë jam reaksionare” dhe nga kjo mënyrë të menduari e propozoj këtë. Në të vërtetë, pavarësisht se një pjesë e albanologëve të huaj e kanë idealizuar dhe hyjnizuar “virtytin shqiptar”, dhe mjaft studiues vendës u kanë rendur prapa me shumë zell shkencë të rreme atdhetare, projektet e tyre kanë pasur si qëllim ngrirjen e së sotmes, ndalimin e kohës, monumentalizimin e prapambetjes, thotë mes tjerash gazetarja Alma Mile. <http://floripress.blogspot.com/2011/04/shqiptaret-ne-shtypin-arab.html>

HISTORIK I SHKURTËR I GJUHËS SHQIPE

Origjina e shqiptarëve është bërë prej disa kohësh çështje debati ndër historianë. Shqiptarët janë një popull që flet shqip, një gjuhë indoevropiane. Ndonëse leksiku përmban disa fjalë greke, latine dhe turke, gjuha në vetvete nuk ka të afërm të tjerë të gjallë, duke e bërë të vështirë për ta përcaktuar se nga cila gjuhë e vjetër ballkanase ka rrjedhur.

Vendi i prejardhjes

Vendi ku u formua shqipja është gjithashtu i diskutueshëm, por duke studiuar gjuhën mund të mësojmë se shqipja është formuar më tepër në një zonë malore sesa fushore apo bregdet: ndërkohë që fjalët për bimët dhe kafshët që janë karakteristike në zonat malore janë krejt origjinale, emrat për peshqit e detit dhe ato për veprimtaritë bujqësore, (të tilla si plugimi) janë të huazuara nga gjuhët e tjera. Studiuesi Georg Stadtmüller duke shqyrtuar etimologjinë e emrave të bimëve në shqip ka arritur në përfundimin se *Urheimat*'''i (= vendi i të parëve) historik dhe gjuhësor i shqiptarëve duhet kërkuar në rajone në lartësinë 600 metra mbi nivelin i detit, që është zona gjeobotanike e pyjeve të thatë.

Gjuhët romane

Pyjet e thatë subtropikalë si ç''' mund të shihen (me të verdhë) nga kjo hartë e bërë nga Organizata për Ushqimin dhe Agrikulturën e Kombeve të Bashkuara gjenden sot në Ballkan në zonat malore të Shqipërisë së sotme, Kosovës, Greqisë, Bullgarisë, Maqedonisë dhe në zonat malore pranë bregdeteve të Kroacisë dhe Malit të Zi. Nga ana tjetër mungesa e fjalorit të trashëguar detar mund të mos thotë gjë. Dimitër Deçev (shqip. Dimiter Deçev) në *Charakteristik der thrakischen Sprache* (Karakteristike të gjuhës trake), Sofia, 1952, faq. 113, thotë se shqiptarët kanë pasur një fjalor detar por e kanë humbur. Eqrem Çabej në "VII Congresso internazionale di scienze onomastiche, 4-8 Aprile 1961, 248-249" (Kongresi VII ndërkombëtar i shkencave onomastike, 4-8 Prill 1961) ka argumentuar për praninë aktuale të disa fjalëve të vjetra të ruajtura.

Zonat me të kuqe mendohet të jenë ato ku shqiptarët kanë jetuar pranë rumunëve

Eric Hamp (shqip. Erik Hemp) thotë se këto fjalë janë në pjesën më të madhe jobindëse në vetvete: det (e afërm me fjalën angleze "'''deep, depth''' = thellë,

thellësisë) mund të ishte fjala për cilado ujëra të thellë. Pyetjes sime në një forum të gjuhëve indo-evropiane më 2002-shin mbi atë se si është e mundur që shqiptarët e lashtë nëse nuk kanë jetuar pranë detit prapë të kishin një fjalë origjinale për këtë gjë që nuk e kishin parë studiuesi polak Piotr Gasioroëski (shqip. Pjotër Gasiorovski) i përgjigjet se ai është i mendimit se përvoja e dorës së parë nuk është e domosdoshme në këto raste dhe se kjo fjalë duhet të ketë qenë pjesë e trashëgimisë getike të parashqiptarëve dhe që nuk humbi përgjatë baritjeve të tyre në brendësi të steresë. Lidhjet tregtare me krahinat bregdetare duhet të kenë mjaftuar për t'u kujtuar atyre që deti ekziston. Si shembull ai merr përhapjen e fjalësuan ndër sllavë përpara se këta ta kenë parë vetë këtë kafshë. Ky shembull mund të mos qëndrojë plotësisht nga ana logjike kur arsyetohet se fjala det është e trashëguar në shqip ndërsa fjala e përdorur për luanin nëgjuhët sllave është e huazuar nga gjuhët gjermanike. Va, mat, valë mund të përdoren për ujëra të ndryshme. Aq më tepër va mendohet që mund të jetë e huazuar nga fjala latine vadum me të njëjtin kuptim.

Fjalë si grykë (ngushticë) janë metafora të lehta (fyt). Gjithashtu anije (anë, shum. enë), bile Gasioroëski më jep mësim duke më treguar se kjo fjalë është krahasimisht e re, e studiuar mirë më vonë nga vetë etimologët shqiptarë si Dodbiba (1972), hasur për herë të parë në shek. e 19-të në një shkrim të arbëreshëve të Italisë si ani dhe pranuar nga shqiptarët në Kongresin e Manastirit më 1908-n në formën toske anije. Albanian migrations in 1300-1350 AD. Poashtu, sipas Hamp, edhe disa pjesë të tjera të një barke (ballë, pëlhurë, shul, lugatë që i përket fjalës lugë) kuptohen lehtë si metafora; likurishtë (krahas. likurë, lëkurë) dhe shumë emra të tjerë, shpeshherë që shihen qartë që janë fjalë të përbëra (faq. 249), janë përshtatëse dhe mund të jenë shfaqur në përdorimet e dëshmuara ndoshta në pothuajse cilëndo kohë. Albanians in the 5th-10th centuries according to the Dacian theor Fjala ngjalë < *engella, edhe sikur të ishte e lidhur me fjalën ilire “Eggelanev” nuk ka si kusht patjetër detin. Për më tepër Gasioroëski thotë se edhe kjo fjalë është e huazuar nga latinishtja anguilla. Kështu na mungon akoma një trup i vërtetuar morfemash detare anase, që nuk ka lidhje të tjera morfologjikeose kuptimore brenda gjuhës që mund të kishin bërë të mundur përcjelljen. The distribution of E-V13 in Europe. Për këtë lloj diskutimi, vetëm format e veçuara do të ishin bindëse. Në Kuvendin e Rruzullit nën Prejardhjen e fjalëve shqipe anëtarët që kanë dëshirë mund të hedhin fjalë detare shqipe të cilat mendojnë se plotësojnë kushtet e parashtruara nga Hamp. Më pas mund të lusim studiuesin Abdullah Konushevc – që ka nxjerrë kohët e fundit Fjalorin e Trashëgimisë Shqipe – t'u hedhë një sy fjalëve të mbledhura dhe të na japë ndonjë mendim mbi etimologjinë e tyre. Mund të

merret me mend që shqiptarët e lashtë nuk jetonin në Dalmaci, pasi ndikimi latin mbi shqipen është më tepër i llojit të origjinës së Romancës Ballkanike (që u zhvillua në rumanishte) sesa i origjinës dalmate. Ky ndikim i Romancës Ballkanike përfshin fjalët latine që shfaqin shprehje të folure dhe ndryshime kuptimi që gjenden vetëm në rumanishte dhe jo në gjuhët e tjera romance. Duke ia shtuar këtë fjalëve të përbashkëta vetëm për shqipen dhe rumanishten, mund të pranojmë si të vërtetë se rumunët dhe shqiptarët kanë jetuar dikur pranë njëri-tjetrit. Në përgjithësi sipërfaqet ku kjo mund të ketë ndodhur gjykohet të jenë zona të ndryshme që nga Transilvania, Serbia e Lindjes (zona rreth Naissus/Nishit), Kosova dhe Shqipëria e Maqedonia e Veriut. Sidoqoftë rumanishtja e ka pjesën më të madhe të termave bujqësore me origjinë latine, por jo termat që kanë të bëjnë me aktivitete qytetare, gjë që tregon që rumunët ishin popull bujqish në rrafshinat e ulëta përkundër shqiptarëve të cilët ishin në fillim barinj në vendet malore. Zonat me të kuqe mendohet të jenë ato ku shqiptarët kanë jetuar pranë rumunëve. Disa studiues shpjegojnë bile edhe hendekun midis bullgarishtes dhe serbishtes me praninë e një zone ndarëse shqiptaro-rumune në lindje të lumit Moravë (ndonëse ekziston një dialekt ndërmjetës serb, por është i formuar vetëm pas zgjerimit serb në lindje). Një argument tjetër që mbështet origjinën veriore të shqiptarëve është numri krahasimisht i vogël i fjalëve me prejardhje greke, ndonëse Iliria e Jugut ishte nën ndikimin e qytetërimit dhe gjuhës greke/bizantine, sidomos pas rënies së Perandorisë Romake. Sidoqoftë, nëse origjina e shqiptarëve duhet kërkuar në pyjet e thata tropikale, duke përjashtuar Dalmacinë, dhe duke ditur nga e njëjta hartë e mësipërme botanike se Transilvania dhe zona e Nishit hyjnë në zonën epyjeve të butë kontinentale atëherë zonat që përmbushin kriteret janë po ato zona që banohej edhe sot nga shqiptarët: zonat malore të Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë e Veriut.

Thënie për gjuhën:

“Gjuha është tepër e rëndësishme për t’ua lënë vetëm gjuhëtarëve”

Heidegger

“Gjuha Shqipe është i vetmi mjet i ndriçimit dhe i përparimit moral. Ajo është një gjuhë e fuqishme dhe e bukur që duhet të jetë krenaria e folësve të saj dhe një mjet i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të vjetër shqiptar”

Holger Pedersen

“Kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado që të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet vetëm me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet”

Filip Shiroka

“Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij”

E.Çabej

“Shenjat e civilizimit të një populli janë:

si kujdeset ai për drunjtë e tij,

si kujdeset ai për fëmijët dhe pleqtë

si sillet ai me gjuhën e tij.

Por gjuha është më e rëndësishme. Është detyrë e tij që ta ruaj dhe ta kultivoj atë si vlerë kulturore dhe si tipar identiteti”

Erëin Chargaff

“Themelin e diturisë dhe të atdhetarisë e përbën gjuha shqipe”

Mit’hat Frashëri

“Fjala e huaj në gjuhë është si dhia ndër dhen”

N. Frashëri

“Gjuha më e mirë se gjithçka tjetër jep shpesh dritën ose mjerimin e një kohe”

I. Kadare

“Gjuha shqipe ka aq pasuri fjalësh e është e ardhshme e plot gjallëri e jetë, sa mund të përkthehen në të klasikët e çdo kombi, e çdo kohe”

Gj. Fishta

“Gjuha letrare s’është vetëm thesari i kulturës sonë, por edhe mjet i fortë për mbrojtjen e etnisë shqiptare”

I. Ajeti

“Gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar”

E. Çabej

“Ka një mjet me anën e të cilit kërkimtari është në gjendje ta ndriçojë, deri-diku,

muzgun e fillimeve të popullit shqiptar dhe të hyjë në kohën që shtrihet përtej dëshmime historike. Këtë mjet e jep gjuhësia”

N. Jokl

“Larg gjuhës shqipe, larg të qenit shqiptar”

Q. Murati

“Mbrojtja e gjuhës është detyrë dhe peng nderi për çdo shqiptar”

Gj. Shkurtaç

“Viktimat e gjuhës janë më të shumta se ato të shpatës”

S. Frashëri

“Gjuha ruhet atje ku shkruhet”

Populli

“E mjera shqipe, ç’i punojnë e s’ka gjuhë të ankohet!”

T. Zavalani

“Zot! Jepu shqiptarëve vullnet dhe logjikë që të flasin shqip të paktën kur janë në Shqipëri. Se, siç kanë zënë disa, shpejt a vonë do ta bëjnë atdheun babiloni gjuhësh, ku s’do ta marrë vesh qeni të zonë”

N. Bulka

“Duke lexuar autorët që shkruajnë mirë, mësohesh të flasësh mirë”

Volter

“Ai që e zotëron gjuhën e vet vlen më tepër se ai që pushton një qytet”

Një mendimtar i lashtë

“Gjuha e keqe sjell shumë të këqija”

Latine

“Gjuha është institucion mbi të gjitha institucionet”

Heidegger

“Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është tregues i nivelit të kësaj kulture” **E. Çabej**

KRITIKA TANI NGJAN NË NJË DIGË TË SHPARTALLUAR, QË I VAREN LLAMARINAT NGA ERËRAT E FITIMIT

Dikur kritika ishte si buloni e si vida që i shtërngonte trarët e trasesë që treni i artit dhe letërsisë të mos dilte nga shinat e ideologjisë. Tani vagonat e ndryshkuara kanë dalë para trenit dhe secila me zhurmën e vet që nuk i ngjan asnjë sirene, kërkon të dalë e para dhe të zërë kryet e vendit.... Kritika aq më keq, heshtja e saj i ka bërë një dëm të madh shkëlqimit elitar të kulturës dhe letërsisë. Kritikët kanë hyrë nën sqetullat e euros, dollarit dhe lekut ...Shoqëria e kaluar mbështetej në parime ideologjike e revolucionare, e sot i mban sytë nga slloganet politike...Jo se nuk ka vepra të mirëfillta artistike dhe ato janë të pakta, kur temat janë të mëdha, por me tepër po shkruhet për fisin dhe kullën e bajrakut sesa për çështje madhore të kombit atë të bashkimit dhe njësimin kulturor, ku ushqehet palca e karakterit. Rolin më të dëmshën e bëjnë mediat që kanë mbetur pas karrocës politike duke e zvetnuar shpirtin intelektual të shoqërisë....Letërsia nuk e paqyron realitetin objektiv në ato përmasa që e kërkon koha dhe mjetet artistike janë të vobekta për shkak se gjithkush është bërë shkrimtar, poet e këngëtar. Ka një ngatërrim profesionesh dhe dikush duke mos i njohur as gjymtyrë e fjalisë nuk e pranon kritikën. Ka kopje e vjedhje të tmerrshme, sa që poetët, disa, them këtu në Kosovë, Shqipëri, diasporë, u ngjajnë rrobaqepseve të kohës së monizmit në Shqipëri/Kosovë, që i kthenin kapotat e klientëve për t'u dukur të reja. . . Pas rënies së Murit të Berlinit, ra edhe muri i kritikës. Në shoqërinë e re, kritika heshti në vend që ta orientonte letërsinë dhe kahjen e saj në dobi të shoqërisë. Kritika tani i ngjan një dige të shpartalluar, që i varen llamarinat nga erërat e fitimit...Një herë tjetër do të shkruajmë me emër dhe mbiemër për të gjithë ata shkrimtarë "të mëdhenjë", që shkruajnë libra me para për analfabetët, që s'i dijnë 36 shkronjat e shqipes.

Sugjeroni leximet e verës 2011

Stina e nxehtë tashmë ka filluar dhe së bashku me përgatitjet për pushimet e verës, menduam t'ju kërkojmë ndihmë sërish me sugjerimet tuaja, për librat dhe autorët që do t'ia vlente t'i lexonit gjatë kësaj vere nën çadrën e plazhit. Në këto dy vite, që kur e filluam këtë nismë, shumë prej jush na kanë ndihmuar me sugjerime shumë të mira çdo verë dhe prandaj e mirëpresim kontributin

tuaj edhe për këtë verë. Çfarë librash keni lexuar që ju kanë pëlqyer në mënyrë të veçantë? Çfarë librash keni në plan të lexoni këtë verë? Na sugjeroni librat dhe autorët e preferuar dhe ne do kujdesemi që t'ua kalojmë këtë informacion të gjithë vizitorëve tanë kudo që janë! Ideja është e thjeshtë! Në vend që t'jua sugjerojmë ne librat që mund të lexoni, po ju kërkohet juve të sugjeroni titujt apo autorët që do ishin me interes edhe për lexuesit e tjerë. Sugjerimet tuaja janë plotësisht të lira, e vetmja gjë që do t'ju kërkohet është që të fokusoheni kryesisht te librat e botuar në gjuhën shqipe.

Agjencioni Floripress, këtu te “Shtëpia e librit” mendojmë se shumë mendje janë më mirë se sa pak! Vera erdhi, dielli dhe deti na presin. Secili mund të zgjedhë librin që dëshiron për të lexuar në plazh dhe ne besojmë se ju mund të bëni një sugjerim të vlefshëm për të gjithë vizitorët e “Shtëpisë së Librit” mbi librin apo autorin që ju mendoni se ia vlenë të lexohet gjatë verës 2011. Gjatë muajve të fundit shumë libra të rinj i janë shtuar bibliotekës së gjuhës shqipe, qoftë nga autorët vendas, ashtu edhe nga të huaj. Kështu ne ju ftojme të sugjeroni librin apo librat, ose autorin që ju mendoni se ia vlen të lexohen gjatë kësaj vere. Do vlerësojmë edhe një shpjegim apo arsye të shkurtër pse sugjeroni që ta lexojmë librin përkatës. Ndërsa Floartpress-i dhe Librat shqip, mendonim se çfarë titujsh mund t'ju sugjeroni për të lexuar gjatë kesaj vere, vendosëm të ndryshojmë për të sugjeruar një mënyrë tjetër, mbase më interesante për të gjithë. Çështja është e thjeshtë! Në vend që ne t'ju sugjerojmë librat shqip që mund të lexoni, ju lëmë juve të na sugjeroni titujt apo autorët që do ishin me interes edhe për lexuesit e tjerë. Fundja, në këtë kontekst politiko-social ku njerëzit nuk marrin gjithnjë atë që kërkohet, ne i qëndrojmë bindjes se jeni ju ata që duhet të zgjidhni!

Pra edhe një herë, na sugjeroni librat shqip apo autorët në shqip që duhet të lexojmë gjatë verës dhe pse?

Apo

Këtë verë/korrik, gusht, shtator 2011/ përveç zgjedhjes së vendit ku do kaloni pushimet, mbase jeni duke menduar edhe për librat ose autorët, që do kishit dëshirë të lexonit. Nga ana jonë, duke dashur t'ju vijmë sado pak në ndihmë, menduam t'ju sugjerojmë një përzgjedhje librash të këndshëm që shpresojmë t'ju pëlqejnë.

“Gjuetari i balonave” dhe “Një mijë diej vezullues” nga Khaled Hosseini

“Gatopardi” nga Giuseppe Tomasi Di Lampedusa

Libra nga Daniel Steel (rreth autores)

“Byzylyku bojëshege” nga A.I. Kuprin

“Bukuroshet e fjetura” nga Jasunari Kavabata

“Bija e fatit” nga Isabel Allende

“Largësia mes nesh” nga Fiona Sampson

“Një burrë” nga Oriana Fallaçi

“Postieri i Nerudës” nga Antonio Skarmeta

“Toka e njerëzve” nga Antoine de Saint Exupery

“Vajza me vath margaritari” nga Tracy Chevalier

Ndërkohë kjo është vetëm një listë e shkurtër dhe ne nuk duam ta kufizojmë atë me kaq. Prandaj, nëse ju keni libra apo autorë të tjerë që dëshironi t’i sugjeroni, ju lutem shkruajini këtu duke vendosur titullin dhe autorin e librit, si dhe një koment të shkurtër që shpjegon arsyen pse ju ka pëlqyer.

Ideja është e thjeshtë!

Në vend që t’jua sugjerojmë ne librat që mund të lexoni, po ju kërkojmë juve të sugjeroni titujt apo autorët që do ishin me interes edhe për lexuesit e tjerë te Floripress-it. Sugjerimet tuaja janë plotësisht të lira, e vetmja gjë që do t’ju kërkonim është që të fokusoheni kryesisht te librat e botuar në gjuhën shqipe. Mos harroni t’i shkruani ato këtu poshtë te komentet. Falënderit!

Etnosi shqiptar në internet

Gjuha shqipe sot flitet në Shqipëri dhe jashtë kufijve të saj në Kosovë, në territorin ndërmjet Shkupit, Gostivarit, Tetovës dhe Dibrës, në Preshevë, në Bujanovc dhe në Medvegjë, në Krajë, në Ulqin me rrethina deri në Tivar dhe në Çamëri. Shqipja, pra, flitet në viset perëndimore të Ballkanit, aty ku kryqëzohen rrugët që lidhin lindjen me perëndimin, pikërisht në atë rajon që ka qenë djepi i qytetërimit antik evropian. Gjithashtu, shqipja flitet edhe në diasporë (në Itali, në Greqi, në Bullgari, në Ukrainë), edhe në shumë vende të tjera të kontinentit tonë dhe më gjerë, në Amerikë, në Azi dhe në Australi nga shqiptarë të vendosur atje në kohë më të hershme ose më të vonshme. Gjuha shqipe i përket familjes së gjuhëve indoevropiane. Rreth dy mijë fjalë të shqipes janë me origjinë indoevropiane: kokë, ditë, natë, dimër, ujë, ha, pi, jam, kam, zog, dem, elb etj. Shqipja formon një de-gë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane. Gjuha shqipe pra nuk ka lidhje birërie me asnjërën nga gjuhët e sotme indoevropiane. Territori shqiptar ka qenë i banuar që nga paleolitiku i mesëm (100000 - 40000 vjet para erës sonë). Gjurmët e para të rëndësishme të qytetërimit i përkasin neolitit (6000-2000 vjet para erës sonë). Në fillimet e kohës së bronzit fiset ilire shfaqen në një territor të gjerë që shtrihej nga gadishulli i Istrias në veri

deri në gjirin e Artës në jug. Në lindje, kufiri i tyre shtrihej afërsisht deri te lumenjtë Vardari e Morava. Popullsia ilire është formuar nga popullsi autoktone të epokës së neolitit, pas ardhjes së popullsive indoevropiane aty nga fundi i mijëvjeçarit të tretë para erës sonë. Pra, Ilirët përbënin një popullsi shumë të vjetër të vendosur në perëndim të Ballkanit. Emrat e dy fiseve ilire, Pajonëve dhe Thesprotëve, i gjejmë tek “Iliada” dhe “Odiseja” e Homerit. Kjo popullsi del me ketë emër në shekullin e pestë para erës sonë. Në rrethinat e Durrachium-it (Durrësi i sotëm) u formua nyja e Shtetit të parë Ilir. Gjuha e kësaj popullsie ishte ilirishtja.

Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe gjuha shqipe pasardhëse e ilirishtes.

Nga kjo gjuhë nuk kanë mbetur veçse pak fjalë të cilat mund të shpjegohen me gjuhën shqipe dhe konkretisht sika = thika, peli = pleq, aspetos = i shpejtë. Edhe disa emra gjeografikë dhe emra perso-nash ilirë mund të shpjegohen me fjalë të shqipes. Kështu p.sh. Dardania është shpjeguar me shqipen dardhë, Dalmatia me shqipen del me, dele, Ulkin me shqipen ulk, ujk, Dimalum me shqipen di mal dy male, Bardhul me shqipen i bardhë, Daz me shqipen dash. Në vitin 168 para erës sonë, Iliria u pushtua nga romakët. Filloi kështu një periudhë pushtimi që zgjati për më shumë se pesë shekuj. Në shekullin e VII Shqipëria u pushtua nga sllavët, kurse në shekullin XV nga turqit otomanë. Pushtimi otoman vazhdoi pesë shekuj deri më 28 nëntor 1912. Në Mesjetë, popullsia e territoreve të populluara nga fiset ilire, quhej Albanoi dhe vendi Albanon, prej nga ka dalë forma popullore Arbënesh ose Arbëresh.

Emrat e sotëm, Shqipëri, shqiptar, shqip, janë shfaqur në shekullin XVII.

Gjatë kësaj periudhe të gjatë pushtimi, gjuha dhe kultura shqiptare kanë qenë nën ndikimin e gjuhës e të kulturës latine, greko-bizantine, sllave e turke. Gjenden në shqipe fjalë me origjinë nga greqishtja e vjetër, latinishtja, greqishtja bizantine, sllavishtja, turqishtja etj. Nga greqishtja e vjetër kanë hyrë fjalë të tilla si: drapër, lakër, qer-shi, shpellë; nga latinishtja: arë, kalë, mbret, furkë, ungj,- nga greqi-shtja bizantine: fis, ikonë, kollogjer, manastir; nga sllavishtja: gjobë, lopatë, pushkë, opingë, rob, si edhe toponime: Berat (bel+grad), Dropull (Drino+polje), Konispol (kon+polje), Velipojë (veliko+polje), Zadrinë (za+Drin), Zagori (za+gor); nga turqishtja: tepsi, pazar, cohë, bahçe, oxhak, sobë, jastëk, ilaç etj. Është e vërtetë që shqipja ka pësuar ndikime nga gjuhët e

huaja, sidomos në leksik, po është po kaq e vërtetë që ajo ka shfaqur aftësi për t'i asimiluar dhe ndryshuar sipas modelit të vet huazimet, duke treguar forcën dhe gjallërinë e saj. Kështu fjalët e greqishtes së vjetër drapanon, kerasia, spileon në shqip dalin drapër, qershi, shpellë,- në latinisht arvum, vicinium, impertorem në shqip arë, fqinj, mbret,- në sllavisht glob, opanak, ravnica në shqip gjobë, opingë, rrafshë. Gjithsesi gjatë periudhës që vendi ynë, kultura jonë, gjuha jonë ishin nën influencën e kulturës e të gjuhës latine, greko-bizantine, sllave e turke, gjuha shqipe ka ruajtur origjinalitetin e saj si gjuhë indoevropiane me strukturë fonetike, gramatikore e leksikore të veçantë. Në historinë e Shqipërisë dhe të shqiptarëve Rilindaj shqiptare (XIX-XX) zë një vend të veçantë. Gjatë kësaj periudhe, problemet e gjuhës u bënë pjesë përbërëse e programit të Rilindjes shqiptare, e cila, me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit (1878) hodhi bazat për zgjidhjen e problemit të alfabetit të gjuhës shqipe, i cili përfundimisht u zgjidh në Kongresin e Manastirit më 1908. Në bazë të alfabetit të gjuhës shqipe është alfabeti latin. Dokumentet e para të shkruara të shqipes i përkasin shekullit XIV. Libri i parë i shkruar është “Meshari” i Gjon Buzukut që i përket gjysmës së dytë të shek. XVI (1555). Ka mundësi që tradita e shkrimit të shqipes të ketë qenë më e vjetër. Shqipja është shkruar në dy dialekte kryesore, në gegërisht dhe në toskërisht. Vepra e parë toskërisht është “E mbësuar e krishterë”, shkruar nga Lukë Matrënga dhe botuar në Romë më 1592. Shqipja ka vazhduar të shkruhet në dy dialekte deri më 1972, kur toskërishtja letrare u shpall gjuhë letrare kombëtare ose gjuhë letrare e njësuar.

Letërsia Shqiptare

Në fillimet e letërsisë shqiptare janë veprat e Marin Barletit (“Historia e Skënderbeut”, 1508) dhe të humanistëve të tjerë, të botuara latinisht. Libri i parë shqip është “Me-shari” (1555) i Gjon Buzukut. Letërsia e vjetër përfaqësohet nga vepra fetare, por që ishin shpre-hje e qëndresës kundër sundimit osman. Autorët më të rëndësishëm ishin Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani dhe te arbëreshët e Italisë Lekë Matrënga e Jul Variboba. Në shek. XVIII-XIX lindi rryma e bejtexhinjve, e ndikuar nga i letërsia orientale, por në veprat e poetëve më të shquar kishte edhe tema laike e nota shoqërore (Hasan Zyko Kamberi, Nezim Frakulla, Zenel Bastari etj). Letërsia e re kombëtare nis afër mesit të shek. XIX lidhur me lëvizjen e gjerë për glirimin nga sundimi I huaj dhe prandaj quhet letërsia e Rilindjes Kombëtare. Ajo pati një drejtim iluminist e në periudhën e fundit edhe vepra realiste, por në të mbisundoi romantizmi, bashkëkohës me romantizmin europian. U lëvrua sidomos poezia. Kjo ishte një letërsi me frymë

demokratike e popullore, tema themelore ishte dashuria por atdheun, evokimi i të kaluarës heroike dhe lufta për çlirim kombëtar e shoqëror. Te arbëreshët e Italisë u shquan Jeronim De Rada me poemën “Këngët e Milosaos” (1836) e një varg veprash të mëdha poetike, Gavril Dara i Riu me poemën “Kënga e Sprasme e Balës”, Françesk Anton Santori, Zef Serembe etj. Poeti i madh kombëtar i kësaj periudhe është Naim Frashëri, autor i poemës “Bagëti e Bujqësia” (1886), i “Historisë së Skënderbeut” në vargje dhe i shumë krijimeve të tjera patriotike, lirike e filozofike. Figura të tjera të shquara janë poeti lirik e satirik Andon Zako Çajupi (“Baba Tomori”, 1902), poetët Ndre Mjeda, Aleksandër Stavër Drenova (Asdreni), novelisti Mihal Grameno etj. Pas shpalljes së Pavarësisë (1912) letërsia e zhvilloi më tej frymën atdhetare të Rilindjes Kombëtare dhe në vitet 20-30 thellohet realizmi, karakteri demokratik, problematika shoqërore. Përfaqësues i shquar i rrymës demo-kratike është Fan Noli, figurë politike por edhe poet, publicist e përkthyes. Lirik i njohur i kohës është Lasgush Poradeci. Nga ana tjetër një figurë qendrore e letërsisë dhe e publicistikës ishte At Gjergj Fishta. Ndër prozatorët janë romancierët Ndoc Nikaj, Foqion Postoli dhe Haki Stërmilli. Kulmin e realizmit kritik, me pasqyrimin e gjendjes së masave më të varfëra dhe me theks të fortë të revoltës shoqërore e shënon krijimtaria në poezi dhe në prozë e Migjenit (“Vargjet e lira”, 1935). Faik Konica ndërkohë ishte një kritik letrar me veprimtari shumë të zgjeruar publicistike që ndikoi jo pak në këtë letërsi. Një etapë cilësisht e re në letërsinë shqiptare zë fill në vitet e Luftës ANÇ dhe mori zhvillim të plotë pas Çlirimit si letërsi e realizmit socialist. Në shtypin ilegal, si shprehje e qëndresës antifashiste, u lëvrua një letërsi revolucionare, kryesisht poezia qytetare e patriotike. Poema satirike “Epepeja e Ballit Kombëtar” (1944) e Shefqet Musarajt është krijimi më i shquar i kësaj kohe. Pas Çlirimit pothuajse e tërë letërsia ishte e kontrolluar nga çensura e shtetit. Hapësirat në cilat shtrihej letërsia e asaj kohe ishin të ngushta dhe plot rezik për autorët. Shumë prej tyre si Kasem Trebeshina, Dhimitër Xhuvani, Petro Marko e të tjerë u dënuan nga Partia në fuqi. Shkrimtarë të tjerë si Ismail Kadare, Jakov Xoxa e plot të tjerë shkruanin të vertetat e tyre të fshehura pas një sensi të dyzuar. Megjithatë edhe gjatë periudhës së Socializmit lindi dhe u zhvillua një letërsi e mirëfilltë e cila edhe pse nën çensurë, krijoi dhe u konfirmua. Në vitet e fundit të agonisë socialiste edhe letërsia filloi të shfaqej më hapur dhe të mbante një qëndrim kritik herë hapur e herë të nënkuptuar. Pas diktaturës letërsia shqiptare pati njëfarë mpirjeje. Brezi i ri i shkrimtarëve solli një frymë të re realiste sidomos në poezi. Liria në shkrim solli një dyndje veprash letrare, por vetëm pak prej tyre ishin të një niveli të pëlqyeshëm. Peshën më të madhe e mbajtën akoma shkrimtarët e periudhës së Pas Luftës. Shkrimtarë

si Diana Çuli, Visar Zhiti, Besnik Mustafaj, e plotë të tjerë vezulluan në këtë periudhë. Në poezi u shquan Mimoza Ahmeti dhe ndër më të rinjtë Etvin Hatibi. Vlen të përmendet që periudha e Post Diktaturës pati vlera të veçanta sidomos përsa i përket ribotimit të veprave që çensura komuniste i kishte ndaluar apo i kishte cinguar. U botuan të plota veprat e rilindësve, e Gjergj Fishtës, Faik Konicës, Lasgush Poradecit, Mitrush Kutelit etj. U botuan veprat e ndaluara dhe të dënuara gjatë sundimit komunist të shkrimtarëve Petro Marko, Pjetër Arbnori, Fatos Lubonja, Kasëm Trebeshina, Dhimitër Xhuvani, Visar Zhiti e shumë të tjerë.

Folklori shqiptar

Detyrë kryesore e folklorit dhe e folkloristikës është mbledhja dhe studimi i traditave popullore, duke nënkuptuar për traditë jo vetëm besimet dhe opinionin që ka populli i pakultivuar për faktet dhe dukuritë e universit, por edhe zakonet e përditshme, për ceremonitë e festave të ndryshme, si edhe manifestimet estetike të çfarëdo lloji. Kur flasim për zanafillën e folklorit, duhet ta kemi të qartë se ai nuk lind vetëm, por së bashku me elemente të tjera me të cilat është i lidhur, kështu ai lind edhe me elemente që i përkasin etnografisë (zakone, ritet e ndryshme etj.), që i përkasin muzikës, valles etj. Dhe i parë në këtë tërësi, si dukuri artistike dhe jetësore lidhur me jetën e njeriut primitiv, mund të themi se folklori është i vjetër sa vetë njeriu. Ai lindi si një nevojë e brendshme e këtij njeriu primitiv, në krye, jo si dukuri artistike e pastër, por si një fenomen që ishte i lidhur drejtpërdrejt me jetën e tij, me mbijetesën e tij, me sigurinë për jetën etj. Me një fjalë, e thënë ndryshe, njeriu primitiv, i pafuqishëm në mes të forcave të ndryshme të realitetit, duke e menduar botën të populluar nga shpirtra (faza e animizimit), nga shpirtra që ishin në të mirë të tij, që, së paku kështu i ngjante atij, e ndihmonin për të kapërcyer vështirësitë që ai haste në jetë, që e ruanin nga e keqja, rreziqet e jetës, e ruanin nga sëmundja, e ruanin nga thatësira, i falnin pjellori si atij ashtu edhe tokës, por edhe shpirtra që ishin të ligj, që, së paku kështu i ngjante atij, kishin ngritur pusi dhe donin ta goditnin nga çasti në çast, shpirtra ziliqarë e tekanjozë, që mund t'i dërgonin sëmundjet dhe vdekjen, mund të bënin që prodhimet të mos ishin të mbara, që gjahu të mos ishte i mbarë etj. Për t'u dalë përpara këtyre fatkeqësive, për të siguruar shëndet e pjellori si për vete ashtu edhe për natyrën, njeriu primitiv u mundua me anë të lutjeve dhe yshtjeve magjike, të bëjë për vete shpirtrat dhe të ruhet nga çdo e ligë. Pikërisht nga këto rite primitive fetare e magjike lindin krijimet e para folklorike. Një gjë e tillë mund të hetohet edhe sot në popujt primitive të Afrikës

apo të Amerikës së Jugut, ku riti magjik është ende i gjallë dhe kryhet me anë krijimesh të vërteta folklorike. Nga ana tjetër, kjo mund të vërehet te mbeturinat e këtyre riteve magjike që kanë arritur gjer në ditët tona dhe që duhen pasur parasysh kur duam të shpjegojmë, edhe në folklorin tonë, shumë këngë të vjetra që na kanë mbetur si nga ritet e motmotit ashtu edhe në shumë këngë të lidhura me ritet e dasmës etj. Nga këto që thamë, kuptohet se folklori lindi në gji të natyrës dhe mes njerëzve që jetonin në gji të natyrës, mes atyre që punonin tokën apo mbarështronin bagëtimë dhe jetonin me këto prodhime, pra lindi e u zhvillua në mes të fshatarëve. Më pas krijimet folklorike, edhe pse njeriu përparoi dhe shkenca bëri të vetën, duke lehtësuar jetën e punën e njeriut, nuk u shuan, ndonëse karakteri i tyre ritual e magjik erdhi përherë e me tepër duke u pakësuar në mos zhdukur fare. Në këtë fazë të dytë, në kohën e qytetërimit, krijimi folklorik është më shumë një vepër artistike se sa një veper rituale fetare. Kjo shpjegon, nga ana tjetër, jetëgjatësinë e folklorit, ruajtjen e tij deri në ditët tona, madje dhe gjallërinë e tij në mjaft aspekte, sidomos si mbështetës për artin e kultivuar. Dalngadalë lindën edhe njerëz që merreshin kryesisht me krijimin e këtyre këngëve popullore: të tillë mund të përmendim aedët, rapsodët, trubadurët, truverët, menestrelët etj. dke filluar nga Homeri e duke mbaruar deri te Osiani skoces e deri te rapsodët e këngëtarët tanë. Tashti folklori është një krijim artistik që kryen një funksion krejt tjetër nga ai i pari. Megjithatë shtresa e parë e folklorit (legjendat, këngët e riteve, përrallat, proverbat etj.) mbetet një relike e fosile të gjalla këto krijime ruhen e kalohen ende sot e kësaj dite nga një brez në tjetrin jo vetëm si vepra artistike, por edhe si elemente të qenësishme që flasin për origjinalitetin e një kombi, për identitetin kombëtar të një populli.

Muzika popullore

Një studim sistematik i muzikës tradicionale shqiptare u bë i mundur vetëm në fillimet e viteve '30 falë muzikologut Y. Arabatski i cili mblodhi këngë dhe melodi popullore shqiptare. Për shkak të formimit të veçantë malor të vendit dhe për shkak të vështirësive të lidhjeve e cila kushtëzohej nga mungesa e rrugëve të komunikimit, muzika shqiptare ka ruajtur të paprekura karakteristikat dhe format e saj deri në vund të viteve 1800. Mungesa e ndikimeve është më e qartë nëse shihet në lidhje me arbëreshët e Italisë. Bashkësitë e formuara nga pasardhësit e shqiptarëve të cilët u larguan nga Shqipëria në mesin e dytë të viteve 1.400 për të mos rënë nën zgjedhën turke dhe që kanë ruajtur gjuhën e tyre dhe traditat e tyre muzikore. Studimet e Arabatski-t u zhvilluan nëpërmjet përmbledhjeve të regjistruimeve fonografike të shtrira në të gjithë territorin e Shqipërisë, të cilat

ishin realizuar nga studiuesit e folklorit dhe të etnomuzikologjisë rreth viteve '50.

Polifonia vokale

Shqipëria dallohet nga ana muzikore për një traditë të pasur në polifoninë vokale. Ky tip melodish polifonike zakonisht këndohet nga dy, tre apo katër zëra, të ndjekura nga një kor burrash apo nga një kor grash, pa shoqërim instrumental. Por kemi edhe melodi të kënduara nga zëra të ndërthurrur, të cilat edhe pse kanë ekzistuar edhe me parë kanë marrë më tepër zhvillim pas çlirimit të Shqipërisë. Polifonia vokale shtrihet në pjesën mesdhetare të Shqipërisë nga lumi Shkumbin deri në Çamëri. Kjo zonë ndahet më pas në dy sisteme polifonikë. Sistemi Lab që përfshin rrethin e Tepelenës, Vlorës, Gjirokastrës dhe një pjesë të Sarandës, dhe sistemi Toskë që nis nga lumi Vjosë dhe deri në lumin Shkumbin duke prekur rrethinat e Strugës, Ohrit, dhe deri në Prespë në Maqedoni. Nëse sistemi Lab dallohet për ndryshimin e thellë mes zërave, sistemi Toskë përkundrazi përmban një ritëm të lirë dhe një ecuri të zërave me intervale muzikore më dalluese dhe me shoqërime që pasurojnë meloditë. Repertori i tyre është i ndërtuar më së shumti nga këngë historike me karakter të theksuar nacionalist dhe nga këngë me origjinë fshatare për dashurinë, shpotitëse apo ninulla.

Muzika instrumentale

Muzika instrumentale shqiptare shoqëron këngët e vallet dhe përbën atë orkestër që quhet "Saze". Në përgjithësi në veri të vendit zë vend të dukshëm një formë radikale muzikore e këngëve epike, më të vjetrat e të cilave janë Rapsoditë për Kreshnikët. Këngëtari (rapsodi) shoqërohet nga vegla muzikore me tela, ndërsa në Jug pikërisht për gjurmën polifonike të këngëve, funksioni i instrumenteve është i drejtuar drejt një virtuizmi. Instrumentet e frymës përdoren në të gjithë vendin. Instrumentet shqiptare kanë një shpërndarje heterogjene dhe shpesh nga struktura dhe teknika e përdorimit nuk përputhen më traditën e folklorit të popujve fqinjëve. Si shembull mund të përmendim "Lahutën" (instrument një tel që realizohet me hark), "Bakllamaja" (instrument me tre tela i përdorur në zonën e Korçës dhe Pogradecit), "Çiftelia" (instrument me dy tela shumë i përdorur në gjithë vendin, sidomos në Veri), "Sharkia" (instrument me pesë tela që përdoret për të shoqëruar vallet në Kosovë), "Buzuku" (instrument me gjashtë tela), Fyelli (culedjaria, instrumenti me antik i Shqipërisë i përmendur që në shekullin e V apo të VI para erës së re), Bilbili (që imiton timbrin dhe cicërimin

e zogjve), Kavalli (instrument me origjinë baritore), Surla (përdoret në muzikën e karakterit epik) dhe në fund tamburet e përmasave të ndryshme Daullja dhe Lodra që shoqërojnë këngët dhe vallet pothuajse në të gjithë vendin.

Muzikantët

Qëndrat më të rëndësishme të shpërndarjes për formimin e muzikantëve që aktualisht janë prezentë në skenën artistike shqiptare janë, qyteti i Korçës ku mund të përmendim Eli Farën, këngëtarja më e dashur dhe më e famshme e Jugut të vendit, e njohur edhe jashtë Shqipërisë për turnetë e shumta; qyteti i vogël malor Permeti ku kanë lindur dy muzikantë të njohur popullorë, klarinetisti Laver Bariu i cili akoma jeton në qytetin e Përmetit dhe Remzi Lela i cili tani jeton në Tiranë dhe është lideri i grupit që shënon numrin më të madh të regjistrimeve muzikore të viteve të fundit, Familja Lela nga Përmeti. Përsa i përket traditës së këngës epike në Veri të vendit mund të përmendim këngëtarin dhe muzikantin me sharki z.Bytyçi.

Organizimi

Vlerësimi dhe përhapja e trashëgimisë muzikore shqiptare i ka mbijetuar edhe skemave të diktaturës komuniste. Orkestrat tradicionale janë zgjeruar edhe me instrumente të tjera si kitara dhe fizarmonika dhe se fundi edhe instrumente elektronike si organo. Një takim me rëndësi ka qenë për shumë kohë Festivali i Gjirokastrës i cili pas disa vjet ndërprerjeje ka filluar të zhvillohet përsëri. Ky festival zhvillohej çdo 5 vjet nga Radio Televizioni Shqiptar dhe ishte një aktivitet që afronte brezat e vjetër dhe të rinj të këngëtarëve popullorë nga krahina të ndryshme.

Fjalë të urta shqipe

Proverbat janë fraza të shkurtra që shprehim me pak fjalë filozofinë popullore (urtinë popullore). Pikërisht për këtë, ato thirren nga popufi edhe fjalë të urta. Proverbat janë të përhapur në të gjithë botën dhe nuk ka dyshim se midis tyre hasen edhe ngjashmëri apo identitete. Megjithatë, çdo popull ka proverbat e tij, të ndërtuara sipas psikologjisë dhe përvojës së tij jetësore, filozofike e historike. Nganjëhere është e lehtë të caktohet pak a shumë një moshë për një proverb të caktuar, por në më të shumtën është e vështirë aq më tepër që në rrymë të

kohës, proverbat edhe evoluojnë e mund të marrin edhe trajta disi të ndryshme. Kështu p.sh., për proverbat që përmend Bardhi në librin e tij (ta zemë, “Ku shkel turku, nuk mbin bar”), mund të themi se së paku ato datojnë që nga viti 1635, ndonëse mund të jenë edhe më të vjetër. Një proverb si “Harro mushkë Valarenë se Ali Pashanë na e prenë” duhet të jetë së paku i vitit 1822. Si rregur një proverb që haset në Shqipëri, haset pak a shumë i njëjtë te arbëreshët e Italisë etj. duhet të jetë i vjetër së paku duke datuar nga shekulli i largimit të arbëreshëve nga Shqipëria. Kështu, p.sh., ndodh me proverbin “Lisi bën mëkan’ e dega e klá” (De Rada 1866) që haset edhe te Mitko e Dine “Lisat bënë mëkata, degatë qajnë” (Dine, 1908) etj. Edhe prania e turqizmeve mund të jetë dëshmi e moshës: të tillë proverba mund të kenë lindur pas pushtimit otoman të Shqipërisë, por kjo nuk largon mundësinë që këto proverba të kenë lindur më parë e më pas të kenë pësuar këtë transformim të lehtë që nuk prek brendinë, por vetëm anën e jashtme. Të tillë proverba mund të jenë, p.sh., “Gjën’e neqezit e gëzon xhymerti”, “Kush të det me ba sefa, gjen dehallin ndë shtëpi”, “Gjëj’e turkut, haj’ e ujkut etj. Interesant është në këtë vështrim, mbasi tregon pikërisht fazën e evoluimit të tij, proverbi që hasim te “Dorëshkrimi i Pragës” i Mitkos: “Goja verë, barku grunar” që në popull sot haset në formën “Goja behar, barku grunar”. Nuk është çudi që korrigjimin prej puristi ta ketë bërë Mitkoja, mbasi te Dineja proverbin e gjejmë në formën e dytë, pra me turqizma. Proverbat hasen në formën e një vargu apo të dy deri tri vargjeve si edhe në formën e një fraze në prozë. Është mirë, ndërkaq, që të mos ngatërrohet proverbi me shprehjen popullore, mbasi proverbi, veç të tjerave, ka një kuptim të plotë në vetvete, kurse frazeologjia është një shprehje që e merr kuptimin kur lidhet me një frazë tjetër, bëhet pjesë e kësaj fraze, mbasi në vetvete nuk është e mbaruar si frazë. Kështu, p.sh., “për mustaqet e Çelos është një shprehje frazeologjike e jo një proverb. Proverbat shqiptarë janë të pasur me mendime dhe shprehin përvojë të gjatë. Ata janë përhapur në tërë Shqipërinë, por duhet thënë se Kruja e malësia e saj shquhen për proverba me të vërtetë të bukur dhe të ndërtuar me hollësi artistike (p.sh., “Gjithkuj ia di trani e carani”, “Rrena qet tym, e vërteta flakë”, “Në rranxa gjinet fullanxa”, “Pyka e re shtyn të vjetrën”, “Byrekun që s’e ha, për mue u djegtë”, “Peshk’ pa halë e shpi pa fjalë, s’ka” etj.). Proverbat flasin për dukuri dhe situata të ndryshme në jetën e njeriut. Në to shpaloset qartë filozofia e popullit dhe në gjejmë në to vlerësime për shumë dukuri e anë të jetës. Në këtë vështrim ato janë mësim të vërteta megjithatë do të ishte punë e kotë të orvateshe e të gjeje një konsekuencë të plotë në të gjitha proverbat: shpeshherë për të njëjtën dukuri mund të hasen vlerësime të ndryshme, madje edhe të kundërta. Kjo vjen nga fakti se proverbat janë krijuar nga njerëz e shtresa

të ndryshme dhe për këtë nganjëherë është e vështirë të shmangen ndryshimet. Sidoqoftë ka proverba që flasin për jetën, për dukuri shoqërore për natyrën e njeriut, për cilësitë dhe të metat e tij, për natyrën, për familjen, për detyrat e secilit etj. Madje, shpesh, mbledhësit e folklorit përpiqen t'i renditin ato duke i ndarë në grupe sipas tematikës që ato trajtojnë. Kështu veprojnë një pjesë, mbasi një pjesë tjetër i rendit sipas rendit alfabetik (duke marrë për bazë fjalën e parë) duke qënë se mendojnë që proverbat nuk mund të kufizohen nga ana tematike, mbasi përdorimi i tyre në praktikë nuk njeh tematikë dhe praktikisht përshtatet në mënyrë figurative për shumë situata e dukuri të ndryshme. Sidoqoftë një farë organizimi i tyre nevojitet kur ato mblidhen për të bërë më të volitshëm përdorimin e tyre. Kështu veprojnë mbledhësit më të shquar të proverbave tanë, siç kanë qënë Kolë Kamsi me “Goja e popullit” (1943), Sotir Kolea me “Një tufë proverba” (1944) etj.

Përsa u përket formave të proverbave mund të përmendim disa prej tyre...

1) Një varg i thjeshtë i ndarë në dy hemistëkë të rimuar:

Buk' e hi e ndë shtëpi. Gjen shesh, bën përshesh. Ferra e nisi, ferra e grisi.

Po mund të jenë edhe dy vargje:

Bukuria s'është për fis,/ po kush di e kullandris. Kurë nuk e ke zanat,/ mos u bën hoxhë në fshat.

Edhe tristikët nuk janë të rrallë:

Ia dha drurit, u tha,/ ia dha gurit, u ça,/ ia dha njeriut - dhe e mbajti. Ku hanë e s'apin, ku flet e s'të dëgjojnë,/ zot ynë mos të shtiftë!

Në te gjitha këto raste, vargjet dhe sidomos rimat, janë mjete mnemoteknike (që shërbejnë për kujtesën, për t'i mbajtur mend). Sidoqoftë është me vend të themi këtu që zakonisht me anë të rimës (qoftë kjo edhe e brendshme) vihen në dukje fjalët më të rëndësishme, ato që bartin idenë e proverbit. Shembujt e mësipërm e tregojnë këtë. Ja dhe një shembull me një rimë të brendshme të qartë: “Nëma e solli, gjëma e mori”.

2) Vendin e rimës mund ta zërë aliteracioni, ky jo vetëm në proverba që kanë formën e vargut po edhe në ato që kanë formën e një fraze në prozë.

Çdo mizë nuk bën mjaltë. Ngordhi macja, u ngjall miu. Ka të keqen e kalorësit, se i varen këmbët.

3) Shpesh hasen proverba në formë antiteze, kontrasti: Bëri të pjellë, dështoi.

Vdis pa të dua. Keq me burrë, keq pa burrë.

4) Formë tepër e përdorur është ajo e pyetjes.

Ku di dhia ç'është tagjia? Ç'la dimri të marrë mortja?

Ka raste kur pyetja ka edhe përgjigjen të shprehur: Zure gjarprin? Shtypi kokën. Polli kau? Të rruat viçi.

5) Herë-herë proverbi ka formën e një morali fabule.

Në mos gjeça konop gjetiu, po vi Pashë e virrem te ti. Miun s'e nxinte vëra, hiqte dhe kungullin pas. Shumë herë dhe dhelpra q'është aqë dinake, zihet për katër këmbësh. Shpinin ulkun ta pagëzonjën e ay u thosh: "Ja dhentë tek na turbullojnë ujët!"

6) Shpesh proverbi ka formën e një rregulle jete apo të një neni të kanunit të maleve:

Gusht e gunë. Prilli këndon bilbili. Marsi çan lëkurët shkurti shkurton urët. Gjaku ujë s'bëhet. Gjumi i tepërt, rroba të vjetra.

Shpeshherë proverbat kalojnë nga letërsia e shkruar dhe bëhen popullore. Shumë vargje të N.Frashërit janë bërë proverba (Punë, punë natë e ditë që të shohim pakëz dritë). Një proverb që e gjejmë te Mitkoja "Duaj, të të duan" duket qartë se vjen nga Shën Agostini "Si vis amari, ama" etj. në të tilla raste kemi maksima që kthehen e bëhen proverba popullore..

Humori shqiptar

Folklori shqiptar është i pasur me elemente të së qeshurës. Nuk gabojmë në se themi se ajoo që mbisundon në këngët e vallet tona është drita, optimizmi. Këtu pa tjetër ka ndikuar edhe vetë natyra e vendit, shkëlqimi i diellit, qartësia e qiellit që sundon në pjesën më të madhe të vitit, karakteristikë kjo e gjithë viseve rreth e qark Mesdheut. Te qeshurën e hasim për këtë në shumë aspekte të folklorit që pasqyrojnë çaste të ndryshme të jetës së njeriut. Dhe kjo jo vetëm, p.sh., në këngët e dasmës, ku prania e humorit ngjan plotësisht e justifikuar, por edhe në mjaft këngë të llojit "serioz", siç mund të jenë këngët historike, këngët e trimërisë etj. Megjithatë duhet thënë se në folklor ka zhanre të saj në të cilat spikat më shumë komikja, e cila edhe këtu është e dy llojeve; ajo paraqitet në formën e humorit, ku vihet në lojë, kritikohet lehtë diçka e një personi apo veprimi të cilin në përgjithësi ne e duam, madje në të tilla raste humori mund të jetë një mënyrë e shprehjes së kësaj dashurie; edhe në formën e satirës, ku vihet, në lojë e kritikohet një person apo një dukuri që është krejt i papranueshëm për ne.

Ja disa shembuj. Te kënga e parë, humori bëhet me flokët e vajzës:

Mori e mira flokët e ngata
shkurtoi pak sat' doket qafa!

Kurse te shembulli i dytë, humori që fsheh dashurinë bëhet me anë të rimës së vazhdueshme dhe fjalëve turqisht:

A çua Rushja në saba,
kapi sitën me bismila...

-Bismilahi, mori sitë,
me durë t'bardha ta kam ngjitë.

Të qeshurit është i përhapur në folklorin e të gjitha krahinave tona. Kjo është një karakteristikë e vetë psikologjisë së shqiptarit që di të shohë anën komike dhe në dukuri që për nga natyra nuk janë të tilla. Edhe vetë karakteri i gjuhës shqipe, ku shpesh fjalët kanë apo marrin lehtë kuptim të dyfishtë humoristik, ndihmon në këtë. Megjithëse ende pa u mbështetur në hulumtime më të plota, mund të thuhet se shquan mbi të gjithë humori shkodran, spontan dhe i mençur, humori dibran, herë-herë tepër i fshehur (veçohet në këtë mes humori i fshatit Muhur), humori myzeqar që buron në më të shumtën nga situata dhe batuta në dukje jo të mënçura apo të një mençurie të maskuar me budallallëk (humori i shejtan-budallait), humori gjirokastrit dhe ai i Tiranës mbështetur më shumë në lodrën e nëndialektit etj. Dihet se te qeshurit sjell me vete një kritikë të lehtë apo të rëndë, sipas rastit, për një person apo për një veprim të caktuar etj. -Humori i popullit tonë nuk bën përjashtim. Madje duhet thënë se përpara këtij humori nuk ka tabura, persona, veprime a dukuri të paprekshme. Ai mban qëndrim dhe ve në lojë çdo gjë që nuk pranohet prej tij qoftë tërësisht, qoftë pjesërisht. Siç është lehtë e kuptueshme, është vështirë të gjesh në tërë këtë një filozofi të vetme, tepër solide e tepër kompakte. Edhe pse një fill qëndror ekziston në vija të përgjithshme, nuancat e kësaj filozofie janë të shumta, mbasi psikologjitë dhe mentalitetet që e përbëjnë janë të shumta e të ndryshme. Megjithatë mund të thuhet në vija të përgjithshme se në folklorin tonë vihen në lojë veset-gënjeshtër, përtacia, mëndjemadhësia, egoizmi etj; vihen në lojë ata që të presin në besë, por edhe ata që gënjehen lehtë; ata që me rrobën e sundimtarit shtypin të tjerët, por edhe ata që ulin zverkun dhe i nënshtrohen fatit, ata që nuk dinë ç'është miqësia, por edhe ata që për "mikun" janë gati t'i venë flakën shtëpisë; ata që janë armiq të lirisë, shtypës të popullit, por edhe ata që janë gati të jetojnë si derrat pa ndier nevojën e lirisë; ata që nuk dinë ç'është frika e Perëndisë, por edhe ata që janë fanatikë të tërbuar etj.

Legjenda shqiptare

Epika popullore mund të ndahet, përveç përrallave, anekdotave dhe fabulave, edhe në dy grupe të tjerë të mëdhenj: në 1) Epikën legjendare dhe 2) Epikën historike. Në epikën legjendare hyjnë këngët e ndryshme legjendare (duke përfshire këtu edhe Ciklin e Kreshnikëve), ndërsa në epikën historike hyjnë këngët që na fiasin për ngjarje e personalitete të ndryshme të historisë sonë, duke nisur nga Skënderbeu dhe duke ardhur deri në ngjarjet më të fundit historike. Është e udhës ndërkaq, që para se të nisim nga studimi i këngëve legjendare, të ndalemi te vetë lëgjetat. Legjendat, ose gojëdhënat janë tregime disi të çuditshme nga të cilat ngjarjet që mund të kenë një bazë historike deformohen nga imagjinata popullore. Ka legjenda që janë lidhur me emra vendesh, lumenjsh, bimësh etj. Ka raste, pra, që nuk kemi këngë, por tregime të thjeshta për shpjegimin e një emri apo toponimi. Legjenda të tilla, që thuhet në prozë, ka shumë në popullin tonë, megjithëse ato janë mbledhur ende pak. Këto legjenda është bërë zakon të ndahen në

- 1) legjenda të metamorfozës (legjenda kozmogonike, mitike) dhe në
- 2) legjenda historike.

Legjendat e metamorfozës na flasin për zanafillën e shumë dukurive apo objekteve të realitetit. Këto, pa dyshim, janë nga legjendat më të vjetra, dhe mjaft prej tyre, janë të lidhura me fazat, më të hershme të njerëzimit, me paganizmin e parapaganizmin. Të tilla legjenda për nga natyra e tyre të kujtojnë së tepërmi “Metamorfozat” e Ovidit. Ashtu si dhe te metamorfozat e Ovidit edhe këtu gjejmë origjinën e ndonjë shpendi, luleje etj. Kështu, psh, S. Dineja te “Valët e Detit jep legjendën e qyqes dhe të Gjonit. Qyqeja kishte qenë një vajzë e varfër. Vëllai i saj quhej Kuku ose Kuko. Një ditë vëllai u largua nga shtëpia e vajti në kurbet e nuk u kthye më. Motra u bë si e çmendur dhe iu lut Zotit që ta bënte zog në mënyrë që të fluturonte e të kërkonte vëllanë. Dhe Zoti e bëri zog e ajo fluturon pyll më pyll duke kërkuar të vëllanë : “Kuku!Kuku!” Kur duan ta bëjnë që të pushojë, atëherë i këndojnë qyqes këto vargje që kanë qartas trajtën e një yshtjeje : “Qyqe, qyqe, mana qyqe,/ç’ e bëre zonë tët vëlla/që ta therë posi ka./gjaknë ia pinë me lugë./mishnë ia prenë me thikë ?” E tillë është edhe legjenda e Gjonit, po këtë radhë është një nënë e cila i lutet Zotit ta bëjë zog dhe ajo bredh duke kërkuar djalin :”Gjon! Gjon!”Të shumta janë edhe legjendat për lulet megjithëse nuk janë mbledhur thuajse fare. Vetëm te Nikolla Lako “Legjenda lulesh të florës shqiptare “(Tiranë, 1960) gjejmë disa syresh, por mbledhësi ka qenë një botanist dhe legjendat e mbledhura i ka cënuar duke vënë dorë mbi to e duke u prishur vende-vende vërtetësinë. Megjithatë ne arrijmë të marrim vesh disa legjenda, si psh legjendën e Lules Ah-Jane (*Myositis silvatica* Hofm)

mbledhur te arvanitët e Greqisë, legjendën e Lule Frosos, (*Nymphaea Alba*), legjendën e Lules Sapun-Qyqe (*Saponaria officinalis L.*), legjendën e Lules Honinë (*Convolvus sepium L.*), legjendën e Lules Thundër Mushke (*Tussilago Farfara L.*) etj. Legjenda e Lules Sapun Qyqe është kjo: Një nuse mbahej pis, nuk lahej dhe atëhere vjehrra e mallkon dhe ajo bëhet qyqe, ndërsa sapuni me të cilin ajo nuk lahej, u bë lule. Kurse Lulja Thundër Mushke ka këtë legjendë: Skënderbeu ia kishte hipur një mushke të cilën e kishte stolitur me ar. Në një fard vendi, një flori këputet nga freri dhe bie në tokë. Skënderbeu nxjerr shpatën dhe do që ta ngrejë nga dheu, por mushka vë këmbën përsipër floririt dhe e fundos. Që atëhere floriri u bë një lule e verdhë. Me figurën e Skënderbeut lidhen edhe legjenda të tjera të metamorfozës, që me sa duket, kanë qënë më të vjetra dhe më pas i janë atribuar atij. Kështu për shembull legjenda e burimeve të fshatit Shkretë të Krujës e tillë duhet të jetë. Sipas legjendës që tregohet sot, Skënderbeu, në një nga manovrimet e tij, për t'i shpëtuar ndjekjes së hordhive osmane, bariste mal më mal. Kur erdhi në fushën e Shkretës, ushtria nuk dëgjoi të ecte më tutje : ishte korrik a gusht dhe ushtarëve u ishte tharë buza për një pikë ujë. Atëhere Skënderbeu hiqet mënjanë, bie në gjunjë dhe i lutet Zotit. Kur ai ngrihet, nga vendi ku ishin mbështetur gjunjët e tij, buron ujë dhe kështu ushtria piu ujë dhe u freskua. Edhe sot e kësaj dite ato burime quhen të Skënderbeut. Për Skënderbeun, që është pa tjetër figura me kryesore e shumë legjendave tona, tregohen shumë ndodhi që nën rrobën legjendare na flasin për shtegtimit, luftërat dhe personalitetin e tij. Para së gjithash këto legjenda historike na japin të kuptojmë se prirja e popullit për të idealizuar udhëheqësit e vet, për t'i legjendarizuar ata, duket e qartë edhe me këtë hero. Këtë na e tregojnë shumë legjenda. Dihet psh , “Kroi i vashës” në malin e Bushkashit, i cili quhet kështu sipas gojëdhënës, mbasi Skënderbeu, i mahnitur nga bukuria e një vajze që po mbushte ujë, e ndali ushtrinë aty dhe priti deri sa vajza mbushi ujë. Në rrethin e Kurbinit mund te hasësh Kroin e Skënderbeut, Gurrën e Mamicës etj. Në Rrajcë të Elbasanit gjen “Shkambin e Skënderbeut”, në Pishkash gjen “Tryezën e Skënderbeut”, kurse në vise të tjera “Gjurmën e kalit të Skënderbeut”. Skënderbeu shikohet si “evliha”, ”shenj” dhe për këtë bekimet apo mallimet e tij janë me pasoja. Legjenda të ndryshme hasen edhe për ditët e fundit të marsit që ngrin plakat, për yllin e karvanit, për Bisticën, për vijat e malit të Shpiragut që, sipas legjendës, janë blana të plagëve që bëri në trup të këtij vigani, vigani tjetër, Tomori, kur këta të dy u ndeshën etj. Të tilla legjenda shihet qartë që kanë të bëjnë me elemente të kozmogonisë dhe nuk ka dyshim që këto kanë qënë më të shumta, por dora-dorës janë harruar dhe nuk janë mbledhur dot. Një mitologji e ruajtur pak a shumë mirë është ajo që haset në veri të vendit tonë dhe që del si

në Ciklin e Kreshnikëve si dhe në përrallat e mbledhura sidomos në këtë zonë. Orët, shtojzavallet, zanat (Zërat e Jugut) Gërzheta etj. janë pa dyshim mbetje të një mitologjie të lashtë e pagane. Disa prej tyre janë personazhe të përcaktuara mirë dhe me një karakter original që nuk ngatërrohet me karakteret e të tjerëve. Te arbëreshët e Italisë hasim legjendën e së Bijës së Diellit, të Bijës së Hënës etj. ashtu si gjejmë praktikën legjendare për t'i përfunduar shpesh heronjtë e vdekur apo të vvarë të legjendave si bimë që mbijnë në varr të tyre (apo dhe si trupa të vdekurish që metamorfozohen në bimë). Kështu, kënga e famshme “Shumë u desh trimi me vashën”, përfundon :”Trimi bëhet qiparis/vasha një hardhi”. Po qiparis e hardhi bëhen edhe te këngët “Kur leve, leve ti vashë”, “Valla e Engjëlinës” të mbledhura nga De Rada.

Përralla shqiptare

Proza gojore është shumë e zhvilluar. Ajo paraqitet në forma të ndryshme. Një nga format më të përhapura e më të njohura, është pa dyshim përralla. Përralla është një tregim i trilluar, plot fantazi dhe elemente të çuditshme në subjekt me anë të së cilës paraqiten mendimet dhe ëndërrimet e njerëzimit në formë alegorike. Përrallat nuk nisen, si ndodh me këngët legjendare, nga një fakt i vërtetë (ndoshta edhe historik) që legjendarizohet, por nga një trill i plotë, që megjithatë mban kurdoherë lidhje me probleme, me situata, me mendime filozofike, morale, shoqërore, estetike etj. të jetës njerëzore. Përrallat tregohen në prozë dhe kanë, domosdo, strukturën dhe elementet e tyre. Ato janë të përhapura në të gjithë botën dhe janë tepër të pëlqyera si për vlerat e tyre filozofike, ashtu edhe për vlerat e tyre didaktike. Pikërisht për vlerat e saj të gjithanshme, përralla ka tërhequr vëmendjen e shkencëtarëve: me të merren folkloristët, etnografët, psikologët, letrarët etj. Etnografia e studion përrallën si dokument kulturor e historik dhe merret me rolin e saj në shoqëi, psikologjia e sheh përrallën si shprehje të proceseve shpirtërore, ndërsa shkenca e letërsisë përpiqet të përcaktojë se ç’është ajo që e bën përrallën të jetë e veçantë edhe brenda llojeve të prozës gojore. Ajo synon të përcaktojë elementet më të qenësishme të këtij lloji dhe, ashtu si etnografia, të kërkojë zanafillën e saj. Përrallat shqiptare shquajnë për larminë e fantazisë së tyre dhe për thurrrjet interesante të subjekteve. Roli i fantastikes edhe në përrallat tona është shumë i madh. Me anë të saj rrëfimtari popullor deformon artistikisht dhe përpunon qoftë artistikisht, qoftë filozofikisht subjektin, elementet e realitetit duke krijuar një simbolikë të pasur që flet alegorikisht për mësim shoqërore, etike dhe estetike për jetën. Pikërisht në vlerën e saj filozofike qëndron edhe një nga anët më të

rëndësishme të përrallës. Nëpërmjet saj jepen gjykime për jetën, për lumturinë, për të mirën dhe të keqen, për të bukurën dhe të shëmtuar, për aspiratat dhe ëndërrimet e njerëzve etj. Duhet thënë se vizioni i përgjithshëm që buron nga përrallat për botën e jetën është optimist. Kështu, edhe në përrallën tonë, e mira triumfon dhe njeriu me anë përpjekjesh dhe sakrificash, duke qënë kurdoherë i ndershëm, ia arrin më në fund lumturisë, arrin ta fitojë atë (e Bukura e Dheut, si simbol i lumturisë). Ky vizion optimist e realist e ka burimin te karakteri kolektiv i folklorit dhe shpreh soliditetin dhe qëndrueshmërinë e popullit përballë problemeve të jetës dhe vështirësive që dalin përpara.

****Këtë material e kanë përgatitur për lexuesin shqiptar z. Saimir Lolja, Denis Zavalani, Flori Bruqi ,e shumë të tjerë.***

MASAKRA E TIVARIT...

(Krimet e Ramiz Alisë gjatë regjimit komunist)

Maskara e Tivarit është vetëm një pjesë e vogël e krimeve për të cilat mund të hetohet roli i Ramiz Alisë. Vrasjet në kufi të 13 shtetasve dhe plagosjen e një tjetri nga periudha 23 maj 1990 deri në datën 8 korrik 1990, ku janë vrarë nga forcat e kufirit të rretheve Korçë, Ersekë, Librazhd, Shkodër, Sarandë, Gjirokastrë shtetasit Sokol Lika, Sami Daja, Kujtim Xhaja, Bujar Osmani, Fatmir Duro, Nik Hoti, Pëllumb Pëllumbi, Artan Çemi, Muhamet Nurja, Harallamb Papuçiu, Ilia Dalla, Thoma Boda, Enver Duka dhe është plagosur shtetasi Kristaq Lloci, nuk mund të thuhet se janë kryer pa dijeninë dhe miratimin e ish presidentit Alia. Po ashtu, në muajin qershor 1985, në afërsi të Ksamilit dhe në gjirin e Manastirit, janë gjetur kufomat e shtetasve Sotiraq Nasto e Jorgji Sholla nga Narta e rrethit të Vlorës. Ekuipazhet e motoskafit të shërbimit të kufirit janë urdhëruar të vendosin në bashet e motoskafit dhe t'i shëtisnin përgjatë bregdetit të qytetit të Sarandës me sinjale alarmi të ndezura. Me këto veprime të paligjshme dhe anti-humane ushtrohej për një kohë relativisht të gjatë një presion dhe një terror psikologjik në popull dhe nga ana tjetër indinjatë tek të gjithë banorët e zonës dhe pushuesit e tjerë. Gjithashtu, në vitin 1989 nga ana e forcave të kufirit janë kryer imitime të të vrarëve në kufi nën pretekstin e stërvitjes, duke ekspozuar para popullit persona gjoja të vrarë në kufi, të mbështjellë me çarçafë të lyer me bojë të kuqe. Këto veprime shoqëroheshin një natë më parë me fishekzjarre, të shtëna e sirena për të krijuar në qytet imazhin e alarmit dhe të gjendjes së gatishmërisë. Në këto kushte është e qartë se këto veprime nuk kishin qëllim stërvitjen e forcave të kufirit, por “stërvitjen” e popullit me ndjenjën e frikës dhe panikut. E sigurisht që për këto e shumë e shumë krime të tjera ende të pazbardhura, Alia kishte dijeni, madje kishte hedhur firmën e tij për dënimin kapital të këtyre njerëzve të pafajshëm, por që nuk jetonin dot nën diktaturën e egër komuniste. Prandaj, meqenëse Alia duket se nuk është penduar për krimet që ai ka kryer teksa ishte president, Berisha ndoshta përveç masakrës së Tivarit do të duhej të kërkonte dhe zbardhjen e qindra e mijëra krimeve të tjera të kryera nga Alia. Vetëm falë një hetimi të mirëfilltë dhe serioz, Ramiz Alia do të denoncohej si personi përgjegjës i këtyre masakrave të pazbuluara që ndër vite morën jetë njerëzish të pafajshëm.

Ramiz Alia i përgjigjet premierit Sali Berisha për masakrën e Tivarit

Ish-presidenti Ramiz Alia ka komentuar akuzat e kryeministrit Berisha në drejtim të tij, të lidhura me masakrën e Tivarit, të ndodhur në mars të vitit 1945. Alia i është përgjigjur Berishës me një gjuhë sfiduese duke thënë se kishte një të keqe të madhe se nuk e dëgjonte asnjëherë Berishën. “Unë kam një të keqe të madhe, që nuk e dëgjoj Berishën”, ka theksuar Alia. Më tej ai ka theksuar se asokohe ka qenë në Bosnjën Jugore. “Unë në kohën që ka ndodhur Masakra e Tivarit kam qenë në Bosnjën Jugore”, ka theksuar ai. Sipas shpjegimit të Alisë, ai ishte në krye të një prej formacioneve luftarake shqiptare, të dërguara në ndjekje të nazistëve përtej kufijve, në kohën që në Tivar të Malit të Zi ishte konsumuar e quajtura “Masakra e Tivarit”. Pra sipas tij, ai vetë, bashkë me trupat partizane shqiptare, ishin shumë larg vendngjarjes.. Sipas tij, përgjegjës për nisjen në drejtim të Tivarit të rekrutëve kosovarë ishin kosovarët, më saktë serbët, që i nisën rekrutët në drejtim të Tivarit, të cilët mund të flasin rreth kësaj akuze. E deshifruar një përgjigje e tillë do të thotë se përgjegjës për këtë ngjarje janë drejtues të formacioneve antifashiste kosovare apo jugosllave, që pas çlirimit të Kosovës kishin marrë në duar frenat e pushtetit në këtë rajon.

Kush është Ramiz Alia?

Ramiz Alia lindi më 18 tetor 1925 në Shkodër. Ai u diplomua në shkollën e Partisë në Moskë (1954). Alia është një nga figurat më të rëndësishme të Partisë së Punës së Shqipërisë, i cili udhëhoqi Shqipërinë mes viteve 1984 – 1990. Gjatë kësaj periudhe Ramiz Alia ka kryer detyra të larta në drejtim të PPSH-së, rrjedhimisht edhe të shtetit shqiptar. Detyrat më të rëndësishme kanë qenë: Sekretar i Parë i KQBRPSH (1949-1955), Minister i Arsimit dhe Kulturës (1955-1958), anëtar i Byrosë Politike dhe Sekretar i KQ PPSH-së për ideologjinë (1961-1985), deputet, Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor (1982-1990), Sekretar i Parë i KQ të PPSH-së (1985-1991) dhe kryetar i Këshillit Presidential (1991). Pas zgjedhjeve të para shumëpartiake në Shqipëri të zhvilluara më 31 mars 1991, parlamenti i ri pluralist i dominuar nga deputetët e PPSH-së, më 30 prill 1991 me propozim të PPSH-së e zgjodhi Ramiz Alinë, President të Republikës. Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 22 marsit 1992 ku fitoi koalicioni i opozitës i udhëhequr nga Partia Demokratike, më 3 prill 1992 Alia dha dorëheqje nga posti i Presidentit. Alia u lind në vitin 1925 dhe u bashkua lëvizjes komuniste shqiptare para se ai ishte njëzet vjeç. Ai e kishte rritur me shpejtësi nën patronatin Hoxhës dhe nga 1961 ishte një anëtare e plotë e Byrosë Politike në pushtet (Byrosë Politike) të Partisë së Punës të Shqipërisë (PLA).

Hoxha Alia zgjodhi për disa arsye. Së pari, Alia kishte qenë prej kohësh një ndjekës militant e marksizmit-leninizmit dhe i mbështetur politikën e Hoxhës e vetë kombëtare besim. Alia edhe u favorizuar nga gruaja e Nexhmije Hoxhës, i cili dikur kishte qenë mësuesi i tij në Institutin e marksizmit-leninizmit. Përvojë politike Alia ishte i ngjashëm me atë të Hoxhës, dhe duke qenë se ai u paraqit për të shkëmbyer pikëpamjet e Enver Hoxhës në çështjet më të huaj dhe vendas, ai me lehtësi veten për të vendosur regjimin totalitar i Partisë. Se ai kishte arritur të mbijetonte disa valë të gjerë purges bespokene aftësitë e tij politik dhe kapaciteti për mbijetesë.

Sekretari i parë i Partisë së Punës, Ramiz Alia me Enver Hoxhën

Kur Alia mori si sekretar i parë i PPSH-së, vendi ishte në vështirësi të rënda. Apati politike dhe cinizëm u përhapur, me segmente të mëdha të popullsisë që ka hedhur poshtë vlerat e qeverisë. Ekonomi, e cila vuante nga produktiviteti i ulët dhe mungesa e përhershëm të produkteve ushqimore më elementare, tregoi asnjë shenjë të përmirësimit. Kontrolle Sociale dhe vetë-disiplinë kishte geryer. Inteligjencës ishte fillimi për të rezistuar kontrollin e rreptë të partisë dhe të kritikojnë dështimin e qeverisë për të respektuar standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Me sa duket duke njohur thellë dhe shtrirjen e kësaj pafuqie shoqërore, Alia me kujdes dhe ngadalë filloi të bënte ndryshime në sistem. Objektivi i tij i parë ishte sistemi ekonomik. Në një përpjekje për të përmirësuar eficientë ekonomike, Ramiz Alia prezantoi një decentralizim ekonomik dhe reformën e çmimeve në sektorë të veçantë. Edhe pse këto ndryshime shënoi një largim nga qeveria e Hoxhës, ata nuk kanë ditur një reformë themelore të sistemit ekonomik. Alia nuk pushojnë censurën, por ai lejoi diskutimet publike të problemeve shoqërore në Shqipëri dhe debatet e inkurajoi midis shkrimtarëve dhe artistëve në çështjet kulturore. Në përgjigje të kritikës ndërkombëtare të të dhënave të Shqipërisë mbi të drejtat e njeriut, udhëheqja e re loosened disa kontrolle politike dhe pushuar të aplikojë shtypje në një shkallë masive. Rusova rregull, megjithatë reduktuar në masë të madhe këtë përpjekje në një reputacion të mirë. Në vitin 1989, solli amnisti e përgjithshme për lirimin e të burgosurve shumë afatgjatë. Alia mori gjithashtu hapa për krijimin e lidhjeve më të mira me botën e jashtme, forcimin e marrëdhënieve me Greqinë, Italia, Turqia dhe Jugosllavia. Një loosening e kufizimeve të udhëtimit dhe turizmit ka rezultuar në një pikëpamje më premtuese për tregti të Shqipërisë turistike.

Tranzicioni në presidencë dhe demokraci

Pavarësisht nga përpjekjet e Alia për të vazhdojë me ndryshimin në një bazë të kufizuar, të matur, e reformave nga lart kërcënuar se do të kthehet në reforma nga poshtë, kryesisht për shkak të kërkesave gjithnjë e më të ashpër të të rinjve të Shqipërisë. Më 9 dhjetor, 1990, demonstruesit marshuan student nga Universiteti Enver Hoxha (sot Universiteti i Tiranës) në Tiranë nëpër rrugët e kryeqytetit duke hedhur parrulla dhe duke kërkuar dhënien fund të diktaturës. Në dhjetor të 11, numri i pjesëmarrësve kishte arritur pothuajse 3.000. Në një përpjekje për të shuar trazirat e studentëve, gjë që kishte çuar në përleshje me policinë e ndërhyrjes së shpejtë, Alia u takua me studentë dhe ranë dakord për të marrë hapa të mëtejshëm drejt demokratizimit. Informuar studentët Alia që donin të krijojnë një organizatë e pavarur politike të studentëve dhe të rinjve. Përgjigja Alia ishte se një organizatë e tillë duhej të ishte regjistruar me Ministrinë e Drejtësisë. Në mesazhin e tij tradicionale të Vitit të Ri për të popullit shqiptar, Ramiz Alia përshëndeti ndryshimet që kishin qenë që ndodhin në vend dhe deklaroi që 1991 do të jetë një pikë kthese në kushtet e ekonomisë. Por, pavarësisht nga shenjat pozitive të ndryshimit, shumë shqiptarë janë ende duke u përpjekur për të lënë vendin e tyre. Në fund të vitit 1990, deri në 5.000 shqiptarë kaluar kufirin malor në Greqi. Të rinjtë e motivuar me pakënaqësinë ekonomike bërë deri pjesa më e madhe e refugjatëve. Në shumë aspekte, Alia ishte një i mbijetuar politik. Ai kishte arritur të mbetet një figurë e rëndësishme politike nëpër disa kriza politike. Edhe pse ai kishte disa shqetësime të vërtetë për stabilitetin dhe vazhdimësinë, ai nuk ishte i papërkulur. Ai ndryshoi në përgjigje të rrethanave dhe kërkesave të vendosur reformatorët. Megjithatë, me Shqipërinë në grahmat e një krize të rëndë ekonomike, Alia kishte për t'u përballur me sfidat me të cilat ai nuk mund të kapërcej. Pas rënies së qeverisë së koalicionit në dhjetor 1992 dhe Partia Demokratike e PDSH (Shqipërisë) fitore dërrmuese në zgjedhjet e përgjithshme të pranverës 1992, ai dha dorëheqjen si president më 3 prill, 1992. Më 9 prill, Kuvendi Popullor zgjodhi kreu i PDSH, Sali Berisha si kreu i ri i Shqipërisë të shtetit. Më 21 maj, 1994, zyrtarë të lartë të regjimit komunist, përfshirë edhe Ramiz Alia, shkoi në gjyq. Alia u akuzua për shpërdorim të pushtetit dhe shpërdorim të fondeve shtetërore, siç ishte Adil Çarçani, ish kryeministër, Manush Myftiu, zëvendësi i tij, dhe Rito Marko, ish-zëvendës-president. Alia ishte vendosur nën arrest shtëpie në gusht 1992 dhe u arrestuan zyrtarisht në shtator 1993. Në gjykatë ai pretendoi se ishte viktimë e një gjyqi politik tregojnë dhe kërkoi që gjyqi të transmetohet në televizion, një kërkesë mohuar nga gjyqtari kryesues. Gjyqi u monitoruar nga një Human

Rights Watch / Helsinki dhe përfaqësues vazhdoi vetëm me parregullsi të vogla proces të rregullt ligjor. Dhjetë të pandehurit ishin gjetur fajtorë si të akuzuar dhe të dënuar me ndërmjet tre dhe nëntë vjet në burg; Alia mori një dënim nëntë-vjeçar. Një gjykatë e apelit pas reduktuar disa nga dënimet, sidomos Alia në pesë vjet. Alia, Myftiu, Çarçani, Stefani dhe Isai janë urdhëruar gjithashtu që të paguajë shuma të ndryshme të shtetit. Më 30 nëntor, Gjykata e Kasacionit reduktuar afat Alia e nga një tre vite të tjera. Më 7 korrik, 1995, Ramiz Alia ishte liruar nga burgu.

<http://floart-press.blogspot.com/2010/07/nga-flori-bruqi-m-asakra-e-tivarit-pd.html>

SPASTRIMI ETNIK NË KOSOVË

Lufta në Kosovë nuk ishte lojë e fuqisë gjeopolitike ...

Kosova, një rajon me shumicë shqiptare, mbeti nën sundimin osman deri në Luftën ballkanike të vitit 1912. Deri më sot, banorët e Kosovës janë muslimanë, të krishterënjë dhe orthodox. Mbarimi i luftës së ftohtë hapi një erë të re në botë, të përcjellur me ndryshime drastike të kufinjve dhe regjimeve, veçanërisht në Ballkan. Gjenerata që mbajti trashëgiminë kulturore të osmanëve mbeti në qendër të këtyre ndryshimeve. Ajo që sot po ndodh në Bosnjë dhe Kosovë është pasojë e këtyre zhvillimeve historike. Zbrastësira që mbeti pas rrënimit të Perandorisë Osmane, ajo që shërbeu si “faktor balancues” në vendet që i udhëhiqte, nuk mundi të plotësohej nga shtetet e reja që u shfaqën pas Luftës Botërore. Konfliktet që po ndodhin sot në vend janë pasojë e këtyre zbrastësive të mbetura. 90% e popullsisë dy milionëshe të Kosovës janë shqiptarë muslimanë. Territori i krahinës paraqet 12% të Serbisë. Në vitin 1989, forca policore e përbërë kryesisht nga sllavët u angazhua në akte represioni. Ndërkohë, serbët ndaluan planprogramin shkollor në gjuhën shqipe. Që nga 28 shkurti e deri në ditë e sotme, serbët vazhdimisht kanë ushtruar dhunë ndaj kosovarëve. Kjo është vetëm një nga 300 mijë familjet që kanë lëshuar Kosovën, pas operacionit të filluar nga NATO më 24 mars 1999. Rreshtat e refugjatëve të uritur zgjatëshin me kilometra. Ata i referohen pozitës së tyre si më të mirë krahasuar me ata që kanë mbetur prapa në Kosovë për të qenë viktimat të dhunës e dhunimeve ose të atyre që nuk patën mundësi të mbijetojnë kushtet e ashpra të dimrit duke vdekur rrugës. Dhjetë mijë refugjatë nuk u lejuan që të kalonin në destinacionin e tyre në pikën kufitare të Morinit, në kufirin Shqipëri-Jugosllavi. Ata u morrën dhe u mbyllën në ndërtesa strategjike, të gjitha caqe të mundshme të bombardimit. Ambasada shqiptare në Romë raportoi 25 mijë refugjatë kosovarë që mungonin. Forca Evropiane e NATO-s tha se lufta në Kosovë ka shkaktuar 960,000 refugjatë. Bazuar në informacionin e ofruar nga UK, ministri i jashtëm britanik tha se ka më shumë se 400,000 civilë shqiptarë, refugjatë nëpër zonat malore të Kosovës, të cilët janë nën kërcënim konstant nga uria e vdekja. Sipas autoriteteve nga UÇK-ja, 40.000 civilë shqiptarë që orvateshin të gjenin mbrojtje në shpatet e ulëta të maleve të Berishës, u bënë cak I të shtënave të mëdha të serbëve. Pas Luftës së Dytë Botërore, Serbia kreu gjenocidin më të madh që ka ndodhur ndonjëherë në Evropë. Qëllimi kryesor ishte që të asgjësonte shqiptarët muslimanë në Kosovë, të cilët përbëjnë 90% të popullsisë së përgjithshme, dhe që të bënte Kosovën tokë serbe. Serbët ndoqën

politikën e tyre kundër muslimanëve duke vrarë, plaçkitur e dhunuar. Serbët shkatërruar shtëpitë e fshatrat dhe deportuan shqiptarët muslimanë. Regjimi serb filloi një fushatë të vendosjes së serbëve në çdo vend të mundshëm në Kosovë me qëllim të qartë që të prishë strukturën e jetës shqiptare këtu. Qëllimi ishte ndërrimi i strukturës demografike në favor të serbëve. Siç tha një zëdhënës i NATO--s, me qëllim që të fshijnë gjithçka që kishte të bënte me identitetin kulturor të muslimanëve në Kosovë, serbët madje ndryshuan edhe letrat martesor dhe regjistrimin tite-deed. Të detyruar që të lëshojnë shtëpitë e tyre nga kërcënimet e sulmeve, në mars 1999 popullata muslimane e Kosovës filloi të largohet, duke lënë fshatrat e tyre të shkatërruara. Nën shiun e fortë dhe duke u përballur me të ftohtit e ashpër, gratë, fëmijë dhe vegjël dhe pleqtë lanë gjithçka prapa dhe ecën, drejt një destinacioni të panjohur. Rreth tre muaj më vonë, kur ata u kthyen, asgjë më nuk ishte e njëjtë. Shtëpitë ishin djegur e rrënuar, të afërmit ishin zhdukur, fëmijë ishin të sëmurë kurse prona ishte plaçkitur... lufta dhe migrimi shkatërroi jetën e çdo kosovari, të pasur ose të varfër, në një rrëmuje të plotë. Organizatat humanitare në rajon kanë raportuar gjithashtu se në Kosovë serbët kanë kryer gjenocid ndaj muslimanëve. Refugjatët dhe masat e gjera i qenë nënshtruar të gjitha formave të dhunës e torturës. Serbët kanë dhunuar femrat, kanë vrarë shtatëzënat dhe kanë shkatërruar ndërtesat dhe pasurinë. Më shumë se 100,000 njerëz janë vrarë. Gjendja e shtegtarëve ishte e frikshme. Rreth dyzet njerëz- nga to njëzet foshnja dhe të tjerë, të moshuar- kanë vdekur në kufirin maqedono-jugosllav gjatë ndalesës së detyruar e të gjatë që mbajti aty rreth 250-300 mijë shtegtarë. 12 vite që kur avionët e NATO-s shkuan në aksion kundër Serbisë, lufta e Kosovës mbetet ende kontraverse. E mirëpritur nga shumë në atë kohë si një evidencë e një rendi humanitar botëror në formim, trashëgimia e saj është anashkaluar, mundur dhe krejtësisht shtrembëruar nga debati i luftës kundër terrorit. Çka Vaclav Havel e quajti “lufta e parë për vlera” tash më shumë po përshkruhet si një precedent i rrezikshëm. Bile edhe Clare Short, përkrahëse e flakët e intervenimit në Ballkan, gabimeve të Tony Blair-it në politikën e jashtme i vuri zanafillën në “shijen e pedestalit” që ai e kishte marrë në Kosovë. Ka disa arsye për këtë, më e rëndësishmja padyshim është lufta në Irak që mbjelli dyshimet në legjitimitetin dhe efikasitetin e fuqisë ushtarake perëndimore. Duke u larguar nga principi i mos-intervenimit dhe pa mandat të KB-së, Kosova shpesh trajtohet si mëkati origjinal që bëri Irakun të mundshëm. Edhe invazioni i Rusisë dhe njohja e Abkhazisë dhe Osetisë Jugore janë karakterizuar si një nxitje nga deklarimi i pavarësisë së Kosovës disa muaj më parë. Krahasimet e këtij lloji më shumë konfuzojnë se sa sqarojnë. Lufta në Kosovë ishte përgjigje ndaj një emergjence humanitare, e jo një lojë fuqie gjeopolitike. Dhe kjo edhe tash kontestohet. Anti-imperialistët e vetëquajtur, që

shpesh përkrahin imperializmin e çfarëdo regjimi që i kundërshtohet perëndimit, kanë konstruktuar një histori alternative në të cilën krimet e Slobodan Millosheviqit janë minimizuar apo arsyetuar dhe perëndimi “grykës” portretohet si nxitës i dhunës. Në këtë histori, tentimet e tija (të Milosevic-it) që të arrij zgjidhje të negociushme ishin sabotuar në konferencën e paqes në Rambuje nga Evropa dhe SHBA-të; dhe vdekjet dhe lëvizjet e refugjatëve brenda Kosovës ishin shkaktuar nga bombardimet e NATO-s. Këta kritikë flasin thuaj se shkatërrimi i Bosnjës ishte një pjellë e imagjinatës. Realiteti është se deri sa erdhi tek Rambujeja, liderët perëndimorë kishin mbledhë mend nga loja tinëzake e Millosheviqit në të cilën ai negocionte paqe të rreme derisa vazhdonte të zbatonte terrorin etnik në terren. Ata kishin duruar tetë vite të tilla. Në Kosovë, forcat serbe kishin vrarë 1,500 veta dhe kishin dëbuar nga shtëpitë e tyre 270,000 veta para se NATO të intervenonte. Lufta e Kosovës filloi me 28 shkurt të vitit 1998, pas sulmit jugosllav në fshatrat Likoshan dhe Qirez në Drenicë të Kosovës. Lufta nga 28 shkurt 1998 e deri më 23 mars 1999 u zhvillua mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave jugosllave. Ndërsa nga 24 mars 1999 e deri më 10 qershor 1999, Aleanca Veriatlantike NATO me bombardime të përditshme në caqet ushtarake jugosllave, me përkrahjen tokësore të UÇK-së detyroi forcat serbomalazeze dhe Kasapin e Ballkanit Slobodan Millosheviqin të nënshkruaj kapitullimin në Kumanovë. Në këtë luftë u dëbuan 800,000 mijë shqiptarë, u vrane 15,000 persona, nga të cilët 2,400 luftëtar të UÇK-së e të tjerët civilë. Gjatë luftës janë zhdukur rreth 5,000 njerëz, fati i shumicës prej tyre është zbardhur deri në vitin 2007, por i madh ka mbetur numri i rasteve të pasqaruara. Vlerësohet, se gjatë luftës në Kosovë (1998-1999), forcat militare dhe paramilitare serbe kanë vrarë, ekzekutuar apo masakruar në forma më mizore, rreth 15 mijë shqiptarë, ku 90% prej tyre qenë civilë të pa armatosu.. Në këtë periudhë kohore janë përdhunuar afër 20 mijë femra shqiptare. Gjithashtu, mësohet për rrëmbimin e mbi 3 mijë shqiptarëve, ku pas luftës një pjesë e tyre u gjetën nëpër varrezat masive në Serbi, ndërsa akoma nuk dihet për fatin e 2087 të tjerëve. Sipas një përlllogaritje, gjatë periudhës kohore mars 1998 - qershor 1999, njësitë kriminale dhe artileria e rendë serbe kanë shkatërruar dhe djegur pjesërisht ose tërësisht rreth 1.100 vendbanime Shqiptar, kanë plaçkitur, djegur e shkatërruar mbi 200.000 shtëpi, banesa, lokale afariste, punëtori zejtare, fabrika, shkolla, biblioteka, monumente kulturore-historike, objekte kulturore, shkencore, fetare etj.

<http://floripress.blogspot.com/2011/04/lufta-ne-kosove-nuk-ishte-loje-e-fuqise.html>

<http://floripress.blogspot.com/2011/08/mighty-and-almighty-i-fuqishmi-dhe-i.html>

<http://flori-press.blogspot.com/2005/11/kosova-ky-tmerr-i-patreguar-n-mesin-e.html>

TOKA E HUAJ, S'BËHET E JOTJA!

Eksperti për Ballkan i Qendrës “Woodrov Vilson” në Washington, proserbi Martin Sletzinger: Serbia t’ia thotë popullit se Kosova ka shkuar...

Eksperti për Ballkan i Qendrës “Woodrov Vilson” në Washington, Martin Sletzinger, konsideron se autoritetet në Serbi duhet të marrin guximin dhe t’ia thonë popullit se Kosova shkoi, në vend se të shpenzojë kohë e para, që i mungojnë për fushatë rreth Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, por ai ka thënë se Serbia mund të bëhet anëtare e BE-së, nëse e luan si duhet lojën e kartave. Sletzinger, siç ka vlerësuar në një intervistë për FoNetin, e ka “frustruar” politika dhe fushata e qeverisë së Serbisë për marrjen e mendimit të GJND-së, meqë individë kanë kaluar kohë të gjatë në udhëtime nëpër botë “çdo të pestën ditë kanë qenë në OKB”, dhe kanë folur se kurrë nuk do ta njohin Kosovën. Ndonëse nuk e di se çfarë kanë bërë “nën rrogë”, në opinion është promovuar kjo vijë e fortë, ka theksuar Sletzinger, i cili konsideron se në vend të kësaj qytetarëve të Serbisë është dashur t’u thuhet e vërteta. “Do të duhej ta thoshin të vërtetën se Serbia nuk do ta mbante Kosovën, madje edhe sikur SHBA, pavarësisht nga të gjitha ato punë të këqija që mund të kenë bërë, ta ndërronte mendimin e vet, meqë realiteti i jetës në terren është tjetër”, ka sqaruar Sletzinger. Serbët janë shumë të lidhur me Kosovën, ka thënë Sletzinger dhe ka vlerësuar se politikanët do të duhej ta thoshin qartë se Kosova “fizikisht po shkon”, porse përgjithmonë do të jetë pjesë e Serbisë përmes kushtetutës, njerëzve që jetojnë atje, rrëfimeve.... Përkundër kësaj, mendimi i GJND-së, sipas vlerësimit të Sletzingerit, nuk mund të konsiderohet sukses i diplomacisë kosovare, meqë ajo askund nuk ka punuar si duhet, pos në SHBA. Sletzinger ka vlerësuar se SHBA “për shqiptarët janë kampionë”, por ka thënë se Ëashingtoni, për shkak të krizës ekonomike, dhe luftërave në Irak e Afganistan, ka në mendje gjëra të tjera dhe konsideron se BE duhet të marrë rolin kryesor në Kosovë. Në një këso situatë, ka shtuar Sletzinger, shqiptarët e Kosovës “do të duhej të silleshin më me përgjegjësi dhe jo kombëtarisht”. “Duhet të heqin dorë nga mbështetja në SHBA, duhet të bëjnë gjithë ç’është e mundur që serbët të mbesin në Kosovë, që të mos dëmtohen tempujt serbë, që njerëzit të kenë liri lëvizjeje dhe jetë të dinjitetshme. Kosovarët duhet të jenë në nivelin e detyrave të kohës”, ka porositur Sletzinger. Duke u marrë me rolin e BE-së dhe SHBA-së në rajon, Sletzinger ka rikujtuar se unioni është i pranishëm në terren, ka misionin e vet, po deponon shumë para dhe ka

qëllime të mira, kur bëhet fjalë për të ardhmen e Serbisë. Ndonëse konsideron se serbët janë më së paku unikë kur është më së shumti e nevojshme, Sletzinger thekson se Serbia “nëse luan mirë lojën e vet të kartave, mund të bëhet anëtare e BE-së, sikundër edhe e NATO-s, po deshi”. “Serbia mund të ketë edhe votën e vet në Kosovë, një lloj kontrolli, por nuk do ta udhëheq më”, parashikon Sletzinger, duke vlerësuar se Serbia, pas theqafjeve të viteve 90-ta, tani ka rast unik që t’i bashkohet bashkësisë ndërkombëtare. Ai përfshirjen e Serbisë në listën e bardhë të Shengenit e ka vlerësuar si një hap të madh të saj, dhe dëshmi se BE e dëshiron si anëtare të veten. Kosova s’është Serbi, Kosova është Kosovë. Pse nuk ke shkuar në Shqipëri, e pyeti policia serb banorin shqiptar të Pejës, një qyteti në Perëndim të Kosovës. Këtu e kam shtëpinë, iu përgjigj njeriu. “Kosova është serbe, i keni fituar bombarduesit e NATO-s, ik në Shqipëri”, ia ktheu polici special, bashkë me fjalët ngriti edhe revolen dhe civilin e frikësuar e qëlloi me plumbin e saktësisë së ushtruar në shteg të ballit, shkruan “Jutarnji List” i Zagrebit me autor Ahmed Salihbegović. Kjo ngjarje, bashkë me shumë të tjera, ishte shënuar në shkrimin “Sfilitja e natës” botuar në magazinën amerikane “Newsweek” para 19 vjetëve. Fatkeqësisht, nuk bëhej fjalë për një gjumë të çrregulluar, por për një ngjarje tipike të atij regjimi dhe të atij ambienti, që arritën kulmin në agim të pranverës 1999. Këtë likuidim e pa anash atëherë 74-vjeçari Riza Sapunxhiu, të cilit nuk do t’i ndihmonte fakti para atyre që kishin ardhur “për të vend rend” se si një ekonomist i shkëlqyer në kohën e vet kishte punuar për Bankën Botërore, më vonë në Beograd ishte anëtar goxha besnik i Kryesisë së shtetit të atëhershëm të përbashkët, megjithatë, jo aq sa duhet ndaj vullnetit të regjimit të Millosheviqit, i cili asokohe u përpoq me grushtet ushtarak të thyejë Slloveninë, e sidomos Kroacinë, për ç’arsye Sapunxhiu u ndoq nga kjo pozitë dhe u zëvendësua me Sedo Bajramovićin bizar. “Incidenti” i përshkruar në Pejë ishte pjesë e shabllonit “të zgjidhjes përfundimtare për Kosovës”, të heshtur në një varg shqyrtimesh që asokohe zhvilloheshin rreth saj në Kroaci. Ky një njeri i vrazhdë ishte vetëm e njëqinda pjesë e përqindjes, e dhjeta e promilit të atyre “rasteve” brenda disa javësh të kulmit të “fushatës njëvjeçare dhe intensive të përbërjes së policisë speciale dhe të forcave (para)militare”. Të dhënat e Departamentit të Shtetit dhe të Tribunalit të Hagës flasin se kështu ishin vrarë dhjetëra mijë njerëz, më shumë se edhe në Srebrenicë katër vjet më parë dhe me pjesëmarrjen më të madhe fëmijësh dhe grash ndër viktime. Aktivistë të nderuar të Qendrës beogradase për të Drejtën Humanitare kanë hartuar regjistrin me të dhëna për më shumë se 10 mijë shqiptarë të vrarë. Kur u bë e qartë se NATO do ta marrë Kosovën, do të zbulohet se shumica e të vrarëve nuk ishin guerilë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por civilë të pafuqi, regjimi

i Millosheviqit një pjesë të kufomave i zhvendosi në Serbi. Më shumë se 800 u eshumuan më 2001 në poligonin policor afër Beogradit, 700 të tjerë në paralagjen e Beogradit, Batajnicë, dhe zbulimet e tilla vazhdojnë ende – sivjet janë gjetur 250 trupa afër Rashkës. Krahas vrasjeve masive dhe jouselektive, të shoqëruara me plaçkitje, tortura dhe dhunime, u ndërmor edhe dëbimi masiv i popullsisë së Kosovës. Shqiptarëve iu shkatërroheshin pasaportat, ngarkoheshin në vagonë kafshësh dhe kështu brenda disa javësh, Serbia ia doli “t’i transferojë” 850 mijë, duke ndërmarr “evakuimin” edhe të 400 mijë të tjerëve dhe nuk do të duhej shumë kohë që ta përfundonte “punën” me 2 milionë njerëzish të tillë. Këto plane i pengoi NATO-ja. Për shkak të gjitha atyre që u thanë ishte i saktë mendimi që ato ditë Kongresi i hebrenjve në Amerikë (AJC) publikoi në Neë York Times dhe mediet e tjera, me tekstin: “Kur të pyes historia kush u ngrit dhe kush iu kundërvu krimit, përgjigja do të jetë NATO”. E ky intervenim, krahas aspektit humanitar kishte edhe vetëmbrojtjen. Ishte i dukshëm plani i Beogradit – i dëbimit të kosovarëve në Shqipëri e Mal të Zi, dhe sidomos në Maqedoni (që kanë një pakicë të madhe shqiptare) të shkaktojë krizë humanitare dhe kaos në ato vende dhe që lufta atëherë të implikonte palët e ndryshme dhe më vonë anëtarët e NATOs (Greqinë, Turqinë, Shqipërinë, Bullgarinë). Atëherë, si edhe më parë, pozicioni kroat nuk ishte i qartë dhe as pozitiv. Në kohën e “heshtjes kroate”, heshte edhe për Kosovën, me përjashtim të librit të prof. Branko Hërvatit, i cili u sulmua nga Serbia se ishte ustash dhe “mercenar separatist” për shkak të propozimit që Kosovës t’i njihej statusi i republikës, megjithëse kishte sugjeruar si komunist e titist, në favor të Serbisë dhe Jugosllavisë komuniste. Kur pas protestave të rralla në Kosovë më 1981 u ripërtëri represioni i atjeshëm (për të cilin, madje edhe më të zi në kohën e luftërave ballkanike në fillim të shekullit XX, kishte shkruar me përbuzje idealisti fisnik serb Dimitrije Tucoviq), represioni, të cilin e ndërmori në dhjetëvjetëshin e parë të Jugosllavisë së Titos, sidomos në Kosovë, shefi i policisë sekrete Aleksandër Rankoviq, për ndihmë “për shuarjen e irredentizmit” u dërguan njësitë policore nga të gjitha republikat, dhe ta themi troç “rrahjen e shqiptarëve” e kursyen vetëm njësitë e kontingjentit të ardhur nga Sllovenia. Kur nga fundi i viteve të 80’ u nxor jashtë ligjit edhe pjesa më e madhe e popullsisë dhe udhëheqjes shqiptare, sado që i ishin lokalë Beogradit, vetëm sllovenët kundërshtuan, madje edhe nëse kështu (“Kosova moja dezhele – Kosova vendi im) t’ia hapin rrugën pavarësisë së vet. Meqë kreu ynë në vitet e 90-ta nuk pranoi politikën “me të gjithë kundër Millosheviq”, por “me Millosheviqin kundër të gjithëve”, i ofruam mbështetje Serbisë edhe rreth Kosovës, deri në atë masë sa që presidenti ynë i ndjerë në kulmin e luftës së NATO-s me Serbinë thirri tubimin diplomatik

që të publikojë propozimin e vet për ndërprerjen e konfliktit dhe ndarjen e Kosovës. Një shprehje të tmerrshme të fytyrës kishte asokohe edhe i ngarkuari i Rusisë, vendi i të cilit me urrejtje ato ditë injoroi deklaratën ekzibicioniste, të cilën parlamenti i Beogradit ia kthente projektileve të NATO-s me deklaratën për bashkimin e RS të Jugosllavisë së atëhershme bashkimit shtetëror Federatës Ruse dhe të Bjellorusisë. Por, do të mund të ndodhte edhe më zi, sikur Pandovçaku nën presion të mos hiqte dorë nga vendimi që të ndalonim fluturimet e avionëve “të agresorit” NATO. Kur iu ofruar Beogradit kompromis (në negociatat e Rambujesë) kjo u hodh poshtë me përbuzje (“çfarë marrëveshje?, pyeste me ironi Millan Millotinoviç) edhe pas ndryshimit të regjimit autoritetet e reja, ku ritmin nacionalist e diktoi një kohë të gjatë Vojislav Koshtunica, e në kohë të re shefi i diplomacisë Vuk Jeremiç, do të refuzonin çfarëdo kompromisesh madje edhe versionin e parë proporcionalisht shpirtgjerë të planit të diplomatit finlandez dhe burrështetasit, Marti Ahtisarit (që ishte edhe autori i planit “Vance – Oëen” për BeH). Në vend të kësaj, Serbia nisi të ofrojë “më shumë se autonomi, më pak se pavarësi”, pa e sqaruar asnjëherë se çka do të thoshte ky formulim i çuditshëm. Një vend kësaj e kësaj dite ende i parregulluar, për çka nuk është i vetmi në rajon, por është shembulli më i keqi, Serbia në fakt përfitoi duke humbur Kosovën, për shkak të moszhvillimit të saj ekonomik dhe të pozitës dytësore në qarkullim, por edhe për shkak “të barrës” të 2 milionë shqiptarëve, përfaqësuesit e të cilëve do të kishin të drejtën e përfshirjes edhe në strukturat më të larta të pushtetit në Beograd. Mediet serbe, pushteti dhe pjesa më e madhe e opinionit vazhdojnë akuzat për kërcënimin e Islamizmit (edhe pse shqiptarët e Kosovës, me përjashtime të pjesërishme katolike janë më sekularë se bashkëkombësit në Maqedoni, Mal të Zi, madje edhe në Shqipëri). Serbia vazhdimisht thekson pozitën e rrezikuar të serbëve e malazezëve në Kosovë, por, ashtu siç kishte tërhequr vërejtjen edhe Bogolub Kariç, një ndërmarrës dhe politikan me origjinë nga Kosova – asgjë nuk kishte bërë që atyre njerëzve t’u ndihmojë, as në planin e nevojave më themelore jetësore,

sidomos nëpër enklava. Ashtu sikundër kishte filluar regjimi i Millosheviçit me gjykime pompoze në mungesë të krerëve të Perëndimit për “gjenocidin e NATO-s”, edhe pushteti aktual reagoi ndaj njohjeve të jashtme të shtetësisë së Kosovës me paralajmërime të zhurmshme të ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike dhe të gjitha lidhjeve të tjera, nga të cilat u mor vesh, nuk u bë asgjë, pos tërbimit të shkurtër të huliganëve para ambasadave të SHBA-së dhe Kroacisë. Që nga dita e parë e shpalljes së sovranitetit të Kosovës, më 18 shkurt 2008, këtë shtet e njohën 3 nga gjithsej 5, anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së – SHBA, Britania, Francë – dhe pastaj katër vende nga tri kontinent

– Afganistani, Shqipëria, Kosta Rika dhe Turqia. Kroacia ishte mjaft e matur dhe e kujdesshme ndaj Serbisë së zemëruar që të mos ngutej me këtë punë. Pritëm një muaj të plotë dhe deri atëherë Prishtinën e njohën edhe disa nga shtetet më të mëdha të Evropën (Gjermania dhe Italia), i gjithë Beneluksi, pjesa më e madhe e Baltikut (tash vonë iu bashkua edhe Letonia), vendet nordike (Norvegjia jo shumë pas nesh, të gjitha të tjerat më herët), si dhe sllovenët, por edhe polakët, irlandezët, madje edhe zviceranët neutralë. Në “pakon” njihjen bashkë me ne e shpallën edhe dy fqinjë serbësh (Hungaria dhe Bulgaria), pa vonuar këtë e bënë edhe Çekia dhe Portugalia, qysh para nesh kishin nisur të vinin njohje nga anë të ndryshme të botës (Australia, Senegali, Peru...), e ndër to edhe njohjet nga Kanadaja dhe Japonia, duke i bërë që të gjitha shtetet e G7, grupit udhëheqës të ekonomisë botërore, të njohin Kosovën më parë se Kroacia. Në tetor të atij viti përnjëherësh njihjen e publikuan dy vende që janë fqinjë edhe të Kosovës, edhe të Serbisë, Mali i zi dhe Maqedonia, duke mbetur kështu Serbia i vetmi fqinj i Kosovës që ende nuk e ka njohur. Që atëherë, njohje kanë arritur nga Afrika (Burkina Faso, Liberia, Sierra Leone, Gambia, Malavi, Mauritania, Somalia), Amerika (Kolumbia, Panama, Republika Dominikane), vendet arabe (Emiratet e Bashkuara, Arabia Saudite, Jordania), Azia (Koreja e Jugut, Malajzia), Oqeania (Zelanda e Re)... Kosovën e kanë njohur gjithsej 69 shtete, nga këto 33 evropiane (22 nga 27 vendet anëtare të BE-së, 24 nga 28 anëtarët e NATO-s). Ritmi i njohjeve u ngadalësua në pritje të vendimit të GjND-së, nga e cila Asambleja e Përgjithshme e KB me kërkesë të Serbisë kishte kërkuar mendimin nëse pavarësia e Kosovës shkelte të drejtë ndërkombëtare. Përgjigja e javës së shkuar në atë pyetje, me të cilën u konfirmua se nuk kishte ndodhur ndryshimi i kufijve (Kosova ka pasur kufij të qartë brenda Serbisë, por edhe brenda Jugosllavisë), se nuk ishte e njëanshme (por, pas shterimit të të gjitha mundësive negociuse për shkak të qëndrimit obstruktiv të Serbisë), se nuk ishte shkelur rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB (e cila kishte vërtetuar se Kosova atëherë ishte pjesë e RStë Jugosllavisë, vendit që nuk ekziston pas pavarësisë së Malit të Zi) dhe kështu nuk u krijua precedenti që kishte shkaktuar zhbërjen e shteteve të tjera, ishte e qartë, edhe pse agjencia serbe Tanjug raportonte rrejshëm mbi “vendimin” kompromis, që shqiptarëve nuk u lejon shkëputjen e Kosovës, dhe që kthen vendimin në Asambelën e Përgjithshme të KB. Dhjetëra vende dhanë shenja se presin vendimin e gjykatës dhe tani pritet njohja e tyre e Kosovës. Ndër to janë disa nga shtetet më të shumta populatë (Bangladeshi, Brazili, Meksiko, Pakistani), disa arabe (Egjipti, Iraku, Jemeni, Katari, Kuvajti, Libani, Maroku), të Amerikës (Kili, Ekuadori, Paraguaji) dhe shtete afrikane (Afrika e Jugut, Etiopia, Gaboni, Gana,

Kenia, Bregu i Fildishtë, Mozambiku, Nigeri, Tanzania, Zambia...) dhe të “botës së tretë”, nga të cilat diplomacia e Jeremiqit pret si kundërpeshë ndaj “diktatit të Perëndimit”. Disa nga shtetet megjithatë nuk do të nguten që të njohin Kosovën – presidenti sllovak (me origjinë kroate) Ivan Gashparoviq, i kishte premtuar Serbisë se edhe nëse vendimi i GJND-së të jetë siç është (qeveria e re në Bratislavë, megjithatë këtu është më pak e vendosur) dhe katër vendet e tjera të BE-së tash për tash janë me Beogradin: më me turp Greqia, më e hapur Spanja e Rumania, vendosmërisht Qipro. Kina është më e matur, por jo e prirur tash ta njoh Prishtinën, si dhe disa vende të tjera të Azisë me popullsi të madhe (India, Indonezia, Filipinet). Me Beogradin është edhe Rusia (e cila mund të ndërrojë mendjen po vazhdoi rrugën Serbia drejt anëtarësimit në NATO), dhe disa vende të tjera të afërta me Moskën dhe që janë në marrëdhënie të këqija ndërmjet vete: Irani dhe Izraeli, Armenia dhe Azerbejxhani. Mendimi i Hagës nuk ka luhatur as popullitët ultra të majtë të Amerikës Latine, Kubën e Kastros, Bolivinë, Venezuelën e Chavezit, e as aleatët arabë të Serbisë, Libinë e Sirinë. Gjeorgjia nuk do të ndijë për pavarësinë e Kosovës për shkak të territoreve të veta të humbura, edhe pse Rusia pavarësisht nga “precedenti” ballkanik ia ka rrëmbyer Osetinë e Jugut dhe Abkhazinë, si ndëshkim për “bërje me sy” të Tbilisit anëtarësimit të mundshëm në NATO. Bosnja e Hercegovina nuk mund të njohë Kosovën, meqë për këtë kundërshton Republika Srpska, kryeministër i së cilës Milorad Dodik vendimin e GJND-së e ka shpjeguar si argument të ri për shkëputje nga BeH. Kjo paralele është absurde, ma ka thënë para disa vitesh edhe ish-ambasadori amerikan në Kroaci, Peter Gallbright, i cili thekson se Kosova është njohur përveç të tjerash edhe pse ishte shtruar gjenocidit (as Franko nuk i kishte “shfarosur” kështu baskët e katalonit”), kurse Republika Srpska nuk është e njohur si viktimë, por si ushtrues gjenocidi. Këtë tezë këto ditë e kanë shtruar edhe disa komentues të guximshëm nga Serbia, si Dinko Gruhonjiq, në portalin Autonomia, duke rikujtuar autoritetet se ndaj tezës “Kosova është Serbi”, gjykata kompetente i është përgjigjur “Kosova është Kosovë”. Millan Marikonviq në portalin e Nishit, Differentia, tërheq vërejtjen ndaj urrejtjes së rrënjosur ndaj shqiptarëve në pjesën më të madhe të opinionit serb, rikujton se veç Serbia i ka paraprirë vlerësimin juridik mbi legalitetin e shtetit të Kosovës (që e përshkruan si “vetëvrasje nga pusia”), dhe fton që të miratohet apeli i diplomacisë kosovare drejtuar Serbisë për negociata, bashkëpunim dhe pajtim. Luftëtarja e paepur e vlerave liberale në Serbi, Vesna Peshiq, në radio emisionin Peshçanik (Ora e rërës) shfaqë dëshpërimin që pas Millosheviqit e Koshtunicës, edhe Boris Tadiq, i cili është më i mirë në krahasim me ata dy, po e çon popullin dhe shtetin e vet nga gremina e fanatizmit tashmë shumë herë më

parë të humbur të “betejës për Kosovën me çdo çmim”. Është e padiskutueshme nga e gjitha që u tha se si Kroacia, me aleatët, duke njohur Kosovën dhe duke argumentuar bazën juridike të vendimit para Gjykatës së KB-së ishte jo vetëm në anën e viktimës dhe të pafuqive në rajon, e njëherësh edhe në anën e të fuqishmëve dhe të rëndësishmëve në botë, në të cilët mbështetemi, por edhe në anën e të drejtës, ja pra edhe formalisht edhe të drejtës ndërkombëtare. E kjo e të drejtës nuk është kundër Serbisë, e asaj çfarë të gjithëve u duhet si fqinj e partnerë – optimiste, të hapur, normale, të zhvilluar, vendit njerëzor që është gjë e mirë të vizitohet, të udhëtohet nëpër të, të bëhet tregti me të, të pranohet nga andej turistë, të bashkëpunohet në turizëm, në kulturë, në sport, në integrimet e pakicave dhe në ballafaqim me të drejtën dhe fajësinë, në të tashmen dhe në të kaluarën. Kjo vështirë është të jetë Serbia në të cilën këto ditë u rrahë gazetari Teofil Pançiç, nëse ky krim nuk do të ndëshkohet ashtu siç nuk janë ndriçuar vrasjet e kolegëve të tij, Dada Vujasinoviqit, më 1994, Sllavko Çurulisë në vitin 2000 dhe Millan Pantiçit në vitin 2001. Në këtë çështje, megjithatë, nuk kemi të drejtë të shikojmë ndaj fqinjit nga lartësia, meqë as tentim vrasja në sulmin e porositur ndaj gazetarit të Jutranji Listit, Dushan Milushit, nuk është proceduar, edhe pse ka herë kanë kaluar datat qysh kur Tomisllav Karamarko ka paralajmëruar se kjo do të ndodhë.

NGA DISA LETRA....

LETËR NGA SHKRIMTARJA SHQIPTARE, ILIRIANA SULKUQI

Z. Flori,

Irespektuar, i mirënjohur, jo vetëm nga unë, por edhe nga të gjithë ata (ato) që ti, mik, me bujarinë tënde prej krijuesi dhe botuesi, i bëre të kenë flatra për të fluturuar, pa dallime kohore, vërtetësisht në histori apo vërtetësisht në cilësi krijuese (ca të lindura prej gjeneze e ndonjë të marra hua ...) -ju falem shumëherë me të njëjtin Falënderim: -jo vetëm për krijimet tuaja të mirëfillta, në shërbim të së ardhmes, por edhe për publikimin e gjithçkaje që shkruhet, nga secili prej nesh, pavarësisht se kujt kohe i përkasim (në ide apo në moshë). Falënderit, shumëfish, për poezinë kushtuar Nënës suaj, e cila tashmë është së bashku me të tjerë bij nënash-krijues.

Jo vetëm kaq. E vetmja e vogël-Elisa, në klasën e dytë fillore -Prishtinë, është midis emrave të të rriturve, me poezinë e saj për Nënë. Se dashuria për Nënë, mik i dashur, fillon që në fëmijëri, pavarësisht nga fjalët poetike, që mund t'ia themi në rritje e sipër...Nëna, miku im Flori, fillon në fillim të dashurisë për Botën.

Shumë falënderit , që u bëtë pjesë e një “Karvan Dashurie” për Nënë!

Sa të ketë lindje- në këtë botë-do të ketë gjithmonë NËNA.

Përgjithmonë!...

Iliriana Sulkuqi, Brooklyn, 30 maj, 2011

LETËR NGA SHKRIMTARI SHQIPTAR NË BELGJIKË, ENGJËLL SHEHU

Ju, i nderuari miku im, Flori, jeni domethënia e letërsisë shqiptare. Në veprat tuaja letrare i jepni dritë letërsisë dhe çështjes mbarëkombëtare, asaj të Pavarësisë së Kosovës, edhe pse disa hijena dhe antishqiptërë duan të hedhin baltë mbi juve. Peronaliteti juaj dhe emri juaj ngrihet fuqishëm dhe i pastër, si vetë shpirti juaj i kulluar, për të mirën e mbarëkombëtares.

Unë të uroj sukses të mëtejshëm në punën tënde të mrekullushme në publikimet e librave, materialeve domethënëse në internet, ku gjejmë relitetin e shoqërisë dhe të vërtetën e historisë sonë kombëtare.

Juve, duke vazhduar si gjithmonë në rrugën e shkrimeve të tua në internet, i shërbeni të vërtetës, duke demaskuar meskinët, mashtruesit e internetit, tashmë të vetëshpallur si poetë dhe poetesha, si shoqata grash e shoqata mështuesesh, që nuk bëjnë gjë tjetër, por vetëm demaskojnë veten e tyre në rrugën e shpifjeve dhe sajimeve, ku ato janë futur dhe se zor do të dalin nga ajo çorbë që po bëjnë. Ata mburrin dhe lavdërojnë njëri-tjetrin për t'u dukur së janë dikushi, e në të vërtetë nuk i njeh askushi.

Juve, jam i bindur, miku im Flori, se do t'i demaskoni këto hijena dhe llafazanë të internetit, për të mos i lënë të shtrëmbërojnë realitetin dhe të mashtrojnë opinionin. Duke i kritikuar këto dhe këta tipa fantazmë, që tani kanë vendosur emrin e tyre, e që dalëngadalë u harrohet fare, nga mëkatet e shkrimeve pa moral, juve do t'i tregoni opinionit se asnjëherë mashtrimi dhe shpifja nuk fiton ndaj moralit dhe aftësisë. Asnjëherë intriga dhe servilizmi nuk fiton nga e vërteta dhe e thëna ballë për ballë, ashtu si është në realitet.

Forumet e lartëpërmendura, ku unë jam regjistruar, ose siç i quaj unë furriqe, janë mbledhur një pjesë njerëzish, që për të treguar se dinë edhe ata të shkruajnë apo të krijojnë, ata shajnë, shpifin, mburrin njëri-tjetrin, përdorin fjalor vulgar e banal, si dhe sulmojnë intelektualë e njerëz të zot, meqë ata nuk janë të zotët të prezantohen me dinjitet.

I nderuar miku im Flori, të uroj suksese në shkrime dhe mbarësi në jetë e familje...

Miqësisht Engjëll M. Shehu.(shkrimtar nga Belgjika)

LETËR NGA PUBLICISTI, ADNAN ABRASHI

I nderuar miku im Flori,

Fillimisht të përshëndes dhe të uroj, në rend të parë, shëndet dhe të gjitha të mirat në jetë. Librin tënd të ri që ma dërgove në pdf, e pranova dhe jam në lexim e sipër.

Desha të të shkruajë pasi ta lexojë atë, por nuk munda ta bërballoja sfidën që më shtyente të të lajmërohem sa më shpejtë dhe të falënderohem për konsideratën tënde të madhe dhe vlerësimin e lartë që ke për punën time në publicistikë.

Në mesin e shumë intelektualëve dhe njerëzve të mirëfilltë të letrave dhe penës, aty më kishe klasifikuaë edhe mua. U befasova nga pak, por edhe u ndjeva krenar, posaqërisht kur një vlerësim i tillë bëhet nga një krijues dhe njohës shumë i mirë i kësaj fushe të krijimtarisë artistike. Edhe një herë të falënderoj nga zemra dhe të vërtetoj se respekti për njëri-tjetrin, pa dyshim është i dyanshëm.

Të lakmoj për enërgjinë e madhe krijuese që ke dhe të inkurajoj që me këtë elan dhe intensitet të shtuar kreativ të vazhdosh edhe në të ardhmen.

Me nderime dhe respekt,

Adnan Abrashi, publicist nga Prizreni (Kosovë)

LETËR NGA SHKRIMTARI NË GJERMANI, PAL SOKOLI

I nderuari Flori Bruqi!

Uroj të jeni mirë edhe ju personalisht dhe familjarisht. Për Librin e ri ju përgëzoj. Por, që kam edhe unë një vend të merituar aty, ju falënderoj për konsideratën dhe ju uroj suksese të reja në veprimatrinë e mëtutjeshme. Mundësisht më tregoni se si mund ta siguroj këtë libër pasi të botohet. Përsëndetje dhe suksese.

Pal Sokoli,shkrimtar nga Gjermania

LETËR NGA PUBLICISTI DEMIR RESHITI

I dashur Flori,

Të përgëzoj për shkrimin. Krijues si Iljaz Prokshi e meritojnë këtë, madje meritojnë edhe shumë më tepër. Do të duhej një përkujdesje institucionale, që veprat e tij të lëna në dorëshkrim të botohen.

Duke të përgëzuar edhe njëherë për angazhimin që ke bërë e po bën për mbajtjen gjallë të figurave të tilla, që i kanë dhënë mjaft kombit dhe letërsisë, të përshëndes me dëshirën që të të prijë shëndeti dhe e mbara...

Miqësisht, Demir Reshiti (shkrimtar dhe publicist nga Prishtina)

PËRMBAJTJA

VEPËR VËSHTRIMESH KRITIKE DHE SHUMËSHTRËSIMESH LETRARE, 5
NJË PERSONALITET I SHQUAR I KULTURËS SHQIPTARE, 9

CIKËL POETIK

FILLIMI I NJË POEME, 15
PORTRETI I NËNËS
RREZE DRITE
LAJTMOTIV I SINQERTË
LIRI FJALE
QYTETI KU TË PRITA
AKUARELI I DIELLIT
MENDIM I KREDHUR
REKUIEM I PËRLIGJUR
SHPRESA TË DJEGURA
Ç'RËNDËSI KISHTE E KA GJITHÇKA?!
MBI NGJARJE...
BARDHËSITË E SAJ
RRJEDHAT E KOSOVËS
RELIKTET TONA
AGIMET E KOSOVËS
GJAK SHEKULLOR

KRITIKË LETRARE NË SHTYPIN E KOHËS...

FATI I GAZETARËVE NË SISTEMIN MONIST, 37
SHQIPFOLËSIT E BARBARIZUAR, 38
KUKUDHËT NË KOHËN E MONIZMIT, 39
CENSURA SHQIP, 40
GJURMË QË MBESIN NË FATET E HIDHURA TË SHQIPTARËVE, 41
GJEOGRAFIA E ATDHEUT, 42
POEZI E NËNQIELLIT DHE NJERIUT PA LIRI..., 43
POEZI E SHQETËSIMIT DHE GJAKIMIT PËR LIRINË, 44
PËRGJIGJE KRASISTËVE TË HISTORISË SHQIPTARE, 45
BURRI DHE GRUAJA, LIBËR KËSHILLASH PËR BASHKËJETESË FAMILJARE, 47
BURRI DHE GRUAJ, LIBËR QË LEXOHEM ME DASHURI PËR DASHURINË, 48
SFIDIMET PËR LIRINË, 49
PROZË E REALITETIT ARTISTIK, 50
TRAGJIKA E SERVILËVE TË NJË KOHE TË PERËNDUAR, 51
VEPËR ME INTERES TË GJERË LETRAR, 53

LIBRI “VADEMECUM DDD”, I AUTORIT FLORI BRUQI, I VEÇANTË NË FUSHËN PROFESIONALE, 56
PROZË E NJË KOHE TRAGJIKE, 58
NË TIRANË, RIBOTOHET ROMANI “VRASËSIT E LIRIDONËVE”, 61
U PROMOVUA LIBRI “GUXIM SHQIPTAR” I AUTORIT FORI BRUQI, 62
SFIDA SHKENCORE TË NJË LIBRI TË GUXIMSHËM..., 63
TË DISH TË GUXOSH..., 78
LUFTA E OPINIONEVE, 84
LIBËR QË SPIKAT ME TEMATIKËN DHE GJERËSINË NJOHËSE TË SHUMË FAKTEVE E TË VËRTETASH, 86
NGA FORMA ELEKTRONIKE TE FORMA E SHTYPUR, 87
ZBARDHJE E ÇËSHTJES KOMBËTARE ËSHTË NË LIBRIN STUBIMOR TË FLORI BRUQIT “FLORI BRUQIT”, 89
PIKËPAMJE NGA OLIMPI I MENDIMIT SHQIPTAR, 90
REAGIME DHE POLEMIKA, QË SFIDOJNË TË PAVËRTETAT SERBE TË KOHËS?!..., 92
NJË SYTH SHPIRTI NË AKUARELIN E NJË KOSOVARI, 94
NJË PUBLIKIM SERIOZ DHE I VLERËSUESHËM NË FUSHËN E DIJES SHQIPTARE, “OLIMPI SHQIPTAR”, I FLORI BRUQIT, 98
LETËRSIA SI “AKSION” KOMUNIKIMI, 107
FLORI BRUQI - TRIUMF SHQIPTAR, 111
DOLI NGA SHTYPI “OLIMP SHQIPTAR” ME AUTOR FLORI BRUQIN, 113
NJERIU QË SHTROI SHINAT E “OLIMPIT” SHQIPTAR, 114
POEMA E DRITËS, 120

VËSHTRIME KRITIKE PËR VEPRAT LETRARE

ZIGMUND FROJDI DHE NDIKIMET E TIJ NË TEORITË SEKSUALE SI DHE NË LETËRSI, 125
HEMINGUEJ, SHKRIMTARI I DY LUFTËRAVE, 130
SERGEI A. ESENIN (1895-1920): U DËRGOJ PËRULËSISHT TË FALA GJITHË LEXUESVE DHE PAKËZ VËMENDJE PËRPARA TABELËS “JU LUTEM MOS QËLLONI!”, 132
NË VEND TË PËRKUJTIMIT... ALBERT KAMY (1913-1960), 144
DR IBRAHIM RUGOVA, KULTIVUES I MODERNITETIT, 150
NËNË TEREZA, NDERI I KOMBIT SHQIPTAR, 156
ERNEST KOLIQUI (1901-1975), 159
SHQIPJA BURIMORE, SHËNON NJË MODEL TË RI NË VEPRAT LETRARE TË MARTIN CAMAJT, 164
EQREM ÇABEJ- JETA DHE VEPRA, 184
ISMAIL KADARE, SHKRIMTARI EPOKË I SHQIPTARËVE, 188
NË SHENJË RESPEKTI PËR SHKRIMTARIN TONË TË MADH, AZEM SHKRELIN (1938-1997), 194

NAIM KELMENDI, SHKRIMTAR E POET I VLERAVE TË LARTA POETIKE:”NË VEND TË ASGJËSË”, 208
REFLEKSIONE (RI) LEXIMI PËR STUDIUESIN ERUDIT PREND BUZHALA, 227
RRËFIMI PALIATIV, 229
LIRIKA E INTELIGJENCËS EMOCIONALE, 236
ROMANI “PASIO” I ANTON GOJÇAJT, 242
SHKRIMTARI THANI NAQO DHE ROMANI I TIJ I RI “MURMASHËT, 245
NË GJUNJË, JO, KURRË S’MË ULËN!..., 257
BUQETË LIRIKASH NGA POETI,MIKU IM I MIRË, JORGO SOFOKLI TELO, 259
PËR FËMIJËRINË DHE NËNOCKËN QË MË RRI TI ME HALLE, 263
I PREMTOVE SHPIRTIT NJË SERENATË..., 269
BARDH FRANGU,EMËR I NDRITUR NË LETËRSINË SHQIPE, 274
IRENA GJONI,NJË ZË QË PO VJEN NË POEZINË SHQIPE, 278
LEDIANA KAPAJ,ZË I VEÇANTË POETIK, 286
DEGËT LARG TRUPIT I THYEN ERA?!..., 294
PËR FLAMUR, SHQIPTARI S’FAL..., 297
DURRSAKJA REBELE ..., 304
VALDETE BERISHA DHE POEZIA E NDJENJËS DHE VEGIMEVE EMOCIONALE, 307
NURIE ZEKAJ, NJË ZË POETIK QË U SHUA HERËT, 312
ILIRIANA SULKUQI: ‘PYEJE PA PËRGJIGJE’, 315
PROMETHEU SHQIPTAR-ADEM JASHARI DHE SHTRATI I POEMËS
NACIONALE, 322
SHKRIMTARI IDEALIST SHQIPTAR GJATË SHEKULLIT XX, 327
SHQIPTARËT NË SHTYPIN ARAB, 334
HISTORIK I SHKURTËR I GJUHËS SHQIPE, 346
KRITIKA TANI NGJAN NË NJË DIGË TË SHPARTALLUAR, QË I VAREN
LLAMARINAT NGA ERËRAT E FITIMIT, 351
MASAKRA E TIVARIT..., 369
SPASTRIMI ETNIK NË KOSOVË, 374
TOKA E HUAJ, S’BËHET E JOTJA!, 377

NGA DISA LETRA....

LETËR NGA SHKRIMTARJA SHQIPTARE, ILIRIANA SULKUQI, 387
LETËR NGA SHKRIMTARI SHQIPTAR NË BELGJIKË, ENGJËLL SHEHU, 388
LETËR NGA PUBLICISTI, ADNAN ABRASHI,389
LETËR NGA SHKRIMTARI NË GJERMANI, PAL SOKOLI, 390
LETËR NGA PUBLICISTI DEMIR RESHITI, 391

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-92

Bruqi, Flori

Nëse kam ditur të guxoj : (poezi...për krijimtarinë letrare e publicistike në kohë...vështrime kritike ...letra...) / Flori Bruqi. - Prishtinë : Rugova Art, 2012. - 395 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-536-23-3

NGA I NJËTI AUTOR

1. Zjarri i diellit, poezi, Prishtinë, 1995.
 2. Ndërgjegjja, roman, Prishtinë, 1995.
 3. Vrasësit e liridonëve, roman, Prishtinë, Tiranë, 1996.
 5. Ringjallja, roman, Tiranë, Prishtinë, 1996.
 6. Gjarpërinjtë e pallatit, roman, Tiranë, Prishtinë, 1996.
 7. Dorëzeza, roman, Tiranë, Prishtinë, 1997.
 8. Tokë e djegur, roman, Shkodër, Tiranë, Prishtinë, 1998.
 9. Burri dhe gruaja, libër shkencor, Tiranë, Prishtinë, 2000.
 10. Pallati i akeronit, roman, Tiranë, Prishtinë, Neë York, 2000.
 11. Vademecum DDD, libër shkencor, Prishtinë, 2002.
 12. Struktura faktoriale e dimensioneve antropometrike dhe fiziologjike, Prishtinë, 2004.
 13. Ndikimi i sportit në personalitetin e njeriut, libër shkencor, Prishtinë, 2004.
 14. Delinkuenca e të miturve dhe ushtrimet fizike, Prishtinë, 2004.
 15. Vademecum për preparate higjienike të "Schulke – Mayr" – it, libër shkencor, Prishtinë, 2004.
 16. Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe josportistë para dhe pas vrapimit 400 metra (Punim magjistrature, Prishtinë 2005).
 17. Antropometri-Jakov Milaj "Raca shqiptare", recension i zgjeruar, botuar në Floart, 2005.
 18. Si ta njohim internetin, Flomed, tetor-2005.
 19. Sëmundjet infektive seksuale, Floart, tetor-2005.
 20. Udhëzues i shkurtër i preparateve dezinfektuese, Flomed, 2006.
 21. Merruni me sport dhe ushtrime fizike për t'u relaksuar, Floart, janar 2006.
 22. Kosova nuk është i berzë e zezë, Floart, dhjetor 2005.
 23. Fshehtësitë dhe të vërtetat për virusin avian', Flomed, 2005.
 24. The economic aspects of sports recreation and health, sport ritmi-zemrës, janar 2006, etj.
 25. Determinantat socio-psikologjike të ushtrimit fizik (Hulumtim socio-psiko-kineziologjikë më studentët e Universitetit të Prishtinës), Flomed, 2006.
 26. Guxim shqiptar, Prishtinë, 2008.
 27. Olimpi shqiptar, Prishtinë, 2009
 28. Polemika shqip, Prishtinë, 2009
 29. Triumfi shqiptar, Prishtinë, 2010
 30. Nëse kam ditur të guxoj, Prishtinë, 2011
- Ka botuar 21 fejtone publicistiko-shkencore në gazetën "Rilindja" të Prishtinës, në periudhën 1974-1982, si dhe mijëra punime në shumë veb faqe interneti (2003-2008).

ISBN 978-9951-536-23-3



9 789951 536233